UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË

DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

BARRA E PROVËS DHE STANDARDI I TË PROVUARIT NË PROCESIN PENAL. VËSHTRIM TEORIK DHE PRAKTIK

KAND/DOKTOR:
OLGERT RUMNICI

UDHËHEQËS
PROF.AS.DR. SKERDIAN KURTI

DHJETOR, 2022

© **E drejta e autorit**: Olgert RUMNICI, 2022.
Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, shpërndarje, fotokopjim, kopjim, përkthim, përshtatje, përdorje dhe çdo formë tjetër qarkullimi tregtar apo çdo veprimtari tjetër e cila cënon të drejtën e autorit, pa lejen përkatëse të tij.

Mirënjohje

Dëshiroj të shpreh një mirënjohje të thellë dhe të sinqertë për profesorin Skerdian KURTI, falë mbështetjes dhe këmbënguljes së të cilit është përmbushur ky proces doktoral.

Një mirënjohje të veçantë shpreh për familjen time, e cila me shumë durim ka qenë pranë meje gjatë rrugëtimit të këtij procesi.

Gjithashtu, dëshiroj të shpreh falenderime për të gjithë kolegët dhe profesorët që më kanë mbështetur, të cilët realisht janë të shumtë dhe për të cilët, vetëm përmendja e secilit në këto pak rreshta, thjesht do të ishte e pamjaftueshme.

Përmbajtja

Akronime dhe Shkurtesa i
Abstrakt ii
Abstract iii
Qëllimi dhe objektivat e disertacionit iv
Metodologjia e përdorur vi
Struktura e disertacionit viii
KREU I 1
Barra e provës dhe standardi i të provuarit. Evolucioni historik 1
1.1 Kuptimi i barrës së provës dhe standardit të të provuarit. 1
1.2 Historiku i barrës së provës dhe standardit të të provuarit 4
1.2.1 Në Athinën antike 4
1.2.2 Në Romën antike 4
1.2.3 Në të drejtën e Sheriatit 5
1.2.4 Në të drejtën kanonike 6
1.2.5 Në mesjetë 7
1.2.6 Në sistemin anglo - sakson 8
1.2.6.1 Si vlerësonte juria 9
1.2.6.2 Rruga deri te arsyetimi i standardit 10
1.2.6.3 Dilema paramoderne dhe konfuzioni i sotëm 11
1.2.7 Në të drejtën shqiptare 12
1.3 Barra e proves dhe standardi i të provuarit në KPrP të vitit 1980 13
KREU II 16
Barra e provës dhe standardi i të provuarit në procesin penal bashkëkohor 16
2.1 E vërteta në procesin penal 16
2.2 Dallimi midis common law dhe së drejtës kontinentale 20
2.2.1 Vlerësimi i provave në juridiksionet e së drejtës kontinentale 20
2.2.2 Standardi i të provuarit në juridiksionet e së drejtës kontinentale 22
2.2.3 Barra e provës në juridiksionet e së drejtës kontinentale 23
2.2.4 Barra dhe standardi i të provuarit në juridiksionin e common law. 27
2.3 Dallimi ndërmjet barrës së provës dhe standardit të të provuarit të aplikuar në procesin civil dhe të atij të aplikuar në procesin penal. 28
2.3.1 Barra e provës në procesin civil krahasuar me procesin penal 29
2.3.2 Standardi i të provuarit në procesin civil krahasuar me procesin penal 31
2.3.3 Prezumimet në procesin civil krahasuar me procesin penal 37
2.3.4 Efektet e vendimeve penale dhe civile/administrative 39
2.3.5 Padia civile në procesin penal 40
KREU III 45

Barra e provës dhe standardi i të provuarit në fazën e hetimeve paraprake.....45

3.1 Standarde të ndryshme apo vetëm një standard..... 45

3.1.1 Vendimi për regjistrimin e procedimit penal dhe vendimi për mosfillimin e procedimit penal..... 56

3.2 Dyshimi arsyeshëm – standard kryesor në hetimet paraprake për kufizimin e lirisë..... 61

3.2.1 Kufizimi i lirisë si pjesë e procesit penal..... 61

3.2.2 Në përgjithësi mbi arrestimin në flagrancë dhe ndalimin e të dyshuarit për një krim... 65

3.2.3 Arrestimi në flagrancë..... 66

3.2.3.1 Kuptimi i arrestimit të kryer nga qytetarët (citizen's arrest).....71

3.2.4 Ndalimi i të dyshuarit për një krim..... 74

3.3 Dyshimi i arsyeshëm për caktimin e masave të sigurimit..... 81

3.4 Marrja e personit si i pandehur dhe dërgimi i çështjes në gjykatë..... 96

3.4.1 Të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur..... 96

3.4.2 Kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq..... 99

3.4.3 Kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e çështjes104

3.5 Standardi i zbatueshëm në vendimmarrjet për kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake..... 107

3.5.1 Përgjimi..... 107

3.5.2 Kontrollet..... 119

3.5.3 Sekuestrimi..... 123

3.5.3.1 Sekuestrimi si mjet kërkimi prove 123

3.5.3.2 Sekuestrimi si masë sigurimi 125

KREU IV.....128

Barra e provës dhe standardi i aplikuar gjatë gjykimit në themel të çështjes...128

4.1 Kuptimi i standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm..... 128

4.2 Parimi in dubio pro reo (dyshimet ne favor të të pandehurit)..... 136

4.3 Barra e provës..... 142

4.3.1 Përjashtime të barrës së provës..... 145

4.4 Vlerësimi i provave dhe formimi i bindjes së brendshme të gjyqtarit..... 157

4.4.1 Vlerësimi i indicjeve në procesin penal..... 161

Kreu V.....167

Prezumimet në procesin penal.....167

5.1 Kuptim i përgjithshëm i prezumimeve në procesin penal. Raporti me barrën e provës dhe standardin e të provuarit..... 167

5.1.1 Kuptimi i prezumimeve..... 168

5.1.2 Qendrimet e ndryshme mbi ekzistencën e prezumimeve..... 169

5.1.3 Qëllimi i prezumimeve..... 169

5.1.4 Kushtetutshmëria e prezumimeve..... 170

5.1.4.1 Në sistemin ligjor italian.....170

5.1.4.2 Në praktikën e GJEDNJ 171
5.1.4.3 Në sistemin ligjor të BE-së 171
5.1.4.4 Në sistemin common law (Gjykata Supreme e SHBA) 171
5.1.5 Llojet e prezumimeve 173
5.1.6 Efekti i prezumimeve në barrën e proves dhe standardin e të provuarit 174
5.2 Prezumimet ligjore në legjislacionin penal dhe prezumimet e faktit 178
5.2.1 Parimet e procesit penal dhe prezumimet ligjore 178
5.2.1.1 Prezumimi i njohjes së ligjit 179
5.2.1.2 Prezumimi i rrezikshmërisë shoqërore 180
5.2.1.3 Prezumimi i rrezikut. Veprat penale që rrezikojnë 182
5.2.1.4 Prezumimi i moshës së mitur 184
5.2.1.5 Prezumimet ligjore të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale 185
5.2.2 Prezumimet e faktit dhe mekanizmi prezumues te indicjet 190
5.2.2.1 Prezumimet e faktit bazuar në heshtjen (sjelljen) e të pandehurit 191
5.2.2.2 Prezumimet faktike në praktikën gjyqësore shqiptare 194
5.3 Ndikimi i interpretimeve gjyqësore në krijimin e prezumimeve 199
5.3.1 Roli i gjykatës në interpretimin e ligjit 200
5.3.2 Prezumimet si rrjedhim i interpretimit 201
5.3.2.1 Vendimi unifikues mbi veprën penale vazhduese 201
5.3.2.2 Vendimi unifikues mbi pozitën e bashkëekzekutorit 204
5.3.2.3 Vendimi unifikues mbi bashkëpunëtorin e panjohur 206
5.3.2.4 Vendimi unifikues mbi trafikimin e lëndëve narkotike 207
5.3.2.5 Vendimi unifikues mbi vjedhjen me pasojë vdekjen 209
PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME 212
BIBLIOGRAFI 223

Akronime dhe Shkurtesa

KPrP – Kodi i Procedurës Penale
KP- Kodi Penal
KPrAd-Kodi i Procedurave Administrative
KPrP italian – Kodi i Procedurës Penale italiane
GJEDNJ- Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut
KEDNJ- Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
KPrC- Kodi i Procedurës Civile
OKB-Organizata e Kombeve të Bashkuara
BE- Bashkimi Europian
OPGJ-Oficer i policisë gjyqësore
SHISH- Shërbimi Informativ Shtetëror
DPQ, DVP-Drejtoria e Policisë së Qarkut, Drejtoria Vendore e Policisë
IPSH- Instituti i Policisë Shkencore
RSH- Republika e Shqipërisë
ShBA-Shtetet e Bashkuara të Amerikës
MB-Mbretëria e Bashkuar
Shek.- Shekull
Psh.- Për shembull
Dmth.- Do me thënë
B.fj- Bie fjala
Etj. –E të tjerë

Abstrakt

Në këtë studim trajtohen konceptet e barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesi penal, si dy mekanizma që sigurojnë zbatimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në procesin penal. Interpretimi sistematik i neneve 4, 8 dhe 390 të KPrP mund të përcjellë një ide lidhur me mënyrën e funksionimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesin penal, megjithatë për studimin e plotë të tyre është e nevojshme që këto institute të trajtohen në përqasje me doktrinën dhe praktikën gjyqësore të viteve të fundit.

Përgjithësisht, barra e provës dhe standardi i të provuarit konsiderohen detyrime të organeve proceduese, por, siç do të shohim përgjatë punimit, jo gjithnjë është kështu, pasi përjashtime të caktuara i atribuojnë të pandehurit një rol më aktiv në procesin penal.

Rëndësia e trajtimit të këtyre instituteve qendron në faktin që, në varësi të sistemit ligjor të zgjedhur, balanca e drejtësisë mund të anojë kah interesave të publikut dhe/ose shtetit përmes synimit të rritjes së efektivitetit në zbatimin të ligjit penal ose në anën e kundërt–në drejtim të garantimit më të mirë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Sistemet e përziera, ashtu sikundër mund të interpretohet sistemi ynë i procedurës penale, synojnë të gjejnë drejtpeshimin e duhur të këtyre interesave.

Në procedurën penale, barra e provës dhe standardi i të provuarit karakterizohen nga një marrëdhënie dinamike me procesin penal. Nëse në një vështrim sipërfaqësor të procesit penal, kjo marrëdhënie mund të duket pa probleme të dukshme, në një vëzhgim të kujdesshëm substancial rezulton se si barra e provës, ashtu edhe standardi i të provuarit nuk janë koncepte statike, të ngurta. Kjo karakteristikë në fakt i detyrohet kontradiktoritetit dhe dialektikës së procesit penal.

Barra e provës zbërthehet në kuptimin më të plotë të saj në gjykimin e themelit të çështjes, aty ku prokurori mbart barrën e provës të provojë fajësinë e të pandehurit. Ajo i imponon prokurorit detyrimin që edhe në hetimet parprake apo vendimmarrjet në këtë fazë të mbledhë jo vetëm provat që synojnë fajësinë e të pandehurit, por edhe ato që e shfajësojnë. Paralelisht me barrën e provës, standardi i të provuarit paraqitet në disa nivele të ndryshme në varësi të fazës konkrete të procesit penal; ai ndryshon me avancimin e fazave të procesit penal. Por, sikundër çdo rregulli të përgjithshëm, edhe rregullat mbi barrën e provës dhe standardit të të provuarit kanë përjashtimet e tyre, herë të përcaktuara nga ligjvënësi, herë të vendosura nga praktika e gjykatave. Në këtë drejtim, prezumimet në procesin penal, janë një ilustrim i përjashtimeve të barrës së provës dhe standardit të të provuarit.

Fusha e studimit*: procedurë penale, e drejtë penale*
Fjalë kyçe*: barra e provës, standardi i të provuarit, proces penal, hetime paraprake, seancë paraprake, gjykimi në themel, prezumime*

Abstract

This study deals with the concepts of the burden of proof and the standard of proof in the criminal process, as two mechanisms that ensure the application of the principle of presumption of innocence in the criminal process. The systematic interpretation of articles 4, 8 and 390 of the Criminal Procedure Code can convey an idea about the functioning of the burden of proof and the standard of proof in the criminal process, however, for their complete study it is necessary that these institutes be treated in approach to the doctrine and judicial practice of recent years.

In general, the burden of proof and the standard of proof are considered obligations of the prosecuting bodies, but, as we will see throughout the paper, this is not always the case, as certain exceptions attribute to the defendant a more active role in the criminal process.

The importance of dealing with these institutes lies in the fact that, depending on the chosen legal system, the balance of justice can tilt towards the interests of the public and/or the state through the aim of increasing the effectiveness of the implementation of the criminal law or in the opposite direction - in the direction of better guaranteeing human rights and freedoms. Mixed systems, as our system of criminal procedure can be interpreted, aim to find the right balance of these interests.

In criminal proceedings, the burden of proof and the standard of proof are characterized by a dynamic relationship with the criminal process. If on a superficial look at the criminal process, this relationship may seem without obvious problems, on a careful substantive observation it turns out that both the burden of proof and the standard of proof are not static, rigid concepts. This characteristic is actually due to the principle of contradiction and the dialectic of the criminal process.

The burden of proof unfolds its fullest sense in the trial of the merits of the case, where the prosecutor bears the burden of proof to prove the defendant's guilt. It imposes on the prosecutor the obligation to collect not only the evidence aimed at the defendant's guilt, but also those that exonerate him, even in the preliminary investigations or decision-making at this stage. Parallel to the burden of proof, the standard of proof is presented at several different levels depending on the concrete phase of the criminal process; it changes as the stages of the criminal process progress. But, like any general rule, the rules on the burden of proof and the standard of proof have their exceptions, sometimes defined by the legislator, sometimes established by the practice of the courts. In this regard, presumptions in the criminal process are an illustration of the exceptions to the burden of proof and the standard of proof.

Field of study: *criminal procedure, criminal law*
Keywords: *burden of proof, standard of proof, criminal process, preliminary investigations, preliminary hearing, trial on the merits, presumptions*

Qëllimi dhe objektivat e disertacionit

Në këtë disertacion është bërë përpjekje për studimin e barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesin penal, duke përfshirë fazën e hetimit paraprak dhe fazën e gjykimit. Studimi është kryer në përqasje me doktrinën dhe jurisprudencën e gjykatave të vendit tonë, si edhe atyre të huaja, veçanërisht të sistemit italian të procedurës penale, por edhe të familjes ligjore common law. Interesi im për këtë tematikë është i hershëm, që prej studimeve në Shkollën e Magjistraturës, dhe kulminon me këtë studim, të pasuruar me trajtime të legjislacionit, praktikave gjyqësore dhe prezumimeve. Kjo temë përbën interes të veçantë nga pozita e subjekteve të procesit penal *prokuror-gjykatë-mbrojtës* për shkak se ka lidhje të drejtpërdrejtë me mënyrën se si duhet të zhvillohet e çfarë synon të arrijë procesi i të provuarit, i mirënjohur si pjesa më e rëndësishme e procesit penal, dhe se si duhet t'i qaset prokurori respektimit të prezumimit të pafajësisë. Ky studim paraqet një version të rishikuar, ripunuar dhe azhornuar të studimit të kryer në përfundim të Shkollës së Magjistraturës me temë: "*Standardi i të provuarit në procesin penal dhe praktika gjyqësore*". Përpos evidentimit të ndryshimeve legjislative të KPrP, veçanërisht ato të vitit 2017, doktrinave dhe praktikave të reja gjyqësore, pjesë e rëndësishme integrale e disertacionit janë edhe përjashtimet e barrës së provës dhe standardit të të provuarit, që i shërbejnë kuptimit më të drejtë të dinamikës së procesit penal. Në këtë drejtim, një fokus i veçantë i është kushtuar konceptit të prezumimeve në procesin penal dhe ndërveprimit të tyre me barrën e provës dhe standardin e të provuarit.

Disertacioni është hartuar në formë të atillë që përmes tij, të jepet një kontribut modest në dy planet e së drejtës, në rrafshin doktrinor dhe atë jurisprudencial, ku edhe pas vitesh kërkimesh e studimesh më rezulton se trajtimet e natyrës teorike dhe praktika gjyqësore nuk janë ende të thelluara në këtë fushë studimi. Të studiosh barrën e provës dhe standardin e të provuarit është një operacion, që sipas gjykimit tim, përpiqet të zbërthejë thelbin dhe logjikën e procesit penal, duke njohur rëndësinë dhe rolin e çdo pale të procesit. Në një kuptim të përgjithshëm realizimi i këtij studimi synon t'u japë përgjigje tri pyetjeve themelore *Çfarë duhet provuar, Kush duhet të provojë* dhe *Cili është standardi i të provuarit*. Qëllimi i studimit është të evidentojë se në rastet kur mund t'i kufizohet *liria ose një e drejtë tjetër* një individi, në kuadër të një vendimmarrje të prokurorit apo gjykatës gjatë hetimeve paraprake duhet detyrimisht të respektohet një standard i caktuar që ta përligjë këtë kufizim; po ashtu, gjatë gjykimit të themelit fajësia e dënimi i të pandehurit duhet të jetë rezultat i përmbushjes së barrës së provës dhe zbatimit të një standardi të caktuar të të provuarit. Përmbushja e këtij qëllimi i shërben misionit të dhënies së drejtësisë nëpërmjet shmangies së gabimeve gjyqësore. Realizimi i qëllimit të mësipërm është konceptuar me detajimin e objektivave konkrete, që përkojnë me krerët e këtij disertacioni.

Së pari, evidentimi i standardit të provuarit dhe barrës së provës në fazën e hetimeve paraprake, duke përfshirë vendimmarrjet më të rëndësishme të prokurorit dhe gjykatës,

Së dyti, evidentimi i standardit të të provuarit dhe barrës së provës në seancën paraprake si një risi e legjislacionit procedural, ku pozita e gjyqtarit të seancës paraprake është konceptuar si një proces ndërmjetës ndërmjet fazës së hetimit dhe fazës së gjykimit

Së treti, evidentimi i standardit të të provuarit dhe barrës së provës në veprimet procedurale e hetimore të rëndësishme, kryesisht gjatë fazës së hetimeve paraprake

Së katërti evidentimi i standarit të të provuarit dhe barrës së provës në gjykimin e themelit të çështjes, me theks të veçantë përcaktimi i fajësisë së të pandehurit

Së pesti, evidentimi i prezumimeve në procesin penal, të trajtuara si përjashtime të barrës së provës dhe standardit të të provuarit.

Metodologjia e përdorur

Metodologjia në realizimin e një studimi shkencor nënkupton tërësinë e metodave të përdorura për arritjen e qëllimit të studimit dhe objektivave të tij. Metodat e përdorura, në varësi të kategorizimit të tyre, konsistojnë në zbatimin e atyre rregullave dhe parimeve që shërbejnë për të shpjeguar dukuri të caktuara, e në këtë drejtim ato janë të lidhura me natyrën e studimit dhe fushën e shkencës në të cilën bën pjesë studimi.

Duke u nisur nga natyra e këtij studimi, që bën pjesë në fushën e shkencës juridiko-penale, kryesisht në atë procedurale penale, metodologjia e përdorur është specifike, në kuptimin që janë përdorur ato metoda kërkimi, të cilat shërbejnë për kuptimin dhe trajtimin e institutit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesin penal.

Kryerja e këtij studimi ka kaluar në një proces relativisht të gjatë grumbullimi të materialeve akademike relevante me temën e studimit, kryesisht e përbërë nga burime të huaja si literaturë e shkruar dhe elektronike, por duke administruar njëkohësisht edhe çdo material të vlefshëm akademik vendas. Materialet akademike të grumbulluara, janë përzgjedhur në mënyrë të atillë që të përfshijnë periudha kohore sa më të hershme, të cilat përkojnë me fillesat e trajtimeve të institutit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit dhe deri në përiudhat aktuale, në të cilat trajtohen institutet e mësipërme në këndvështrimin e procesit penal modern. Përzgjedhja dhe selektimi i materialeve akademike ka ndjekur të njëjtë logjikë duke u treguar kujdes i veçantë që ato të shërbejnë për të dhënë informacion mbi zhvillimin kronologjik të institutit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit. Pas këtij procesi, mbi bazën e temës së projektit, janë formuluar idetë/tezat themelore mbi çështjet që janë të nevojshme të trajtohen, duke marrë në konsideratë procesin tonë penal dhe problematikat e tij, strukturën se si duhet të shpalosen këto ide dhe përshtatjen e çdo materiali akademik të përzgjedhur me çështjen përkatëse të trajtuar. Pas dy fazave të mësipërme, studimi ka vijuar me pjesën e rëndësishme të përshkrimit të ideve dhe trajtimit të tyre, rishikimit të tyre në përputhje me ndryshimet legjislative në procedurën penale të vitit 2017, ilustrimin e tyre me praktikën gjyqësore vendase dhe të huaj, si edhe të GJEDNJ, diskutimi dhe analizimi i këtyre të fundit, duke përvijuar me përfundimet dhe rekomandimet përkatëse.

Metoda historike, në bazë të së cilës instituti i barrës së provës dhe standardit të të provuarit studiohet në aspektin e zhvillimit historik, evidentohet që në dy kapitujt e parë të studimit, duke paraqitur një evolucion historik të këtyre instituteve. Por, kjo metodë është përdorur gjerësisht në këtë punim, së bashku me metodën krahasuese, edhe për të evidentuar ndryshimet në praktikën gjyqësore dhe legjislacionin procedural penal. Në këtë drejtim, janë marrë në konsideratë ndryshimet më të rëndësishme që kanë ndodhur në legjislacionin procedural penal me reformën legjislative të vitit 2017, si edhe ndryshimet në praktikën gjyqësore.

Metoda krahasuese, e cila zbatohet për evidentimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet koncepteve apo instituteve të ndryshme, është aplikuar gjerësisht në përcaktimin e dallimeve dhe të përbashkëtave midis sistemeve civil law dhe common law në fushën e barrës së provës dhe standardit të të provuarit, në krahasimin

ndërmjet proceseve civile/administrative dhe procesit penal, si edhe në krahasimin e standardeve në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykimin e themelit të çështjes.

Metoda e analizës është aplikuar së bashku me *metodën interpretuese* për të shpjeguar kuptimin e dispozitave ligjore, si edhe për analizimin e vendimmarrjeve të gjykatave vendase dhe të huaja. Përgjatë punimit gjenden analiza të shumta lidhur me dispozita ligjore, jo vetëm të aspektit procedural siç janë interpretimet që janë kryer në rastet e institutit të mosfillimit të procedimit penal, të seancës paraprake etj., por edhe të aspektit material siç është interpretimi i veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, të prezumimeve ligjore etj.

Metoda e sintezës, lidhur ngushtësisht me *metodën e analizës*, është aplikuar gjerësisht në përfundimet e arsyetuara për zbatimin e standardit në hetimet paraprake, në regjistrimin e procedimit penal dhe mosfillimin e tij, në seancën paraprake për dërgimin në gjyq të çështjes, në veprimet hetimore të kryera në hetimet paraprake, në gjykimin në themel të çështjes, në mënyrën e operimit të prezumimeve në procesin penal etj.

Metoda dialektike, e cila është një metodë arsyetimi bazuar në shkëmbimin e argumenteve dhe kundërargumenteve [1] është përdorur kryesisht në trajtimin e standardeve të të provuarit në seancën paraprake, në trajtimin e provës së vetme në procesin penal, në fushën e prezumimeve.

Metoda deduktive, e cila ka të bëjë me arsyetimin nga e përgjithshmja te rastet e veçanta, në këtë studim i referohet kryesisht kuptimeve të prezumimeve, e më saktë prezumimeve ligjore dhe mënyrës së interpretimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit në këto raste. Duke ditur rregullat bazë të funksionimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit është arsyetuar se në të njëjtën formë duhet të aplikohen edhe në rastet e prezumimeve, me përjashtime të caktuara.

Metoda induktive, e cila në të kundërt me atë deduktive, nënkupton që nga fakte të caktuara mund të konkludohet në një përfundim të përgjithshëm. Kjo metodë është aplikuar veçanërisht në trajtimin e standardit të të provuarit në hetimet paraprake, ku nga evidentimi se në disa prej veprimeve hetimore që parashikohen në këtë fazë të procesit, vepron standardi i dyshimit të arsyeshëm, është konluduar në një përfundim apo rregull të përgjithshëm se në tërësi në këtë fazë aplikohet standardi i dyshimit të arsyeshëm.

Metodat e mësipërme janë metodat kryesore të përdorura në realizimin e këtij studimi, por ato nuk janë të vetmet, por të ndërthurura edhe me metoda të tjera apo teknika të tjera të kërkimit shkencor si metoda e vëzhgimit, abstraksionit, studimi i rasteve, deskriptive, empirike dhe ajo e kompilacionit. Nevoja për aplikimin e ndërthurur ndërmjet disa metodave shkencore buron nga vetë natyra komplekse e objektivave të këtij studimi.

---

[1] https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/675/07bdd401-52aa-4028-b278-f8acc3de8d81.pptx?sequence=3&isAllowed=y, aksesuar në datë 15.11.2022

Struktura e disertacionit

Struktura e këtij studimi është menduar në mënyrë të atillë që lexuesi fillimisht të prezantohet me kuptimin e institutit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit, si mekanizma dhe pjesë përbërëse të parimit të prezumimit të pafajësisë, duke evidentuar evolucionin historik të këtyre instituteve në sisteme të ndryshme ligjore dhe në sistemin ligjor të vendit tonë. Në vijim, paraqiten të përbashkëtat dhe dallimet e këtyre instituteve në familjet kryesore ligjore civil law dhe common law, si edhe ndërmjet proceseve civile/administrative dhe atij penal. Pas prezantimit të lexuesit me kuptimin e përgjithshëm të këtyre instituteve, në vijim krerët 3, 4 dhe 5 janë thellësisht me natyrë teknike e profesionale, duke pasur si objekt ndërveprimin e këtyre instituteve në fazën e hetimit paraprak dhe gjykimin e themelit të çështjes, duke kulminuar me përjashtimet e barrës së provës dhe standardit të të provuarit-prezumimet në procesin penal. Në vijim po paraqesim në mënyrë më të detajuar përmbajtje e secilit kre të studimit.

Në kreun I, paraqitet kuptimi i instituteve të barrës së provës dhe standardit të të provuarit dhe përvijohet me evoluimin historik të këtyre koncepteve në familjet e ndryshme ligjore, duke nisur nga periudhat e hershme të qytetërimit. Vëmëndje e posaçme në këtë kre i është kushtuar edhe kuptimit të këtyre koncepteve në të drejtën shqiptare dhe në KPrP pararendës të kodit aktual të procedurës penale.

Në kreun II, janë trajtuar kuptimet e koncepteve të barrës së provës dhe standardit të provuarit në procesin penal bashkëkohor në juridiksionet e familjes ligjore kontinentale dhe anglo-saksone. Përpos këtij këndvështrimi, në këtë kre janë trajtuar dallimet dhe të përbashkëtat ndërmjet barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesin civil dhe atë penal, ku një element me rëndësi është trajtimi i raportit ndërmjet proceseve penale e civile në këndvështrimin e instituteve të mësipërme, veçanërisht pikëtakimet më të rëndësishme ndërmjet këtyre proceseve, konkretisht efektet e vendimeve gjyqësore ndaj proceseve penale e civile reciprokisht dhe padia civile në procesin penal.

Në kreun III nis të studiohen barra e provës dhe standardi i të provuarit në fazën e hetimeve paraprake, që prej momentit fillestar të kësaj faze, që fillon me vendimmarrjet e prokurorit për regjistrimin ose mosfillimin e procedimit penal dhe vijojnë me vendimet e rëndësishme procedurale të kësaj faze si vendimi për marrjen e personit si të pandehur dhe njoftimin e akuzës, kërkesat e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim ose për pushimin e procedimit penal. Një trajtim i hollësishëm është kryer lidhur me seancën paraprake, ku analizohen kompetencat e prokurorit dhe gjyqtarit të seancës paraprake në këndvështrimin e standardit të të provuarit të vendimmarrjeve të secilit prej këtye subjekteve. Në kreun III përveç se janë përdorur gjerësisht materiale të bollshme akademike, ka edhe një trajtim të hollësishëm të jurisprudencës që përkon me ndryshimet ligjore të vitit 2017. Në këtë kre, i është kushtuar rëndësi dhe hapësirë e veçantë edhe veprimeve hetimore të kësaj faze të procesit, si kryerja e përgjimit, kontrollit etj.

Në kreun IV përshkruhet barra e provës dhe standardi i të provuarit në gjykimin e themelit të çështjes. Në fakt, në fazën e gjykimit në themel të çështjes evidentohet më hollësisht kuptimi i instituteve të mësipërme, për shkak se kjo fazë karakterizohet nga aktiviteti dinamik i palëve të procesit dhe më mirë se në çdo moment tjetër të procesit

penal kuptohen efektet praktike dhe ligjore të barrës së provës dhe standardit të të provuarit. Me ndryshimet legjislative të vitit 2017, ligjvënësi kodifikoi standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke ndjekur në fakt një tendencë të sistemeve ligjore kontinentale drejt pranimit të standardeve që e kanë origjinën nga common law, ku shembull konkret përbën legjislacioni procedural italian që standardin e mësipërm e prezantoi në vitin 2006. Në këtë kre janë trajtuar koncepti i provës së vetme në procesin penal në kuadrin e përmbushjes së standardit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe indicjeve. Gjithashtu, në kuadrin e barrës së provës janë trajtuar përjashtimet e barrës së provës të vërejtura nga doktrina e së drejtës penale, për të kaluar natyrshëm në kreun e V mbi prezumimet në procesin penal.

Në kreun V janë analizuar prezumimet në procesin penal, të cilat konsiderohen, kryesisht nga doktrina dhe jurisprudenca e huaj, si përjashtime të barrës së provës dhe standardit të të provuarit. Ky kre është strukturuar në varësi të llojit apo kategorizimit më të gjithëpranuar të prezumimeve, në ato ligjore dhe faktike. Përtej kësaj, në këtë kre janë studiuar disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë, të cilat në këndvështrimin e instituteve të barrës së provës dhe standardit të të provuarit, kanë krijuar me jurisprudencën e vendosur prezumime të caktuara, efektet e të cilave ndikojnë në pozitën e njërës apo tjetrës palë të procesit penal.

Në përmbyllje të studimit janë paraqitur përfundimet përkatëse që rezultojnë nga trajtimi i këtij studimi, si edhe propozimet që mund të merren në konsideratë përmes procesit ligjvënës ose jurisprudencës së gjykatave, lidhur me çështjet për të cilat ende ka paqartësi në zbatimin e tyre në praktikën e përditshme të gjykatave.

KREU I

Barra e provës dhe standardi i të provuarit. Evolucioni historik

***Përmbledhje**: **1.1** Kuptimi i barrës së provës dhe standardit të të provuarit. **1.2** Historiku i barrës së provës dhe standardit të të provuarit. **1.2.1** Në Athinën antike. **1.2.2** Në Romën antike. **1.2.3** Në të drejtën e Sheriatit. **1.2.4** Në të drejtën kanonike. **1.2.5** Në mesjetë. **1.2.6** Në sistemin anglo – sakson. **1.2.6.1** Si vlerësonte juria. **1.2.6.2** Rruga deri te arsyetimi i standardit. **1.2.6.3** Dilema paramoderne dhe konfuzioni i sotëm. **1.2.7** Në të drejtën shqiptare. **1.3** Barra e proves dhe standardi i të provuarit në KPrP të vitit 1980*

1.1 Kuptimi i barrës së provës dhe standardit të të provuarit.

Barra e provës dhe standardi i të provuarit janë koncepte për të cilat nuk gjendet ndonjë përkufizim në legjislacionin penal, procedural ose material. Legjislacioni ynë penal, procedural e material, pjesë e sistemit kontinental nuk ka ndonjë kuadër normativ specifik lidhur me këto koncepte, për shkak se normat e funksionimit të këtyre koncepteve janë të shpërndara ndërmjet atyre pak dispozitave të ligjit dhe efekteve që ato kanë në procesin penal për shkak të jurisprudencës. Interpretimi sistematik i neneve 4, 8 dhe 390 të KPrP, *këto dy të fundit të parashikuara pas ndryshimeve legjislative të vitit 2017,* mund të ofrojë një ide lidhur me mënyrën e funksionimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesin penal, megjithatë për studimin e plotë të tyre është e nevojshme që këto institute të trajtohen në përqasje me doktrinën dhe praktikën gjyqësore të viteve të fundit.

Siç dihet, në drejtësinë penale vepron parimi, i ngritur në nivelin e një garancie kushtetuese për individët, që njihet si parimi i prezumimit të pafajësisë. Në kuptimin e tij klasik ai do të thotë se çdo individ prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet me vendim të formës së prerë të gjykatës. Prezumimi i pafajësisë, përveç se një garanci kushtetuese, përfaqëson edhe një parim të rëndësishëm procedural – penal. Dy institutet proceduralë që e përbëjnë këtë parim janë *barra e provës dhe standardi i të provuarit.* Aplikimi i këtyre instituteve mundëson zbatimin real dhe efektiv të parimit të prezumimit të pafajësisë në procesin penal. Prezumimi i pafajësisë nuk është një parim lehtësisht i cenueshëm apo i rrëzueshëm, pasi standardi që duhet të përmbushë organi i akuzës është i lartë. Nëse supozojmë, *a contrario*, një prezumim shumë të dobët formal, të cilin shteti mund ta rrëzojë lehtësisht, duke përcaktuar se për dënimin e të akuzuarit mjafton që ai të kishte *mundësinë* e kryerjes së krimit; pasoja që vjen, në këtë mënyrë, është se të akuzuarit i duhet të provojë pafajësinë e tij, sa herë që përmbushet ky standard minimal.[2] Kjo do të binte në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj. Barra e provës dhe standardi i të provuarit janë pjesë e parimit të prezumimit të pafajësisë, të cilët, sikurse përmendëm më sipër synojnë të mbrojnë liritë dhe të drejtat e individit nga forca represive ose gabimet e organeve shtetërore. Barra e provës nënkupton mekanizmin përmes së cilit realizohet në procesin penal detyrimi për të provuar faktet dhe paraqitur provat. Standardi i të

[2] Paul Roberts and Adrian Zuckerman, Criminal Evidence, Oxford University Press, second edition, 2010, fq. 223.

provuarit është një mjet që shërben për të maksimalizuar aftësinë mbrojtëse të ofruar nga ligji për individët që akuzohen në një proces penal. Ai mund të konsiderohet si prezumimi i pafajësisë në veprim.

Pasi trajtuam zanafillën e koncepteve, duhet të sqarojmë më tej kuptimin e tyre në procedurën penale. Termi barrë e provës është asociuar dhe kuptuar i lidhur ngushtësisht me rolin e prokurorit në procesin penal dhe detyrimin e tij për të provuar faktet objekt akuze dhe për të paraqitur provat në mbështetje të saj. Me ndryshimet legjislative të vitit 2017 (ligji nr.35/2017) ligjvënësi parashikoi një dispozitë re në KPrP, neni 8/a, të titulluar "Provat", ku në paragrafin e dytë të normës përcaktoi se: "*Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij*". Ky mund të jetë përcaktimi më i saktë që mund të jetë dhënë ndonjëherë nga legjislacioni i procedurës penale lidhur me detyrimin jo vetëm të mbledhjes, por edhe të shqyrtimit të provave, madje jo vetëm të atyre që fajësojnë të pandehurin, por edhe të atyre që janë në favor të tij.

Kjo dispozitë duhet të analizohet ngushtësisht me nenin 390/1 të KPrP, ku përmes reformës legjislative të vitit 2017, u kodifikua standardi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këtë të fundit ligjvënësi ka parashikuar se: "*Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit"*. Nga interpretimi sistematik i të dy dispozitave mund të dalim në disa përcaktime të rëndësishme. Ndërsa, neni 8/a i KPrP, kryesisht, i referohet detyrimit të paraqitjes dhe mbledhjes së provave, që përbën njërin aspekt të barrës së provës, neni 390/1 i KPrP përcakton barrën e provës në kuptimin e arsyetimit apo të bindjes së fajësisë së të pandehurit. Prej kësaj dispozite rezulton se objekti i të provuarit të akuzës është fajësia e të pandehurit dhe jo pafajësia e tij. Në këtë kuptim, pavarësisht detyrimit të prokurorit për të mbledhur e shqyrtuar prova, të cilat mund të jenë në favor të të pandehurit, ai ka vetëm detyrimin të arsyetojë e të bindë gjykatën lidhur me fajësinë e të pandehurit, pra, elementët e akuzës së ngritur ndaj tij.

Në këtë arsyetim gjendet hapësira e të pandehurit për të patur një rol aktiv në procesin penal duke qenë se interesi i tij i natyrshëm është të kundërshtojë akuzën dhe të tregojë se është i pafajshëm. Pikërisht, në këtë pikë pranohet një barrë e caktuar prove për të pandehurin, e quajtur barrë pretendimi, me anë të së cilës i pandehuri mbështet pretendimet e tij. Në këtë rast nuk bëjmë fjalë për zhvendosje të barrës së provës nga akuza te i pandehuri, për shkak se kjo do të cenonte krejt arkitekturën e procesit penal. Për t'u rikthyer te neni 8/a i KPrP, sipas gjykimit tim, detyrimi për të mbledhur e shqyrtuar provat të cilat mund të jenë në favor të të pandehurit, patjetër që ka karakter ligjor detyrues, por kuptimi duhet të jetë relativ, në raport dhe me rolin që luan i pandehuri në proces, si dhe me dijeninë që mund të ketë ai për fakte apo prova të caktuara, të cilat mund të jenë jashtë sferës së njohjes nga akuza apo policia gjyqësore.

Termi standardi i të provuarit apo siç njihet ndryshe "standardi i provës", i referohet masës apo shkallës së përmbushjes së barrës së provës. Është sistemi matës i shkallës së sigurisë apo probabilitetit që provat i ofrojnë gjykatës për të pranuar si të vërteta fakte të caktuara, standardi me të cilin duhet bindur gjykata nëpërmjet provave të ofruara nga pala që mbart barrën e provës në proces. Prandaj, standardi është një sistem matës i cilësisë dhe i forcës bindëse të provave të paraqitura për të përmbushur barrën e provës. Standardi i kërkuar i provës në disa raste ndryshon në varësi të

natyrës së çështjes që duhet provuar, por dallimet më themelore janë midis çështjeve penale dhe civile.[3]

Standardi i të provuarit ka kuptimin e shkallës së vërtetësisë me të cilën kërkohet të provohen në procesin penal fakte të caktuara, me qëllim shmangien e gabimit gjyqësor apo padrejtësisë në gjykim që mund të çojë në dënimin e personave të pafajshëm. Por, është e rëndësishme të theksojmë këtu, se ky standard është i ndryshëm në faza të ndryshme të procesit penal: kështu, standardi i të provuarit për të vendosur dërgimin e çështjes në gjyq është më i ulët sesa ai që kërkohet për ta deklaruar të pandehurin fajtor në përfundim të gjykimit. Standarde të ndryshme kërkohen, gjithashtu, edhe për të provuar fakte të caktuara brenda fazës së hetimeve paraprake; p.sh., për të kërkuar një masë sigurimi personal kërkohet një dyshim i arsyeshëm, i mbështetur në prova, se personi e ka kryer veprën për të cilën hetohet, kurse për marrjen e tij si i pandehur kërkohen të dhëna të mjaftueshme se e ka kryer atë vepër, etj.

Në tekstin e KPrP ndeshemi shpeshherë me standardin e dyshimit të arsyeshëm, i cili kërkohet të përmbushet para se të ndërmerren disa veprime të rëndësishme procedurale dhe hetimore. Ky standard zbatohet sidomos në fazën e hetimeve paraprake. Detyrimi për të provuar fakte të caktuara në proces në nivelin e dyshimit të arsyeshëm i takon organit të akuzës. Megjithatë, edhe gjykata, me vendimin e saj duhet të manifestojë se ka arritur bindjen për ekzistencën dhe vërtetësinë e këtyre fakteve deri në këtë nivel. Zbatimi i drejtë i kësaj kërkese mënjanon arbitraritetin ndaj kufizimit të të drejtave dhe lirisë së të dyshuarit në hetimet paraprake. Më tej, në këtë punim do të shohim se në hetimet paraprake, Kodi ynë parashikon dhe standarde të tjera, të cilat ndryshojnë nga standardi që vepron në fazën e gjykimit në themel.

Në gjykimin e themelit, aty ku përcaktohet fajësia apo pafajësia e të pandehurit kërkohet një standard tjetër. Kur gjykata gjen se i pandehuri e ka kryer veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës, bindja e gjykatës duhet të jetë formuar në përputhje me standardin e "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm". Pra, fajësia shpallet vetëm atëherë kur gjykata nuk ka asnjë dyshim në drejtim të saj. Ndërsa, pafajësia e të pandehurit shpallet gjithmonë kur gjykata ka një dyshim në lidhje me fajësinë e tij. Në këtë rast aplikohet parimi *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit. Pafajësia nuk kërkohet të provohet, mjafton të mos provohet dot nga pala akuzuese fajësia e të pandehurit, deri në atë masë sa të zhduket çdo dyshim i arsyeshëm mbi mundësinë që ai të jetë akuzuar padrejtësisht. Kodifikimi për herë të parë i standardit *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* u krye pikërisht me reformën legjislative të vitit 2017 në nenin 390/1 të KPrP. Zbatimi i këtij standardi lidhet me momentin e përcaktimit të fajësisë së të pandehurit. Kodifikimi nënkupton që aktualisht ky standard është përcaktuar në nivelin e normës ligjore, ndërkohë që përmbushja e tij analizohet duke vlerësuar provat që mund të ekzistojnë në një çështje konkrete, pra, tashmë ka dy anë të tij, si çështje ligji dhe çështje provash, çka mund të përbëjë një temë me interes në vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë në raport me kompetencat e saj si gjykatë ligji.

---

[3] Peter Murphy, Murphy për provën, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 163.

1.2 Historiku i barrës së provës dhe standardit të të provuarit

1.2.1 Në Athinën antike

Në Athinën antike procedura penale zhvillohej para trupit gjykues të quajtur "Heliaja", të cilin e përbënin numër i ndryshueshëm gjyqtarësh joprofesionistë, të zgjedhur nga rradhët e qytetarëve të lirë. Për pjesën më të madhë të veprave penale si akuzues paraqitej vetë i dëmtuari ose përfaqësuesi i tij ligjor, kurse për një krim kundër shtetit secili mund të paraqitej si një paditës publik. Kësisoj, ekzistonin dy lloje procedurash: private dhe publike. Në procesin e të provuarit ai që akuzonte mbante barrën e akuzës, duke i paraqitur gjykatës dëshmitarë dhe dokumente. Ai i pyeste vetë dëshmitarët dhe mund të pyeste edhe të pandehurin. Mbrojtjen e realizonte vetë i pandehuri ose mbrojtësi i tij, të cilët paraqisnin dëshmitarë para gjykatës, me qëllim pyetjen e tyre. Pas përfundimit të fjalës së palëve, gjyqtarët votonin për fajësinë e të pandehurit.

Siç shihet, procesin e të provuarit e zhvillonin palët. Ato vetë i gjenin dhe i paraqitnin provat para trupit gjykues i cili ishte krejtësisht pasiv. Si provë vlente pohimi i të pandehurit, dëshmia e dëshmitarit, dokumentet dhe indicjet. Çmuarja e provave bëhej sipas bindjes së lirë të gjykatës. Mirëpo, vlen të theksohet se trupi gjykues, i përbërë prej qindra anëtarësh, nuk ishte në gjendje që nëpërmjet procesit të analizës së provave dhe sintezës së tyre, çdoherë t'i çmonte drejt provat. Bindjen për fajin e të pandehurit trupi gjykues e formonte më tepër në bazë të aftësive oratorike të palëve, me ç'rast mund të merreshin vendime të tilla, për të cilat më vonë qytetarët e Athinës pendoheshin.[4]

1.2.2 Në Romën antike

Në Romën antike, gjatë periudhës së Republikës romake, barra e provës i takonte atij që akuzonte. Si ai që akuzonte, ashtu edhe i pandehuri, sillnin provat e tyre në gjykim; gjithashtu, njihej dhe pyetja e kryqëzuar, pra, pyetja e dëshmitarit të palës tjetër. Duke u nisur nga sentenca *actore non probante reus absolvitur*[5], i pandehuri angazhohej në mbrojtjen e vet vetëm kur konsideronte se duheshin zhvlerësuar provat e atij që akuzonte për t'i shpëtuar shpalljes fajtor. Ndryshimi më i rëndësishëm në procedurën penale të epokës perandorake është angazhimi i gjykatës në administrimin e provave nëpërmjet pyetjes së të pandehurit, të dëshmitarëve, zbatimit të torturës si ndaj të pandehurit, i cili rridhte nga shtresat më të ulëta shoqërore, ashtu edhe ndaj dëshmitarëve. Për vepra penale të rënda, siç ishin tradhëtia, etj., tortura mund të zbatohej edhe ndaj të pandehurve nga rradhët e shtresave të larta.

Në epokën perandorake nuk ekzistonte një sistem i përgjithshëm i rregullave provuese rreth asaj se sa dhe çfarë provash duhej të siguroheshin për ta shpallur fajtor të pandehurin. Ka pasur këshilla jodetyruese për gjyqtarët. Në të vërtetë, në këtë drejtim, ishin me rëndësi shkrimet e juristëve, të cilët shpeshherë përfshiheshin edhe me reskripcione perandorake në formë udhëzimesh, këshillash dhe vërejtjesh pa karakter detyrues për gjyqtarët. Në procedurën penale të epokës perandorake, sikurse

---

[4] Prof.Dr.Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006, fq. 23, 24, 25.

[5] Kur paditësi nuk është në gjendje të provojë, i padituri shfajësohet. Shprehje që sintetizon parimin e prezumimit të pafajësisë. Tek Dizionario giuridico romano, Edizioni Simone, IV Edizione, 2006, faqe 39.

edhe në procedurën e epokës republikane, çmuarja e provave bëhej sipas bindjes së lirë të gjyqtarit. Ekzistonte dallimi në atë që pohimi i të pandehurit duhej të verifikohej. Megjithatë, nga fundi i shekullit të tretë të epokës së re *kristalizohet rregulla juridike se në bazë të dëshmisë së një dëshmitari të vetëm nuk mund të konsiderohet një fakt i vërtetuar*. Për vërtetimin e një fakti nevojitej dëshmia e pajtueshme e dy dëshmitarëve juridikisht pa të meta.[6]

1.2.3 Në të drejtën e Sheriatit

Në të drejtën e Sheriatit, sipas udhëzimeve që Profeti u jepte gjyqtarëve me rastin e emërimit të tyre, hasen principe që në aspektin e teorisë juridike gjyqësore bashkëkohore, janë përgjithësisht të pranuara. Po përmëndim disa prej tyre: të dallohen veprat e kryera me paramendim nga ato të rastit, sepse veprat gjykohen sipas dashjes; përgjegjësia penale është personale; *në rast dyshimi të veprohet në favor të të pandehurit*; për aq sa është e mundur të mos aplikohet dënimi ndaj të pandehurit, sepse është më mirë të gabohet në falje sesa në ndëshkim; *barra e provës i takon atij që akuzon*, kurse betimi i takon të pandehurit, etj.

Sipas kësaj të drejte, funksioni i gjyqtarit çmohej si një detyrë e shenjtë. Puna e gjyqtarit, i cili me tërë intelektin e tij angazhohej për gjetjen e së vërtetës në procedurën gjyqësore, nga aspekti shoqëror dhe fetar vlerësohej lart. Në anën tjetër, gjykimi me hile, për interes etj., konsiderohej mëkat i rëndë. Një gjykim i tillë nënkupton vetëdijen e gjyqtarit se zgjidhja gjyqësore që ai bën në rastin konkret është zgjidhje kundërligjore dhe jo e drejtë. Në literaturën juridike, e cila mbështetet edhe në disa thënie të profetit Muhamed, me qëllim që të pengohen gjykimet jo të drejta, theksohen shumë pasojat (zakonisht të natyrës morale) që e presin gjyqtarin që e keqpërdor detyrën. Edhe pse sipas së drejtës së Sheriatit, në procedurën gjyqësore kërkohet dëshmia e dy dëshmitarëve, fakt ky që të orienton drejt teorisë ligjore të vlerësimit të provave, nuk mund të pohohet se dëshmia e dy dëshmitarëve ka pasur gjithnjë vlerën e provës së plotë. Në të vërtetë, kadiu ishte i detyruar që me rastin e gjykimit të kujdesej për sigurimin e numrit të nevojshëm të provave, por atij gjithashtu i kërkohej që ato prova t'i çmonte sipas bindjes së brendshme dhe vendimin ta mbështeste në prova të tilla, vetëm nëse ishte i bindur për saktësinë e tyre.

Gjatë gjykimit të një çështjeje penale, çdoherë synohej të sigurohej pohimi i vullnetshëm i të pandehurit apo dëshmia e dy (apo katër) dëshmitarëve të ndershëm, prova të cilat kërkoheshin në mënyrë që kadiu të jepte vendim për fajësi. Mirëpo, dihej se për shumicën e çështjeve penale prova të tilla mungonin. Prandaj, rregullat e procesit të të provuarit, të parashikuara në procedurën gjyqësore që zbatonte kadiu për zgjidhjen e veprave penale të inkriminuara në Kur'an, synonin të siguronin që të mos dënohej personi i pafajshëm, sepse nëse nuk siguroheshin provat e duhura si për nga cilësia, ashtu edhe për nga sasia e tyre, i pandehuri lirohej nga akuza. Pavarësisht ekzistencës së disa provave, por që nuk mjaftonin për gjykimin e të pandehurit, pafajësia e tij nuk mbetej e dyshimtë, për shkak se nuk ekzistonte lloji i tretë i vendimmarrjes i quajtur *absolutio ab instantia*,[7] e cila ka ekzistuar në procedurën inkuizitore. Kjo e fundit është një procedurë, në të cilën gjykata nuk mund të shprehej për themelin e çështjes. Kësisoj, e drejta e sheriatit me tepër i jepte përparësi prirjes së

---

[6] Prof.Dr.Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006, fq. 28-29.

[7] Rit procedimi që nuk lejon shprehjen e gjykatës për themelin e çështjes.

mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarit sesa prirjes për efektivitet të procedurës penale, sepse në pamundësi juridike që të përdorte torturën për nxjerrjen e pohimit nga i pandehuri dhe në pamundësi që të siguronte prova të drejtpërdrejta – b.fj., dëshmi nga një numër i mjaftueshëm dëshmitarësh, - kadiu nuk mund ta dënonte të akuzuarin. Në procedurën penale synohej arritja e së vërtetës materiale. Megjithatë, ishte i njohur edhe fakti se e vërteta e konfirmuar në procedurën gjyqësore është e vërtetë relative dhe subjektive.[8]

1.2.4 Në të drejtën kanonike

Pas shkatërrimit të Perandorisë Romake, edhe procedura penale e zhvilluar sipas të drejtës romake pësoi pothuaj të njëjtin fat. Në shumicën e shteteve të krijuara mbi gërmadhat e Perandorisë Romake zuri vend zbatimi i së drejtës gjermanike. Vetëm në territoret ku sot shtrihet Italia, vazhdoi të zbatohej procedura penale romake. Me përhapjen dhe forcimin e krishtërimit, Kisha u përfshi gradualisht në realizimin e pushtetit gjyqësor. Në fillim pushteti i saj shtrihej mbi klerikët për disa vepra penale të kryera prej tyre. Më vonë, pushteti i saj, në këtë drejtim, u zgjerua dukshëm. Kështu, në kompetencë të gjykatave kanonike (kishtare) përfshiheshin veprat penale me karakter të thjeshtë fetar, për ta zgjeruar më vonë pushtetin gjyqësor edhe për ato vepra penale që nuk kishin vetëm karakter fetar, por që Kisha konsideronte se autorët e tyre duheshin ndëshkuar. Kisha veçanërisht kujdesej për gjykimin e veprave penale siç ishin: herezia, shizma (veprime të cilat rrezikonin ndarjen e Kishës), apostazia (braktisja e besimit në Zot, besimi në djall me qëllim aftësimin për të bërë magji), simonia (blerja e detyrave të larta fetare). Pavarësisht nga procedura e zbatuar (romake apo gjermanike) Kisha zbatonte sistem provues romak të kohës së vonshme perandorake, duke e shmangur torturën si mjet të provës, e cila nuk përputhej me karakterin e parimeve të hershme të krishtërimit.

Duke i mbetur besnik procedurës penale romake, në fillim, procedura penale kanonike zhvillohej sipas tipit akuzator të procedurës penale. Mirëpo, me kalimin e kohës, u fut në veprim edhe tipi i ri i procedurës penale, tipi inkuizitor. Si prova në procedurën penale kanonike përdoreshin: pohimi, dëshmia, shkresa dhe indicjet. Meqenëse në procedurën penale kanonike synohet të gjendet e vërteta materiale, pohimi i të pandehurit nuk duhet të merrej me dhunë dhe ai duhej të verifikohej. Mospërdorimi i dhunës në procedurën penale kanonike ishte në përputhje me karakterin e hershëm të krishtërimit. Duke respektuar këtë frymë, Kisha ishte dhe kundër dënimit me vdekje. Por, për shkak të rrezikut që ndjente nga shfaqja e herezisë, ajo e ndryshoi qëndrimin ndaj torturës, duke lejuar përdorimin e saj ndaj heretikëve.[9]

Sistemi i të provuarit i procesit inkuizitor romano-kishtar siguronte një sistem të hetimit të drejtuar nga gjyqtarët profesionistë. Ajo ishte projektuar për të marrë prova të plota, të përcaktuara nga standarde, të cilat specifikonin në mënyrë të ngurtë cilësinë dhe sasinë e provave. Një numër i caktuar i dëshmitarëve ishin të nevojshëm për të provuar faktet, dhe sapo një "provë e plotë" të ishte arritur, dënimi ishte automatik. Në thelb, gjyqtari në shumicën e çështjeve penale ishte një kontabilist i cili mblidhte fraksionet e provave. Në çështjet penale, kërkoheshin dy dëshmitarë të mirë

---

[8] Prof.Dr.Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë 2006, fq. 39, 46.

[9] Prof.Dr.Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006, fq. 49.

ose pohimi. Për shkak se pohimi kishte vlerë veçanërisht të lartë provuese, për nxjerrjen e tij përdorej tortura. Rregulla komplekse përcaktonin nëse kishte prova të mjaftueshme për të përligjur torturën gjyqësore.

1.2.5 Në mesjetë

Në mesjetë, deri te rikthimi në të drejtën e vjetër romake dhe të asaj kanonike, në procesin e të provuarit janë zbatuar parimet e së drejtës së vjetër gjermane dhe të asaj franke. Prandaj, sistemi provues i të drejtave të Evropës Kontinentale të periudhës mesjetare ka qenë krejt ndryshe nga ai që zbatohej në të drejtën romake dhe atë kanonike. Në dallim nga e drejta provuese romake si dhe e drejta provuese bashkëkohore, të cilat mbështeten në themele racionalo-empirike, e drejta provuese gjermane ka qenë irracionale-fetare. Procedura provuese në fjalë karakterizohej nga formalizmi dhe *barra e provës i takonte të pandehurit*. E drejta e gjermanëve dhe e frankëve të vjetër karakterizohej nga një formalizëm i theksuar. Me karakterin formalist nënkuptohet se në procesin e të provuarit nuk shkohej drejt idesë që para gjykatës të paraqitej materiali i nevojshëm provues, në bazë të të cilit ajo do të konfirmonte të vërtetën materiale, por gjykata kujdesej kryesisht për anën formale të procesit. Në këtë kontekst, ishte e mjaftueshme që provat të cilat paraqiteshin para gjykatës, të ishin në përputhje me ligjin, pavarësisht vërtetësisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Betimi ishte mjet kryesor i provës. Për vepra penale të lehta atë mund ta përdorte i pandehuri me rastin e deklarimit apo, për rastet më të rënda, i pandehuri me një numër të afërmish ose miqsh - me bashkëbetarë. Në të vërtetë, kur i pandehuri akuzohej për disa vepra penale të rënda, për të argumentuar pafajësinë e vet, ai duhej të siguronte një numër të caktuar bashkëbetarësh, më së shumti 12, të cilët së bashku me të pandehurin duhej të betoheshin (po qe se kishin vullnet për një gjë te tillë). Bashkëbetarët duhen dalluar nga dëshmitarët. Te bashkëbetarët nuk kërkohet, sikur te dëshmitarët që të dinë diçka për faktet nga vëzhgimi i tyre i drejtpërdrejtë, por ata me betimin e tyre i vinin në ndihmë palës e cila provon. Me atë rast nuk është me rëndësi nëse bashkëbetari ka bërë më parë hetime për faktet që betohet apo eventualisht di diçka për to në bazë të vrojtimit personal apo betimin e ka bërë duke pasur mirëbesim në thëniet e të pandehurit. Megjithatë, edhe pse bashkëbetarët nuk ishin të detyruar të dinin diçka për faktet të cilat provoheshin me betim, pasojat që i prisnin në rast të betimit të rremë mund t'i shtynin ata që para se të betoheshin të informoheshin për faktet kontestuese. Betimi i të pandehurit me bashkëbetarë quhej betim pastrimi (*juramentum purgationis*), çka faktikisht nënkuptonte se kur betimi jepej sipas dispozitave, i pandehuri ishte "pastruar" nga akuza.

Si mjet prove i llojit të veçantë shërbente edhe dyluftimi gjyqësor, i cili ishte privilegj i njerëzve të lirë. Në dyluftim mund të fitonte si i akuzuari ashtu edhe akuzuesi, por këtë mund ta bënte vetëm nëse me akuzuesin ishte i barabartë ose më i lartë për nga pozita. Te ky mjet i provës, sikurse edhe te mjetet e tjera irracionale, shihet qartë se vendimmarrja e gjykatës nuk bazohej tek bindja e saj e brendshme, por vendimi varej nga faktorë që nuk kishin lidhje me veprën penale. Në të vërtetë, nga epilogu i dyluftimit varej edhe "konstatimi" i fajtorit, sepse thëniet e palës e cila humbiste dyluftimin, patjetër duhej të konsideroheshin si të pasakta. Sipas rregullit, barra e provës i takonte të akuzuarit. Vetëm atëherë kur i pandehuri kapej në flagrancë, barra e provës i takonte akuzuesit, i cili e provonte me betim. Mirëpo, duke i pasur parasysh mjetet e provës që mund të përdoreshin, mundësinë e betimit të rremë, etj., gjykata

caktonte në rastin konkret se cila palë duhej të provonte dhe çfarë mjeti të provës duhej të përdorte.

Nga sa parashtruam kuptohet se sistemi provues mesjetar ishte irracional. Ky sistem mbështetej në besimin dhe jo në njohuritë e siguruara nga përvoja dhe arsyeja. Si i tillë, ky sistem provues nuk mundi t'i bëjë ballë filozofisë racionaliste që e mbështeste dijen tek përvoja dhe fuqia e mendimit njerëzor.[10]

1.2.6 Në sistemin anglo - sakson

Teksa shkruajmë për historikun e standardeve të të provuarit, sigurisht që duhet të theksohet origjina e tyre në sistemin ligjor common law, pasi tek ky sistem racional e kanë origjinën standardet e të provuarit. Ashtu siç dihet, asnjë individ në ShBA apo në MB, si dy ndër vendet më përfaqësuese të këtij sistemi, nuk mund të dënohet për një vepër penale, nëse fajësia e personit nuk provohet "përtej dyshimit të arsyeshëm". Në të vërtetë, kërkesa për të provuar "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm" është aq thelbësore, saqë Gjykata Supreme e SHBA-ve e ka konsideruar atë si të mishëruar në kushtetutën amerikane, edhe pse shprehja "dyshim i arsyeshëm" nuk përmendet aspak në Kushtetutë.

Gjyqtarët dhe studiuesit e ligjit kanë ardhur në përfundimin se shprehja "dyshim i arsyeshëm" nuk mund të përkufizohet në mënyrë shteruese. Në origjinën e tij ky rregull nuk kishte për qëllim kryerjen e atij funksioni që kryen sot. Nuk ka qenë aspak si qëllim kryesor mbrojtja e të akuzuarit, as edhe ofrimi i garancive të duhura procedurale për gjykimin dhe fajësinë e tij. Në të vërtetë, sado e çuditshme që mund të tingëllojë, *formula e dyshimit të arsyeshëm kishte për qëllim mbrojtjen e shpirtrave të anëtarëve të jurisë kundër mallkimit.*[11]

Në gjykimin penal të shekujve të kaluar, viheshin më shumë gjëra në rrezik se sa thjesht fati i të akuzuarit. Fati i atyre që duhet të gjykonin ishte në rrezik dhe kjo konsiderohej më e rëndësishme. Pjesërisht, kjo vinte për shkak se anëtarët e jurisë i druheshin frikës për hakmarrje nga ana e të afërmve të personit të dënuar. Po ashtu, ka pasur edhe arsye fetare. Të dënoje një të pafajshëm konsiderohej, në traditën e vjetër të krishterë, si një mëkat i rëndë. Rregulli i dyshimit të arsyeshëm u zhvillua në përgjigje të kësaj mundësie shqetësuese. Kjo, pra, ishte fillimisht *një doktrinë teologjike, me qëllim që të siguronte se anëtarët e jurisë mund të dënonin të pandehurin pa rrezikuar shpëtimin e tyre.*

Sipas doktrinës mesjetare, gjykimi ishte një punë shpirtërore e rrezikshme. Çdo hap i gabuar mëkatar i kryer nga një gjyqtar në rrjedhën e gjykimit do të thoshte "të ndërtoje një vend në ferr." Kjo ishte veçanërisht e vërtetë në kohën që një gjyqtar vendoste për të ashtuquajturat "ndëshkime gjaku" - që konsistonin në ekzekutime dhe gjymtime, të cilat kanë qenë ndëshkime të zakonshme në kohët paramoderne.

---

[10] Prof.Dr.Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006, fq. 55-56.

[11] James Q. Whitman, The Origins of 'Reasonable Doubt', Yale Law School, 2005, https://openyls.law.yale.edu/bitstream/handle/20.500.13051/185/0Whitman__Origins_of_Reasonable_Doubt1.pdf?sequence=2, klikuar më datë 20 shtator 2022.

Dhe kur u arrit të kuptohej ky rrezik shpirtëror, teologjia e krishterë paramoderne e ktheu vëmendjen mbi problemin e "dyshimit". Dyshimi ishte zëri i një ndërgjegjeje të pasigurtë, por që duhej t'i bindeshe. "Në rastet e dyshimit", në përputhje me evoluimin e formulës standarde teologjike, "*rruga më e sigurt ishte që më mirë të mos veprohej sesa të merrej vendimi.*" Kjo devizë u aplikua në gjykim, ashtu siç ndodh zakonisht për të gjitha aktet/veprimet e tjera që përfshijnë ndërgjegjen individuale. Ligji standard i krishterë shpjegonte se: "*Në çdo rast të dyshimit, kur shpëtimi i dikujt është në rrezik, duhet gjithmonë të ndiqet rruga më e sigurt. . . . Një gjyqtar që ka dyshime duhet të refuzojë të gjykojë*". Një gjyqtar i cili dënonte një person të akuzuar me një "ndëshkim gjaku", ndërsa kishte "dyshime" rreth fajit të personit të dënuar, kryente një mëkat të rëndë, dhe kështu e vinte shpëtimin e tij në një rrezik të madh.

Historia e rregullit/parimit të "dyshimit të arsyeshëm", e cila tani duket aq misterioze për ne, është thjesht një kapitull në zhvillimin e shoqërisë angleze në këtë histori të gjatë fetare. Anëtarët e jurisë të sistemit common law ishin të krishterë, dhe si të tillë ata ishin angazhuar në aktet e gjykimit. Kjo do të thoshte që të ishe një anëtar jurie potencialisht kishe vënë si "peng shpirtin tënd". Anëtari i jurisë që gjen një person tjetër fajtor është përgjegjës për hakmarrjen e Zotit mbi familjen e tij dhe ekonominë, trupin dhe shpirtin, në këtë botë dhe në atë që do të vijë.

Ka shumë prova e dëshmi që tregojnë se anëtarët e jurive i kanë marrë këto kërcënime ogurzeza mjaft seriozisht, sidomos në fundin e shekullit të tetëmbëdhjetë. Anëtarët e jurive kanë përjetuar një *" frikë të përgjithshme, sepse përndryshe akuza e gjakut të pafajshëm do të binte në dyert e tyre."* Në përgjigje të kësaj frike apo këtij tmerri të anëtarëve të jurisë, standardi i dyshimit të arsyeshëm u pranua në common law, sidomos gjatë viteve 1780. Rregulli i dyshimit të arsyeshëm u ngrit përballë frikërave fetare. Ai mbetet ende mes nesh sot, si një fosil i gjallë i ardhur nga një botë e vjetër morale.[12]

1.2.6.1 Si vlerësonte juria

Nga të dhënat historike, rezulton se fillimisht gjyqtarët nuk preokupoheshin për detyrat gjyqësore të anëtarëve të jurisë. Anëtarët e hershëm të jurive merrnin vendime në bazë të një përzierje të njohurive të tyre vetjake mbi ngjarjet dhe mbi bazën e dëshmive të të tjerëve.

Studimet e fundit po ndryshojnë pikëpamjen tradicionale që juria mesjetare ishte plotësisht e vetëinformuar. Tani duket se disa anëtarë jurie jetonin shumë larg nga vendi i ngjarjes dhe nuk kishin njohuri të dorës së parë të ngjarjeve. Në fillim të shek. të pesëmbëdhjetë rezulton qartësisht se juritë nuk ishin më të vetëinformuara, por në mënyrë aktive angazhoheshin në dëgjimin dhe vlerësimin e provave të paraqitura nga akuzues privatë dhe zyrtarë qeveritarë.

Që nga shek. i gjashtëmbëdhjetë, aspekti i njohurive vetjake filloi të mos merrej në konsideratë për vlerësimin në lidhje me marrjen e vendimit. Pasi anëtarët e jurisë flluan të perceptohen se qartësisht merrnin vendime mbi bazën e provave të paraqitura

---

[12] James Q. Whitman, The Origins of 'Reasonable Doubt', Yale Law School, 2005, https://openyls.law.yale.edu/bitstream/handle/20.500.13051/185/0Whitman__Origins_of_Reasonable_Doubt1.pdf?sequence=2, klikuar më datë 20 shtator 2022.

në gjykatë, akuzat që silleshin para tyre, theksonin detyrimin që kishin ata për të arritur sigurinë në përcaktimin e fajësisë, të bazuar në prova

Anëtarët e jurive nuk kanë pasur njohuri të mjaftueshme për të arritur në vendimmarrje të pambështetur në prova. Ata mblidhnin informacion nga një numër burimesh, duke përfshirë përgjigjet e të pandehurit ndaj pyetjeve që i bëheshin për akuzat dhe pyetjet e tjera të gjyqtarëve. Ata merrnin në konsideratë besueshmërinë e mohimit dhe sjelljen e të akuzuarit. Ata merrnin, gjithashtu, në konsideratë deklaratat e viktimës, gjininë e saj, dëshmitarët, si dhe dëshmitë e zyrtarëve, të tillë si gjyqtari i paqit, hetuesi ose polici.

Ndërkohë që shoqëria u bë më komplekse dhe u rrit migrimi i popullatës, si juritë civile dhe ato penale filluan të humbitnin dijet e tyre vetjake për faktet që merrnin në shqyrtim dhe gjithnjë e më shumë filluan të mbështeteshin në dëshmitë e dëshmitarëve dhe dokumentet e paraqitura, të cilat tani duhej t'i vlerësonin për vërtetësinë dhe saktësinë e tyre. Anëtarët e jurive u bënë kështu palë të treta në proces, të cilët kishin detyrimin të vlerësonin dhe analizonin faktet dhe ngjarjet, të cilat ata nuk i kishin përjetuar personalisht ose t'i kishin njohur më parë, në mënyrë që të arrinin në konkluzione dhe të merrnin vendime. Një pikë kthese ndodhi më 1563, kur legjislacioni e sanksionoi si të detyrueshme praninë e dëshmitarëve në gjyq dhe kriminalizoi dëshminë e rreme.[13]

1.2.6.2 Rruga deri te arsyetimi i standardit

Përpjekja për të ndërtuar një nivel të ndërmjetëm të dijes, pa siguri absolute, por mbi nivelin e mendimit të thjeshtë, u bë nga një grup teologësh dhe natyralistësh. Për teologët protestantë, të cilët refuzuan pohimet romako-katolike të pagabueshmërisë, pyetja qendrore ishte nëse të vërtetat fetare të tilla si ekzistenca e Zotit, mrekullitë, tregimet biblike, doktrinat e ndryshme dhe praktikat e kishës, mund t'i mbijetonin një sulmi të skeptikëve, pasi ato të ishin zhveshur nga konsiderimi si të vërteta absolute dhe të reduktoheshin në pretendime të bazuara në fakte. Për natyralistët, problemi qendror ishte bërja e përcaktimeve plotësisht të vërteta rreth fenomeneve natyrore, të cilat mund të vëzhgohen, por nuk mund të reduktohen në demonstrime logjike dhe matematikore, që tradicionalisht ishin menduar se përcaktonin të vërteta të padiskutueshme. Të dyja grupet kanë arritur në përfundimin se njerëzit e arsyeshëm, duke përdorur shqisat e tyre dhe arsyen, mund të arrinin tek të vërtetat për të cilat nuk do të kishte shkak për të dyshuar.

Edhe pse përdorën terminologji të ndryshme, teologët dhe natyralistët u ndanë midis "dijes", ose "shkencës", nga njëra anë dhe "probabilitetit" nga ana tjetër. Ka pasur tri nënlloje të dijes, ku secili prej tyre ka një lloj të ndryshëm të sigurisë: ***dije fizike***, që rrjedh nga të dhënat shqisore të menjëhershme; ***dije matematikore***, që derivon nga përcaktimi logjik, të tilla si argumentimet në gjeometri dhe ***dije morale***, bazuar në dëshmi dhe në raporte të dorës së dytë të të dhënave shqisore.

Kjo siguri morale ishte më relevante për ligjin, historinë, dhe shumë lloje të tjera të shkencave natyrore. Edhe pse siguritë morale nuk vareshin nga prova që kërkonin

---

[13] Shapiro, Barbara J. *Beyond Reasonable Doubt and Probable Cause: Historical Perspectives on the Anglo-American Law of Evidence.* Berkeley: University of California Press, c1991 1991. http://ark.cdlib.org/ark:/13030/ft409nb30v/ , fq.6, klikuar më datë, 2 Shtator 2022.

miratim, ato ishin aq të qarta saqë gjithkush, "*gjykimi i të cilit është i lirë nga paragjykimet, do të jepte miratimin për to. Gjërat mund të jenë aq të sigurta sa të mos pranojnë ndonjë dyshim të arsyeshëm lidhur me ato*. Siguria morale, kështu, mund të vetëquhet si e padyshimtë. Njeriu i arsyeshëm "*nuk do të kërkojë demonstrim ose prova që përjashtojnë të gjitha dyshimet, dhe kërkojnë miratim*", por do të pranojë provat morale dhe fizike që janë më të mirat që mund të mblidhen, duke fituar një bindje të plotë kompetente.

"Probabiliteti" nga bota e lashtë deri në fund të shek. të XVII, tradicionalisht, kishte bashkuar së bashku ***të pasigurtën***, atë ***në dukje të vërtetë***, dhe atë ***thjesht të mundshme***. Kur provat ishin të paqarta ose dyshimi i paarsyeshëm ekzistonte, rezultati ishte një mundësi ose thjesht opinion, por jo njohuri/dije.[14] Një zhvillim i fund shek.XVII, sugjeroi se probabiliteti përbëhej nga një madhësi e shkallëzuar që shtrihej nga ***e pamundshmja***, ***përmes së mundshmes***, deri në një kategori më të lartë quajtur "***besimi i arsyeshëm***" apo "***siguri morale.***" Kjo kategori e fundit, e trajtuar ndonjëherë si "njohuri" dhe ndonjëherë si kategoria më e lartë e probabilitetit, do të kishte një ndikim të madh në të drejtën angleze.

Duhet t'i kushtojmë një vëmendje të veçantë Xhon Lokut (John Locke), jo vetëm për shkak se sistematizimi prej tij i kësaj qasjeje në një ese mbi Të Kuptuarit e Njeriut (1690), u bë tejet ndikuese, por dhe për shkak se shkrimtarët e parë të traktateve mbi provat ligjore u përpoqën të bazoheshin mbi themelet e vendosura nga Loku. Çfarë të tjerët quanin siguri morale", për Lokun ishte një lloj probabiliteti, niveli shumë më i lartë i të cilit të diktonte miratimin universal. Ky probabilitet u zhvillua "***aq afër deri në një siguri***" që qeveris "*të menduarit tonë në mënyrë po aq absolute sa demonstrimi më i dukshëm*." Nivelet e ulëta të probabilitetit prodhonin "besim," "besim të sigurt" ose "opinion të thjeshtë." Për Lokun, shkalla më e lartë e probabilitetit arrihet "kur *miratimi i përgjithshëm i të gjithë njerëzve, në të gjitha moshat. . . pajtohet me përvojën e vazhdueshme dhe asnjëherë të dështuar të një njeriu në raste të tilla, për të konfirmuar të vërtetën e ndonjë çështje të veçantë të faktit, të vërtetuar nga dëshmitarë të drejtë.*"[15]

1.2.6.3 Dilema paramoderne dhe konfuzioni i sotëm

Siç e kemi parë, fillimisht nuk ka pasur nevojë të ndërtohet një arsyetim për aftësitë e jurive në zbulimin e së vërtetës. Me rritjen e rolit të dëshmitarëve, problemi i besueshmërisë së të dhënave të rëndësisë së dorës së dytë mbi faktet, të cilat ishin themelore për teologët, natyralistët dhe historianët, u bë një çështje kryesore për teoricienët ligjorë, të cilët huazuan elemente konceptuale nga filozofia e re empirike.

Gjyqtarët e shek. të XVI, XVII dhe XVIII u përballën me detyrën e vështirë për t'u shpjeguar anëtarëve të jurive standardet që duhet të zbatonin në marrjen e vendimeve të tyre. Në common law e hershme nuk ofrohej asnjë udhëzim i veçantë në këtë drejtim. Në këtë drejtim, as burimet civile dhe kishtare nuk ishin shumë të dobishëm në procesin e të provuarit. Standardi i "përtej dyshimit të arsyeshëm" nuk ishte projektuar në fillim si një garanci procedurale për të pandehurin. Përkundrazi, ky

---

[14] Shapiro, Barbara J. *Beyond Reasonable Doubt and Probable Cause: Historical Perspectives on the Anglo-American Law of Evidence.* Berkeley: University of California Press, c1991 1991. http://ark.cdlib.org/ark:/13030/ft409nb30v/, fq. 8-9, klikuar më datë, 2 Shtator 2022.

[15] Barbara J.Shapiro, fq.12.

standard ishte projektuar për të lehtësuar marrjen e vendimit të fajësisë dhe justifikimin e dënimit ndaj të pandehurit.

Konfuzioni që ekziston sot në lidhje me aplikimin e këtij standardi është se ne kërkojmë që standardi i dyshimit të arsyeshëm t'i shërbejë një funksioni për të cilin nuk ishte projektuar fillimisht, gjë që vështirëson kuptimin e tij në procedurën bashkëkohore. Ligji nuk mund të japë një përgjigje bindëse për pyetjen se cili është kuptimi i "përtej dyshimit të arsyeshëm. Sipas mendimit të studiuesve, kjo është një pyetje përgjigjen e së cilës mund ta japë vetëm historia[16].

1.2.7 Në të drejtën shqiptare

Çështja e standardit të të provuarit në vendin tonë daton në periudhën e funksionimit të principatave feudale shqiptare. Standardi i të provuarit nuk ishte pjesë e së drejtës penale ose procedurale penale. Edhe pse, sigurisht, nuk kishte një koncept të mirënjohur juridik, ashtu siç pranohet sot, ka ekzistuar një nivel i caktuar i të provuarit, në varësi të të cilit përcaktohej nëse një person ishte i pafajshëm apo fajtor për kryerjen e një vepre penale. Ky nivel i të provuarit është mbështetur, fillimisht në misticizëm dhe më vonë në sistemin e provave ligjore, por me një lloj pavarësie të kadiut për të vendosur, duke mbartur në vetvete edhe mundësinë e arbitraritetit. Në shek. XV provohet nga dokumentet se në fushën e së drejtës bëhej dallimi midis çështjeve civile dhe penale. Në procedurën penale zbatoheshin torturat si dhe të ashtuquajturat "gjyqe të zotit" kur mungonin prova të tjera. Në këtë rast barra e provës i takonte të pandehurit. Për të provuar pafajësinë e tij, ai duhej të kapte me dorë një hekur të skuqur, të fuste dorën në ujë të valuar etj. Në rast se përballonte këto prova mbinjerëzore fitonte pafajësinë, ndryshe konsiderohej fajtor dhe dënohej nga gjykata. Gjyqet e zotit ishin një mekanizëm mesjetar, i përdorur gjerësisht në Europën feudale për të dënuar të pandehurin edhe atëherë kur mungonin provat më elementare. Ato nuk zbatoheshin ndaj klerikëve dhe shumë rrallë ndaj fisnikëve.[17]

Në periudhën e pushtimit turk, shqyrtimi i çështjeve penale bëhej para kadiut, i cili vepronte si gjyqtar i vetëm. Formës procedurale nuk i jepej rëndësi, prandaj nuk kishte kod të procedurës penale ose të procedurës civile dhe nuk bëhej dallim midis gjykimit të çështjeve penale dhe atyre civile. Akuzuesi paraqiste para kadiut kërkesën në mënyrë të qartë dhe pas kësaj kadiu pyeste të pandehurin nëse e pranonte akuzën. Nëse i pandehuri e pranonte akuzën, procedimit i jepej fund dhe vendosej sipas kërkesës së paraqitur nga akuzuesi. Në çështjet civile, kur paditësi nuk ishte në gjendje të paraqiste prova për t'i bërë të besueshme pretendimet e tij, kishte të drejtë të kërkonte nga i padituri të bënte be se nuk i detyrohej asgjë paditësit. Por beja nuk i kërkohej të pandehurit në çështjet penale. Përjashtim bëhej vetëm për të pandehurin në vjedhje. Në rast se nuk dispononte prova për vërtetimin e akuzës për vjedhje mund të kërkonte nga i pandehuri të bënte be se nuk kishte faj. I pandehuri që nuk e pranonte benë detyrohej ta kthente sendin për të cilin akuzohej se e kishte vjedhur ose të paguante vleftën e tij, por nuk dënohej. Personi në banesën e të cilit gjendej një

---

[16] James Q. Whitman, The Origins of 'Reasonable Doubt', Yale Law School, 2005, https://openyls.law.yale.edu/bitstream/handle/20.500.13051/185/0Whitman__Origins_of_Reasonable_Doubt1.pdf?sequence=2, klikuar më datë 20 shtator 2022.

[17] Grup autorësh, Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Luarasi University Press, Botim i katërt, fq. 99.

send i huaj i vjedhur dhe ai nuk e tregonte shitësin nga i cili pretendonte se e kishte blerë, i nënshtrohej torturës, por jo gjer në vdekje.

Mjete për provimin e akuzës ishin pohimi, dëshmitarët, beja. Pohimi duhet të bëhej para kadiut, nga një person madhor, i shëndoshë nga mendja dhe të shoqërohej me indicje. Dëshmia kishte vlerën e provës kur bëhej nga një person që ishte në gjendje të perceptonte drejt faktet, t'i mbante mend dhe të bënte deklarime të qarta. Nuk mund të paraqiteshin si dëshmitarë heretikët, ata që njiheshin si persona me sjellje jo të mira, që ishin gjini me palët etj. Për veprat penale nevojiteshin dy dëshmitarë meshkuj, ndërsa për disa lloje të veçanta veprash penale duheshin katër dëshmitarë. Beja ishte afirmimi i një fakti duke invokuar në seancë emrin e Allahut para kadiut. Beja përsëritej gjer në 50 herë dhe bëhej në xhami ose në ndonjë vend tjetër të shenjtë. Procedimi, sipas Sheriatit, kishte tipare të procedurës akuzatore dhe të asaj inkuizitore. Kadiu nuk kishte rol aktiv, por e zgjidhte çështjen në bazë të provave që paraqitnin palët. Në çështjen e çmuarjes së provave, megjithëse në sistemin e Sheriatit kishte disa karakteristika të sistemit të provave formale, kadiut i siguroheshin mundësi të shumta për të vepruar sipas bindjes së tij, pa qenë i detyruar të motivonte hollësisht këtë bindje.[18]

Në përfundim, mund të thuhet se standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm e ka origjinën e vet në sistemin common law. Në fillesat e veta ky standard nuk kishte kuptimin e një garancie për individët që akuzoheshin. Ky standard lindi si nevojë e anëtarëve të jurive gjyqësore për të marrë vendime të drejta në përputhje me parimet fetare e filozofike. Në sistemet e tjera ligjore kanë ekzistuar kritere të ndryshme për përcaktimin e fajësisë së personit të akuzuar. Në të drejtën tonë nuk patur një koncept mbi standardin e të provuarit. Para pushtimit turk bindja e gjyqtarit mbi fajësinë e të akuzuarit bazohej në prova, vlera e të cilave ishte e paracaktuar. Gjatë pushtimit turk gjyqtari vendoste në bazë të bindjes së tij. Kuptimi bashkëkohor mbi standardin e të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm lidhet me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe barrës së provës në ngarkim të akuzës. Ky standard është garanci për individin që akuzohet, pasi synon të shmangë gabimet e vendimeve gjyqësore. Në procesin penal ekzistojnë standarde të ndryshme të të provuarit në përputhje me fazat e ndryshme të procesit.

1.3 Barra e proves dhe standardi i të provuarit në KPrP të vitit 1980

KPrP i vitit 1980 njihte si parim themelor të tijin zbulimin e së vërtetës. Nga natyra e saj, e vërteta që kërkohej në procesin penal, ishte e vërtetë objektive. I gjithë procesi penal ishte i ndërtuar në mënyrë të tillë që të krijonte mundësi për zbulimin e së vërtetës objektive dhe mënjanimin e gabimeve gjyqësore të dëmshme për shtetin, shoqërinë dhe shtetasit. Gjetja e kësaj të vërtete ishte kusht i domosdoshëm për një luftë efektive kundër kriminalitetit. Sipas literaturës juridike të kohës[19], e vërteta objektive përfaqësonte vërtetësi të pakushtëzuar të përfundimeve të gjykatës lidhur me fajësinë e të pandehurit dhe saktësinë e rrethanave të çështjes, pajtim të plotë të këtyre përfundimeve me realitetin objektiv. Në frymën e këtij kodi ishtin të papranueshme teoritë juridike të vendeve perëndimore, të cilat theksonin se rezultati i

---

[18] Grup autorësh, Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Luarasi University Press, Botim i katërt, fq. 206-207.

[19] Grigor Gjika, etj., Procedura penale e RPSSH-pjesa e përgjithshme, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 1988, fq. 64.

procesit gjyqësor është e vërteta që del prej procesit. Literatura juridike e kohës mbante qëndrimin se probabiliteti maksimal që sipas filozofisë borgjeze është rezultat i vetëm i mundshëm për drejtësinë, përbënte një shtrembërim të teorisë procedurale penale, që kishte për qëllim të përligjte vendimet e padrejta dhe të pathemelta.[20]

Në KPrP të vitit njihej parimi i prezumimit të pafajësisë, megjithatë kodi nuk e parashikonte shprehimisht. Në nenin 5 të tij parashikohej se "Asnjeri nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e veprës penale pa vendim të gjykatës. Në bazë të këtij parimi personi që merret në përgjegjësi penale nuk konsiderohet fajtor. Kodi i mëprashmë i vitit 1953, në nenin 13 parashikonte se "I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij". Duket se kodi i 1953 shprehte më qartë parimin e prezumimit të pafajësisë. Nga interpetimi i nenit 5 të kodit të 1980 nuk rezulton shprehimisht parimi i prezumimit të pafajësisë, por parimi se fajësia e të pandehurit deklarohet nga gjykata. Deklarimi i fajësisë nga gjykata i referohet më tepër funksionit dhe rolit të gjykatës sesa prozitës procedurale të të pandehurit. Në çdo sistem, fajësia, përgjithësisht, është deklaruar me vendim të gjykatës, por për të dalluar, parimin e prezumimit të pafajësisë, shërben pozita që ka i pandehuri në procesin penal. Gjithsesi, literatura juridike, me të drejtë për kushtet e kohës, mbante qëndrimin se i pandehuri nuk quhej fajtor edhe pas dërgimit të çështjes në gjyq, dhe gjersa nuk ishte vërtetuar fajësia e tij në përfundim të shqyrtimit gjyqësor.[21]

Sipas kodit të 1980 njihej e drejta për t'u mbrojtur e të pandehurit, por ky kod mohoi të drejtën e mbrojtjes me avokat. Në këtë mënyrë nuk mund të flitet për konceptin e mbrojtjes efektive, parim i cili është përpunuar nga jurisprudenca e GJEDNJ dhe e Gjykatës sonë Kushtetuese. Sipas literaturës juridike, i pandehuri nuk kishte asnjë detyrim të vërtetonte pafajësinë e tij. Qëndrimi i literaturës juridike ishte bashkëkohor kur shprehte se mungesa e provave që vërtetojnë pafajësinë nuk kishte ndonjë vlerë për fajësinë. Fajësia nuk vërtetohet me mungesën e provave të pafajësisë, ajo duhet të vërtetohet në mënyrë pozitive, me prova të sigurta dhe objektive.

Njihej, gjithashtu, se barra për të vërtetuar pretendimin se i pandehuri është fajtor, qëndron mbi organet shtetëore. Transferimi i barrës së provës së provimit të pafajësisë mbi të pandehurin është i palejueshëm dhe i paligjshëm.[22] Nuk kishte një koncept të qartë se cili organ duhet të kishte barrën e provës në proces. Ajo ndahej ndërmjet organeve të hetimit dhe gjykatës. Theksohej se organet e hetimit dhe gjykata janë të detyruar të zbulojnë në çështjen konkrete të vërtetën, duke bërë hetime objektive, të plota dhe të gjithanëshme. Në këtë kod nuk njihej koncepti i standardit të të provuarit dhe shkallës së përmbushjes së këtij standardi nga organet shtetërore. Megjithatë, pranohej se fajësia duhet të provohej në mënyrë të padyshimtë. Në këtë drejtim, njihej edhe parimi in dubio pro reo. Sipas literaturës juridike, çdo provë që nuk është plotësisht e besueshme, kur një rrethanë është e dyshimtë, gjykata është e detyruar që këto dyshime t'i interpretojë në favor të të pandehurit. Teoritë bashkëkohore se jo çdo dyshim por 'dyshimet e arsyeshme' përbënin pengesë për gjyqtarin që të jepte vendim fajësie, konsideroheshin si antishkencore.[23]

---

[20] Grigor Gjika, etj., vepër e cituar, fq. 65.
[21] Grigor Gjika, etj., vepër e cituar, fq. 185.
[22] Grigor Gjika, etj., vepër e cituar, fq. 186.
[23] Grigor Gjika, etj., vepër e cituar, fq. 200.

Në lidhje me metodën e çmuarjes së provave, pranohej se kjo realizohej nëpërmjet bindjes së brendshme të gjyqtarit apo hetuesit. Çmuarja e provave konsiderohej një proces mendor që zhvillohej në bazë të rregullave logjikë nga gjyqtari dhe hetuesi, që ka për qëllim të përcaktojë saktësinë dhe rëndësinë e çdo lloj prove të veçantë dhe të të gjitha provave në tërësi për të arritur në përfundime të sakta e kategorike lidhur me fajësinë e të pandehurit.[24] Në ligj nuk pranoheshin rregulla e kushte në bazë të të cilave të përcaktohej rëndësia e provave, pasi këto konsideroheshin si kufizime të mundësisë së gjyqtarit për të çmuar lirisht provat. Bindja e brendshme nuk duhet të bazohej në qëndrime subjektive, irracionale dhe të pakontrolluara, por në baza objektive, pas shqyrtimit të rrethanave dhe fakteve të konstatuara në shqyrtimin gjyqësor.[25] Megjithatë, nuk përcaktohej se cili është limiti i vlerësimit të lirë të provave.

[24] Grigor Gjika, etj., vepër e cituar, fq. 205.
[25] Grigor Gjika, etj., vepër e cituar, fq. 203.

KREU II

Barra e provës dhe standardi i të provuarit në procesin penal bashkëkohor

***Përmbledhje**: **2.1** E vërteta në procesin penal. **2.2** Dallimi midis common law dhe së drejtës kontinentale. **2.2.1** Vlerësimi i provave në juridiksionet e së drejtës kontinentale. **2.2.2** Standardi i të provuarit në juridiksionet e së drejtës kontinentale. **2.2.3** Barra e provës në juridiksionet e së drejtës kontinentale. **2.2.4** Barra dhe standardi i të provuarit në juridiksionin e common law. **2.3** Dallimi ndërmjet barrës së provës dhe standardit të të provuarit të aplikuar në procesin civil dhe të atij të aplikuar në procesin penal. **2.3.1** Barra e provës në procesin civil krahasuar me procesin penal. **2.3.2** Standardi i të provuarit në procesin civil krahasuar me procesin penal. **2.3.3** Prezumimet në procesin civil krahasuar me procesin penal. **2.3.4** Efektet e vendimeve penale dhe civile/administrative. **2.3.5** Padia civile në procesin penal*

2.1 E vërteta në procesin penal

Gjetja e së vërtetës, veçanërisht në shtetet që zbatojën sistemin e *civil law,* konsiderohet si një prej gurëve të themelit të procesit të dhënies së drejtësisë penale. Është konsideruar të jetë një parakusht për një vendim gjyqësor të drejtë dhe në këtë kuptim, qëllimi përfundimtar i vërtetë i drejtësisë penale. Kjo është njohur shprehimisht në shumë kode penale europianë.[26] Qëllimi i gjetjes së të vërtetës është misioni, deri në shkallën që është njerëzisht e mundur, për të arritur në një vendim të saktë.[27]

Fakti që gjetja e së vërtetës është një objektiv parësor i drejtësisë penale, ka një impakt të fuqishëm në të gjithë procedimin penal. Në një sistem të udhëhequr drejt gjetjes së të vërtetës, të gjithë subjektet e përfshirë, përveç të akuzuarit, kanë përgjegjësinë për përcaktimin e kësaj të vërtete. Kjo përshin edhe prokurorët, të cilët duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet që të jenë në gjendje t'i paraqesin gjyqtarit të vërtetën më të plotë dhe të paanshme ose "materiale", aq sa të jetë njerëzisht e mundur.[28] Prandaj, hetimi penal duhet të kryhet pa paragjykime, i pandikuar dhe i paanshëm. Në përfundim të hetimeve paraprake prokurori duhet të paraqesë para gjyqtarit të gjithë produktin e hetimeve dhe nuk mundet që për arsye thjesht strategjike, të paraqesë vetëm një pjesë të tyre. Kjo përbën komponentin procedural të procesit të kërkimit të së vërtetës.[29]

Pyetja që shtrohet është se çfarë e vërtete kërkohet në procesin penal dhe në çfarë niveli mund të arrihet në shpalosjen e kësaj të vërtete. Kuptohet se e vërteta absolute shkon para së vërtetës relative dhe gjithnjë duhen bërë përpjekje për gjetjen e saj. E vërteta, e kuptuar në mënyrë absolute, është përputhshmëria e plotë e gjykimit tonë, përfytyrimeve tona mbi ngjarjet e kaluara ose mbi gjendjen e tanishme të një sendi me

---

[26] Karim A.A Khan, Caroline Buisman dhe Christopher Gosnell, Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 10.
[27] Po aty.
[28] Karim A.A Khan, etj., vepër e cituar, fq. 11.
[29] Po aty.

realitetin e asaj ngjarjeje apo të asaj gjendjeje, përputhshmëri e cila përjashton mundësinë e të kundërtës.[30]

Mirëpo, është fakt i pamohueshëm që e vërteta absolute nuk mund të arrihet gjithmonë as në shkencë e as në jetën e përditshme. Prandaj, si në jetën e përditshme ashtu edhe në të drejtën në përgjithësi, pra, edhe në procedurën penale, duhet të kënaqemi me të vërtetën relative. Po ashtu, as e vërteta objektive, e vërtetë për të gjithë, nuk mund të arrihet as në jetën e përditshme, e vështirë që të arrihet edhe në procedurë penale. Parë nga aspekti filozofik, e vërteta është "shprehje besnike e realitetit", kurse nga aspekti procedural, ajo është "shkalla më e lartë e vërtetësisë për veprën penale dhe për përgjegjësinë e të pandehurit".[31]

Sipas ndonjë studiuesi, në procesin penal detyra e të provuarit është konstatimi i të vërtetës, njohja e fakteve dhe e rrethanave konkrete të çështjes penale në përputhje të plotë me realitetin objektiv, duke iu përmbajtur parimit që asnjë person fajtor të mos i shmanget përgjegjësisë për veprën penale të kryer dhe që asnjë njeri i pafajshëm të mos i nënshtrohet akuzës.[32] Sigurisht, procesi penal është gjithmonë në kërkim të së vërtetës, por kjo e vërtetë nuk mund të jetë e vërteta objektive, e pavarur nga njeriu. Asnjë rast nuk mund të rindërtohet saktësisht në hetim apo në senacë gjyqësore; palët në proces parashtrojnë idetë e tyre, shpeshherë kontradiktore, të cilat i nënshtrohen gjykimit të prokurorit ose të trupit gjykues, që mishërojnë në vendimmarrje përshtypjen që kanë lënë në ndërgjegjen e tyre provat e shqyrtuara. Për këtë arsye, sinteza e vendimit tenton drejt rindërtimit të së vërtetës, por gjithmonë mbart në vetvete një probabilitetet të kundërtash që prodhojnë një të vërtetë që jo gjithmonë përputhet me atë që quhet "realiteti objektiv". Duket sikur e kalon masën e gjërave pretendimi që asnjë fajtor të mos i shmanget dot dënimit, ndërkohë që qëllim parësor mbetet që asnjë i pafajshëm të mos deklarohet fajtor nga gjykata.

Teoria moderne e provave dhe e procesit penal nuk e pranon tezën e së vërtetës objektive. Sistemet akuzatore apo të mbështetura në parimet e procesit akuzator, synojnë realizimin e të ashtuquajturës "*e vërteta procesuale*", pra, e vërteta që rezulton nga procesi gjyqësor dhe që arrihet përmes metodës dialektike të kundërvënies së tezave të kundërta.

Te këto ide e ka burimin parimi i kontradiktoritetit, i cili gjen mishërimin e vet në rregullat e pyetjes së kryqëzuar[33], të pranishme edhe në Kodin tonë (nenet 361, 363 e 365). Gjykata duke dëgjuar tezat e akuzës dhe kundërtezat e mbrojtjes, si dhe duke ua nënshtruar faktet rregullave të arsyetimit logjik, mbërrin në një sintezë, e cila përbën thelbin e vendimit gjyqësor. Kjo sintezë nuk mund të jetë e vërteta objektive, por "e vërteta e procesit", një e vërtetë që realizohet gjatë vlerësimit gjyqësor të fakteve, duke dëgjuar dhe ballafaquar idetë e palëve që parimisht kanë interesa të kundërta (prokurori dëshiron të mbrojë akuzën, kurse mbrojtja paraqit argumente për ta rrëzuar

---

[30] Prof.Dr Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006, fq. 12.
[31] Prof.Dr Ejup Sahiti, vepër e cituar, fq. 15.
[32] Izet Hoxha, 'Bazat për marrjen e një personi në përgjegjësi penale', Tribunë Juridike Nr.21, Viti i III i botimit, 1998, fq. 23.
[33] Në të drejtën angleze dhe amerikane njihet me termin cross-examination.

atë)[34]. Në literaturën juridike të huaj theksohet se *procesi penal akuzator nuk e humbet funksionin njohës të fakteve në kërkim të së vërtetës, por "kultura bashkëkohore pranon tashmë idenë se.....e vërteta mund të arrihet vetëm duke u ballafaquar idetë që ofrojnë palët në perspektivën e ndryshme të interesave të tyre."*[35]

Të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve dhe të paraqitura në kohën e zhvillimit të procesit (të quajturat provat gjyqësore), synojnë që të rindërtojnë fakte të caktuara, duke u kthyer prapa në kohë. Tërësia e këtyre të dhënave, të shqyrtuara sipas një radhe të caktuar, synon të rindërtojë faktin kriminal që ka ndodhur, duke ia nënshtruar këto të dhëna analizës që mbështetet në disa rregulla të përvojës njerëzore, në disa përfundime shkencërisht të pranuara dhe në ligjet e arsyetimit logjik. Pra, dëshmia, dokumentet, gjurma papilare, gëzhoja e qitur nga arma, etj., të shqyrtuara në kohën kur kryhen hetime apo kur zhvillohet procesi gjyqësor, bëjnë të mundur që të kuptojmë se si ka ndodhur në të shkuarën një ngjarje e caktuar, por pa mundur ta riprodhojmë dot atë.[36]
Sikundër dihet, procesi penal përqendrohet në temën e provave dhe synon të provojë faktet objekt prove (neni 150 i KPrP). Duke qenë se gjykimi është faza qendrore e procesit penal, kemi pranuar parimin e disponimit: në gjykim provat merren me kërkesën e palëve (nenet 151.2, 356 të KPrP). Pa qenë nevoja të ndalemi në përjashtimet nga ky rregull, është vendi të theksojmë se provat i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor, duke e diskutuar vërtetësinë e tyre në mënyrë të kryqëzuar, nga dy palë me interesa krejt të kundërta: akuza dhe mbrojtja. Faktet objekt prove të paraqitura si të vërteta nga akuza, në shumicën e rasteve, kundërshtohen nga mbrojtja me argumente që lëkundin ose rrëzojnë vërtetësinë e tyre. Le të marrim rastin e një dëshmitari të thirrur nga akuza. Dëshmitari paraprakisht betohet se do të thotë të vërtetën dhe ai tregon fakte të ndodhura në të kaluarën, të para apo të dëgjuara prej tij, me ndihmën e mekanizmit të kujtesës, mekanizëm i cili nuk është i pagabueshëm. Por pasi mbaron prokurori, është radha e mbrojtjes për të bërë pyetje dhe natyrshëm ajo do të procedojë me pyetje të cilat vënë në dyshim faktet që ai paraqiti. Në varësi nga përgjigjet e dëshmitarit, por edhe nga çmuarja e tyre në lidhje me të dhënat e tjera me vlerë provuese, me anën e rregullave të përvojës jetësore dhe të logjikës juridike, gjykata është e lirë të krijojë bindjen nëse faktet që paraqiti dëshmitari duhet të vlerësohen si të vërteta, si jo të vërteta apo si pjesërisht të vërteta. Pra, dëshmia si mjet prove, e vërtetë për prokurorin dhe e pavërtetë për mbrojtjen, sido që të vlerësohet nga gjykata, do të mbartë në vetvete një probabilitet të kundërtash. Kjo do të thotë se siguria gjyqësore dhe e vërteta e pranuar si e tillë në një proces, është e lidhur pazgjidhshmërisht me arsyen, me përvojën njerëzore dhe me normat e logjikës juridike.[37]

Vlerën e së mundshmes në sigurinë e vendimeve gjyqësore, e tregojnë qartë dy dispozita të Kodit:

- Neni 383.1, i cili normon që vendimi gjyqësor duhet të përmbajë *"parashtrimin e përmbledhur të rrethanave të faktit dhe provat mbi të*

---

[34] Henrik Ligori, "Leksione të procedurës penale", Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 5.
[35] Henrik Ligori, "Për të vërtetën në procesin penal", Tribunë Juridike nr. 63, Viti 2007, fq. 43.
[36] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 5.
[37] Henrik Ligori, "Për të vërtetën në procesin penal", Tribunë Juridike nr. 63, Viti 2007, fq. 45.

cilat bazohet vendimi, si dhe arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta". Ky formulim tregon se në procesin penal, si rregull, përveç provave që mbështetin një përfundim të caktuar ka edhe prova që të çojnë në përfundime të kundërta. Është detyrë e gjykatës që, në vendimin e saj, të arsyetojë pse nuk i pranon këto prova.

- Neni 456.2, i cili i referohet vendimit të rishikimit: *"Kur pranohet kërkesa e rishikimit, gjykata prish vendimin. Nuk mund të jepet vendim vetëm duke bërë një vlerësim tjetër të provave të marra në gjykimin e mëparshëm"*. Mundësia e rishikimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, në vetvete, provon faktin se siguria gjyqësore ka vlerë probabël dhe mund të cenohet nga zbulimi i provave të reja. Madje, shprehja e nënvizuar në përmbajtje të kësaj dispozite tregon qartë se gjykata e rishikimit, në rrafshin thjesht logjiko-juridik, mund t'i interpretojë provat e marra në mënyrë të tillë që të çojnë në një përfundim krejt të ndryshëm (por që i ndalohet nga parimi i pakthyeshmërisë së vendimeve gjyqësore). Pra, provat e administruara në gjykimin e parë dhe të vendosura në themel të vendimit, përderisa ekziston mundësia që të çojnë logjikisht në një rezultat krejt tjetër, kanë prodhuar vetëm një të vërtetë gjyqësore, siguria e së cilës qëndron në kufijtë e së mundshmes. Natyrisht, një siguri e tillë është e papranueshme jo vetëm në procesin tonë penal, por edhe në të gjitha sistemet juridike të vendeve të qytetëruara.[38]

Gjetja e së vërtetës ka gjithashtu edhe një komponent konjitiv/njohës. Kjo i referohet procesit të vlerësimit të gjyqtarit. Në atë që është kryesisht një proces subjektiv, gjyqtarët kanë detyrimin të përcaktojnë, sa të jetë e mundur, fakte të vërteta; jo thjesht fajësinë apo pafajësinë e një personi të akuzuar, bazuar në provat e sjella nga palët. Roli i gjyqtarit nuk është i kufizuar në atë të një arbitri. Kur është e nevojshme për përcaktimin e së vërtetës, gjyqtari duhet të shkojë përtej asaj çfarë kanë paraqitur palët, që të fitojë njohjen dhe kuptimin mbi faktet.[39]

Është çështje shumë e diskutueshme nëse qëllimi për të arritur të vërtetën objektive ose materiale, mund të arrihet në një gjykatë, që në fund të fundit përbëhet nga njerëz, mundësitë e të cilëve nuk janë të pakufizuara. E vërteta relative është niveli më i lartë i arritshëm i sigurisë, duke pasur parasysh se siguria vendoset në bazë të një gjykimi subjektiv të gjyqtarit, sipas njohurive dhe eksperiencës së tij. Njohja njerëzore është gjithnjë e pasigurt dhe për më tej, i përngjan besimit. Prandaj, pak rëndësi ka sesa të kujdesshëm janë gjyqtarët në ushtrimin e detyrës së tyre për gjetjen e së vërtetës; ky proces asnjëherë nuk mund të çojë në zbulimin e së vërtetës absolute. Duke u përpjekur në gjetjen e së vërtetës, gjyqtarët nuk kanë zgjidhje tjetër, veçse të bazohen në atë se çfarë të tjerët apo dokumentet thonë se ka ndodhur. Në rastin më të mirë, ata janë dëshmitarë të dëshmitarëve.[40]

---

[38] Henrik Ligori, "Për të vërtetën në procesin penal", Tribunë Juridike nr. 63, Viti 2007, fq. 46.
[39] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 12.
[40] Po aty.

Kështu, mund të themi se në procedurën penale nuk përjashtohet mundësia që në një çështje penale konkrete, me një sasi të caktuar provash, një gjyqtar ta deklarojë fajtor të pandehurin, kurse për një gjyqtar tjetër, të njëjtat prova të mos mjaftojnë. Pra, në sendërtimin e vendimit gjyqësor me të cilin konstatohet e vërteta në procedurën penale, kontribuuon edhe bindja e brendshme e gjyqtarit, e cila përmban elemente të karakterit subjektiv, meqë gjatë çmuarjes së provave, secili gjyqtar fut në veprim shprehitë e veta.[41] Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm luan zbatimi i vlerësimit të provave sipas bindjes së lirë të gjyqtarit. Pjesë e kësaj bindjeje janë niveli arsimor i gjyqtarit, mundësitë e tij intelektuale, gjakftohtësia në gjykim dhe veti të tjera.

Lidhur me shkallën e sigurisë që garanton një vendim gjyqësor, natyrisht që kërkohen standarde të caktuara. Përndryshe do t'i hapej rruga vendimeve arbitrare me pasojë shformimin e parimeve dhe qëllimit të procesit penal në shoqeritë demokratike, kurse instituti përjashtimor i rishikimit do të rrezikonte të kthehej në rregull. Në një shtet të së drejtës mund të ndodhë që fajtori të shpëtojë pa u ndëshkuar, por është e papranueshme që të dënohet një person i pafajshëm. Gjyqtari duhet të interpretojë çdo dyshim të arsyeshëm në favor të të akuzuarit. Nëse në përfundim të gjykimit, gjyqtari ka një dyshim lidhur me fajësinë e të pandehurit, atëherë ai duhet ta shpallë atë të pafajshëm. Prandaj, e drejta anglosaksone ka pranuar pa mëdyshje standardin që fajësia e të akuzuarit, në përfundim të gjykimit duhet të provohet *"përtej çdo dyshimi të arsyeshëm"*. Drejt një standardi të tillë është orientuar, në vijëmësi, edhe legjislacioni i vendeve europiane ku vepron e drejta kontinentale.[42]

2.2 Dallimi midis common law dhe së drejtës kontinentale

2.2.1 Vlerësimi i provave në juridiksionet e së drejtës kontinentale

Juridiksionet e *civil law* kanë adoptuar një sistem të lirë të provave, ku gjyqtarët nuk janë të detyruar nga ndonjë rregull në vlerësimin e provave. Është konstatuar se rregullat që kanë të bëjnë me lejimin dhe paraqitjen e provave janë fleksibël. Në këtë kuptim, juridiksionet e civil law ndryshojnë nga ato të common law, në të cilat lejimi dhe paraqitja e provave i nënshtrohet rregullave strikte. Gjithsesi, kur vjen puna te procesi i vlerësimit, është e vështirë të bëhet një dallim i qartë ndërmjet këtyre juridiksioneve. Për më tepër, sistemet e civil law dallojnë nga njëri – tjetri në këtë aspekt.[43]

Ekzistojnë tre tipe të sistemeve të vlerësimit. *I pari* është sistemi i vlerësimit të lirë, i parashikuar, *inter alia*, nga Belgjika dhe Franca. Gjyqtarët në këto sisteme janë, me të vërtetë të lirë në vlerësimin e provave. Nuk ekzistojnë kërkesa ligjore që duhet të zbatohen. Ligji nuk dikton burimet e provave dhe gjyqtarët janë plotësisht të lirë të lejojnë dhe mbështeten në çdo lloj prove që e konsiderojnë të përshtatshme. Nuk ka një prag të provave që janë të nevojshme për një dënim. Kërkesa e vetme për dënimin është që gjyqtarët të jenë të bindur për fajësinë e të akuzuarit.[44]

---

[41] Prof.Dr Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006, fq. 14.
[42] Henrik Ligori, "Leksione të procedurës penale", Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 6.
[43] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 34.
[44] Po aty.

Në ngjashmëri me sistemin belg dhe francez të drejtësisë penale, juria e common law është plotësisht e lirë në vlerësimin e provave të paraqitura para tyre. Juria nuk e ka të nevojshme të justifikojë vendimin e saj, i cili thjesht përcakton "fajtor" ose "jo fajtor". Juritë franceze dhe belge, gjithsesi, ekzistojnë vetëm në rastet që kanë të bëjnë me krimet që gjykohen në të ashtuquajturën Gjykata e Asizit, ku në trupin gjykues bëjnë pjesë edhe qytetarë të caktuar me short. Në çështjet e gjykuara vetëm nga gjyqtarët, duhet të nxirret një vendim i arsyetuar.[45]

Ndryshe nga Franca dhe Belgjika, ku çdo provë paraqitet para trupi gjykues në sistemin e common law gjyqtari i procedurës paraprake vendos për pranueshmërinë e provave në mungesë të jurisë dhe përpara se provat të paraqiten para saj. Për më tepër, nëse besueshmëria e provave të pranuara është në diskutim, gjyqtari është i detyruar t'u japë antarëve të jurisë udhëzime të përshtatshme, të cilat kur nuk respektohen përbëjnë shkak të pranueshëm për apelim. Gjithsesi, juria nuk është e detyruar nga ky paralajmërim. Në Francë dhe Belgjikë, gjyqtarët profesionistë dhe gjyqtarët popullorë vendosin së bashku nëse është vërtetuar apo jo fajësia e të akuzuarit. Kështu që, nuk ka nevojë për një paralajmërim apo udhëzim në lidhje me provat e dyshimta.[46]

Tipi i dytë i sistemit të vlerësimit quhet sistemi ligjor mohues/negativ; konsiderohet ligjor, pasi provat duhet të plotësojnë disa kushte ligjore; konsiderohet mohues/negativ, sepse gjyqtarët mund të refuzojnë prova të tilla, edhe nëse janë plotësuar kushtet ligjore. Ky sistem është një sistem i ndërmjetëm midis sistemit të vlerësimit të lirë të provave dhe sistemit të provave ligjore. Gjyqtarët duhet të arsyetojnë me shkrim vendimin e tyre që refuzon ose pranon provat për përcaktimin e fajësisë së të akuzuarit. Për më tepër, ky sistem mund të parashikojë pragun e provave që janë të mjaftueshme për dënimin. Një shembull është parimi *unus testis nullus testis*[47], sipas të cilit një provë me dëshmitarë duhet të konfirmohet nga prova të tjera me qëllim që të jepet një dënim i bazuar. Prandaj, gjyqtarët mund të jenë ligjërisht të detyruar për të deklaruar të pafajshëm të akuzuarin, por nuk janë asnjëherë të detyruar ligjërisht për të dënuar të akuzuarin. Hollanda dhe Gjermania kanë adoptuar një tip të sistemit ligjor mohues.[48]

Nëse gjyqtarët janë të detyruar të mbështeten në çdo provë e cila plotëson kushtet e përcaktuara ligjore, ose të japin një vendim fajësie kur kërkesat minimale ligjore janë plotësuar, një sistem i tillë kategorizohet si sistemi ligjor pozitiv, i cili përbën dhe *tipin e tretë* të sistemit të vlerësimit. Sistemi ligjor pozitiv nuk përdoret sot, por ka qenë sistemi mbizotërues në origjinën romano – kishtare, e cila u kishte atrubuar një peshë specifike kategorive të caktuara të provave.[49] Ky sistem u rrëzua në Francë më 1791. Në një sistem ligjor pozitiv, gjyqtarët nuk ishin të lirë në vlerësimin e provave, por duhet të aplikonin në mënyrë strikte ligjin. Kështu, ligji jo vetëm diktonte rrethanat se kur një i akuzuar duhej të shpallej i pafajshëm, por diktonte, gjithashtu,

---

[45] Po aty.
[46] Po aty.
[47] Një dëshmitar i vetëm nuk është dëshmitar.
[48] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 34.
[49] Kjo çoi në përdorimin e torturës, pasi, nëse i akuzuari nuk tregonte, ishte e vështirë të përmbushej sasia minimale e provave të kërkuar për një dënim sipas ligjit kanonik romak.

edhe rrethanat se kur një i akuzuar duhej të dënohej. Si një reagim kundër këtij sistemi të ngurtë dhe për të krijuar sa më shumë hapësirë për një vlerësim rast pas rasti të çështjeve, shumë juridiksione të civil law adoptuan sistemet e lirisë të provës.[50] Në një sistem ligjor mohues, gjyqtarët janë plotësisht të lirë në vlerësimin e provës, sapo plotësohen kushtet ligjore për dënimin. Gjithsesi, gjyqtarët nuk kanë diskrecion për të pranuar një provë, të cilën e konsiderojnë të besueshme, por janë të detyruar nga zgjedhjet e ligjvënësit se cilat prova duhet të jenë të pranueshme.

2.2.2 Standardi i të provuarit në juridiksionet e së drejtës kontinentale

Standardi i të provuarit është i ngjashëm, por jo identik në të gjitha juridiksionet e civil law. Në sistemet e lirisë së provave, si në sistemin francez dhe belg, standardi i të provuarit është "bindja intime" e gjyqtarit (bindja e brendshme apo vetjake e gjyqtarit).[51] Ky standard shkon përkrah me parimin e vlerësimit të provave. Në këto sisteme, gjyqtarët i vlerësojnë provat në dispozicion, në liri të plotë dhe e japin vendimin në përputhje me ndërgjegjen e tyre vetjake. Ligji nuk krijon hierarki ndërmjet llojeve të ndryshme të provave që mund të paraqiten para gjykatës. Gjithsesi, bindja e brendshme duhet të bazohet në elementë që kanë dalë në gjyq gjatë debatit kontradiktor të palëve.[52] Ndryshe nga standardi i common law, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, i cili nënkupton një nivel objektiviteti, standardi i *bindjes së brendshme*, është qartësisht subjektiv dhe nuk mund të testohet në përputhje me standardet objektive. Për këtë arsye, është e vështirë të përcaktosh me saktësi se çdo do të thotë kur gjyqtari është i bindur personalisht për fajësinë e të akuzuarit.[53]

Niveli i bindjes së brendshme apo vetjake që kërkohet për të gjetur fajësinë, në sistemet e vlerësimit të lirë të provave duhet të konsiderohet në përputhje me parimin *in dubio pro reo*[54], sipas të cilit dyshimi duhet të interpretohet në favor të të akuzuarit. Kjo lidhet me prezumimin e pafajësisë, një parim i njohur ndërkombëtarisht në procedurën penale. Prezumimi i pafajësisë është parashikuar në nenin 6 (2) të KEDNJ-së, i cili është mishëruar në legjislacionet e brendshme ose është i aplikueshëm drejtpërdrejtë në të gjitha sistemet europiane të civil law.[55]

Në dritën e parimit *in dubio pro reo*, standardi i *bindjes së brendshme*, shpesh, barazohet me standardin e të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Madje, është sugjeruar se standardi i *bindjes së brendshme* është më i lartë se standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, për shkak të qëllimit për të arritur të vërtetën objektive. Në të vërtetë, nëse rezulati i procedimit penal ka për qëllim të barazohet me të vërtetën objektive, standardi duhet të jetë i një sigurie absolute. Megjithatë, kjo është e realizueshme vetëm nëse pranohet që aktualisht është e mundur të arrihet siguria absolute. Siç është përmëndur më sipër, nuk mund të besohet se një standard i sigurisë absolute është i arritshëm në përfundim të një procesi gjyqësor. Prandaj, studiuesit

---

[50] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 35.
[51] Neni 355 i Kodit të Procedurës Penale franceze, Neni 342 i Kodit të Procedurës Penale belge
[52] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 36.
[53] Karim A.A Khan, etj., vepër e cituar, fq. 37.
[54] In dubio pro reo: term i vjetër latin i përdorur në vendet e traditës civil law.
[55] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 37.

konkludojnë se standardi është i *një sigurie të arsyeshme* dhe jo *i një sigurie shkencore*, i cili është i ngjashëm me standardin e përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.[56]

Të tjerë studiues, kanë pikëpamjen tjetër se standardi i bindjes së brendshme është më i ulët se standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Sipas studiuesit Paul De Hert, të barazosh dy standardet nuk e adreson idenë fikse të sistemit kontinental për të vërtetën objektive që duhet të arrihet për të mirën e përgjithshme. Në modelin akuzator bindje nuk do të thotë siguri dhe një shtet që dënon njerëzit pa siguri nuk duhet të besohet. Me fjalë të tjera, standardi amerikan i të provuarit është më i lartë dhe e bën më të vështirë për prokurorinë për t'u pajtuar me një dënim.[57]

Të tjerë studiues ndajnë këtë pikëpamje me arsyetimin se ndërsa gjyqtari mund të jetë plotësisht i bindur personalisht për korrektësinë e gjykimit të tij, asnjë bindje vetjake nuk mund të jetë e sigurt. Në të kundërt, një bindje personale e tillë mund të jetë shumë çorientuese për sa kohë që bazohet thelbësisht te instikti, i cili mund të jetë ndikuar nga paragjykime të pandërgjegjshme. Prandaj, mendohet se bindjes së brendshme rreth fajësisë së të akuzuarit i jepet më shumë besim sesa duhet, ndërkohë që kjo nuk mund të testohet/provohet.[58]

Një tjetër standard i civil law që mund të afrohet me standardin e përtej dyshimit të arsyeshëm dallohet nga standardi i bindjes së brendshme. Kjo është *bindja e arsyeshme*.[59] Sipas këtij standardi gjyqtarët duhet ta mbështesin bindjen e tyre në burimet e ligjshme të njohura të provave dhe të japin arsye për bindjen e tyre. Kritikët e standardit të bindjes së brendshme preferojnë standardin e bindjes së arsyeshme, sepse është më transparent dhe i kontrollueshëm dhe më pak i ndikuar nga gabimi njerëzor. Gjetjet faktike të arsyetuara mund të apelohen. Çdo mosmarrëveshje për korrektësinë e gjetjeve faktike do të zgjidhet, në këtë mënyrë, nga një gjykatë më e lartë. Për më tepër, aplikimi i njëjtë i ligjit garantohet më mirë.[60]
Standardi i *bindjes së arsyeshme* është aplikuar në Hollandë që nga viti 1938, por është fuqizuar ndër vite, veçanërisht nën ndikimin e KEDNJ. Gjermania tradicionalisht ka pranuar një sistem të lirisë së provave, ku është zbatuar standardi i *bindjes së brendshme*. Megjithatë, në dekadën e fundit, jurisprudenca e gjykatave gjermane gradualisht ka shtrënguar kërkesat e vendosura mbi gjyqtarët për gjetjen e fakteve dhe ka zhvilluar një standard arsyetimi më të rreptë. Prandaj, në ditët e sotme, standardi gjerman i përngjet standardit të *bindjes së arsyeshme*.[61]

2.2.3 Barra e provës në juridiksionet e së drejtës kontinentale

Doktrina mbi barrën e provës është zhvilluar në sistemin common law. Sipas kësaj doktrine, barra e provës përbëhet nga dy aspekte: (i) barra ligjore ose e bindjes; dhe (ii) barra provuese ose prodhuese. Sipas doktrinës së common law, këto dy koncepte

---

[56] Po aty.
[57] Po aty.
[58] Po aty.
[59] Në gjuhën frënge 'Conviction raisonnée'.
[60] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 37.
[61] Po aty.

janë mekanizma për shpërndarjen e rrezikut të gabimit në vendimin gjyqësor.[62] Barra provuese ose prodhuese i referohet detyrimit që ka prokurori për të sjellë prova në sasinë e mjaftueshme në mënyrë që të mbështesë versionin për fajësinë e të pandehurit. Ndërsa, barra ligjore ose e bindjes i referohet detyrimit që ka prokurori për të provuar versionin e tij të çështjes në një shkallë të caktuar bindjeje dhe probabiliteti për fajësinë e të akuzuarit. Në rast se nuk përmbushet qoftë edhe një prej këtyre aspekteve të barrës së provës, atëherë i pandehuri deklarohet i pafajshëm.[63] Në procesin penal, ku prokurori ka akuzuar të pandehurin për një vepër penale të caktuar, është në ngarkim të prokurorit që të paraqesë prova, të cilat, në rastin e fajësisë së të pandehurit, duhet të bindin gjykatën përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Barra e prodhimit vendos vetëm detyrimin për të sjellë prova të mjaftueshme në mënyrë që një pretendim të bëhet pjesë e çështjes në gjykim. Në ndryshim nga barra e bindjes, barra e prodhimit të provave nuk i kërkon atij, mbi të cilin rëndon kjo barrë, të arrijë një shkallë të caktuar bindjeje, në mënyrë që të ndikojë në mendjen e gjyqtarit. Në këtë kuptim, barra e prodhimit nuk kërkon që të bindet gjyqtari për të vërtetën e ndonjë fakti të çështjes.[64] Lë të marrim rastin e një akuze për vrasje[65], ku i akuzuari pretendon se ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Në këtë çështje barra e prodhimit dhe barra e bindjes ndryshojnë. Barra për ta bërë çështjen e mbrojtjes së nevojshme, pjesë të gjykimit, rëndon mbi të pandehurin, por barra për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë qëndron gjithnjë mbi organin e akuzës. I pandehuri duhet të sjellë ose së paku të identifikojë[66] disa të dhëna për pretendimin e mbrojtjes së nevojshme, përndryshe gjyqtari nuk ka mundësi të vihet në dijeni të këtij fakti. Sapo pretendimi për mbrojtjen e nevojshme bazohet në një të dhënë, detyrimi i prokurorisë për të provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se vrasja ka qenë e paligjshme, zgjerohet akoma më shumë. Në një rast të tillë organit të akuzës i duhet të provojë edhe se i pandehuri nuk ka qenë në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Duke qenë se i pandehuri nuk mbart barrën e bindjes, ai duhet vetëm të sjellë prova, në mënyrë që të krijojë një dyshim të arsyeshëm se ai ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme. Arsyeja e ndarjes së barrës së provës nga barra e prodhimit qëndron në nevojën për të shmangur shpërqëndrimin e vëmëndjes së palës tjetër dhe gjyqtarit me pretendime të cilat janë tërësisht të pambështetura me prova.[67] Sipas studiuesve të sistemit common law, rregulli që organi i akuzës duhet të provojë fajësinë e të pandehurit nuk do të thotë që akuza duhet të parashikojë dhe t'i paraprijë çdo shpjegimi të besueshëm që mund të ofrojë i pandehuri. Në këtë kuptim, barra e prodhimit të provave e bën gjykimin më efiçent, megjithatë, kjo efiçencë ka një çmim të caktuar. Mund të ndodhë që edhe pse i pandehuri ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme, të mos ketë mundësi të sjellë para gjyaktës një provë që tregon këtë

---

[62] Paul Roberts, Adrian Zuckerman, Criminal evidence, second edition, Oxford University Press, 2010, fq. 226, 227.
[63] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 38.
[64] Paul Roberts, Adrian Zuckerman, Criminal evidence, second edition, Oxford University Press, 2010, fq. 228.
[65] Paul Roberts, Adrian Zuckerman, vepër e cituar, fq. 229.
[66] Barra e prodhimit mund të përmbushet në disa mënyra. Nuk është e nevojshme gjithnjë të paraqiten prova që përmbushin këtë barrë; mund të mjaftojë psh. rasti kur mbrojtja merr përgjigje të favorshme për versionin e saj nga ekzaminimi i tërthortë i një dëshmitari të akuzës (cross-examination).
[67] Paul Roberts, Adrian Zuckerman, Criminal evidence, second edition, Oxford University Press, 2010, fq. 229.

fakt. Situatat ku i pandehuri nuk e ka një mundësi të tillë janë të rralla dhe në këtë rast ai mundet që me pëlqimin e vet të japë deklarime para gjykatës.

Në juridiksionet e civil law koncepte të tilla janë të panjohura. Në shumicën e këtyre juridiksioneve, kodet e procedurave penale dhe të provave, nuk parashikojnë në mënyrë të shprehur nëse prokurori ka ndonjë barrë për të provuar çështjen kundër të akuzuarit. Për shembull, neni 338 i KPrP gjermane parashikon që gjyqtari mund të japë një dënim, nëse bindet për fajësinë e të akuzuarit mbi bazën e provave, që përmbushin standardet e kërkuara ligjore. Megjithatë, nuk tregon se prokurori duhet të provojë këtë fajësi.[68]

Gjithsesi, ashtu si në common law, edhe në sistemet e civil law, i pandehuri gëzon të drejtën e mbrojtjes nga vetëinkriminimi. Kjo buron nga parimi i prezumimit të pafajësisë, i cili është përfshirë pothuajse në të gjitha kodet e brendshme. Nga ky parim buron se i pandehuri nuk ka barrën të provojë pafajësinë e tij, të paraqesë ndonjë provë apo të dëshmojë. E megjithatë, kjo nuk do të thotë automatikisht se barra për të demostruar fajësinë e të akuzuarit i takon prokurorit[69], ndonëse nuk ka asnjë dyshim dhe është pranuar se kjo barrë bie mbi akuzën.

Në sistemet e common law, testi është nëse prokurori i ka provuar akuzat kundër të pandehurit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Kësisoj, theksi vihet tek detyrimet e prokurorisë. Përkundrazi, në sistemet e civil law, testi është nëse i akuzuari është fajtor apo jo. Në përputhje me këtë test, gjyqtarët, mjaftueshëm të ndarë dhe të pavarur nga palët, duhet të vlerësojnë nëse i akuzuari është apo nuk është fajtor sipas asaj që akuzohet. Palët mund të jenë aktive aq sa mund të konsiderohet e përshtatshme për të asistuar gjyqtarët të përcaktojnë nëse i akuzuari është fajtor sipas asaj që akuzohet apo jo. Prandaj, nuk është e qartë nëse prokurori ka barrën e provës apo barrën e bindjes apo të dyja. Në shumicën e juridiksioneve të civil law, barra e provës duket sikur ndahet ndërmjet prokurorit dhe gjyqësorit. [70] Megjithatë, pavarësisht se nuk parashikohet shprehimisht në kode, pranohet se akuza ka barrën e provës për të bindur gjykatën se i pandehuri është fajtor.

Prokurori ka detyrën të mbledhë provat dhe të përgatisë çështjen kundër të akuzuarit. Një çështje shkon në gjykatë vetëm kur prokurori, ose në disa shtete, gjyqtari hetues, të ngrejë akuzë kundër një të akuzuari. Në sistemet ku gjyqtari hetues ngre akuzën, prokurori mbart vetëm barrën për të sjellë provat, përveç inicimit të hetimeve paraprake dhe mbledhjes së provave pranë gjyqtarit hetues. Në sistemet ku prokurori është përgjegjës për ngritjen e akuzës, kjo normalisht kërkon aprovim paraprak nga gjyqtari hetues ose gjykata. Një aprovim i tillë do të jetë i disponueshëm vetëm atëherë kur prokurori ka ngritur një çështje *prima facie.*[71] Në shtetet ku një aprovim i tillë nuk kërkohet, akuza mund të sfidohet si nga i pandehuri, ashtu edhe palët civile. Nëse nuk ka prova të mjaftueshme, çështja kundër të akuzuarit do të pushohet përpara

---

[68] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 39.
[69] Po aty.
[70] Po aty.
[71] Një çështje *prima facie* ka kuptimin kur akuza bazohet në prova mjaftueshmërisht të forta, të cilat mund të rrëzohen vetëm nëse pala tjetër paraqet prova që i kundërshtojnë. http://thelawdictionary.org/prima-facie/, klikuar për herë të fundit më datë 15.11.2022.

gjykimit. Prandaj, prokuroria ka të paktën, një barrë për prodhimin e sasisë së provave të mjaftueshme për të demostruar se një çështje ekziston *prima facie.*[72]

Për më tepër, një dosje duhet të plotësohet përpara gjykimit. Në disa juridiksione të civil law, prokurori është përgjegjës për hartimin e dosjes. Në juridiksione të tjera, gjyqtari hetues është përgjegjës për hartimin e dosjes. Sido që të jetë, prokurori ka një kontribut domethënës në formimin e dosjes duke dërguar shumicën e provave të fajësisë. Hartimi i dosjes është në një shkallë të madhe një përpjekje e përbashkët midis gjyqtarit hetues dhe prokurorit. Pa dosje, nuk ka çështje. Prandaj, prokurori ka barrën e prodhimit të paktën të disa provave inkriminuese, të cilat i shtohen dosjes.[73]

Ky detyrim mbi prokurorin për të hartuar dosjen ose për të asistuar në hartimin e saj, gjithsesi, nuk është e njëllojtë me detyrimin e prokurorit në sistemin common law për të përmbushur barrën e paraqitjes së provave. Mungesa e plotësisë së dosjes nuk do të thotë patjetër se do të jepet vendim pafajësie. Në vend të kësaj, nëse nga këndvështrimi i gjyqtarëve të çështjes, dosja është e paplotë, gjyqtarët mund të ndërmarrin hetimet e tyre të pavarura, të urdhërojnë hetime shtesë ose të thërrasin dëshmitarë shtesë për të plotësuar provat e sjella nga prokurori dhe gjyqtari hetues. Kështu, në përputhje me detyrën e tyre për të siguruar që vlerësimi i çështjes në gjykim, është i plotë dhe i saktë, gjyqtarëve u është dhënë e drejta të plotësojnë çështjen e prokurorit dhe të sjellin prova shtesë të nevojshme për të zbuluar fajësinë.[74]

Prokurori në juridiksionet e civil law duket se ka akoma më pak barrën e bindjes. Në mënyrë që të japë një dënim, gjyqtarët duhet të binden për fajësinë e të pandehurit.

Megjithatë, duke qenë se shumica e juridiksioneve të civil law kanë adoptuar sistemin e lirisë së provës, gjyqtarët janë plotësisht të lirë në vlerësimin e provave që gjenden në dosje. Gjyqtarët pritet të shqyrtojnë me hollësi dosjen dhe të vlerësojnë peshën e të gjitha provave në dispozicion në kontekstin e tërësisë së provave dhe në mënyrë të pavarur nga palët. Nëse dosja nuk hedh dritë të mjaftueshme për të krijuar bindje lidhur me zgjidhjen e çështjes kundër të pandehurit, gjyqtarët mund të pyesim palët dhe të pandehurin me pyetje sqaruese. Gjyqtarët mund të shikojnë përtej asaj çfarë gjendet në dosje për të gjykuar mbi faktet dhe të mbështeten në vëzhgimin e tyre personal.[75]

Qasja e civil law është në përputhje me objektivin e saj për të arritur të vërtetën. Arsyetimi është se e vërteta nuk është e varur nga palët. Barra e të provuarit dhe standardet mund të bëhen pengesa potenciale në rrugën për të vendosur të vërtetën. Studiuesi Juliane Kokott, i cili ka kryer kërkime mbi barrën e të provuarit në ligjin ndërkombëtar dhe të krahasuar të të drejtave të njeriut ka theksuar se[76]:

> *Në procedimet akuzatore, barra e prodhimit të provave u është dhënë palëve, ndërsa gjykata është e kufizuar vetëm në shqyrtimin e provave*

---

[72] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 39.
[73] Po aty.
[74] Po aty.
[75] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 40.
[76] Karim A.A Khan, etj., vepër e cituar, fq. 41.

të paraqitura nga ato. Kështu që, mungesa e prodhimit të provave nga një palë mund të çojë në refuzimin e pohimeve/konstatimeve të asaj pale. Në të kundërt, kjo barrë teknike e prodhimit të provave nuk aplikohet në proceset inkuizitore, ku gjyqtarëve mund t'u kërkohet madje të hetojnë dhe të gjejnë provat me iniciativën e tyre. Për pasojë, mungesa e prodhimit të provave ose mungesa e bashkëpunimit me gjykatën për gjetjen e së vërtetës materiale, nuk çon automatikisht në refuzimin e akuzës në sistemin inkuizitor. Megjithatë, pas shqyrtimit të të gjitha provave, duke përfshirë edhe hetimet e kryera nga vetë gjykata, gjyqtari mund të jetë ende në baraspeshë ose jo në gjendje për të arritur shkallën e nevojshme të bindjes.

2.2.4 Barra dhe standardi i të provuarit në juridiksionin e common law.

Në sistemin e common law, rregullat mbi barrën dhe standardin e të provuarit, janë të një rëndësie të madhe. Këto rregulla përfaqësojnë kuadrin brenda të cilit gjyqtari duhet të vlerësojë provat në tërësi në mënyrë që të arrijë në një vendimmarrje. Pa rregullin e barrës së provës, gjyqtari nuk ka një pikë fillimi të vlerësimit të provave dhe bazë për dhënien e një vendimi të drejtë në një çështje ku provat janë të drejtpeshuara. Pa rregullin e standardit të provës, gjyqtari nuk ka një udhëzues për nivelin e bindshmërisë që duhet të kenë provat e paraqitura nga pala e cila ka barrën e provës, të nevojshme për të marrë një vendim në favor të asaj pale. Rregulli i pandryshuar i common law në çështjet penale është që prokurori ka barrën të provojë fajësinë e të akuzuarit dhe se kjo barrë përmbushet nga të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm. I akuzuari nuk ka detyrim të provojë pafajësinë e tij, në kuptimin që nuk ka detyrim të hedhë poshtë elementët e veprës penale për të cilën akuzohet. Megjithatë, në parim, nuk ka kundërshtim që të akuzuarit t'i ngarkohet barra e provës kur parashtron para gjykatës një pretendim bazuar në një institut të ligjit penal që e përjshton nga përgjegjësia penale ose e zvogëlon këtë përgjegjësi.[77] Një ide e tillë në sistemin common law konsiderohet e pranueshme për sa kohë që të akuzuarit nuk i kërkohet të hedhë poshtë ndonjë element të veprës penale për të cilën akuzohet. Kësisoj parimesh në lidhje me ndryshimin e barrës së provës parashikohen edhe në vetë ligjet e common law. Konkretisht, sipas Aktit "*Mbi parandalimin e krimit*" i vitit 1953[78] konsiderohet vepër penale kur i akuzuari mban një armë vdekjeprurëse në një vend publik, por është mbrojtje për të akuzuarin kur ai provon se kishte një autorizim të ligjshëm ose një justifikim të arsyeshëm për posedimin e armës. Kjo barrë e përmbysur është tashmë e dyshimtë në termat e procesit të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ, dhe në mungesë të një arsye bindëse për caktimin e barrës së përmbysur te i akuzuari, dispozita duhet të interpretohet se parashikon që i akuzuari ka barrën për të paraqitur para gjykatës disa prova të mjaftueshme, në mënyrë që të mbështesin pretendimin e tij, ndërsa prokuroria ka barrën ligjore për të hedhur atë poshtë përtej dyshimit të arsyeshëm.[79]

---

[77] Në doktrinën common law institutet e së drejtës penale që përjashtojnë të pandehurin nga përgjëgjësia penale ose e zvogëlojnë këtë përgjegjësi quhen mbrojtje afirmative. Me termin 'mbrojtje afirmative' kuptohen mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, kushtet e tronditjes së fortë psiqike të çastit etj.

[78] Ligj në Angli.

[79] Karim A.A Khan, etj., Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010, fq. 105.

Edhe pse çështja nuk është trajtuar në mënyrë eksplicite nga dokumentet e gjykatave vendase ose ndërkombëtare, të gjitha gjykatat duket se kanë adoptuar rregullat e common law lidhur me barrën dhe standardin e të provuarit. Prandaj, çdo person i cili akuzohet para një gjykate të vendit apo ndërkombëtare ka të drejtën e prezumimit të pafajësisë, barra qëndron mbi prokurorinë për të provuar fajësinë përtej një dyshimi të arsyeshëm, me qëllim që të jepet një dënim.

Rregullat e Gjykatës Ndërkombëtare Penale hedhin një hap më tej duke garantuar në mënyrë eksplicite se i akuzuari nuk ka në ngarkim të tij ndojë barrë të përmbysur apo barrën e përgënjeshtrimit/kundërshtimit.[80]

Si përfundim, duhet theksuar se shtetet e familjes civil law kanë filluar të adoptojnë konceptet ligjore të sistemit common law në lidhje me standardet e të provuarit. Italia ka bërë ndryshime legjislative në KPrP italiane duke përfshirë standardin e përtej dyshimit të arsyesëhm. Ky standard, i cili aplikohet në gjykimin e themelit, duhet të udhëheqë gjykatën në dhënien e vendimit të fajësisë. Konkretisht, me ligjin nr. 46/2006, ligjvënësi italian ka ndryshuar nenin 533 të KPrP italiane. Kjo dispozitë parashikon se gjyqtari deklaron vendimin për dënimin, nëse i pandehuri rezulton fajtor përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ky parashikim është bërë shkas për debate të shumta juridike. Sipas disa studiuesve[81], parashikimi i standardit të të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm ka karakter kryesisht përshkrues dhe jo substancial, duke pasur parasysh se edhe më parë dyshimi i arsyeshëm mbi fajësinë e të pandehurit sillte pushimin e çështjes, sipas nenit 530 të KPrP italiane. Me parashikimin e rregullit të gjykimit përtej dyshimit të arsyeshëm, ligjvënësi nuk ka prazantuar një kriter të ndryshëm dhe më rigoroz për vlerësimin e provave, krahasuar me atë që ka pasur më parë kodi. Ligjvënësi thjesht ka formalizuar një parim të elaboruar tashmë nga jurisprudenca, sipas të cilit dënimi është i mundur nëse rezulton siguria procesuale mbi përgjegjësinë e tij[82]. Në rastet e pamjaftueshmërisë apo kontradiktave të provave, i pandehuri shpallej i pafajshëm. Në Gjermani, siç e përmendëm më sipër, gjykatat janë orientuar drejt aplikimit të një standardi të provuari më rigoroz se ai i aplikuar më parë. Ky standard është *bindja e arsyeshme*, i cili i përngjet standardit të *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*.

2.3 Dallimi ndërmjet barrës së provës dhe standardit të të provuarit të aplikuar në procesin civil dhe të atij të aplikuar në procesin penal.

Në çështjet civile ligji synon të ruajë asnjëanësinë mes palëve dhe përpiqet t'i mbajë ato në pozicione të barabarta për aq sa është e mundur. Rëndësia që paraqet barra e provës në procesin civil nuk është e nivelit që kërkohet në procesin penal, por përmes saj synohet të ruhet drejtpeshimi mes palëve dhe të mundësohet zgjidha më e mirë.[83] Standardi i zbatuar në procesin civil ndryshon nga ai i procesit penal, nisur nga

---

[80] Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale, Neni 67 (i).
[81] Giovanni Conso, Vittorio Grevi, Commentario breve al codice di procedura penale, 7 edizione, CEDAM, 2011, fq. 2165.
[82] G.Borelli, Codice di procedura peanle operativo, VI edizione, Edizoni Siomone, giugno 2010, fq. 932.
[83] Peter Murphy, Murphy mbi provën, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 129.

kriteri i rëndësisë të së mirës juridike apo lirisë që cenohet në secilin prej proceseve përkatëse. Për shkak se në procesin penal një individi i rrezikohet kufizimi i lirisë personale, çka është baza për realizimin e të gjitha të drejtave të tjera dhe nga pikëpamja juridike përbën kufizimin më të rëndë, standardi i të provuarit në këtë proces është i një shkalle më të lartë se ai që kërkohet në procesin civil. Mund të thuhet me siguri se, në varësi të natyrës së procesit, penal apo civil, sa më i rëndësishëm të jetë interesi që mbrohet aq më i lartë është standardi që kërkohet për ta cenuar atë.

2.3.1 Barra e provës në procesin civil krahasuar me procesin penal

Kuptimi i barrës së provës në procesin civil deduktohet prej nenit 12 të KPrC, në të cilin parashikohet se "*pala që pretendon një të drejtë, ka detyrim që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilët bazon pretendimin e saj*". Megjithatë, barra e provës në procesin civil duket të jetë më e komplikuar se parashikimi i ligjit, pasi ndërthur elementet e ligjit material civil dhe atij procedural civil. Në ndryshim nga procesi penal, ku barra e provës rëndon kryesisht mbi akuzën/prokurorin, e në këtë kuptim mund të thuhet se karakterizohet nga një natyrë statike, në procesin civil barra e provës duket të ketë natyrë dinamike. Është e natyrshme që edhe në procesin penal barra e provës të karakterizohet nga përjashtime, të cilat do t'i studiojmë në vijëmësi, por megjithatë nuk mund të flitet kurrsesi për barrë prove në kuptimin e mirëfilltë të këtij koncepti, në ngarkim të të pandehurit. Ndërsa, në procesin civil duket se barra e provës shpërndahet ndërmjet palëve të procesit civil, paditësit dhe të padituri.

Për të ilustruar këtë qendrim, paraqesim një vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, i cili shprehet se: … *Në proçesin e të provuarit rëndësi ka përcaktimi i drejtë nga ana e gjykatës së barrës së të provuarit dhe* ***i shpërndarjes së saj në pjesëmarrësit në gjykim bazuar në nenin 12 të K.Pr.C.*** *Në interpretim të kësaj dispozite është e qartë se kush pretendon një të drejtë ka dhe detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e tij,* ***por edhe kush prapëson se këto fakte të pretenduara prej palës paditëse nuk sjellin pasojat ligjore të kërkuara, duhet gjithashtu t'i provojë gjyqësisht prapësimet e tij.***[84] Në këtë drejtim, doktrina e së drejtës procedurale civile është shprehur se: "*Në procesin gjyqësor civil rregullat për ndarjen e barrës së provës e zgjidhin çeshtjen se cila palë do të humbasë gjyqin, kur një fakt mbetet i pa provuar. Rregulli i përgjithshëm është se secila palë ka barrën e provës për ato fakte të cilat i vijnë në ndihmë. Kjo do të thotë se pala që pretendon ekzistencën e një të drejte, ka barrën e provës së atyre fakteve që parashikon e drejta materiale si prezumim i ekzistencës së saj dhe e kundërta, pala që mohon ekzistencën e një të drejte ka barrën e provës së fakteve që pengojnë ose që e shuajnë atë.*"[85]

Në ndryshim nga kjo, në procesin penal, ligjërisht, të pandehurit nuk i ngarkohet asnjë barrë prove, megjithatë për efektet e zhvillimeve në proces, përjashtimisht pranohet se i pandehuri mund të ketë barrën e pretendimit për rrethana të caktuara. Me fjalë të tjera, nëse shpërndarja e barrës së provës në procesin civil duket të ketë natyrën e një rregulli të përgjithshëm, shpërndarja apo zhvendosja e barrës së provës në procesin

---

[84] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 153, datë 01.04.2010

[85] Y.Pjetërnikaj, Provat në procesin civil, Disertacion, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Qershor 2010, fq.10-11

penal në ngarkim të të pandehurit ka natyrë përjashtimore. Në praktikë, në procesin civil, jo kurdoherë është e lehtë të dallohet se cilës palë i bie barra e provës të një fakti të caktuar, sidomos kur dispozitat ligjore materiale ose procedurale nuk përcaktojnë se kush është pala që ka barrën e provës, por në këtë situatë ajo që vjen në ndihmë është ndarja e fakteve në fakte formuese, penguese dhe shuese.[86] Magjistrati Ylli Pjetërnikaj, në bazë të kategorizimit të mësipërm të fakteve në procesin civil, shpjegon edhe mënyrën e operimit të barrës së provës në procesin civil. Sipas tij, [***fakte formuese ose konstitutive*** *janë ato fakte që sjellin me vete lindjen e një të drejte, sjellim ndër mend këtu fakte të tilla si e drejta për të përfituar nga trashgimia, e drejta për të fituar pronësi mbi sendin me vlerë etj. Faktet formuese duhet të provohen nga pala që i pretendon, që zakonisht është paditësi.* ***Fakte penguese*** *janë ato fakte që pengojnë lindjen e një të drejte. Të tillë mund të jenë; mungesa e zotësisë për të vepruar, veset e vullnetit, mashtrimi, kanosja, lajthimi etj. Zakonisht këto fakte pretendohen nga i padituri, por mund të pretendohen edhe nga paditësi. Prandaj themi që barra e provës i takon atij që e pretendon.* ***Fakte shuese*** *janë ato fakte që sjellin me vete shuarjen e një të drejte. Kësisoj mund të përmendim; shlyerja e detyrimit në të holla duke i dhënë këto prova, edhe këto fakte zakonisht i pretendon i padituri, prandaj i takon atij edhe barra e provës, por kjo nuk përjashton që barrën e provës mund ta ketë edhe paditësi. Vështirësia kryesore qëndron në dallimin nëse fakti është formues ose pengues. Për zgjidhjen e këtij problemi Alqiviadh Lamani*[87] *thekson se duhet bërë dallimi midis kushteve të nevojshme për qenien e marrëdhënies juridike. Në bazë të këtij dallimi duhet bërë dallimi në kushte të përgjithshme dhe të posaçme specifike. Kushtet e përgjithshme janë të përbashkëta edhe për marrëdhëniet e tjera juridike dhe jo vetëm për një marrëdhënie juridike. Dimë që zotësia juridike, veset e vullnetit janë të përbashkëta për marrëdhëniet juridike. Këto kushte nuk janë fakte formuese dhe vetëm mungesa e tyre mund të përbëjë një fakt pengues. Kurse, kushtet specifike që janë të veçanta për një marrëdhënie juridike janë fakte formuese .*

Arsyeja e këtij dallimi është se kushtet e përgjithshme të shumë marrëdhënieve jridike, rregullisht, ekzistojnë në të gjitha këto marrëdhënie, kurse mungesa e tyre është përjashtim. Përkundrazi kushtet specifike të marrëdhënieve juridike nuk janë në të gjitha marrëdhëniet juridike, prandaj ekzistenca e tyre nuk është rregull dhe si pasojë mungesa e tyre nuk është përjashtim. Pikërisht në mbështetje të këtij dallimi të rregullit dhe të përjashtimit nga rregulli, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se duhet të provohen vetëm ato fakte që nuk janë në rregull, pra vetëm ato që janë përjashtim, pra duhet të provohen vetëm faktet specifike si fakte formuese. Ndërsa faktet e përgjithshme që përbëjnë rregulli nuk duhet të provohen nga i padituri, pasi barra e provës është mbi paditësin, por kjo nuk do të thotë se nëse fakti formues pretendohet nga i padituri, barra e provës nuk i takon atij.

Mungesa e një kushti të përgjithshëm përbën përjashtim nga rregulli dhe pala që pretendon një fakt të tillë që është pengues, duhet ta provojë.

Duke u nisur nga ajo se barra provuese e fakteve duhet të bazohet midis asaj që është rregull dhe asaj që përbën përjashtim nga rregulli, del se mungesa e fakteve provuese është e përgjithshme dhe si i tillë përbën rregullin, ndërsa ekzistenca e fakteve penguese është përjashtim, prandaj kur pretendohet qënia e kushtit ose e faktit nga pala, i ngarkohet kësaj të fundit barra e provës për qënien e këtij fakti. Kështu

---

[86] Alqiviadh Lamani Procedura civile e RPSSH ,Tiranë 1962,fq 121, cit.nga Y.Pjetërnikaj, Provat në procesin civil, Disertacion, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Qershor 2010, fq.11

[87] Alqiviadh Lamani Procedura civile e RPSSH ,Tiranë 1962,fq 121, cit.nga Y.Pjetërnikaj, Provat në procesin civil, Disertacion, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Qershor 2010

nëse marrim si rast konkret kontratën e shitjes së sendit të luajtshëm do të theksonim që në rastin kur sendi i shitur është me të meta, blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi, ndër të tjera, ndërrimin e sendit me të meta me një send pa të meta ose zbritjen e çmimit. Shitësi nga ana e tij pretendon se blerësi i dinte këto të meta në kohën e blerjes të sendit. Pyetja që lind në këtë moment është si ndahen barrat e të provuarit të pretendimeve? Duke u nisur nga dallimi i kushteve që përbëjnë rregullin nga kushte që përbëjnë përjashtim, nxirret përfundimi se mungesa e të metave të sendit përbën rregullin, prandaj ato duhet t´i provojë blerësi që i pretendon si përjashtim. Po ashtu pretendimi për dijeninë e të metave përbën përjashtim dhe këtë fakt duhet ta provojë shitësi që e pretendon, për arsye se si rregull i përgjithshem blerësi nuk i di të metat e sendit.

Lidhur me faktet shuese, siç e thamë më sipër barra e të provuarit i takon si rregull të paditurit. Nëse çështja përpara gjykatës ka të bëjë me ekzekutimin e detyrimit që përbën në vetvete fakt shues, atëherë për të përcaktuar barrën e provës është i vlefshëm dallimi midis detyrimeve pozitive e negative. Detyrime negative janë detyrimet për moskryerjen e një detyrimi. Ndërsa detyrimet pozitive janë detyrimet që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimit ose dhënien e një sendi. Në detyrimet pozitive paditësi duhet të provojë vetëm qënien e detyrimit, por jo edhe moskthimin e tij nga ky i fundit, ndërsa në detyrimet negative paditësi duhet të provojë qënien e detyrimit për të mos kryer veprimin si dhe kryerjen e veprimit nga i padituri].[88]

Në ndryshim nga procesi civil, në procesin penal faktet apo rrethanat kategorizohen në dy grupime, në faktet të cilat përbëjnë elementët përbërës të figurës së një vepre penale, të cilat detyrimisht duhet të provohen nga organi i akuzës (faktet pozitive) dhe faktet apo rrethanat që përjashtojnë apo minimizojnë përgjegjësinë penale (faktet negative), të cilat duhet të pretendohen nga i pandehuri, e në varësi të forcës bindëse të pretendimit, duhet të provohen se nuk ekzistojnë sërish apo të rrëzohen nga akuza, pra, barra përfundimtare e provës i ngarkohet akuzës/prokurorit. Një kategori të veçantë përbëjnë prezumimet, të cilat përbëjnë mekanizma provues (jo prova apo fakte), por që njëkohësisht përbëjnë edhe përjashtime të barrës së provës në të dyja proceset. Në varësi të llojit të tyre, prezumimet operojnë në favor të njërës apo tjetrës palë të procesit duke shmangur barrën e provueshmërisë së tyre.

2.3.2 Standardi i të provuarit në procesin civil krahasuar me procesin penal

Në ndryshim nga KPrP, ku ligjvënësi me ndryshimet legjislative me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017 kodifikoi standardin e *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* si standardin që duhet të zbatohet nga gjykata në rast të konstatimit të fajësisë së të pandehurit[89], në KPrC nuk përcaktohet ndonjë standard povues që duhet të përmbushet në rastin e vendimmarrjes së gjykatës. Në këtë të fundit është përcaktuar parimi që "*Gjykata çmon provat e marra gjatë gjykimit të çështjes, sipas bindjes së saj të brendshme, të formuar nga shqyrtimi i të gjitha rrethanave të çështjes në tërësinë e tyre*".[90] Bindja e

---

[88] Y.Pjetërnikaj, Provat në procesin civil, Disertacion, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Qershor 2010, fq.11-12-13

[89] Neni 390/1 i KPrP parashikon se: "*Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit*".

[90] Neni 309/2 i KPrC

brendshme sipas këtij formulimi nuk mund të konsiderohet si standard të provuari, pasi nuk bën fjalë drejtpërdrejtë për ndonjë *quantum probatorium* të përcaktuar, por ajo përbën procedurën apo mekanizmin që duhet të përdoret nga gjykata për të arritur në një vendimmarrje të drejtë. Në mënyrë të natyrshme mund të theksohet se bindja e brendshme, përpos karakterit subjektiv dhe intelektual të gjyqtarit, duhet të përfaqësojë sintezën e arsyetimeve të përdorura nga gjyqtari mbi bazën e rrethanave dhe provave të shqyrtuara në gjykim, e në këtë kuptim, ajo nuk mund të shihet si e pavarur nga karakteri i objektivitetit.

Është e kuptueshme që në procesin penal standardi i të provuarit është më i lartë kur vjen fjala për deklarimin fajtor dhe dënimin e të pandehurit. Gjykimi në procesin penal përshkohet nga standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, standard i cili garanton një shkallë më të lartë vërtetësie dhe sigurie në vendimin e gjyqtarit. Në procesin penal, është detyrimi i organit të akuzës të provojë para gjykatës, sipas këtij standardi, se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga i pandehuri. Megjithatë, edhe ky standard nuk përfaqëson sigurinë absolute, por sigurinë gjyqësore. Gjykata nuk mund të deklarojë fajtor një individ nëse ekzistojnë dyshime mbi fajësinë e tij. Gjithsesi, jo çdo lloj dyshimi që mund të lindë në mendjen e gjyqtarit, është i tillë që të përjashtojë të akuzuarin nga dënimi, por vetëm dyshimi që kualifikohet si dyshim i arsyeshëm; përndryshe, paradoksalisht, asnjë dënim nuk mund të jepej, sepse sikundër shprehen studiuesit, *"...gjithmonë mund të ekzistonte një hije dyshimi kartezian mbi ekzistencën e vetë realitetit."*[91] Megjithatë, ndryshe nga procesi civil, i cili iniciohet kryesisht me kërkesëpadi dhe përbëhet nga palët e procesit, paditës, i paditur etj., e vijon i tillë në shkallët e tjera të sistemit gjyqësor, procesi penal përmban në vetvete dhe përbëhet nga disa procese paraprake deri në gjykimin e themelit të çështjes dhe përfshin disa institucione si prokuroria dhe policia gjyqësore. Siç do të shohim në vijim, standardi i të provuarit në procesin penal ndryshon përgjatë ecurisë së procesit, duke filluar me fazën e hetimeve paraprake e duke përfunduar me gjykimin në themel të çështjes. Që në fazat fillestare të hetimit paraprak parashikohen vendimmarrje të rëndësishme të prokurorit që kanë të bëjnë me regjistrimin e personit si person nën hetim apo si person të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale, me kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, njoftimin e akuzës së të pandehurit dhe dërgimin e çështjes për gjykim, vendimmarrje këto që karakterizohen nga standarde të ndryshme të të provuarit. Përgjatë fazës së hetimit paraprak vepron kryesisht standardi i dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, veçanërisht në rastet e masave të sigurimit, të cilat në praktikën gjyqësore konsiderohen si procese brenda procesit penal. Megjithatë, edhe në fazën e hetimit paraprak, me përparimin e hetimeve dhe në kushtet e vendimmarrjeve të tjera si vendimi për marrjen e personit si të pandehur dhe dërgimin e çështjes në gjykim, edhe standardi i të provuarit ndryshon në drejtim të rritjes së nivelit bindës lidhur me fajësinë e të pandehurit. Procese të tilla nuk gjenden në procesin civil, por si rast të ngjashëm me masat e sigurimit në procesin penal, do të veçonim institutin e sigurimit të padisë, veçanërisht kur mund të kërkohet edhe përpara ngritjes së padisë[92]. Lidhur me këtë institut, praktika gjyqësore, përmes jurisprudencës së Gjykatës së Lartë ka shprehur se: "*Ligjvënësi ka parashikuar sigurimin e padisë jo vetëm për të siguruar të drejtën, e cila përbën dhe tërësinë e kërkimeve të paditësit, por në të njëjtën kohë këtë*

---

[91] Giovanni Conso, Vittorio Grevi, Commentario breve al codice di procedura penale, 7 edizione, CEDAM 2011, fq. 2165.

[92] Për më gjerë, shih nenin 204/1 të KPrC

parashikim e ka bërë dhe me qëllimin që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e proçesit gjyqësor që është duke u realizuar mes palëve...Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë vlerëson se në gjykime të këtij lloji, në mënyrë që gjykata të vendosë për marrjen e një mase sigurimi padie (të parashikuara këto të fundit në nenin 206 të K.Pr.Civile), duhet të hetojnë ekzistencën e dy kushteve themelore:
a- Ekzistenca e mundshme e një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë;
b- Ekzistenca e frikës, që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë.
Në lidhje me kushtin e parë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë çmon të theksojë se në gjykimin e kërkesës për sigurimin e padisë nuk është e domosdoshme, që të jetë vërtetuar plotësisht ekzistenca e së drejtës që është edhe objekti i shqyrtimit gjyqësor dhe që ka lidhje me themelin e çështjes, ***por vetëm të ekzistojë mundësia e të drejtës që kërkohet të rivendoset. Për të krijuar bindje në lidhje me mundësinë e ekzistencës të së drejtës që kërkohet të rivendoset, për gjykatën është e mjaftueshme që padia të jetë e mbështetur në prova shkresore, pasi këto të fundit i lejojnë gjykatës që të krijojë një njohje të shpejtë të së drejtës që pretendohet se është shkelur".***[93]

Ndërsa sa i përket institutit të sigurimit të padisë, ligji procedural civil, por bazuar në të, edhe jurisprudenca, kanë përpunuar disa standarde për bazueshmërinë e këtij instituti, lidhur me gjykimin e themelit, ligji nuk ka përcaktuar standarde provueshmërie. Parimi i njohur i procedurës civile është se pala që pretendon një të drejtë, ka detyrimin që, në përputhje me ligjin, të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Ky parim, siç e trajtuam dhe më lart, i referohet kryesisht nocionit të barrës së provës, më shumë sesa nocionit të standardit të të provuarit. Megjithatë, bazuar në natyrën e ligjit procedural civil dhe synimin e tij për ruajtjen e barazisë mes palëve, analiza e përbashkët e kuptimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit, nënkupton që pretendimi i palës paditëse duhet provuar deri në atë shkallë sa të bindë gjykatën se pretendimi ka më shumë probabilitet e gjasa të jetë i bazuar dhe i vërtetë sesa i pavërtetë. Nëse probabilitetet e besueshmërisë mes pretendimeve të paditësit dhe prapësimeve të të padituri janë të njëjta, d.m.th., nëse gjykata është e pavendosur për të zgjedhur versionin që i afrohet më tepër të vërtetës, *pala që mbart barrën e provës e humbet çështjen*[94]. Për të kuptuar konkretisht standardin e të provuarit në procesin civil, duhet t'i referohemi doktrinës së të drejtës procedurale civile.

Në sistemin common law, në çështjet civile zbatohet ai standard i të provuarit, i quajtur standardi i "*balancës së probabiliteteve*" ose ndryshe i "*epërsisë së provave*"; pra, standardi i kërkuar nga palët për përmbushjen e barrës së provës, është vërtetësia dhe siguria e bazuar në versionin që ka më shumë gjasa të jetë i vërtetë. Sipas fjalorëve juridikë, *standardi i balancës së probabiliteteve/epërsisë së provave ka kuptimin e "peshës më të madhe specifike që mbartin provat", që jo domosdoshmërisht përcaktohet nga numri më i madh i provave që vërtetojnë një fakt të caktuar, por nga provat që janë më të besueshme dhe bindëse. Fjala "epërsi" do të thotë diçka më shumë se "peshë"; ajo tregon një epërsi të peshës, ose mbipeshë.*

---

[93] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.370 datë 05.10.2010
[94] Peter Murphy, Murphy mbi provën, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 170.

Fjalët nuk janë sinonime, por thelbësisht të ndryshme. Në përgjithësi ekziston një "peshë" e provave të secilës palë të procesit në rast të fakteve të kontestuara. Por, juritë nuk mund të veprojnë siç duhet, bazuar në peshën e provave, në favor të atij që ka barrën e provës, përveç nëse ato mbizotërojnë, në një farë mase, peshën e provave të palës tjetër. Standardi i epërsisë së provave bazohet në atë provë e cila, kur merret në konsideratë në mënyrë të drejtë, krijon përshtypjen më të fortë, ka peshën më të madhe dhe është më bindëse për të vërtetën, kur vlerësohet kundrejt provave të kundërta.[95].

Në sistemin ligjor të SHBA-ve, në bazë të rregullave dhe instruksioneve federale për juritë përcaktohet se *standardi i epërsisë së provave nënkupton provueshmërinë se diçka ka më shumë të ngjarë të ekzistojë se sa jo. Me fjalë të tjera, ky standard nënkupton që të dhënat e apo provat e çështjes, të krahasuara me ato të kundërta, kanë një forcë më bindëse dhe krijon në mendjen e njeriut besimin se ajo çfarë kërkohet të provohet ka më shumë të ngjarë të jetë e vërtetë sesa e pavërtetë. Ky rregull nuk kërkon provueshmërinë në një siguri absolute, për shkak se një nivel i tillë rrallëherë ndeshet në ndonjë y rregull nuk kërkon provueshmërinë në një siguri absolute, për shkak se një nivel i tillë rrallëherë ndeshet në ndonjë çështje*.[96]

Në vlerësimin e probabiliteteve, pavarësisht natyrës dhe përhapjes që ka konflikti në shqyrtim, si rregull, gjykata duhet të mbajë parasysh se, sa më i rëndësishëm të jetë pretendimi, aq më pak mundësi ka që ai të jetë i vërtetë dhe, për rrjedhojë, aq më bindëse duhet të jenë provat e paraqitura në mënyrë që gjykata të konkludojë se pretendimi është vërtetuar sipas standardit të balancës së probabiliteteve. [97] Megjithatë, standardi i balancës së probabiliteteve nuk duhet kuptuar si një standard që ndryshon në varësi të rrethanave dhe rëndësisë së çështjes, por se këto elementë janë pjesë e shqyrtimit që bën gjykata[98] për të përcaktuar mundësinë e vërtetësisë së njërit apo tjetrit version. Pra, pranohet se ky standard ka një lloj fleksibiliteti, në kuptimin që gjykata, gjatë vlerësimit të tij, mund të konsiderojë se disa elementë janë më të mundshëm se disa të tjera.[99]

Në doktrinën e huaj konsiderohet problematik rasti kur në një proces civil ngrihen pretendime që synojnë të provojnë natyrën penale apo quasi penale të veprimeve të palës kundërshtare. Kjo doktrinë ka dhënë përgjigjen se standardi i provës në një

---

[95] Henry Campbell Black, M.A., Black's Law Dictionary, revised fourth edition, St.Paul.Minn, West Publishing Co, 1968, fq. 1344-1345.
https://heimatundrecht.de/sites/default/files/dokumente/Black%27sLaw4th.pdf, klikuar më datë 5 Tetor 2022

[96] Schweizer, Mark, The Civil Standard of Proof – What is it, Actually? (August 1, 2013). MPI Collective Goods Preprint, No. 2013/12, International Journal of Evidence and Proof 2016, Volume: 20 Issue: 3, p. 217-234 (revised version), Available at SSRN:
https://ssrn.com/abstract=2311210 or http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2311210, fq. 2, klikuar më datë 10 Tetor 2022.

[97] Peter Murphy, Murphy mbi provën, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 172.

[98] Po aty.

[99] Jeremy Cooper, The burden and the standard of proof,https://www.judiciary.uk/wp-content/uploads/2016/01/cooper-burden-standard-of-proof-spring2008.pdf, fq.4, klikuar më datë 10 Tetor 2022.

çështje civile, ku pretendohet një sjellje me natyrë penale apo quasi – penale, është balanaca normale e probabiliteteve.[100]

Në doktrinën italiane të procedurës civile, si përfaqësuese e së drejtës kontinentale, diskutohet një standard i ngjashëm me atë që aplikohet në sistemin common law. Standardi që aplikohet është standardi "***me shumë gjasa sesa jo***" ose "***më probabël se jo***" (nga italishtja- *più probabile che non*). Edhe në këtë sistem ky standard barazohet me standardin e "epërsisë së provave".[101] Standardi i epërsisë së provave është në fakt kombinimi i dy rregullave: të rregullit "*me shumë gjasë sesa jo*" dhe "*prevalencës relative*" të probabilitetit.[102] Jurisprudenca e gjykatave italiane[103], me rastin e shqyrtimit të lidhjes shkakësore në çështjet civile ka shprehur se: ["*Rregulli i "me shumë gjasa sesa jo/më probabël se jo", nënkupton që në lidhje me çdo konstatim logjik merret në konsideratë mundësia që ai mund të jetë i vërtetë ose i rremë, d.m.th. që për të njëjtin fakt ka hipoteza pozitive dhe një hipotezë negative plotësuese, kështu që, ndërmjet këtyre dy hipotezave alternative,* ***gjyqtari duhet të zgjedhë atë që, në bazë të provave të disponueshme, ka një shkallë më të lartë konfirmimi logjik se tjetra****: në fakt do të ishte irracionale për të preferuar hipotezën e cila është më pak e mundshme se hipoteza e kundërt. Me fjalë të tjera, konfirmimi i së vërtetës së një konstatimi/përfundimi nënkupton se ka prova mbizotëruese në mbështetje të tij: kjo ndodh kur ka një ose më shumë prova të drejtpërdrejta - besueshmëria ose vërtetësia e të cilave është e sigurt - që konfirmojnë atë hipotezë, ose ekziston një ose më shumë prova indirekte nga të cilat mund të nxirren përfundime konvergjente në mënyrë të vlefshme në mbështetje të hipotezës.*] Lidhur me rregullin e "prevalencës relative" të probabilitetit, Gjykata e Kasacionit në Itali shprehet se: [*sipas rregullit të "prevalencës relative" të probabilitetit, sa i përket lidhjes shkakësore, në rastin e "multi shkaqeve" në prodhimin e një ngjarjeje të dëmshme, kur i njëjti fakt ka hipoteza të ndryshme, d.m.th. konstatime të ndryshme që e rrëfejnë faktin në mënyra të ndryshme, dhe kur këto hipoteza kanë marrë një konfirmim pozitiv nga provat e marra në gjykim, duhet të merren në konsideratë vetëm hipotezat që rezultojnë "me shumë gjasa sesa jo", pasi hipotezat negative mbizotëruese janë të parëndësishme.* ***Megjithatë, nëse kjo ndodh, d.m.th nëse ka disa konstatime për të njëjtin fakt që kanë marrë konfirmim provues, rregulli i prevalencës relative nënkupton që gjyqtari zgjedh si "të vërtetë" konstatimin/përfundimin që ka marrë shkallën relativisht më të lartë të konfirmimit bazuar në provat e disponueshme***].[104] Studiuesi Luigi Viola e kritikon këtë qasje të jurisprudencës duke argumentuar në mënyrë të përmbledhur se, pavarësisht dallimeve që ekzistojnë ndërmjet procesit civil dhe penal, ato nuk janë të tilla që të justifikojnë aplikimin e standardeve të ndryshme të të provuarit në të dy proceset, duke sugjeruar, në përputhje me normat e kodit të

---

[100] Peter Murphy, vepër e cituar, fq. 170.
[101] Luigi VIOLA, Più probabile che non VS prudente apprezzamento, Rivista scientifica di Diritto Processuale Civile, La Nuova Procedura Civile, 3, 2020, datë 08.09.2020, fq. 2., https://www.lanuovaproceduracivile.com/ëp content/uploads/2020/09/violaPRUDENZA.pdf
[102] Po aty.
[103] Cassazione civile, sezione terza, ordinanza del 6.7.2020, n. 13872, cit. nga Luigi VIOLA, Più probabile che non VS prudente apprezzamento, Rivista scientifica di Diritto Processuale Civile, La Nuova Procedura Civile, 3, 2020, datë 08.09.2020, fq. 2., https://www.lanuovaproceduracivile.com/wp content/uploads/2020/09/violaPRUDENZA.pdf
[104] Po aty

procedurës penale italiane, se gjyqtari duhet t'i vlerësojë provat në përputhje me një gjykim të kujdesshëm e të matur.[105]

Diskutimi është prezent edhe në legjislacione të tjera të sistemit kontinental. Studiuesi Mark Shveizer, i cili është marrë me studimin e standardit të të provuarit në çështjet civile në sistemet ligjore të Gjermanisë dhe Zvicrës ka shprehur se: *Ndryshe nga sistemi common law, në sistemin kontinental përgjithësisht nuk bëhet dallimi ndërmjet standardit të të provuarit në çështjet civile dhe penale. Standardi i të provuarit kuptohet si* ***bindje e plotë e gjyqtarit, e shprehur si bindje e brendshme ose bindje e arsyeshme****. Duke pasur këtë kuptim, autori beson se standardi i aplikuar në çështjet civile në Gjermani (që duhet të jetë e njëjtë edhe në vende të tjera të sistemit civil law) është i një shkalle më të lartë se ai i aplikuar në sistemet ligjore të SHBA dhe Britanisë. Megjithatë, përgjatë një studimi të hollësishëm empirik të kryer, rezulton se ndryshe nga doktrina dhe jurisprudenca të cilat njohin standardin e bindjes së plotë, standardi i aplikuar në praktikë i përngjet atij të njohur në sistemin common law (preponderance of evidence).*[106]

Në fakt, edhe nëse i referohemi ligjit tonë procedural civil, nuk duket e gabuar që standardi i të provuar të karakterizohet nga një shkallë e krahasueshme bindje dhe sigurie si standardi i procesit penal. Përpos faktit që, veçanërisht në doktrinën e së drejtës procedurale civile ka një tendencë për njohjen dhe zbatimin e standardit të provuarit, sipas sistemin common law, nga interpretimi i sistematik i neneve 10, 14, 16, 20, 28, 29 dhe 309 të KPrC, rezulton se ka vend për aplikimin e një standardi të ngjashëm me atë që operon në procesin penal, por megjithatë, ndërmjet tyre nuk mund të vihet shenja e barazisë. Kjo për shkak se proceset penale e civile kanë dallime të konsiderueshme, qoftë sa i përket të drejtës materiale në diskutim, ashtu edhe procedurave përkatëse të zhvillimit të këtyre proceseve. Për ilustrim sjellim në vëmëndje praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, e cila ka shprehur se*: "Hetimi gjyqësor është parim themeltar i gjykimit civil dhe përbën një detyrim për gjykatat në të gjitha shkallët e gjykimit. Mungesa e një* ***hetimi të plotë*** *nga ana e gjykatës e bën vendimin të dyshueshëm, të pa bazuar në provat e pretenduara nga palët, e për pasojë kemi një vendim të padrejtë dhe një proces të parregullt ligjor."*[107] Termi "hetim i plotë dhe i gjithanshëm" që përmend neni 14 i KPrC është i papërcaktuar në kod, në kuptimin që nuk saktëson nëse me të nënkuptohet karakteri procedural i gjykimit civil, pra, nëse nënkupton detyrimin e gjykatës për të administruar të gjitha të dhënat dhe provat që kërkohen në proces e që janë të nevojshme apo ky detyrim nënkupton një aspekt thelbësor të gjykimit civil, të lidhur me krijimin e bindjes së plotë të gjykatës për zgjidhjen e çështjes në një mënyrë të caktuar.

---

[105] Për më gjerë, shih Luigi VIOLA, Più probabile che non VS prudente apprezzamento, Rivista scientifica di Diritto Processuale Civile, La Nuova Procedura Civile, 3, 2020, datë 08.09.2020, https://www.lanuovaproceduracivile.com/wp content/uploads/2020/09/violaPRUDENZA.pdf

[106] Për më gjerë, shih Schweizer, Mark, The Civil Standard of Proof – What is it, Actually? (August 1, 2013). MPI Collective Goods Preprint, No. 2013/12, International Journal of Evidence and Proof 2016, Volume: 20 Issue: 3, p. 217-234 (revised version), Available at SSRN: https://ssrn.com/abstract=2311210 or http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2311210, fq. 4-5-6. Autori shpjegon se në një proces civil ka probabilitet në masën 50% që padia të pranohet, mjafton që gjyqtari bindet në nivelin deri në 63% se faktet që mbështesin pretendimet janë të vërteta.

[107] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 348 datë 14.09.2010

2.3.3 Prezumimet në procesin civil krahasuar me procesin penal

Prezumimet konsiderohen si përjashtime në procesin penal dhe atë civil. Lidhur me orgjinën e tyre pranohet përgjithësisht se sfera civile ka qenë territori i parapëlqyer i ligjvënësit për të eksperimentuar prezumimet dhe mekanizmat se si ato veprojnë. Më pas ato kanë fituar të drejtën e qytetarisë dhe janë huazuar edhe në sferën penale. Për shkak të një kohë të gjatë aplikimi në procesin penal apo civil, një pjesë e tyre kanë fituar statusin e parimit, siç është rasti i prezumimit të pafajësisë në procesin penal.

Sipas jurisprudencës së Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë [108] , *prezumimi (praesumptio) ligjor është rregulli sipas të cilit gjykata apo organi administrativ është e detyruar që të marrë si ekzistues një fakt (fakti i prezumuar), në qoftë se ekziston tjetri, fakti i përcaktuar nga ligji (baza e prezumimit basis praesumptio). Në këtë vështrim, mund të thuhet se, për të drejtën prezumimi është një mënyrë arsyetimi nëpërmjet të cilës, nga ekzistenca e një fakti të provuar deduktohet ekzistenca e një fakti i cili nuk është i provuar.* Prezumimet janë të përcaktuara në ligj. Në doktrinën juridike prezumimet klasifikohen në tre kategori: Prezumime të thjeshta (relative); prezumime mikse; prezumime absolute (të pakundërshtueshme).

Prezumimet relative, çlirojnë nga barra e provës, palën në favor të së cilës është parashikuar prezumimi, por pala kundërshtare mund të rrëzojë prezumimin me provën e kundërt. *Prezumimet absolute*, jo vetëm që nuk kanë nevojë të provohen, por as nuk mund të sillet prova e kundërt. Ndërsa *prezumimet mikse* mund të rrëzohen vetëm me lloje të përcaktuara të mjeteve provuese, të cilat i parashikon ligji. Për të vlerësuar rast pas rasti, nëse prezumimi ligjor është i natyrës relative apo absolute, do të duhet të shihet formulimi i normës juridike konkrete që e parashikon atë[109].

Edhe pse KPC hesht në lidhje me prezumimet e gjyqtarit, ato janë pasojat që nxjerr gjykata prej një fakti të ditur për të caktuar një fakt të paditur ose të panjohur. Në këtë rast është organi vlerësues dhe jo ligji, ai që gjykon mbi marrëdhënien shkak-pasojë të fakteve të ndryshme. Prezumimet e gjyqtarit janë operacione intelektuale dhe abstragime të tij, që realizohen në bazë të rregullave të logjikës formale. Kështu, duke u mbështetur në eksperiencën jetësore ose profesionale, gjyqtari është në gjendje që të nxjerrë një fakt të panjohur nga një fakt të provuar gjatë procesit gjyqësor. Në këtë rast gjykata nuk bën gjë tjetër veçse një arsyetim logjik të gjërave, ku prej një ose disa fakteve që ekzistojnë arrin në përfundimin e mundësisë së ekzistimit të një fakti për aq kohë sa nuk vërtetohet e kundërta. Prezumimet e gjyqtarit janë rrjedhojë e natyrshme e veprimtarisë intelektuale që kryen ai në një proces gjyqësor, detyra e të cilit nuk kufizohet vetëm në një zbatim mekanik të ligjit. Kështu, operacioni i parë intelektual që kryen gjyqtari në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeje është analiza e fakteve dhe provave të përcaktuara nga palët, arsyetimi bazuar në rregullat e logjikës formale ku metoda më e rëndësishme është metoda deduktive. Gjetja e normës juridike dhe zbatimi i saj, në situatën konkrete është operacioni përmbyllës, që vjen si rezultat i kësaj analize[110].

---

[108] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00 – 2021 - 706, datë 10.05.2021
[109] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 00 – 2021 - 706, datë 10.05.2021
[110] Po aty.

Pa u ndalur në llojet e prezumimeve, për shkak se për të do të flitet hollësisht në vijim, vlen të përmendet se prezumimet në procesin penal ndahen kryesisht në prezumime të ligjit dhe prezumime të faktit (të thjeshta). Prezumimet për të cilat ka rezerva dhe objeksione në doktrinë janë ato me karakter absolut, të cilat pamundësojnë paraqitjen e provave të kundërta për rrëzimin e tyre. Diskutimi mbi to lind për faktin se kryesisht janë në favor të akuzës dhe nga ana tjetër, kjo e fundit ka detyrimin për të provuar elementët e veprës penale përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Çështja që shtrohet është nëse një prezumim absolut në favor të akuzës e përmbush ose jo standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në procesin civil, ndryshe nga ai penal ku operon parimi i prezumimit të pafajësisë, ka raste përjashtimore, që në fakt nuk janë të pakta në KC, ku vepron parimi i prezumimit të fajësisë, i cili përbën *një kusht thelbësor në përgjegjësinë civile kontraktore dhe atë jashtëkontraktore. Ky parim prezumohet si në përgjegjësinë e debitorit për mospërmbushjen e detyrimit, ashtu edhe në shkaktimin e dëmit.*[111] Profesoresha e ligjit Mariana Semini-Tutulani shprehet se: *Debitori që nuk ka përmbushur detyrimin e marrë përsipër vullnetarisht prej tij në marrëdhëniet kontraktore konsiderohet se është fajtor për mospërmbushjen. Po kështu, në rastin e shkaktimit të dëmit, personi që ka shkaktuar një dëm pasuror me sjelljen e tij të kundërligjshme konsiderohet se është fajtor dhe duhet të përgjigjet për këtë dën, përveç rasteve kur provon se nuk ka pasur faj.*[112]

Një konceptim i tillë i fajësisë në fushën civile, passjell efekte edhe në barrën e provës. Lidhur me këtë të fundit, dhe mënyrën si operon barra e provës në fushën civile, Profesoresha e mësipërme shprehet se: (...) *duke qenë se në fushën civile pranohet prezumimi i fajësisë së debitorit, i takon këtij të fundit të provojë të kundërtën, pra, se detyrimi nuk është përmbushur për shkak të rrethanave që ai nuk ka mundur t'i ndalonte, jo për fajin e tij, ose në detyrimet që lindin nga shkaktimi i dëmit debitori duhet të provojë se dëmi është shkaktuar jo për faj të tij.*[113] Në ndryshim nga procesi civil, në procesin penal operon parimi dhe prezumimi i mirënjohur i pafajësisë, i cili vepron në favor të të pandehurit. Ky prezumim kategorizohet në prezumimet relative, pasi mund të rrëzohet nga provat që paraqiten, madje në procesin penal rrëzimi i prezumimit të pafajësisë, pra provueshmëria e fajësisë përbën edhe objektin e procesit penal. Lidhur me prezumimin e pafajësisë, Profesor Ejup Sahiti ka shpjeguar se: *Situata në procesin penal është e tillë që, krahas ekzistencës së prezumimit të fajësisë, duhet të ekzistojë njëkohësisht probabiliteti i caktuar se është e pabazë ajo që supozohet me prezumimin e pafajësisë. Sipas dispozitave procedurale, procedura penale zhvillohet vetëm po qe se ekziston dyshimi se është kryer ndonjë vepër penale konkrete, si dhe se ndonjë person është autor i saj. Me fjalë të tjera, procedura penale vihet në lëvizje kur ekziston besueshmëria (probabiliteti) se një person ka kryer vepër penale.*[114]

---

[111] M.Tutulani-Semini, E Drejta e deyrimeve dhe e kontratave, Pjesa e Përgjithshme, Scanderbeg books, 2006, fq. 183
[112] Po aty, fq. 184
[113] Po aty.
[114] Prof. dr. sc. Ejup Sahiti / Prof. dr. sc. Rexhep Murati / Mr. Xhevdet Elshani, Komentar i Kodit të Procedurës Penale, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Dhjetor 2014, fq. 54

2.3.4 Efektet e vendimeve penale dhe civile/administrative

Më lart paraqitëm qendrimet e ndryshme që ekzistojnë në doktrinë lidhur me shkallën apo nivelin e standardeve të të provuarit që operojnë në procesin civil dhe penal. Siç rezulton, më e qartë është diferenca që ekziston në sistemin common law ndërmjet standardit të përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe balancës së probabiliteteve, ku shkalla e bindjes së standardit penal është më e lartë se ai civil. Po ashtu, rezulton se në legjislacionin tonë procedural civil, ndryshe nga ai penal, në të cilin në vitin 2017 u kodifikua standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, nuk gjenden standarde të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykata. Pikërisht, evidentimi i diferencës ndërmjet standardeve të procesit penal dhe atij civil mund të gjendet edhe në efektet që kanë vendimet e njërit proces në procesin tjetër. Në nenin 70, pika 1 e K.Pr.Penale është përcaktuar se: "*Vendimi penal i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës vetëm përsa i përket faktit nëse vepra penale është kryer dhe nëse është kryer nga i gjykuari*". Kjo do të thotë se nga vetë përmbajtja e vendimit penal që disponon "***sqarimin e ekzistencës së faktit vepër penale***", "***paligjshmërinë penale të faktit***" dhe "***përcaktimin që i pandehuri e ka kryer***", të detyrueshme për gjykatën civile janë përcaktimi i parë dhe i tretë, duke u shmangur nga detyrimi "paligjshmëria penale" sepse ajo është e panevojshme, kjo pasi mund të jetë e ndryshme nga përgjegjësia civile.[115] Duke qenë se në procesin penal provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fakti penal dhe autorësia e tij, siguria gjyqësore që percjell vendimi penal i shtrin efektet e saj edhe në procesin civil dhe atë administrativ[116]. Edhe pse ligjvënësi nuk e lidh rezultatin e procesit penal me rezultatin e ngjashëm që duhet të ketë në procesin civil/administrativ, për shkak se gjykatat janë të pavarura dhe vendimmarrja bazohet në bindjen e brendshme të gjyqtarit të formuar nga shqyrtimi tërësor i rrethanave të çështjes, sërish elementët që janë të detyrueshëm në procesin civil/administrativ, si fakti penal dhe autorësia e vërtetuar në procesin penal, janë thelbësorë edhe në procesin civil dhe rrjedhimisht kushtëzojnë mënyrën e përfundimit të këtij procesi në një mënyrë të caktuar, që i përgjigjet zgjidhjes që mund të jetë dhënë në gjykimin penal. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në praktikën e tij është shprehur se: "(...) *në mbështetje të parashikimeve të nenit 70, të Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për efektet e vendimit penal në gjykimin civil dhe administrativ, vlerëson se gjykata gjatë një procesi gjyqësor civil* ***detyrohet të marrë të mirëqenë vendimin penal të formës së prerë për sa i përket faktit të paligjshëm, për sa i përket mënyrës së ndodhjes së saj në kuptimin e kronologjisë së ngjarjeve dhe autorësinë e tyre***[117]. Rastet praktike tipike që ilustrojnë më mirë parashikimin e normës së mësipërme, janë rastet e veprave penale, të cilat shkaktojnë pasoja në shëndetin e viktimave ose në pasurinë e tyre, si shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, shkeljet e rregullave të mbrojtjes në punë, vjedhjet, shkatërrimi i pronës, mashtrimet etj.

Megjithatë, siç rezulton, efektet e vendimit penal në procesin civil apo administrativ nuk janë të pakufizuara, pasi ligjvënësi e lidh detyrueshmërinë e këtyre efekteve *për gjykatën që shqyrton pasojat civile të veprës.* Kjo nënkupton që bëhet fjalë për të njëjtat fakte juridike dhe persona, të cilët i nështrohen gjykimit në juridiksione të

---

[115] Dh. Lara, Koment mbi Procedurën Penale, Botimet Morava, Tiranë 2019, faqe 369.
[116] Titulli i dispozitës, neni 70 i K.Pr.Penale përcakton ***Efektet e vendimit penal për gjykimin civil dhe administrativ***
[117] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr.153, datë 11.05.2016

ndryshme gjyqësore, penal dhe civil/administrativ. Fakti që efekti i vendimit penal nuk ka karakter absolut rezulton edhe prej paragrafit të dytë të nenit 70 të K.Pr.Penale, në të cilin parashikohet se: "*Vendimi penal që zgjidh rastësisht një fakt që lidhet me një çështje civile, administrative ose penale nuk ka efekt detyrues në asnjë proces tjetër".* Nga ana tjetër, efekti i një vendimi civil në procesin penal ka karakter relativ, vetëm përsa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit.[118] Kjo për shkak se, siç e kemi trajtuar më lart, fajësia e të pandehurit në procesin penal nuk mund të provohet me një standard të provuari që aplikohet në procesin civil. Shkalla e vërtetësisë me të cilën duhet të deklarohet fajësia e individit duhet të jetë e tillë që të shmangë çdo dyshim të arsyeshëm rreth fajësisë.

2.3.5 Padia civile në procesin penal

Në procesin penal mund të diskutohen edhe raste të tjera të zbatimit të standardit të të provuarit të këtij procesi në çështjet civile. Në këtë kuptim, një vëmendje e veçantë i duhet kushtuar institutit të *padisë civile në procesin penal*. Padia civile nuk ka dallim nga "padia civile" sipas konceptimit nga dispozitat e KPrC. Dallimi në këtë rast ka të bëjë vetëm me faktin se kjo padi civile, për shkak të specifikës se lidhet "*me dëm të pësuar nga vepra penale*" do të gjykohet nga gjykata penale së bashku me procedimin penal. Ky rregullim është i veçantë nga rregulli i përgjithshëm i gjykimit të padive nga gjykata civile, duke vlerësuar oportunitetin e bashkimit të dy gjykimeve, të cilat kanë të përbashkëta palët, provat e nevojshme, etj. Ky bashkim nuk mund të cenojë as procedimin penal dhe as atë civil. Të dy procedimet ruajnë karakteristikat e tyre të veçanta sipas dispozitave respektive që i rregullojnë por, për shkak të elementeve të përbashkëta bashkohen në një procedim të vetëm.[119]

Diskutimi që shtrohet në rastin e padisë civile në procesin penal është nëse në të njëjtin gjykim mund të aplikohen dy standarde të ndryshme të të provuarit, një që i referohet vërtetimit të akuzës penale dhe tjetra që i referohet vërtetimit të fakteve mbi pretendimet e natyrës civile. Në KPrP nuk parashikohet ndonjë rregullim i posaçëm në këtë drejtim. Pavarësisht se kemi një shkrirje të dy proceseve të natyrave të ndryshme, në vetvete ato ruajnë autonominë e gjykimit.[120] Gjykata e Lartë është shprehur se "*kjo autonomi konsiston në mundësinë e ndarjes së proceseve dhe gjykimin më vete duke i dërguar aktet e padisë gjykatës civile. Parregullsitë që konstatohen në gjykimin e padisë civile nuk e kondicionojnë dhe nuk e bëjnë të parregullt procesin penal për aq kohë sa nuk vërehen shkelje që e bëjnë atë të pavlefshëm sipas KPrP. Ky konkluzion del nga interpretimi që i bëhet nenit 68 të KPrP*[121] *në të cilin përcaktohen vendimarrje të veçanta si për akuzën penale, ashtu*

---

[118] Neni 71/1 i K.Pr.Penale parashikon se: "*Vendimi civil i formës së prerë është i detyrueshëm për gjykatën që gjykon çështjen penale vetëm përsa i përket faktit nëse vepra ka ndodhur ose jo, por jo për fajësinë e të pandehurit*.

[119] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 284, datë 06.10.2000.

[120] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 224, datë 12.09.2012.

[121] Neni 68 K.Pr.Penale. "**Disponimet për padinë civile".**

1. Gjykata, sipas rastit, pranon tërësisht ose pjesërisht padinë civile ose e rrëzon atë. 2. Kur jepet vendim pafajësie, për shkak se fakti nuk parashikohet si vepër penale ose kur vendoset pushimi i

edhe për padinë civile. Ndërsa në lidhje me akuzën penale gjykata ka detyrimin që të shprehet me vendim përfundimtar, për padinë civile vendimarrja është në varësi të zgjidhjes së çështjes penale duke parashikuar jo vetëm rrëzimin apo pranimin e padisë civile, ***por edhe të mundësisë të lënies pa shqyrtuar në rastet kur gjykata jep vendim pafajësie për shkak se fakti nuk parashikohet si vepër penale ose është vendosur pushimi i çështjes në një nga rastet e parashikuara në ligj."***[122]

Në nenin 68 të KPrP parashikohen mënyrat e përfundimit të padisë civile në procesin penal. Është e qartë se nëse gjykata e deklaron të pandehurin fajtor, atëherë do të pranojë edhe padinë civile. Në këtë rast nuk shtrohet problemi i aplikimit të dy standardeve të ndryshme, pasi nëpërmjet procesit penal është provuar përtej çdo dyshimi se vepra penale është kryer dhe se atë e ka kryer i pandehuri. Në këtë kuptim, standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm e përfshin standardin e aplikuar në procesin civil. Kur jepet pafajësi, si rregull, padia civile rrëzohet.[123] Sipas ligjit, përbën përjashtim rasti kur fakti nuk parashikohet si vepër penale ose kur vendoset pushimi i çështjes sipas nenit 387 të KPrP, ku padia civile lihet e pashqyrtuar. Në këtë rast i dëmtuari ka të drejtë të ngrejë padi përsëri në gjykatën civile.[124]

Sipas mendimit tim nëse gjykata deklaron se i pandehuri është i pafajshëm, kjo nuk duhet të passjellë që padia civile të rrëzohet automatikisht. Formulat e pafajësisë janë parashikuar në nenin 388 të KPrP. Rrëzimi i padisë civile në procesin penal vendoset atëherë nëse gjykatës i rezulton se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë në rastin kur pafajësia jepet për shkakun se a) ....,*fakti nuk provohet se ekziston* ose se d) *nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën penale që akuzohet* etj. Kjo për shkak se, pavarësisht se nuk mund të jetë vërtetuar fajësia përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, mund të jetë provuar sipas standardit të procesit civil, balancës së probabiliteteve, se ka të ngjarë/mundësi që i pandehuri ta ketë kryer një vepër të paligjshme, për të cilën është paditur civilisht.

Në lidhje me këtë çështje, i rëndësishëm është edhe qëndrimi që mbështet jurisprudenca e GJEDNJ. GJEDNJ nuk e konsideron automatikisht shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ rastin kur gjykatat e shteteve kanë akorduar në favor të të dëmtuarit dëmshpërblim civil, edhe pse i pandehuri është shpallur i pafajshëm për akuzën e ngritur. Në çështjen *Orr kundër Norvegjisë*, rezulton se Gjykata ka marrë në shqyrtim ankesën e aplikantit, i cili ishte shpallur i pafajshëm për veprën penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë, por u ngarkua nga gjykata e shtetit me pagimin e dëmshpërblimit civil, pas kërkesës së të dëmtuarës. E dëmtuara ka kërkuar në gjykatën e shtetit kompensim për dëmin pasuror dhe jopasuror. Aplikanti arsyetonte se kishte një lidhje të qartë ndërmjet deklarimit të pafajësisë dhe dëmshpërblimit civil, në lidhje me çështjet e njëjta, provat, trupin gjykues, palët e njëjta, referencat në dispozitat ligjore etj., dhe si e tillë edhe në rastin e procedimit për dëmshpërblim civil duhet të aplikohej neni 6(2) i KEDNJ.[125] Pavarësisht se GJEDNJ gjeti shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ, ajo u shpreh se "*Është e vërtetë se deklarimi i pafajshëm nga*

çështjes penale, padia civile lihet e pashqyrtuar. 3. Kur rrëzohet padia civile në procesin penal, nuk lejohet ngritja e saj përsëri në gjykatën civile.

[122] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 224, datë 12.09.2012.

[123] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura Penale, Botimet Morava, Tiranë, 2007, fq. 170.

[124] Po aty.

[125] Çështja *Orr kundër Norvegjisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 31283/04), 15 maj 2008, pg. 38.

përgjegjësia penale, nuk e ndalon një gjykatë kombëtare të konstatojë, në bazë të një niveli më të ulët të barrës së provës, përgjegësinë civile për të paguar dëmshpërblim referuar të njëjtave fakte."[126] Në këtë çështje, GJEDNJ konstatoi shkelje të nenit 6(2), jo për shkak të faktit se ligji i brendshëm njihte një procedurë të tillë dëmshpërblimi, por për shkak të mënyrës së arsyetimit të gjykatave. Për këtë GJEDNJ arsyeton: "*gjykata kombëtare e bazoi arsyetimin e saj për akordimin e dëmshpërblimit në një përshkrim të fakteve që jepnin të dhëna mbi aktin e marrëdhënieve seksuale, dijenia e aplikantit për mungesën e pëlqimit të viktimës, shkalla e dhunës e përdorur nga aplikanti për të kryer aktin dhe qëllimi i tij lidhur me këtë. Me fjalë të tjera, praktikisht, gjykata ka përshkruar të gjithë elementët përbërës objektivë dhe subjektivë, të cilët, normalisht përbëjnë veprën penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë parashikuar nga KP i shtetit.*" [127] GJEDNJ nuk u bind nëse nëpërmjet arsyetimit të vendimit nuk ishte shmangur vendimi i pafajësisë së aplikantit apo hedhja e dyshimeve mbi korrektësinë e asaj pafajësie.[128]

Në një çështje tjetër të ngjashme[129], GJEDNJ konstatoi se nuk kishte pasur shkelje të nenit 6(2) të Konventës kur në favor të të dëmtuarit gjykata e shtetit kishte akorduar dëmshpërblim civil, edhe pse i pandehuri ishte deklaruar i pafajshëm. Testi i GJEDNJ për të përcaktuar nëse procedura të tilla shtetërore cenojnë nenin 6 të KEDNJ, është përcaktimi nëse procedura e dëmshpërblimit konsiderohet si një akuzë re në kuptim të Konventës. GJEDNJ thekson se koncepti akuzë i përdorur në Konventë është autonom. Ekzistojnë tre kritere për të përcaktuar nëse një person është akuzuar për një vepër penale: klasifikimi i procedimit sipas ligjit kombëtar, natyra e tyre thelbësore dhe lloji e ashpërsia e ndëshkimit që aplikanti rrezikon. Në *Ringvold kundër Norvegjisë*, GJEDNJ arsyetoi në lidhje me kriterin e parë se *argumenti i kërkuesit se ai formalisht mbeti i akuzuar deri në pritje të marrjes së fuqisë ligjore të vendimit të pafajësisë, nuk qëndron pasi kjo kishte të bënte vetëm më akuzat e fillimit për të cilat ishte deklaruar i pafajshëm dhe nuk kishte lidhje me pretendimet për dëmshërblim civil. Ky pretendim civil e kishte bazën në legjislacionin civil norvegjez, që parashikon parimet themelore të dëmit jashtëkontraktor. Është e qartë se përgjegjësia penale nuk është parakusht për të paguar dëmshpërblim.*[130] Duke qenë se pretendimi për kompensim rregullohej nga ligji civil, GJEDNJ theksoi se ky pretendim nuk mund të shihet si një akuzë penale bazuar në ligjin e brendshëm. Në lidhje me dy kriteret e tjera, natyrën thelbësore të procedimeve dhe ashpërsinë e dënimit që rrezikon aplikanti, GJEDNJ u shpreh se ndërsa kushtet e përgjegjësisë civile mund të mbivendosen, në varësi të rrethanave të caktuara, me ato të përgjegjësisë penale, gjithsesi, një pretendim i natyrës civile do të përcaktohet në bazë të parimeve të legjislacionit civil. Rezultati i procedimit penal nuk ishte vendimtar per rastin e dëmshpërblimit. Viktima kishte një të drejtë dëmshpërblimi pavarësisht faktit nëse i pandehuri ishte dënuar apo deklaruar i pafajshëm (si në këtë çështje) dhe çështja e dëmshpërblimit ishte objekt i një vlerësimi të veçantë juridik bazuar në kritere dhe standarde të provuari që në shumë aspekte ndryshonin nga ato që aplikoheshin në përgjegjësinë penale. Në këndvështrimin e GJEDNJ, fakti që një akt, i cili shërben si bazë për ngritjen e një pretendimi civil, përbën njëkohësisht dhe elementet përbërëse

---

[126] Po aty, pg. 51.
[127] Po aty.
[128] Çështja *Orr kundër Norvegjisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 31283/04), 15 maj 2008, pg. 53.
[129] Çështja *Ringvold kundër Norvegjisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 34964/97), 11 maj 2003.
[130] Çështja *Ringvold kundër Norvegjisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 34964/97), 11 maj 2003, pg. 37.

objektive të një vepre penale, pavarësisht rëndësisë së saj, nuk mundet, ta konsiderojë një individ që dyshohet përgjegjës në aspektin civil si të akuzuar për një vepër penale. Një konsideratë e tiilë nuk duhet të ekzistojë edhe pse provat e procedimit penal janë përdorur për të përcaktuar pasojat civile të një akti të tillë. Përndryshe, neni 6 do t'i jepte pafajësisë një efekt të padëshiruar duke i hequr të drejtën viktimës për të ngritur një pretendim civil dhe duke krijuar një kufizim arbitrar dhe shpërpjestimor të së drejtës për akses në gjykatë. Kjo do t'i jepte një individi të deklaruar të pafajshëm për një vepër penale, por që ishte përgjegjës civilisht sipas barrës civile të provës, një avantazh të padrejtë për t'iu shmangur përgjegjësisë për veprimet e veta.[131] Kështu, GJEDNJ arsyeton se "*pavarësisht se shkarkimi i përgjegjësisë penale ndodh përgjatë procedurës për dëmshpërblim, kjo nuk e përjashton ngritjen e pretendimeve për kompensim bazuar mbi të njëjtat fakte dhe me një barrë prove më të ulët. Nëse një vendim i një gjykate kombëtare mbi dëmshpërblimin do të përmbajë një deklarim për përgjegjësinë penale të palës së paditur, atëherë kjo do të ngrinte çështje që përfshihen në qëllimin e nenit 6 të KEDNJ.*"[132] Për më tepër, qëllimi i përgjegjësisë civile për pagimin e dëmshpërblimit, në dallim nga përgjegjësia penale, synonte kryesisht ndreqjen e dëmit dhe vuajtjes së shkaktuar viktimës.

KPrP nuk e parashikon shprehimisht mundësinë që edhe pse i deklaruar i pafajshëm, i padituri civil të mbajë përgjegjësi civile. Përkundrazi, nga intepretimi i nenit 68 të KPrP rezulton se padia rrëzohet nëse i pandehuri deklarohet i pafajshëm. Kjo nuk është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ, sikurse trajtuam më sipër. Për këtë qëllim, është e nevojshme që norma të tilla të plotësosheshin më mirë prej ligjvënësit, në të kundërt gjykatat do të duhet të ndjekin praktikën e GJEDNJ. Në fakt, në KPrP parashikohet shprehimisht përjashtimi që nëse i pandehuri është shpallur i pafajshëm për shkak se *fakti nuk parashikohet si vepër penale* ose kur *është vendosur pushimi i çështjes*, padia civile lihet e pashqyrtuar. Ky formulim është i paqartë dhe nuk i jep zgjidhje rasteve me të cilat mund të përballen gjykatat në praktikë. Nëse fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe gjykata për këtë ka shpallur pafajësi, nuk ka kuptim që padia civile të lihet e pashqyrtuar, përkundrazi, duke përbërë potencialisht një shkelje civile, është në favor të ekonomisë gjyqësore, shpejtësisë së gjykimit dhe afateve të arsyeshme që gjykata të disponojë edhe për padinë civile.

Paqartësia më e madhe i referohet rasteve të pushimit të çështjes penale. Gjykata vendos pushimin e çështjes bazuar në nenin 387 të KPrP[133]. Përpara ndryshimeve të prezantuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, nuk bëhej dallimi ndërmjet shkaqeve ligjore që kishin të bënin me pushimin e çështjes dhe atyre që kishin të bënin me pafajësinë[134], kësisoj duke shkaktuar paqartësi lidhur me kuptimin e formulave të pafajësisë të parashikuara në nenin 388 i KPrP me ato që parashikoheshin për pushimin sipas nenit 387 të K.Pr.Penale të pandryshuar me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017. Duke vlerësuar rastet për të cilat gjykata mund të

---

[131] Po aty, pg. 38.

[132] Po aty.

[133] Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, sipas rasteve të parashikuara në shkronjat "c", "ç", "e" dhe "ë", të paragrafit 1, të nenit 328, të këtij Kodi, ose kur vepra penale është shuar dhe i pandehuri nuk pretendon pafajësi, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun

[134] Neni 387 i K.Pr.Penale përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2017 parashikonte se: *Kur ndjekja penale nuk duhej të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun.*

disponojë me pushimin e çështjes, gjykoj se mosshqyrtimi i padisë civile bie ndesh me parimin e cituara më lart, përveç rastit kur padia civile bëhet pengesë për zgjidhjen brenda një afati të arsyeshëm të procesit penal. Sipas gjykimit tim, rastet e vetme se kur duhet të rrëzohet padia civile është rasti kur gjykata shprehet se rezulton e provuar se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale, si edhe rasti kur fakti nuk ekziston, në çdo rast tjetër, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ, në parim, padia civile nuk duhet të rrëzohet thjesht për faktin e deklarimit të pafajësisë, por duhet të shqyrtohet dhe pas këtij shqyrtimi të përcaktohet themeltësia dhe bazueshmëria e saj, në ligj dhe në prova.

KREU III

Barra e provës dhe standardi i të provuarit në fazën e hetimeve paraprake

***Përmbledhje**: **3.1** Standarde të ndryshme apo vetëm një standard. **3.1.1** Vendimi për regjistrimin e procedimit penal dhe vendimi për mosfillimin e procedimit penal. **3.2** Dyshimi arsyeshëm – standard kryesor në hetimet paraprake për kufizimin e lirisë. **3.2.1** Kufizimi i lirisë si pjesë e procesit penal. **3.2.2** Në përgjithësi mbi arrestimin në flagrancë dhe ndalimin e të dyshuarit për një krim. **3.2.3** Arrestimi në flagrancë. **3.2.3.1** Kuptimi i arrestimit të kryer nga qytetarët (citizen's arrest). **3.2.4** Ndalimi i të dyshuarit për një krim. **3.3** Dyshimi i arsyeshëm për caktimin e masave të sigurimit. **3.4** Marrja e personit si i pandehur dhe dërgimi i çështjes në gjykatë. **3.4.1** Të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur. **3.4.2** Kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq. **3.4.3** Kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e çështjes. **3.5** Standardi i zbatueshëm në vendimmarrjet për kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake. **3.5.1** Përgjimi. **3.5.2** Kontrollet. **3.5.3** Sekuestrimi. **3.5.3.1** Sekuestrimi si mjet kërkimi prove. **3.5.3.2** Sekuestrimi si masë sigurimi*

3.1 Standarde të ndryshme apo vetëm një standard

Në procesin penal janë të përcaktuara standarde të ndryshme të të provuarit në varësi të fazës procedurale ku gjendet procedimi penal. Procesi penal përbëhet nga disa mini procese brenda tij, si edhe nga disa faza, ku më kryesoret janë faza e hetimit paraprak dhe ajo e shqyrtimit gjyqësor. Në këtë kre do të përpiqemi të evidentojmë standardet e të provuarit që veprojnë në fazën e hetimeve paraprake. Kjo fazë e procesit penal karakterizohet nga një veprimtari e gjerë procedurale dhe hetimore dhe në këtë pikëpamje nuk duket e gabuar të thuhet se hetimet paraprake kushtëzojnë në masë të konsiderueshme ecurinë e mëtejshme të procesit penal. Për shkak të kësaj veçorie, ashtu siç kam qenë edhe më parë i idesë dhe mendimit[135], në fazën e hetimeve paraprake nuk mund të evidentohet e konkludohet në mënyrë përfundimtare nëse ekziston vetëm një standard të provuari apo një tërësi standardesh.

KPrP, pavarësisht reformave legjislative të ndryshme, ku më thelbësoren do të veçoja atë vitit 2017, vijon të mos ofrojë shumë qartësi në lidhje me këtë çështje. Madje, në gjykimin tim, kjo temë duket disi më e komplikuar nga parashikimi për herë të parë në legjislacionin procedural penal i figurës dhe institutit të gjyqtarit të seancës paraprake, si organi kompetent, i veshur me kompetencat përkatëse ligjore, me qëllim për të vlerësuar kërkesat e prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake, pra si një figurë ndërlidhëse ndërmjet fazës së hetimit paraprak dhe gjykimit. Megjithatë, përpos sa më lart, nga pikëpamja praktike mund të thuhet se standardi i aplikuar përgjithësisht në fazën e hetimeve paraprake, është standardi i dyshimit të arsyeshëm. Zbatimi dhe respektimi i këtij standardi përbën një ndër detyrimet dhe kërkesat kryesore që mundëson vendimmarrjen e organit procedues për përmbushjen e veprimeve të ndryshme procedurale dhe në marrjen e masave të sigurimit. Për rrjedhojë, respektimi i këtij standardi paraqet rëndësi për ecurinë e procedimit penal dhe veçanërisht për subjektin ndaj të cilit zbatohen masat e sigurimit apo që i nënshtrohet veprimeve të tjera procedurale.

---

[135] Olgert Rumnici, Standardi i të provuarit në procesin penal dhe praktika gjyqësore, Temë diplome, Shkolla e Magjistraturës, Korrik 2013.

Pyetja që shtrohet është nëse zbatojmë vetëm një standard apo niveli i të provuarit që kërkohet ndryshon në varësi të interesit që prek norma e zbatuar. Nëse ekzistojnë standarde të tjera, a janë këto të pavarura nga dyshimi i arsyeshëm apo janë variacione të këtij parimi?

Në një studim të hershëm mbi sistemin e drejtësisë penale, duke u bazuar në karakterin kronologjik të zhvillimit të procesit penal, përcaktoheshin pesë kategori të ndryshme standardesh[136]. Këto kategori janë: personi të cilit i atribuohet vepra penale, personi nën hetim, i pandehuri, dyshimi i arsyeshëm dhe dërgimi i çështjes për gjykim nga prokurori[137]. Kriteri për një kategorizim të tillë mund të jetë i vlefshëm pjesërisht edhe aktualisht, pas ndryshimeve legjislative të kryera në KPrP, ku do të veçoja atë të vitit 2017. Baza e një kategorizimi të tillë ka të bëjë me *pozitën e subjektit që i nënshtrohet hetimit*, e parë kjo në kuadër të zhvillimit të fazës së hetimeve paraprake, duke filluar që me regjistrimin e veprës penale dhe të autorit të dyshuar të saj deri me dërgimin në gjyq të çështjes, ku për këtë të fundit duhet të bëhet dallimi ndërmjet fazës së seancës paraprake dhe gjykimit të themelit. Pra, rrjedhimisht nëse bazohemi në këtë studim, standardeve të përcaktuara në të duhet t'i shtohet edhe standardi i të provuarit i aplikuar në seancën paraprake. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se në KPrP nuk njihen edhe standarde të tjera të të provuarit përgjatë fazës së hetimeve paraprake. Këtu është fjala për veprimet e ndryshme procedurale që kryhen gjatë kësaj faze dhe për të cilat dispozitat përkatëse parashikojnë standardin që duhet të përmbushë organi procedues në realizimin e tyre. Në këtë listë përfshihen në mënyrë jo shteruese arrestimi në flagrancë, ndalimi i të dyshuarit për një krim, kontrolli, sekuestrimi, përgjimi etj.

Çështja e pozitës së subjektit që i nënshtrohet hetimit ka qenë objekt i trajtimit nga Gjykata e Lartë përmes jurisprudencës së saj në dy vendime unifikuese[138], ku janë diferencuar figurat e personit të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale, personi ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe i pandehuri. Sipas kësaj jurisprudence "*Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim*". Edhe pse sipas kësaj jurisprudence sqarohet se autori i mundshëm mund të paraqitet në disa figura procedurale, në të nuk ofrohet një trajtim i hollësishëm i arsyeve apo shkaqeve që kushtëzojnë këto figura të ndryshme procedurale. Konkretisht, në vendimin unifikues nr. 3, datë 27.09.2002, Gjykata e Lartë është shprehur se për personin që i nënshtrohet hetimit, në KPrP ekzistojnë tre figura të ndryshme procedurale, qartësisht të dallueshme nga njëra – tjetra. "*Terminologjia e përdorur nga KPrP për subjektet e veprave penale ndryshon nga fillimi i çështjes penale e deri në dërgimin e saj për gjykim. Emërtimi i autorëve të veprave penale fillon me termin "personi, të cilit i atribuohet vepra penale" (neni 287), "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 – "b" e "d" dhe 308 etj.) dhe "i pandehur" që ndeshet në shumë dispozita të tjera të KPrP. Autori i mundshëm i veprës penale, këto*

---

[136] OSBE, Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri – raporti i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë, 2006

[137] OSBE, Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri – raporti i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë, 2006, fq. 41.

[138] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002 dhe Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 2, datë 20.06.2013

emertime i merr në faza të ndryshme të procedimit penal. Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim".[139]

*"Termin "person të cilit i atribuohet vepra penale" e gjejmë në nenin 287 të KPrP që bën pjesë në kreun e dytë të titullit të gjashtë të kodit që flet për mënyrën si njoftohet e merr dijeni për veprën penale prokurori dhe policia. Kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i veprës penale, prokurori, shënon në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale emrin e personit që tregon kallzuesi, se është ose mund të jetë autor i veprës penale. Nuk ka asnjë dyshim se ky emërtim i përket fazës fillestare të procedimit penal. Termi "person të cilit i atribuohet vepra penale" i marrë në kontekstin e nenit 287 të KPrP plus momentin procedural në të cilin perdoret, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" dhe as me termin "i pandehur"***".***[140]

Bazuar në dispozitat procedurale penale, procedimi penal mund të fillojë me disa mënyra:

- Ex-officio apo me iniciativën e prokurorit
- Me referim nga Policia e Shtetit
- Me kallëzim nga qytetarët
- Me kallëzim nga nëpunësi publik dhe personeli mjekësor.[141]

Edhe pse duket sikur ligji e detyron prokurorin që të regjistrojë procedimin për çdo vepër penale, për të cilën ai merr dijeni, qoftë me iniciativën e tij apo me kallëzim, atij nuk mund t'i mohohet diskrecioni në vendimmarrjen për të regjistruar ose jo një çështje. Prokurori, duhet, së pari, të bindet vetë që ekzistojnë, të paktën, shkaqe te arsyeshme për të besuar se është kryer një vepër penale, për të cilën mund të mblidhen prova.[142] Regjistrimi i çështjes penale shoqërohet ose ndiqet[143] nga regjistrimi i emrit të personit nën hetim në regjistrat e prokurorisë. Prokurori ka detyrim të shënojë edhe emrin e personit që i atribuohet vepra penale, si autor i dyshuar i saj. Ky regjistrim duhet të bëhet njëkohësisht me regjistrimin e procedimit, ose më vonë në momentin që identifikohet personi nën hetim. Ky parashikim i ligjit duhet të kuptohet se i kërkon prokurorit të regjistrojë emrin e personit nën hetim, nëse ky është i qartë nga kallëzimi apo nga të dhënat që prokurori ka siguruar kryesisht, por edhe se i lejon prokurorit të regjistrojë çështje pa pasur që në fillim emrat e personave nën hetim. Një aspekt që duhet të merret në konsideratë është se afatet hetimore fillojnë të ecin atëherë kur personit i atribuohet vepra penale, edhe nëse hetimi ka filluar në një kohë të mëparshme.[144] Regjistrimi i emrit të personit të cilit i atribuohet vepra penale nuk do të thotë se ai është vërtet autor i veprës penale. Në se vërtet personi të cilit i atribuohet vepra penale është apo jo autor i veprës penale do të dalë nga një hetim i plotë i gjithanshëm e në përputhje me ligjin.

"*Në fazën e hetimeve paraprake kuptohet se ndryshon dhe gjendja juridiko-procedurale penale e autorit të mundshëm të veprës penale nga person që i atribuohet vepra penale në "person ndaj të cilit zhvillohen hetime". Këtë emërtim e mbajnë vetëm*

---

[139] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002.
[140] Po aty.
[141] Nenet 280, 281, 282 dhe 283 të Kodit të Procedurës Penale.
[142] Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010, fq. 39.
[143] Neni 287 i Kodit të Procedurës Penale.
[144] Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, Botimet Dudaj, Tiranë 2010, fq. 44.

personat që dyshohen si autorë të mundshëm të veprës penale. Edhe ky, emërtimi i dytë që merr autori i mundshëm i veprës penale gjatë hetimeve paraprake nuk mund të barazohet me termin "i pandehur". Personi ndaj të cilit zhvillohen hetime është një figurë procedurale e përkohshme që qëndron midis asaj që KPrP e quan "person të cilit i atribuohet vepra penale" dhe "të pandehurit" e cila është një figurë më e avancuar procedurale dhe relativisht më e qëndrueshme, e cila ruhet e pandryshuar, në çdo gjendje dhe shkallë të procesit penal, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajsisë ose fajësisë (neni 34/2 i KPrP)".[145]

"**Duke përmbledhur sa u tha më sipër, arrihet në përfundimin se figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale që nga momenti i njoftimit të saj tek prokurori e deri në momentin e përfundimit të hetimeve (neni 327) evoluon nga "person të cilit i atribuohet vepra penale" në "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" dhe së fundi në "i pandehur", pavarësisht se çështja pushohet (neni 328) apo dërgohet për gjykim (neni 331). Si rregull statusi i të pandehurit merret në përfundim të hetimeve përpara se të depozitohet fashikulli i gjykimit, por ky status mund të merret edhe më përpara. **Kjo është në çmimin e prokurorit**. Dhe këtë prokurori mund ta bëjë në çdo fazë të hetimit deri në përfundimin e tyre. Këtë veprim prokurori e kryen vetëm pasi të ketë siguruar të dhënat e mjaftueshme (neni 34/1 i KPrP).**"[146]*

Edhe pse në këtë vendim sqarohet se autori i mundshëm mund të paraqitet në disa figura procedurale, në të nuk ofrohet një trajtim i hollësishëm i arsyeve apo shkaqeve që kushtëzojnë këto figura të ndryshme procedurale. Gjithsesi, mund të nënkuptohet që figura procedurale e autorit të mundshëm të veprës penale, është në varësi të të dhënave hetimore të mbledhura, në një fazë të caktuar të hetimeve paraprake. KPrP, madje as jurisprudenca e Gjykatës së Lartë nuk kanë përcaktuar se sa duhet të jetë ky nivel të dhënash që janë të nevojshme për t'i dhënë një subjekti pozitën e atij të cilit i atribuohet vepra penale ose e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime ose e të pandehurit. Po t'i referohemi nenit 287 të KPrP në të nuk përcaktohet ndonjë mjet procedural për të evidentuar dallimin ndërmjet personit që i atribuohet kryerja e veprës penale nga ajo e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Ndryshimet që mund të kryhen në regjistrat e prokurorisë i referohen ndryshimeve të cilësimit juridik ose ndonjë rrethane të kryerjes së veprës penale, por jo statusit të personit ndaj të cilit mund të jetë iniciuar një procedim penal[147].

Gjithashtu, në gjykimin tim vërehet një mospërputhje ndërmjet përmbajtjes së nenit 287 të KPrP dhe dispozitave që kanë të bëjnë me veprimtarinë me iniciativë të policisë gjyqësore, ndër të cilat veçojmë nenin 296 të KPrP. Sa i përket nenit 296 të KPrP, profesor Henrik Ligori ka sqaruar se: "*Norma synon të rregullojë raportet mes policisë gjyqësore, personit nën hetim dhe mbrojtësit të tij në tri situata tipike, që parashikojnë paragrafët përkatës të nenit 296, në një fazë të procedimit kur policia gjyqësore vepron me inisiativën e saj,* ***ndërsa prokurori ende nuk ka marrë përsipër kontrollin dhe drejtimin e hetimeve".***[148] Ndërsa, në situatën e parë dhe të tretë të

---

[145] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002.
[146] Po aty.
[147] Neni 287/2 i KPrP: 2. *Kur gjatë hetimeve paraprake ndryshon* ***cilësimi juridik*** *ose* ***ndonjë rrethanë e kryerjes së veprës penale****, prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas paragrafit 1 të këtij neni.*
[148] Henrik Ligori, Koment mbi nenin 296 të KPrP, http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/296, aksesuar në 20.07.2022

parashikuar nga neni 296 KPrP mund të pritet angazhimi i prokurorit në kontrollin e hetimeve, në situatën e dytë që i referohet veprave penale më vendngjarje ose në rastet e menjëhershme të konstatimit të faktit penal, prokurori ende mund të mos ketë marrë dijeni për faktin, ndërkohë që policia gjyqësore mund të procedojë me pyetjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Profesor Ligori lidhur me këtë shprehet se: "*Në rastet të kësaj natyre, ligjvënësi dëshiron ta zgjerojë sferën e veprimtarisë së policisë gjyqësore me nismën e saj,* ***edhe pse prokurori ende mund të mos ketë marrë dijeni për faktin***".[149] Ajo që konstatohet në këtë rast ka të bëjë me faktin se nëse nga njëra anë jurisprudenca e mësipërme e Gjykatës së Lartë pranon se statusi i personit ndaj të cilit zhvillohen hetime përbën një stad/nivel më të avancuar se statusi i personit që i atribuohet kryerja e veprës penale, dhe se këto janë të lidhura drejtpërdrejtë me vendimmarrjet e prokurorit, nga ana tjetër, në kod janë pranuar situata, në të cilat edhe pse prokurori mund të mos ketë dijeni për faktin e ndodhur, policia gjyqësore ka atributin e identifikimit dhe pyetjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetimet, pra, në një kuptim është policia gjyqësore që i atribuon personit që i nënshtrohet hetimit pozitën e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Një qendrim pragmatik mund të jetë ai sipas të cilit prokurori nuk është i kushtëzuar nga konstatimet e policisë gjyqësore, për shkak se është subjekti që drejton e kontrollon hetimet, por këtij qendrimi mund t'i kundërvihet lehtësisht argumenti i racionalitetit që duhet të udhëheqë punën e secilit subjekt të procesit penal, të cilët duhet të zbatojnë të njëjtat norma procedurale në të njëjtën mënyrë, jo sipas vullneteve subjektive. Një qendrim tjetër mund të jetë ai sipas të cilit, pavarësisht se policia gjyqësore mund të kryejë veprime me iniciativë, nënkuptohet që prokurori ka ose duhet të ketë domosdoshmërisht dijeni për këto hetime e në këtë kuptim e ka ligjëruar edhe statusin me të cilin do pyetet subjekti apo do të kryhen veprime të ndryshme procedurale, por edhe këtij qendrimi sipas gjykimit tim, mund t'i kundërvihen dy argumente, një me natyrë praktike, e që konsiston në faktin që policia gjyqësore përgjithësisht nuk njofton për kryerjen e veprimeve procedurale hetimore të rasteve të caktuara, përjashtuar ato në të cilat procedohet me arrestim në flagrancë, dhe arsyeja tjetër me natyrë ligjore që lidhet me argumentin e mësipërm, ka të bëjë me faktin që sipas nenit 293 të KPrP, *policia gjyqësore i referon prokurorit pa vonesë, por jo më vonë se 72 orë, me shkrim, elementet thelbësore të faktit dhe elementet e tjera që janë mbledhur deri atëherë, duke treguar burimet e provës dhe veprimet e kryera, si dhe vë në dispozicion të prokurorit, për vlerësim, të gjitha aktet dhe provat e marra*, çka do të thotë që përgjatë këtij harku kohor policia gjyqësore mund të ketë kryer një sërë veprimesh hetimore, përpara se prokurori të ketë marrë dijeni e të jetë vënë në kontroll dhe drejtim të hetimeve.

Sipas gjykimit tim, kategorizimi që bëhet nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë ndërmjet figurave të ndryshme të personit që i nënshtrohet hetimit, do të kishte kuptim ose do të ishte efektiv nëse do të reflektohej në të drejta dhe garanci të parashikuara nga legjislacioni procedural respektivisht për secilin status që i njihet personit. Ndërsa, praktikisht nuk evidentohen dispozita që të trajtojnë në mënyrë të diferencuar figurat e ndryshme të personit që i nënshtrohet hetimit. Nga ky arsyetim mund të kuptohet se efekti i kategorizimit të statusit të personit që i nënshtrohet hetimit, është kryesisht me natyrë teorike. Madje, me ndryshimet legjislative të vitit 2017, nga pikëpamja procedurale të tria figurat e personit që i nënshtrohet hetimit,

---

[149] Po aty.

duket se janë barazuar ndërmjet tyre. *Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky KPrP parashikon ndryshe.*[150] Megjithatë, barazia në të drejta dhe garanci, nuk nënkupton detyrimisht edhe të njëjtat detyrime ligjore apo më saktë efekte të procesit penal ndaj personit që i nënshtrohet hetimit. Pra, nga pikëpamja teorike nuk do të ishte e gabuar të gjykohej se në rastin e kufizimeve të lirisë apo efekteve të caktuara të procedurës penale, këto të diferencoheshin në varësi të statusit të subjektit. E thënë me fjalë të tjera, i pandehuri mund të priste që ndaj tij prokuroria të kishte një qasje më kërkuese në drejtim të paraqitjes së kërkesave për masa sigurimi, apo për veprime të tjera procedurale e hetimore si këqyrje, sekuestrime, kontrolle etj., sesa ndaj personit që i atribuohet kryerja e veprës penale ose ndaj të cilit zhvillohen hetime. Por, dukshëm KPrP nuk është i ndërtuar në këtë formë, pra, që secilit subjekt, t'i njohë jo vetëm të drejtat dhe garancitë, por edhe mundësitë e rrezikimit/cenimit të këtyre të drejtave. Kjo do të argumentonte që diferencimi i këtyre subjekteve të bazohej në një qëllim apo arsye. Por, përkundër kësaj, duket se edhe vendimi unifikues, përtej sentencave të rëndësishme që janë artikuluar, ka një kontradiktë të thellë logjike, kur nga njëra anë pranon dallimin ndërmjet figurave të ndryshme të personit që i nënshtrohet hetimit dhe nga ana tjetër nuk evidenton se ku qendron trajtimi i diferencuar në të drejta dhe detyrime. Pra, është e pritshme që kur bëhen dallime ndërmjet subjekteve, ndërmjet tyre të përcaktohen edhe se cilat të drejta apo detyrime i takojnë njërit apo tjetrit subjekt, përndryshe rrezikon që arsyetimi të jetë jo racional, pa ndonjë efekt praktik. Kjo kontradiktë logjike është thelluar më tej kur, duke mos njohur asnjë diferencim në zbatimin praktik të legjislacionit procedural ndërmjet figurave të ndryshme të personit që i nënshtrohet procedimit penal, Gjykata e Lartë ka dalë në përfundimin që masat e sigurimit mund të vendosen edhe kur personi nuk është marrë si i pandehur, çështje e cila do të gjejë një trajtim të veçantë në vijim.

Në ndryshim nga figurat e personit që i atribuohet kryerja e veprës penale dhe ai ndaj të cilit zhvillohen hetime, figura e të pandehurit është pozita më e rëndësishme që merr autori i dyshuar i veprës penale. Në nenin 34 të KPrP parashikohet, "Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur". Siç del nga përmbajtja e kësaj dispozite, personi e merr cilësinë e të pandehurit vetëm atëherë kur ai njoftohet, me akt të shkruar, për akuzën që i ngarkohet. **"***Në këtë akt procedural, mbi bazën e të cilit personi merr cilësinë e të pandehurit, parashtrohen të dhënat e grumbulluara deri në atë fazë të hetimit paraprak, të cilat janë vlerësuar të mjaftueshme, për të konkluduar si për natyrën kriminale të veprës së kryer ashtu dhe për autorin e saj dhe fajësinë e tij. Njoftimi i akuzës, me akt të shkruar, si veprim procedural, nënkupton përfundimin paraprak, të arritur nga organi i prokurorisë, se vepra penale është kryer dhe se autor i saj është personi të cilit i bëhet ky njoftim".*[151]

Ashtu siç rezulton nga ky vendim unifikues i Gjykatës së Lartë, formimi i bindjes se personi që hetohet, duhet të merret në cilësinë e të pandehurit, i takon organit të akuzës, pra prokurorit. Në vendimin e sipërcituar Gjykata e Lartë është shprehur se "*siç del nga përmbajtja e dispozitave të Titullit V, Seksioni I dhe II, të KPrP***,** *kur personit i është hequr liria, në formën e ndalimit apo arrestimit në flagrancë apo kur ndaj tij është*

---

[150] Neni 34/a/3 i KPrP
[151] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002.

caktuar masë sigurimi personal, organi i prokurorisë ***nuk është i detyruar që atë, përpara marrjes së këtyre masave apo përpara se të paraqitet në gjykatë, për vleftësimin apo caktimin e masës së sigurimit personal, ta marrë me cilësinë e të pandehurit.***"[152]

Le të ndalemi pak në krahasimin e nivelit të të provuarit që kërkohet për të fituar cilësinë e të pandehurit dhe dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për vendosjen e masave të sigurimit. Standardi i dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova duhet të zbatohet në kryerjen e arrestit në flagrancë dhe ndalimit, si edhe në marrjen e masave të sigurimit (kuptimi i të cilit do të jepet në vijim). Në lidhje me përmbajtjen e njoftimit të akuzës, si doktrina[153], ashtu edhe jurisprudenca[154], mbajnë qëndrimin se, në këtë akt paraqiten të dhëna, të cilat konsiderohen të mjaftueshme për faktin e kryerjes së veprës penale dhe autorësinë e saj. Pothuaj i njëjti përkufizim jepet dhe për standardin e dyshimit të arsyeshëm[155], duke qenë kësisoj e pamundur të evidentohet nëse ka realisht ndonjë dallim midis këtyre dy koncepteve. Ajo që mund të thuhet me siguri është se subjektet procedurale që vlerësojnë nëse është arritur një standard i caktuar, janë të ndryshëm. Ndërsa, në rastin e marrjes si të pandehur të një personi është prokurori ai që vlerëson nëse ka të dhëna të mjaftueshme, në rastin e aplikimit të masave të sigurimit, prokurori duhet të provojë para gjykatës se ekziston dyshimi i arsyeshëm për aplikimin ndaj personit të një mase sigurimi, dhe më pas është gjykata që duhet të arrijë në një shkallë bindjeje të caktuar se ky dyshim ekziston realisht mbi personin ndaj të cilit kërkohet të caktohet masa e sigurimit.

Pavarësisht këtij dallimi, si niveli i të provuarit për marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit, ashtu edhe standardi i dyshimit të arsyeshëm, duket se janë të njëjtë, po të nisemi nga përkufizimi që jepet nga doktrina dhe jurisprudenca për këto dy koncepte. Megjithatë, ka një dallim esencial ndërmjet këtyre dy koncepteve dhe që konsiston në qëllimin e ndryshëm që ato ndjekin. Marrja e cilësisë së të pandehurit tregon bindjen e prokurorit se një person është autor i veprës penale, ndërsa dyshimi i arsyeshëm shërben për marrjen e masave të sigurimit, të cilat nga ana e tyre synojnë të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer një vepër penale, të pengojnë shmangien e tij nga procedimi, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale[156]. Duke marrë në konsideratë pikërisht këtë dallim, pra, qëllimin e ndryshëm që ndjekin këto standarde, sipas gjykimit tim, standardi për marrjen e personit si të pandehur, që Kodi e përcakton si *të dhëna të mjaftueshme për marrjen si të pandehur*, është një standard më i lartë se dyshimi i arsyeshëm për kryerjen e një vepre penale.

Në vendimin unifikues të mësipërm Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzionin se "*për ndalimin apo arrestimin në flagrancë, nga organi i akuzës si dhe për caktimin e masave të sigurimit personal, nga gjykata, marrja me parë e personit me cilësinë e të*

---

[152] Po aty.
[153] Halim Islami, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, Procedura penale, Botimet Morava, Tiranë, 2007, fq. 134.
[154] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002.
[155] Halim Islami, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, Procedura penale, Botimet Morava, Tiranë, 2007, fq. 356.
[156] Halim Islami, etj., vepër e cituar, fq. 340.

pandehurit, nuk është e detyrueshme".[157] Kjo do të thotë që masat e sigurimit mund të merren jo vetëm pas marrjes së cilësisë së të pandehurit, por edhe përpara marrjes së kësaj cilësie, që nënkupton që ndërmjet standardit të të dhënave të mjaftueshme për marrjen si të pandehur dhe dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova nuk ka një marrëdhënie të kushtëzuar. Gjithsesi, kjo, përgjithësisht ndodh se gjatë hetimit prokurori vëren se hetimi mund të cenohet nga ekzistenca e shkaqeve që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, kur i pandehuri largohet ose ka rrezik të largohet, si dhe kur i pandehuri ka rrezik të kryejë një krim më të rëndë ose të njëjtë me atë që procedohet. Në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia normale e hetimit, prokurori i drejtohet gjykatës me kërkesë për caktimin e masës së sigurimit, edhe kur e ka marrë personin më parë me cilësinë e të pandehurit. Megjithatë, praktika më e zakonshme është që masat e sigurimit merren para se personi të merret me cilësinë e të pandehurit, madje që në fazat e para të hetimit, në mënyrë që të përmbushen qëllimet që përmendëm më lart.

Në praktikë, ndodh më së shumti që masat e sigurimit merren ndaj një personi që ka cilësinë *e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime* apo *personit nën hetim*, apo në rastet e *arrestimit në flagrancë*. Në KPrP, siç theksuam më sipër, nuk përcaktohet se cili është niveli i të provuarit që nevojitet për të konsideruar një person se ka cilësinë e personit nën hetim. Kodi përmban në disa dispozita të tij termin "person ndaj të cilit zhvillohen hetime" apo "person nën hetim", por në asnjë prej tyre nuk sqarohet se cila është baza e mjaftueshme e të dhënave për të pasur cilësinë e personit nën hetim. Vetëm në nenin 308 të KPrP tregohet në mënyrë shumë të shkurtër se në ftesën për paraqitje, të bërë nga prokurori, përmbahet edhe *parashtrimi i përmbledhur i faktit që rezulton nga hetimet e bëra deri në atë çast*.[158] Por, kjo është e pamjaftueshme për të përcaktuar standardin e të provuarit për një person ndaj të cilit zhvillohen hetime. Duke pasur parasysh se figura procedurale e personit nën hetim është një figurë procedurale e përkohshme dhe nën nivelin e figurës së të pandehurit, duket se aplikimi i një mase sigurimi që kërkon dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova si kusht i përgjithshëm për marrjen e saj, nuk përputhet me standardin që mendohet se justifikon statusin e personit nën hetim. Kjo mospërputhje vihet akoma më shumë në dukje nëse kemi të bëjmë vetëm me një person të cilit i atribuohet vepra penale, pra me një figurë procedurale akoma më të hershme se vetë figura e personit nën hetim.

Ky diskutim duket se është bërë edhe nga pakica në vendimin e mësipërm unifikues, e cila ka vërejtur një ndarje të qartë ndërmjet figurave të ndyshme procedurale që merr autori i dyshuar për një vepër penale. Ndarje të tillë e bën, në fakt dhe shumica, por që del me një konkluzion të kundërt, të cilin e paraqitëm edhe me sipër. Pakica arsyeton se ... "*rezulton, qartësisht i shprehur, qëllimi i ligjvënësit sipas të cilit, të gjitha këto masa të sigurimit personal që u përmëndën, mund te merren ose vendosen nga gjykata jo ndaj kujtdo, jo ndaj çdo lloj personi (kuptohet që plotëson kushtet për të qenë subjekt i veprës penale), por vetëm ndaj personave që ndodhen në një gjendje ose me një status të caktuar, po qartësisht të shprehur, nga vet ligjvënësi. Dhe ky person, nga vet ligjvënësi, është emërtuar "i pandehur". Edhe nga përmbajtja e dispozitave të kreut të II të, të titullit të V të, të KPrP, (neni 244-250) në të cilat përcaktohen rregullat që duhen ndjekur për caktimin dhe zbatimin e masave të*

---

[157] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002.
[158] Neni 308 i Kodit të Procedurës Penale.

sigurimit, pavarësisht se jo në të gjitha ato përmëndet termi "i pandehur", rezulton se masa të tilla mund të caktohen nga gjykata jo ndaj çdo personi, por vetëm ndaj personave që kanë marrë cilësinë e të pandehurit".[159]

Më tej pakica arsyeton se "*duke u nisur jo vetëm nga përmbajtja e këtyre dispozitave, por edhe nga titulli i kodit në të cilin ato janë vendosur, si dhe nga organi që procedon për zbatimin e secilës prej tyre, jemi të mendimit se këto tre terma nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë, nuk kanë të njëjtin kuptim.*"[160]

"Përsa i takon termit "person të cilit i atribuohet vepra penale" që përdoret në përmbajtjen e dispozitës së nenit 287 të KPrP, nga qëllimi dhe momenti procedural në të cilin është përdorur, kuptohet se nuk mund të barazohet as me termin "i pandehur" as edhe me termin "personi ndaj të cilit zhvillohen hetime". Ai ka të bëjë me shënimin, nga prokurori, në regjistrin që mbahet për njoftimin e veprave penale, të emrit të personit për të cilin ky njoftim bën fjalë se është ose mund të jetë autor i veprës penale dhe kjo ndodh vetëm në ato raste kur njoftuesi mendon se e di se kush është autori i kësaj vepre."[161]

"Duke patur si pikë referimi, po përmbajtjen e dispozitave të përmëndura të KPrP dhe organin që procedon për zbatimin e tyre, mendojmë se edhe termi "personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet" nuk mund të barazohet me termin "i pandehur" pasi nga përmbajtja e dispozitave që u përmënden se është përdorur ky term, rezulton që këtë emërtim e mbajnë vetëm personat që dyshohen si autorë të mundshëm të veprës penale dhe që me përjashtim të një rasti të vetëm (neni 308 i KPrP), kemi të bëjmë me veprime të kryera nga oficeri i policisë gjyqësore me ta. Kjo sepse, "personi ndaj të cilit zhvillohen hetimet", është një figurë e përkohëshme, provizore procedurale, e cila qëndron midis asaj që ligjvënësi e quan "person të cilit i atribuohet vepra penale" për efekte të regjistrimit, nga prokurori, të emrit te tij, në regjistrin e veprave penale (neni 287) dhe "të pandehurit", i cili përbën një figurë më të avancuar, relativisht më të qëndrueshme procedurale, e cila ruhet e pandryshuar, në çdo gjendje dhe shkallë të procesit, derisa të ketë marrë formë të prerë vendimi i pushimit, i pafajësisë ose i dënimit, (neni 34/2 i KPrP)."[162]

Siç rezulton, pranohet se ka dallim ndërmjet figurave të ndryshme procedurale të autorit të dyshuar të veprës penale, megjithatë ky dallim nuk reflektohet për aplikimin e standardit të dyshimit të arsyeshëm në marrjen e masave të sigurimit, por përkundër kësaj, nëpërmjet vendimit të mësipërm unifikues, ekziston një praktikë e konsoliduar se masat e sigurimit mund të caktohen përgjithësisht përpara se personi të merret në cilësinë e të pandehurit. Pa dashur të kritikojmë këtë praktikë, e cila ka një miratim të gjerë sot, nuk mund të mos përmendim se standardi i dyshimit të arsyeshëm nuk përputhet me standardin që kërkohet për personin që i atribuohet vepra penale dhe personin nën hetim. Në studimin e cituar në hyrje të kësaj pjese[163] standardet janë të renditura edhe duke marrë për bazë forcën bindëse të tyre në raport me figurën e personit që i nënshtrohet procedimit penal. Në këtë drejtim konstatohet që dyshimi i arsyeshëm vjen në radhë pas standardit të aplikuar për marrjen si të pandehur të personit, çka mund të interpretohet si shkallë apo nivel më bindës i standardit të

---

[159] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002, mendimi i pakicës.
[160] Po aty.
[161] Po aty.
[162] Po aty.
[163] OSBE, Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri – raporti i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë, 2006

dyshimit të arsyeshëm kunddrejt atij të ngritjes së akuzës ndaj të pandehurit. Sipas gjykimit tim, të shprehur dhe më lart, e anasjellta duhet të jetë e saktë, pasi cilësia e të pandehurit karakterizohet nga vazhdimësia në procesin penal deri në momentin e marrjes formë të prerë të vendimit të gjykatës, ndërsa masat e sigurimit nga natyra karakterizohen nga përkohshmëria dhe përveç kushtit të përgjithshëm të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, duhet të plotësohen edhe nga kushte dhe kritere të tjera ligjore.

Rast përjashtimor përbën urdhërimi i gjykatës për prokurorin më qëllim që ky i fundit të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur gjyqtari i seancës paraprake çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq. Kjo është një risi e prezantuar me ndryshimet legjislative të vitit 2017 dhe është një vendimmarrje që kryhet nga gjyqtari i seancës paraprake gjatë vlerësimit të kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal (ose mbi ankimin ndaj vendimit të pushimit për kundërvajtje penale). Pa dashur të bëjë pjesë të diskutimit çështjen e kushtetutshmërisë së kësaj norme, pasi ndryshimet legjislative të vitit 2017 kanë qenë objekt i shqyrtimit nga Gjykata Kushtetuese[164] dhe tejkalojnë objektin e këtij punimi, mund të thuhet se në këtë normë përmbahen dy veprime procedurale të ndryshme që karakterizohen nga standarde të ndryshme të të provuari, pra, ligjvënësi ka paraqitur në të njëjtën normë detyrimin për të ngritur akuzë dhe për të paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas gjykimit tim, duke qenë se qëllimi i gjyqtarit të seancës paraprake në këtë rast është shqyrtimi i kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, për shkak se i rezulton që ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq, e bën të panevojshme parashikimin në pjesën e parë të dispozitës, në të cilën kërkohet edhe formulimi i akuzës, pasi ky është një veprim procedural i detyrueshëm për prokurorin për t'u kryer në rast të dërgimit të çështjes në gjykatë, pra, nuk është çështje fakultative në vullnetin dhe vlerësimin e prokurorit. Megjithatë, lidhur me standardet e të provuarit në seancën paraprake sa i përket shqyrtimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim dhe kërkesës për pushim do të trajohen në vijim të kësaj pjese.

Në analizë të sa më sipër rezulton se në lidhje me tre figurat procedurale të autorit të dyshuar të veprës penale, në Kod nuk njihen nivelet që duhen provuar për secilën prej këtyre figurave. Në kushtet aktuale të legjislacionit procedural penal, por edhe të vazhdimësisë konstante të praktikës gjyqësore lidhur me masat e sigurimit, mund të themi se dyshimi i arsyeshëm është standardi që aplikohet për të tre këto figura procedurale, por duhet thënë se ai nuk përfaqëson të njëjtën shkallë specifike, por është variabël në varësi të figurës konkrete procedurale. Kështu, nuk mund të barazohet dyshimi që ekziston për personin që i atribuohet vepra penale, me personin nën hetim apo me vetë të pandehurin. Kjo është mëse evidente, edhe pse Kodi nuk përmban asnjë dallim në këtë drejtim, madje as doktrina dhe as jurisprudenca nuk e kanë parë të arsyeshme ta shqyrtojnë këtë problematikë në një këndvështrim të tillë. Pra, po të nisemi nga parashikimet e KPrP, është më e pranueshme ideja se ***<u>në lidhje me pozitën e të dyshuarit për një vepër penale</u>***, kemi të bëjmë me nivele të ndryshme të standardit të dyshimit të arsyeshëm, sesa me disa standarde të ndryshme.

---

[164] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 02.03.2018

Nëse bëjmë një krahasim me legjislacionin procedural penal të Kosovës duket se përgjatë fazës së hetimit paraprak standardi kryesisht i zbatuar është ai dyshimit të arsyeshëm, me nivele të ndryshme. Në komentarin e kodit të procedurës penale të Kosovës citohet se: *Sipas dispozitave procedurale, procedura penale zhvillohet vetëm nëse ekziston dyshimi se është kryer ndonjë vepër penale konkrete, si dhe nëse ndonjë person është autor i saj. Me fjalë të tjera, procedura penale vihet në lëvizje kur ekziston besueshmëria (probabiliteti) se një person ka kryer vepër penale. Pas vënies në lëvizje të procedurës penale, gjyqtari, duke i proceduar provat, i ofrohet gradualisht gjykimit psikologjik për faktet juridike relevante. Në rrugëtim gradual gjykimi (bindja) i gjyqtarit lëviz nga besueshmëria, e cila nuk përjashton mundësinë e së kundërtës, drejt bindshmërisë. Vetë konstrukti i procedurës penale u është përshtatur* ***gradacioneve të besueshmërisë*** *për veprën e kryer penale dhe autorin e saj. Kështu, që në fillim të procedimit penal, organet policore ndërmarrin veprime të caktuara kur ekziston "dyshim i arsyeshëm" se është kryer vepra penale që ndiqet kryesisht (ex officio); hetimi fillohet kundër personit të caktuar posa prokurori i shtetit të informohet se ekziston "dyshimi i arsyeshëm" se është kryer vepër penale, e cila ndiqet kryesisht; për zbatim të masave të fshehta dhe teknike kërkohet ekzistimi i dyshimit të bazuar, i shoqëruar me ndonjë shkak tjetër; pas përfundimit të hetimit (ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet që disponon ai për veprën penale dhe autorin e saj, paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedimi në gjyq mund të bëhet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit, e cila i nënshtrohet kontrollit gjyqësor nëpërmjet shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë. Mirëpo, besueshmëria se i pandehuri ka kryer vepër penale, se për të ka përgjegjësi penale dhe se për këtë ekzistojnë kushtet për shqiptim të sanksionit penal ndaj autorit të veprës penale nuk është vetëm kusht se ndaj tij mund të fillojë procedura penale, por është edhe kusht për mundësinë e vazhdimit të atij procesi. Posa të mos ekzistojë më besueshmëria e tillë, procedura duhet të pushojë.*[165]

Një vëmëndje të veçantë duhet t'i kushtojmë momentit të dërgimit të çështjes për gjykim, përmes kërkesës së prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake dhe vendimmarrjen e këtij të fundit për dërgimin ose jo të çështjes për gjykim. Përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017 prokurori procedonte drejtpërdrejtë me kërkesë për gjykimin e çështjes me qëllim që gjykata e themelit të investohej në gjykimin e një apo disa akuzave të caktuara të parashtruara në atë kërkesë. Rëndësia e kësaj çështje qëndron në faktin se deri në ç'masë prokurori duhet të ketë provuar në hetimet paraprake ekzistencën e faktit kriminal dhe autorit të tij, në mënyrë që të krijojë bindjen se çështja duhet të shkojë në gjykim, kur kërkesa do të shqyrtohet paraprakisht nga gjyqtari i seancës paraprake dhe se cili është standardi i të provuarit që duhet të përmbushet nga momenti i zhvillimit të fazës së gjykimit në seancë paraprake deri në dërgimin eventual të çështjes për gjykim nga gjyqtari i seancës paraprake. I rëndësishëm është dhe trajtimi i dallimit midis standardit të marrjes së personit si të pandehur dhe atij të aplikuar në seancë paraprake dhe dërgimit eventual të çështjes për gjykim. Kjo çështje do të trajtohet posaçërisht në vijim, ndaj këtu po mjaftohemi me konstatimin që standardi për marrjen e personit në cilësinë e të pandehurit nuk është i njëjtë me standardin që kërkon ligjvënësi për dërgimin e

---

[165] Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Komentar i Kodit të Procedurës Penale, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, dhjetor 2014, fq. 54

çështjes në gjyq. Gjithashtu, kërkesa e prokurorit dhe vendimi i gjykatës së seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq përmban në vetvete një standard më të avancuar apo të lartë edhe se vetë dyshimi i arsyeshëm.

3.1.1 Vendimi për regjistrimin e procedimit penal dhe vendimi për mosfillimin e procedimit penal

Vendimmarrja e prokurorit mbi mosfillimin e procedimit penal parashikuar nga nenet 290 e vijues të KPrP, pavarësisht se parashikohet si institut pas përcaktimeve të nenit 287 të KPrP, që kanë të bëjnë me regjistrimin e procedimit penal, nuk përfshihet në konceptin e hetimit paraprak. Siç e kemi trajtuar më lart, koncepti i hetimit paraprak nënkupton kryerjen e një procesi hetimor, pas regjistrimit të një procedimi penal. Megjithatë, në kuadër të studimit të standardeve të të provuarit në procesin penal, paraqet interes studimi i standardit të të provuarit që duhet të përmbushet në arsyetimin e kësaj vendimmarrje nga prokurori. Gjithashtu, trajtimi i tyre paraqet interes edhe për shkak të faktit se kjo vendimmarrje e prokurorit është një nga dy vendimmarrjet që së bashku me vendimin/urdhrin për regjistrimin e procedimit penal, kushtëzojnë dhe ecurinë e mëtejshme të një procesi penal. Është e qartë që të dy vendimmarrjet janë përjashtuese ndaj njëra-tjetrës në kuptimin që nëse nga prokurori procedohet me vendimin për mosfillimin e procedimit penal, ky përbën një vendim përfundimtar lidhur me konstatimet e prokurorit mbi pretendime të caktuara të shprehura në materialin hetimor që i paraqitet për vlerësim prokurorit dhe kjo vendimmarrje mund të zhbëhet vetëm pas vendimit të gjykatës që e shfuqizon/prish mosfillimin mbi bazën e një ankimi të paraqitur nga palët.

Përpara se të diskutohet mbi shkallën e bindjes dhe sigurisë që duhet të ofrojë vendimi i mosfillimit të procedimit penal, është e nevojshme paraprakisht të shpjegohet se cili është standardi që duhet të aplikohet në regjistrimin e një procedimi penal. Në pjesën e mësipërme shpjeguam që prokurorit nuk mund t'i mohohet diskrecioni në regjistrimin ose jo të një procedimi penal, edhe pse është e qartë sipas mendimit tim se neni 287 i KPrP orienton drejt detyrueshmërisë së regjistrimit të procedimit. Në sistemin tonë të procedurës penale mund të thuhet se vepron parimi i detyrueshmërisë (legalitetit) së ndjekjes penale, për këtë arsye nuk gjenden në procedurën penale rregullime që e lejojnë prokurorin të mos fillojë, të ndërpresë procedimin ose të pushojë ndjekjen për shkaqe oportuniteti. Parimi i detyrueshmërisë së ndjekjes penale garanton, nga njëra anë, pavarësinë e prokurorit në ushtrimin e funksioneve të tij dhe, nga ana tjetër, ligjshmërinë në veprimtarinë e prokurorit dhe barazinë e shtetasve para ligjit penal. Në memorandumin ligjor të Shkollës së Magjistraturës [166] drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme është cituar se: "*Doktrina juridike shqiptare ka përcaktuar që kompetenca e një organi nënkupton jo vetëm të drejtën e organit për të ushtruar një funksion të caktuar, por njëkohësisht detyrimin e tij për ta ushtruar atë, brenda kufijve të përcaktuar nga ligji*[167]*. Kompetenca e prokurorit për të vendosur mosfillimin e procedimit apo pushimin e çështjes "... nuk lejohet të interpretohet si e*

---

[166] Memo ligjore, "Ankimi gjyqësor ndaj vendimit të mosfillimit/pushimit të çështjes dhe fillimi/rifillimi i hetimeve nga prokurori", hartuar nga Flojera Davidhi, Elsa Ulliri, Armanda Xhaferri, 17 korrik 2013.

[167] Dr. Sadushi S., "E drejta administrative 2", shtëpia botuese "Grand Prind", Tiranë, Shtator 2008, fq. 112.

drejtë subjektive e tyre, d.m.th. si e një e drejtë që ata ose e përdorin, ose mund të vendosin të mos e përdorin"[168]*. "Kjo e drejtë nuk ka karakter subjektiv, pasi zbatimi i saj sipas vullnetit të prokurorit, jashtë kritereve ligjore, do të cenonte parimin e ligjshmërisë nga i cili udhëhiqet i gjithë procesi penal në të gjitha fazat ..."*[169]*. Pra, në Shqipëri vepron sistemi i legalitetit, sipas të cilit prokurori ka detyrimin të procedojë penalisht çdo krim apo kundërvajtje penale, dhe nuk ka diskrecion të vlerësojë nëse duhet filluar procedimi penal apo jo. Rastet e vetme në të cilat prokuroi vendos mosfillimin e procedimit penal janë ato të parashikuara shprehimisht nga ligji"*[170]

Megjithatë, nëse i referohemi formulave të mosfillimit të procedimit penal, ku më e rëndësishmja është rasti *kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston,* mund të kuptohet që ligjvënësi brenda parimit të detyrueshmërisë ka njohur disa përjashtime, si rasti i mësipërm, ku dilema e regjistrimit të procedimit penal apo e mosfillimit të tij, do të zgjidhet në bazë të diskrecionit apo vullnetit të prokurorit. Sipas gjykimit tim, ndërsa nga njëra anë, zbatimi i parimit të oportunitetit në procesin penal do të vinte në diskutim ligjshmërinë dhe procesin e rregullt ligjor në tërësi, njohja e një diskrecioni të kufizuar të prokurorit në momentet fillestare të një çështjeje penale, do të shërbente si një filtër ndaj kallëzimeve penale apo materialeve hetimore të pabaza dhe ato që paraqiten për shkaqe jo të ligjshme, të iniciuara kryesisht për arsye ngushtësisht personale, financiare, politike etj. Në këtë rast, diskrecioni nuk duhet kuptuar si një veprimtari arbitrare, çka rëndom mund të perceptohet në mënyrë të gabuar gjerësisht, por si një veprimtari që synon zbatimin e ligjit edhe atëherë kur nuk është mjaftueshmërisht i qartë ose i vetpërcaktuar ose kur e lejon një gjë të tillë. Në KPrP nuk përcaktohet koncepti i diskrecionit, por për mendimin nuk ka asnjë kontradiktë ligjore apo logjike që për kuptimin e tij t'i referohemi të drejtës administrative. Në nenin 3 të KprAd është përcaktuar se: "*Diskrecioni i organit publik" është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik* ***për të përmbushur një qëllim të ligjshëm***, ***në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë***, ***duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik.***" Nga ky përkufizim mund të përcaktohen disa karakteristika të ushtrimit të diskrecionit, si përmbushja e qëllimit të ligjshëm, parashikimi i modaliteteve nga ligji për ushtrimin e diskrecionit dhe hapësira e vlerësimit të zgjedhjeve të kryera nga organi publik, të cilat i përgjigjen dhe përputhen me kompetencën e prokurorit për regjistrimin e procedimit penal ose mosfillimin e tij.

Megjithatë, edhe ky diskrecion, sipas dispozitave ligjore është i kontrollueshëm. Së pari vetë ligji përcakton se jo pa qëllim vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal duhet të jetë i arsyetuar, i cili është një element që i shërben gjykatës për të vlerësuar pikërisht mënyrën e ushtrimit të kompetencave të prokurorit. Së dyti, ligji ka përcaktuar mundësinë e ankimit ndaj këtij vendimi. Së treti, natyra juridike e një vendimmarrje të tillë nuk barazohet me atë të një vendimi gjyqësor penal. *Vendimi për mosfillimin e procedimit konsiderohet* ***i formës së prerë*** *në rast se kundër tij nuk paraqitet ankim brenda afatit të përcaktuar në ligj ose në rastin kur lihet në fuqi me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në aspektin e parimit të sigurisë juridike, ky*

---

[168] Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 21 Korrik 2008, fq. 7 – 8 të vendimit.
[169] Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 137, datë 26 Tetor 2011, prg. 31 i vendimit.
[170] Memo ligjore, "Ankimi gjyqësor ndaj vendimit të mosfillimit/pushimit të çështjes dhe fillimi/rifillimi i hetimeve nga prokurori", hartuar nga Flojera Davidhi, Elsa Ulliri, Armanda Xhaferri, 17 korrik 2013, fq. 12-13 e punimit

vendim edhe pse konsiderohet i formës së prerë, mund të revokohet në rast se disponohet për rifillimin e hetimeve kur dalin të dhëna apo prova të reja të cilat së bashku me aktet dhe provat e marra tregojnë se vendimi i mosfillimit nuk është i bazuar apo nëse më pas bëhet ankim nga viktima. Vendimi për mosfillimin e procedimit nuk përbën "gjë të gjykuar" për arsye se deri në marrjen e këtij vendimi nuk ka procedim penal të regjistruar dhe as emër të personit që i atribuohet vepra penale, megjithëse kallëzimi penal mund të jetë bërë kundër një personi konkret të kallëzuar. Për këto arsye revokimi i këtij vendimi më vonë nuk konsiderohet se cënon interesat e personit të kallëzuar.[171]

Rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal përgjithësisht janë të tilla që mund të evidentohen pa qenë nevoja e verifikimeve apo arsyetimeve të hollësishme nga ana e prokurorit, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë *kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston.* Edhe pse ka mendime, në praktikë apo doktrinë që rasti kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale përbën një rrethanë që mund të vlerësohet nga krahasimi i faktit me normat përkatëse të KP, sipas gjykimit tim ky është rasti ku konstatohet më së shumti diskrecioni i prokurorit. Vlerësimi nëse fakti përbën ose jo vepër penale apo kur del qartë që fakti nuk ekziston nuk mund të deduktohet mbi bazën e konstatimeve të thjeshta, por përbëjnë operacione të mirëfillta logjike dhe juridike, ku prokurori duhet të konkludojë përmes një procesi arsyetimi të fakteve nëse ato përbëjnë ose jo vepër penale apo nëse nuk ekzistojnë. Kjo tregon që në momentin, në të cilin përcaktohet regjistrimi i procedimit apo mosfillimi i tij, prokurori kryen një proces arsyetimi dhe është pikërisht ky moment që përbën pikën e takimit me nocionin e diskrecionit. Nëse gjykojmë mbi bazën e parimit të detyrueshmërisë, prokurori do duhej të regjistronte automatikisht procedimin penal dhe nga ana tjetër do të ishte e pakuptimtë që krahas parimit të detyrueshmërisë të bashkëekzistonte dhe instituti i mosfillimit të procedimit penal. Vetë ekzistenca e këtij instituti, shoqëruar edhe me formula të mosfillimit që kanë nevojë për vlerësime logjike dhe juridike, tregon që prokurorit i njihet diskrecioni mbi vlerësimin e rrethanave që passjellin regjistrimin e procedimit ose mosfillimin e tij. Lidhur me këtë çështje, në jurisprudencën e saj, Gjykata e Lartë është shprehur se: "*"Duhet pasur parasysh se jo për çdo kallëzim apo denoncim organi i akuzës është i detyruar të bëjë regjistrimin për procedimin penal dhe* ***regjistrimi bëhet kur ai plotëson kushtet ligjore për nisjen e tij****, gjë që do të thotë se duhet bërë një vlerësim paraprak për nisjen ose jo të procedimit penal. ...* ***në kushtet kur vërtetohen kriteret ligjore që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal nuk mund të kryhen veprime hetimore***"[172]

Fakti që duhet të zhvillohet një proces vlerësimi i rrethanave të cilat passjellin regjistrimin e procedimit penal, nënkupton që për të justifikuar këtë vendimmarrje të prokurorit, rrethanat apo faktet e konstatuara duhet të jenë të tilla, në një shkallë të caktuar bindëse dhe sigurie që mbi bazën e tyre të konkludohet se ka nevojë për hetime. Në doktrinë ekziston mendimi se për të filluar procedimi penal është e nevojshme ekzistenca e të dhënave, të cilat shfaqin *dyshimin e arsyeshëm* dhe krijojnë bindjen se gjendemi përpara kryerjes së një vepre penale, bindje kjo që krijohet mbi bazën e

---

[171] Ornela Naqellari, Koment mbi neni 291 të KPrP, http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/291

[172] Vendimi nr. 222, datë 12 Shtator 2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, fq. 3 – 4 të vendimit.

perceptimit intelektual të prokurorit [173] . Edhe nëse i referohemi sistemit të legalitetit/ligjshmërisë, mbi të cilin është bazuar edhe instituti i regjistrimit të procedimit penal në KPrP, sipas këtij sistemi pranohet se roli i prokurorit është i kufizuar në vlerësimin ligjor të mjaftueshmërisë së të dhënave në ngarkim të të dyshuarit[174]. Diferenca me sistemin e oportunitetit nuk ka të bëjë me kufizimin ose jo të rolit të prokurorit në shqyrtimin e të dhënave për regjistrimin e një procedimi penal, por me faktin që në sistemin e oportunitetit, prokurorët marrin në konsideratë përveç të dhënave që mund të ekzistojnë në një çështje, edhe faktorë të tjerë me interes publik. Është pikërisht vlerësimi i këtyre të fundit që u ndalohet prokurorëve në sistemin e legalitetit.

Sipas gjykimit tim, në nenin 287 të KPrP parashikohet detyrueshmëria e regjistrimit të njoftimeve që përbëjnë vepër penale, jo edhe të çdo njoftimi që nuk mund të përcaktohet/konfirmohet në nivelin e një standardi të dyshimit të arsyeshëm si vepër penale dhe autorësia e mundshme e saj. Gjithashtu, në këtë kuadër, prokurori nuk mund të kryejë vlerësim sipas nenit 291/1 të KPrP (vendimi i mosfillimit të procedimit penal brenda 15 ditëve) në kushtet e paplotësisë së materialit hetimor të dërguar në Prokurori. Sipas këtij arsyetimi, afati i përcaktuar në nenin 291/1 të KPrP duhet të fillojë në momentin kur materiali fillestar hetimor/kallëzimi i dërguar në Prokurori është i plotësuar në atë masë sa të përmbushë standardin e dyshimit të arsyeshëm për ekzistencën e një vepre penale dhe/ose të autorit të mundshëm të saj, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet për regjistrimin e tij si procedim penal ose të përjashtojë kategorikisht ekzistencën e veprës penale ose të dyshimeve të arsyeshme mbi ekzistencën e saj. Një vendimmarrje e prokurorit për regjistrimin e një procedimi penal në të tilla kushte nuk do të ishte në përputhje me parashikimet e nenit 287 të KPrP, për rrjedhojë, çdo vendimmarrje duhet të kryhet pas ekzistencës dhe administrimit të akteve përkatëse, mbi bazën e të cilave mund të ekzistojë probabiliteti ose jo i kryerjes së një vepre penale.

Çështja tjetër që shtrohet ka të bëjë me nivelin e bindjes dhe sigurisë që duhet të manifestohet në vendimin e mosfillimit, pra, cili është standardi i të provuarit të kësaj vendimmarrje. Në nenin 291/1 të KPrP ligjvënësi ka përcaktuar se prokurori vendos mosfillimin e procedimit ***kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal***. Sipas gjykimit tim, terminologjia e përdorur nga ligjvënësi është e qartë dhe nuk lë vend apo hapësira për interpretime. Shkalla e sigurisë apo bindjes mbi vërtetimin e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal duhet të jetë e tillë që ekzistenca e rrethanave të tilla të mos jetë e diskutueshme dhe të shmangen opsionet e mundshme apo të arsyeshme që tregojnë se këto rrethana nuk ekzistojnë. Në këtë kuptim, standardi i të provuarit në vendimmarrjen e mosfillimit të procedimit penal i përngjet një standardi të avancuar në procesin penal, i krahasueshëm me standardin që aplikohet në gjykimin e themelit të çështjes kur përcaktohet fajësia e të pandehurit. Nga interpretimi sistematik i nenit 287 të KPrP dhe nenit 291/1 të KPrP, kur prokurori ka dyshime të arsyeshme nëse ekzistojnë rrethanat që passjellin mosfillimin e procedimit, pra, nëse nuk është e qartë që ato ekzistojnë apo qendrojnë, atëherë prokurori, duhet të procedojë me kryerjen e verifikimeve dhe nëse këto nuk

---

[173] Murat Hulaj, Disertacion, Aspekte juridike krahasuese lidhur me fillimin apo me mosfillimin e procedimit penal Kosovë-Shqipëri, UET, Tiranë, Dhjetor 2016, fq. 32

[174] Despina Kyprianou, The role of the Cyprus attorney general's office in prosecutions: rhetoric, ideology and practice, University of London, Dhjetor 2006, fq. 59,

japin rezultat, me regjistrimin e procedimit penal. Lidhur me këtë çështje, me vendimin unifikues nr. 02/2013, Gjykata e Lartë, ka shprehur se:…..*vendimi i prokurorit që ka disponuar mosfillimin e procedimit penal, merret mbasi më parë, janë verifikuar rrethanat e parashikuara nga neni 290 i K.Pr.Penale. Këto rrethana, në fakt, nuk kërkojnë një proces të ndërlikuar e të gjatë për mbledhjen e të dhënave apo të kryerjes së veprimeve të rëndësishme hetimore në drejtim të zbulimit të fakteve lidhur me themelin e fajësisë apo të pafajësisë.* Gjithashtu, Gjykata është shprehur se*: "Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi."* Edhe pse në mënyrë implicite mund të kuptohet nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë, rrethanat që passjellin mosfillimin e procedimit penal, duhet të jenë të qarta, pra, jo të dyshimta, e kjo konfirmon, gjithashtu, se ato duhet të jenë të provuara në momentin që prokurorit i paraqitet kallëzimi ose gjatë procesit të verifikimit, me një shkallë vërtetësie dhe sigurie të lartë.

Përgjithësisht, rrethanat e mosfillimit janë të tilla që siç shprehet Gjykata e Lartë konstatohen lehtësisht, por ky mund të jetë një përfundim në parim ose më saktë kërkesa që imponon neni 291 i KPrP, që në rast të mosfillimit të procedimit penal, rrethanat të jenë të qarta, por operacioni për të konfirmuar nëse ekziston njëra apo tjetra rrethanë e përcaktuar në nenin 290 të KPrP ndërthur nevojën për të kryer verifikime me argumentimin juridik të tyre. Le të marrin si shembull rastin e papërgjegjshmërisë mendore, e cila në pamje të parë mund të duket si rrethanë lehtësisht e konstatueshme duke u mjaftuar me administrimin e dokumenteve shëndetësore të personit. Por, përgjegjshmëria mendore sipas nenit 17 të Kodit Penal duhet të vlerësohet sipas disa kritereve, së pari nëse në momentin e kryerjes së një vepre penale të dyshuar a ka qenë realisht personi nën efektet e një sëmundje mendore apo në kohën e kryerjes së saj ka qenë i kthjellët, së dyti, nëse konfirmohet që personi në kohën e kryerjes së veprës penale ka vuajtur nga një sëmundje e caktuar mendore, a i ka ulur ajo tërësisht ekuilibrin mendor apo e ka ulur pjesërisht, së treti a duhet caktuar ndaj personit një masë mjekësore sipas nenit 46 të KPrP dhe si do të realizohet nga pikëpamja procedurale. Rrethana të tjera që kërkojnë një proces të vërtetë analize janë rastet e cituara dhe më sipër kur fakti nuk përbën vepër penale ose nuk ekziston, apo edhe rasti i përcaktuar në germën "e" të nenin 290, për raste të tjera të parashikuara me ligji, ku përgjithësisht, prokurorët kanë arsyetuar mbi vepra penale që ndiqen me kërkesën e viktimës akuzuese sipas nenit 59 të KPrP.

Pavarësisht se nuk është objekt i temës sonë, shqyrtimi i rasteve të mosfillimit të procedimit penal, e konsideroj të rëndësishme të ndalemi në trajtimin e përmbledhur të rastit kur fakti nuk ekziston. Në një vendim të hershëm, Gjykata e Lartë ka shprehur: *"Nëse fakti ekziston apo jo dhe nëse vepra është kryer nga personat e kallëzuar, ky përfundim mund të nxirret vetëm pasi të jenë kryer hetimet lidhur me rrethanat. Tjetër është nëse fakti nuk parashikohet si vepër penale dhe tjetër është rasti kur fakti nuk ekziston. Për të parin mund të procedohet edhe me mosfillim, pasi prokurori të bëjë verifikimet e nevojshme, ndërsa në rastin e dytë duhen zhvilluar hetime"*[175]. Mbi bazën e një praktike të tillë, jurisprudenca e mëtejshme e gjykatave,

[175] Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 65, datë 30 Janar 2002.

por edhe doktrina kanë mbështetur këtë qendrim. Sipas gjykimit tim, qendrimi është pjesërisht i drejtë, për shkak se nuk ka marrë në konsideratë formulimin e plotë të këtij rasti të mosfillimit të procedimit penal. Ligji shprehet se mosfillimi në këto raste vendoset kur del **qartë** që fakti nuk ekziston. Pra, ligji ka imponuar si detyrim për prokurorin që mosfillimi vendoset **kur mosekzistenca e faktit është e qartë**, dhe kjo qartësi është e konfirmuar qoftë nga kallëzimi, qoftë nga veprimet verifikuese të kryera në kuadër të atij kallëzimi. Ky arsyetim është në përputhje me argumentin e mësipërm se standardi i të provuarit në rastin e vendimmarrjes së prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është i niveli të lartë bindës. Duhet theksuar se kjo pjesë e normës ka mbetur e pandryshuar edhe nga reforma legjislative e vitit 2017, çka do të thotë se ligjvënësi nuk e ka përkrahur qasjen e jurisprudencës. Qendrimi i mësipërm i jurisprudencës, sipas mendimit tim, ka vend për rastet kur për mosekzistencën e faktit ka paqartësi, pra, kur ka dyshime të arsyeshme se ai mund të ekzistojë, në këtë rast prokurori ka detyrimin për regjistrimin e procedimit penal sipas nenit 287 të KPrP. Me qëllim për të argumentuar mundësinë e zbatimit të kësaj dispozite, le të marrim një shembull të thjeshtë: kur një person pretendon se i kanë tentuar të vjedhin banesën, për shkak se e gjen derën e pakyçur, por nga materialet e grumbulluara në kallëzim, supozojmë nga policia, rezulton nga këqyrja e pamjeve filmike se personi ka harruar të kyçë derën kur është larguar nga banesa dhe në të nuk është futur asnjë njeri tjetër. Në këtë rast është e qartë që fakti i vjedhjes nuk ekziston dhe për këtë nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme. Shembuj të tillë mund të hasim edhe në rastet e gjykimeve civile të përfunduara me vendim të formës së prerë, ku është konfirmuar me ekspertim grafik origjinaliteti i një dokumenti. Pala humbëse e gjyqit, duke mos qenë dakort me përfundimet e tij kallëzon në Prokurori për të njëjtat dokumente si të fallsifikuara. Në këtë rast, nga materiali kallëzues që disponon Prokurori dhe verifikimet që mund të kryejë në drejtim të administrimit të një kopje të fashikullit të gjykimit civil, i rezulton se për të njëjtin dokument është kryer një ose disa ekspertime grafike, të cilat kanë konkluduar që nuk ka fallsifikim të dokumenteve. Në këtë rast është e qartë që fakti i falsifikimit nuk ekziston dhe hetime të tjera do të ishin të panevojshme.

3.2 Dyshimi arsyeshëm – standard kryesor në hetimet paraprake për kufizimin e lirisë

3.2.1 Kufizimi i lirisë si pjesë e procesit penal

Standardi i të provuarit të masave të kufizimit të lirisë ka natyrë kushtetuese. Në nenin 27, pika 2, gërma "c" e Kushtetutës është parashikuar se liria e personit mund të kufizohet kur ka ***dyshime të arsyeshme se personi kryer një vepër penale*** ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj; Gjithashtu, në nenin 5/1 (c) të KEDNJ parashikohet se çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj: c) kur arrestohet ose ndalohet ligjërisht për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent pas *dyshimit të arsyeshëm* se ka kryer një vepër penale ose kur çmohet në mënyrë të arsyeshme e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj.

Në KPrP në nenin 251/1 parashikohet se oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kryejnë detyrimisht arrestimin e cilitdo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më

të ulët në maksimum se pesë vjet. Në paragrafin e dytë të nenit 251 parashikohet arresti në flagrancë fakultativ.[176] Ndërsa në nenin 253 parashikohet se kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet. Edhe nga vetë funksioni që kryejnë, arrestimi në flagrancë dhe ndalimi, synojnë që një person i dyshuar për kryerjen e një vepre penale të dërgohet para gjyqtarit. Gjyqtari duhet të vlerësojë ligjshmërinë e aktit të kryer nga policia gjyqësore dhe nëse kufizimi i lirisë së personit duhet të vazhdojë më tej apo personi duhet të lirohet.

Është e rëndësishme të ndalemi në nenin 5/1 (c) të KEDNJ-së për rëndësinë që kjo Konventë paraqet si pjesë e sistemit tonë të brendshëm juridik. Teksti i nenit 5(1) përcakton qartë se kufizimi i lirisë së një individi, të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, mund të bëhet si përpara, ashtu edhe pas kryerjes së një vepre penale, tek e cila mbështeten autoritetet vendase për të justifikuar këtë masë. GJEDNJ ka përpunuar kriteret, mbi të cilat përcaktohet ligjshmëria e kufizimit të lirisë së një individi. Së, pari, siç është konstatuar në çështjen *Lukanov kundër Bullgarisë*, *duhet të jetë kryer një vepër penale sipas ligjit vendas, që mbi këtë bazë, të konsiderohet legjitim kufizimi i lirisë së individit*. Kjo nuk do të thotë se është e nevojshme të përcaktohet që në këtë fazë fakti i kryerjes së një vepre penale. E rëndësishme është që marrja e masës, që kufizon lirinë e individit të jetë kryer për qëllim të një vepre penale, të parashikuar me ligj[177]. Në këtë çështje, Komisioni dhe më pas, GJEDNJ konstatuan se nuk mund të flitej për dyshime të bazuara, për shkak se veprimi për të cilin akuzohej *Lukanov*, nuk përbënte vepër penale në çastin e kryerjes së saj. Pra, arrestimi i *Lukanov*, nuk ishte në pajtim me ligjin dhe nuk ishte bërë në lidhje me dyshimin e bazuar për kryerjen e një vepre penale[178].

Në vijim të kriterit të parë të trajtuar më lart, GJEDNJ ka përpunuar edhe dy kriteret e tjera. Kriteri i dytë parasheh se *objektivi i ndalimit të të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale, duhet të jetë nxjerrja e tij përpara një autoriteti ligjor kompetent*. Kriteri i tretë parasheh se *dyshimi mbi kryerjen e veprës penale duhet të jetë i arsyeshëm*[179]. Pavarësisht se, ekzistenca e dyshimit të kryerjes së një vepre penale(...), përbën bazën mbi të cilën mund të shqyrtohet kufizimi i lirisë së një individi, një masë e tillë do të jetë në përputhje me nenin 5/1 (c), vetëm nëse kryhet, me synimin e nisjes së procedimit penal kundrejt të dyshuarit. Gjithsesi, kjo nuk nënkupton, që për të qenë në përputhje me nenin 5/1 (c), duhet të zhvillohet domosdoshmërisht ndjekja penale apo të ngihet një akuze formale(...)[180].

---

[176] Neni 251/2 i KPrP- Arrestimi në flagrancë.

2. Oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore kanë të drejtë të arrestojnë cilindo që kapet në flagrancë për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dhjetë vjet.

[177] Monica Macovei, E Drejta për lirinë dhe sigurinë e personit- Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Europës, 2002, Ribotim, nëntor, 2005, Gjermani, fq. 23.

[178] Marek Antoni Noëicki, Rreth Konventës Europiane- Komentar i shkurtër mbi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Botim i Qendrës Shqiptare Për të Drejtat e Njeriut, përkth. Edlira Llohja, Botimet Morava, Tiranë 2003, fq. 136.

[179] Monica Macovei, vepër e cituar, fq. 24.

[180] Po aty.

Neni 5/1 (c) i KEDNJ-së nuk i referohet thjesht dhe vetëm aplikimit të masave të sigurimit, por edhe arrestimit dhe ndalimit si forma të kufizimit të lirisë së lëvizjes. GJEDNJ, nëpërmjet jurisprudencës së saj, e ka zgjeruar fushën e veprimit të këtij neni edhe në këto raste të kufizimit të lirisë. Pranohet se edhe në rastin kur një oficer policie, me fjalë apo me veprime fizike, i tregon një individi se ai nuk është i lirë për t'u larguar, atëherë kemi një arrestim në kuptimin e nenit 5[181]. Komisioni është shprehur se nëse një personi të marrë në rajonin e policisë, i është privuar ose jo liria, kjo gjë do të varet nga qëllimi i policisë. Gjithashtu, një individ që detyrohet të qëndrojë i ndaluar në rrugë apo diku tjetër, me qëllim për t'u pyetur nga policia, për t'u kontrolluar apo për të dëshmuar lidhur me një procedim penal, mbrohet nga neni 5. Në këtë kuptim, neni 5 aplikohet edhe nëse periudha e ndalimit është shumë e shkurtër, si edhe kur personi i ndaluar vetëdorëzohet në organet e policisë për t'u ndaluar[182].

Megjithëse nevoja për të nisur një proces penal kundër një të dyshuari, ose nevoja për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër, përbën bazën fillestare për t'i kufizuar lirinë personit të dyshuar, kjo nuk është e mjaftueshme për vazhdimin e paraburgimit. Vazhdimi i paraburgimit duhet t'i nënshtrohet hetimit të menjëhershëm gjyqësor. Gjykata duhet të shqyrtojë, së pari, nëse kufizimi i lirisë përbën një masë të justifikuar, dhe së dyti, nëse është ende e përshtatshme për t'u vazhduar. *GJEDNJ, në mënyrë të vazhdueshme ka deklaruar se ekzistenca e një dyshimi është thelbësor, por jo e mjaftueshme për të zgjatur masën e ndalimit pas përfundimit të afatit kohor.*[183]

Pra, mund të thuhet se standardi kryesor veprues i Nenit 5/1 (c) është *arsyeshmëria*. GJEDNJ ka përcaktuar se, standardi i zbatuar për kufizimin e lirisë së individit, nuk do të thotë se shtetit i kërkohet që në këtë moment të vërtetojë fajësinë. Madje në fakt, neni 5 nuk presupozon që policia të ketë mbledhur prova të mjaftueshme për të ngritur akuzat. *Megjithatë, Shteti duhet ta bazojë arrestimin dhe paraburgimin në këtë fazë, mbi të paktën një nivel të caktuar faktesh ose informacionesh për të vërtetuar dyshimin se është kryer një vepër e kundraligjshme dhe se i ndaluari ka një lidhje të mjaftueshme me kryerjen e veprës në fjalë*[184]. Në zbatim të nenit 5/1, arsyet për ndalim duhet të jenë specifike dhe të ligjshme në kuptim të KEDNJ. Neni 5 nuk e lejon ndalimin e dikujt në bazë të dyshimeve të paqarta. Neni 5 nuk lejon as edhe ndalimin bazuar në shkaqe të pamaterializuara në vendime zyrtare të marra nga autoritet kompetente[185].

Një nga çështjet më të rëndësishme të GJEDNJ që tregon se dyshimi i arsyeshëm është standardi i kërkuar në rastin e arrestimeve apo ndalimeve, është *Fox, Campbell*

---

[181] Adnor Shameti, "Liria dhe siguria e personit, arresti dhe ndalimi", Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës, nr. 4, 2006, Tiranë, dhjetor, 2006, fq. 25.
[182] Adnor Shameti, artikull i cituar, fq. 26.
[183] Monica Macovei, E Drejta për lirinë dhe sigurinë e personit- Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Europës, 2002, Ribotim, nëntor, 2005, Gjermani, fq. 29.
[184] Donna Gomien, Udhëzues i shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Botim i Këshillit të Europës, edicioni i tretë, maj, 2005, fq. 37.
[185] Po aty.

dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar.[186] Aplikantët u ndaluan nga policia e Belfastit me 5 shkurt 1986 dhe u çuan në një stacion policie, ku iu bë edhe nje kontroll i plotë makinës me të cilën ata udhëtonin. Pas mbërritjes së tyre në stacionin e policisë, ata u arrestuan zyrtarisht në bazë të legjislacionit përkatës irlandez.[187] Ata u informuan se ishin arrestuar për shkak të dyshimeve për përfshirjen e tyre në veprimtari terroriste. Gjatë ndalimit të tyre, ata u pyetën në lidhje me dyshimin për përfshirjen e tyre në shërbimet inteligjente të Ushtrisë Republikane Irlandeze të Përkohshme (ndryshe IRA). Ata, gjithashtu, u pyetën në lidhje me anëtarësimin e tyre në këtë organizatë. Sipas Qeverisë, informacioni ku u bazua dyshimi kundër tyre, ishte i njohur nga policia në momentin kur u ndalua makina e tyre. Asnjë akuzë nuk u ngrit ndaj të arrestuarve. Para GJEDNJ-së aplikantët pretenduan se nuk ishin arrestuar bazuar në një dyshim të arsyeshëm se kishin kryer një vepër penale. Ligji irlandez parashikonte që policia mund të arrestojë pa urdhër çdo person për të cilin dyshon se është terrorist.[188] Në parashtrimet e tyre, aplikantët theksonin se ky nen ishte në kundërshtim me nenin 5/1 (c) të KEDNJ në pjesën që nuk parashikonte asnjë kërkesë në drejtim të arsyeshmërisë.

GJEDNJ shprehu se neni 5/1 (c) flet për një "dyshim të arsyeshëm"[189], sesa për një dyshim të thjeshtë dhe në mirëbesim. "Arsyeshmëria" e dyshimit, në të cilën duhet të bazohet arresti, formon një pjesë thelbësore të mbrojtjes kundër arrestimit dhe ndalimit arbitrar. GJEDNJ theksoi se ekzistenca e një "dyshimi të arsyeshëm" presupozon "*ekzistencën e fakteve ose informacioneve që do të krijonin bindjen te një vëzhgues objektiv që personi në fjalë mund të ketë kryer veprën penale. Megjithatë, ajo se çfarë do të konsiderohet si "e arsyeshme", do të varet dhe përcaktohet në bazë të të gjitha rrethanave."*[190] Në këtë drejtim, krimi i terrorizmit përbën një kategori të veçantë. Duke pasur parasysh rrezikun që përfaqëson një krim i tillë për vuajtjen dhe humbjen e jetëve njerëzore, policia ka për detyrë të veprojë me urgjencë, me qëllim që të mbledhë të gjithë informacionin e nevojshëm, përfshirë këtu edhe informacionin nga burime sekrete. Policia mund të ndalojë një person të dyshuar për terrorizëm, mbi bazën e informatave, që mund të jenë të besueshme, por që nuk mund t'i bëhen të njohura personit të dyshuar ose të paraqiten në gjykatë në mbështetje të akuzës, pa vënë në rrezik burimin e informacionit. Gjykata mbështeti argumentin e qeverisë se për shkak të vështirësive specifike që hasen në hetimin dhe ndjekjen e veprave të karakterit terrorist, "*karakteri i arsyeshëm i dyshimit që përligj masën e arrestit, nuk mund të vlerësohet gjithnjë në bazë të po atyre kritereve me të cilat vlerësohet një krim konvencional.* Megjithatë, *kriteret në trajtimin e një krimi terrorist nuk mund të përligjin shtrirjen e nocionit 'të arsyeshmërisë', deri në atë masë sa të cenojë thelbin e mbrojtjes që parashikon neni 5 i KEDNJ"*[191]. Shumica e Komisionit ishte e opinionit që qeveria nuk paraqiti asnjë informacion i cili do të lejonte Komisionin të

---

[186] Çështja Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, *(Aplikimi nr. 12244/86; 12245/86; 12383/86)*, 30 Gusht 1990.
[187] Neni 11(1) i Aktit mbi Dispozitat e Jashtëzakonshme, Irlandë e Veirut, vitit 1978.
[188] Po aty.
[189] Në sistemin amerikan standardi i zbatuar është standardi i '*probable cause for arrest'* (shkaqe të mundshme për arrestim). Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, *Virgil.D 'Gus' Reichle et.al v. Steven Howards, 132 S.Ct. 2088 (2012)*, https://casetext.com/case/reichle-v-howards-3, klikuar më datë 23 Shtator 2022.
[190] Çështja *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, *(Aplikimi nr. 12244/86; 12245/86; 12383/86)*, 30 Gusht 1990, pg. 35.
[191] Po aty, pg. 32.

konkludonte se dyshimet kundër aplikantëve në momentin e arrestimit ishin të arsyeshme sipas kuptimit të nenit 5 të Konventës ose se arrestimi ishte bazuar në diçka më shumë se dyshimi i sinqertë/i ndershëm sipas ligjit irlandez.

GJEDNJ u shpreh se "*Neni 5/1 (c) i KEDNJ-së nuk duhet të zbatohet në një mënyrë të tillë, që të krijojë vështirësi të tepërta për policinë e Shteteve Kontraktuese në marrjen e masave kundër terrorizmit. Nga kjo del se Shteteve Kontraktuese, nuk mund t'u kërkohet që të provojnë karakterin e arsyeshëm të një dyshimi, që ka shërbyer si bazë për arrestimin e një terroristi të dyshuar, duke zbuluar burimet konfidenciale të informacionit përkatës, ose edhe të fakteve që mund të çonin në zbulimin e këtyre burimeve, ose të identitetit të tyre. Megjithatë, GJEDNJ ka për detyrë të konstatojë nëse është garantuar thelbi i parashikuar nga neni 5/1(c).*"[192]

Gjykata pranoi se arrestimi dhe ndalimi i secilit prej aplikantëve, u bazua në një dyshim në mirëbesim dhe jo në një dyshim të arsyeshëm. Fakti se aplikantët kishin dënime të mëparshme për akte terrorizmi dhe se policët gjatë arrestimit kishin një dyshim të vërtetë se aplikantët kishin qenë të përfshirë akte të tjera të këtij lloji, *nuk mund të bindë një vëzhgues objektiv se aplikantët mund të kenë kryer këto akte.* Elementet e mësipërme u konsideruan të pamjaftueshme për të mbështetur konkluzionin se ekzistonte "dyshimi i arsyeshëm". Shpjegimet e autoriteteve shtetërore nuk e përmbushnin standardin minimal të përcaktuar në nenin 5/1 (c) për të gjykuar arsyeshmërinë e dyshimit për arrestimin e një individi.[193] Për rrjedhojë, GJEDNJ-ja konstatoi se kishte ndodhur shkelje e nenit 5/1 (c).

3.2.2 Në përgjithësi mbi arrestimin në flagrancë dhe ndalimin e të dyshuarit për një krim.

Bazuar në KPrP, një rëndësi të veçantë paraqet rasti i kufizimit të lirisë së personit që dyshohet për kryerjen e një vepre penale, në rastin e flagrancës (kur kryhet arrestimi në flagrancë) dhe rrezikut të ikjes (kur kryhet ndalimi i të dyshuarit për një krim). Arrestimi në flagrancë dhe ndalimi duken si masa sigurimi, sepse në të vërtetë, nëpërmjet tyre realizohet kapja e të dyshuarit dhe izolimi i tij[194]. Megjithatë, ato nuk janë masa sigurimi, por veprime procedurale që diktohen nga rrethanat konkrete, të flagrancës apo të ikjes. Arrestimi në flagrancë është veprim që kryhet me iniciativë të policisë gjyqësore, i autorizuar nga ligji procedural penal dhe i kontrolluar nga prokurori. Ndalimi i të dyshuarit për një krim realizohet me urdhërin e prokurorit, por, përjashtimisht, në raste të ngutshme kryhet nga policia gjyqësore. Rrethanat e flagrancës dhe të ikjes e bëjnë të pamundur zbatimin e rregullave të përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit nga gjykata, prandaj ligji ka lejuar kryerjen e këtyre veprimeve procedurale nga policia gjyqësore. Pasi vleftësohen nga gjyqtari në seancë gjyqësore, mbi kërkesën e prokurorit, ndaj të arrestuarit apo të ndaluarit caktohet masa e sigurimit[195].

---

[192] Çështja *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, *(Aplikimi nr. 12244/86; 12245/86; 12383/86)*, 30 Gusht 1990, pg. 34.
[193].Po aty, pg.34, 35.
[194] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura penale, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2007, fq. 379.
[195] Halim Islami, etj., vepër e cituar, fq. 380.

Edhe pse konsistojnë në kufizim apo heqje të lirisë vetjake, siç janë edhe masat e sigurimit personal, sepse disponohen nga policia gjyqësore dhe prokurori që nuk janë autoritete gjyqësore, si dhe sepse vendosen përpara vlerësimit të gjykatës, "arresti në flagrancë" dhe "ndalimi" formohen si *masa para-sigurimi* mëvetësisht të disiplinuara dhe nuk përfshihen në masat e sigurimit personal të disponueshme nga gjykata me kërkesën e prokurorit.[196]

Arrestimi dhe ndalimi, njëlloj si masat e sigurimit personal, kanë qëllimin të privojnë nga liria autorin e dyshuar për një vepër penale të caktuar, të parashikuar nga ligji me kriterin e taksativitetit. Megjithatë, ato janë përkufizuar si masa shtrënguese parasiguruese kryesisht për dy arsye: sepse kanë *natyrë instrumentale* dhe *paraprake* në krahasim me rregullimin e parashikuar nga masat e sigurimit; sepse *bazohen në parakushte autonome*, në krahasim me ato të parashikuara për masat e sigurimit personal.[197]

KPrP ka pranuar parimin e përgjithshëm sipas të cilit "vetëm gjyqtari ka kompetencën të aplikojë një masë sigurimi që kufizon lirinë personale, masë që ka efekte të vazhdueshme në kohë, edhe pse masa të tilla kanë një kohëzgjatje maksimale të caktuar". Konform kësaj qasjeje, arrestimi në flagrancë dhe ndalimi kualifikohen për shkak të karakterit të tyre, si masa të përkohshme, të zbatueshme në situata urgjence kur nuk mund të aktivizohet efektivisht procedimi për masë sigurimi. Ato, siç dihet, janë të lidhura me pushtetin e policisë gjyqësore për të marrë në raste të jashtëzakonshme domosdoshmërie dhe urgjence, të treguar nga ligji në mënyrë taksative, masa të përkohshme kufizuese ndaj lirisë së individit, pa rënë ndesh më nevojën për një garanci nga autoriteti gjyqësor. Gjykata investohet për të verifikuar brenda afateve shumë të shkurtër kohorë, ligjshmërinë e kufizimit të lirisë personale. Për këtë arsye, masat e arrestimit dhe të ndalimit, edhe pse konvalidohen nga gjyqtari, nuk përbëjnë titull përfundimtar për ndalimin dhe efektet e tyre janë të destinuara të shuhen nëse brenda afateve të përcaktuara nga ligji nuk ndiqen nga aplikimi i masave të sigurimit. Miratimi i masave *para – siguruese* është i kushtëzuar nga parametra normativë të ndryshëm nga ato që kërkohen për aplikimin e masave të sigurimit personal. Për disiplinën e arrestit është e huaj çdo vlerësim bazuar në nevojat e sigurimit. Nevojat e sigurimit duhet të vlerësohen në një moment të mëvonshëm, në momentin kur prokurori bën kërkesën për caktimin e masës së sigurimit dhe në momentin kur gjyqtari miraton kërkesën e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese duke zëvëndësuar në këtë mënyrë masat *para - siguruese* të kryera nga policia gjyqësore.[198]

3.2.3 Arrestimi në flagrancë

Në kushtet e përgjithshme që ekzistojnë për marrjen e masave të sigurimit, një ndër to, është dhe *standardi i dyshimit të arsyeshëm*, *i bazuar në prova*, megjithatë në Kod nuk parashikohet se ky standard është i aplikueshëm për arrestimin në flagrancë si një masë para-siguruese. Në arrestimin në flagrancë një detyrë e rëndësishme i ngarkohet

---

[196] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 742.
[197] Antonio Laronga, "Le misure precautelari: aspetti problematici, 'Il sistema cautelare personale", Roma, 14–16 korrik 2008, CONSIGLIO SUPERIORE DELLA MAGISTRATURA, Ufficio per gli Incontri di Studio, fq. 2-3.
[198] Po aty.

policisë gjyqësore. Policia gjyqësore, duke qenë se është organi kompetent sipas ligjit procedural penal, për të kryer këtë veprim procedural, ka detyrimin për të përligjur në procesverbalin që mbahet për këtë qëllim, shkakun e arrestimit në flagrancë dhe të dhënat konkrete që tregojnë për ekzistencën e gjendjes së flagrancës.

Në rastin e arrestimit në flagrancë Kodi nuk kërkon kriterin e *dyshimit të arsyeshëm,* sepse flagranca është një gjendje fakti. Kur personi kapet në njërin nga rastet e flagrancës së kryerjes së veprës penale, autorësia e krimit rezulton nga një situatë konkrete fakti, ndaj nuk ka kuptim të vendoset kriteri i dyshimit, qoftë edhe në kufijtë e arsyes. Megjithatë, në nenin 256 të Kodit parashikohet se kur prokurori merr në pyetje të arrestuarin apo të ndaluarin, ai i njofton faktin për të cilin procedohet dhe *arsyet e marrjes në pyetje, duke i treguar të dhënat në ngarkim të tij* dhe, kur nuk i shkaktohet dëm hetimeve, edhe *burimet*. Kjo do të thotë se gjendja e flagrancës duhet të provohet dhe ky detyrim i takon prokurorit.

Kushtet që sherbejnë si bazë për ta arrestuar në flagrancë një person që ka kryer një vepër penale, nuk duhet të jenë supozime, por të krijuara mbi bazën e fakteve konkrete, të cilat për shkak të kohës së shkurtër midis momentit të ndodhjes së veprës dhe marrjes së vendimit për të ndaluar personin[199], nuk mund të verifikohen dhe saktësohen në atë shkallë që është e nevojshme për të vendosur marrjen e një mase më të qëndrueshme ndaj tij, siç mund të jetë një masë sigurimi. Faktet mbi bazën e të cilave mund të krijohen dyshimet se një person ka kryer një vepër penale, ndaj të cilit organeve kompetente u lind e drejta të zbatojnë masën e arrestimin në flagrancë, mund të jenë të ndryshme, por ato gjithmonë duhet t'i referohen veprës penale që është kryer dhe të hedhin dritë për lidhjet që ekzistojnë midis kësaj vepre dhe një personi të caktuar si autor i saj[200].

Arrestimi në flagrancë është një veprim procedural që kryhet mbi një bazë reale, mbi një të dhënë konkrete e jo të supozuar dhe as të marrë me mend. Në qoftë se kjo bazë reale, këto të dhëna konkrete mungojnë, është e qartë se zbatimi i këtij veprimi procedural është i pabazuar. Shkalla e bazueshmërisë për zbatimin e arrestimit në flagrancë ndaj një personi që dyshohet se ka kryer vepër penale në kushtet *kur është kapur në kryerje e sipër*, *gjatë ose menjëherë pas kryerjes së saj*, apo *kur është kapur me sende e prova materiale*, do të varej nga rrethanat e veçanta të çdo rasti konkret, të cilat sigurisht duhet të provohen. Provueshmëria e gjendjes së flagrancës vlerësohet si nga organet që kryejnë arrestimin në flagrancë, ashtu edhe nga prokurori kur kontrollon ligjshmërinë dhe bazueshmërinë e tij[201].

Në rastin e flagrancës ligjvënësi ka normuar një ndarje apo një shkallëzim në dy situata. Kështu, pjesa e parë e dispozitës që normon "*kapja në kryerje e sipër të veprës penale ose ndjekja e menjëhershme pas kryerjes së saj nga policia, i dëmtuari apo për persona të tjerë*", formon për të kapurin një gjendje flagrance. Ndërsa, pjesa e dytë "*kapja me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën*

---

[199] Në Kodin e mëparshëm të Procedurës Penale(1979), me ndalim ligjvënësi kishte parasysh rastet e flagrancës që njohim sot në Kodin aktual.
[200] Spiro Spiro, "Disa çështje të rregullimit juridik dhe zbatimit në praktikë të masës së ndalimit", Drejtësia Popullore, nr. 4, tetor-Dhjetor, viti 1983, fq. 67.
[201] Për më gjerë shih, Sinan Baboçi, "Kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore, nr.2, Prill-Qershor, viti 1979, fq. 99.

penale", formon një gjendje gati-flagrance. Situata e parë është flagrante, sepse *raporti kohor ndërmjet faktit dhe njohjes është i njëkohshëm apo i menjëhershëm dhe njohja e ekzistencës së veprës dhe e autorit vjen e perceptohet drejtpërdrejtë nga shqisat ndjesore tek oficeri, agjenti i policisë gjyqësore ose tek i dëmtuari apo personi tjetër, pa nevojën e ndonjë prove që jep njohje.* Pra, nëse ekziston njëkohshmëria e njohjes dhe perceptimi i drejtëpërdrejtë, kapja aty për aty apo nëpërmjet ndjekjes së menjëhershme, është element fakti i cili krijon besueshmërinë e tyre. Prandaj, është e nevojshme që ndjekja duhet të jetë një veprimtari kronologjikisht menjëherë pas kryerjes së veprës penale, e pandërprerë dhe në vazhdim, veti këto që krijojnë besueshmërinë. Ndërsa, situata e dytë është gati-flagrante sepse raporti kohor ndërmjet faktit dhe njohjes është më i largët dhe i distancuar dhe bindja formohet nga njohja që jep dukja e kapjes në befasi me sendet, provat materiale, pra jo e drejtëpërdrejtë.[202]

Në rastin kur personi i dyshuar është arrestuar sipas dy rasteve të para të flagrancës, pra *kur është kapur në kryerje e sipër të veprës penale* apo *kur menjëherë pas kryerjes së saj ndiqet nga policia gjyqësore, i dëmtuari ose nga persona të tjerë*, është e kuptueshme se për sa i përket problemit se ai është autor i veprës penale, nuk ka asnjë dyshim. Në rastin e parë, autori i veprës penale është parë dhe është kapur në vendin e kryerjes së veprës. Edhe në rastin e dytë, përsëri është fjala për vepra të dukshme dhe autori është parë, por nuk është kapur, prandaj ndiqet[203]. Për sa i përket rastit të tretë të gjendjes së flagrancës, në këtë rast sendet dhe provat materiale janë ato që determinojnë në kryerjen e arrestimit në flagrancë. Gjurmat e veprës penale, thika, arma, gjaku, sendet e vjedhuar etj., janë prova materiale që krijojnë kurdoherë dyshime të bazuara se personi te i cili këto u gjetën, mund të jetë autori i veprës penale.[204] Arrestimi në flagrancë i personit me sende dhe prova materiale përbën një fakt, i cili tregon lidhjen që ekziston midis një personi dhe një vepre penale të ndodhur, lidhje që tregon se ky person është autor i mundshëm i kësaj vepre, por që ende nuk është verifikuar plotësisht një gjë e tillë. Për të arritur në një përfundim të tillë, në këto raste është e nevojshme që të kryhen veprime hetimore, rezultatet e të cilave plotësojnë me prova të plota tablonë e qënies së një personi autor i një vepre penale[205].

Natyrisht, edhe pse gjendja e flagrancës është një situatë fakti që perceptohet *ictu oculi*, vetëkuptohet se nuk mund të pretendohet që në një fazë të tillë, të ketë të dhëna të tilla që të argumentojnë në mënyrë të plotë ekzistencën e veprës penale, fajësinë e personit autor të kësaj vepre si dhe të rrethanave të tjera, sqarimi i të cilave ka rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes. Argumentimi në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme i këtyre aspekteve është detyrë e hetimit, dhe në këtë vështrim, as që duhet kërkuar prania si tërësi e tyre në momentin e arrestimit[206]. Megjithatë, duhet theksuar se që në

---

[202] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 743.
[203] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura penale, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2007, fq. 383.
[204] Sinan Baboçi, "Kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore nr.2, Prill-Qershor, viti 1979, fq. 102.
[205] Spiro Spiro, "Disa çështje të rregullimit juridik dhe zbatimit në praktikë të masës së ndalimit", Drejtësia Popullore nr. 4, Tetor-Dhjetor, viti 1983, fq. 68.
[206] Teodor Mosko, Florian Kolaneci, "Kriteret dhe kushtet ligjore për zbatimin e masës së ndalimit sipas Kodit të ri të Procedurës Penale dhe kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore nr. 4, Tetor-Dhjetor, viti 1980, fq. 71.

momentin e kryerjes së arrestimit në flagrancë, policia gjyqësore e dokumenton këtë veprim procedural në procesverbalin e arrestimit në flagrancë, në të cilin tregon me saktësi vendin, ditën dhe orën e arrestimit, gjeneralitetet e personit të arrestuar, veprën që ka ndodhur dhe të dhënat që e vërtetojnë atë.

Pavarësisht se në situatën e flagrancës kemi të bëjmë më një perceptim të drejtëpërdrejtë të faktit, që krijon bindje te policia gjyqësore, standardi minimal i *mjaftueshëm* që legjitimon arrestimin në flagrancë është dyshimi i arsyeshëm. Policia gjyqësore në situatën e flagrancës duhet të vlerësojë së pari, nëse fakti përbën apo jo vepër penale. Vetëm pas përcaktimit pozitiv, asaj i nevojitet që të bëjë një vlerësim të përafërt të cilësimit ligjor të saj, vlerësim i cili lehtëson dhe sqaron nëse konkurrojnë kushtet e përcaktuara në nenin 251/1 të KPrP.[207] Megjithatë, në perceptimin e drejtëpërdrejtë të flagrancës, policia gjyqësore mund të gabojë si në lidhje me perceptimin e rrethanave, ashtu edhe për cilësimin juridik të faktit që percepton. Ekzistenca e gjendjes së flagrancës e prezumon standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova.[208] Një konkluzion i tillë vjen në përputhje me standardin që kërkon neni 5/1/c i KEDNJ-së dhe neni 27/2/c i Kushtetutës sonë për arrestimin. Praktika e GJEDNJ e trajtuar më sipër është e konsoliduar në këtë drejtim duke afirmuar se masat që kufizojnë lirinë e individit, duhet të bazohen në dyshimin e arsyeshëm.[209] Prandaj, doktrina jonë ka mbajtur qëndrimin se policia gjyqësore kur kryen një arrestim në flagrancë duhet të mbajë parasysh *kriteret e përgjithshme* për caktimin e masave të sigurimit.(ku përfshihet dhe ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm).[210] Gjithsesi, është i domosdoshëm sqarimi se vërtetimi i gjendjes së flagrancës nënkupton përmbushjen e kriterit të dyshimit të arsyeshëm. Për më tepër, duket se edhe gjykatat në praktikën e tyre të vleftësimit të arrestit në flagrancë i kushtojnë vëmëndje faktit të konstatimit të gjëndjes së flagrancës. Kjo përforcohet edhe nga kodi ynë, i cili mjaftohet vetëm me vërtetimin e gjëndjes së flagrancës. Sapo vërtetohet gjendja e flagrancës[211], për prokurorin dhe gjykatën konsiderohet se arrestimi është i ligjshëm. Për këtë qëllim në vijim po studiojmë disa vendimeve gjyqësore. Konkretisht, në vendimin nr. 1253 Akti, datë 05.11.2011 të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë rezulton se shtetasit L.K dhe A.B kanë kryer kallëzim në Komisariatin e policisë nr.2, pasi i janë marrë shuma të konsiderueshme parash nëpërmjet mashtrimit nga shtetasi A.L. A.L u ka premtuar të dy shtetasve të sipërpërmëndur plotësimin e dokumenteve për kolaudimin e automjeteve në këmbim të shumave të caktuara të parave. Pas marrjes së parave A.L nuk ka ka kontaktuar me shtetasit L.K dhe A.B. Policia gjyqësore ka kryer arrestimin në flagrancë të A.L. Gjatë kontrollit i janë gjetur dhe sekuestruar edhe dokumentet që i janë dhënë nga kallëzuesit A.B dhe L.K. Gjykata ka arsyetuar se "*kushtet ligjore për vlerësimin e arrestit në flagrancë janë të parashikuara nga nenet 251 dhe 252 të KPrP. Ndërsa kuptimi i flagrancës jepet nga neni 252 i KPrP. Në rastin konkret, Gykata vëren se,*

---

[207] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 744.
[208] Po aty.
[209] Çështja *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* GJEDNJ, (Aplikimi nr. 11209/84; 11234/84; 11266/84; 11386/85), 29 Nëntor 1988; Çështja *Murray dhe kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 14310/88), 28 Tetor 1994.
[210] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura penale, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2007, fq. 380 dhe 472.
[211] Është në gjendje flagrance ai që është kapur në kryerje e sipër të veprës penale ose ai që menjëherë pas kryerjes së veprës penale ndiqet nga policia gjyqësore, nga personi i dëmtuar ose nga persona të tjerë ose që është kapur me sende dhe prova materiale, nga të cilat duket se ka kryer veprën penale.

personi nën hetim A.L është kapur me prova materiale, të cilat janë pjesë e objektit të veprës penale të parashikuar nga neni 143/2 i KP. Gjithashtu, Gjykata vëren se, neni 143/2 i KP, parashikon për veprën penale të "Mashtrimi më shumë se një herë", një dënim me burgim nga tre vjet deri në dhjetë vjet. Sa më sipër, Gjykata ka çmuar se, në vështrim të neneve 251 dhe 252 të KPrP, arresti në flagrancë i personit nën hetim A.L është plotësisht i ligjshëm."

Edhe në vendimin në vijim me nr. 12 Akti, datë 06.01.2013 të Gjykatës së Tiranës rezulton se gjykata ka çmuar ekzistencën e gjendjes së flagrancës, llojin e veprës penale nga ato të parashikuara nga kodi dhe afatin brenda të cilit prokuorori ka paraqitur kërkesën. Konkretisht, në këtë vendim rezulton se në vendin e quajtur Sheshi Skenderbej nga ana e autopatrullës së përgjithshme të Komisariatit të Policisë Nr-3-Tiranë, është bërë kapja ne flagrancë e shtetasit L.Gj dhe gjatë kontrollit personal iu sekuestruan një sasi bime me aromë dhe karakteristika si ato të lëndës narkotike të llojit *"cannabis sativa*". Gjykata ka arsyetuar se "*Nga procesverbali "mbi kapjen në flagrancë", dt.03/01/2013 si dhe aktet e tjera provuese rezulton se arrestimi i personit nën hetim L.Gj është realizuar në kushtet e gjendjes së flagrancës në kuptim të nenit 252 te KPrP. Personi nen hetim L.Gj është arrestuar në flagrancë i dyshuar për kryerjen e veprës penale të "mbajtjes së lëndëve narkotike", parashikuar nga neni 283/1 i KP. Kërkesa objekt gjykimi është paraqitur në gjykatë nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda afatit procedural prej 48 orësh parashikuar nga neni 258 i KPrP. Në këto kushte, gjykata e vlerëson arrestimin të ligjshëm.*" [212] Siç rezulton nga këto vendime gjyqësore, gjykata në seancën e vleftësimit të arrestit në flagrancë mjaftohet me vlerësimin e kushteve që parashikohen në KPrP, në lidhje me ekzistencën e gjendjes së flagrancës(n. 252) dhe llojin i veprës penale(n. 251). Masa e arrestimit në flagrancë e detyrueshme, që justifikohet nga prania e *gjendjes së flagrancës*, *krimit të ndëshkueshëm me burgim jo më të ulët në maksimum se pesë vjet* dhe *dashjes*, përmbush njëkohësisht edhe kushtet e caktimit të masës së sigurimit.[213] Në nenin 259/3 të KPrP parashikohet se kur arrestimi është kryer në mënyrë të ligjshme, gjykata merr vendim për vleftësimin e masës.

Në nenin 251/2 të KPrP është parashikuar e drejta e policisë gjyqësore të kryejë arrestimin në flagrancë të kujtdo për një krim me dashje, të kryer ose të mbetur në tentativë, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet ose për një vepër penale të kryer nga pakujdesia, për të cilën ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum së dhjetë vjet. Kjo formë e arrestimit në flagrancë është quajtur arrestimi në flagrancë fakultativ, për shkak se është në vlerësimin e policisë gjyqësore të kryejë këtë veprim procedural. Arrestimi në flagrancë fakultativ ndryshon nga arrestimi në flagrancë i detyrueshëm, i trajtuar më sipër, pasi në këtë të fundit, policia gjyqësore ka detyrim të realizojë arrestimin. Ligji nuk përcakton ndonjë kriter përzgjedhës për të dalluar rastin kur duhet aplikuar arrestimi në flagrancë fakultativ nga ai kur nuk duhet, gjë që mbetet në diskrecionin e policisë gjyqësore që duhet të vlerësojë në çdo rast konkret nevojat e mbrojtjes dhe kujdesin ndaj publikut.[214] Në vështrim të parë formulimi i dispozitës lë përshtypjen se

---

[212] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 12 Akti, datë 06.01.2013. I njëjti arsyetim edhe në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3 Akti, datë 04.01.2013.
[213] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 745.
[214] Dhimitër Lara, vepër e cituar, fq. 746.

policia gjyqësore ka një diskrecion të gjerë në vlerësimin e secilit rast. Megjithatë, është e qartë se parametrat vlerësues[215] të "*rëndësisë së faktit*" ose të "*rrezikshmërisë së subjektit*", që deduktohen nga rrethanat e faktit dhe personaliteti i autorit, përbëjnë kufizimin e diskrecionit të policisë gjyqësore.[216] Për të ilustruar rëndësinë e këtyre kritereve po marrim një shembull nga praktika gjyqësore. Konkretisht, në vendimin nr. 523 Akti, datë 05.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se nga ana e shërbimeve të Komisariatit Nr 5, është konstatuar lëvizja e gjashtë automjeteve kolonë në vendin e quajtur "Bulevardi Blu" Kamëz, Tiranë. Këto mjete drejtoheshin nga shtetasi L.O dhe dhe të afërm të tij, të cilët administrojnë linjën e transportit urban Kamëz-Tiranë dhe që prej disa ditësh kishin konflikt me drejtues te linjës së furgonave për arsye konkurence. Pas këtij konstatimi shërbimet e policisë kanë ndaluar dhe kontrolluar mjetet që ishin në lëvizje. Gjatë kontrollit u gjetën dhe u sekuestruan me cilësinë e provave materiale: nje armë gjahu shotgan dhe dy shkopa bejzbolli. Në këto kushte shërbimet e policisë gjyqësore kanë kryer arrestimin në flagrancë të shtetasit V.P konform nenit 252 te KPrP dhe është marrë me cilësinë e personit nën hetim, për kryerjen e veprës penale të "Moskallëzimit të krimit" dhe "Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik" të parashikuar nga nenet 300 dhe 242 të KP. Gjykata ka arsyetuar se "*Nga interpretimi i nenit 252 dhe analiza në tërësi e provave të administruara në fashikull, rezulton se personi është kapur menjëherë pas kryerjes së veprës penale. Që të kryhet arrestimi në flagrancë i një personi duhet të ketë dyshim se ka kryer një nga veprat që parashikon neni 251 i KPrP. Veprat penale për të cilat akuzohet personi nën hetim V.P "Moskallëzim krimi", "Mosbindje ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik", parashikojnë si sanksion në maksimum respektivisht tre vjet dhe tre muaj. Në këto kushte, organi i policisë nuk mund të bënte përcaktim tjetër nga ai që ka bërë ligji.*"[217] Për këto arsye gjykata e ka konsideruar të ligjshëm arrestimin në flagrancë. Pavarësisht se arsyetimi i gjykatës është i cunguar, rezulton se gjykata ka marrë parasysh rrethanat e faktit dhe rrezikshmërinë e veprave penale, për të vlerësuar iniciativën e policisë gjyqësore në kryerjen e arrestimit në flagrancë fakultativ. Për të vlerësuar ligjshmërinë e arrestimit në flagrancë fakultativ nuk është e nevojshme prania e përbashkët e *rëndësisë së faktit* dhe *rrezikshmërisë së subjektit*, por është i mjaftueshëm vetëm njëri prej këtyre kushteve.[218]

3.2.3.1 Kuptimi i arrestimit të kryer nga qytetarët (citizen's arrest)[219]

Sa më sipër, u trajtuan rregullat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar, të cilat theksojnë se ndalimin apo arrestimin e personave të cilët kanë kryer një vepër penale apo janë në kryerje e sipër të një vepre penale, e kanë të drejtë dhe detyrim organet ligjzbatuese sipas parashikimeve ligjore. Konkretisht, oficerët dhe agjentët e policisë gjyqësore. Padyshim që ligji ka ngarkuar me ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike

---

[215] Për më gjerë, Giovanni Conso, Vittorio Grevi, Commentario breve al codice di procedura penale, 7 edizione, CEDAM, 2011, fq. 1507.
[216] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 747.
[217] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 523 Akti, datë 05.05.2012. I njëjti qëndrim rezulton edhe në vendimin nr. 524 Akti, datë 05.05.2012.
[218] Giovanni Conso, Vittorio Grevi, Commentario breve al codice di procedura penale, 7 edizione, CEDAM, 2011, fq. 1508.
[219] Olgert Rumnici, pjesë e cituar nga shkrimi "Arrestimi në flagrancë i kryer nga policia gjyqësore dhe citizen's arrest", revista BJIR, shtator 2022.

Policinë e Shtetit dhe organe të tjera ligjzbatuese. Hetimi i veprave penale, ekzekutimi i vendimeve penale të gjykatave, ndalimi, arrestimi në flagrancë, janë atribute të organeve ligjzbatuese, si Prokuroria dhe policia gjyqësore.

Pra, në rastin klasik dhe më të zakonshëm arrestimi në flagrancë është e drejtë dhe sipas rastit detyrim i oficerëve të policisë gjyqësore, të cilët kanë formimin e duhur për të vlerësuar ekzistencën e kushteve dhe kritereve ligjore të përcaktuara nga ligjvënësi. Megjithatë, ligjvënësi ka parashikuar një përjashtim nga rregulli i mësipërm, duke i dhënë në raste të caktuara çdo qytetari të drejtën për të kryer arrestimin e një personi që ka kryer apo është duke kryer një vepër penale.

Kështu çdo qytetar, pavarësisht nëse është punonjës i organeve ligjzbatuese apo jo, është i detyruar të kallëzojë një krim, për të cilin vjen në dijeni, në organet ligjzbatuese, të dëshmojë në mënyrë të vërtetë rrethana që ka mësuar në lidhje me një vepër penale, të mos kryejë veprime që fshehin të vërtetën apo që përbëjnë përkrahje të autorit të krimit, në rast të kundërt veprimet e tij përbëjnë vepër penale, dhe janë të dënueshme sipas Kodit Penal (përjashtuar rastet e përcaktuara në ligj).

Përveç detyrimit që kanë qytetarët për rastet e mësipërme, ligji i ka njohur edhe të drejtën (jo detyrimin) për të kryer veprime, të tilla në natyrë, që i kryejnë personat me atributet e policisë gjyqësore. Konkretisht në paragrafin 4 të nenit 251 të Kodit të Procedurës Penale, ligjvënësi i ka njohur të drejtën çdo qytetari të arrestojë në flagrancë persona të cilët janë në kryerje e sipër të një krimi, ose që janë në ndjekje e sipër apo që kapen me prova materiale me të cilat është kryer vepra penale. Vepra penale duhet të jetë e tillë që dënohet në maksimum më shumë se pesë vjet. Parashikimi i mësipërm përbën përjashtim nga rregulli i përgjithshëm dhe në ndryshim nga detyrimet e parashikuara më sipër për çdo qytetar, ky përjashtim përbën të drejtë të qytetarit dhe jo detyrim.

Duhet theksuar se ky parashikim gjen zbatim edhe në legjislacione të tjera. Arrestimi nga qytetarët, i njohur si *"citizen's arrest"* ka fillesat që në kohën e mesjetës dhe është trajtuar edhe në jurispudencën e vendeve të ndryshme, sidomos të vendeve me sistem ligjor common law.

Në Vendimin Malley v. Lane, Gjykata e Lartë e Conecticut, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka arritur në përfundimin se një person në prezencën e të cilit dikush kryen një vjedhje, mundet që pa mandat, të arrestojë ose të mbajë personin, derisa të vijë një oficer policie në vendin e ngjarjes[220]. Në një çështje tjetër, sipas vendimit Ërexford v. Smith, 2 Root 171 (1795) specifikohet e drejta e pronarit të sendeve të vjedhura, që të ndjekë dhe ta arrestojë autorin e vjedhjes pa një mandat[221]. Në një çështje tjetër, në vendimin State v. Ghiloni, 35 Conn. Sup. 570 (1978), një gjyqtar i Gjykatës së Lartë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ri-citoi rregullin se një qytetar ka të drejtë të kryejë një arrestim ose të ndalojë largimin e dikujt që ai ka parë se ka kryer një vepër penale[222].

---

[220] Coppolo, G., Citizen's Arrest-Standards, 1998
https://www.cga.ct.gov/PS98/rpt%5Colr%5Chtm/98-R-0959.htm, klikuar më datë 23.08.2022
[221] Po aty
[222] Po aty

Madje qytetarëve ju njihet e drejta për të përdorur forcë të arsyeshme, kur qytetari çmon se është e nevojshme kryerja e një arrestimi të dikujt që në mënyrë të arsyeshme besohet se ka kryer një vepër penale[223].

Sa më sipër, rezulton e qartë që qytetarët kanë ligjërisht të drejtë të marrin rolin e oficerit të policisë gjyqësore sipas doktrinës së *"citizen's arrest"*[224]. Qytetarët kanë të drejtën, por jo detyrimin, që për vepra penale të caktuara të kryejnë arrestim. Kjo e drejtë zbatohet sipas kushteve dhe rregullave të caktuara, në legjislacione të ndryshme[225].

Në ndryshim nga oficerët e policisë gjyqësore, qytetarët nuk kanë edukimin dhe trajnimin e duhur për të vlerësuar plotësimin e kushteve dhe kritereve ligjore, për ekzistencën e kushteve të arrestimit në flagrancë, sic kërkon neni 251/4 dhe 252 të Kodit të Procedurës Penale. ***Megjithatë, një vlerësim eventual i gabuar i faktit penal nga ana e qytetarit, nuk mund ta ngarkojë atë me përgjegjësi penale.***

Gjykoj që nëse ka apo nuk ka elementë të veprës penale në rastin konkret, i përket hetimit të organit të akzuës dhe vendimmarrjes së këtij organi ose të gjykatës, dhe jo qytetarëve që kanë bërë ndalimin apo oficerëve të policisë gjyqësore që kanë bërë referimin e materialit kallëzues. Fakti se në një rast eventual, mund të konkludohet se nuk ka patur elementë të veprave penale të parashikuar nga Kodit Penal, nuk i ngarkon qytetarët me përgjegjësi penale. Në bazë të nenit 251, por edhe të jurispudencës të brendshme dhe të huaj, në momentet e para kërkohet vetëm që të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova dhe jo që fakti të përbëjë vepër penale tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

I njejti qëndrim është mbajtur edhe në jurispudencën e huaj. Kështu në një vendim të Gjykatës së Apelit të Karolinës së Jugut në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, gjykata nuk e konsideron të paligjshëm një arrest të kryer nga një qytetar, *kur ka patur arsye të bazuara për të besuar se është kryer një krim dhe se personi i arrestuar është fajtor*, pavarësisht se në përfundim ka rezultuar se nuk ishte kryer asnjë krim (Vendimi State v. McNeil, 445 S.E.2d 461 (1994), Gjykata e Apelit e Karolinës së Jugut).

Në gjykimin tim, në përputhje edhe me doktrinën dhe praktikën e huaj lidhur me konceptin e *citizen's arrest*, sipas legjislacionit tonë procedural, individi nuk mundet të vlerësojë nëse fakti përbën apo jo vepër penale dhe cilësimin ligjor të saj, pasi kjo është përtej kapacitetit të tij profesional dhe ligjor. Në këto raste, gjykimi duhet të shtrihet kryesisht në aspektin subjektiv të veprimeve të një qytetari që ka kryer arrestimin, pra, nëse ka vepruar me bindjen se personi autor ka kryer një krim.

---

[223] Po aty
[224] Robbins, Ira P. (2016) "Vilifying the Vigilante: A Narrowed Scope of Citizen's Arrest," *Cornell Journal of Law and Public Policy*: Vol. 25 : Iss. 3 , Article 1.
https://scholarship.law.cornell.edu/cjlpp/vol25/iss3/1/, klikuar më datë 23.08.2022
[225] Po aty

3.2.4 Ndalimi i të dyshuarit për një krim

Në lidhje me ndalimin e të dyshuarit për një krim kërkohet ekzistenca e njëkohëshme e dy kushteve njëkohësisht: *dyshimi se personi është autor i një krimi* që dënohet jo më pak se dy vjet burgim dhe *ekzistenca e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes së tij*[226]. Këto kushte duhet të provohen fillimisht nga prokurori apo policia gjyqësore, në rast se ndalimi është kryer me iniciativë. Kjo përbën pikërisht dallimin midis ndalimit dhe arrestimit në flagrancë, pasi në rastin e ndalimit, ndryshe nga rrestimi në flagrancë, dyshimi se personi është autor i një vepre penale krijohet para se ai ndalohet nga policia gjyqësore. Më pas, gjykata duhet të arsyetojë se janë plotësuar kushtet për ndalimin e të dyshuarit. Në ndryshim nga arrestimi, i cili konsiderohet si një akt i hetimit paraprak, pushteti i ndalimit mund të ushtrohet nga prokurori edhe nëse faza e hetimeve paraprake ka përfunduar.[227]

Nga interpretimi i dispozitave që kanë të bëjnë me ndalimin e të dyshuarit, rezulton se kemi të bëjmë me dy standarde të ndryshme, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, me qëllim që ndalimi i një personi të konsiderohet i ligjshëm. Së pari, kërkohet *standardi i dyshimit se një person ka kryer një krim* nga ato që parashikon KPrP, dhe së dyti standardi *i shkaqeve të bazuara se ekziston rreziku i ikjes*. Këto standarde duket sikur janë standarde autonome, të pavarura nga standardet e tjera që përshkojnë hetimet paraprake dhe veçanërisht nga standardi i dyshimit të arsyeshëm.

Nga ajo që rezulton nga interpretimi literal i nenit 253 të KPrP, të jepet përshtypja se ligjvënësi në rastin e ndalimit të një personi nuk kërkon një standard relativisht të lartë, siç mund të jetë dyshimi i arsyeshëm, por vetëm ekzistencën e dyshimit. Është e vështirë të përcaktohet *ratio* e këtij parashikimi, apo nëse kjo është thjesht çështje e teknikës legjislative, apo nëse kjo e nënkupton ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, megjithatë mund të thuhet se, edhe pse një dyshim, ai duhet të jetë i motivuar dhe i bazuar në prova. Prokurori ka detyrimin të motivojë urdhrin e ndalimit dhe njëkohësisht të provojë para gjykatës, kur të kërkojë vleftësimin e ndalimit, se ka dyshime, të bazuara në të dhëna indiciare apo prova që tregojnë se personi është autori i krimit. Kjo, sepse nuk mund t'i kufizohet një personi liria, pa u bazuar në disa të dhëna që justifikojnë këtë kufizim. Është e qartë në bazë të KEDNJ-së[228] dhe Kushtetutës[229] se, edhe në rastin e ndalimit duhet të ekzistojë një *dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova*, megjithatë në bazë të Kodit, nga mënyra e formulimit të tij, nuk mund të thuhet e njëjta gjë me siguri. Në kod mungon ekzistenca e kriterit të arsyeshmërisë që duhet të shoqërojë ndalimin e të dyshuarit për një krim.

---

[226] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura penale, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2007, fq. 385.

[227] Antonio Laronga, "Le misure precautelari: aspetti problematici, Il sistema cautelare personale", Roma, 14–16 Korrik 2008, CONSIGLIO SUPERIORE DELLA MAGISTRATURA, Ufficio per gli Incontri di Studio, fq. 8.

[228] Neni 5/1 shkronja c e KEDNJ-së: Askush nuk privohet nga liria përveçse në rastet mëposhtme dhe në përputhje me procedurat e parashikuar me ligj: … c) arrestimi ose ndalimi i ligjshëm i një personi i bërë me qëllim që ai të sillet para një autoriteti ligjor kompetent ***në bazë të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer një shkelje të ligjit*** ose kur konsiderohet arsyeshmërisht e nevojshme për të parandaluar kryerjen prej tij të një shkeljeje ose largimin e tij pas kryerjes së shkeljes.

[229] Neni 27/2 shkronja c e Kushtetutës: Liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastet e mëposhtme: …c) ***kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale*** ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj.

Problematike mund të jetë në praktikë rasti kur prokurori kërkon vleftësimin e ndalimit dhe bazuar në të njëjtat prova kërkon dhe marrjen e masave të sigurimit. Kjo është problematike, pasi, nëse do të mbanim qëndrimin që gjendemi para dy standardeve të ndryshme, do të kishim përballjen e dy standardeve, të cilat kanë nivele të ndryshme të të provuarit në këtë gjykim, *atë të dyshimit* që kërkohet për vleftësimin e ndalimit dhe *dyshimit të arsyeshëm* që kërkohet në marrjen e masave të sigurimit. Gjithsesi, në këtë drejtim mund të thuhet se kjo çështje duhet të vlerësohet rast pas rasti, pasi mund të ndodhë që të njëjtat prova të jenë të tilla që të tejkalojnë edhe standardin e dyshimit të arsyeshëm. Akoma më problematike është rasti nëse ndalimi i një personi kryhet vetëm duke u bazuar në dyshime dhe prokurori kërkon caktimin e masës së sigurimit. Në këtë rast, gjykata do të merrte vendim për mospranimin e kërkesës së prokurorit për caktimin e masës së sigurimit, pasi standardi i kërkuar në caktimin e masës së sigurimit është bindja në nivelin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Si rrjedhim, dyshimi i kërkuar për kryerjen e ndalimit duhet të jetë i arsyeshëm dhe i bazuar në prova në mënyrë që të ekzistojë siguria për marrjen e një mase sigurimi.

Ky arsyetim bazohet në hipotezën që niveli i të provuarit, i cili nevojitet për vlefshmërinë e ndalimit, nuk përputhet me atë që kërkohet për caktimin e masave të sigurimit. Në një hipotezë të tillë, nëse prokurori e ka bazuar ndalimin në dyshime ose kur provat që provojnë dyshimin e ndalimit nuk e tejkalojnë nivelin e standardit të të dyshimit të arsyeshëm, prokurori duhet të sjellë prova të tjera, të cilat nga pikëpamja sasiore apo cilësore të vlejnë për të provuar para gjykatës ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, në mënyrë që ajo të caktojë masën e sigurimit. Megjithatë, mendoj që, pavarësisht formulimit në Kod, edhe në rastin e ndalimit, duhet të ekzistojë, një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova. Madje, logjikisht, dyshimi i arsyeshëm, supozohet të jetë më mirë i arsyetuar dhe argumentuar në rastin e ndalimit, pasi ky veprim procedural, ndërmerret kur janë kryer disa hetime, nga të cilat rezulton një individ i dyshuar për kryerjen e një krimi. Ky është interpretimi i duhur i dispozitës, që bazohet edhe në praktikën e GJEDNJ-së, të trajtuar hollësisht më sipër. Një interpretim i tillë është një garanci më shumë për individin kundrejt ndalimeve të pabazuara në ligj. Duke qenë se garancia e ofruar nga KEDNJ përbën standardin minimal, gjykatat nuk duhet të aplikojnë një standard më të ulët, përndryshe, do të shkelej neni 17 i Kushtetutës[230].

Në mbështetje të qëndrimit se në rastin e ndalimit, si një masë kufizuese e lirisë së individit, standardi i kërkuar është ai *dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova*, është edhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Në vendimin nr.19 datë 02.04.2012 Gjykata Kushtetuese, në dritën edhe të jurisprudencës së GJEDNJ, është shprehur në lidhje me një ndër rastet e kufizimit të lirisë së individit, atë të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm se personi ka kryer një vepër penale. Nga rrethanat e kësaj çështje rezultonte se i mituri V.GJ., në prani të prindërve të tij, kishte bërë kallëzim tek opgj në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier se ndaj tij, është kryer krimi i marrëdhënieve homoseksuale me dhunë. I dyshuari është shoqeruar në komisariatin e policisë dhe pas paraqitjes për njohje, ai u njoh nga i dëmtuari si autori kësaj vepre penale. Pas paraqitjes për njohje, prokurori i çështjes urdhëroi ndalimin e kërkuesit,

---

[230] Neni 17/2 i Kushtetutës: 2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

urdhër që është ekzekutuar nga oficeri i policisë gjyqësore. Më pas, prokurori ka kërkuar vlerësimin e ndalimit dhe të caktimit të masës së sigurisë në gjykatë dhe gjykata, mbi bazë të rezultateve të veprimit procedural të paraqitjes për njohje, ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorit duke caktuar si masë sigurimi personal atë të arrestit me burg.

Ndër të tjera, kërkuesi pretendoi se vendimet e gjykatave i kishin cenuar të drejtën themelore për një proces të rregull ligjor për shkak të: Cenimit të së drejtës themelore të lirisë dhe sigurisë personale, të sanksionuar në nenet 27 - 28 të Kushtetutës dhe në nenin 5 të KEDNJ-së, *për shkak se është ndaluar në kundërshtim me ligjin* dhe cenimit të së drejtës themelore të barazisë para ligjit të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetutës dhe në nenin 14 të KEDNJ-së, për shkak se kërkuesi *është ndaluar, arrestuar*, proceduar, gjykuar e më pas dënuar për veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të mitur, jo mbi bazën e vlerësimit të plotë e të gjithanshëm të provave, por nisur nga vlerësime diskriminuese, të bazuara mbi njohuritë për orientimin e tij seksual.

Gjykata Kushtetuese e bazoi arsyetimin në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ**.** Ajo u shpreh se "*Një nga kushtet për të cilat mund të kufizohet liria e individit është rasti kur ka dyshime të arsyeshme se personi ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj. Lejimi i këtij kufizimi tenton të balancojë nevojën për të vepruar kundër veprave penale ndaj pretendimeve të lirisë personale që çdo individ normalisht ka, dhe që duhet të garantohet nëpërmjet procedurave ligjore.*"[231] E drejta e lirisë së individit dhe kufizimet e saj sanksionohen edhe në nenin 5/1, shkronja "c" të KEDNJ-së, sipas së cilës " *çdokush ka të drejtën e lirisë dhe të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijojnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj... kur është arrestuar dhe paraburgosur për t'u çuar përpara autoritetit gjyqësor kompetent..."* [232] Prej këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese nxirret konkluzioni se ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, është e domosdoshme në rastet e ndalimit[233].

Nëse ndalimi bëhet me iniciativë të policisë gjyqësore, për shkak të gjendjes së ngutshme, duhet të evidentohet qartësisht në procesverbalin e ndalimit, gjendja e ngutshme, që detyroi policinë gjyqësore të vepronte me iniciativë dhe të mos priste urdhrin e prokurorit. Sidoqoftë, kushtet e ndalimit janë të njëjta, si për prokurorin, ashtu edhe për policinë gjyqësore. Policia gjyqësore nuk mund të veprojë në ndalim vetëm për shkak të gjendjes së ngutshme që mund të japë një shkak sado të bazuar, e që bën të mendohet se personi ka rrezik ikjeje, pa konkurrimin e "dyshimit" mbi personin se ka kryer një krim të përcaktuar, të ndëshkueshëm me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet. Nga momenti i kryerjes së veprës penale dhe referimit të saj pa vonesë të prokurori deri në ndërhyrjen e tij, kalon një kohë e caktuar. Duke njohur mundësinë e kalimit të kohës, si dhe pamundësinë e kapjes në situatë flagrance të të dyshuarit, rezulton se përgjatë kësaj hapësire policia gjyqësore ndodhet gjithnjë në një

---

[231] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 02.04.2012.
[232] Po aty.
[233] I njëjti qëndrim vihet re dhe në vendimin nr.28, datë 23.06.2011 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

gjendje të ngutshme, çka në prani të kushteve të tjera, e legjitimon atë të kryejë ndalimin me iniciativë.[234]

Standardi i aplikuar në ndalimin e të dyshuarit për një krim nuk është i njëjtë me standardin që aplikohet në veprimin e shoqerimit të kryer nga policia. Ndalimi i të dyshuarit për një krim dallon me shoqerimin dhe mbajtjen deri në dymbëdhjetë orë në zyrat e policisë, pasi në këtë rast personi refuzon të identifikohet ose jep dokumente identifikimi që dyshohet se janë të rreme. Në këtë rast ka dyshime për identitetin, kurse në rastin e ndalimit, personi është i identifikuar, por dyshohet se ka kryer një krim. Në nenin 11 pika 6 e Ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 "Për policinë e Shtetit", shoqerimi nënkupton rastin kur një person ka shkelur një rregull administrativ dhe identifikimi i tij krijon nevojën e shoqerimit në zyrat e policisë me ose pa vullnetin e tij. Është me shumë rëndësi që të theksojmë, se ligji në këtë dispozitë të rëndësishme të tij e ka kushtëzuar shoqërimin në polici të një personi vetëm në rastet kur ai *shkel një rregull administrativ* dhe jo kur dyshohet se ka shkelur një rregull apo dispozitë penale[235].

Standardi tjetër që duhet të plotësojë prokurori për vlefshmërinë e ndalimit të të dyshuarit për kryerjen e një krimi, është ai i provueshmërisë së *shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes së të dyshuarit*. Rreziku i ikjes është elementi dallues i ndalimit, ai që lejon t'i akordohen prokurorit dhe policisë gjyqësore kompetencat parandaluese, në mënyrë që të shmanget që i dyshuari të ikë, gjatë kohës që është e domosdoshme për t'iu drejtuar gjykatës.[236] Problemet interpretative më të mëdha i përkasin pikërisht elementëve specifikë prej të cilëve deduktohet *rreziku i ikjes*. Në lidhje me këtë standard, ligji nuk përcakton se cilat shkaqe tregojnë për rrezikun e ikjes së të dyshuarit. Gjithashtu, nuk përcaktohet as niveli i të provuarit të këtyre shkaqeve, pra me çfarë dhe sa provash duhet të provohet shkaku apo shkaqet që përbëjnë rrezik. Nga interpretimi gramatikor i dispozitës[237], rezulton se kërkohen disa shkaqe dhe jo një shkak i vetëm që të tregojë mbi rrezikun e ikjes.

Megjithatë, në doktrinë pranohet se, në lidhje me shkakun, është e nevojshme që të ekzistojë një i tillë, i bazuar në një situatë që tregon dhe mbështet nevojën e sigurimit të të dyshuarit për shkak të rrezikut që buron nga lënia e tij e lirë (*pericula libertatis*). Ligji nuk kërkon prova që të vërtetojnë rrezikun e ikjes apo planin e të dyshuarit për të ikur. Është e mjaftueshme çdo e dhënë me karakter objektiv, përbërëse e procedimit konkret, e cila të bën të mendosh se i dyshuari ka rrezik ikjeje, e ndryshme kjo nga supozimet apo abstragimet e krijuara mbi baza të eksperiencës apo intuitës.... Gjithashtu, konsiderohen të mjaftueshme të dhëna të tërthorta prej të cilave rezulton që i dyshuari, nëse nuk ndërhyhet, do të humbte gjurmët e tij.[238] Për provueshmërinë e rrezikut të ikjes nuk mund të konsiderohen si shkaqe të bazuara elementët e ngjarjes

---

[234] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 749.
[235] Sotiraq Nushi, "Shoqerimi i personave në zyrat e Policisë së Shtetit", Tribunë Juridike, nr.1, viti 2009, Luarasi University Press, fq. 30.
[236] Antonio Laronga, "Le misure precautelari: aspetti problematici, Il sistema cautelare personale", Roma, 14–16 Korrik 2008, CONSIGLIO SUPERIORE DELLA MAGISTRATURA, Ufficio per gli Incontri di Studio, fq. 9.
[237] Neni 253/1 – Ndalimi i të dyshuarit për një krim: Kur ka shkaqe të bazuara për të menduar se ka rrezik ikjeje, prokurori urdhëron ndalimin e personit që dyshohet për një krim, për të cilin ligji cakton dënimin me burgim jo më të ulët në maksimum se dy vjet
[238] Antonio Laronga, artikull i cituar, fq. 9.

kriminale, për të cilën është ngarkuar i dyshuari, sepse përndryshe, për të gjitha krimet – së paku për ato të ndëshkueshme jo më të ulët në maksimum se dy vjet burgim – do të normohej ndalimi i të dyshuarit automatikisht.[239] Në këtë drejtim, rreziku i ikjes nuk duhet të vlerësohet në mënyrë abstrakte, duke iu referuar dispozitës dhe rrezikshmërisë së veprës penale apo personalitetit të të dyshuarit, por përkundrazi duke iu referuar rrethanave konkrete.[240] Psh., akti i atij që largohet nga vendi i kryerjes së krimit dhe që është përkohësisht i padisponueshëm, nuk duhet të ngatërrohet me rrezikun e ikjes, sepse përndryshe ndalimi do të ishte i ligjshëm në të gjitha rastet kur i dyshuari nuk ishte arrestuar në flagrancë ose kur krimi është konstatuar më vonë.[241]

Megjithatë, një kusht i rëndësishëm është se të dhënat mbi të cilat bazohet rreziku i ikjes duhet të jenë "specifike", dmth. të lidhen me aftësinë e personalizimit, drejtuar pikërisht ndaj atij individi i cili dyshohet për të ikur, ndërsa duhet të përjashtohet mundësia që rreziku i ikjes së një subjekti të bazohet në faktin që një bashkëpunëtor i të dyshuarit i është shmangur procedimit.[242] Bazuar në këto direktiva, jurisprudenca e huaj ka zhvilluar, me kalimin e kohës, një numër të elementeve të caktuara nga të cilat është deduktuar rreziku i ikjes: i dyshuari menjëherë pas kryerjes së veprës, ka braktisur familjen dhe nuk ka pasur një banesë fikse; kërkimet, të kryera në vendin e banimit, në vendin e punës dhe në vende të tjera të frekuentuara zakonisht nga i dyshuari, nuk kanë qenë të suksesshme, dhe kështu me radhë.[243]

Problematika e sipërcituar del qartë në njërin prej vendimeve të Gjykatës së Lartë, të cilin po e shtjellojmë në vijim. Kështu, në vendimin nr.52 dt.04.03.2009 Gjykata e Lartë është shprehur se: "*Nga vetë kërkesa e organit të akuzës, por edhe nga ç'ka kanë pranuar të provuar gjykatat e faktit, rezulton se ndalimi i shtetasit N. P. për veprat penale të parashikuara nga neni 236 dhe 293 i KP, ka qenë i paligjshëm. Në momentin e ndalimit nuk ka ekzistuar një prej kushteve kryesore që parashikon dispozita e nenit 253/1 të KPrP dhe* ***që është "shkaku i bazuar për të menduar se ka rrezik ikje"***. *Provat e administruara në dosje gjyqësore dhe vetë rrethanat e ngjarjes tregojnë se personi nen hetim jo vetëm nuk ka patur rrezik ikje, pasi disa dite me radhë ka qëndruar në vendin e ngjarjes sepse ky ishte qëllimi i veprimeve të tij, por vetë gjykatat e faktit duke qenë kontradiktore në arsyetimin e vendimit për caktimin e masës se sigurimit personal, si rrethane në favor të pranimit të kërkesës së prokurorit, kanë arsyetuar ... mundësinë që ky person të kryeje të njëtin veprim. Është i papranueshem arsyetimi që të njejtit person, i cili ndalohet sepse paraqet rrezik ikje, i caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg" sepse paraqet rrezik të kryejë të njëjtën vepër në vendin e ngjarjes, pra të mos ikë. Që organi i akuzës të ndalonte këtë shtetas dhe që gjykata të konsideronte të ligjshëm këtë ndalim duhet që të arsyetoheshin se cilat ishin shkaqet e bazuara për të menduar rrezikun e ikjes së këtij personi. Mungesa e këtij arsyetimi e bën ndalimin të paligjshëm.*"[244]

---

[239] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 749.
[240] Antonio Laronga, artikull i cituar, fq. 9.
[241] Po aty.
[242] Po aty.
[243] Po aty.
[244] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.52, datë.04.03.2009.

Edhe në vendimin e mëposhtëm të Gjykatës së Lartë[245] arsyetohet në lidhje me standardin e shkaqeve të bazuara që tregojnë rrezikun e ikjes. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë është shprehur për kuptimin e shkaqeve të bazuara që tregojnë rrezikun e ikjes. Konkretisht, në këtë vendim rezulton se prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka filluar procedimin penal kundër shtetasit G.V, për faktin se në pallatin 63 të Lagjes "Emin Matraxhiu" të qytetit të Elbasanit është gjendur i vdekur shtetasi B.K. Nga pyetja e deklaruesve H.K dhe A.K, vëllezër të viktimës, dëshmohet se 2-3 muaj para ngjarjes, viktima ka patur konflikt dhe zënka me vëllezërit A,V dhe G.V për shkak të një përplasje midis tyre me makinë-biçikletë midis shtetasit A.V dhe viktimës, ngjarje nga e cila viktima kishte pësuar dëmtime trupore. Pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të çështjes të prokurorit nga prokurori më i lartë, është vendosur rifillimi i hetimit. Organi i akuzës ka rifilluar veprimet procedurale duke urdhëruar ndalimin e shtetasit G.V. DPQ Elbasan ka njoftuar prokurorin se shtetasi G.V ka qëllim t'i shmanget hetimeve të filluara kundër tij. Më datë 09.10.2010 është ekzekutuar ndalimi i shtetasit G.V.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me vendimin nr.623, datë 13.10.2010 ka arsyetuar se: *".... Shqyrtimi i akteve të paraqitura të krijojnë dyshime të arsyeshme në këtë fazë se shtetasi ka kryer veprën penale të vrasjes me dashje të shtetasit B.K. Meqenëse vepra penale objekt hetimi parashikon në sanksion 10-20 vjet burgim dhe ka shkaqe (të bazuara në prova) që rrezikohet largimi i tij, çmohet se, në kushtet e nenit 253/1 të KPrP, ndalimi duhet ligjëruar."*

Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr.281, datë 18.11.2010 ka arsyetuar se: *"...prej përmbajtjes së shkresës...së DPQ Elbasan nuk rezulton se cilat janë ato rrethana faktike që imponojnë konkluzionin e mundësisë largimit jashtë shtetit të të dyshuarit. Shkresa përmban vetëm një artikulim të përgjithshëm të paargumentuar dhe në mungesë të aspekteve konkrete...Në këto rrethana, gjykata e apelit e çmon të pabazuar konkluzionin e gjykatës së shkallës së parë, sipas së cilës ndalimi i shtetasit G.V është i ligjshëm...".*

Gjykata e Lartë duke vlerësuar të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit ka arsyetuar se: "*Në rastin në shqyrtim, prokuroria nuk ka arritur të provojë se ndodhemi përpara ekzistencës së "shkaqeve të bazuara" referuar nenit 253 të KPrP, që do të thotë ekzistenca e fakteve apo rrethanave konkrete, të perceptuara përmes sjelljes së personit të dyshuar, të cilat të bëjnë të besosh se ekziston mundësia e largimit të të dyshuarit jashtë shtetit apo ikja e tij për t'iu shmangur procesit hetimor kundër tij."*[246]

Në praktikën e gjykatave të shkallës së parë rezulton se ndalimi i kryer prej Prokuorisë apo Policisë Gjyqësore nuk ka respektuar standardin e rrezikut të ikjes së personit të dyshuar për kryerjen e një krimi. Në gjykimin për vlerësimin e ndalimit dhe caktimit të masës së sigurimit, organi i akuzës, shpesh nuk justifikon të dy kushtet për ndalimin: dyshimin për kryerjen e një krimi, nga ato që parashikon KPrP dhe ekzistencën e shkaqeve që tregojnë rrezikun e ikjes së të dyshuarit. Konkretisht, në vendimin nr. 50, datë 07.04.2011 të Gjykatës së Rrethit gjyqësor Lushnje rezulton se më 30.03.2011, salla operative e Komisariatit të Policisë Lushnje është njoftuar për

---

[245] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 90, datë 29.06.2011.
[246] Po aty.

një vjedhje në lagjen "20 Tetori" Lushnje. Policia gjyqësore pasi ka marrë të dhëna se autor i mundshëm i kësaj vjedhje është shtetasi T.B, ka shkuar në banesën e këtij të fundit dhe ka konstatuar disa prej sendeve të vjedhura, të cilat i njohu personi i dëmtuar sapo iu paraqitën. Në datë 04.04.2011 shtetasi T.B ka shkuar me iniciativë në komisariatin e policisë, pasi ishte njoftuar se ishte në kërkim nga policia në lidhje me sa më sipër. Në këto kushte, nisur nga rrezikshmëria e veprës penale dhe e personit, organi i akuzës, ka kërkuar vlerësimin si të ligjshëm të ndalimit të shtetasit T.B me iniciativë të policisë gjyqësore dhe caktimin ndaj tij, si masë sigurimi personal atë të "Detyrimit për paraqitje në policinë gjyqësore". I dyshuari dhe mbrojtësi i tij kërkuan vleftësimin si të paligjshëm të ndalimit, pasi ai u paraqit vetë në komisariat dhe nuk kishte rrezik ikjeje.
Lidhur me sa më sipër, Gjykata vërejti se i dyshuari u ndalua me inisiativë nga policia gjyqësore, pasi ky i fundit ishte paraqitur me iniciativën e vet në Komisariatin e Policisë, pasi kishte ardhur në dijeni të faktit se po kërkohej si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të vjedhjes. "*Në këtë kontekst, gjykata vlerëson se ndodhemi para mungesës së kushtit të dytë atij të "rrezikut të ikjes", pasi shtetasi T.B është paraqitur me iniciativë në Komisariatin e Policisë Lushnje. Gjithashtu, nga ana e organit të akuzës, jo vetëm që nuk u provuan shkaqet e bazuara për rrezikun e ikjes së këtij shtetasi, por gjithashtu nuk u motivua ndalimi me inisiativë i këtij shtetasi nga oficerët e policisë gjyqësore.*"[247] Nga analiza e praktikës gjyqësore të gjykatave të rretheve gjyqësore, rezulton se përgjithësisht gjykatat nuk arsyetojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se i dyshuari ka kryer një krim dhe ekzistencën e shkaqeve që tregojnë rrezikun e ikjes.

Në përfundim, mund të themi që arrestimi në flagrancë dhe ndalimi i të dyshuarit për një krim janë masa, të cilat kufizojnë lirinë e lëvizjes së individit. Duke qenë të tilla, standardet që ligjërojnë marrjen e tyre bazohen në Kushtetutë dhe KEDNJ, pasi liria e lëvizjes është një nga të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara përkatësisht në nenin 27 të Kushtetutës dhe 5 të KEDNJ. Për masat që kufizojnë lirinë e lëvizjes, kur ato merren me qëllim që individi konkret të dërgohet para gjykatës, standardi i të provuarit i njohur prej Kushtetutës dhe KEDNJ, është dyshimi i arsyeshëm se është kryer një vepër penale. Kushti, ekzistenca e të cilit është e domosdoshme në arrestimin në flagrancë, është gjendja e flagrancës. Gjendja e flagrancës është një gjendje e përceptimit të drejtpërdrejtë të faktit kriminal nga policia gjyqësore. Ekzistenca e kësaj gjendje e presupozon përmbushjen e standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, madje arrin deri në nivelin e bindjes, pasi është e qartë autorësia e krimit. Arresti në flagrancë fakultativ është e drejtë e policisë gjyqësore, që duhet të zbatohet duke pastur parasysh dy kushte: rëndësinë e faktit dhe rrezikshmërinë e subjektit. Në ndalimin e të dyshuarit për një krim duhet të përmbushen nga organi i procedimit dy kushte: dyshimi se personi ka kryer një krim dhe shkaqet e bazuara që tregojnë rrezikun e ikjes. Standardi i dyshimit te ndalimi duhet të interpretohet si *dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova*, në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ. Standardi i shkaqeve të bazuara që tregojnë rrezikun e ikjes së të dyshuarit duhet të jenë të dhëna objektive, që çojnë në konkluzionin se i dyshuari ka rrezik të ikë. Nuk konsiderohen shkaqe të bazuara supozimet, rrezikshmëria e veprës penale dhe personaliteti i të pandehurit.

---

[247] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 50, datë 07.04.2011.

3.3 Dyshimi i arsyeshëm për caktimin e masave të sigurimit

Standardi i dyshimit të arsyeshëm është standardi tipik i të provuarit në caktimin e masave të sigurimit. Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit ka filluar procedimi penal dhe kryhen hetime. Në caktimin e masave të sigurimit duhet të zbatohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për caktimin e tyre. Kushti më i rëndësishëm, të cilin do ta trajtojmë në vijim, është ai sipas të cilit askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal, në qoftëse në ngarkim të tij nuk ekziston një *dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova*. Ky është dhe perifrazimi që bën neni 228 i Kodit të Procedurës Penale për dyshimin e arsyeshëm, duke vënë kërkesën që ai të jetë i bazuar në prova. Përveç Kodit, koncepti "dyshim i arsyeshëm" ndeshet në Kushtetutën tonë dhe në KEDNJ. Dyshimi i arsyeshëm mbështetet në konceptin filozofik mbi të vërtetën dhe në parimin juridik të prezumimit të pafajësisë. Zbulimi i së vërtetës është një proces kompleks që realizohet gradualisht në bazë të shkallës së njohjes dhe të provave që e argumentojnë atë[248].

Në vijim do të parqesim mënyrën se si e ka trajtuar doktrina jonë e procedurës penale kuptimin e standardit të dyshimit të arsyëshëm. Nga studimi rezulton se doktrina juridike është e ndarë në dy qëndrime kryesore. Kuptimi, që i jepet nga pjesa më e madhe e doktrinës sonë të procedurës penale këtij koncepti, është se dyshimi i arsyeshëm *nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra dhe të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre, tregojnë se vepra ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet. Kjo bindje duhet të jetë e tillë që të pranohet përgjithësisht si e drejtë dhe e arsyeshme nga kushdo që njihet me rrethanat e faktit dhe provat që e vërtetojnë atë. Çdo kuptim tjetër i "dyshimit të arsyeshëm" përmban në vetvete rrezikun e shkeljes së lirive dhe të drejtave të njeriut*[249]. Rezulton se koncepti i dyshimit të arsyeshëm trajtohet si një standard relativisht i lartë i të provuarit, duke theksuar se ky standard tregon ***bindjen se vepra e ndodhur, është kryer nga ai që akuzohet***. Ky qëndrim mbështetet në arsyetimin se në procesin e të provuarit, bindja e brendshme në lidhje me akuzën dhe me zbatimin e masës së sigurimit formohet jo mbi bazën e dyshimeve, por mbi prova të vërteta, që përjashtojnë dyshimet. Konstatimi i fakteve në çështjen penale dhe zbatimi mbi këtë bazë i masës së sigurimit, do të thotë të vërtetosh ekzistencën e veprës penale, të konkretizosh kryerjen e veprimeve nga i pandehuri, motivet e realizimit të këtyre veprimeve. Këto dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, hyjnë në përmbajtjen e zbatimit të drejtë të masave të sigurimit, të garantimit të lirisë së personit nga veprime të pabazuara. Pra, në zbatimin e masave të sigurimit dhe posaçërisht në zbatimin e arrestit të të pandehurit si masë shtrëngimi, nuk duhet të sigurohet dyshimi apo bindja si ndjenjë subjektive besimi, por bindja që mbështetet në rrethana të konstatuara, në të dhëna të verifikuara në rrugë objektive[250]. Pikërisht, mbi një bindje të tillë të bazuar, të motivuar dhe të argumentuar me prova, duhet të zgjidhet problemi i caktimit të masave të sigurimit. Në KPrP nuk shpjegohet se deri ne çfarë niveli duhet të provohet dyshimi i arsyeshëm. Kjo pjesë e doktrinës ka mendimin se *detyra e gjykatës në miratimin e masës së shtrëngimit do t'i përgjigjet*

---

[248] Halim Islami, Artan Hoxha dhe Ilir Panda, Procedura penale, Shtëpia Botuese Morava, Tiranë, 2007, fq. 356.
[249] Po aty.
[250] Izet Hoxha, "Arrestimi me dyshime i hap rrugë veprimeve arbitrare", Tribunë Juridike, nr. 27, Viti i IV i botimit, 2000, fq. 15.

realizimit të drejtësisë, kur për personin që urdhërohet të mbyllet në një institucion paraburgimi ka prova të mjaftueshme për kryerjen e veprës, kur te organi që ka të drejtën e procedimit dhe miraton masën e sigurimit, ekziston bindja e plotë mbi fajësinë e personit, kur mungon çdo dyshim mbi fajësinë e tij. Nga pikëpamja logjike, dyshimet e arsyeshme janë të papërcaktuara, kurse çdo orvatje për t'i përkufizuar do të krijonte një gjendje të papranueshme sigurie[251]. Për mendimin tim, ky qëndrim duket se dyshimin e arsyeshëm për një masë sigurimi e barazon me bindjen se i arrestuari është fajtor.

Ndërsa qëndrimi i dytë i përkrahur nga një pjesë tjetër e doktrinës së procedurës penale[252] thekson se dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova konsiston në krijimin e besimit në formën e probabilitetit apo mundësisë për ekzistencën e veprës penale dhe përgjegjësisë së të dyshuarit. Kjo bindje nuk është në nivelin e asaj që kërkohet për shqyrtimin gjyqësor mbi fajësinë e të pandehurit për kryerjen e veprës penale. Një standard i tillë (dyshimi i arsyeshëm) zvogëlon mundësinë e aplikimit të masës së sigurimit personal dhe shfaqet si garantuese e mbrojtëse e lirisë dhe të drejtave të të dyshuarit. Kushti i ekzistencës së provave, mbi të cilat krijohet dyshimi përbën thelbin e dyshimit të arsyeshëm.[253]

Siç do të tregojmë në vijim, qëndrimi i dytë mbi standardin e dyshimit të arsyeshëm është në përputhje me kuptimin që i jep këtij standardi jurisprudenca e konsoliduar e GJEDNJ. Vlen të përmëndet se në procesin për caktimin e masës së sigurisë nuk jepet vendim fajësie, pasi masa e sigurimit është masë e përkohshme që, ndër të tjera, synon të mbrojë procesin, b.fj. nga deformimi i provave; rreziku i largimit të të pandehurit ose kryerja prej tij e krimeve më të rënda apo të të njëjtit lloj. Janë të mjafueshme dyshime të bazuara në nivelin e arsyes, të pranueshme nga njeriu me një logjikë normale që gjykon paanshmërisht. Nuk kërkohet bindje. Kjo do të thotë që veprimtaria provuese vazhdon. Në këtë kontekst, bazuar edhe në jurisprudencën e GJEDNJ-së nuk kërkohet një nivel i lartë i të provuarit sipas standardit të dyshimit të arsyeshëm. Organi i akuzës nuk është i detyruar që kur kërkon caktimin në gjykatë të masës së sigurimit, të bindë gjykatën se *vepra ka ndodhur* dhe *se ajo është kryer nga ai që akuzohet.* Mjafton, sipas GJEDNJ, që dyshimi i arsyeshëm duhet të jetë i sinqertë dhe në mirëbesim. Standardi i të provuarit "Dyshimi i arsyeshëm", i referuar në Nenin 5/1(c) të KEDNJ-së, që një vepër penale është kryer, presupozon *ekzistencën e fakteve ose informacioneve që do të bindin një vëzhgues objektiv* se *personi në fjalë mund të ketë kryer një vepër penale*. Pra, i kushtohet rëndësi mundësisë se i dyshuari është autori i veprës dhe jo sigurisë se plotë se ai është autori. GJEDNJ ka vënë në dukje kriteret të cilat përcaktojnë kuptimin e standardit të dyshimi të arsyeshëm:

1. Të ekzistojnë fakte ose informacione që personi në fjalë të ketë kryer një shkelje,
2. Këto fakte dhe informacione të krijojnë bindjen tek një vëzhgues objektiv,
3. Dyshimi të jetë i arsyeshëm.

Megjithatë, edhe GJEDNJ është shprehur se nuk mund të gjykohet gjithmonë sipas standardeve të njëjta, si ato që zbatohen për krime në një kohë normale, ashtu edhe

---

[251] Izet Hoxha, artikull i cituar, fq. 16.
[252] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 636.
[253] Po aty.

për krime të veçanta. Për këtë theksi mund të vihet në luftën që zhvillohet sot kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar[254]. Në Fox, Campell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ u shpreh se "*Ajo se çfarë do të konsiderohet e 'arsyeshme' do të deduktohet nga tërësia e të gjitha rrethanave. Në këtë kuptim, krimi i terrorizmit përbën një katëgori të veçantë. Megjithatë, kriteret e zbatueshme për krimet terroriste nuk mund të përligjin shtrirjen e nocionit 'të karakterit të arsyeshëm' deri në nivelin që mund të cenojë thelbin e mbrojtjes të parashikuar nga neni 5 i KEDNJ. Natyrisht, neni 5 nuk duhet të zbatohet në një mënyrë të tillë që të krijojë vështirësi disproporcionale për organet policore në luftën ndaj tërrorizmit.*"[255].

Termi provë, që parashikohet në tekstin e ligjit, nënkupton që ky dyshim nuk është i hamendësuar, por i mbështetur në një akt dhe dyshimi i arsyeshëm duhet të bazohet në faktet dhe informacionin që e lidhin në mënyrë objektive personin e dyshuar me faktin e supozuar dhe këto prova janë të tilla që justifikojnë vazhdimin e hetimit. Prova nuk është e nevojshme për të justifikuar fajësinë ose për të ngritur një akuzë, pasi masa e sigurisë nuk është e lidhur domosdoshmërisht me to. Ndryshon niveli i provës kur duhet vërtetuar dyshimi i arsyeshëm, nga prova për fajësinë apo njoftimin e akuzës. Kjo është e lidhur dhe me faktin se sipas legjislacionit tonë "prova formohet në procesin gjyqësor[256]. Megjithatë, edhe prej kuptimit të *dyshimit të arsyeshëm* që përmban dy elementë:dyshimin dhe arsyeshmërinë, rezulton se një dyshim që të jetë i arsyeshëm, duhet të bazohet në të dhëna me karakter objektiv.

Një nga çështjet ku GJEDNJ trajton konceptin e dyshimit të arsyeshëm në kontekstin e një mase sigurmi, është *Wloch kundër Polonisë*. Në çështjen *Wloch kundër Polonisë*, kërkuesi, një avokat, ishte akuzuar për tregti fëmijësh dhe nxitje për dëshmi të rreme. Nga procedimet para gjykatave kombëtare rezultonte se kërkuesi kishte përfituar nga gjendja sociale dhe ekonomike e familjeve të caktuara, në mënyrë që t'i bindte ato për pranimin e birësimit të fëmijëve të tyre të porsalindur, madje këto familje i kishin dhënë atij tagra për të vepruar edhe përpara se fëmijët të kishin lindur. Më pas, kërkuesi i merrte fëmijët që nga spitali dhe i dërgonte ata pranë palëve të treta, duke bërë në këtë mënyrë që prindërit biologjikë të mos kishin mundësi për ushtrimin e autoritetit prindëror dhe kontakti me familjen birësuese. Në procedurat e birësimit në gjykatë prindërit biologjikë pranonin birësimin në favor të familjes birëuese. Prokurori mbështeste qëndrimin se ekziston një dyshim i fortë se kërkuesi i ka nxitur prindërit biologjikë të bënin deklarime të rreme në procedurat e birësimit, sidomos në lidhje me faktin nëse prindërit biologjikë i kishin takuar prindërit adoptues. Prokurori theksonte më tej se, kërkuesi kishte marrë shpërblime tepër të larta për procedurat e birësimit, gjë që tregonte se ai kishte kryer veprën penale të tregëtimit të fëmijëve. Bazuar në argumentat e organit të akuzës ndaj kërkuesit ishte marrë masë shtrënguese e kufizimit të lirisë. Pas ankesave të pasukseshme brenda sistemit ligjor polak, kërkuesi u ankua në GJEDNJ.

Në vendimmarrjen e saj mbi këtë çështje, GJEDNJ përcaktoi disa kritere të rëndësishme për kuptimin e saktë të 'arsyeshmërisë së dyshimit'. Në analizë të kësaj

---

[254] Alma Kodraliu, "E drejta për liri dhe siguri", Tribunë Juridike, nr. 67(4), viti XI i botimit, 2007, fq.37.
[255] Çështja Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar, (Aplikimi nr. *12244/86; 12245/86; 12383/86), 30 gusht 1990, pg.32 dhe pg.34.*
[256] Po aty,

çështje, GJEDNJ u shpreh se "*Neni 5/1 i KEDNJ përmban një listë të plotë të shkaqeve të lejuara për privimin e lirisë, të cilat duhet të interpretohen në mënyrë rigoroze. Një person mund të ndalohet në bazë të nenit 5/1 (c) vetëm në kontekstin e procedimeve penale, me qëllim që të çohet përpara autoritetit kompetent ligjor bazuar në dyshimin se ai ka kryer një vepër penale. Një "dyshimi i arsyeshëm", i referuar në Nenin 5/1 (c) të KEDNJ, që është kryer një vepër penale, presupozon ekzistencën e fakteve ose informacioneve që do të bindin një vëzhgues objektiv se personi në fjalë mund të ketë kryer një vepër penale. Si rregull, problemet që lindin në këtë fushë janë në nivel të fakteve. Çështja është nëse arrestimi dhe paraburgimi janë bazuar në elemente objektivë të mjaftueshme që për të justifikojnë "dyshimin e arsyeshëm" se faktet në shqyrtim kanë ndodhur në të vërtetë.*"[257]

Megjithatë, përveç anës së saj faktike, ekzistenca e një "dyshimi të arsyeshëm" brenda kuptimit të nenit 5/1 (c) kërkon që faktet përkatëse, të konsiderohen në mënyrë të arsyeshme se parashikohen në një nga seksionet që përshkruan sjelljet kriminale në ligjin penal. Kështu, qartësisht nuk mund të ekzistojë një "dyshim i arsyeshëm" nëse aktet apo faktet në ngarkim të një personi të paraburgosur, nuk përbëjnë vepër penale në kohën kur ato kanë ndodhur. Çështja që diskutohet në rastin në shqyrtim është nëse ndalimi i kërkuesit ishte "i ligjshëm" brenda kuptimit të nenit 5/1. KEDNJ, këtu, i referohet në thelb ligjit të shtetit, por ajo gjithashtu kërkon që çdo masë individuale e cila privon individin nga liria e tij, duhet të jetë në përputhje me qëllimet e Nenit 5, pikërisht për të mbrojtur individin kundër arbitraritetit.[258]

Aty ku KEDNJ i referohet direkt ligjit të brendshëm, siç bën në nenin 5, përputhja e një ligji të tillë me KEDNJ është një pjesë integrale e detyrimeve të Shteteve Kontraktuese. GJEDNJ ka kompetencë, në përputhje me rrethanat, që të përmbushë dhe zbatojë vetë këtë pajtueshmëri; megjithatë, fushëveprimi i punës së saj, në këtë drejtim, është subjekt i kufizimeve të qenësishme në logjikën e sistemit evropian të mbrojtjes, pasi i takon fillimisht autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, për të interpretuar dhe zbatuar ligjin e shtetit.

GJEDNJ konstatoi se paraburgimi i kërkuesit u krye bazuar në dyshimin se ai kishte qenë i përfshirë në akte të kualifikuara si vepra penale e tregëtimit të fëmijëve, e cila dënohej sipas ligjit penal polak, dhe gjithashtu në arsyet se ai kishte nxitur persona të caktuar për të dhënë dëshmi të rreme në procedurat gjyqësore. GJEDNJ konstatoi se dispozita që parashikonte tregëtimin e fëmijëve ishte objekt i vështirësive serioze përsa i përket interpretimit të elementeve përbërëse të kësaj vepre. Në veçanti, një çështje e rëndësishme ishte përcaktimi i akteve të cilat mund të konsiderohen si pjesë përbërëse e veprës penale të tregëtimit të fëmijëve. Për këtë, GJEDNJ iu referua jurisprudencës së gjykatave polake, të cilat theksonin se për rastin në shqyrtim mungonin precedentët dhe se ekzistonin vështirësi serioze, përsa i përket interpretimit të fakteve dhe ligjit.[259]

"Për të vlerësuar nëse ndalimi i kërkuesit ishte në përputhje me kërkesat e nenit 5/1 (c) të KEDNJ për sa i përket ligjshmërisë saj, GJEDNJ ka parasysh situatën ligjore në kohën përkatëse. Në mungesë të jurisprudencës përkatëse, apo një mendimi

---

[257] Çështja Wloch kundër Polonisë, GJEDNJ, (Aplikimi nr. *27785/95),* 19 Tetor 2001, pg. 108.
[258] Po aty, pg. 109.
[259] Po aty, pg. 111.

unanim të doktrinës, të cilat do të sqarojnë çështjen e zbatueshmërisë së dispozitave të ligjit penal në situata të ngjashme me atë të kërkuesit, GJEDNJ vëren se gjykatat kombëtare kanë shqyrtuar një numër elementesh të cilat konsiderohen të përshtatshme për vlerësimin e kësaj çështjeje. Prandaj, ato kanë marrë në konsideratë qëllimin e ushtrimit të tagrave të avokatit, të dhënë aplikantit nga palët në procedurat e birësimit dhe kanë analizuar nëse ky qëllim dhe masat konkrete të ndërmarra nga aplikanti kishin qenë në përputhje me praktikën e pranuar normalisht. Ato kanë vlerësuar, më tej, nëse shpërblimi i marrë nga aplikuesi ka qenë i përshtatshëm. GJEDNJ vëren gjithashtu, se autoritetet vendase iu referuan gjerësisht provave të mbledhura gjatë hetimeve dhe konsideruan në sajë të këtyre provave se aspektet faktike të dyshimit kundër aplikuesit ishin në mënyrë të arsyeshme të justifikuara."[260]

Së fundi, GJEDNJ ka arsyetuar se "*Nëse paraburgimi i kërkuesit do të ishte i bazuar vetëm në dyshime në lidhje me përfshirjen e tij në veprën e tregëtimit te fëmijëve, ligjshmëria e paraburgimit të tij, duke pasur parasysh kontradiktat që ekzistonin në interpretimin e ligjit të brendshëm, do të kishte qenë e dyshimtë. Megjithatë, ishte e bazuar edhe mbi dyshimin se ai kishte kryer veprën penale të nxitjes së personave, të cilët kishin marrë pjesë në procedurat e birësimit, për të dhënë dëshmi të rreme para gjykatave*."[261] Në tërësi, GJEDNJ ka konsideruar se nuk ka asnjë të dhënë që tregon se interpretimi i dispozitave ligjore i mbështetur në nga ana e autoriteteve shtetërore në rastin e aplikantit ishte arbitrar apo i paarsyeshëm, në mënyrë që të bënte paraburgimin i tij të paligjshëm. Rrjedhimisht, nuk ka pasur shkelje të nenit 5/1 të KEDNJ-së.[262]

Në këtë vendim, GJEDNJ ka theksuar mënyrën se si duhet kuptuar standardi i dyshimit të arsyeshëm. Për një kuptim të drejtë, në analizën e këtij standardi, duhet të merren në konsideratë çështjet ligjore dhe faktike. Nga pikëpamja ligjore vlen të theksohet se ndaj të dyshuarit nuk mund të merret masë shtrënguese nëse veprimet/mosveprimet e tij të paligjshme nuk janë parashikuar shprehimisht nga ligji si vepër penale. Nga pikëpamja faktike duhet të merren në konsideratë të gjitha rrethanat dhe provat e çështjes, të cilat krijojnë bindjen në përputhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm. Risia e vendimmarrjes së GJEDNJ qëndron në faktin se, pavarësisht mungesës së qartësisë së ligjit penal shtetëror që parashikon veprën penale konkrete, për të cilën dyshohet se ka kryer subjekti, rëndësi themelore ka analiza e rrethanave të çështjes dhe provat ku mbështeten. Nga ana tjetër, nëpërmjet këtij vendimi GJEDNJ mbështet qëndrimin e konsoliduar të praktikës së saj mbi kuptimin dhe kriteret e standardit të të dyshimit të arsyeshëm.

Është e rëndësishme të studiojmë nëse jurisprudenca e gjykatave tona është në përputhje me këto kritere të përcaktuara nga GJEDNJ për kuptimin e drejtë të përmbajtjes së standardit të dyshimit të arsyeshëm. Për këtë qëllim, është me interes të evidentojmë praktikën më të fundit unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe risitë që ka sjellë kjo praktikë në drejtim të kuptimit të konceptit të dyshimit të arsyeshëm. Në vendimin unifikues nr.7, datë 14.10.2011 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë u shprehën se dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova sipas pikës 1 të nenit 228,

---

[260] Po aty, pg. 114.
[261] Po aty, pg. 115.
[262] Po aty, pg. 117.

nënkupton që bëhet fjalë për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, pra për ekzistencën e atyre elementëve të mjaftueshëm juridikë dhe të rrethanave të faktit që i krijojnë bindje gjykatës në drejtim të mundësisë që personi nën hetim dhe i pandehuri të ketë kryer veprën penale. Për rrjedhojë, për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla *që të bëjnë të duket e mundshme* përgjegjësia e të hetuarit a të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij. Dyshimi i bazuar në prova nuk kërkon që ai të jetë ezaurues, domosdoshmërisht një drejtimesh, pra në drejtim të fajësisë. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit.

Prandaj, Kolegjet e Bashkuara kanë ardhur në përfundimin unifikues se "*Dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre mund të nxirren përfundime se ndaj të hetuarit a të gjykuarit ekziston një shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë për kryerjen e veprës penale në ngarkim të tij. Dispozita e pikës 1 të nenit 228 tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë vepër penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij."*[263]

Nga ana tjetër, ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm bazuar në prova në ngarkim së të gjykuarit (*fumus delicti)* është vetëm kushti fillestar, paraprak për zbatimin e masës së sigurimit. Ky kusht nuk përjashton, përkundrazi, nënkupton se duhet të vërtetohet në vijim, qoftë edhe njëri nga kushtet dhe kriteret e tjera ligjore mbi nevojat e sigurimit dhe për përshtatshmërinë e masës konkrete të sigurimit me të cilën kufizohet liria e të gjykuarit (*periculum libertatis)*. Procesi i vlerësimit dhe gjykimit për vendosjen ose jo të masës së sigurimit sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara nga ligji, mbështetet dhe synon arritjen e ekuilibrit të nevojshëm, nga njëra anë, për respektimin dhe garantimin e rendit publik e të interesit publik për dhënien e drejtësisë dhe nga ana tjetër, me të drejtat dhe interesat ligjore të individit subjekt i procedimit, të dyja të parashikuara nga Kushtetuta[264].

Qëndrimi i mbajtur nga jurisprudenca e Gjykatës së Lartë është i ndryshëm nga ai i mbajtur më parë në vendimin unifikues nr. 3, datë 27.09.2002. Në këtë të fundit Gjykata e Lartë pranon se "*Në pajtim të plotë me nenin 5/1, germa "c" dhe pikën 3 të këtij neni të KEDNJ, neni 228 i KPrP ka përcaktuar kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit. Është theksuar kushti i rëndësishëm, sipas të cilit askush nuk mund*

---

[263] Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.7, datë 14.10.2011.
[264] Po aty.

t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qofte se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova. Është pranuar tashmë si nga teoria[265] *dhe praktika gjyqësore shqiptare*[266] *se dyshimi i arsyeshëm nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra e të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra penale ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet. Për caktimin e masave të sigurimit personal kërkohet detyrimisht ekzistenca e veprës penale dhe përgjegjshmëria e atij që akuzohet."*[267]

Qëndrimi i mbajtur në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011 duket se është në përputhje përmbajtjen e përkufizimit të ofruar nga jurisprudenca e GJEDNJ-së. Është e vërtetë se dyshimi i arsyeshëm duhet detyrimisht të bazohet në prova, por se ai nuk kërkon detyrimisht që të tregojë sigurinë e plotë mbi autorin e veprës penale, por mundësinë se personi është autor i veprës penale. Sipas mendimit tim, nuk është legjitim shqetësimi i literaturës sonë juridike[268] se nuk mund të caktohen masa sigurimi mbi dyshime, pasi kjo do të cenonte parimin e prezumimit të pafajësisë. Parimi i prezumimit të pafajësisë është një parim i rëndësishëm që shoqëron të gjitha fazat e procesit deri në dhënien e vendimit përfundimtar të formës së prerë nga gjykata. Pikërisht, zbatimi i konceptit se dyshimi i arsyeshëm tregon mundësinë e kryerjes së veprës penale nga i dyshuari dhe jo sigurinë e kryerjes së kësaj vepre penale, i kontribuon respektimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, pasi fajësia vërtetohet vetëm në procesin e themelit ku standardi duhet të jetë ai tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nëse që në momentin e kërkesës dhe caktimit të masës së sigurimit, prokurori do të provojë se i dyshuari ka kryer veprën penale dhe gjykata e konstaton të tillë, atëherë (pa)fajësia e të dyshuarit është paragjykuar. Në këtë linjë arsyetimi, do të ishte e panevojshme që prokurori të vazhdonte më tej me hetimet. Gjykimi i themelit do të zëvendësohej nga gjykimi për masën e sigurimit. Kjo do të ishte haptazi jologjike dhe nuk shkon në përputhje me ecurinë dhe fazat e procesit gjyqësor penal dhe veçanërisht me konceptin e masave të sigurimit si masa të përkohshme të kufizimit të lirisë.

Pavarësisht vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, gjithsesi, gjatë hulumtimit për këtë punim, kemi hasur në vendime të cilat nuk e kanë respektuar këtë standard. Në raste të tilla Gjykata e Lartë ka konstatuar gabimet e vërejtura në gjykatat e dy shkallëve të para. Konkretisht, në vendimin nr. 114, datë 28.05.2008 të Gjykatës së Lartë trajtohet rasti kur organi i akuzës ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit bazuar në prova të konsideruara të papërdorshme në një gjykim të mëparshëm dhe në prova jo të marra sipas dispozitave përkatëse të KPrP. Në këtë vendim rezulton sa më poshtë:

Rrethanat e faktit.

Në datë 12.08.2002, është qëlluar me armë zjarri shtetasi P.K, i cili ka gjetur vdekjen si pasojë e plagëve të shkaktuara. Pranë vendit të ngjarjes janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale dy armë zjarri. Në njërën prej tyre, nga akti i ekspertimit është arritur në përfundimin se është fiksuar një gjurmë e pjesshme gishti me vlerë identifikuese. Me aktin e ekspertimit është arritur në konkluzionin se kjo gjurmë është formuar nga gishti i madh i dorës së majtë të shtetasit A.I. Çështja është

---

[265] H.Islami, A.Hoxha, I.Panda, "Procedura penale", Shtëpia Botuese Morava, Tiranë 2007, fq. 356.
[266] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr.3, datë 27.09.2002
[267] Po aty.
[268] Izet Hoxha, "Arrestimi me dyshime i hap rrugë veprimeve arbitrare", Tribunë Juridike nr. 27, Viti i IV i botimit, 2000, fq. 15.

dërguar për gjykim me akuzën e vrasjes me paramedim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, sipas neneve 78/2 dhe 278/2 të KP. Gjatë gjykimit të çështjes, ***aktet e mësipërme të ekspertimit janë deklaruar të papërdorshme*** për shkak të mosrespektimit të nenit 179/2 të KPrP. Janë kryer në gjykim disa akte riekspertimi, që kanë arritur në konkluzionin se gjurma e lënë nuk ka karakteristikat e mjaftueshme për identifikim. Përsa më lart, gjykata ka vendosur kalimin e akteve prokurorisë. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe pas shqyrtimit të rekursit të prokurorit, edhe nga Gjykata e Lartë. Në vijim, prokuroria e ka pushuar çështjen në ngarkim të A.I. Mbi kërkesën e organeve të policisë, organi procedues ka vendosur rifillimin e hetimeve. IPSh i ka përcjellë prokurorisë një dokument "Ëitness Statement", të konsideruar akt ekspertimi, të kryer nga një ekspert i Policisë Metropolitane angleze, ku arrihej në konkluzionin se gjurma e fiksuar në vendngjarjen e datës 12.08.2002 ishte formuar nga gishti i personit nën hetim A.I. Nga kërkesa për caktimin e masës së sigurimit për shtetasin A.I, rezulton se prokuroria paraqiti si prova, ku mbështeste dyshimin, aktet e ekspertimeve, si dhe dokumentin e përcjellë nga autoritetet angleze. Të dyja gjykatat e mbështeten vendimin e tyre në aktet e ekspertimit të hartuara nga ekspertët shqiptarë, duke konkluduar se në kushtet kur ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, ndaj shtetasit nën hetim duhet të vendoset masa e sigurimit personal "arrest në burg".

Arsyetimi i Kolegjit Penal.

Gjykata e Lartë, ka çmuar se vendimet e gjykatave janë marrë në shkelje të dispozitave të KPrP. Ato kanë caktuar ndaj A.I një masë sigurimi personal pa patur kriteret ligjore për caktimin e masës, pa patur dyshime të bazuara në prova në ngarkim të tij, si dhe e kanë bazuar vendimin e tyre në prova të pashqyrtuara në seance gjyqësore. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Ka qenë detyrim i gjykatës që, gjatë shqyrtimit të kërkesës së prokurorisë, përveçse të konstatonte ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprave penale nga personi nën hetim, të vlerësonte ekzistencën e provave të marra sipas procedurave ligjore në të cilat bazohej ky dyshim. Në interpretim të nenit 228/1 të KPrP, kur gjykata shqyrton kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurimit, është e detyruar të administrojë e të vlerësojë provat që paraqet akuza me qëllim mbështetjen e dyshimit të arsyeshëm për kryerjen e veprës penale. Këto prova do të duhen të jenë marrë në përputhje me kërkesat e dispozitave përkatëse të KPrP. Ndërkohë, në gjykimin konkret rezulton se gjykatat e kanë mbështetur vendimin e tyre në prova, të cilat me një vendim gjyqësor të mëparshëm që nuk është cenuar, janë deklaruar të papërdorshme. Pavarësisht se në kundërshtim me ligjin, organi i prokurorisë i paraqet këto akte ekspertimi,* ***të deklaruara të papërdorshme****, si prova ku bazohet dyshimi i arsyeshëm, ka qenë detyrim i gjykatës të konstatonte këtë shkelje të ligjit nga ana e organit të prokurorisë që, edhe pse në dijeni të gjendjes procedurale të këtyre akteve, vijon t'i kërkojë gjykatës t'i administrojë e çmojë si të marra në përputhje me dispozitën e nenit 149 të KPrP. Akti shkresor i hartuar nga eksperti anglez, të cilin gjykatat e kanë çmuar si provë për të krijuar dyshimin se A.I është autor i veprës penale, nuk mund të konsiderohet si një prove në kuptimin që i neni 149 të KPrP, pasi ai nuk është rrjedhojë e urdhërimeve që përmbajnë dispozitat e kreut VI-të të KPrP lidhur me mënyrën e caktimit të ekspertit, etj. Nuk mundet që mbi një akt ekspertimi të deklaruar nga gjykata të papërdorshëm dhe dy akteve të tjerë që konkludojnë në favor të të pandehurit, gjykata të çmojë si provë mendimin e një*

specialisti të huaj, të marrë jo sipas rregullimeve ligjore në fuqi në RSh."[269] Në këtë vendim, Gjykata e Lartë ka zbatuar një kriter të rëndësishëm, sipas të cilit provat mbi të cilat mbështetet standardi i dyshimit të arsyeshëm, nuk duhet të jenë prekur nga sanksioni i papërdorshmërisë për shkak të marrjes së tyre *contra legem*.

Në një vendim tjetër të Gjykatës së Lartë janë konstatuar gabimet e kryera prej gjykatave të dy shkallëve të gjykimit në lidhje me arsyetimin e dyshimit të arsyeshëm. Megjithatë, prova në të cilën e bazon ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm Gjykata e Lartë janë shpjegimet e dhëna nga personi tjetër nën hetim V.S, të cilat konsiderohen nga gjykata të mjaftueshme për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Nuk rezulton nga vendimi nëse këto shpjegime të dhëna nga personi nën hetim përmbushin elementët ligjorë për t'u konsideruar provë në kuptimin që i jep KPrP. Kështu, në vendimin nr. 67, datë 16.04.2008 rezulton sa më poshtë:

Rrethanat e faktit.

Prokuroria e Rrethit Tiranë, ka filluar procedimin penal në ngarkim të të pandehurit D.H për veprat penale të falsifikimit të dokumenteve, falsifikimit të vulave dhe stampave, si dhe atë të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike dhe ka kërkuar që ndaj këtij personi të caktohet si masë e sigurimit personal ajo e "arrestit në burg". Gjykata e Rrethit Tiranë, me vendim i cili është miratuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, ka pranuar kërkesën e organit të akuzës duke caktuar ndaj të pandehurit si masë sigurimi personal atë të "arrestit në burg".

Arsyetimi i gjykatës

Gjykata e Lartë ka çmuar se vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen vetëm përsa i përket llojit të masës së sigurimit personal të caktuar ndaj të pandehurit D.H, pasi në caktimin e kësaj mase gjykatat nuk kanë patur parasysh nenet 228 dhe 229 të KPrP. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Nga provat e administruara në gjykim, ekziston një dyshim i arsyeshëm se i pandehuri D.H, për të regjistruar një sipërfaqe trualli prej për të cilën pretendon se e ka trashëgim nga prindërit, ka paguar shumën 35.000 euro. Shpjegimet e dhëna nga personi në hetim V.S, lidhur me mënyrën e regjistrimit të kësaj prone, janë një dyshim i arsyeshëm që i pandehuri D.H, mund të ketë kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike. Këto dyshime legjitimojnë gjykatën që ndaj këtij personi të caktojë një masë sigurimi personal, konform kërkesave të nenit 228/1 të KPrP. Lidhur me arsyetimin e gjykatave të faktit se në ngarkim të të pandehurit D.H ka dyshime të bazuara në prova që të ketë kryer edhe veprat penale të falsifikimit të dokumenteve dhe atë të falsifikimit të vulave dhe stampave, Gjykata e Lartë çmon se është i gabuar. Në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë dyshim të bazuar në ndonjë provë qe sipërfaqja prej truall të mos jetë pronë e të pandehurit D.H dhe që ky person ta ketë regjistruar këtë sipërfaqe duke përdorur dokumente të falsifikuara. Vetë gjykatat, në arsyetimin e vendimeve të tyre, nuk përmendin se kush është dokumenti që dyshohet të jetë falsifikuar nga i pandehuri D.H, kush është dyshimi i arsyeshëm që e çon gjykatën në një përfundim të tillë dhe cilat janë vulat apo stampat që dyshohet të ketë falsifikuar ky i pandehur. Gjykatat e kanë bazuar vendimin e tyre në prova të paadministruara dhe që nuk i janë nënshtruar shqyrtimit gjyqësor. Kështu Gjykata e Rrethit Tiranë, në arsyetimin e vendimit të saj pranon si fakt ekzistencën e disa procesverbaleve të transkriptimit të bisedave telefonike të bëra ndërmjet të pandehurit dhe personit në*

---

[269] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 114, datë 28.05.2008.

hetim V.S, ndërkohe që nga dosja gjyqësore, këto proces verbale nuk rezulton të jenë administruar nga gjykata duke vënë kështu në dyshim ekzistencën e tyre. Të njëjtën shkelje procedurale bëjnë gjykatat kur në arsyetimin e vendimeve të tyre përmendin si të provuar dyshimin që i pandehuri mund t'i shmanget hetimit, ndërkohë që nga dosja gjyqësore një dyshim i tillë nuk rezulton i bazuar në ndonjë provë."[270] Në vendimin e mësipërm, Gjykata e Lartë me të drejtë ka vlerësuar se nuk është i bazuar në prova dyshimi për kryerjen e veprave penale të fallsifikimit të dokumenteve dhe vulave e stampave, pasi në dosjen gjyqësore nuk ekziston asnjë provë. Megjithatë, ka gabuar kur ka vlerësuar se ekziston dyshimi i arsyeshëm se i pandehuri mund të ketë kryer veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm. E vetmja e dhënë ka qenë deklarimi i personit tjetër në hetim V.S. Ligjvënësi ka vendosur kritere për çmuarjen e deklarimeve që jep i pandehuri në një vepër të përbashkët ose personi që ka cilësinë e të pandehurit në një procedim të lidhur. Në kushtet kur neni 34/5 i KPrP parashikon se dispozitat, që zbatohen për të pandehurin, zbatohen edhe për personin nën hetim, me përjashtim të rasteve kur kodi parashikon ndryshe dhe kur gjendemi përpara një procedimi të lidhur, Gjykata e Lartë duhet të zbatonte nenin 152/3 të KPrP[271]. Nga interpretimi i kësaj dispozite rezulton se deklarimet e vetme, të palidhura me prova të tjera, nuk janë të mjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova. Është e mjaftueshme që provat e tjera të vlerësuara në unitet me deklarimet, sipas parimit të bindjes së brendshme, të shërbejnë për të konfirmuar besueshmërinë e deklaruesit. Në rastin konkret, nuk kanë ekzistuar prova të tjera, të cilat të konfirmonin besueshmërinë e personit nën hetim V.S. Gjithashtu, është gabuar në ndryshimin e vendimit duke caktuar ndaj të pandehurit masën e sigurimit 'arrest në shtëpi'. Vetë gjykata në arsyetimin e vendimit ka pranuar që nuk ka asnjë provë që të tregojë se i pandehuri i shmanget hetimit, pra, mungojnë kriteret e posaçme të caktimit të masave të sigurimit, të cilat ashtu si dyshimi i arsyeshëm duhet të provohen nëpërmjet provave nga akuza. Në vendim nuk arsyetohet nëse ekzistojnë kriteret e tjera të posaçme.

Në vendimin në vijim[272], Gjykata e Lartë është shprehur se dyshimi i arsyeshën nuk mund të bazohet në indicje. Nga rrethanat e kësaj çështje rezulton se organi i policisë Berat, duke patur të dhëna në ngarkim të shtetasit A.Y për dhënie ndihme në kalimin e paligjshëm të kufirit, kanë realizuar kapjen e tij në flagrancë, duke shoqëruar disa persona për të kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme. Dy ditë përpara kapjes në flagrancë, nga ana e gjykatës së rrethit është lejuar vënia në përgjim e telefonit celular të shtetasit A.Y. Duke konstatuar se ditën e kapjes në flagrancë, shtetasi nën hetim A.Y ka bërë një bisedë telefonike me shtetasin E.V, nga përmbajtja e të cilës, sipas organit të akuzës, del se këta dy shtetas janë bashkëpunëtorë në kryerjen e veprës penale. Është bërë ndalimi i tij dhe kërkohet që të caktohet masa e sigurimit personal "arrest në burg".
Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: ..Në kuptim të nenit 228/1, kjo dispozitë kërkon si kusht bazë për krijimin e "dyshimit të arsyeshëm", ekzistencën e një ose më shumë provave që tregojnë se është kryer një vepër penale dhe se autori i saj mund të jetë personi ndaj të cilit kërkohet caktimi i masës së sigurimit. Ndërkohe konstatohet

---

[270] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 67, datë 16.04.2008.
[271] Neni 152/3- Çmuarja e provave: 3. Deklarimet e bëra nga i bashkëpandehuri në të njëjtën vepër penale ose nga personi i marrë si i pandehur në një procedim që lidhet me të, vlerësohet në unitet me provat e tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.
[272] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.49 datë 25.02.2009.

lehtësisht se ndryshe nga ç'ka kërkon dispozita e mësipërme, gjykatat e faktit, arsyetimin e vendimeve të tyre e bazojnë mbi një indicje të interpretuar si provë. Shprehjet e përdorura nga personi nën hetim E.V (akuzuar për veprën penale "dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit", parashikuar nga neni 298/2 i KP) në bisedën telefonike me shtetasin A.Y kurrsesi nuk mund të konsiderohen si provë, që në kuptim të dispozitës së nenit 228 të KPrP, shtetasi E.V t'i nënshtrohej masës së sigurimit personal " arrest në burg". Kjo bisedë mund të shfrytezohej si një indicje në ngarkim të këtij personi që organet e policisë të organizonin punën e tyre operative, por jo si provë e arsyeshme në kuptimin procedural penal[273]. Ky vendim i Gjyaktës së Lartë është në përputhje me kriterin që parashikon ligji për vlerësimin e indicjeve. Neni 152/2 i KPrP parashikon se indicjet shërbejnë për të vërtetuar një fakt vetëm nëse ekzistojnë disa të tilla të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra – tjetrën.

Në vendimin që do të marrim në shqyrtim më poshtë, Gjykata e Lartë ka konstatuar gabimet e gjykatave në lidhje me mbështetjen dhe justifikimin e dyshimit të arsyeshëm. Në këtë çështje, e vetmja provë në ngarkim të të pandehurit, është dëshmia e një dëshmitari, i cili e ka parë të pandehurin në vendin e ngjarjes, por që nuk dëshmon se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në këtë çështje rezulton:

Rrethanat e faktit.

Gjatë trazirave të viti 1997, në qytetin e Vlorës, një grup i armatosur ka hapur zjarr ndaj një automjeti të policisë dhe si rezultat është vrarë me armë zjarri dhe më pas është djegur së bashku me makinën e policisë një oficer policie dhe është marrë peng e më pas rrahur një tjetër punonjës i policisë. Për këtë ngjarje, organi i prokurorisë ka filluar procedimin penal, i cili është pezulluar dhe janë rifilluar hetimet disa herë. Në datën 12.11.2007, çështja është rifilluar me vendim nga Prokuroria e Krimeve të Rënda. Për efekt të këtij procedimi, organi i prokurorisë, ndër të tjera, ka vendosur të ndalojë shtetasin nën hetim A.P dhe në vazhdim të kërkojë në gjykatë që ndaj këtij personi të caktohet si masë sigurimi personal "arrest në burg", me arsyetimin se në ngarkim të tij ka dyshime të bazuara në prova se është një prej autorëve të ngjarjes. Gjykata e shkallës së parë për Krime të rënda ka miratuar si të ligjshëm ndalimin e shtetasit në hetim, i ka caktuar atij si masë sigurimi personal atë të "arrestit në burg". Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë ka miratuar masën e sigurimit personal të këtij shtetasi, por ka shfuqizuar si të paligjshëm ndalimin e tij.

Arsyetimi i Gjykatës

Gjykata e Lartë e gjen të bazuar në ligj vetëm pjesën e vendimit të gjykatës së Apelit, e cila me të drejtë ka çmuar se ndalimi i shtetasit A.P është i paligjshëm. Gjykata e Lartë duke konstatuar se nga të dyja gjykatat, në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit në hetim A.P është vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 228 të KPrP, çmon se në këtë pjesë, të dy vendimet duhet të ndryshohen dhe ndaj shtetasit në hetim A.P nuk duhet të caktohet asnjë lloj mase e sigurimit personal. "*Nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore nuk rezulton që në ngarkim të këtij shtetasi të ketë dyshim të arsyeshëm, të bazuar në ndonjë provë, që ai të jetë autor i veprës penale për të cilën heton organi i akuzës. Të dyja gjykatat, në arsyetimin e vendimeve të tyre kanë vlerësuar si prova në ngarkim të shtetasit A.P materialet e dosjes hetimore që hedhin dritë mbi ngjarjen e ndodhur, por në asnjërën prej tyre nuk bëhet fjalë që si person i dyshimtë të ketë qenë edhe shtetasi A.P. Është e*

---

[273] Po aty.

vërtetë, siç e ka pranuar dhe vetë në shpjegimet e dhëna disa herë nga viti 1999 e në vazhdim A.P, se atë ditë ai është ndodhur në karburantin e Qafë-Gjashtës, vend ku ka ndodhur ngjarja. Ai ka pretenduar dhe në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë provë të kundërt, që A.P është ndodhur në këtë karburant rastësisht për të furnizuar makinën, ka qenë i paarmatosur dhe nuk ka marrë pjesë në konfliktin ndërmjet forcave të policisë dhe bandës së qytetarëve të armatosur që kanë shtënë kundër tyre. Edhe dëshmitari i vetëm okular që ka dhënë shpjegime të qarta për këtë ngjarje, lidhur me shtetasin A.P ka shpjeguar vetëm faktin që ai ka qenë prezent tek karburanti ditën e ngjarjes. Lidhur me praninë e këtij shtetasi në vendngjarje, organi i hetimit ka zhvilluar hetime dhe nuk është bërë e mundur, që përveç faktit se ai është ndodhur rastësisht në vendin e ngjarjes, të ketë dyshime si një prej autorëve të kësaj ngjarje."[274] Gjykata e Lartë është bazuar në dy kritere të rëndësishme për të vlerësuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Së pari, dyshimi i arsyeshëm nuk mund të deduktohet nga rëndësia e ngjarjes kriminale dhe rrezikshmëria e veprës penale për të cilën akuzohet i dyshuari. Së dyti, pavarësisht ekzistencës së një prove të drejtpërdrejtë, kjo nuk do të thotë se automatikisht përmbushet standardi i dyshimit të arsyeshëm. Një provë mund të jetë e mjaftueshme për të krijuar te gjykata bindjen në përputhje me dyshimin e arsyeshëm, vetëm nëse ajo jep të dhëna që tregojnë se një person mund të ketë kryer veprën penale.

Në një vendim tjetër, Gjykata e Lartë, sërish, ka prishur vendimet e gjykatave të cilat, jo vetëm nuk i mbështesnin dyshimet në prova, por ishin alogjike në përpjekjen për të arsyetuar këto dyshime. Nga ky vendim rezulton:

Rrethanat e faktit.

Gjatë shqyrtimit të akteve të procedimit penal që i përket personit ndaj të cilit zhvillohen hetime J.M, u konstatua se më 20.12.2006 u ekzekutua urdhëri i po asaj date, lëshuar nga prokurori, për ndalimin e tij. Me kërkesë të prokurorit, gjykata, pasi vleftësoi të ligjshëm ndalimin, si masë sigurimi caktoi atë të arrestit në burg. U konstatua gjithashtu se, megjithëse gjykata, në vendimin e saj, ka pranuar se: *"Pas ngjarjes janë kryer një seri veprimesh hetimore, si dhe janë organizuar përgjimet për një grup personash, nga të cilët rezulton se ngjarja është ndjekur në vijimësi edhe pse nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim konkret nga i dyshuari J.M, i cili edhe mbas ngjarjes ka shoqëruar dhe përkrahur në mënyrë të vazhdueshme të pandehurin M.K me të cilin ka qenë edhe në momentin kur është ndaluar"*, arrin në përfundimin sipas të cilit ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova, se i dyshuari ka luajtur rol në realizimin e veprës penale, përfundim, të cilin Gjykata e Lartë e gjen të pabazuar dhe alogjik.

Arsyetimi i gjykatës

Gjykata e Lartë aryseton se "*Gjykata për të argumentuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, nuk i referohet asnjë prove, qoftë ajo edhe indirekte. Edhe përmendja e përgjimeve në vendim, jo vetëm që nuk mund të shërbente si bazë për të caktuar masë sigurimi personal ndaj të dyshuarit, (pasi procesverbali i transkriptimit të tyre nuk është administruar), por edhe vetë ajo në vendimin e saj ka pranuar faktin* ***që, nga këto përgjime nuk rezulton të jetë kryer asnjë veprim konkret nga ky i dyshuar.*** *Pikërisht këtu konsiston edhe alogjizmi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në të njëjtin përfundim, Gjykata e Lartë arriti edhe për vendimin e Gjykatës së Apelit, me të cilin, me arsyetimin sipas të cilit, "Në vlerësimin e rrethanave të*

---

[274] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 29, datë 13.02.2008.

ngjarjes, provave të administruara deri në këtë fazë të hetimit, ka dyshime të arsyeshme në prova se i dyshuari J.M ka luajtur rol në realizimin e kësaj vepre penale", pa përmendur se cilat janë konkretisht provat, vendosi miratimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Aq më tepër kur edhe përfaqësuesi i prokurorisë, sipas procesverbalit të seancës gjyqësore zhvilluar në gjykatën e apelit, deklaroi ***se i vetmi dyshim për të arrestuarin "..... është që e kanë kapur me M.K dhe që është me precedent penal".*** [275] Me këtë vendim Gjykata e Lartë thekson kërkesën e domsodoshme që dyshimi i arsyeshëm duhet detyrimisht të shoqërohet nga prova që mbështesin këtë dyshim. Një dyshim nuk mund të përmbushë kushtin e arsyeshmërisë nëse nuk gjen mbështetje në prova. Fakti që i dyshuari është arrestuar në praninë e një personi me precedent penal nuk përbën dyshim të arsyeshëm se mund të ketë kryer një vepër penale.

Në vijim është një tjetër vendim i Gjykatës së Lartë, në të cilin arsyetohet mbi bazueshmërinë e dyshimit të arsyeshëm. Gjykata ka theksuar se nuk mund të ketë dyshime të bazuara *në prova që mbështeten në dyshime mbi ekzistencën e provave*. Konkretisht, në këtë vendim rezulton:

Rrethanat e faktit.

Rezulton se nga një kontroll i ushtruar nga policia ndaj shtetasit V.E në makinë dhe banesë i janë kapur disa dokumente si: leje pune e shtetit grek, vizë Schengen greke një kompjuter, aksesorëe printer. Ky kontroll është ushtruar mbasi, më parë, nga policia është realizuar përgjimi i bisedave telefonike të këtij personi nga përmbajtja e të cilave organi i policisë ka krijuar dyshime se ai mendon të ushtrojë aktivitet të paligjshëm. Menjëherë pas kësaj, është realizuar arrestimi në flagrancë e këtij shtetasi dhe është kërkuar në gjykatë, e cila ka caktuar masën e sigurimit personal "arrest në burg".

Arsyetimi i gjykatës.

Nga arsyetimi i vendimeve të gjykatave të faktit, del qartë se prej tyre ka një konfondim në aplikimin e nenit 228/1 të KPrP. Kjo dispozitë kërkon si kusht bazë për krijimin e "dyshimit të arsyeshëm" ekzistencën e një ose më shumë provave, që tregojnë se është kryer një vepër penale dhe se autori i saj mund të jetë personi ndaj të cilit kërkohet caktimi i masës së sigurimit. *Ndërkohë, konstatohet lehtësisht se ndryshe nga ç'ka kërkon dispozita e mësiperme, gjykatat e faktit, arsyetimin e vendimeve të tyre e bazojnë mbi dyshime për ekzistencën e provave. Është e qartë se dyshimi lidhur me ekzistencën e një prove është pjesë që lidhet me procesin e të provuarit gjatë hetimit paraprak, por kurrsesi dyshimi nëse ekziston ose jo një provë nuk mund të jetë "dyshim i bazuar në prova", sipas kuptimit të dispozitës së nenit 228/1 të KPrP. Arsyetimet e përdorura në vendimet e gjykatave të faktit se shtetasi V.E dyshohet të ketë falsifikuar aktet për të cilat akuzohet, ndërkohë që nuk ka asnjë provë që të tregojë se ndonjëra prej tyre është e falsifikuar, apo që dyshohet se ka kryer veprën penale të prodhimit të mjeteve për falsifikim, ndërkohë që nuk ka asnjë provë veç ekzistencës së një kompjuteri të zakonshëm me aksesorët e tij, apo që ka dhënë ndihmë për kalim të paligjshem të kufirit, ndërkohë që nuk ekziston asnjë person konkret, të cilit t'i jetë ofruar apo dhënë kjo ndihmë, tregojnë se vendimet e të dyja gjykatave janë marrë jo vetëm pa qenë kushtet e parashikuara nga neni 228/1 i KPrP, por janë marrë edhe në shkelje të rregullimeve që bën dispozita e nenit 152 dhe 380 të KPrP. Edhe pse gjykatat kanë pranuar si të provuar se veprat penale nga*

---

[275] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 20, datë 16.03.2007.

shtetasi V.E dyshohen të jenë kryer në bashkëpunim, nuk rezulton që ky dyshim i gjykatave të jetë i arsyshëm, pasi nuk është bazuar në ndonjë provë.[276] Gjykata e Lartë ka përpunuar kriterin që dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova nuk duhet të bazohet në dyshime mbi ekzistencën e provave, por vetëm mbi prova të vërteta. Në vendimin për caktimin e masës së sigurimit, gjykatat duhet të arsyetojnë se cilat janë provat mbi të cilat është mbështetur dyshimi e arsyeshëm që i dyshuari është autor i këtyre veprave penale.

Në vendimin që do të paraqesim në vijim, Gjykata e Lartë bën dallimin ndërmjet *nivelit të provueshmërisë që kërkohet për dyshimin e arsyeshëm dhe atë që kërkohet në gjykimin e themelit.*

Rrethanat e faktit.

Duke miratuar vendimin e Gjykatës së shkallës së parë për Krime të Rënda, me të cilin ishte vendosur masa e sigurimit arrest në burg për të pandehurin G.S, gjykata e apelit shprehet se janë kushtet ligjore për caktimin e asaj mase. Arsyetohet në vendimin e gjykatës së apelit se, në caktimin e masës së sigurimit arrest në burg, janë zbatuar drejt kërkesat ligjore dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm në provat e administruara në seancën gjyqësore për kryerjen nga i pandehuri G.S të veprave penale të trafikimit të lëndëve narkotike, organizim dhe drejtim i organizatës kriminale dhe krijim të bandës së armatosur e organizatës kriminale parashikuar nga nenet 283/a, 284/a e 333 të KP.

Arsyetimi i Kolegjit Penal.

Gjykata e Lartë është shprehur se në marrjen e vendimit, gjykata e apelit, nuk ka respektuar kërkesat e nenit 152 të KPrP për çmuarjen e provave dhe një ndër kërkesat kryesore në këtë drejtim atë që, asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar. Gjykata e Apelit ka arsyetuar se provat e paraqitura, tregojnë se G.S ka marrë pjesë në organizatën kriminale duke lehtësuar kalimin e lëndëve narkotike nga porti i Durrësit për në portin e Barit. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Lartë këto konkluzione mund të nxirren vetëm në gjykimin në themel të çështjes kur çdo provë, i nënshtrohet debatit gjyqësor, shqyrtimit dhe administrimit nga gjykata, ndërsa në rastin e caktimit të masës së sigurimit, në mbështetje të nenit 228 të KPrP, gjykata duhej të provojë e pranojë vetëm ekzistencën e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova.[277]

Në lidhje me këtë vendim të Gjykatës së Lartë mund të thuhet se nuk ekziston asnjë pengesë ligjore që nga provat të dalë përfundimi se ka dyshime të arsyeshme se vepra është kryer nga i hetuari që në këtë fazë. Provat mund të jenë të tilla që të tejkalojnë edhe dyshimin e arsyeshëm. Është e rëndësishme të theksojmë se KPrP cakton cakun minimal të domosdoshëm që lidh personin me veprën: dyshimin e arsyeshëm mbështetur në prova. Por, nëse ky cak kapërcehet pozitivisht, pra kemi me shumë se sa dyshimin e arsyeshëm, në këtë rast të drejtat e individit janë më të garantuara. Megjithatë, në këtë fazë nuk mund të ketë konkluzione mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, pasi kjo zgjidhet në gjykimin e themelit të çështjes.

Edhe në vendimet e mëposhtme, Gjykata e Lartë thekson dallimet ndërmjet gjykimit të themelit dhe caktimit të masës së sigurimit. Më tepër për rëndësinë e dallimit të standardeve të të provuarit në fazën e gjykimit dhe për caktimin e masës së

---

[276] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.311 datë 19.12.2008.
[277] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 64, datë 07.07.2006.

sigurimit në fazën e hetimeve paraprake do të shprehemi në pjesën e studimit të standardit të të provuarit në gjykimin e themelit.

Gjykata e Lartë ka arsyetuar se… "*Nëse personi nën hetim është ose jo autor i veprës penale kjo është një çështje që lidhet me gjykimin në themel dhe me procesin e të provuarit, por nëse ndaj tij duhet caktuar një masë sigurimi personal, aq më tepër ajo e arrestit në burg, kjo është një çështje që lidhet me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligj dhe që janë të ndryshme nga ato të gjykimit të çështjes në themel. Gjykata e Lartë i ka tërhequr vëmëndjen gjykatave se masat e sigurimit nuk janë dënime penale, por janë masa që lidhen me nevojat e sigurimit dhe jepen mbi disa kushte dhe kritere të përcaktuara saktësisht në titullin e V të KPrP.*"[278]

Gjithashtu edhe në një vendim tjetër Gjykata e Lartë është shprehur për dallimin ndërmjet standardit që kërkohet në caktimin e masave të sigurimit dhe procesit të gjykimit të themelit të çështjes. Gjykata e Lartë ka arsyetuar në përputhje me praktikën e saj unifikuese. Konkretisht, Gjyakata e lartë ka arsyetuar se: "*Për caktimin e masës së sigurimit është e nevojshme që provat, direkte apo indirekte, të jenë të tilla që të bëjnë të duket e mundshme përgjegjësia e të hetuarit dhe të gjykuarit në lidhje me akuzën e ngritur ndaj tij. Pavarësisht prej këtij dyshimi të arsyeshëm bazuar në prova se i gjykuari ka kryer veprën penale, në përfundim të gjykimit të themelit mund të rezultojë e të vërtetohet si fajësia, ashtu edhe pafajësia e të pandehurit. I dyshuari ka qenë në zbatim të detyrës së tij, si punonjës i patrullës që ka shkuar në ndihmë të kolegëve, pas debatit që po ndodhte në orët e para të mëngjesit pranë lokalit "M", midis punonjësve të policisë dhe personave që gjendeshin në lokal, por argumentimi i Gjykatës së Apelit duhet plotësuar. Për personin nën hetim nuk është arritur të merren të dhëna të cilat ta implikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e veprës për të cilën hetohet dhe në këto kushte asnjë masë sigurimi personal nuk mund të merret kundër tij.* Kolegjet e Bashkuara në vendimin nr. 07/2011 kanë arritur në përfundimin unifikues se: "*dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit (...)*".[279]

Në konkuzion të atyre që kemi trajtuar më sipër në lidhje me zbatimin e standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova e gjejmë me vend të evidentojmë disa karakteristika të rëndësishme për kuptimin e drejtë të këtij standardi. Konkretisht,

1- Dyshimi i arsyeshëm duhet të bazohet në prova
2- Provat mbi të cilat bazohet dyshimi duhet të jenë të përdorshme;
3- Nuk mund të mjaftojnë për të bazuar dyshimin e arsyeshëm vetëm deklarimet e të pandehurit në një vepër të përbashkët ose në një procedim të lidhur, të pa shoqëruara me prova që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.
4- Dyshimi i arsyeshëm nuk mund të krijohet duke u bazuar vetëm në një indicje
5- Një provë mund të jetë e mjaftueshme për të krijuar te gjykata bindjen në përputhje me dyshimin e arsyeshëm, vetëm nëse ajo jep të dhëna që tregojnë se një person mund të ketë kryer veprën penale.
6- Dyshimi duhet të jetë i mbështetur në prova dhe jo në dyshime mbi

[278] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.21 datë 09.07.2010, si dhe Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 137 datë 27.05.2009.
[279] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 244, datë 26.09.2012.

ekzistencën e këtyre provave,

7- Standardi i dyshimit të arsyeshëm për caktimin e masave të sigurimit është i ndryshëm nga standardi i zbatuar në gjykimin e themelit ku përcaktohet fajësia apo pafajësia e të pandehurit.

3.4 Marrja e personit si i pandehur dhe dërgimi i çështjes në gjykatë

3.4.1 Të dhënat e mjaftueshme për marrjen si të pandehur

Një tjetër standard i rëndësishëm që parashikohet në KPrP është standardi i *të dhënave të mjaftueshme për marrjen e një personi në cilësinë e të pandehurit*. Kur merr njoftim për kryerjen e një vepre penale që ndiqet kryesisht, organi procedues regjistron procedimin penal dhe nga momenti i identifikimit të saktë, edhe emrin e personit të cilit i atribuohet vepra. Gjatë hetimeve paraprake, kur mblidhen të dhëna të mjaftueshme që tregojnë se kjo vepër është kryer nga një person i caktuar, në bazë të nenit 34 të KPrP, prokurori vendos marrjen e tij si i pandehur.[280] I pandehuri është personi, të cilit i atribuohet fajësia për kryerjen e një vepre penale me aktin e njoftimit të akuzës.

Marrja e një personi si i pandehur realizohet në fazën e hetimit të një procedimi penal. Para kësaj faze dhe pikërisht para momentit të fillimit të procedimit penal, nuk ka dhe as nuk mund të ketë marrje të një personi si i pandehur, pasi në përputhje me nenin 24 të KPrP, organit të procedimit i lind e drejta e kryerjes së akteve/veprimeve hetimore vetëm pas regjistrimit të një procedimi penal të caktuar. Para regjistrimit të procedimit penal, organi i procedimit nuk ka asnjë të drejtë të kryejë veprime hetimore të materializuara në akte procedurale.

Procedimi penal regjistrohet kur ka të dhëna të besueshme që tregojnë një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet. Regjistrimi i procedimit nuk zgjidh dhe nuk mund të zgjidhë dot problemin nëse ekziston ose jo vepra penale. Këtë gjë e realizon vetëm zhvillimi i hetimeve lidhur me procedimin e regjistruar. Rëndësia e ekzistencës së saj, del edhe nga neni 290 pika 1/c i KPrP: *Procedimi penal nuk mund të fillojë dhe në qoftëse ka filluar, duhet të pushojë në çdo gjendje të procedimit, kur fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale ose kur del qartë që fakti nuk ekziston*.[281] Pasi ka vendosur fillimin e procedimit penal dhe ka vërtetuar në rrugë hetimore qënien e veprës penale, organit te procedimit i del për detyrë që të zbulojë autorin e saj. Në momentin e regjistrimit të procedimit penal, ai nuk ka dijeni e të dhëna të mjaftueshme lidhur me personin që ka kryer veprën penale. Është zhvillimi i hetimeve që mund ta orientojë atë në zbulimin e autorit të veprës penale, çka nënkupton kryerjen e një sërë veprimesh hetimore: pyetje dëshmitarësh të ndryshëm që kanë dijeni për rrethanat e faktit penal, kryerje të këqyrjeve në vendin e ngjarjes e kontrolle të ndyshme në banesa, ekspertime, njohje, eksperimente hetimore, etj.

Për rrjedhojë, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal deri në atë të marrjes të një personi të caktuar si të pandehur, ekziston një hapësirë kohore. Megjithatë, mund të ndodhë që momenti i fillimit të procedimit penal të përkojë me

---

[280] Dr.Jorgo Dhrami, I pandehuri dhe prokurori, Tiranë, 2011, fq. 31.
[281] Dr.Jorgo Dhrami, vepër e cituar, fq. 39.

atë të marrjes së të dyshuarit si të pandehur, sepse qysh në këtë moment organi i procedimit zotëron të dhëna të majftueshme që i japin të drejtën atij të marrë një person të caktuar me cilësinë e të pandehurit, pa u kryer veprime të tjera hetimore. Në këto raste është kusht i domosdoshëm që provat të jenë bindëse, që ta cilësojnë si *fajtor të mundshëm* personin e marrë në përgjegjësi penale[282], megjithatë, siç dihet, nuk ka prova të pakundërshtueshme.

Neni 34, duke pranuar si bazë për marrjen e një personi si të pandehur ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme në lidhje me kryerjen e një vepre penale, mendoj se me këtë formulim përcakton se si kriter për vënien e një personi para përgjegjësië penale shërben ekzistenca e provave. Ekzistenca e provave është e domosdoshme për të vërtetuar ato fakte, të cilat në tërësinë e tyre formojnë elementët përbërës të veprës penale.[283] Megjithatë, në KPrP nuk përcaktohet baza e të dhënave që mund të konsiderohen të mjaftueshme për marrjen e një personi si të pandehur. Nga interpretimi literal i nenit 34 mund të thuhet se standardi i të provuarit që prezantohet në këtë dispozitë është i ndryshëm nga standardet e trajtuara deri më tani në procesin penal. Ky arsyetim të shpie në konkluzionin se nuk mund të vihet shenja e barazimit ndërmjet standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe standardit të të dhënave të mjaftueshme për marrjen të pandehur. Në këtë drejtim, mund të thuhet se niveli i provueshmërisë që nevojitet për marrjen e një personi si të pandehur është disi më i lartë se dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, që kërkohet në caktimin e masave të sigurimit, por gjithsesi, ky dallimi më së shumti i referohet aspektit sasior sesa cilësor. Doktrina jonë e procedurës penale[284], kur arsyeton standardin e të dhënave të mjaftueshme për marrjen e një personi të pandehur, jep pothuaj të njëjtin definicion ashtu si për dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, duke mos bërë në këtë drejtim asnjë dallim për sa i përket nivelit të provueshmërisë që duhet të përligjë kryerjen e këtij veprimi. Standardi i të dhënave të mjaftueshme për marrjen si i pandehur krahasohet nga një pjesë tjetër e doktrinës me standardin që parashikohet për dërgimin e çështjes në gjyq[285]. Për këtë të fundit, në nenin 331/1 të KPrP theksohet se prokurori e dërgon çështjen në gjyq kur ka *prova të plota për fajësinë*. Standardi i *të dhënave të mjaftueshme* është i ndryshëm edhe nga ai që kërkohet për dërgimin e çështjes në gjyq.

Për zbatimin e drejtë të standardit të të dhënave të mjaftueshme prokurori duhet të ketë parasysh disa kritere:

1. Të mos ketë dyshime se fakti penal ka ndodhur dhe ai është kryer nga një subjekt i caktuar,

2. Në ngarkim të këtij subjekti të jenë administruar të dhëna të mjaftueshme që i japin mundësinë prokurorit për të ngritur formalisht akuzë.

Këto kushte janë të lidhura me njëra – tjetrën dhe mungesa vetëm e njërit prej tyre bën që vendimi i prokurorit për marrjen e një personi si të pandehur, të jetë i padrejtë dhe i pabazuar në ligj. KPrP nuk përcakton tërësinë e provave që lejojnë dhe bëjnë të

---

[282] Dr.Jorgo Dhrami, vepër e cituar, fq. 47.
[283] Izet Hoxha, 'Bazat për marrjen e një personi në përgjegjësi penale', Tribunë Juridike, Nr.21, Viti i III i botimit, 1998, fq. 24-25.
[284] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura Penale, Botimet Morava, Tiranë, 2007, fq. 356 dhe 134.
[285] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 217.

bazuar ligjërisht marrjen e një personi të caktuar me cilësinë e të pandehurit. Lidhur me kuptimin e standardit, meqenëse KPP-ja nuk përcakton quantum-in e provave që shërbejnë ose duhet të shërbejnë për ta mbështetur në ligj marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit, në literaturën juridike janë shfaqur mendime e qëndrime të ndryshme.

a. Sipas një pikëpamjeje, organi i procedimit penal duhet të vendosë marrjen e një personi si të pandehur vetëm kur rreth këtij personi ai ka krijuar një bindje të plotë mbi fajësinë e tij, dmth., kur provat e administruara krijojnë bindje për fajësinë e tij; të dhënat e tjera që do të grumbullohen gjatë vazhdimit të mëtejshëm të hetimeve, nuk do të ndikojnë në krijimin e kësaj bindjeje për fajësinë e të pandehurit, ato vetëm do të jenë plotësuese që në asnjë mënyrë nuk mund të përgenjeshtrojnë bindjen e organit të procedimit e cila mbetet e pandryshuar. Pra, marrja e një personi si i pandehur kushtëzohet me krijimin e një situate të tillë hetimore, ku fajësia e tij të jetë e sigurtë, që çdo hetimi i mëtejshëm të mos e lëkundë ose rrëzojë këtë. Rrjedhimisht, pa u krijuar kjo sitiuatë hetimore, organi i procedimit (prokurori) nuk duhet ta marrë një person të caktuar si të pandehur.
b. Sipas pikëpamjes së dytë, me prova të mjaftueshme kuptohet rasti kur këto prova duhet të jenë nga burime të besueshme dhe të kontrolluara dhe, mbi bazën e tyre, mund të arrihet mendimi se veprën penale duhet ta ketë kryer i pandehuri. Me një fjalë, sipas kësaj pikëpamjeje, bindja e organit të procedimit nuk ka karakter përfundimtar, por paraprak. Autorët e kësaj pikëpamjeje argumentojnë mendimin e tyre me faktin se, nëse në këtë fazë të hetimeve do të pranohet bindja përfundimtare e organit të procedimit, në këtë rast do të mungojë objektiviteti në kryerjen e veprimeve hetimore, sepse çështjen e ka paragjykuar, prandaj dhe nuk mund të kërkojë të arrijë në një përfundim të ndryshëm nga i pari
c. Veç këtyre, ka edhe një pikëpamje të tretë, ajo e probabilitetit, çka nënkupton të gjitha provat krijojnë jo bindjen e plotë, por një shkallë të lartë dhe të arsyetuar probabiliteti, se personi i hetuar e ka kryer veprën penale. Mbetet që shkalla e sigurisë probabël të arritur në këtë fazë të verifikohet gjatë debatit kontradiktor në shqyrtimit gjyqësor.

Mendoj që pikëpamja e dytë dhe e tretë janë pikëpamje që japin një kuptim të drejtë të standardit të të dhënave të mjaftueshme për marrjen e personit si i pandehur. Bindja e prokurorit në këtë rast ka karakter probabilitar. Personi i marrë si i pandehur ka mundësitë më të mëdha të jetë autori i veprës penale. Nuk mund të pritet në këtë fazë të procedimit siguria absolute se i pandehuri është autori i veprës penale. Mund të ndodhë që pas marrjes si të pandehur të zbulohen në linjën e hetimit, prova të tjera të cilat rrëzojnë akuzën në ngarkim të të pandehurit ose hedhin dyshime mbi të. Në këtë kuptim, në këtë fazë mendoj se kemi të bëjmë me një konstatim paraprak të prokurorit mbi mundësinë që i pandehuri të jetë autori. Marrja e personit me cilësinë e të pandehurit nuk e ndërpret procesin e të provuarit, mbledhjen, verifikimin dhe çmuarjen e provave. Përkundrazi, ai është një proces në vazhdimësi, që realizohet pa asnjë kufizim gjatë gjithë fazës së hetimit të çështjes. Kuptimi i këtij standardi afron me kuptimin dhe përmbajtjen e standardit të dyshimit të arsyeshëm. Mendoj se, në thelb edhe standardi i të dhënave të mjaftueshme për marrjen si i pandehur është një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova, përderisa bindja paraprake e prokuorit ka karakter probabilitar. Megjithatë, në këtë rast dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova është i një shkalle vërtetësie më të madhe se ai që aplikohet në masat e sigurimit, pasi,

jo vetëm aspekti kuantitativ, por edhe kualitativ i provave është i një shkalle më të avancuar dhe nëpërmjet tyre synohet të provohet përgjegjësia penale e të pandehurit. Mendimi që, për të dhënat e mjaftueshme kemi të bëjmë me një dyshim të arsyeshëm, mbështetet edhe nga fakti që cilësia e të pandehurit ruhet deri në fund të procesit deri sa vendimi i gjykatës merr formë të prerë.

3.4.2 Kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq

Duke qenë se në KPrP, me reformën legjislative të vitit 2017 është parashikuar figura e gjyqtarit të seancës paraprake, i cili ka si objekt shqyrtimin e kërkesave të prokurorit në përfundim të hetimeve paraprake për pushimin e çështjes ose dërgimin në gjykim, e vlerësojmë të nevojshme të paraqesim standardin e të provuarit që aplikohej në momentin e dërgimit të çështjes në gjyq me vendim dhe kërkesë të prokurorit, përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, për të krahasuar nëse me ndryshimet aktuale jemi në kushtet e standardeve të njëjta të të provuarit apo ato janë të ndryshme.

Përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, në lidhje me momentin e dërgimit të çështjes në gjyq, në nenin 331/1 të KPrP parashikohej se: "*Kur ka prova të plota për fajësinë e të pandehurit, prokurori paraqet kërkesën për gjykimin e çështjes"*. Siç rezultonte, standardi që duhet të plotësohej për dërgimin në gjyq të çështjes penale, ishte ekzistenca e provave të plota për fajësinë e të pandehurit. Më sipër, gjatë trajtimit të standardit për marrjen e një personi me cilësinë e të pandehurit është theksuar se *kur i pandehuri dërgohej në gjyq, hetimet kanë sqaruar në mënyrë përfundimtare qënien e veprës penale, kohën, vendin e mënyrën e kryerjes së saj, fajësinë e të pandehurit, motivet e qëllimet e autorit të veprës penale, rrethanat rënduese e lehtësuese, pasojat e veprës penale, pretendimet e të pandehurit kur ka patur të tilla.* Koncepti i të provuarit të fajësisë *me prova të plota* mund të konsiderohej i diskutueshëm nëse përbënte një koncept të përdorur në mënyrë të përshtatshme në atë fazë të procedimit penal, pra kur dërgohej çështja për gjykim, meqenëse fajësia vërtetohet në gjykimin e themelit nga organi që jep drejtësi – gjykata, dhe jo në hetimet paraprake, qoftë edhe në momentin e përfundimit të tyre.

Kjo mund të dukej me të vërtetë problematike, megjithatë qëllimi i ligjvënësit nuk dukej të kishte qenë kurrsesi akordimi ndaj prokurorit të pushtetit të dhënies së drejtësisë. Sipas gjykimit tim, interpretimi i duhur dhe pajtues i kësaj dispozite, edhe me normat e tjera të procedurës penale dhe ato kushtetuese, ka qenë se prokurori duhet të dërgojë të pandehurin në gjyq, vetëm nëse ai kishte sigurinë se bazuar në provat e mbledhura, kishte vend që akuzat të merreshin në shqyrtim nga gjykata dhe ekzistonin mundësitë që pandehuri të shpallej fajtor në përfundim të gjykimit. Kjo siguri bazohej në tërësinë e provave që prokurori kishte mbledhur përgjatë fazës së hetimeve paraprake. Nëse prokurori nuk ishte i bindur për fajësinë e të pandehurit apo kishte dyshime në lidhje me të, konform neneve 327/2 dhe 328 të KPrP, të pandryshuar me ligjin nr. 35/2017, prokurori duhet të vendoste pushimin e çështjes. Kishim të bënim në atë rast më një çmim apo vlerësim të prokurorit, i cili për sa i takonte atij, konsiderohej çmim përfundimtar, megjithatë, kjo nuk ndikonte gjykatën në vlerësimin e saj përfundimtar mbi çështjen, të cilin e arrin pas zhvillimit të debatit kontradiktor ndërmjet palëve në proces. Fajësia vendoset në gjykim dhe prokurori ka barrën e të provuarit të saj para gjykatës.

Standardi i aplikuar për dërgimin e çështjes në gjyq ishte i ndryshëm nga ai i të dhënave të mjaftueshme për marrjen si të pandehur, pasi midis momentit të vendimit për marrjen e një personi si i pandehur, me atë të dërgimit në gjyq, në pikëpamje të masës së provave kishte një ndryshim. Ligji parashikonte ekzistencën e provave të plota për dërgimin në gjyq të çështjes. Ndërkohë, në rastin e marrjes së personit me cilësinë e të pandehurit, ligji nuk kërkon një standard të një niveli kaq të lartë. Nga interpretimi i nenit 331/1 të KPrP të pandryshuar, rezultonte se prokurori dërgonte çështjen për gjykim kur kishte sqaruar përfundimisht sipas bindjes së tij:

* Kryerjen ose jo të veprës penale me të gjithë përbërësit e saj (kohën, vendin, mënyrat e rrethanat e tjera) që kanë ndjekur kryerjen e veprës penale.
* Fajësinë e personit lidhur me veprën që është akuzuar ose që do të akuzohet.
* Shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e tij.
* Pasojat e ardhura nga vepra penale.

Vërtetimi i këtyre rrethanave ishte i domosdoshëm për të krijuar një përfundim të saktë e bindës. Megjithatë, pavarësisht krijimit të bindjes së plotë mbi fajësinë e të pandehurit për dërgimin e tij në gjyq, respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë së të pandehurit, në kuptimin e garantimit të të pandehurit të gjitha të drejtave që i njihen ligji dhe Kushtetuta, pa paragjykimin e fajësisë së tij, përbën një detyrim të përhershëm për prokurorin.

Me ndryshimet e kryera me ligjin nr. 35/2017, me ripërcaktimin e kompetencave të prokurorit dhe ndërfutjen e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, standardi i mësipërm i të provuarit që duhet të shoqëronte e argumentonte kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes, është vlerësuar jo i përshtatshëm ose i panevojshëm nga ligjvënësi.

Megjithatë, me qëllim studimin e standardeve të të provuarit që operojnë në këtë fazë është e nevojshme të analizohet roli dhe kompetencat e prokurorit në përfundimin e hetimeve paraprake dhe paraqitjen e kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim, si edhe roli dhe kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake në vendimmarrjen lidhur me kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim.

Aktualisht, në nenin 331 të KPrP të ndryshuar nuk parashikohet ndonjë standard të provuari që duhet të përmbushet nga prokurori. Kjo dispozitë në përmbajtje të saj, ndër të tjera, kërkon që prokurori të ketë respektuar normat përkatëse gjatë përfundimit të hetimeve sipas nenit 327 të KPrP, por edhe në këtë dispozitë të fundit nuk përcaktohet ndonjë standard të provuari. Sipas gjykimit tim, në mënyrë implicite mund të deduktohet nga dispozitat e neneve 332/c/2 dhe 332/ç, që prokurori duhet të ketë kryer hetime të plota dhe në seancë paraprake duhet të paraqesë rezultatet e hetimeve paraprake dhe provat ku mbështetet kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Megjithatë, duhet të jemi të vetdijshëm se vetëm këto parashikime, të pakordinuara ndërmjet tyre edhe me standardin e të provuarit në këtë fazë, janë të pamjaftueshme për të deduktuar me saktësi nëse jemi përpara një standardi të të provuari apo thjesht përpara detyrimeve normale, të zakonshme, procedurale të prokurorit. Standardi i të provuarit ka efekte procedurale, por nga pikëpamja e përmbajtjes së tij, ai i referohet shkallës bindëse që reflektojnë provat, në këtë kuptim ai synon argumentimin e një lidhje racionale ndërmjet fakteve të çështjes dhe provave që i vërtetojnë ato. Ndërsa, parashikimet e mësipërme duket të jenë qartësisht procedurale, pa ndonjë efekt në arsyetimin e lidhjes racionale ndërmjet fakteve dhe provave. Kjo passjell një situatë

paradoksale ku '*hetimi i plotë, apo paraqitja e rezultateve të hetimeve paraprake dhe provat ku mbështetet kërkesa'*, nuk nënkuptojnë domosdoshmërisht edhe ekzistencën e përfundimeve logjike/të arsyeshme lidhur me konstatimet e prokurorit për faktet penale dhe autorësinë e tyre. Karakteri logjik i përfundimeve arrihet atëherë nëse ato janë të tilla që përmbushin ose tejkalojnë një standard të caktuar të provuari, çka në rastin konkret nuk ekziston. Efektet në praktikë të një mangësie apo problemi të tillë mund të diktojnë cilësinë e hetimeve të prokurorëve dhe ta shndërrojnë procesin e hetimit në një proces të thjeshtë mekanik të mbledhjes dhe grumbullimit të të dhënave provuese, dhe jo një proces logjik të analizës së tyre. Në këtë drejtim, me modesti do të sugjeroja, që në rast të nismave legjislative të mundshme, kjo çështje duhet të diskutohet sërish në harmoni edhe me kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake lidhur me kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes për gjykim.

Megjithatë, analiza e mësipërme përbën vetëm njërën anë të medaljes, pra, të rolit të prokurorit në seancën paraprake, nga ana tjetër, me rëndësi është edhe evidentimi i standardit të të provuarit që i kërkohet gjyqtarit të seancës paraprake për të aplikuar në rastin e pranimit të kërkesës për dërgimin e çështjes në gjykim. Në nenin 332/dh/1/a të KPrP është përcaktuar se gjykata vendos pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin e çështjes në gjyq, kur çmon se ka ***prova të mjaftueshme në mbështetje të akuzës***. Edhe pse ky standard i referohet shkallës apo nivelit të bindjes që duhet të ekzistojë te gjykata në seancë paraprake në momentin e vendimmarrjes për dërgimin e çështjes në gjyq, gjykoj se ky standard duket të jetë i zbatueshëm edhe për prokurorin në momentin e paraqitjes së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq.

Edhe nëse ky arsyetim do të konsiderohet i përshtatshëm, diskutimi që lind pas tij, është raporti i përputhjes së këtij standardi me standardet e tjera në hetimet paraprake. Në gjykimin tim, në kushtet kur ligji nuk përcakton kritere për të dalluar se kur do të konsiderohet i përmbushur ky standard, ai duhet të konsiderohet se është i një shkalle më të lartë sigurie e vërtetësie se standardet e tjera të hetimit paraprak, duke marrë në konsideratë logjikën e zhvillimit të hetimeve paraprake, që është dinamike nga momenti i regjistrimit të çështjes penale. Megjithatë, ky standard të provuari nuk duhet të barazohet me standardin që aplikohet në gjykimin e çështjes "*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*" dhe që është i detyrueshëm për t'u zbatuar në rastin e konstatimit të fajësisë së të pandehurit.

Aplikimi në seancën paraprake i një standardi të provuari të një niveli apo shkalle bindje më të ulët se në gjykimin e themelit të çështjes, duhet parë lidhur ngushtë edhe me kompetencat që duhet të ketë gjyqtari i seancës paraprake. Në këtë kuptim, aplikimi i një standardi të tillë argumenton edhe faktin se kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake nuk mund të jenë ato që i takojnë ato të gjyqtarit të themelit të çështjes. Kjo do të thotë se kompetencat e verifikimit dhe vlerësimit të gjyqtarit të seancës paraprake duhet të kufizohen në shqyrtimin e plotësisë së hetimeve me të dhënat/provat që justifikojnë elementët faktikë dhe juridikë të përgjegjësisë penale të një individ (akuza). Sipas gjykimit tim, në këtë fazë nuk duhet verifikuar themeltësia dhe bazueshmëria e akuzës ndaj të pandehurit nga pikëpamja materiale, por fakti nëse nga pikëpamja formale janë kryer hetimet e plota, pra, janë administruar të dhënat e nevojshme e të mjaftueshme, të cilat konfirmojnë lidhjen e arsyeshme ndërmjet tyre dhe akuzës së ngritur nga prokurori. Interpretimi ndryshe lidhur me këtë, do të passillte një situatë jo logjike, pasi do t'i atribuoheshin në këtë mënyrë gjyqtarit të seancës paraprake kompetenca po aq të gjera sa gjyqtarit të themelit të çështjes. Por përtej kësaj, kjo do të

përbënte cenim të disa parimeve, siç është prezumimi i pafajësisë, standardi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe kontradiktoritetit. Pra, nëse gjyqtari i seancës paraprake do të gëzonte kompetencën për të kryer një vlerësim thelbësor të akuzës së ngritur nga prokurori, atëherë do të gjykohej mbi fajësinë e të pandehurit, me një standard më të ulët të provuari se ai i gjykimit të themelit të çështjes dhe pa një proces kontradiktor. Gjykimi i seancës paraprake karakterizohet nga parimi i oralitetit, por mungon kontradiktoriteti lidhur me debatin mbi provat (nuk pyeten dëshmitarë, ekspertë etj).

Në praktikë, ky dallim është i vështirë për t'u kryer dhe shpeshherë gjykatat në seancë paraprake përpiqen ta orientojnë procesin në provueshmërinë e akuzës ndaj të pandehurit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke synuar në një kuptim përcaktimin e fajësisë që në këtë fazë. Sipas mendimit tim, një ndër problematikat që është e vështirë për të gjetur një kuptim të drejtë është efekti që paraqet koncepti i hetimeve të plota në përmbushjen e standardit që përcakton ligji - *provat e mjaftueshme në mbështetje të akuzës*. Nevoja për hetime të plota përbën një detyrim të vazhdueshëm të prokurorit edhe përpara se çështja të dërgohet përpara gjyqtarit të seancës paraprake dhe nuk ka lidhje me faktin nëse çështja është e destinuar për gjykim apo për t'u pushuar. Në çdo rast është e padiskutueshme që hetimet duhet të karakterizohen nga plotësia. Për këtë arsye, vlerësoj se ***kryerja e hetimeve të plota nga prokurori e nënkupton përmbushjen e standardit që kërkohet nga ligji për ekzistencën e provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, natyrisht me kushtin që, në këtë rast, plotësia e hetimeve i referohet kryerjes së atyre hetimeve që kanë lidhje me elementët e veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri***. Nëse hetimet e kryera nuk i përmbahen këtij objekti, atëherë nga pikëpamja procedurale nuk gjendemi përpara hetimeve të plota dhe rrjedhimisht të dhënat e administruara, që nuk përfaqësojnë një lidhje racionale me veprën penale për të cilën është hetuar, nuk e përmbushin standardin e *provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës.*

Sa i përket kompetencave të gjyqtarit të seancës paraprake, në rastin e vlerësimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, Gjykata e Lartë ka shprehur se*: Në seancën paraprake, gjyqtari duhet të verifikojë **nëse nga organi procedues janë kryer hetimet e plota**, **nuk ka nevojë për marrjen e provave të tjera**, **nuk kemi pavlefshmëri apo papërdoshmëri të provave, a janë respektuar të drejtat e të pandehurve apo viktimës nga vepra penale** etj. Ratio legis e nenit 332/dh të KPP-së shqiptare është garantimi i hetimeve të plota. Legjislatori me anë të kësaj dispozite i ka dhënë gjyqtarit të seancës paraprake, jo vetëm ushtrimin e "kontrollit" dhe "filtrit" të hetimeve paraprake, por njëkohësisht, **ai bën verifikimin nëse kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq ka elemente të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjykim**. Nëse gjyqtari i seancës paraprake konstaton se akuza nuk është e plotë përcakton drejtimet e hetimeve dhe provat që duhet të ribëhen.*[286]

Sa i përket mënyrës së ushtrimit të kompetencave të mësipërme, që nënkupton njëkohësisht edhe kufijtë e ushtrimit të këtyre kompetencave dhe përmbajtjen e standardit të të provuarit të vendimmarrjes dhe qendrimit të gjykatës së seancës paraprake, Gjykata e Lartë ka shprehur se: *Detyra e gjyqtarit të seancës paraprake është që në prani të burimit të provave që i paraqiten të limitohet të verifikojë nëse në situatën në të cilën ndodhen aktet, mund të kalohet çështja në gjyq,* **pa bërë vlerësime**

---

[286] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-121 i Vendimit (37), datë 28.01.2022, –pg.*51-52*

thelbësore që i takojnë fazës së gjykimit. *Gjyqtari i seancës paraprake* ***nuk mund të bëjë një vlerësim më të thellë se ai që kërkohet për seancën paraprake****, si dhe* ***nuk mund të hyjë në çështje të të vlerësuarit të provave e çmuarjes së tyre në kuptim të të provuarit*** *vlerësim që bëhet në kontradiktoritet e debat gjyqësor që është karakteristikë e gjykimit në themel të çështjes.*[287] Prej këtij arsyetimi, rrjedh edhe fakti se standardi i aplikuar në gjykimin në seancë paraprake, nuk duhet të barazohet me standardin e gjykimit të themelit për përcaktimin e fajësisë së të pandehurit. Nga interpretimi i neneve 332/ç, 332/dh, 328, 390 të KPP rezulton se gjyqtari i seancës paraprake konstaton vetëm nëse provat janë të mjaftueshme për të mbështetur akuzën, por jo nëse provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësia e të pandehurit, pasi ky vlerësim bëhet nga gjyqtari që shqyrton çështjen penale në ngarkim të të pandehurit. Qendrimi i mësipërm është konfirmuar edhe në vendimmarrje të tjera të Gjykatës së Lartë, në të cilat është konstatuar *shkelje e dispozitave procedurale që rregullojnë rolin e gjyqtarit të seancës paraprake*, kur ky i fundit bën vlerësim të provave "përtej çdo dyshimi të arsyeshëm", për shkak se merr kompetencat e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen në themel.[288]

Interpretimet e mësipërme passjellin disa implikime të rëndësishme edhe për mënyrën se si duhet ushtruar kompetenca e gjykatës për pushimin e çështjes, gjatë vlerësimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas nenit 332/dh të K.Pr.Penale gjyqtari i seancës paraprake pasi shqyrton kërkesën e prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq ka të drejtën e pushimit të akuzës ose të çështjes penale në rast se vërtetohen rastet e parashikuara nga neni 328 paragrafi i parë i KPrP. Fakti që standardi i aplikuar në seancën paraprake është i një shkalle më të ulët provueshmërie se ai i gjykimit të themelit, e nënkupton që mund të ekzistojnë edhe dyshime të arsyeshme mbi themeltësinë e akuzës në gjykim, pra, që ospioni që i pandehuri mund të deklarohet i pafajshëm (ose të pushohet çështja sipas rastit) është i mundshëm. Për rrjedhojë, duke qenë se edhe përcaktimi i pafajësisë është kompetencë e gjykatës së themelit, e cila vlerëson pasi analizon standardin e përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjyqtari i seancës paraprake është i kufizuar në arsyetimin e pushimit të çështjes, kur si bazë e këtij arsyetimi është provueshmëria e veprës penale, për shkak se në seancën paraprake nuk kërkohet të përjashtohen dyshimet e arsyeshme lidhur me vërtetimin dhe bazueshmërinë e akuzës. Dyshimet e arsyeshme duhet të përjashtohen në momentin e aplikimit të standardit të gjykimit të themelit, për shkak se vetem në këtë mënyrë mund konstatohet fajësia e të pandehurit, por nuk kërkohet që këto dyshime të përjashtohen edhe në seancë paraprake, për shkak se në një rast të tillë standardet e seancës paraprake dhe gjykimit të themelit do të barazoheshin ndërmjet tyre. Këtij argumenti i shërben dhe arsyetimi i mëposhtëm i Gjykatës së Lartë, sipas së cilës: *"Përshtatshmëria e materialit provues te paraqitur nga Prokurori, për të mbështetur gjykimin e kërkesës – akuzës së kontestuar të pandehurit – përpara gjykatës (gjyqtarit natyral dhe neutral) se gjykimit të çështjes në themel, në prezencë të debatit dhe të kontradiktoritetit të palëve, kërkohet, sipas përcaktimit të gërmës "a", të paragrafit të parë, të nenit 332/dh te K.Pr.Penale, në nivelin – standardin provues – të mjaftueshmërisë (suficencës), gjë që presupozon pranueshmërinë e kërkesës së Prokurorit për gjykimin e çështjes edhe në kushtet e prezencës, në përbërje të këtij materiali, edhe* ***të provave të karakterit kontradiktor***.*"*[289]

---

[287] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-121 i Vendimit (37), datë 28.01.2022, –pg.*55-56*
[288] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. *00-2022-1189 datë 29.09.2022, pg.15*
[289] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-978 i Vendimit (215), datë 26.07.2022, pg.18

Pikërisht, lidhur me kompetencën e gjyqtarit të seancës paraprake për të vendosur pushimin e çështjes, pas vlerësimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë **ka shprehur se**: *Gjyqtari i seancës paraprake mund të pushojë akuzën kur del qartë që fakti nuk ekziston ose kur nga pikëpamja e kontrollit të hetimeve nga ana e tij rezulton se prokurori që kërkon dërgimin e çështjes në gjykim, nuk ka sjellë prova që lidhen me të pandehurin, duke bërë një numërtim përkatës të provave, ose provat që ka sjellë nuk janë të tilla që në raport me këtë të pandehur në gjykim më tej të japin ndonjë të dhënë për fakte objekt akuze lidhur me këtë person.* ***Por, gjyqtari i seancës paraprake nuk mund t'i hyjë vlerësimit të provave, të vlerës së tyre në raport me faktin apo fajësinë apo vlerës së tyre në raport me prova të tjera, pasi kjo mund të bëhet vetëm në seancë gjyqsore të gjykimit të themelit të çështjes në kushtet e debatit gjyqësor e kontradiktoritetit.***[290]

Duke qenë se në rastin e vendimmarrjes së pushimit të çështjes sipas nenit 328/1 të KPrP, gjykatës në seancë paraprake i duhet të arsyetojë lidhur me provueshmërinë e veprës penale, duke kryer në këtë mënyrë vlerësim të provave (psh. nëse nuk provohet kryerja e veprës penale ose nëse nuk provohet që vepra penale të jetë kryer nga i pandehuri), duket se ka një mospërputhje ndërmjet kësaj dispozite dhe kompetencës së "pakufizuar" për të vendosur pushimin e çështjes në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim (neni 332/dh/1, germa "ç"), me faktin që gjyqtari i seancës paraprake është i kufizuar në vlerësimin e provueshmërisë së veprës penale. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: ***Gjyqtari i seancës paraprake, referuar nenit 328, pika 1, germa "dh" të KPP, mund të vendosë pushimin e çështjes, <u>vetëm kur prima facia</u> del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale ose nuk provohet që e ka kryer ai***[291]**.** Ky arsyetim i Gjykatës së Lartë përcakton se pushimi i çështjes mund të vendoset nga gjykata në seancë vetëm në raste përjashtimore, kur rezulton qartësisht shkaku i pushimit dhe për këtë nuk është e nevojshme kryerja e hetimeve të mëtejshme. Në një vendimmarrje tjetër të Gjykatës së Lartë konfrmohet se pushimi i çështjes nga gjyqtari i seancës paraprake mund të vendoset: (...) *vetëm në kushtet e verifikimit* ***qartazi*** *(përcaktimi i gërmës "a" të paragrafit të parë të nenit 328 të K.Pr.Penale, i vlefshëm me cilësinë e standartit provues edhe për përcaktimet e parashikuara në germat e tjera të kësaj dispozite))* ***haptazi – ictu oculi*** *– (me një veshtrim të parë) pa nevojën e hetimeve dhe të verifikimeve shtesë dhe, aq më teper, te atyre te thelluara, sikurse ne rastin konkret,* ***<u>të inekzistences se faktit penal</u>***.[292]

3.4.3 Kërkesa e prokurorit drejtuar gjyqtarit të seancës paraprake për pushimin e çështjes

Arsyetimet e mësipërme lidhur me mundësinë e disponimit të gjyqtarit të seancës paraprake me pushimin e çështjes penale gjatë shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjykim, sipas gjykimit tim, janë të diskutueshme nëse janë ose jo të aplikueshme edhe në rastet kur kërkesa e prokurorit është pushimi i çështjes sipas nenit 329/a të KPrP.

---

[290] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-121 i Vendimit (37), datë 28.01.2022, –pg.57
[291] Vendim i Gjykatës së Lartë nr.00-2022- 1189 i Vendimit, datë 29.09.2022, pg. 15
[292] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-978 i Vendimit (215), datë 26.07.2022, pg.19

Diskutimi qendron në faktin nëse pushimi i procedimit penal do të kërkohet vetëm në rastet kur *prima facia* rezulton një shkaqet e pushimit sipas nenit 328 të KPrP apo edhe në rastet kur nga verifikimi i provueshmërisë së çështjes rezultojnë dyshime të arsyeshme lidhur me përgjegjësinë penale të personit nën hetim, e për rrjedhojë këto do të interpretohen në favor të tij. Për të arritur në një përfundim, paraprakisht mund të thuhet se dhe në rastet e kërkesave për pushim, kërkesë imperative e ligjit duket të jetë plotësia e hetimeve. Kjo rezulton nga interpretimi logjik i neneve 329/3/b dhe 329/b/3, ku përcaktohet se gjyqtari i seancës paraprake i kthen aktet prokurorit kur çmon se hetimet janë të paplota. Megjithatë, sipas mendimit tim, nëse në kërkesën për gjykim, gjyqtari i seancës paraprake është i kufizuar në vlerësimin e provueshmërisë sa i përket faktit penal dhe autorësisë së tyre, në shqyrtimin e kërkesës për pushimin, gjyqtari i seancës paraprake duhet të kryejë pikërisht operacionin e kundërt, pra, të vlerësojë provueshmërinë e faktit penal dhe autorësisë së tij, pasi përndryshe duket se pa një veprimtari të tillë vendimmarrja mbi kërkesën e pushimit është e pamundur. Por përpos kësaj, mund të interpretohet se një gjë e tillë imponohet edhe nga formulat e pushimit të parashikuara në nenin 328 të KPrP, ku veçojmë rastet e pushimit: *a) del qartë se fakti nuk ekziston; b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale; dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai.*

Nga kjo analizë mund të deduktohet se mënyra e procedimit të gjyqtarit të seancës paraprake (gjatë kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq ose për pushim) është e kushtëzuar nga natyra e kërkesës së prokurorit. Në kërkesën për pushim objekti i shqyrtimit është vërtetimi i mungesës së elementëve që përbëjnë faktin penal apo që e përjashtojnë të pandehurin nga përgjegjësia penale. Duke qenë se standardi i aplikuar në rastin e dërgimit të çështjes në gjykim nuk përfaqëson standardin më të lartë të procesit penal, duke nënkuptuar se pranohen edhe dyshimet e arsyeshme rreth këtij standardi (pra që i referohen mundësisë që fakti penal nuk është i tillë si ai i përshkruar nga prokurori apo se i pandehuri ka rrethana që mund ta përjashtojnë nga përgjegjësia penale), prej kësaj rrjedh se kërkesa për pushimin e procedimit penal nuk mund të bazohet/pranohet mbi dyshime të arsyeshme në favor të të pandehurit, për shkak se në një rast të tillë çështja mund të ndodhë që të ketë njëkohësisht mjaftueshmërisht prova për t'u dërguar në gjykim, çka passjell që shkaqet e pushimit duhet të provohen me një standard relativisht të lartë të të provuari, në mos të provohen katërcipërisht. I gjithë diskutimi i mësipërm, edhe pse ndjek një linjë racionale arsyetimi, shtron në mënyrë të padiskutueshme nevojën për të reflektuar lidhur me zbatimin e parimit *in dubio pro reo* në seancë paraprake, i cili qartazi nuk gjen aplikim në mënyrën se si është ndërtuar kjo pjesë e KPrP. Duket se në përputhje me nenin 4 të KPrP parimi shërben ekskluzivisht në gjykimin e themelit të çështjes. Lidhur me çështjen e kompetencave të gjyqtarit të seancës paraprake në shqyrtimin e kërkesës për pushim, autori Andi Duraj, në disertacionin e tij, shprehet se: "*Prerogativat vendimmarrëse te gjyqtarit të seancës paraprake përputhen me ato të gjyqtarit të themelit (giudice del dibatimento), pasi formulat që i japin fund procesit, mbi të cilat vendoset lirimi nga akuzat për shkak se ka prova që shkarkojnë përgjegjësinë penale, ose sepse nuk ka prova që e ngarkojnë me përgjegjësi penale ose provat në ngarkim janë kontradiktore, janë të aplikueshme edhe në këtë fazë. Kjo përputhje merr në konsideratë edhe fushën e ndryshme të njohjes që i është rezervuar njërit dhe tjetrit gjyqtar.*[293] Ky është një arsyetim që

[293] Andi Duraj, Roli i gjykatës në fazat që paraprijnë gjykimin e themeli në procediminn penal, Disertacion, UET, Tiranë, Janar 2021, fq. 149, vep.e cituar M.Ferraioli, "Manuale di Diritto Processuale Penale" Settima edizione, Cedam, Padova 2010

mbështet qendrimin e mësipërm se standardi i të provuarit gjatë gjykimit të kërkesës për pushimin e procedimit penal duhet të jetë i një shkalle relativisht të lartë bindjeje, duke marrë në konsideratë, megjithatë, kompetencat e ndryshme të gjykatave përkatëse (seancë paraprake dhe themeli).

Diskutimi i mësipërm lind pikërisht për shkak të faktit që ligjvënësi ka ripërcaktuar kompetencat e prokurorit në hetimin paraprak, në drejtim të kufizimit të tyre në fazën përmbyllëse të hetimit, duke hequr disa kompetenca thelbësore vendimmarrëse: dërgimin në gjyq dhe vendimin e pushimit të procedimit (për krimet) duke i parashikuar ato si kompetenca të gjyqtarit të seancës paraprake. Përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, standardi i përcaktuar nga ligjvënësi për dërgimin e çështjes në gjyq, ai i *provave të plota për fajësinë e të pandehurit* ishte i krahasueshëm me standardin e themelit të çështjes përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për këtë arsye, parimi *in dubio pro reo* gjente me të drejtë vend në arsyetimet e prokurorëve edhe në rastet e vendimeve të pushimit të procedimit penal, për shkak se dyshimet e arsyeshme lidhur me faktet/rrethanat që përbënin shkak për pushimin e procedimit e përjashtonin standardin e provave të plota për fajësinë për dërgimin e çështjes në gjykim, në ndryshim nga standardi aktual i provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, i cili bashkëekziston me standardin/parimin e dyshimit të arsyeshëm.

Në jurisprudencën e saj të fundit, Gjykata e Lartë, lidhur me standardin e të provuarit në kërkesën për pushimin e procedimit penal, është shprehur se: "*Qëllimi i hetimeve të realizuara prej prokurorit dhe policisë gjyqësore në kuadrin e kompetencave të përcaktuara nga KPP është t'i lejojë të parit – prokurorit – "hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale" (neni 277/1 i KPP) domethënë, t'i tolerojë këtij të fundit zgjedhjen, midis "ushtrimit të ndjekjes penale" (nëpërmjet formulimit të akuzës, dhe kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq, në përfundim të hetimeve paraprake, neni 327 /6/1 i KPP) dhe* ***kërkesës për "pushimin e çështjes", neni 327/6/a i KPP, kjo e fundit, për tu paraqitur para gjyqtarit (të hetimeve paraprake) kur "njoftimi për veprën penale – notitia criminis", mbi bazën e të cilit është regjistruar procedimi penal, në konformitet me përcaktimet e nenit 287/1 të KPP dhe legjitimuar këto hetime, konsiderohet i pathemeltë, "sepse elementët e provës, të mbledhur, gjatë hetimeve paraprake nuk rezultojnë të përshtatshëm (të mjaftueshëm) për të mbështetur akuzën në gjykim".***[294] Edhe pse në këtë përcaktim të Gjykatës së Lartë ka një lapsus lidhur me gjyqtarin, përpara të cilit paraqitet kërkesa për pushimin e procedimit penal, sa i përket standardit të të provuarit që aplikohet në gjykimin e kësaj kërkese, pavarësisht faktit se mungon një përcaktim në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhur me këtë çështje, mund të thuhet se qendrimi i Gjykatës së Lartë mbështet idenë që kërkesa për pushim ka vend atëherë kur të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake nuk rezultojnë të mjaftueshme për mbështetur akuzën në gjykim, çka më tej shërben për të dalë në përfundimin që standardi i aplikuar në këtë proces duhet të jetë i një niveli më bindës se dyshimi i arsyeshëm lidhur me ekzistencën e shkaqeve të pushimit të procedimit. Në këtë arsyetim duhet të mbahet në konsideratë dhe të ritheksohet se nuk diskutohet plotësia e hetimeve që duhet të kryhen nga prokurori, por forca bindëse që derivon prej këtyre hetimeve.

---

[294] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. **00-2022-413 i Vendimit (74), datë 01.03.2022, pg. 36**

Nga analiza e mësipërme, sipas gjykimit tim, në ndryshim nga konceptimi i fazës së hetimit paraprak dhe përfundimit të kësaj faze, përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, ku kërkohej zbatimi i standardit të provave të plota për fajësinë e të pandehurit, aktualisht hetimi paraprak ka një karakter më probabilitar, që rrjedhimisht i transmetohet edhe gjykatës së themelit, duke e ngarkuar atë me detyrimin për të vendosur mbi probabilitetin e ekzistencës ose jo të fajësisë së të pandehurit. Në një kuptim tjetër, jo domosdoshmërisht të lidhur ngushtësisht me kuptimin procedural të procesit, por më shumë me oportunitetin e procesit penal, vlerësoj se është shpërndarë dhe relativizuar përgjegjësia e organeve proceduese (prokuroria dhe gjykata) në aspektin e zbatimit të duhur të legjislacionit penal. Nëse me reformën legjislative të vitit 2017, objektivi i dëshiruar nga ligjvënësi ka qenë padyshim minimizimi i gabimeve në procesin penal, përcaktimi i standardeve të të provuarit të niveleve të ulta në fazën e hetimit paraprak, shoqëruar me kompetenca jo të qarta të prokurorit dhe gjyqtarit të seancës paraprake, kanë gjasa që të kenë efektin e kundërt në praktikën gjyqësore.

3.5 Standardi i zbatueshëm në vendimmarrjet për kërkesat e palëve gjatë hetimeve paraprake

3.5.1 Përgjimi

Në KPrP nuk është parashikuar nocioni i përgjimit, megjithatë dispozitat përkatëse normojnë kushtet dhe kriteret për realizimin e tij, duke filluar me përcaktimin e veprave penale, për të cilat përdoret ky mjet i kërkimit të provës, objektin, mënyrën e kryerjes, mjetet, si edhe dokumentimin dhe ruajtjen. Nga pikëpamja procedurale, përgjimet janë mjet për kërkimin e provës të rregulluara nga nenet 221-226 të KPrP. Për nga karakteristikat që paraqet, përgjimi mund të përkufizohet si marrje informacioni dhe dijenie për përmbajtjen e bisedave, komunikimeve dhe veprimeve të kryera ndërmjet dy ose më shumë personave, të përftuara nga autoriteti shtetëror, i cili ndërhyn pa dijeninë e bashkëkomunikuesve.

Përgjimi si mjet për kërkimin e provës vendos përballë njëra–tjetrës dy interesa apo të drejta. Nga njëra anë, qendron e drejta për një jetë private, e njohur dhe e garantuar nga Kushtetuta dhe nga aktet e tjera me karakter ndërkombëtar, e cila është thelbësisht e cenueshme prej veprimit të përgjimit. Mbrojtja e jetës private, në Kushtetutën tonë, bëhet përmes disa dispozitave, veçanërisht nga neni 35 (mbrojtja e të dhënave personale), neni 36 (liria dhe fshehtësia e korrespondencës), neni 37 (paprekshmëria e banesës)[295]. Nga ana tjetër, qendron e drejta me karakter të përgjithshëm, që ka të bëjë me mbrojtjen e interesave të shoqerisë nga krimi, e cila është e lidhur njëkohësisht edhe me detyrimin e shtetit për të luftuar kriminalitetin. Kufizimi i së drejtës për jetë private me anë të veprimit të përgjimit, përbën një kufizim proporcional, të vendosur me ligj, në mbrojtje të interesit të shoqërisë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me nenin 17 të Kushtetutës[296].

---

[295] Urjana Çuri, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.Ndikimi i instrumenteve ligjore të BE-së dhe të akteve ndërkombëtare në legjislacionin e brendshëm që rregullon këtë të drejtë. Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore "doktor", Tiranë 2018, fq.51

[296] Neni 17 i Kushtetutës: "Kufizime të të drejtave dhelirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë

Për t'u rikthyer në normat procedurale penale, për shkak të të drejtave specifike që cenohen nga ky lloj mjeti për kërkimin e provës, ligjvënësi ka parashikuar një rezervë ligjore shumë strikte, e cila parashikon kushte të posaçme për lejimin dhe përdorimin e rezultateve të përgjimeve. *Së pari*, nga ligji procedural penal specifikohet se për cilat lloj veprash do të lejohet përgjimi dhe që janë:

1. Krime të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet;
2. Kundërvajtjet penale të fyerjes e të kanosjes, të kryera me mjete të telekomunikimit.
3. Për veprat penale të parashikuara nga shkronja "a", paragrafi 1, i nenit 75/a, të këtij Kodi (kompetencë e Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit).

Në nenin 221/2 parashikohet lejimi i përgjimeve në vende private duke specifikuar llojin e veprave penale, për të cilat parashikohet jo më pak se dy vjet burgim. Pra, përjashtohen kundërvajtjet penale dhe veprat penale të konsideruara jo të rënda. Po kështu, në legjislacionin procedural penal parshikohen në mënyrë specifike personat që mund të përgjohen dhe që janë: të dyshuarit për kryerjen e një vepre penale, personat që dyshohet se marrin ose transmetojnë komunikime nga i dyshuari; personat që marrin pjesë në transaksione me të dyshuarin si dhe personat, vëzhgimi i të cilëve mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të të dyshuarit. Ky mjet i kërkimit të provës duhet të jetë një përjashtim dhe jo një rregull. Kjo për shkak të së drejtës së rëndësishme që cenohet nga ky veprim hetimor.[297]

Së dyti, ligji e lidh këtë veprim hetimor me gjendjen në të cilën ndodhet procedimi. Neni 221/1 i KPP parashikon se akti lejohet atëhere kur:

- Përgjimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara;
- Kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale

Përpara ndryshimeve ligjore të prezantuara me ligjin nr. 35/2017, datë 30.3.2017, kjo dispozitë parshikonte se që të lejohej përgjimi, duhej që hetimet jo vetëm të kishin filluar, por të kishte dhe *prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën*. Ky ishte standardi kryesor ligjor që duhej të përmbushte prokurori, në mënyrë që kërkesa e tij të pranohej nga gjykata. Nga studimi i praktikës gjyqësore ka rezultuar se ky kusht, në formën e përcaktuar nga ligjvënësi, përgjithësisht nuk zbatohej, pasi në vendimet për lejimin e përgjimit, të vendosura nga gjykatat, nuk merrej në shqyrtim nëse kishte ose jo prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën. Pas ndryshimeve legjislative të vitit 2017, ligjvënësi ka adoptuar standardin që përgjithësisht shoqëron fazën e hetimeve paraprake, atë të *dyshimeve të arsyeshme të bazuara në prova*. Nga pikëpamja literale, por edhe nga aspekti thelbësor, diferenca ndërmjet të dy standardeve është e dukshme dhe dallon në fuqinë bindëse që kërkohet të reflektohet prej provave të administruara në faza të ndryshme të hetimit. Standardi i provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës i përngjet një niveli të avancuar të provueshmërisë së faktit penal. Nga pikëpamja literale me të kuptohet që paraprakisht akuza ka administruar të dhënat e

---

thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut".

[297] Arben Shehu, "Përgjimet si mjet i kërkimit të provës", Revista Studime Juridike, Nr.1, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, Dhjetor, 2010, fq. 234.

provat që e vërtetojnë akuzën e personit nën hetim/ të pandehurit dhe pas këtij procesi prokurori kërkon edhe kryerjen e veprimit të përgjimit. Në formën që shfaqej përbënte, ndër të tjera, dhe një problem me karakter logjik, pasi përkundër kësaj, prokuroria kërkonte lejimin e përgjimit nga gjykata, pikërisht në rastet kur deri në momentin konkret nuk kishte arritur të mblidhte provat e mjaftueshme për të vërtetuar akuzën dhe përgjimi synonte të ndihmonte në zhvillimin e hetimeve. Kontradikta logjike qendronte në faktin që parakushtet për dhënien e autorizimit ishin kontradiktore mes tyre: veç *"domosdoshmërisë për vazhdimin e hetimeve të filluara"* kërkoheshin edhe *"prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës"*[298]. Këto dy kushte përjashtonin njëri-tjetrin, sepse kur prokurori kishte prova të mjaftueshme nuk ishte i dosmosdoshëm vazhdimi i hetimeve dhe nuk kishte arsye pse të harxhohej kohë, mjete dhe para për të kryer përgjime të panevojshme.[299] Kjo kontradiktë u konstatua edhe në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në një vendimmarrje të saj, pak përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve ligjore të vitit 2017, ku gjykata arsyetoi se: "*Ligjvënësi në këtë dispozitë, kur flet per prova ka parasysh faktin e ekzistencës se tyre para paraqitjes se kërkesës në gjykatë nga ana e organit procedues, si dhe domosdoshmërinë për vazhdimin e hetimeve të filluara. Pra, përgjimi është i mundur të lejohet atëherë kur është rasti se mund të ndodhë një vepër penale ne vazhdimësi, ose ekziston një procedim i lidhur, nga i cili pritet apo është ne vazhdim kryerja e një ose disa veprave të tjera penale.* ***Kjo, pasi ç'kuptim dhe çfarë vlere do të kishte përgjimi nëse vepra penale ishte kryer dhe për të ekzistonin të gjitha provat***".[300]

Megjithatë, pavarësisht formulës së parashikuar nga ligji procedural penal përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2017, *për ekzistencën e provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës*, GJEDNJ e ka quajtur të ligjshëm përgjimin kur ka *dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova* se mund të kryhet ose është në kryerje e sipër një veprimtari kriminale, duke e përligjur me kërkesat e larta të interesave kombëtare, publike, apo për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, etj., si dhe me vetë motivacionin e vendimit që autorizon përgjimin, në të cilin fiksohen mënyra dhe kohëzgjatja e veprimeve përgjuese, pa qenë nevoja të citohen treguesit specifikë të dispozitës ligjore ose të figurës së krimit, siç do të duhet të bëhet për hetimin e krimit të konsumuar.[301]

Përpara reformës legjislative të vitit 2017, praktika gjyqësore ka pasur një qasje interesante ndaj standardit të përcaktuar nga ligji procedural penal për kryerjen e përgjimit, ku përgjithësisht duket se koncepti i provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, pavarësisht se ka përbërë një kusht ligjor të përcaktuar shprehimisht nga neni 222 i KPrP, nuk ka gjetur përkrahjen e jurisprudencës. Praktika gjyqësore ka përkrahur qendrimin e jurisprudencës së GJEDNJ që ka elaboruar standardin e dyshimit të aryeshëm të bazuar në prova për përgjimin. Edhe nëse në vendime të caktuara mund të gjendet i cituar standardi i provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, sërish interpretimi i përmbajtjes së tij i është referuar dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Praktika jonë gjyqësore nuk ka zbatuar në mënyrë strikte parashikimin e ligjit mbi standardin e provave të mjaftueshme për vërtetimin e

---

[298] Shih nenin 222.1 të KPrP përpara ndryshimeve ligjore me ligjin nr.35/2017.
[299] Henrik Ligori, "Për ndryshime e plotësime në titullin VI- hetimet paraprake", Relacion, Komisioni për reformimin e Kodit të Procedurës Penale, Tiranë, 2012.
[300] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 8/25, datë 14.06.2017
[301] Henrik Ligori, "Për ndryshime e plotësime në titullin VI- hetimet paraprake", Relacion, Komisioni për reformimin e Kodit të Procedurës Penale, Tiranë, 2012.

akuzës, nisur nga kontradikta e shpjeguar më lart në nenin 222 të KPrP, por duke i paraprirë në fakt zgjidhjes që bëri ligjvënësi me ndryshimet ligjore të vitit 2017 për parashikimin e standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si një standard që përkon me logjikën dhe dikton pothuaj në mënyrë të konsiderueshme fazën e hetimeve paraprake.

Për të ilustruar këtë diskutim në vijim paraqitet një vendim i gjykatës së rrethit gjyqësor Lushnje në të cilin, është arsyetuar në lidhje me të drejtat që vihen në diskutim në rastin e lejimit të përgjimit dhe kushtin e provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës. Rasti i referohet një çështje të regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, e cila ka filluar procedimin penal dhe kryer hetime për veprën penale të "Prodhim dhe shitja e narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i KP. Në bazë të informacioneve policore, mësohej se shtetasi E.T merrej me shpërndarjen e lëndëve narkotike, kryesisht të llojeve kokainë dhe Cannabis Sativa. Sipas të dhënave të ardhura nga policia, ky shtetas kishte në përdorim një numër telefoni celular, të cilin e përdorte për krijimin e pikave të kontaktit në funksion të zhvillimit të aktivitetit te tij kriminal. Gjithashtu, ky shtetas njihej nga policia si shpërndarës i lëndëve narkotike, pasi kishte qenë i arrestuar edhe më parë për të njëjtën vepër. Në rrethanat e mësipërme, organi i akuzës pretendoi se kishte dyshime të bazuara që shtetasi E.T në bashkëpunim edhe me persona të tjerë kryente veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" parashikuar nga neni 283/1 i KP dhe në rrethanat konkrete ishte e domosdoshme që për vazhdimin e hetimeve të filluara, duke qenë se kishte të dhëna të mjaftueshme, të bëhej përgjimi i bisedave telefonike midis shtetasit E.T drejt numrave celularë të cilat përdoreshin nga bashkëpunëtorët e tij dhe shtetas të tjerë që mund të ishin përdorues të lëndëve narkotike. Mbi bazën e kërkesës së Prokurorisë, Gjykata vlerësoi se jo vetëm që nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e organit të akuzës, "*por në rastin objekt gjykimi jemi thjesht vetëm para informacioneve të marra nga DPQ Fier, i pabazuar kjo në prova për të provuar ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm.* ***Në vlerësimin e gjykatës, me prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës, neni 222/1 i KPrP, nënkupton dyshime të arsyeshme mbështetur në prova/fumus commissi delicti****, sepse prova në kuptimin juridik merr rëndësinë dhe vlerën e provës vetëm kur është bërë pjesë e shqyrtimit gjyqësor dhe administrohet nga gjykata. Dyshimi i arsyeshëm nënkupton bindjen që krijohet nga provat e marra dhe të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre tregojnë se vepra ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet e, si rrjedhojë,* ***edhe ndaj atij që kërkohet të bëhet përgjimi****. Bindja e gjykatës duhet të jetë e tillë që të pranohet si e drejtë dhe e arsyeshme nga kushdo që njihet me faktet apo me provat që e vërtetojnë atë. Dyshimi i arsyeshëm duhet të krijohet mbi bazën e provave të paraqitura nga prokurori, të cilat shqyrtohen në seancë gjyqësore, në përputhje me dispozitat procedurale të Kodit, në të kundërt ato nuk mund të shërbejnë si bazë për krijimin e dyshimit të arsyeshëm. Ky dyshim konsiston në krijimin e besimit që bind me probabilitet apo mundësi të lartë për ekzistencën e veprës penale dhe përgjegjësinë e të hetuarit edhe pse jo në nivelin maksimal të asaj që kërkohet pas shqyrtimit gjyqësor mbi fajësinë për veprën penale që i atribuohet të pandehurit. Gjykata çmon të theksojë se dyshimi i arsyeshëm, dyshim ky i cili mbështetet në konceptin filozofik mbi të vërtetën dhe parimin juridik të prezumimit të pafajësisë, nuk duhet të jetë i supozuar. Nga ana tjetër vetëm kushti se ka dyshim të arsyeshëm, bazuar në prova se mund të kryhet ose është në kryerje e sipër një veprimtari kriminale, i cili nuk pohon aspak se kjo veprimtari rezulton efektivisht e pranishme, nuk është i mjaftueshëm për lëshimin e vendimit për*

autorizimin e kryerjes së veprimeve përgjuese. Ekzistenca vetëm e këtij kushti, pa zbatuar kërkesat e nenit 222/1 i KPrP, përbën shkelje të së drejtës së jetës private të personit, (nenet 36 e 37 të Kushtetutes), sepse përgjimi lejohet vetëm kur plotësohen kërkesat e nenit 221 i KPrP i cili duhet parë lidhur ngushtë dhe në bashkëpunim me kushtet e përgjithshme - është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës - parashikuar në nenin 222/1 i KPrP. Në këto kushte, kur nga ana e organit të akuzës nuk u paraqit asnjë provë për ekzistencën e dyshimit të arësyeshëm se personi ndaj të cilit po zhvillohen hetime ka kryer, apo është duke kryer veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 të KP, gjykata nuk mund të procedojë me autorizimin e këtij përgjimi, përgjim i cili do të legjitimohej vetëm nëse do të konsiderohej nga gjykata për plotësimin e provave të tjera i domosdoshëm për vazhdimin e hetimit, dhe jo të shërbejë si provë kyç për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm."[302]

Me vendimin e mësipërm, gjykata çmoi të mos e vleftësonte ligjshmërinë e lejimit të përgjimit të kërkuar nga organi i akuzës, pasi në rastin konkret edhe pse kufizimi (kuptohet përgjimi si veprim që cenon jetën private, familjare etj) ishte parashikuar shprehimisht nga ligji, ishte i domosdoshëm në një shoqëri demokratike për mbrojtjen e rendit publik dhe të të drejtave të të tjerëve *(neni 17 i Kushtetues, nenet 221 dhe 222 të KPrP të përshkruara dhe të analizuara në rastin konkret si më sipër si një garanci e sigurisë juridike),* nga ana tjetër ky kufizim nuk ishte proporcional me interesin e ligjshëm të ndjekur në rastin konkret. Gjykata çmoi se cënimi, kufizimi i të drejtës të njeriut për lirinë e komunikimit dhe të jetës së tij private, është e nevojshme në kushtet në të cilat vihet në zbatim ky kufizim (përgjimi) me qëllim mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë së jetës së të tjerëve, por nga ana tjetër theksoi se me qëllim që një ndërhyrje ndaj të drejtës së jetës private të jetë e justifikuar ishte e domosdoshme që të ekzistonte edhe një marrëdhenie përpjesëtimore midis mjeteve të përdorura dhe synimit që kërkohet të realizohet. Mbi këtë bazë sistemi ligjor duhet të përmbajë një sërë garancish procedurale për të siguruar që ndikimi i tij mbi të drejtën e jetës private ***të mos jetë arbitrar dhe i paparashikueshëm***.[303] Sa më lart, gjykata ka vënë shenjën e barazisë mes standardit të provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës me atë të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Kjo do të thotë se, niveli i provueshërisë që gjykata ka kërkuar nga organi i akuzës të plotësojë, për pranimin e kërkesës për lejimin e përgjimit, është krijimi i dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në prova, mbi ekzistencën e faktit penal.

Megjithatë, kryesisht ndodh që gjykatat në gjykimin për lejimin apo vleftësimin e përgjimit nuk analizojnë nëse ka prova të mjaftueshme që tregojnë se një person i cili do të përgjohet është i përfshirë në veprimtari kriminale. Jo vetëm kaq, por ky gjykim zakonisht është sipërfaqësor dhe gjykatat mjaftohen me kërkesën e prokurorit dhe urdhërin e regjistrimit të procedimit penal pa analizuar kushtet e tjera që kërkohen nga ligji. Mbrojtësi dhe i pandehuri marrin dijeni për vendimin e gjykatës vetëm pasi të jetë realizuar përgjimi dhe për pasojë pretendimet se nuk ka patur prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën ngelen formale dhe pjesë e diskutimeve teorike.[304]

---

[302] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 36, datë 9.06.2011.
[303] Po aty.
[304] Arben Shehu, "Përgjimet si mjet i kërkimit të provës", Revista Studime Juridike, Nr.1, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë, Dhjetor, 2010, fq. 236

Neni 222 i KPrP nënkupton që gjyqtari duhet të verifikojë ekzistencën e parakushteve për lejimin e përgjimit. (rëndësinë e provave në nivelin e dyshimeve të arsyeshme se personi ka kryer një vepër penale dhe domosodoshmërinë e tyre në vazhdimin e hetimeve). Në KPrP italiane, aty ku është bazuar kodi ynë për adoptimin e institutit të përgjimit, është parashikuar në nenin 267 të tij se prokurori kërkon në gjykatë lejimin e përgjimit kur ekzistojnë indicje të rëndësishme për krimin dhe kur përgjimi është absolutisht i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve. Nëse krahasojmë dispozitën tonë procedurale dhe normën përkatëse në procedurën penale italiane rezulton që ka ndryshime pikërisht lidhur me standardin e provave që justifikon apo ligjëron përgjimin, ndërsa sa i përket parakushtit të domosdoshmërisë së përgjimeve për vazhdimin e hetimeve, ai është i njëjtë në të dy sistemet.

Për të evidentuar dallimin ndërmjet standardit të përcaktuar në normën tonë dhe atë italiane është me rëndësi trajtimi i jurispridencës së Gjykatës së Kasacionit në Itali. Jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit[305] në Itali ka mbajtur qëndrimin se *indicjet e rëndësishme për krimin, parakusht për kërkesën për përgjimin e bisedave apo komunikimeve, i përkasin ekzistencës së veprës penale dhe jo fajësisë së një subjekti të caktuar. Për të proceduar në mënyrë legjitime me përgjimin, nuk është e nevojshme që këto indicje të jenë në ngarkim të një personi të identifikuar ose ndaj subjektit, komunikimet e të cilit duhet të administrohen për qëllime hetimi*. Gjykata e Kasacionit në Itali[306] përkrah qëndrimin se dispozita që parashikon lejimin e përgjimit, nuk përcakton aspak që indicjet e rëndësishme të jenë në ngarkim ekskluzivisht të subjektit, komunikimet e të cilit duhet të përgjohen. Lidhur me kufijtë e vlerësimit të *indicjeve të rëndësishme të krimit*, jurisprudenca e Gjykatës së Kasacionit në Itali përcakton se ato nuk nënkuptojnë vlerësimin e themelit të akuzës, por vlerësimin e rëndësisë së hipotezave rreth faktit penal, të cilat nuk duhet të jenë hipotetike.[307]

Sipas gjykimit tim, ndërmjet standardit të ligjit tonë *–dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova në ngarkim të personit se ka kryer një vepër penale,* dhe standardit të ligjit italian – *indicje të rëndësishme të krimit,* ka dallime të konsiderueshme. *Së pari*, standardi i përcaktuar nga ligji ynë procedural bazohet në ekzistencën e provave, ndërsa ai i ligjit italian në indicje dhe *së dyti*, ligji ynë procedural e lidh kryerjen e përgjimit me ekzistencën e të dhënave ndaj një personi konkret që mund të ketë kryer një vepër penale, ndërsa ligji italian e lidh ekzistencën e indicjeve kryesisht me atë të një krimi se sa të një individi apo personi konkret. Nga karakteristikat e mësipërme mund të dilet në përfundimin që standardi i përcaktuar në ligjin tonë procedural është më garantist nga pikëpamja e respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit, sesa ai i përcaktuar në legjislacionin italian.

Praktika gjyqësore italiane, ashtu siç do të shohim në vijim edhe në praktikën gjyqësore të vendit tonë, duket se karakterizohet nga paqartësia sa i përket përdorimit të burimeve konfidenciale të policisë gjyqësore në këndvështrim të indicjeve të

---

[305] Gjykata e Kasacionit në Itali, 18 Shtator 2020, n.2568, Art. 267 codice di procedura penale - Presupposti e forme del provvedimento - Brocardi.it, klikuar më datë 05 Gusht 2022.
[306] Gjykata e Kasacionit në Itali 30 Shtator 1996, n. 8832, Art. 267 codice di procedura penale - Presupposti e forme del provvedimento - Brocardi.it, klikuar më datë 06 Gusht 2022.
[307] Gjykata e Kasacionit në Itali, 13 Prill 2015, n. 14954, Art. 267 codice di procedura penale - Presupposti e forme del provvedimento - Brocardi.it, klikuar më datë 06 Gusht 2022.

rëndësishme të krimit. Në një çështje të trajtuar prej saj, Gjykata e Kasacionit në Itali ka konsideruar të përdorshme përgjimet telefonike të urdhëruara kundër një të dyshuari ndaj të cilit, në kohën e dhënies së autorizimit, nuk kishte elemente indicjare, por vetëm deklarata nga burime konfidenciale.[308] Ndërsa, në një praktikë tjetër, Gjykata e Kasacionit, ka përcaktuar se: *Përdorimi i burimeve konfidenciale të marra nga organet e policisë gjyqësore dikton papërdorshmërinë e përgjimeve telefonike, nëse ato përfaqësojnë të vetmin element që i nënshtrohet vlerësimit për qëllime të indicjeve të fajësisë, ndërkohë që përdorimi i tyre është legjitim për fillimin e veprimtarisë hetimore ose për zgjerimin e fushës së kërkimit të elementëve të mëtejshëm.*[309] Në një vendimmarrje tjetër të saj, Gjykata e Kasacionit ka shprehur se: *Megjithatë, ndalimi i përdorimit të burimeve konfidenciale nuk shtrihet edhe në të dhënat e dobishme për identifikimin e subjekteve që do të përgjohen, me kusht që të përcaktohet elementi objektiv i ekzistencës së krimit dhe lidhja ndërmjet vazhdimësisë së hetimit dhe personit, i cili i nënshtrohet përgjimit.*[310]

Nga një konfuzion i ngjashëm duket se karakterizohet edhe praktika jonë gjyqësore, lidhur me përdorimin e burimeve konfidenciale të policisë gjyqësore për lejimin e përgjimit. Çështja që shtrohet ka të bëjë me faktin nëse burimet konfidenciale të policisë gjyqësore e përmbushin ose jo standardin e të provuarit për realizimin e përgjimit, pra, që ndaj një personi të krijohet apo ekzistojë një dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale (*ose prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës-përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2017*).

Në një vendim të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë[311], ku gjykata ka gjykuar në themel çështjen penale për shkak të juridiksionit të saj fillestar me objekt shqyrtimin e veprave penale të korrupsionit aktiv e pasiv të zyrtarëve të lartë publikë, rezulton se procedimi penal ka nisur mbi bazën e informacionit të marrë në rrugë konfidenciale nga oficeri i policisë gjyqësore dhe përgjimi është vendosur pas paraqitjes së një informacioni të dytë konfidencial. Në këtë vendim, Gjykata e Lartë shprehet se: *""Po të marrësh dhe të analizosh pikërisht kushtet kur u mor vendimi i gjykatës (për vleftësimin e vendimit të prokurorit për lejimin e përgjimit- shënimi im),* ***rezulton qartë se të gjitha informacionet e dhëna nga OPGJ ishin të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën duke plotësuar kushtin e parashikuar ne nenin 152/1.2 të K.Pr.Penale****. Në nenin 152/2 të K.Pr.Penale parashikohet se: "ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet, përveçse kur këto janë te rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën".* ***Referuar të drejtës sonë proceduriale, nëse prova-indicje nuk është një e vetme, por ka disa, janë te rëndësishme, të sakta dhe ato përputhen me njëra tjetrën, ligjvënësi i kategorizon ato si të mundshme që të japin njoftimin mbi faktin objekt i të provuarit dhe për këtë, ato janë të afta për të krijuar bindjen tek gjyqtari për ekzistencën e faktit penal. Në çështjen objekt gjykimi, në materialet e referuara nga OPGJ, ne vendimin e prokurorit te datës 03.06.2016, si dhe ne vendimin e gjykatës nr. 386, date 04.06.2016, ne gjejmë një***

---

[308] Gjykata e Kasacionit në Itali, 23 Tetor 2015, n. 42763, Art. 267 codice di procedura penale - Presupposti e forme del provvedimento - Brocardi.it, klikuar më datë 06 Gusht 2022.
[309] Gjykata e Kasacionit në Itali, 10 Janar 2013, n. 1258, Art. 267 codice di procedura penale - Presupposti e forme del provvedimento - Brocardi.it, klikuar më datë 06 Gusht 2022
[310] Gjykata e Kasacionit në Itali, 25 Shtator 2014, n. 39766, Art. 267 codice di procedura penale - Presupposti e forme del provvedimento - Brocardi.it, klikuar më datë 06 Gusht 2022
[311] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 8/25, datë 14.06.2017

sërë prova –indicje të cilat kane lidhje me njëra tjetrën, janë te rëndësishme, janë serioze dhe të sakta, të cilat jo vetëm që nuk përjashtojnë njëra-tjetrën, por ato mbështesin njëra-tjetrën dhe janë në vazhdimësi"[312].

Nga sa më sipër, sipas gjykimit tim, në këndvështrim edhe të jurisprudencës së Gjykatës së Kasacionit në Itali, Gjykata e Lartë është rezervuar të shprehë një qendrim apo vlerësim *in abstracto* nëse mund të pranohet lejimi i një përgjimi i bazuar vetëm në informacionet konfidenciale të policisë gjyqësore, por është investuar në shqyrtimin *in concreto* të përmbajtjes së informacioneve të paraqitura nga policia gjyqësore, duke i përcaktuar të dhënat që përmbahen në to si ***indicje të shumta, të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra tjetrën.*** Kjo zgjedhje e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë është reflektim i praktikave të gjykatave të shkallëve të para dhe apeleve, të cilat rast pas rasti, kanë vlerësuar informacionet konfidenciale, herë si të pamjaftueshme për të vendosur lidhur me lejimin e përgjimit dhe në raste të tjera, si indicje, e në këtë mënyrë të mjaftueshme për lejimin e përgjimit. Në këtë drejtim, në këtë vendim të Gjykatës së Lartë nuk jepen argumentet se përse të dhënat që përshkruhen në një informacion të policisë gjyqësore konsiderohen indicje (*me termin prova-indicje*). Më së paku qendrimi i Gjykatës së Lartë për këtë çështje është tejet i diskutueshëm, pasi nuk i referohet kuptimit që përgjithësisht jepet në doktrinë dhe praktikën gjyqësore për kuptimin e indicjeve si provë e tërthortë ose provë kritike. Sipas gjykimit tim, do të ishte e nevojshme për të bërë dallimin ndërmjet informacionit të policisë gjyqësore dhe të dhënave që e plotësojnë apo argumentojnë informacionin. Ky i fundit duhet të konsiderohet një përmbledhje e gjetjeve apo të dhënave që administrohen nga policia gjyqësore në fazat fillestare të një çështjeje, por nuk mund të përbëjë i vetëm indicje për rrethanat që pretendohen në të. Përkundër kësaj, Gjykata e Lartë i është shmangur, gjithashtu, trajtimit të të dhënave që janë të nevojshme për regjistrimin e një procedimi penal dhe atyre që janë të nevojshme për kryerjen e një veprimi hetimor siç është përgjimi, diskutim që do të mundësonte një gjykim të drejtë nëse informacionet e policisë gjyqësore janë të mjaftueshme për regjistrimin e një procedimi penal apo edhe për më tej, për kryerjen e veprimeve të caktuara, veçanërisht ato që duan një vëmëndje të shtuar ndaj disa të drejtave të ndjeshme të individit.

Në vijim të problematikës së mësipërme me informacionet e policisë gjyqësore, në praktikën e Gjykatës së Lartë problematikë ka qenë vlerësimi i autorizimit të përgjimit të prokurorit nga gjykata, përgjim i cili është filluar bazuar në informacione të ardhura nga SHISH-i apo organe të tjera në kuadrin e përgjimit parandalues. Gjykata e Lartë i ka konsideruar të mjaftueshme informacione të tilla, të cilat sipas qëndrimit të saj konsiderohen si prova të mjaftueshme që vërtetojnë akuzën. Ky qëndrim është i kritikueshëm, pasi nuk është respektuar standardi që vendoste neni 222/1 për prova të mjaftueshme që vërtetojnë akuzën. Informacione të tilla, sado të rëndësishme, nuk konsiderohen provë sipas KPrP. Qëndrim i shumicës është kritikuar nga pakica, e cila duket se në arsyetimin e saj mbështetet në argumenta ligjorë. Në vijim, po ndalemi më imtësisht tek ky vendim i Gjykatës së Lartë:

---

[312] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 8/25, datë 14.06.2017

Rrethanat e faktit.

Në datën 15.11.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin penal, për veprën penale të "trafikimit të narkotikëve", e parashikuar nga neni 283-a/2 i KP. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore ka rezultuar se, personi nën hetim D.SH, ka qenë përdorues i njërit prej numrave celularë të vendosur nën përgjim. Në bazë të informacioneve operative, nga organe të specializuara të shërbimeve të huaja, organi i akuzës është vënë në dijeni të pritshmërisë së një trafiku të lëndëve narkotike, të nisur nga Panamaja në drejtim të Shqipërisë, nëpërmjet postës UPS. Në datë 17.11.2010, organi i akuzës ka vendosur të lejojë përgjimin e disa numrave celularë për një periudhë 15 ditë. Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka vleftësuar përgjimin. Po ashtu, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

Arsyetimi i gjykatës.

Gjykata e Lartë ka arsyetuar si vijon: "*objektivi parësor për ndërmarrjen dhe realizimin e veprimtarisë procedurale të përgjimit është parandalimi i veprimtarisë kriminale dhe, kur kjo veprimtari është konsumuar, sigurimi i provave që nevojiten për zbulimin e autorëve të mundshëm, me synim përfundimtar vërtetimin e fajësisë. Pretendimi, që gjykatat nuk kanë respektuar, qoftë edhe formalisht kriteret e lejimit të përgjimit, është përveç se i pavërtetë edhe i paligjshëm kur referohet në nenin 222 të KPrP. Mbrojtja e personit nën hetim, në mënyrë spekulative, përdor si pamundësi të lejimit të përgjimit pikën 1 të nenit 222 të KPrP, ".. gjykata autorizon përgjimin ... kur ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës...". Së pari, kriteret dhe kushtet, që nuk lejojnë apo mundësojnë lejimin e përgjimit janë të parashikuara në nenin 221 të KPrP dhe vetë mbrojtja nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim të ligjshëm, në lidhje me praninë apo mospraninë e tyre. Së dyti,* ***Informacioni i SHISH, informacioni nga shërbimet e huaja dhe të dhëna të tjera operative, kënaqin vlerësimin subjektiv të gjykatës mbi "prova të mjaftueshme" për vërtetimin e faktit penal, sepse në kohën e lejimit të përgjimit, nuk mund të flitej për fajësi të subjektit posedues të numrit telefonik nën përgjim.*** *Ekzistenca e provave të mjaftueshme ka rezultuar evidente në përfundim të gjykimit penal, kur janë deklaruar fajtorë dhe janë dënuar subjekte të përfshirë në këtë trafik."*[313]

Arsyetimi i pakicës

Pakica ka arsyetuar se "***Në kundërshtim me urdhërimin e nenit 221/5***[314]***, gjykata ka konsideruar si "prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës" (siç kërkon neni 222/1 i KPrP), rezultatet e përgjimit parandalues, të cilat siç theksuam më lart, në bazë të nenit 221/5 të KPrP, nuk mund të përdoren si provë.*** *Respektimi me rigorozitet i dispozitave të mësipërme të KPrP është një detyrim ligjor, që buron në rradhë të parë nga raporti që ato krijojnë me nenin 17 të Kushtetutës, sipas të cilit: "kufizimet e të drejtave të njeriut mund të bëhen vetëm me ligj dhe këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të së drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ". Nga ana tjetër, neni 8 i KEDNJ sanksionon se: "Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit*

---

[313] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 129, datë 12.10.2011.

[314] Neni 221/5 të KPrP: "Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë".

ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të së tjerëve". Duke përdorur si "prova" akte të cilat janë konsideruar e përdorur si të tilla në kundërshtim me ligjin dhe kërkesat e nenit 149 të KPrP, gjykatat kanë shkelur të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personit nën hetim duke legjitimuar përgjime të realizuara në shkelje të neneve 221/5 e 222 të KPrP.[315] Mendoj se qëndrimi i pakicës gjen mbështetje ligjore në KPrP. Përderisa kodi ynë pranon se rezultatet e përgjimit parandalues nuk mund të përdoren, kjo duhet të interpretohet se ato nuk mund të merren në konsideratë për të mbështetur standardin e provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës. Rezulatet e përgjimit parandalues mund të shërbejnë për fillimin e procedimit penal nga organi i akuzës.

Një qëndrim i tillë, i cili nuk i konsideron rezultatet e përgjimit parandalues si prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës mbështetet në vendimin e mëposhtëm të Gjykatës së Lartë. Sipas këtij vendimi rezulton:

Rrethanat e faktit.

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të "Korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer në bashkëpunim dhe "Korrupsionit pasiv të personave që ushtrojnë funksione publike", të parashikuar nga nenet 244 e 25 dhe 259 të KP. Sipas urdhërit të Prokurorit, për regjistrimin e këtij procedimi penal rezulton se: *"Nga ana e SHISH është paraqitur një informacion për referimin e veprës penale me anën e të cilit është kërkuar të fillojë ndjekja penale për veprat penale të parashikuara nga nenet 244 dhe 259 të KP. Nga ky informacion krijohen dyshime të arsyeshme se disa funksionarë publikë të Ministrisë së Brendshme dhe disa pronarë shoqërish tregtare kanë konsumuar veprat penale të parashikuara nga nenet 244, 25 dhe 259 të KP".* Rezulton se informacioni i mësipërm i SHISH-it, i konsideruar si kallëzim nga organi i akuzës, përmban: 1. Pjesë nga përgjime telefonike, 2. Të dhëna sqaruese për shtetasit e implikuar. Këto të dhëna të pasqyruara në informacionin e SHISH-it janë realizuar e mbledhur nga punonjësit e bashkëpunëtorët e këtij të fundit. Me regjistrimin e procedimit penal, organi i akuzës, i ka paraqitur gjykatës një kërkesë "Për lejimin e përgjimit" të numrave të telefonave celulare të disa shtetasve. Arsyetimi i organit të akuzës për këtë kërkesë është si vijon: *"Nga informacioni i dërguar nga ana e SHISH rezulton se ka dyshime se shtetasi I.S ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 244 i KP...."*. Si gjykata e rrethit gjyqësor, ashtu edhe ajo e apelit e kanë pranuar kërkesën e organit të akuzës.

Arsyetimi i gjykatës.

Gjykata e Lartë ka vlerësuar se "*vendimet e mësipërme të gjykatave duhet të prishen dhe të rrëzohet kërkesa e organit të akuzës për lejimin e përgjimit të komunikimeve telefonike hyrëse dhe dalëse në numrat telefonike celularë të shtetasve I.S, J.GJ dhe B.M. Vendimet e gjykatave të të dyja shkallëve të gjykimit janë marrë në kundërshtim me dispozitat procedurale penale, e konkretisht me nenet 221/5 e 222/1 të KPrP. Në kundërshtim me urdhërimet e nenit 221/5*[316]*, gjykatat kanë vënë në themel të arsyetimit dhe vendimit të tyre, duke i konsideruar dhe përdorur si prova rezultatet e përgjimeve parandaluese të pasqyruara në informacionin e SHISH. Në këtë mënyrë gjykata ka konsideruar si "prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës", rezultatet e përgjimit parandalues, në bazë të nenit 221/5 të KPrP, nuk mund të përdoren si provë. Madje në vendimet e tyre të dyja gjykatat i konsiderojnë këto*

---

[315] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 129, datë 12.10.2011.

[316] Neni 221/5 të Kodit të Proçedurës Penale: "Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë"

rezultate të përgjimeve parandaluese si "dyshime të forta e të bazuara", pra as formalisht ato nuk pohojnë se ka prova të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës. Gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë, organi i akuzës pretendoi se "ekziston dyshimi i bazuar", kur sipas dispozitës së mësipërme për lejimin e përgjimit duhen "prova të mjaftueshme". [317]

Interesant nga pikëpamja doktrinare është edhe mendimi i pakicës në vendimin e sipërcituar. Pakica ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga shumica duke theksuar se "*Për veprat penale që ndiqen kryesisht nuk është e nevojshme të bëhet kallzim, prandaj përgjimi parandalues në këtë rast nuk mund të konsiderohet si kallzim i bërë nga SHISH, si organ shtetëror. Përgjimi parandalues nuk mund të përdoret si provë, por ai mund të shërbejë si indicje (jo në kuptimin e atyre që parashikohet në kapitullin e provave), për të vënë në lëvizje organin procedues, i cili i ka kërkuar gjykatës të përdorë një nga mjetet e kërkimit të provës, që është përgjimi.*" Gjithashtu, mendimi i pakicës shprehet më tej se: "*Në nenin 222/a të KPrP është parashikuar mjaft qartë që ankim mund të bëhet vetëm për shkelje të kritereve të parashikuara nga neni 221 i KPrP, që në rastin objekt gjykimi nuk është shkelur asnjë kriter i kësaj dispozite. (...) në raste të tilla gjykata duhet të shikojë vetëm nëse kanë qenë kriteret e lejimit të përgjimit dhe jo t'i hyjë vlefshmërisë së tij, sepse ai nuk është provë, por mjet i kërkimit të saj. Produkti që del nga përgjimi është ai, që në shqyrtimin gjyqësor, do t'i nënshtrohet të gjitha rregullave për vlefshmërinë dhe përdorimin e provës.*"[318] Qëndrimi i pakicës, duket në parim, të jetë në përputhje me parashikimet e KPrP italian për kushtet dhe standardet e nevojshme për lejimin e përgjimit. Sipas KPrP italiane standardi i kërkuar është ai i indicjeve të rëndësishme mbi krimin, pra nuk kërkohen domosdoshmërisht prova, megjithatë, edhe në këtë rast, në këtë qendrim të pakicës, mbetet e diskutueshme se përse një informacion i bazuar në përgjimin parandalues është konsideruar indicje, madje është diferencuar kuptimi i tyre në *indicje që parashikohen në kapitullin e provave të KPrP* dhe ato *që shërbejnë për të vënë në lëvizje prokurorin për të paraqitur kërkesa në gjykatë*, çka nuk gjen mbështetje në procedurën tonë penale. Sikundër është shprehur pjesa më dominante e jurisprudencës, gjykoj se qëndrimi që i konsideron rezultatet e përgjimit parandalues të papërdorshme në procesin e kërkimit të lejimit të përgjimit, është një mendim i mbështetur në kodin tonë. Gjithashtu, ai garanton në një nivel më të lartë të drejtat dhe liritë e subjektit që kërkohet të përgjohet.

Problematike janë në praktikë rastet kur nga përgjimi i komunikimeve të një subjekti të caktuar, organit të akuzës i lind dyshimi për një subjekt tjetër. Për këtë qëllim, po paraqitim në vijm vendimet e gjykatës së rrethit gjyqësor dhe të apelit, të cilat kanë vendosur kundër kërkesës së organit të akuzës për vleftësimin e përgjimit ndaj njërit prej personave të hetuar, me arsyetimin se nuk ka të dhëna të mjaftueshme për përfshirjen e tij në veprimtari kriminale. Nga këto vendime rezulton:

Rrethanat e faktit.

Nga përgjimi i numrit të celularit të K.B ka rezultuar se ai ka biseduar në telefon me një person të paidentifikuar. Ky person dyshohet se ka qenë duke kryer me K.B një marrëveshje për çmimin e shitjes së lëndëve narkotike, destinuar për tregun e

---

[317] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 33, datë 13.10.2010.
[318] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 33, datë 13.10.2010, mendim i pakicës.

paligjshëm. Në vijim të përgjimit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore në sektorin e përgjimeve të Prokurorisë së Përgjithshme është identifikuar si i implikuar në veprimtarinë kriminale shtetasi i quajtur "F", mbajtësi i një numri telefonik. Bazuar në kërkesën e policisë gjyqësore, referuar nenit 222/2 të KPrP, prokurori ka vendosur lejimin e përgjimit të komunikimeve telefonike të numrit të telefonit celular të përdorur nga personi i quajtur "F". Prokurori ka paraqitur në gjykatë kërkesë për vleftësimin e lejimit të përgjimit.

Arsyetimi i gjykatave.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka vendosur rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova.....", duke arsyetuar se*: "Nga aktet e paraqitura nga prokurori nuk rezulton se ka të dhëna që krijojnë dyshim për përfshirjen e shtetasit të quajtur "F" në veprimtarinë kriminale të "prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" në bashkëpunim me shtetasin K.B e të tjerë. Si në kërkesën e prokurorit, ashtu edhe në kërkesën e policisë gjyqësore për lejimin e përgjimit, vetëm se përmendet fakti se në veprimtarinë kriminale është implikuar shtetasi me emrin "F", por nuk përcaktohet se cilat janë të dhënat konkrete të marra nga përgjimi që krijojnë dyshimin për këtë përfshirje. Në gjykim nga prokurori u paraqitën procesverbale të transkriptimeve të përgjimeve të numrit të përdorur nga K.B dhe disa numrave të tjerë, ndër të cilët dhe numri për të cilin është lejuar përgjimi. Në seancë, me gjithë kërkesën e gjykatës për të specifikuar pjesë të transkriptimeve që japin të dhëna mbi përfshirjen në veprimtarinë e paligjshme të shtetasit "F" nga ana e prokurorit nuk u përcaktuan të tilla.....".*[319]

Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur lënien në fuqi të vendimit administrativo-penal nr.688, datë 15.11.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan", duke arsyetuar se: *" .....nuk jepet asnjë e dhënë konkrete në informacionin e DPQ Elbasan dhe në vazhdim edhe në kërkesën e prokurorisë së këtij rrethi lidhur me implikimin e shtetasit "F" në këtë veprimtari kriminale, aq më pak që të jetë argumentuar edhe shkalla e implikimit të këtij shtetasi në këtë veprimtari. Arsyeja e parashtruar nga prokurori përfaqëson përcaktim të përgjithshëm dhe nuk është argumentuar, aq më pak ajo nuk është e detajuar, e qartë dhe e kuptueshme. Mbi këtë bazë edhe vendimi i prokurorit për lejimin e përgjimit të bisedave të këtij numri telefonik është i paqartë, i pa detajuar dhe i pakuptueshëm, në drejtim të rrethanave që kanë imponuar mënyrën e vendimmarrjes..... vendimi i lejimit të përgjimit të bisedave të këtij numri telefonik nuk rezulton proporcional dhe në përputhje me kriteret e pranuara nga jurisprudenca e GJEDNJ lidhur me rastet e ndërhyrjes në të drejtën e paprekshmërisë së jetës private të individëve.....".*[320]

Si konkluzion në lidhje me përgjimin duhet theksuar se standardi i kërkuar për lejimin e tij përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, ishte ai i *provave të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës*. Në vetvete ky standard përmbante dy kushte të domosdoshme. Së pari, që organi i akuzës duhet ta mbështeste kërkesën për lejimin e përgjimit në prova. Së dyti, këto prova duhet të ishin të tilla që të konsideroheshin të mjaftueshme për vërtetimin e akuzës. Pikërisht, kushti i dytë e shndërronte standardin në tërësi të një niveli tepër të lartë, duke marrë parasysh faktin që përgjimi është mjet për kërkimin e provës dhe duhet t'i shërbejë vërtetimit të akuzës. Nuk ka kuptim që të kërkohet përgjimi, kur akuza vërtetohet me prova të tjera. Standardi në tërësi mund të

---

[319] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr.688, datë 15.11.2010.
[320] Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës nr.296, datë 09.12.2010.

vlerësohej edhe më i lartë se standardi që përgjithësisht shoqëron fazën e hetimeve paraprake, atë të dyshimit të arsyeshëm. Duket se me këtë parashikim ligjvënësi, ndërmjet dy interesave të rëndësishme, jetës private dhe luftës ndaj kriminalitetit, i kishte dhënë përparësi mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Me ndryshimin e standardit të mësipërm, në atë të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, ligjvënësi mbështeti në fakt praktikën gjyqësore, e cila prej kohësh bazohej në këtë standard për lejimin ose jo të përgjimit. Duket se gjykimi që ka mbizotëruar në këtë zgjedhje të ligjvënësit ka qenë ai që ky standard ofron një drejtpeshim më të mirë ndërmjet intersave të individit dhe intersave të shtetit.

3.5.2 Kontrollet

Kontrolli përbën një nga mjetet kryesore të kërkimit të provës që për shkak të interesave dhe të drejtave të përfshira në proces kërkon një trajtim të veçantë në drejtim të kushteve që duhen plotësuar për realizimin e tij. Kontrolli si mjet për kërkimin e provës, lidhet me nevojën që kanë organet e procedimit për të gjetur e administruar prova materiale, sende ose dokumente që lidhen me objektin e të provuarit sipas nenit 150 të KPrP, të cilat ndodhen ose fshihen në persona apo vende të caktuara. Kontrolli si një mjet tepër delikat në duart e organeve proceduese prek në vetvete të drejta tepër sensitive që gëzojnë mbrojtje kushtetuese, edhe në nivel ndërkombëtar. Kështu, neni 37, par.1, i Kushtetutës garanton paprekshmërinë e banesës, ndërsa paragafi 2, parashikon kushtet që duhet të plotësohen për kryerjen e kontrollit vetjak të personit si dhe të banesës. Kontrolli i banesës si dhe i mjediseve të njësuara me të mund të bëhet vetëm në rastet dhe mënyrat e parashikuara nga ligji.

Edhe KEDNJ në pikën 1 të nenit 8 të saj, ka parashikuar se *"Çdokush ka të drejtën e repektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij"*. Ndërsa në paragrafin e dytë të kësaj dispozite parashikohen rastet e aplikimit të kontrollit si dhe detyrimet e organeve proceduese në aplikimin e këtij mjeti kërkimi prove. Të njëjtat garanci parashikon edhe Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike i OKB-së, i cili në nenin 17/1 parashikon se *"Askush nuk mund të jetë objekt i ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familjen, në banesën ose letërkëmbimin, as duhet të cënohet në mënyrë të paligjshme në nderin dhe reputacionin e tij."*

Duke reflektuar rëndësinë e garancive të mësipërme, KPrP në nenet 202-207, ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme rastet e kryerjes së kontrollit, të drejtat e organeve të procedimit në kryerjen e kontrollit, mënyra dhe koha e kryerjes tij, të drejtat e detyrimet e personave që kontrollohen, etj. Për shkak të rëndësisë së madhe që ka kontrolli si mjet i kërkimit të provës nga njëra anë si dhe të faktit që nga ky mjet i kërkimit provës mund të cenohen rëndë të drejtat dhe liritë e individit, ligjvënësi ka parashikuar të drejtën procedurale vetëm të Gjykatës për të vendosur nëse do të aplikohet ky mjet i kërkimit të provës, me përjashtim të rasteve kur ndodhemi në kushtet e flagrancës. Nga interpretimi logjik i nenit 202/1 të KPrP[321] rezulton se kontrolli nuk është një mjet i zakonshëm për kërkimin e provës, por **ai zbatohet vetëm kur organi procedues disponon të dhëna të mjaftueshme, të cilat**

---

[321] Neni 202/1 i KPrP sanksionon se *"Kur **ka arsye të bazuara** për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale **gjykata** merr vendim për kontrollin personal. Kur këto sende ndodhen në një vend të caktuar, vendoset kontrolli i vendit ose banesës"*

tregojnë që në personin apo në vende të caktuar, ndodhen apo fshihen prova të cilat shërbejnë për procesin penal. Lidhur me kontrollin**,** Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë shprehur se: **"***Me mjetin e kontrollit do të kuptohet veprimtaria e kërkimit të imtësishëm dhe të kujdesshëm të personave, sendeve, vendeve, siç mund të jenë banesa, apo vendet e tjera. Pra, kontrolli është një ndërhyrje fizike mbi një person të caktuar apo në një vend të mbrojtur nga pikëpamja kushtetuese, pra në vend ku personi gëzon pritshmëri privatësie dhe liri nga ndërhyrjet e autoriteteve publike. Qëllimi i kontrollit nuk është përshkrimi i detajuar i asaj çka vëzhgohet, sikundër është këqyrja, por kërkimi i një sendi, pra i objektit të kontrollit duke synuar në arritjen dhe sekuestrimin e atyre sendeve që përbëjnë prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale. Mund të ndodhë që kontrolli të bëhet edhe me qëllim kryerjen e një ndalimi, ekzekutimi të një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim*".[322]

Sa i përket standardit të arsyeve të bazuara, në vendimin e mësipërm është shprehur se ky standard nënkupton që ato *duhet të bazohen në të dhëna apo dyshime konkrete të bazuara në indicje reale, ato duhet të formojnë një bashkësi indicjesh që ngrihen objektivisht dhe drejtohen kundër personit të caktuar dhe që i referohen një lloji të caktuar vepre penale të dyshuar, jo çfarëdolloj vepre penale apo një kontroll të përgjithshëm pa një qëllim dhe objekt të caktuar, të paarsyetuar apo të pa shpjeguar mbi baza racionale. Qëllimi i kontrollit të ligjshëm përkufizohet nga objekti i kontrollimit dhe i vendeve mbi bazën e të cilët duhet të bazohen arsyet për të menduar se është kryer një vepër dhe do të gjenden sende apo prova që lidhen me atë vepër. Kryerja e kontrollit me iniciativë të policisë gjyqësore, duhet të bazohet në baza probabiliteti dhe objektive që konvergojnë rreth gjetjes së sendeve mbi një person apo në një vend të caktuar për lloje të përcaktuara veprash penale dhe me një objekt të paracaktuar. Mungesa e lidhjes së objektit të veprimtarisë së kontrollit me objektin e veprimtarisë kriminale do ta shndërronte kontrollin nga një mjet për kërkimin e provave, në një mjet për kërkimin e njoftimeve të veprave penale, i cili do të ishte subjekt i veprimeve arbitrare*[323]

Nga mënyra e përkufizimit, standardi i përdorur nga neni 202/1 i KPrP me termin "*arsye të bazuara",* gjykoj se barazohet me standardin e *"dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova"* i parashikuar nga neni 228 i KPrP. Një qëndrim i tillë mbështetet nga jurisprudenca e gjykatave tona të faktit. Konkretisht, në vendimin me nr. Akti 808, datë 1.05.2012 gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se "*Në analizë edhe të akteve shkresore të vëna në dispozicion të gjykatës dhe ... të analizuara në unitet me njëri-tjetrin, vlerësohet se krijojnë dyshimin e arsyeshëm se shtetasi në fjalë, mund të jetë një ndër autorët e veprës penale. Në rrethanat kur ekziston dyshimi i arsyeshëm se shtetasi E.D mund të jetë një ndër autorët e veprës penale të vjedhjes në bashkëpunim, me qëllim zhvillimin e hetimit të plotë dhe të saktë, gjykata konkludon në pranimin e kërkesës së prokurorisë për kontrollin e banesës së shtetasit E.D ndodhur në Bashkia – Vorë, si e bazuar në ligj e në prova*."[324] Të njëjtin standard për lejimin e kontrollit ka pranuar gjykata edhe në vendimin në vijim. Konkretisht, në

---

[322] Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 26.06.2017 dhe 30.06.2017.
[323] Po aty.
[324] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 808, datë 1.05.2012

vendimin nr.Akti 939, datë 28.05.2012 gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë[325] ka arsyetuar se "*...ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se e pandehura merret me aktivitetin e fallsifikimit të dokumenteve shkollore dhe se në banesën e saj mund të gjenden dokumente të tjerë të fallsifikuar, mjete për fallsifikimin, si çertifikata personale të të dëmtuarve, kopje të deftesës së klasës së tetë të dëmtuarve, fotografi të tyre apo sende të tjera që lidhen me veprën penale të "Fallsifikimit të dokumenteve shkollore" parashikuar nga neni 187 të KP. Këto dyshime mbështeten në deklarimet e dhëna nga shtetasit L.B, E.Xh, R.B, akte ekspertimi grafik nga rezulton se diplomat e shkollës së mesme janë të fallsifikuara.*" [326] Gjykata ka arsyetuar më tej se "*Është krijuar dyshimi i arsyeshëm se e pandehura E.Z, ka kryer fallsifikimin e kopjeve të deftesave të klasës se tetë të dëmtuarve, fotografi të tyre etj. Në rrethanat kur ekziston dyshimi i arsyeshëm, se në adresën ku jeton e pandehura E.Z, fshihen prova materiale si vula, stampa për fallsifikim, çertifikata lindje të të dëmtuarve, kopje të deftesës së klasës së tetë të dëmtuarve, fotografi të tyre si dhe sende të tjera që bëhen me veprën penale për të cilën akuzohet e pandehura."*[327]

Barazia ndërmjet standardeve të ushtrimit të kontrollit dhe dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, gjendet edhe në argumentimin e vendimit të mësipërm të Gjykatës së Lartë, sipas së cilës*: "*(…) *kryerja e kontrollit me iniciativë të policisë gjyqësore, duhet të bazohet në arsye që krijojnë* ***një dyshim të arsyeshëm të konkretizuar dhe të individualizuar rreth një personi të caktuar****. Dyshimi i arsyeshëm për ushtrimin e kontrollit përbën një të dhënë të veçantë dhe objektive kundër një personi të caktuar rreth kryerjes së një vepre penale, bazuar në rrethana faktike të mjaftueshme për të ngritur supozimin e një njeriu mesatar duke besuar se në një person të caktuar apo në një vend të caktuar do të gjenden sende apo prova që lidhen me veprën penale. Vlerësimi i ligjshmërisë së kontrollit duhet të bazohet në të gjithë elementet faktikë që rezultojnë të dokumentuar në procesverbalin e kontrollit dhe eventualisht atë të sekuestrimit të sendit të gjetur nga ushtrimi i kontrollit, si dhe mënyrë së veprimit të disa llojeve të caktuar të autorëve të veprave penale.*[328]

Kjo nënkupton, gjithashtu, se në çdo rast, kërkesa e Prokurorit që i drejtohet gjykatës për të marrë autorizimin për kryerjen e kontrollit të personit apo të vendeve, duhet që njëkohësisht të jetë e shoqëruar edhe me provat përkatëse mbi bazën e të cilave gjykata krijon **arsyen** për të menduar që i dyshuari në personin e tij apo në mjedisin që ka në administrim fsheh prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale. Barazimi në standardet e mësipërme lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me rëndësinë e të drejtave themelore të përfshira në proces. Gjykata vendos për pranimin e kërkesës së prokurorit për kryerjen e kontrollit me vendim të veçantë. Ky vendim në përmbajtje përmban në mënyrë të përmbledhur arsyet dhe shkaqet në të cilat është bazuar gjykata në mënyrën e saj të disponimit si dhe provat në të cilat është bazuar.

Për sa më sipër, rregulli është që kontrolli kryhet me vendim gjykate. Mirëpo, në KPrP është parashikuar përjashtimi nga rregulli për rastet e flagrancës dhe rasteve kur duhet të kryhet një ndalim, apo të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim

---

[325] Qëndrime të njëjta vihen re edhe në vendimet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.Akti 1390, datë 05.10.2012 dhe nr. Akti 1474, datë 24.10.2012.

[326] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 939, datë 28.05.2012.

[327] Po aty.

[328] Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 26.06.2017 dhe 30.06.2017.

dënimi. Nga interpretimi i neneve 203/3[329] dhe 298[330], rezulton se, që kontrolli i personit apo i vendeve të realizohet me iniciativë të policisë gjyqësore kërkohet që të vërtetohen në mënyrë kumulative kushtet e mëposhtme:

Së pari, të ekzistojë gjendja e flagrancës sipas përkufizimit të dhënë në nenin 252 të KPrP, ose oficerët e policisë gjyqësore të jenë duke kryer një ndalim sipas nenit 253 të KPrP, ose duke ekzekutuar një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim.

Së dyti, të ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova për të menduar që i arrestuari apo i ndaluari fsheh në personin e tij apo në vendin që ka në administrim sende ose gjurmë të veprës penale.

Së treti, të ekzistojë gjendja e urgjencës e cila nuk lejon nxjerrjen e një vendimi kontrolli nga gjykata kompetente.

Theksojmë se edhe në dritën e jurisprudencës së Gjykatës së Lartë, në rastet e kontrollit me iniciativë të policisë gjyqësore, nuk preket standardi i "*arsyeve të bazuara*" që të krijojnë dyshimin mbi ekzistencën e provave materiale mbi personin apo vendin e dhënë. Iniciativa e policisë gjyqësore në këtë rast lidhet vetëm me ekzistencën e gjendjes së urgjencës, ku me gjendje urgjence duhet kuptuar ajo situatë në të cilën mosveprimi i policisë gjyqësore do të ndikonte drejtpërdrejt në gjetjen e provave dhe mospërfundimin e suksesshëm të hetimeve. Mendoj që, në rastin kur kontrolli kryhet nga policia gjyqësore në gjendjen e flagrancës, kjo është një situatë fakti që perceptohet drejtpërdrejtë dhe në këtë kuptim, kjo gjendje e presupozon ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm. Lidhur me momentin e evidentimit të flagrancës, Gjykata e Lartë shprehet se: "*Në këtë rast, duhet të ekzistojë një marrëdhënie e njëkohshme midis sjelljes kriminale të personit dhe faktit të perceptuar si vepër penale nga ana e oficerit të policisë gjyqësore, i cili mbi bazën e intuitës së tij dhe përvojës, të bazuar në të dhëna indicjare objektive dhe logjike arrin të krijojë mendimin e drejtpërdrejtë se personi është në kryerje e sipër të një vepre penale, apo e ka parë atë duke e kryer dhe fillon pas këtij fakti ndjekjen e personit. Në të gjitha rastet, nga dispozita objekt analize, rezulton se* ***gjendja e flagrancës dhe ndjekja e personit duhet të ekzistojnë përpara ndërmarrjes së kontrollit nga ana e oficerit të policisë gjyqësore dhe jo të lindë si rezultat i mëpasshëm nga kryerja e kontrollit me iniciativë të policisë gjyqësore***".[331]

GJEDNj, në çështjen Modestou k. Greqisë, datë 16.03.2017, ka arritur në konkluzionin se: "*Pavarësisht nga organi që e ka miratuar apo vendosur kontrollin*

---

[329] Sipas nenit 203/3 të KPrP: *"Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontroll, oficerët e policies gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 299"*

[330] neni 298 i KPrP parashikon se: *1. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të lokalit kur* ***kanë arsye të bazuara*** *të mendojnë se mbi personin gjenden të fshehura sende ose gjurmë të veprës penale që mund të zhduken a të humbasin ose që këto sende a gjurmë ndodhen në një vend të caktuar ose atje ku gjendet personi nën hetim ose i ikur. 2. Kur duhet të kryhet një ndalim, të ekzekutohet një vendim arresti ose një vendim dënimi me burgim, oficerët e policisë gjyqësore mund të bëjnë kontrollin e personit ose të lokalit, kur ekzistojnë kushtet e treguara në paragrafin 1 dhe ka arsye të veçanta urgjence që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli. Kur vonesa mund të dëmtojë përfundimin e suksesshëm të hetimeve, kontrolli i banesës që në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, që nuk lejojnë nxjerrjen e vendimit të kontrollit, oficerët e policisë gjyqësore, kryejnë me iniciativë kontrollin e personit ose të lokalit.*

[331] Vendim i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 26.06.2017 dhe 30.06.2017.

e rëndësishme është përmbushja e detyrimit ligjor për dhënien e arsyeve relevante dhe të mjaftueshme që përligjin kryerjen e kontrollit."[332]

Përveç parashikimeve të përgjithshme, në KPrP janë parashikuar edhe llojet e veçanta të kontrollit. Konkretisht, kontrolli i personit në nenin 204 të KPrP, kontrolli i vendeve në nenin 205 të KPrP, apo kontrolli i llogarive dhe dokumentecionit bankar në nenin 202/2 të KPrP. Të gjitha këto lloje të veçanta kontrolli bëhen sipas rregullave të parashikuar më lart, pra, si rregull këto kontrolle mund të bëhet vetëm sipas parashikimeve të nenit 202/1 të KPrP, kur më parë nga ana e gjykatës është disponuar me vendim të veçantë për kryerjen e tyre, dhe si përjashtim mund të kryhen me iniciativë të policisë gjyqësore në rastet e analizuar më sipër. Edhe në këto raste standardi i kërkuar është i "arsyeve të bazuara" që nga pikëpamja e nivelit të bazueshmërisë dhe provueshmërisë është i njëjtë me standardin e dyshimit të arsyeshëm.

3.5.3 Sekuestrimi

Instituti i sekuestrimit në të drejtën penale (procedurale dhe materiale), në varësi të funksionit dhe qëllimit që ndjek, parashikohet në tre forma (kuptime) kryesore:

Së pari, sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës, i parashikuar nga nenet 208 deri më 220 të KPrP.

Së dyti, sekuestrimi si një masë sigurimi, i parashikuar nga nenet 270-276 të KPrP. Ky lloj sekuestrimi përfshin sekuestron konservative (nenet 270-273 të KPrP) dhe sekuestron preventive (nenet 274-276 te KPrP).

Së treti, sekuestrimi si masë parandaluese i parashikuar nga "Ligji për Parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar". Ky lloj sekuestrimi ka një natyrë të veçantë dhe përbën risi në sistemin tonë të drejtësisë penale. Për këtë lloj sekuestrimi ligjvënësi ka parashikuar standarde të ndryshme të të provuarit nga ato që njihen në KPrP, për këtë qëllim një vëmëndje të veçantë do t'i kushtojmë në kapitullin mbi standardet e zbatuara në fazën e gjykimit.

3.5.3.1 Sekuestrimi si mjet kërkimi prove

Sekuestrimet si mjet për kërkimin e provës kanë për qëllim marrjen dhe ruajtjen nga ana e organit procedues të provave dhe sendeve që kanë lidhje dhe i përkasin veprës penale[333]. Sekuestrimi si mjet i kërkimit të provave është parashikuar nga nenet 208 – 220 të KPrP, në këto dipozita është parashikuar objekti i sekuestrimit, subjektet që disponojnë për kryerjen e sekuestrimit, të drejtat e palëve në këtë proces, mënyra e kryerjes sekuestrimit si dhe ruajtja, administrimi i sendeve e objekteve të sekuestruara. Sipas nenit 208 të KPrP, organet kompetente për të vendosur sekuestrimin e provave materiale apo të sendeve që lidhen me veprën penale janë gjykata dhe, në raste përjashtimore, vendos prokurori (neni 210 i KPrP). Sekuestrimi i provave materiale vendoset me vendim të arsyetuar kur është i domosdoshëm vërtetimi i fakteve të veprës penale. Nga ana e organit procedues mund të vendoset sekuestrimi i çdo sendi të luajtshëm ose të paluajtshëm, i cili lidhet me objektin e të

---

[332] Cit. nga Vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 26.06.2017 dhe 30.06.2017.

[333] Halim Islami, Artan Hoxha, Ilir Panda, Procedura Penale, Botimet Morava, Tiranë, 2007, fq. 302.

provuarit në procesin penal dhe jep njoftime për zgjidhjen e drejtë të çështjes penale. Lidhja që mund të kenë sendet, dokumentet, objektet etj, me procesin penal mund të jetë e ndryshme, ato mund të jenë mjete të cila kanë shërbyer për kryerjen e krimit, produkte të veprës penale, sende të cilat mbajtja ose tjetërsimi i tyre përbën në vetvete vepër penale, etj[334].

Për sa i përket standardit të provës, në vendimmarrjet e organit procedues që lidhet me sekuestrimin e dokumenteve, provave materiale apo korrespondencës, nga interpretimi sistematik i neneve 208 – 220 të KPrP, rezulton se emëruesi i përbashkët është *"ekzistenca e arsyeve të bazuara për të menduar që këto sende kanë lidhje me veprën penale"*. Konkretisht, neni 208/a flet për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike. Sipas kësaj dispozite në rastin e procedimeve për veprat penale në fushën e teknologjisë së informacionit, gjykata, me kërkesë të prokurorit, vendos sekuestrimin e të dhënave dhe të sistemeve kompjuterike. Paragrafi 2, sanksionon se *"Kur* ***ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për të menduar*** *se të dhënat e kërkuara kompjuterike janë memorizuar në një sistem tjetër kompjuterik apo në një pjesë të tij dhe këto të dhëna janë në mënyrë të ligjshme të kapshme prej ose janë të disponueshme nga sistemi kompjuterik fillestar, që kontrollohet, gjykata, me kërkesë të prokurorit, urdhëron menjëherë kërkimin ose hyrjen edhe në këtë sistem kompjuterik".*

Neni 209 parashikon sekuestrimin e korrespondencës. Sekuestrimi i korrespondencës bëhet vetëm me vendim gjykate dhe në raste të ngutshme me urdhër të prokurorit. Edhe këtu standardi që udhëheq zbatimin e këtij mjeti kërkimi prove është "*ekzistenca e arsyeve të bazuara*". Kjo do të thotë se vendimi i gjykatës për vendosjen e sekuestrimit duhet të jetë i bazuar në të dhëna dhe fakte bindëse, të grumbulluara nga policia gjyqësore deri në këtë fazë të hetimit të cilat në tërësinë e tyre tregojnë se letrat, letrat me vlerë, zarfet, pakot, vlerat monetare e pasurore, telegramet dhe mjetet e tjera të korrespondencës të cilat janë dërguar nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe në emër tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër, kanë lidhje me veprën penale. Në nenin 210 të KPrP është parashikuar e drejta e gjykatës për të vendosur sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur nuk i përkasin të pandehurit ose nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky sekuestrim mund të kryhet edhe me vendimin e prokurorit.

Në nenet 299, 300 të KPrP është parashikuar përjashtimi nga rregulli. Në këtë rast marrja e plikove, e korrespondencës ose sekuestrimi i provave materiale kur **ka shkaqe të bazuara se ka rrezik që të humbasin, bëhen me iniciativë të policisë gjyqësore**. Për këtë qëllim nga oficerët e policisë gjyqësore mbahet procesverbal, i cili brenda 48 orëve duhet t`i dërgohet pa vonesë prokurorit. Ky i fundit, brenda 48 orëve vijuese, me vendim të motivuar vleftëson sekuestron kur ekzistojnë kushtet. Duhet theksuar se edhe në rastet kur sekuestrimi i korrespondencës bëhet me urdhër të prokurorit apo me iniciativë të policisë gjyqësore, *standardi i ekzistencës së arsyeve të bazuara* mbetet i paprekur. Përjashtimi në këtë rast diktohet vetëm nga ekzistenca e rrezikut për humbjen apo shkatërrimin e sendeve në fjalë. Në për interpretimin e këtyre dispozitave duhet të kemi parasysh edhe nenin 36 të Kushtetutës sipas të cilit:

---

[334] Ferdinand Elezi, "Prova Penale dhe Procesi i të Provuarit", Disertacion, Tiranë, 2012, fq.166.

"*Liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjeti tjetër të komunikimit janë të garantuara*". Pra, vetëm në kushte të veçanta (si psh. për zbulimin veprave penale) lejohet cenimi i kësaj të drejte, por duke garantuar në maksimum të drejtat e tjera të palëve që shkëmbejnë korespondencën. Për këtë arsye në KPrP, sanksionohet që të drejtën për të vendosur sekuestrimin e ka gjykata. Por, për rastet e urgjencës duhet të kihet parasysh që vendimi për sekuestrim nga prokurori duhet të jetë i justifikuar nga rrethanat tepër të veçanta. Çdo arsyetim i kundërt bie në kundërshtim me parimet dhe të drejtat kushtetuese të shtetasve.

3.5.3.2 Sekuestrimi si masë sigurimi

Masat e sigurimit ndahen në dy kategori të mëdha: masa të sigurimit personal të cilat i drejtohen personit të dyshuar për kryerejn e veprës penale dhe masa të sigurimit pasuror, të cilat i drejtohen pasurisë që ka lidhje me veprën penale apo autorin e saj.

Në kategorinë e masave të sigurimit pasuror përfshihet sekuestroja konservative dhe sekuestroja preventive.

Objekti i sekuestros preventive është përcaktuar në nenin 274/1 të K.Pr.Penale në këtë mënyrë *"1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar."*

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme rezulton se sekuestrimi si masë sigurimi pasuror vendoset mbi sende që plotësojnë dy kushte:

Së pari, ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme që sendet të caktuar kanë lidhje me veprën penale, (sendet mund të jenë mjete ose produkt i veprës penale).

Së dyti, sendet janë të një natyre të tillë, që mund të përdoren nga autori dhe për pasojë përdorimi i tyre mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e veprës penale ose të lehtësojë kryerjen e veprave të tjera.

Në rastin e sekuestros preventive (neni 274 i KPrP) nuk është fjala për një lidhje me karakter provueshmërie si në rastin e sekuestros për marrjen e provës, edhe pse mund të ndodhë që objektet nën sekuestro preventive mund të shërbejnë edhe si prova. Me fjalë të tjera, nëse një objekt është nën sekuestro preventive kjo nuk pengon aspak që ai të konsiderohet provë materiale e veprës penale, edhe pse nuk i është nënshtruar një sekuestroje me qëllim marrjen e provës. Nga ana tjetër, nëse një send është nën sekuestron si mjet për kërkimin e provës, nuk del e nevojshme vendosja edhe e një sekuestroje të dytë si masë sigurimi me karakter preventiv. Pra, sekuestro preventive mund që të gjejë zbatim vetëm në ato raste kur nuk është vendosur sekuestrimi si mjet i kërkimit të provës, për mungesë të supozimeve se sendet në fjalë mund t'i shërbejnë të provuarit[335]. Në caktimin e masës së sekuestros preventive kërkohet standardi i dyshimit të arsyeshëm. Konkretisht, në vendimin nr. Akti 754, datë 23.04.2012, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë është shprehur se "*organi i akuzës nuk i paraqiti*

---

[335] Artur Selmani "Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së paligjshme në Shqipëri, në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar", botuar në Manualin "Itali – Shqipëri, Instrumente Ligjorë dhe Teknika të Luftës Kundër Krimit të Organizuar Transnacional Përballje Përvojash", Botim i Institutit të Kombeve të Bashkuara për Kërkimin mbi Krimin dhe Drejtësinë Penale (UNICRI), Tiranë, 2007, fq.443.

*kësaj gjykate asnjë provë, e cila të shërbejë si një **dyshim i arsyeshëm** dhe i mjaftueshëm, që realisht pasuritë në emër të shtetasve D.B dhe B.B apo dhe A.B e kanë burimin nga aktiviteti kriminal i familjarit të tyre. Vetëm faktin se shtetasit D.B dhe B.B, janë prindërit e shtetasit V.B, gjykata e konsideron të pamjaftueshëm, për të vendosur sekuestron mbi të gjitha pasuritë e tyre. Do të krijonte **dyshimin e arsyeshëm** për gjykatën dhe për pasojë edhe nevojën e vendosjes së sekuestros preventive mbi pasuritë e mësipërme, paraqitja e akteve të tilla të cilat të dokumentonin, pikërisht lidhjet e palëve të mësipërme në veprime të tilla si transferta financiare, transaksione të ndryshme, akte ligjore shitjesh, dhurimi apo blerjesh, midis shtetasit V.B dhe familjarëve të tij. Në kushtet e mungesës së akteve të tilla, gjykata nuk e konsideron një veprim juridik të motivuar vendosjen e sekuestros preventive mbi pasuritë e bashkëshortëve D.B dhe B.B.*"[336] I njëjti qëndrim mbi standardin e zbatuar rezulton në vendimin në vijim, në të cilin gjykata është shprehur se "*të gjitha faktet e provuara **mbështesin dyshimin** se pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe vlerat monetare të konsiderueshme të depozituara në banka, janë krijuar mbi bazën e të ardhurave të siguruara nga aktiviteti kriminal i shtetasit E.D, pra, pasuritë dhe shumat e vendosura në llogari bankare mund të jenë produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale të prodhimit dhe shitjes së lëndëve narkotike të kryer nga shtetasi E.D. Kjo duke pasur parasysh aktivitetin kriminal të këtij shtetasi, shumat e mëdha të investuara për blerje të pasurive të paluajtshme e të luajtshme apo në biznese të mundshme, shumat e mëdha të depozituara në banka dhe transaksionet e kryera me ato, të cilat nuk justifikohen nga pikëpamja ekonomike, sepse nuk identifikohen burime të ligjshme të ardhurash për të siguruar këto pasuri, pasi dhe ushtrimi i aktiviteteve tregëtare të regjistruara ka ndodhur pas vendosjes së pasurive të përmendura më sipër, transaksionet e kryera midis shtetasve A.S e A.M tek pasuritë e paluajtshme, si dhe të gjitha këto veprime pasurore rezultojnë se janë kryer afersisht në të njëjtën periudhë kohore midis tyre dhe aktivitetin criminal, për të cilin dyshohet shtetasi E.D.Gjykata mendon se kjo kërkesë është plotësisht e bazuar në ligj dhe në prova.*"[337]

Të njëjtin qëndrim mban edhe Gjykata e Lartë me vendimin nr. 126, datë 6.10.2011. Gjykata e Lartë ka prishur vendimet e gjykatave të faktit të cilat kishin pranuar vendosjen e sekuestros preventive ndaj pasurive të personave të tretë, të cilët si pronarë të ligjshëm, u kishin dhënë me qira të dyshuarve këto pasuri. Gjykata e Lartë arsyetoi: "*Është vërtetuar dhe pranohet nga gjykata pa asnjë ekuivok se sendet mbi të cilat është vendosur sekuestroja preventive janë objekte në pronësi të kërkuesve që ju janë dhënë me qira personave nën hetim për të kryer aktivitet tregtar e derisa ato janë në pronësi të personave të tjerë,* ***dhe nuk ka prova apo dyshime se midis tyre ka lidhje në kryerjen e aktivitetit kriminal, mbi to nuk mund të vendoset sekuestro preventive.***"[338]

Për sa i përket sekuestros konservative, neni 270/1 i K.Pr.Penale sanksionon se *"1. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nuk ka garanci për pagimin e dënimit me gjobë, të shpenzimeve të procedimit dhe të çdo detyrimi ndaj pasurisë së shtetit, prokurori kërkon sekuestron konservative të pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme*

---

[336] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 754, datë 23.04.2012.
[337] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 1768, datë 26.12.2012.
[338] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 126, datë 06.10.2011.

të të pandehurit ose të shumave a sendeve që të tjerët i detyrohen atij, në caqet që ligji lejon sekuestrimin e tyre".

Sekuestro konservative shërben si një masë me anë të së cilës sigurohet që pronari apo disponuesi i një pasurie, përkohësisht, nuk do të mund të ushtrojë të drejtat e tij të pronësisë mbi pasurinë e sekuestruar, me qëllim që përmes pasurisë objekt sekuestroje të mund të shlyhen të gjitha detyrimet e mundshme që do të ketë autori i veprës penale të kryer. Duke pasur këtë synim sekuestroja konservative shërben vetëm si mjet 'konservues' i pasurisë deri në shlyerjen e detyrimeve nga autori i veprës penale[339].

Nga interpretimi i dispozitës së mësipërme, që gjykata të dalë me vendim për vendosjen e sekuestros konservative, duhet që të ekzistojnë arsye të bazuara të cilat të bëjnë të mendosh që autori i veprës penale nuk garanton se do të paguajë dënimin me gjobë, shpenzimet e procedimit dhe çdo detyrim tjetër të mundshëm ndaj pasurisë së shtetit.

Pra, standardi, në këtë pikë, është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova, kriter i trajtuar gjërësisht në pjesën e masave të sigurimit personal.

---

[339] A. Selmani, vepër e cituar, fq.442

KREU IV

Barra e provës dhe standardi i aplikuar gjatë gjykimit në themel të çështjes

***Përmbledhje**: **4.1** Kuptimi i standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. **4.2** Parimi in dubio pro reo (dyshimet ne favor të të pandehurit). **4.3** Barra e provës. **4.3.1** Përjashtime të barrës së provës. **4.4** Vlerësimi i provave dhe formimi i bindjes së brendshme të gjyqtarit. **4.4.1** Vlerësimi i indicjeve në procesin penal*

4.1 Kuptimi i standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm

Në fazën e gjykimit standardi i të provuarit është i ndryshëm nga standardet që aplikohen në fazat e tjera të procesit penal. Gjykimi është pjesa më kulmore e procesit penal, ku përcaktohet fajësia apo pafajësia e të pandehurit. Në këtë fazë përcaktohet në mënyrë përfundimtare nëse një individi do t'i kufizohen disa të drejta apo nuk do t'i kufizohen. Ky vendim, me marrjen formë të prerë të tij bëhet detyrimisht i zbatueshëm për urdhërimet që përmban. Duke qenë se në fazën e gjykimit janë potencialisht në rrezik të drejta dhe interesa të rëndësishme të të pandehurit, si liria e tij, pasuria apo të drejta të tjera, kërkohet që niveli i sigurisë dhe vërtetësisë së vendimit gjyqësor të jetë i një shkalle sipërore, krahasuar me nivelin që kërkohet në vendimet që mund të marrë organi procedues gjatë fazave të mëparshme të procesit.

Siç e kemi parë në pjesë të tjera të këtij punimi, në faza të ndryshme të procesit penal, ka standarde të ndryshme të të provuarit. Në fazën e hetimeve paraprake është kryesor standardi i dyshimit të arsyeshëm. Ky standard nuk përfqëson sigurinë maksimale që mund të rezultojë nga një vendim gjyqësor, por ai është në përputhje me kërkesat ligjore që duhet të respektohen në një fazë të caktuar të procesit. Në fazën e gjykimit standardi i të provuarit është standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Aplikimi i këtij standardi i referohet rastit kur gjykata e konsideron të pandehurin fajtor dhe e dënon atë. Në rastin kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. I pandehuri shpallet i pafajshëm atëherë kur organi i akuzës nuk ka arritur të provojë në gjykatë se i pandehuri e ka konsumuar veprën penale në të gjithë elementët e saj përbërës ose kur ekziston një dyshim për akuzën, i cili, sipas parimit të njohur *in dubio pro reo*, çmohet nga gjykata në favor të të pandehurit.

Standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm është instrumenti parësor për reduktimin e dënimeve të padrejta.[340] Ai përcakton kufirin e gabimit, që duhet të jetë objekt i vëzhgimit prej gjykatave.[341] Dënimi mund të jepet vetëm atëherë kur të jetë e qartë *siguria gjyqësore* për përgjegjësinë e të pandehurit.[342] Ky standard është pjesë

---

[340] Sanford H. Kadish, Stephen J. Schulhofer, Criminal Law and its Processes. Cases and materials, Fifth Edition, Little, Brown and Company, Boston Toronto, London, fq. 39.

[341] Christian Diesen, "Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases", Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009, fq. 170. Cit. prej http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf. klikuar për herë të fundit me datë 20.11.2022.

[342] Giovanni Conso, Vittorio Grevi, Commentario breve al Codice di Procedura Penale. Complemento Giurisprudenziale. CEDAM, 2011, fq. 2165.

thelbësore e prezumimit të pafajësisë. Në procesin penal të pandehurit i rrezikohen interesa të rëndësishme, sepse ai jo vetëm mund të humbasë lirinë e tij si rezultat i dënimit, por, në të njëjtën kohë do të stigmatizohet prej këtij dënimi. Në këto kushte, një shoqëri që vlerëson emrin e mirë dhe lirinë e çdo individi, nuk duhet të dënojë një njeri për kryerjen e një krimi, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm rreth fajësisë së tij.[343] Përveç kësaj, aplikimi i këtij standardi i shërben krijimit të respektit dhe besimit të publikut në zbatimin e ligjit penal.[344] Është e rëndësishme që forca morale e së drejtës penale të mos vihet në diskutim nga një standard i të provuarit që i lë njerëzit me dyshimin se individët e pafajshëm dënohen.[345]

Standardi i të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm nuk ka kuptimin që në vlerësimin e fajësisë së të pandehurit të përjashtohet çdo lloj dyshimi. Literatura e huaj[346] thekson se provë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nuk do të thotë provë përtej çdo lloj dyshimi. Drejtësia nuk do të arrinte të mbronte komunitetin, nëse lejonte që opsione imagjinare ta shmangnin nga udha e saj.[347] Të vlerësosh provat në një çështje penale do të thotë të përcaktosh nëse provat në ngarkim të fajësisë së të pandehurit, të paraqitura nga akuza në gjykim, janë aq bindëse, saqë akuza e prokurorit përbën të vetmin shpjegim të arsyeshëm të fakteve të çështjes. E thënë më thjesht, kjo do të thotë që provat janë aq bindëse, saqë fajësia e të pandehurit është e sigurt. Skepticizmi personal, subjektiv dhe emocional i gjyqtarit që gjykon çështjen, për të mos e shpallur të pandehurin fajtor, nuk janë të mjaftueshme për të rrëzuar tezën e prokurorit.[348] Por, nëse në anën tjetër, ka një dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë e të pandehurit, atëherë ai duhet të shpallet i pafajshëm nga gjykata.

Në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri.[349] Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

Bazë për marrjen e një personi në përgjegjësi penale është që në veprimet/mosveprimet e tij të konstatohet ekzistenca e tipareve të një figure të veprës penale të parashikuar nga ligji penal. Konstatimi i elementëve të figurës së veprës penale ka rëndësi të madhe juridike, sepse ka të bëjë me respektimin e ligjshmërisë në të drejtën penale, e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, me luftën kundër

---

[343] Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970), cit. prej http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Winship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 17.10.2022.

[344] Po aty.

[345] Po aty.

[346] Peter Murphy, "Murphy për provën", Oxford University Press, 2005, përkth.Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 164.

[347] Po aty.

[348] Christian Diesen, "Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases", Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009, fq. 170. Cit. prej http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf. klikuar për herë të fundit me datë 20.11.2022

[349] Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970), cit. prej http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Winship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 17.10.2022.

kriminalitetit, në mënyrë që asnjë person i pafajshëm të mos dënohet.[350] Prokurori, në procesin penal, ka detyrën të bindë gjykatën se ekzistojnë të gjithë elementët objektivë dhe subjektivë të veprës penale të kryer nga i pandehuri ose që ka mbetur në tentativë. Në KP dhe në KPrP nuk parashikohet në asnjë dispozitë që prokurori duhet të provojë fajësinë e të pandehurit. Megjithatë, ky është një parim i njohur i qytetërimit perëndimor, i cili rezulton nga parimi i prezumimit të pafajësisë së të pandehurit dhe nga parimi se ai që akuzon duhet të provojë se ku e mbështet akuzën. Në këtë kuptim, prokurori ka detyrimin të provojë para gjykatës marrëdhënien juridike që ka cenuar i pandehuri, veprimin dhe/ose mosveprimin e kryer nga i pandehuri, pasojat e veprës penale, lidhjen shkakësore ndërmjet veprimeve dhe/ose mosveprimeve dhe pasojave, mënyra e kryerjes së veprës penale, vendi, koha, formën e fajit me të cilën është kryer vepra penale. Nga ana tjetër, edhe gjykata shprehet për fajësinë e të pandehurit, vetëm nëse është bindur, pas shqyrtimit të të gjitha provave sipas parimeve të barazisë së palëve dhe kontradiktoritetit, tej çdo dyshimi të arsyeshëm, se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në analizë të fundit, i takon gjykatës, si organi që jep drejtësi, të vlerësojë nëse ky standard i të provuarit është përmbushur nga organi i akuzës.

Në përcaktimin e një akuze penale, gjykata duhet të zbatojë standardet e një procesi të rregullt ligjor. Ky detyrim buron nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNj. Edhe GjEDNj, ka zhvilluar standardin e të provuarit të akuzës penale në ngarkim të një personi, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Një person nuk mund të deklarohet fajtor nëse nuk janë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, të gjithë elementët e veprës penale. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. GJEDNJ, në çështjen *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*[351], lidhur me standardin e vlerësimit të provave shprehet, *"Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit 'përtej çdo dyshimi të arsyeshëm', por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktimeve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit."* [352] Në doktrinën tonë juridike nuk është trajtuar gjerësisht standardi i të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Megjithatë, jurisprudenca e gjykatave tona, në këtë drejtim, ka bërë përparime duke njohur se akuza duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm edhe pse nuk jepet një kuptim i plotë i këtij koncepti. Zhvillim i rëndësishëm në jurisprudencën tonë është dallimi që ka bërë Gjykata e Lartë[353] midis standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe standardit të dyshimit të arsyeshëm. "*Dispozita e pikës 1 të nenit 228*[354] *tregon vetë dallimin e natyrës së veçantë të gjykimit dhe mënyrën e kriteret mbi të cilat krijohet bindja e gjykatës për caktimin ose jo të masës së sigurimit krahasuar me atë të dhënies ose jo të vendimit të dënimit. Në rastin e parë, gjykimi mbështetet në dyshime të arsyeshme bazuar në prova, që tregojnë mundësinë e kryerjes së veprës penale objekt procedimi dhe mundësinë e atribuimit, pra të*

---

[350] Prof.Dr.Ismet Elezi, etj., Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, Geer, Tiranë, 2006, fq. 88.

[351] Çështja *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 23458/02), 24 mars 2011, parag. 181.

[352] Po aty.

[353] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011.

[354] Neni 228/1 i Kodit të Procedurës Penale. Kushtet për caktimin e masave të sigurimit personal:

1. Askush nuk mund t'u nënshtrohet masave të sigurimit personal në qoftë se në ngarkim të tij nuk ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në prova.

ekzistencës së fajësisë, pikërisht në drejtim të të gjykuarit për atë vepër penale (fumus commissi delicti), ndërsa në rastin e dytë, gjykimi mbështetet vetëm në prova që vërtetojnë, jashtë çdo dyshimi, dhe e bindin gjykatën për kryerjen ose jo të veprës prej tij".[355]

Ky dallim është i rëndësishëm, sepse thekson që standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, është një standard që aplikohet në gjykimin e themelit të çështjes penale. Këtu është e nevojshme të bëjmë sqarimin se ky standard aplikohet atëherë kur gjykata bindet për fajësinë e të pandehurit. Nëse gjykata merr vendim për pafajësinë e të pandehurit, nuk kërkohet që bindja e gjykatës të jetë krijuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këtë kontekst, mjafton vetëm një dyshim i arsyeshëm mbi fajësinë, që i pandehuri të deklarohet i pafajshëm. Gjithashtu, konkluzioni i mësipërm i Gjykatës së Lartë i shërben dhe konsolidimit të praktikës së gjykatave më të ulta. Në disa vendime të Gjykatës së Apelit rezulton se kjo gjykatë u ka dhënë përgjigje në mënyrë të drejtë pretendimeve të mbrojtjes së të pandehurit, të cilët kërkonin aplikimin e këtij standardi të të provuarit që në fazën e shqyrtimit të masës së sigurimit. Gjykata e Apelit Tiranë ka theksuar se "*Përsa i përket pretendimeve të ngritura në ankimin e personit nën hetim, lidhur me provueshmërinë tej çdo dyshimi të arsyeshëm të veprës penale, gjykata e apelit çmon se ato mbeten të shqyrtohen në hetimet e mëtejshme paraprake apo dhe **<u>në gjykimin e çështjes në themel</u>**, por që në kuadër të caktimit të masës së sigurimit është i mjaftueshëm fakti i ekzistencës së dyshimit të arsyeshem dhe të bazuar në prova për kryerjen e veprës penale*".[356] Qëndrime të njëjta rezultojnë edhe në vendime të tjera të Gjykatës së Apelit.[357] Edhe pse Gjykata e Apelit në mënyrë të gabuar shprehet se standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm aplikohet në hetimet e mëtejshme paraprake, ka një qëndrim të saktë në lidhje me aplikimin e këtij standardi në gjykimin e çështjes në themel.

Në KPrP, përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017 nuk normohej se cilin standard duhet të respektonte gjykata në deklarimin e fajësisë dhe natyrisht, as themelin dhe bazën e formimit të këtij standardi. Megjithatë, përpos këtij fakti, ky standard është përpunuar nga gjykatat tona, në dritën edhe të jurisprudencës së GJEDNJ. Duke qenë se KPrP nuk përcaktonte nivelin e bindjes, që duhet të ekzistonte në rastin e vërtetimit të saktë dhe të plotë të fakteve, aplikimi i standardit të të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm, është bërë nga gjykatat rast pas rasti, në varësi të specifikës së çdo çështjeje penale konkrete. Me ndryshimet legjislative të vitit 2017, ligjvënësi kodifikoi standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke ndjekur në fakt një tendencë të sistemeve ligjore kontinentale drejt pranimit të standardeve që e kanë origjinën nga common law, ku shembull konkret përbën legjislacioni procedural italian që standardin e mësipërm e prezantoi në vitin 2006. Aktualisht, neni 390/1 i KPrP ka këtë përmabjtje: "*Kur fajësia e të pandehurit provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, gjykata jep vendim dënimi, duke caktuar llojin dhe masën e dënimit*". Pavarësisht, se nuk jepet kuptimi i këtij standardi, kjo nënkupton që është detyrë e gjykatës të vlerësojë përmes gjykimit përmbushjen ose jo të këtij standardi. *A contrario* kuptohet se nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme mbi fajësinë e të pandehurit, atëherë ai duhet të deklarohet i pafajshëm. Relacioni ndërmjet këtyre

---

[355] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartëi Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011.
[356] Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 653, datë 23.12.2011.
[357] Për më shumë, Vendimet e Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 658, datë 27.12.2011; nr. 649, datë 21.12.2011; nr. 647, datë 21.12.2011; nr. 646, datë 21.12.2011.

standardeve kuptohet më qartë në rregullin e përcaktuar në nenin 427 pika 4 e KPrP, në të cilin pas ndryshimeve ligjore të vitit 2017 parashikohet se: "*Kur i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, gjykata e apelit nuk mund ta deklarojë atë fajtor vetëm mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë. Në këtë rast gjykata e apelit përsërit shqyrtimin gjyqësor*". Gjykoj se parashikimi i kësaj dispozite përbën rastin më konkret të kuptimit të efekteve dhe mënyrës se si duhet të zbatohet standardi përtej çdo dyshimi të arsyeshëm si një garanci e rëndësishme për individin në procesin penal. Në këtë rast, përmbushja e standardit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përbën njëkohësisht një kufizim apo pengesë për kompetencat vlerësuese të Gjykatës së Apelit, e cila nuk mund të shprehet për fajësinë e të pandehurit vetëm *mbi bazën e vlerësimit të ndryshëm të provave të marra në gjykimin në shkallë të parë.* Me fjalë të tjera, rregulli/kriteri ligjor i vendosur nga ligjvënësi është se vlerësimi i ndryshëm i provave të marra në gjykimin në shkallë të parë nga Gjykata e Apelit, nuk e përmbush standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ky standard përmbushet vetëm nëse Gjykata e Apelit shprehet për fajësinë e të pandehurit, kur një përfundim i tillë është rrjedhojë e përsëritjes së shqyrtimit gjyqësor.

Në zbatim të standardit të të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm, Gjykata e Lartë, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se vendimi i fajësisë së të pandehurit nuk mund të mbështetet në një provë të vetme. Konkretisht në vendimin nr. 291, datë 15.03.2007[358], të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, thuhet: *"... një provë e vetme e pashoqeruar me prova të tjera apo indicie, nuk mund të shërbejë në arritjen e përfundimit për fajësinë e të pandehurit..."*.[359] Më tej, në këtë vendim Gjykata e Lartë shprehet se "*Ekziston dyshimi lidhur me autorin e vrasjes dhe fajësinë e të gjykuarit A.R. (...) nuk ka asnjë provë që të mënjanojë dyshimet për akuzën e në të kundërtën, shtohen dyshimet për qenien e të gjykuarit si autor i vrasjes. Analiza e arsyetimi i bërë në vendimin e gjykatës së apelit që gjithçka e bazojnë vetëm në një provë të tërthortë (deklarimet e T.D të mohuara prej saj në seancë gjyqësore), nuk gjejnë mbështetje në kërkesat e nenit 152 të K.Pr.Penale. Duke qenë para faktit se, baza e të provuarit që pranon gjykata e apelit, nuk përjashton dyshimin per autorësinë e të gjykuarit për shkaqe të ndryshme, si: koha e gjatë e kaluar nga ndodhja e ngjarjes, e mungesa e provave direkte, duhet pranuar kriteri i përcaktuar në nenin 4 të KPrP, sipas të cilit "çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit" e, duke zbatuar këtë kriter, çështja penale në ngarkim të të gjykuarit A.R, nuk mund të vazhdojë*".[360]

---

[358] Në këtë çështje rezulton se: në vendimin e gjykatës së rrethit përmendet si provë në favor të akuzës dëshmia e dëshmitarit Sh.R, i cili edhe në deklarimet para oficerit të policisë gjyqësore ishte shprehur se ishte bashkë me Sh.M, duke punuar afër vendit të ngjarjes dhe kishin parë të kalonin në rrugë dy persona para se të dëgjoheshin krismat e armëve, por nuk mund të identifikonte asnjërin prej tyre. Në seancen gjyqësore të datës 09.01.2004, është bërë paraqitja për njohje e të gjykuarit A.R dhe dëshmitari është shprehur se nuk njihte asnjë nga personat që ishin aty dhe asnjërin prej tyre nuk e kishte parë ditën e ngjarjes. Gjyakata e rrethit gjyqësor ka deklaruar fajtor të pandehurin. Gjyakata e Apelit e ka lënë këtë vendim në fuqi. Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e Apelit dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim. Edhe mbas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit duke u shprehur se, e gjen të bazuar në prova që, në unitet me njëra tjetrën, krijojnë bindjen në fajësinë e të gjykuarit A.R. Në vendim bëhet një arsyetim më i gjerë në deklarimet e bëra para oficerit të policisë gjyqësore nga T.D, duke i pranuar të vërteta këto deklarime dhe jo dëshmine para gjykatës.

[359] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 291, datë 15.03.2007.

[360] Po aty.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata e Lartë edhe në vendimin vijues[361], në të cilin e ka konsideruar të pamjaftueshëm për ta deklaruar të pandehurin fajtor, bazuar në provën shkencore – aktin e ekspertimit daktiloskopik mbi gjurmën e gishtit të të pandehurit. "*Problemi i të provuarit të akuzës është themelori për çdo proces dhe kjo kërkon një analizë të plotë e të gjithashme të provave që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke mënjanuar mbivlerësimin e çdo prove, gjë që do të dëmtonte procesin gjyqësor. Nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale vetëm me një prove çfarëdo qoftë ajo edhe në se është shkencore (sikurse është vepruar me provën e gjurmës së gishtit të të gjykuarit K.B), në se nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Nuk mund të ketë për gjykatën asnjë provë me vlera të paracaktuara e që t'a mbeshtesë vendimin e fajësisë apo pafajësisë vetëm me një provë, pa u harmonizuar ajo me prova të tjera.*".[362]

Një qëndrim i njëjtë i konsoliduar ekziston edhe në vendimin vijues[363] ku Gjykata e Lartë thekson se "*Neni 152/1 të K.Pr.Penale përcakton se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar dhe duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor. Për pasojë, fajësia e të pandehurit në një proces penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar vetëm në një provë të vetme, e pambështetur me prova të tjera, për më tepër kur ajo nuk provon qartësisht fajësinë e të gjykuarve. Nëse do të konkludohej me një provë të vetme, atëherë kësaj prove do t'i jepej vlerë e paracaktuar dhe në këtë rast nuk do të kishim çmuarje të provave, gjë që është kërkesë e detyrueshme kësaj dispozite. E vetmja provë që jep të dhëna fajësie në drejtim të një pjese të të pandehurve, janë procesverbalet e komunikimit të bisedave telefonike, të ardhura nga përgjimi telefonik, i cili përbën në vetvete një mjet për kërkimin e provës dhe kërkon domosdoshmërisht lidhjen e kësaj prove me prova të tjera, të cilat në rastin konkret mungojnë*".[364] Në vlerësimin e Gjykatës së Lartë rezulton se, pavarësisht llojit dhe karakteristikave të provës, provë shkencore, materiale apo shkresore etj, nëse ajo është e vetme dhe e pa lidhur me prova të tjera, nuk mund të shërbejë për të deklaruar të pandehurin fajtor. Në lidhje me këtë gjetje që rezulton nga vendimet e praktikës gjyqësore, do të shprehemi në vijim pas trajtimit edhe të indicjeve si mjete të të provuarit të fakteve. Në vendime të tjera Gjykata e Lartë, pavarësisht ekzistencës së disa provave të shqyrtuara në gjykatat e shkallës së parë dhe të Apelit, ka analizuar nëse prova të tilla kanë qenë të mjaftueshme për krijimin e bindjes tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale.

Në vendimin në vijim, Gjykata e Lartë udhëzon gjykatën e Apelit që të sqarojë në mënyrë të padyshimtë rrethanat e veprës penale. Konkretisht, në këtë vendim[365] rezulton se gjykata e Shkallës së Parë Sarandë, ka vendosur deklarimin e pafajshëm të së pandehurës Ç.B. për veprën penale të "Mjekimit të pakujdesshëm", parashikuar nga neni 96/1 te KP. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër, e cila ka vendosur deklarimin fajtore të së pandehurës për veprën penale të "Mjekimit të pakujdesshëm"....Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Në rastin konkret pasoja e ardhur nuk ka asnjë lidhje shkakësore me veprimet apo mosveprimet e te pandehurës sepse pasoja e ardhur ishte për shkaqe të pavarura nga mjekja Ç.B. Gjykata e Apelit do të*

---

[361] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 876, datë 21.12.2005.
[362] Po aty.
[363] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 201, datë 05.07.2012.
[364] Po aty.
[365] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 235, datë 19.09.2012.

duhej të qartësonte në mënyrë të padyshimtë të gjitha rrethanat, veprimet apo mosveprimet konkrete të cilat kanë sjellë pasojën. Në këtë rast riçelja e pjesshme e shqyrtimit gjyqësor, ka qenë e domosdoshme për sqarimin dhe bindjen e gjykatës ***jashtë çdo dyshimi****, për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurës*".[366] Pamundësia për të përjashtuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm shkaqet alternative që kanë ndikuar në ardhjen e pasojave, bën që lidhja shkakësore të mos jetë e sigurt.[367] Kolegji Penal ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se gjykata e apelit ka marrë për bazë provat e mbledhura gjatë hetimit dhe jo ato që iu nënshtruan shqyrtimit gjyqësor.[368]

Gjykata e Lartë, në vendime të tjera të saj ka analizuar nëse elementë të tjerë të anës objektive të veprës penale, siç janë veprimet apo mosveprimet e të pandehurit, janë provuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Konkretisht, në vendimin nr. 204, datë 11.07.2012[369], rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të "Vjedhjes me dhunë" në dëm të shtetasit G.Z., në cilësinë e llogaritarit dhe arkëtarit të Shoqërisë Kursim- Krediti "A". Më pas, shoqëria "A" ka paraqitur kallëzim në prokurori për të pandehurin G.Z. për veprën penale të "vjedhjes duke shpërdoruar detyrën" për të njëjtin fakt vjedhjeje. Prokuroria i ka bashkuar të dy procedimet dhe e ka dërguar çështjen në gjykatë, duke e akuzuar të pandehurin G.Z. për veprat penale të "vjedhjes duke shpërdoruar detyrën" dhe "kallëzimit të rremë" të parashikuara nga nenet 135 dhe 305 të KP. Gjykata e rrethit gjyqësor Lushnjë e ka deklaruar fajtor të pandehurin G.Z. për veprën penale të parashikuar nga neni 135 i KP. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë. Kundër vendimit të apelit ka paraqitur rekurs i gjykuari. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë shprehet se "*I pandehuri nuk e ka kryer veprën penale, për të cilën është akuzuar dhe dënuar. Përfundimet e aktit të ekspertimit, mbi gjendjen mjekësore të të pandehurit në momentin e shtrimit të tij në spital menjëherë pas ngjarjes, nuk janë kategorike, të tilla që të justifikojnë plotësisht pretendimin se nuk ka pasur dëmtim të këtij personi dhe se gjithçka është simuluar. Gjykatat duhet ta vlerësonin aktin e riekspertimit në harmoni me të gjitha provat e tjera të administruara duke përcaktuar vlerën provuese të secilës prej tyre dhe duke e vlerësuar secilën në raport dhe harmoni edhe me provat e tjera. Gjykatat i kanë dhënë këtij akti vlerë të paracaktuar në kundërshtim me kriteret ligjore të vlerësimit të provave, ndërkohë që nuk kanë vlerësuar mungesën e disa fakteve/provave të tjera të rëndësishme, të cilat nëse do të ekzistonin do të shërbenin për të provuar plotësisht dhe* ***përtej çdo lloj dyshimi*** *akuzën në ngarkim të të gjykuarit. Pretendimet e prokurorisë se i pandehuri ka kryer veprën penale nuk provohen në asnjë moment në mënyrë të plotë, të qartë dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm".*[370] Dhe në një vendimmarrje tjetër, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Nga pikëpamja objektive vepra penale e "Fallsifikimit të dokumeteve" realizohet me veprime aktive kriminale të materializuara në formën e a)*

---

[366] Po aty.

[367] Cherif Bassiouni, Scienza e processo penale: Linee guida per l'acquisizione della prova scientifica, Istituto Superiore Internazionale Di Scienze Criminali, a cura di Luisella de Cataldo Neuburger, CEDAM, 2010, fq. 305. Për më tepër shih, Corte di Cassazione Penale n. 30328/2002, Sezioni Unite Penali, 11/09/2002,
http://www.altalex.com/index.php?idnot=5256, klikuar më datë 2 Shtator 2022.

[368] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 235, datë 19.09.2012.

[369] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 204, datë 11.07.2012.

[370] Po aty.

fallsifikimit të dokumenteve; b) përdorimit të dokumentit të falsifikuar. Përsa i takon formës së parë të veprimit kriminal, e cila lidhet me çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se vepra penale cilësohet e konsumuar kur i gjykuari kryen veprime aktive kriminale dhe ka realizuar fallsifikimin e dokumentit, të cilat duhet të vërtetohen tej çdo dyshimi të arsyeshëm gjatë shqyrtimit gjyqësor; në rastin konkret konkluzioni jo kategorik i aktit të ekspertimit nuk mund ta ngarkojë me përgjegjësi penale të gjykuarin."[371]

Në vendime të tjera të Gjykatës së Lartë arsyetohet në lidhje me të provuarin e anës subjektive të veprës penale tej çdo dyshimi të arsyeshëm.[372] Konkretisht, nga vendimi nr. 257, datë 10.10.2012 i Gjykatës së Lartë rezulton se i pandehuri ka aplikuar për pasaportë dhe është pajisur me një të tillë, por që ka pasur gabim të dhënat në lidhje me vitin e lindjes së të pandehurit. Janë studiuar të gjitha praktikat e aplikimit të të pandehurit për pasaportë. Është kryer ekspertimi grafik ku ka rezultuar se dorëshkrimet dhe vulat i përkasin punonjësve dhe zyrës së gjendjes civile. Gjykata e rrethit dhe ajo e Apelit e kanë deklaruar të pandehurin fajtor për veprën penale të falsifikimit të pasaportave, të parashikuar nga neni 189/1 i KP, në formën e përdorimit. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Gjykatat megjithëse e pranojnë faktin se vetë i gjykuari e ka denoncuar në Komisariat gabimin në vitlindjen e tij dhe ka kërkuar që të korrigjohet ky gabim, duke aplikuar për pasaportë të re me të dhëna të sakta, nuk e pranojnë këtë pretendim të tij, për faktin se ka një kohë të gjatë që e përdor këtë pasaportë. Ky pretendim si dhe ekzistenca e provave dhe e dëshmive të tjera që ndodhen në dosjen hetimore dhe atë gjyqësore çojnë në përfundimin se pretendimet e prokurorisë se i gjykuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet nuk arritën të provohen në asnjë moment në mënyrë të plotë, të qartë dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm*".[373] Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se nga provat e administruara në gjykim nuk ka rezultuar se plotësohen dhe elementët e anës subjektive të veprës penale, konkretisht fajësia e të pandehurit në kryerjen e veprës penale, në formën e dashjes direkte. "*Kolegji Penal i Gjykatë së Lartë çmon se me provat e mësipërme nuk konkludohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i gjykuari e ka konsumuar veprën penale të " Fallsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave, vizave" prandaj nuk duhej të merrej në përgjegjësi penale në bazë të nenit 189/1 i KP. Organi i prokurorisë nuk provoi gjatë gjykimit se i gjykuari A.F e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Mungon ana subjektive e kryerjes së veprës penale, e cila konsiston në përfitimin nga përdorimi i dokumentit prej të gjykuarit. Të gjitha provat të çojnë në konkluzionin se kemi të bëjmë me një gabim material në prodhimin e pasaportës nga organi shtetëror për të cilën nuk mund të penalizohet i gjykuari si mbajtës apo përdorues i dokumentit. Derisa nuk provohet një nga elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 189 i KP , ana subjektive, i gjykuari nuk mund të ketë përgjegjësi penale*".[374]

Në të njëjtën mënyrë, organi i akuzës duhet të provojë para gjykatës të gjithë faktet që përbëjnë veprën penale për të cilën është akuzuar i pandehuri. Vetëm, nëse gjykata bindet se prokurori ka arritur të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm akuzën e ngritur, e deklaron të pandehurin fajtor. Konsiderohet se faktet janë vërtetuar në

---

[371] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 292, datë 07.11.2012.
[372] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 257, datë 10.10.2012.
[373] Po aty.
[374] Po aty.

mënyrë të plotë, nëse gjykata, pas vlerësimit të të gjitha provave të mbledhura, sipas bindjes së brendshme, konstaton se faktet ekzistojnë dhe se nuk ka asnjë dyshim mbi ekzistencën e tyre.

4.2 Parimi in dubio pro reo (dyshimet ne favor të të pandehurit)

Është evidente se përkundër domosdoshmërisë shoqërore për vërtetimin e plotë të fakteve, për shkak të njohjes njerëzore të kufizuar dhe faktit se burimet e njohjes nuk janë të përkryera, gjyqtari e ka të vështirë të arrijë të vërtetën mbi ekzistencën e faktit. Jo rrallë, pas vlerësimit të gjithanshëm të materialit provues, te gjyqtari ngrihet dyshimi në lidhje me ekzistencën e ndonjë fakti, krijohet kështu dilema se a do të mund të përcaktohet nëse një fakt do të konsiderohet i vërtetuar apo jo.[375] Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm merr parimi *in dubio pro reo*. Dyshimi në favor të të pandehurit shpreh atë se kur paraqiten shumë zgjidhje të barabarta, preferohet ajo që është më e favorshme për të pandehurin. Ai është aktualizim i parimit të favorizimit të të pandehurit/*favor rei*.[376] Ky parim është i lidhur me standardin e përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe prezumimin e pafajësisë. Në nenin 4 të KPrP, së bashku me prezumimin e pafajësisë, është parashikuar edhe parimi in dubio pro reo. Duke qenë se prokurori duhet të provojë akuzën tej çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse kjo nuk arrihet për shkak se ka dyshime mbi rrethana apo fakte të caktuara, gjyqtari aplikon parimin in dubio pro reo.

Ky parim është parë në dy këndvështrime. Në këndvështrimin e ngushtë, aplikimi i këtij parimi lidhet me prezumimin e pafajësisë dhe kufizohet vetëm në çështjen: fajtor – jo fajtor. Në këndvështrimin e gjerë, aplikimi i këtij parimi del jashtë rrethit fajtor-jo fajtor dhe përfshin ekzistencën e dyshimeve për sa i përket të gjitha llojeve dhe kategorive të fakteve juridike në një proces penal, si të atyre që shkojnë në favor të të pandehurit, ashtu edhe ato që nuk janë në favor të tij.[377] Tek ky parim mbështetet formula e pranishme në KPrP për pushimin e akuzës ose çështjes penale, kur "nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën", ose në përfundim të hetimeve paraprake (neni 328/1, shkronja 'dh'), ose në përfundim të gjykimit (neni 388/1, shkronja 'd'). Dyshimet çmohen në favor të të pandehurit edhe përsa i përket provueshmërisë së ekzistencës së një kushti procedimi, apo një shkaku që shuan veprën penale (neni 387/2), si edhe në rastet e dyshimit për praninë e shkaqeve të përligjura apo të padënueshmërisë, gjatë kryerjes së veprës (neni 388/1, shkronja 'e'). Pra, dyshimet lidhur me akuzën apo dyshimet për faktet e tjera objekt prove nuk mund të çmohen në mënyrë tjetër, veçse në favor të të pandehurit. Kjo do të thotë që, për të deklaruar një person të pafajshëm, nuk kërkohet që të vërtetohet pafajësia e tij, por mjafton që akuza të mos vërtetojë dot se ai është fajtor.[378]

Zbatimi i këtij parimi gjen shprehje edhe në jurisprudencën e gjykatave tona. Nga analiza e vendimeve të Gjykatës së Lartë rezulton se parimi in dubio pro reo shihet i lidhur ngushtë me parimin e prezumimit të pafajësisë. Konkretisht, në vendimin nr.

---

[375] Prof.Dr Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale", Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë 2006, fq. 180, 181.
[376] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 102.
[377] Prof.Dr Ejup Sahiti, vepër e cituar, fq. 180, 181.
[378] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 4.

53, datë 18.02.2013 rezulton se i pandehuri është shpallur fajtor për veprën penale të përdorimit të dokumenteve të fallsifikuara. I pandehuri akuzohet për përdorim të dokumentit të nxjerre nga arkivi, i cili rezulton i falsifikuar. Është provuar gjatë hetimit e gjykimit se, i gjykuari ka aplikuar pranë zyrës së arkivit dhe është pajisur me një dokument të lëshuar nga ky arkiv. Gjykata e rrethit dhe e Apelit janë bazuar në aktin e ekspertimit grafik i cili është nuk është kryer mbi ekzemplarë, dorëshkrime të lira dhe vula origjinale, por ato janë marrë nga arkivi. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: "*Megjithëse burimi i këtij dokumentecioni është arkivi i shtetit, pikërisht këtij arkivi i është drejtuar edhe i gjykuari për tërheqjen e dokumentit. Paraqitja e këtij dokumenti, të tërhequr nga arkivi dhe të depozituar në Z.R.P.P, nuk mund ta ngarkojë të gjykuarin me përgjegjësi penale. Gjykatat nuk kanë patur parasysh anën subjektive të figurës së veprës penale. Sipas teorisë së të drejtës penale kërkohet ekzistenca e dijenisë së subjektit për kundërligjshmërinë e veprimit që kryen dhe vetëdijen e plotë, dashjen për t'i kryer këto veprime. Në rastin konkret, duke u prezumuar pafajësia e të pandehurit (gjykuarit), dyshimet duhet të shkojnë në favor të të gjykuarit. Në të njëjtën linjë arsyetimi është edhe praktika e GJEDNJ, e cila në vendimin e saj të datës 10 shkurt 1995, çështja Allenet de Ribemont kundër Francës, ndër të tjera arsyeton: "...35. Prezumimi i pafajësisë i parashikuar në paragrafin e 2 të nenit 6 është një ndër elementët e një procesi penal të drejtë siç kërkohet nga paragrafi 1 (shih veçanërisht vendimin Denëer kundër Belgjikës, datë 20 shkurt 1980). Ky parim shkelet në qoftë se një vendim gjyqësor lidhur me një person të akuzuar për kryerjen e një vepre penale pasqyron një mendim paraprak se ai është fajtor kur fajësia e tij nuk është provuar ende në bazë të ligjit. Madje edhe nëse nuk ka ende një konstatim formal, ka shkelje edhe kur gjatë arsyetimit del se gjyqtari e konsideron të pandehurin fajtor. ..."."*[379] Edhe në vendimin në vijim Gjykata e Lartë arsyeton në lidhje me aplikimin e parimit *in dubio pro reo*. "*Elementët kushtëzues të ekzistencës së një figure krimi në të drejtën tonë penale janë subjekti, ana subjektive, objekti dhe ana objektive. Ekzistenca e të katër këtyre elementeve të gërshetuar ndihmojnë gjykatën në përcaktimin e drejtë të figurës së veprës penale konkrete të kryer nga i gjykuari. Me të drejtë gjykata e apelit ka vlerësuar se në sjelljen e të gjykuarit gjenden të konsumuar të katër elementët e figurës së veprës penale dhe se motivet e provuara të kryerjes së veprës penale nga i gjykuari kundër të dëmtuarit (ana subjektive) kanë rezultuar për veprën penale të "Vrasjes me dashje", duke patur parasysh se të gjitha dyshimet lidhur me motivet dhe mekanizmin e ngjarjes,* ***duhet të vlerësohen në favor të të pandehurit*** *(Neni 4 i KPrP). Elementet e anës objektive të kësaj vepre që janë veprimet e kryera në mënyrë të kundërligjshme nuk provohen se janë kryer me paramendim. Elementi paramendim (dolus perameditatus) nuk u arrit të provohej për figurën e veprës penale të akuzuar fillimisht*[380]*. Nuk provohet që i pandehuri të këtë*

---

[379] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 53, datë 18.02.2013.

[380] Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër me vendimin nr.376, datë 09.10.2008 ka vendosur: "Deklarimin fajtor të të pandehurit, për veprën penale të "***Vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë***", të parashikuar nga neni 78- 22 i K.Penal. Deklarimin fajtor të të pandehurit, për veprën penale të "*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit",* të parashikuar nga neni 278/2 i K.Penal

Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr.109, datë 22.04.2009, ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit nr.376, datë 9.10.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër lidhur me deklarimin fajtor të pandehurit, cilësimin ligjor të veprës penale të "*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municionit",* parashikuar nga neni 278/2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Tonin Pjetër Kola për veprën penale të "***Vrasjes me dashje***" të mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 -22 të K.Penal.

parapërgatitur planin për të vrarë të dëmtuarin, pasi nuk rezulton i provuar motivi i pretenduar nga i dëmtuari, ai i hasmërisë mes familjeve."[381]

Në vendimin në vijim, Gjykata e Lartë ka nxjerrë konkluzionin se në kushtet kur fajësia e të pandehurit përcaktohet nga një provë e vetme, kjo jo vetëm që nuk përmbush standardin e të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm, por vjen në kundërshtimin edhe me parimin e sanksionuar në nenin 4 të KPrP, sipas të cilit çdo dyshim është në favor të të pandehurit. Konkretisht, në vendimin nr.1031 datë 07.12.2010 të Gjykatës së Lartë rezulton se i pandehuri H.B që ka iniciuar rekursin është proceduar për veprën penale të "Trafikimi i narkotikëve" të kryer në bashkëpunim. Ka rezultuar se, pas ndjekjes nga agjentët e policisë gjyqësore, është gjetur i ndaluar automjeti, me të cilin dyshohen se kanë lëvizur të dyshuarit. Nga dokumentet e gjetura rezultonte se automjeti i përkiste njerit prej të dyshuarve. Gjatë kontrollit u gjetën dhe u sekuestruan një sasi lëndësh narkotike. Në një paketë cigareje të ndodhur në automjet u gjetën gjurmë papilare, për të cilat u krye ekspertimi daktiloskopik dhe rezultoi se i përkisnin të pandehurit H.B. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pas vlerësimit dhe çmuarjes së provave, nuk ka krijuar bindjen në fajësinë e të gjykuarve V.T dhe H.B dhe i ka deklaruar ata ta pafajshëm për veprën e kryer. Ky vendim është ndryshuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda Tiranë përsa i përket të gjykuarve H.B dhe E.Ç duke i deklaruar ata fajtorë dhe dënuar sipas dispozitës së nenit 283/a/2 të K.Penal. Gjykata e Lartë ka çmuar se vendimi i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda duhet të prishet, pasi është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural penal. "*Kjo gjykatë, në marrjen e vendimit, ka vepruar ndesh me kërkesat e nenit 152 dhe 380 të KPrP, pasi në përcaktimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave i ka dhënë vlerë të paracaktuar aktit të ekspertimit daktiloskopik. Gjykata e Lartë ka çmuar se gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, pasi ka çmuar dhe vlerësuar provat konform detyrimeve të parashikuara nga neni 152 të KP, ka krijuar bindjen se në ngarkim të të gjykuarve H.B e V.T nuk ka prova rreth fajësisë së tyre, me të drejtë ka vendosur deklarimin e tyre të pafajshëm. Duke mos përdorur prova të tjera veç atyre që janë marrë dhe verifikuar në shqyrtimin gjyqësore, si dhe duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar asnjë prove, kjo gjykatë me të drejtë ka konkluduar se në rastin në gjykim, nga të gjitha provat e shqyrtuara dhe të analizuara, rezulton se nuk ka asnjë indicje tjetër, ose për më tepër provë direkte, që të provojë fajësinë e këtyre dy të gjykuarve. Përfundimi i arritur nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimë të Rënda, se në kushtet kur e vetmja provë që e implikon të pandehurin H.B në kryerjen e veprës penale, për të cilën është dërguar për gjykim, është akti i ekspertimit daktiloskopik nuk mund ta çojë gjykatën në fajësinë e tij, çmohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në kushtet kur kjo provë nuk lidhet me asnjë provë tjetër direkte ose indirekte që të provojë fajësinë e të gjykuarit H.B, deklarimi i tij fajtor vetëm mbi bazën e kësaj provë do të vinte ndesh me kërkesat e nenit 4 dhe 383/ç të KPrP dhe do ta çonte gjykatën në marrjen e një vendimi të pabazuar në ligj. Fajësia e të pandehurit në një proçes penal nuk mund të konkludohet duke u bazuar në një provë të vetme, e pa shoqëruar kjo me prova të tjera, pavarësisht faktit nëse kjo provë është një provë shkencore, është dëshmi, është provë me shkresë, apo çdo lloj prove tjetër. Në supozimin që fajësia e të pandehurit do të konkludohej me një provë të vetme, atëherë kësaj prove do t'i jepej vlerë e paracaktuar, gjë që është në kundërshtim me kërkesat e nenit 152/1 të KPrP dhe me*

---

[381] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 185, datë 28.06.2012.

parimin e sanksionuar në nenin 4 të KPrP, sipas të cilit çdo dyshim është në favor të të pandehurit. Në çështjen objekt gjykimi, pavarësisht faktit se në ngarkim të të pandehurit H.B ekziston një provë siç është akti i ekspertimit daktiloskopik, e cila është një provë shkencore, duke qenë se kjo provë nuk është e shoqëruar me asnjë provë tjetër që të provojë fajësinë e tij në kryerjen e veprës penale, fajësia e tij mbetet e dyshimtë. Me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se: "një element tjetër që e shton më tej dyshimin e gjykatës në fajësinë e të pandehurit është fakti se gjurma e gishtit e këtij të pandehuri është lënë në një paketë cigaresh, që është një send i luajtshëm, i ligjshëm dhe plotësisht i lirë në qarkullimin civil dhe nuk është lënë në sasinë e lëndës narkotike apo në mjetin që është bllokuar. Paketa e cigares, duke qenë një send i lirë në qarkullimin civil, si dhe nisur nga natyra e saj, mund të qarkullojë lirisht nëpër disa duar të cilat lënë gjurmët në të, duke shtuar më tej dyshimin e gjykatës në lidhje me fajësinë e të pandehurit H.B ...". Ndryshe nga ky arsyetim logjik dhe i drejtë, Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në të gjithë arsyetimin e vendimit të saj, duke i dhënë vlerë të paracaktuar aktit të ekspertimit daktiloskopik, e ka deklaruar të gjykuarin fajtor duke përmendur si prova në favor të akuzës prova të tilla si kqyrja e vendit të ngjarjes, proçes-verbali i kapjes në flagrancë, apo shpjegimet e dhëna nga punonjësit e policisë, edhe pse këto prova tregojnë faktin se ka ndodhur një vepër penale, por kurrsesi nuk mund të konsideroheshin si prova që gjykata të krijonte bindjen në fajësinë e të gjykuarit H.B, ndërkohë që në asnjërën prej tyre, përveç aktit të ekspertimit daktiloskopik, nuk përmendet apo figuron emri i të gjykuarit H.B."[382] Në lidhje me këtë vendim mund të thuhet se është në përputhje me KPrP dhe parimin se *çdo dyshim vlerësohet në favor të të pandehurit*. Gjykata e Lartë me të drejtë e ka vlerësuar si në përputhje me kërkesat e KPrP. Kjo ka qenë prova e vetme e organit procedues duke mos e shoqëruar atë me prova të tjera që të tregonin fajësinë e të pandehurit. Në kushtet kur kjo provë nuk lidhet me asnjë provë tjetër direkte ose indirekte që të provojë fajësinë e të gjykuarit H.B, dhe, në kushtet kur nuk përcaktohet se çfarë fakti vërtetohet me këtë provë deklarimi i tij fajtor, vetëm mbi bazën e kësaj prove, do të vinte ndesh me kërkesat e nenit 4 dhe 383/ç të KPrP dhe do ta çonte gjykatën në marrjen e një vendimi të pabazuar në ligj.

Një çështje e rëndësishme është se cili duhet të jetë niveli i intensitetit të dyshimit në lidhje me ekzistencën e një fakti të caktuar. Në këtë drejtim mbizotëron mendimi se intensiteti i dyshimit duhet të jetë i njëjtë si për konstatimin se fakti, i cili shkon në dëm të të pandehurit nuk ekziston, ashtu edhe për konstatimin se fakti i cili është në favor të të pandehurit, ekziston. Intensiteti i dyshimit duhet të jetë i avancuar, në kuptimin që të karakterizohet nga një besueshmëri e themeltë, që mbështetet në një shkak të arsyeshëm.[383] Një dyshim i arsyeshëm është një dyshim i cili ka karakteristikat e mëposhtme:

a) Është racional, i arsyeshme, dmth. që mund të përligjet logjikisht,
b) Është konkret, dmth. bazohet në faktet e çështjes,

---

[382] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 1031, datë 07.12.2010.
[383] Prof.Dr Ejup Sahiti, Argumentimi në procedurën penale", Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë 2006, fq.183.

c) Është relativ, dmth. përcaktimi i arsyeshmërisë duhet bërë në kuadër të natyrës së çdo çështjeje konkrete.[384]

Megjithatë, të tri këto karakteristika të dyshimit janë objekt i vlerësimit që u bën gjyqtari rrethanave, fakteve dhe provave të çështjes. Duke qenë se KPrP nuk parashikon kritere për mënyrën e vlerësimit të parimit *in dubio pro reo*, çmimi i karakteristikave të mësipërme do të bëhet rast pas rasti. Kjo mund të shkaktojë vlerësime subjektive të organit procedues, që nga ana tjetër mund të sjellë procedime penale apo vendime gjyqësore fajësie të pa mbështetura në mënyrë bindëse. Dyshimi i arsyeshëm që rezulton në përmbajtjen e parimit in dubio pro reo nuk duhet të ngatërrohet me standardin e dyshimit të arsyeshëm të aplikuar në fazën e hetimeve paraprake kryesisht për masat e sigurimit. *In dubio pro reo* aplikohet atëherë kur krijohen dyshime të arsyeshme në lidhje me fajësinë e të pandehurit ose me fakte të tjera të procesit të themelit, dyshime këto të krijuara nga fakti se akuza nuk i ka vërtetuar tërësisht ose se i pandehuri, bazuar në të drejtën për t'u mbrojtur, ka paraqitur mjaftueshëm argumenta që i bëjnë të dyshimta faktet e paraqitura nga akuza.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë paraqet raste, në të cilat parimi *in dubio pro reo* duhet të gjente vend në arsyetimin e gjykatës, pasi provat e çështjes krijonin një dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë. Konkretisht, në vendimin nr. 855, datë 06.10.2010 rezulton se i pandehuri është akuzuar për veprën penale të "Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor" parashikuar nga neni 290/1 i KP. Nga rrethanant e çështjes rezulton se janë kryer tre ekspertime autoteknike. Ekspertimi i parë është kryer në hetimet paraprake dt. 13.08.2007 nga eksperti i shërbimeve policore. Sipas këtij akti ekspertimi, shkak për aksidentin ka qenë i pandehuri. Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë ka lejuar gjatë gjykimit kryerjen e një ekspertimi tjetër të kryer nga dy specialistë. Me aktin përkatës datë 25.11.2007 kanë arritur në konkluzionin se shkaku determinant për ndodhjen e aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e shtetasit tjetër GJ.M dhe jo nga i pandehuri. Si pasojë, Gjykata e rrethit gjyqësor Lezhë e shpalli të pandehurin të pafajshëm. Mbi ankimin e organit procedues, çështja u gjykua në Gjykatën e Apelit Shkodër. Kjo e fundit vendosi rihapjen e shqyrtimit gjyqësor, duke administruar një akt të ri ekspertimi auto-teknik nga ekspertët teknikë të DPShQ Tiranë. Këta ekspertë nuk rezultojnë të kenë gjetur në shkelje të dispozitave të legjislacionit për qarkullimin rrugor të gjykuarin. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Apelit Shkodër, ndryshoi vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, e gjeti fajtor të gjykuarin për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 290/1 i KP dhe i caktoi dënimin përkatës. Gjykata e Lartë e gjeti të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit, e cila e konsideroi të pandehurin fajtor për kryerjen e veprës penale. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Në intepretim të dispozitës së nenit 178 të KPrP është e vërtetë se gjykata detyrohet të marrë mendimin e ekspertëve për kryerjen e kërkimeve, marrjen e të dhënave apo vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme në fushën përkatëse, megjithatë në përfundim të procesit të çmuarjes së provave (neni 152 i KPrP), në respekt të* ***parimit të përgjithshëm se asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar****, është gjykata ajo që vendos në lidhje me fajësinë ose jo të subjektit të gjykuar për kryerjen e veprës penale. Edhe pse gjykatës i kërkohet t'i referohet përfundimeve që arrijnë ekspertët e caktuar për kryerjen e aktit*

---

[384] Christian Diesen, "Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases", Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009, fq. 170. Cit. prej http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf. klikuar për herë të fundit me datë 20.11.2022.

të ekspertimit, kjo nuk do të thotë se ***vendimmarrja kushtëzohet thjesht dhe vetëm në ato konkluzione.***"[385]

Ky vendim i Gjykatës së Lartë dhe arsyetimi i tij është i kritikueshëm për disa arsye: Gjykata e Lartë nuk e aplikon në mënyrë të saktë parimin se provat nuk kanë vlerë të paracaktuar. KPrP përcakton qartë se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Pra, është e rëndësishme që fillimisht provat të debatohen në gjykim sipas parimit të kontradiktoritetit dhe më pas të përcaktohet se cila është fuqia provuese dhe vërtetësia e tyre. Në gjykimet e zhvilluara në dy shkallët e para të gjykimit rezulton se ky proces është kryer, madje Gjykata e Apelit ka rihapur shqyrtimin gjyqësor, duke mos e marrë të mirëqenë aktin e ekspertimit të kryer nga gjykata e rrethit gjyqësor. Pra, nuk rezulton se i është dhënë vlerë e paracaktuar akteve të ekspertimeve, përderisa ato janë shqyrtuar në gjykim. Gjykata, gjithashtu nuk ka marrë parasysh faktin se të dyja aktet e ekspertimeve të kryera respektivisht në shkallë të parë dhe në Apel, shpreheshin se i pandehuri nuk kishte kryer shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor. Në rastin konkret nuk mund të bëhet fjalë për vlerë të paracaktuar, kur ekzistojnë dy akte ekspertimi dhe jo një akt, të cilët shprehin të njëjtët konkluzione.

Gjykata e Lartë, gjithashtu, ka gabuar në lidhje me standardin e të provuarit në gjykimin penal. Nga arsyetimi i Gjykatës së Lartë kuptohet se *nuk është provuar pafajësia e të pandehurit*, ndërkohë që në gjykimin penal, standardi i të provuarit është krejtësisht e kundërta, duhet të provohet fajësia e të pandehurit *tej çdo dyshimi të arsyeshëm*. Ky standard është përpunuar edhe nga vetë jurisprudenca e Gjykatës së Lartë. Dy akte ekspertimi në favor të të pandehurit janë prova të mjaftueshme që krijojnë dyshime të arsyeshme në lidhje me fajësinë e tij në kryerjen e veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor sipas nenit 290/1 të KP. Bazuar në këtë, Gjykata duhet të shprehej për parimin *in dubio pro reo* dhe për faktin se në gjykimin penal, nga organi procedues nuk synohet të provohet pafajësia, por fajësia e të pandehurit. Nga ky vendim i Gjykatës së Lartë, nuk krijohet bindja *përtej çdo dyshimi të arsyeshëm* se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke përfunduar, mund të themi se parimi *in dubio pro reo* është një parim thelbësor për administrimin e duhur të drejtësisë penale. Ai është pjesë thelbësore e prezumimit të pafajësisë. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se "*Prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është* ***in dubio pro reo****, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte* ***që duhet të provohen*** *nga akuza*".[386]

---

[385] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 855, datë 06.10.2010.
[386] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 23.07.2009. I njëjti qëndrim rezulton edhe në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 28.04.2004.

4.3 Barra e provës

Një aspekt i rëndësishëm i prezumimit të pafajësisë është barra e provës. Më sipër pamë se bazuar në prezumimin e pafajësisë, i pandehuri konsiderohet i pafajshëm deri sa fajësia e tij të provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në procesin penal, barra e të provuarit të çdo elementi të akuzës, të elementëve të veprës penale dhe rrjedhimisht të fajësisë së të pandehurit, bartet nga fillimi deri në fund nga prokuroria. GJEDNJ ka arsyetuar që: "*Barra e provës rëndon mbi akuzën dhe i akuzuari duhet të përfitojë nga dyshimi. Prokurori duhet të informojë të akuzuarin për akuzën që ka ngritur kundër tij, në mënyrë që i akuzuari të ketë mundësinë të përgatisë mbrojtjen e tij në mënyrë të përshtatshme. Nga ana tjetër, i takon organit të akuzës të ofrojë prova të mjaftueshme për të mbështetur një konkluzuion fajësie*".[387] Gjithashtu, GJEDNJ ka konsideruar se kalimi i barrës së provës te i akuzuari cenon nenin 6 të KEDNJ. Konkretisht, GJEDNJ është shprehur se: "*Përpjekja për të detyruar të akuzuarin të sigurojë prova në lidhje me veprat që ai dyshohet se ka kryer, shkel të drejtën e tij për të qëndruar në heshtje dhe të drejtën për mos kontribuar në vetëinkriminim*".[388]

Procesi penal që prej fillimit të tij, që prej marrjes në pyetje të të dyshuarit, në tërësinë e tij mbështetet në prezumimin e pafajësisë. Kjo do të thotë që prezumimi i pafajësisë është parimi i parë drejtues dhe të gjithë parimet e tjera zënë fill pas tij. Në të drejtën e provave është normale të bëhet dallimi ndërmjet barrës së provës dhe mjeteve të provave, ku, ndërsa, si rregull barra e provës i takon akuzës, mjetet e provave mund të përdoren lirisht nga palët në procedimin penal për të provuar faktet objekt akuze (prokuroria) ose alibinë e të pandehurit, apo pretendimet e tij që mund ta shfajësojnë a lehtësojnë pozitën e tij. Parë në këtë këndvështrim GJEDNJ nuk lejon derogime të barrës së provës në procesin penal, pra nuk lejon prezumimin e fajësisë.[389] Por, megjithatë, ka disa përjashtime.

Në jurisprudencën e saj Gjykata Kushtetuese ka theksuar se në procesin penal... " barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës"[390], se "barra e provës i takon palës akuzuese"[391] që të provojë se i pandehuri i ka konsumuar të gjithë elementët e veprës penale për të cilën akuzohet. Konkretisht, në vendimin nr. 16/2009 të Gjykatës Kushtetuese rezulton se kërkuesi ka pretenduar se interpretimi i gabuar i nenit 283/1 të KP. ka cenuar dhe parimin e *prezumimit të pafajësisë.* Sipas tij, dyshimi nëse ai është ose jo përdorues droge nuk është vlerësuar në favor të tij, pasi gjykata është bazuar në përcaktimin e fajësisë nisur vetëm nga sasia e drogës së sekuestruar, duke kaluar kështu barrën e provës për vërtetimin e akuzës nga prokurori tek i pandehuri. Gjykata Kushtetuese është shprehur se "*Nga shqyrtimi i këtij pretendimi nuk rezultojnë prova që të pasqyrojnë faktin se anëtarët e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë që kanë gjykuar çështjen, e kanë konsideruar kërkuesin fajtor para se të shpallej vendimi për fajësinë e tij. Nga sa sipër, vlerësohet se gjykata nuk e ka filluar procesin gjyqësor me*

---

[387] Çështja *Barbera, Messegue, dhe Jabardo kundër Spanjës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10590/83), 6 Dhjetor 1988, pg. 77.
[388] Çështja *Funke kundër Francës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10828/84), 25 Shkurt 1993, pg. 44.
[389] Ma.Amarildo Laçi, "Mbi parimin e prezumimit të pafajësisë", Jeta Juridike, nr. 4, Viti XI i botimit, Tiranë, Dhjetor 2011, fq. 67.
[390] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 7.11.2011.
[391] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 7.11.2011 dhe Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 21.12.2011.

bindjen e paracaktuar se kërkuesi e ka kryer veprën penale. Gjithashtu, vlerësohen të pabazuara pretendimet e kërkuesit për kalim të ***barrës së provës*** *nga prokurori tek i gjykuari, për mosvlerësim të dyshimeve në favor të tij apo për përcaktimin e fajësisë pa prova të provuara nga prokurori, pasi këto nuk gjejnë pasqyrim në aktet dhe materialet gjyqësore. Në këto rrethana vlerësohet se nuk është cenuar asnjë nga aspektet e parimit të prezumimit të pafajësisë*".[392] I njëjti qëndrim rezulton edhe në vendime të tjera të Gjykatës Kushtetuese.[393]

Koncepti i barrës së provës në ngarkim të organit të akuzës është njohur edhe në vendimet e Gjykatës së Lartë. Konkretisht, ne vendimin nr. 257, datë 10.10.2012 rezulton se i gjykuari A.F ka aplikuar kundrejt pagesës për nxjerrjen e një pasaporte dhe kërkesat i ka plotësuar pranë avokatit P.L dhe duke mos qenë në dijeni të faktit të gabimit të vitlindjes në pasaportë e ka vënë atë në përdorim për të realizuar lëvizjen nga territori i shtetit shqiptar në drejtim të Italisë. I gjykuari kur ka rënë në dijeni të këtij gabimi ka kërkuar pranë Komisariatit të Policisë Fier korrigjimin e gabimit, madje pa u plotësuar afati 10-vjeçar i pasaportës, por nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier është regjistruar procedimi penal në ngarkim të tij, sipas akuzës. Gjykata e Lartë ka çmuar se "*Me provat e mësipërme nuk konkludohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i gjykuari e ka konsumuar veprën penale të " Fallsifikimit të letërnjoftimeve, pasaportave, vizave" prandaj nuk duhej të merrej në përgjegjësi penale në bazë të nenit 189/1 i KP. Organi i prokurorisë nuk provoi gjatë gjykimit se i gjykuari A.F e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. <u>Mungon ana subjektive</u> e kryerjes së veprës penale, e cila konsiston në përfitimin nga përdorimi i dokumentit prej të gjykuarit. Të gjitha provat të çojnë në konkluzionin se kemi të bëjmë me një gabim material në prodhimin e pasaportës nga organi shtetëror për të cilën nuk mund të penalizohet i gjykuari si mbajtës apo përdorues i dokumentit. Derisa nuk provohet një nga elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 189 i Kodit Penal, ana subjektive, i gjykuari nuk mund të ketë përgjegjësi penale*".[394]

Edhe në vendimin[395] në vijim rezulton se gjykatat kanë konsideruar si të paprovuar akuzën ndaj të pandehurit për kryerjen e vrasjes me dashje. Si Gjykata e Lartë, ashtu edhe gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrimin që i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të "Fshehjes ose asgjësimit të kufomës". Rezulton se, në një banesë në periferi të Londrës, është gjetur i vdekur, i vrarë me thikë, shtetasi shqiptar F.N. I gjykuari T.Ç dhe shtetasi P.Ç janë vëllezër dhe së bashku me viktimën F.N ishin banorë të qytetit të Shkodrës, kur emigruan në Britaninë e Madhe. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka filluar procedimin penal, për vrasjen me thikë, në Londër-UK, të shtetasit F.N. Gjatë procedimit shtetasi P.Ç ka rezultuar i papërgjegjshëm dhe ishte urdhëruar mjekimi i detyruar, ndërsa i gjykuari T.Ç është bërë subjekt i procedimit penal, pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të çështjes. Gjatë procedimit dhe gjykimit, i gjykuari T.Ç, me cilësinë e të pandehurit, ka deklaruar se nuk ishte autor i vrasjes me thikë të shtetasit F.N. Ai ka shpjeguar se kur është kthyer në banesë ka gjetur viktimën të shtrirë pa jetë. Ai ka vënë re se viktima ishte goditur disa herë me thikë. Në banesë ka gjetur vëllanë e tij P.Ç. Aty ka kuptuar

---

[392] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 15.06.2009.
[393] Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 18.09.2008; nr.23, datë 23.07.2009.
[394] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 257, datë 10.10.2012. I njëjti qëndrim rezulton edhe në vendimin nr. 292, datë 07.11.2012 dhe nr. 209, datë 11.07.2012.
[395] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 254, datë 10.10.2012.

se P.Ç kishte vrarë F.N. Gjatë përpjekjeve të tij për t'i dhënë ndihmë të ndjerit, i gjykuari është njollosur me gjakun e të ndjerit. I gjykuari, pasi ka konstatuar se vëllai i tij ishte plagosur në dorë, e ka ndihmuar duke ia larë dhe fashuar dorën. Më pas ka hedhur në lavaman të dy thikat e përdorura. Po sipas dëshmisë së të gjykuarit, ai ka hequr rrobat e tij dhe të vëllait të tij dhe më pas ka lëvizur trupin e pajetë të viktimës, duke e kapur dhe mbështetur trupin e tij, për ta transportuar drejt shkallës. Aty i ka vendosur një jastëk përsipër për ta mbuluar dhe fshehur. Në mënyrë që të mos dukej nga dera ka mbyllur perdet dhe së bashku me të vëllanë e tij, fillimisht janë larguar nga Londra dhe më pas nga Anglia. Gjykata e Lartë është shprehur se "*Ashtu si me të drejtë ka arsyetuar gjykata e apelit, pretendimet e organit të akuzës, e cila në parashtrimet e saj bën analizë të qëndrimeve dhe sjelljes të të gjykuarit nga fillimi i hetimeve, janë të karakterit psikologjik dhe nuk mund të përdoren si prova për mbi bazën e të cilave mund të mbështetet akuza e ngritur në gjykim. Këto indicje krijojnë vetëm dyshime mbi të gjykuarin, por nuk vërtetojnë akuzën e tij. Fakti se ai nuk ka pohuar më përpara, duke dhënë shpjegime vetëm pas 8 vitesh, nuk e bën atë bashkëpunëtor në krimin e vrasjes me dashje. Mosshpjegimi i rrethanave të faktit penal objekt gjykimi, jo domosdoshmërisht interpretohen si bashkëfajësi, për më tepër që autori i kryerjes së veprës penale të vrasjes me dashje ka qenë vëllai i tij, i dënuari P.Ç. Nëse mosveprimi i të gjykuarit është bërë për motive të fshehjes së bashkëpunimit dhe jo të qëllimit të tij për të fshehur viktimën është detyrë e organit të akuzës të vërtetojë të kundërtën, pasi barra e provës në procesin penal, i takon asaj dhe jo të pandehurit. Po kështu, konkluzionet e aktit të ekspertimit biologjik të njollave të gjakut vërtetojnë se i gjykuari ka pasur kontakte me viktimën, por nuk provojnë kohën se kur janë krijuar këto kontakte, pra nëse janë krijuar në përleshje e sipër, siç pretendon organi i akuzës, gjatë pjesëmarrjes së tij në vrasje apo pas vrasjes kur ka kryer veprimet e tij për të fshehur viktimën siç pretendon i gjykuari. Gjatë hetimit të çështjes, por edhe në të dyja shkallët e gjykimit, ka rezultuar se në shtëpi kanë qenë tre persona, viktima, i dënuari P.Ç dhe i gjykuari T.Ç, por nuk provohet se në çfarë momenti kanë qenë të tre bashkë, para ose pas vrasjes*".[396] Me të drejtë Gjykata e Lartë ka konstatuar se organi i akuzës nuk e ka përmbushur barrën e provës për të provuar veprën penale të vrasjes me dashje. Duke qenë se nuk provohen veprimet e kundërligjshme të të pandehurit ose bashkëpunimi i tij në vrasje, ekzistenca e këtyre rrethanave mbetet e dyshimtë, për pasojë i pandehuri duhet të përfitojë nga dyshimi.

Edhe në vendimin[397] në vijim rezulton se nga organi i prokurorisë nuk është provuar vepra penale e kallëzimit të rremë. Konkretisht, rezulton se e gjykuara F.A, nëpërmjet prokurës së posaçme, autorizonte shtetasen M.F, për të kryer të gjitha veprimet ligjore për shitjen e shtëpisë së saj. Në lidhje më këtë pasuri të paluajtshme e gjykuara që prej vitit 2000 ndodhet një konflikt civil, me shtetasin B.M dhe si provë kryesore në këtë proces është përdorur kjo prokurë. E gjykuara duke pretenduar se prokura nuk ishte hartuar dhe nënshkruar prej saj ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pas një hetimi të plotë, duke realizuar disa akte ekspertimi grafik shkrimi e nënshkrimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin B.M, i cili akuzohej për veprën penale të "falsifikimit të dokumenteve", të parashikuar nga neni 186/1 i K.P, vendim i cili është lënë në fuqi nga gjykata e Apelit

---

[396] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 254, datë 10.10.2012.
[397] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 154, datë 30.05.2012.

Tiranë. Në përfundim të këtij procesi ishte i kallëzuari B.M ai që ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të së gjykuarës duke e akuzuar se ka paraqitur kallëzim të rremë. Nga analiza e provave të shqyrtuara mungon ana subjektive e kësaj vepre penale. Ky krim i cili kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, dhe personi që jep informata apo deklarime të rreme e di që ato janë të tilla dhe dëshiron t'ua japë organeve të drejtësisë për ndjekje penale, në dëm të personit, e cila shoqërohet me ekzistencën e qëllimit konkret për të filluar ndjekje penale. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: "*Nga çmuarja e provave, nuk provohet se e gjykuara ka konsumuar elementët e figurës së veprës penale të "Kallëzimit të rremë", të parashikuar nga neni 305 i KP.* ***Organi i prokurorisë nuk provoi gjatë gjykimit****, se e gjykuara e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Për të krijohen vetëm dyshime, të cilat në bazë të nenit 4 të KPP çmohen në favor të saj. Derisa nuk provohet një nga elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 305 i KP, ana subjektive, nuk mund të ketë përgjegjësi penale, siç ka vendosur me të drejtë gjykata e Apelit. Jo çdo kallëzim, në të cilin ka thënie të pavërteta, përbën vepër penale të parashikuar nga neni 305 i KP. Pavarësisht se ekzistojnë informata të rreme, këto fakte nuk mund të ngarkojnë të gjykuarën me përgjegjësi penale*".[398]

4.3.1 Përjashtime të barrës së provës

Mund të evidentohen tre raste në të cilat barra e provës nuk rëndon tërësisht mbi akuzën:

1. Në rastet e veprave penale qartësisht materiale;
2. Në rastet kur i pandehuri pretendon se e ka kryer veprën në kushtet që e përjashtojnë nga përgjegjësia penale;
3. Në rastet e marrjes së vendimeve në lidhje me konfiskimin e pasurisë.[399]

Në rastin e parë, akuza duhet të paraqesë prova të mjaftueshme që provojnë se i akuzuari efektivisht ka kryer veprimin fizik (element material) pjesë përbërëse e shkeljes ligjore, por akuza nuk është e detyruar të vërtetojë që ai kishte si qëllim të vepronte në atë mënyrë ose të provokonte këtë rezultat. Kjo procedurë është në konformitet me parimet e KEDNJ-së, edhe pse shteti është i përjashtuar në provimin e qëllimit kriminal të të akuzuarit. GJEDNJ ka njohur që legjislacionet penale të shteteve përmbajnë shembuj të veprave penale qartësisht materiale.[400]

Për të tilla shkelje ligjore duhet të provohet vetëm fakti që i akuzuari e ka kryer veprën penale dhe, nëse vërtetohet kryerja e këtij veprimi, parashikohet një parim që e detyron të akuzuarin që të provojë të kundërtën e tij, pra që në veprimet e tij mungon dashja dhe elementë të tjerë të anës subjektive, me qëllim përjashtimin apo lehtësimin e përgjegjësisë penale të tij. GJEDNJ ka konstatuar që prezumime të tilla duhet të mbahen brenda limiteve të arsyeshme, duke marrë në konsideratë rëndësinë e rastit konkret në gjykim duke garantuar të drejtat e mbrojtjes. GJEDNJ ka theksuar se "*Prezumimet e faktit ose të ligjit veprojnë në çdo sistem ligjor. Qartazi, KEDNJ, në parim nuk i ndalon prezumime të tilla. Megjithatë, Shteteve Kontraktuese u kërkohet të mbeten brenda kufijve të caktuar në përputhje me ligjin penal. Nëse do të*

---

[398] Po aty.
[399] Ma.Amarildo Laçi, "Mbi parimin e prezumimit të pafajësisë", Jeta Juridike, nr. 4, Viti XI i botimit, Tiranë, Dhjetor 2011, fq. 70.
[400] Po aty.

konsiderohej se neni 6/2 i KEDNJ parashikon thjesht një garanci që duhet të respektohet nga gjykatat në kryerjen e procedurave ligjore, kërkesat e tij do të mbivendoseshin në praktikë me detyrën e paanshmërisë së imponuar në paragrafin 1. Mbi të gjitha, legjislaturat kombëtare do të ishin të lira për t'i hequr gjykatave pushtetin për të vlerësuar dhe do të cenonin prezumimin e pafajësisë në thelbin e tij, në qoftë se fjalët "sipas ligjit" do të interpretoheshin ekskluzivisht sipas ligjit të brendshëm. Një situatë e tillë nuk mund të barazohet me objektin dhe qëllimin e nenit 6, i cili, duke mbrojtur të drejtën për një gjykim të drejtë dhe në veçanti, të drejtën për t'u konsideruar i pafajshëm, synon të parashikojë parimet themelore të sundimit të ligjit".[401]

Literatura juridike i referohet rastit që parashikon Konventa e KB "Kundër krimit të organizuar transnacional"[402], në nenin 5, të së cilës thuhet se "Dijenia, synimi, qëllimi, plani, ose marrëveshja, të cilat përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive". Në zbatim të këtij instrumenti ndërkombëtar, i cili është pjesë përbërëse rendit tonë juridik, madje me fuqi më të lartë se çdo ligj tjetër, përjashtuar Kushtetutën, në rastet e kryerjes së veprave penale që lidhen me forma të veçanta bashkëpunimi, organit të akuzës i bie barra e provës të vërtetojë vetëm anën objektive të figurës së veprës penale nga i pandehuri, ndërsa elementët e tjerë që lidhen me anën subjektive, prezumohen se provohen nga rrethanat e faktit penal, ashtu siç janë vërtetuar gjatë procesit gjyqësor, në procedurën e kërkimit të së vërtetës procesuale. Është e kuptueshme që një prezumim i tillë është i thjeshtë (juris tantum) dhe qëndron deri në paraqitjen e provave të kundërta nga i pandehuri.[403] Megjithatë, rasti i prezumimeve ligjore në favor të akuzës, është një çështje doktrinore, pasi ligji ynë penal nuk parashikon prezumime ligjore në favor të akuzës, të cilat të synojnë ngarkimin me përgjegjësi penale të të pandehurit. Norma e Konventës së KB, e interpretuar më sipër, përbën një rregull logjik, që përdoret në nxjerrjen e deduksioneve në procesin penal. Prandaj, mendoj se në këtë rast nuk ka asnjë derogim nga barra e provës.

Rasti i dytë, i referohet atyre situatave kur organi i akuzës e ka akuzuar të pandehurin për një vepër penale, për të cilën duhet të provojë në gjykatë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm fajësinë e të pandehurit, dhe ,nga ana tjetër, i pandehuri mbrohet duke ngritur pretendimin se ka vepruar në kushtet që e përjashtojnë ose e lehtësojnë nga përgjegjësia penale. Kushte të tilla janë parashikuar në KP ose rezultonjë nga rrethanat. Si të tilla, mund të përmendim mbrojtjen e nevojshme, nevojën ekstreme, tronditjen e fortë psiqike, alibia etj,. Në procesin penal, siç dihet, të akuzuarit i garantohet e drejta për t'u mbrojtur. Në vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, në lidhje me parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën e mbrojtjes, Gjykata Kushtetuese është shprehur: " *(...) veçanërisht në procesin penal, barazia e armëve, kontradiktoriteti dhe lidhur ngushtë me këto, mbrojtja e të pandehurit, e garantuar shprehimisht në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ, përbëjnë në vetvete elementët më të qenësishëm e thelbësorë të procesit të rregullt ligjor. Synim kryesor është realizimi i një debati real ndërmjet akuzës dhe mbrojtjes, gjë që ndikon pozitivisht edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në zbulimin e së vërtetës dhe dhënien e drejtësisë nga*

---

[401] Çështja *Salabiaku kundër Francës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10519/83), 7 Tetor 1988, pg. 28.
[402] Ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002, botuar në Fletoren zyrtare nr. 41/2002.
[403] Ma.Amarildo Laçi, "Mbi parimin e prezumimit të pafajësisë", Jeta Juridike, nr. 4, Viti XI i botimit, Tiranë, Dhjetor 2011, fq. 71.

gjykata, me objektivitet e paanësi.[404] *Lidhur me parimin e barazisë së armëve Gjykata mban qëndrimin se provat paraqiten dhe marrin vlerën e tyre në debatin gjyqësor, ku secila palë ka mundësi për të paraqitur argumentet e veta në një pozitë jo më pak të favorshme se pala tjetër.*[405] Edhe GJEDNJ thekson, se sipas parimit të barazisë së armëve, secilës palë duhet t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të prezantuar çështjen e vet, në kushte të cilat nuk e vendosin në një pozitë më pak të favorshme përkundrejt kundërshtarit.[406]

I pandehuri në një proces gëzon të drejtën për t'u mbrojtur, por nuk ka detyrim të mbrohet, në këtë kuptim nuk ka detyrim që të provojë se është i pafajshëm. Funksioni i instituteve të mbrojtjes të parashikuar në ligjin penal, ka pikërisht qëllimin, që i pandehuri të deklarohet i pafajshëm ose që përgjegjësia e tij penale të zvogëlohet. Nëse të pandehurit do t'i kërkohej të provonte këto rrethana, atëherë do të cenohej parimi se i pandehuri nuk detyrohet të provojë pafajësinë e tij. Në doktrinën e huaj diskutohet në lidhje me këtë rast. Aktualisht, ka tre qëndrime doktrinare.

a) Qëndrimi i parë doktrinar ka kuptimin që rregullat e procedurës civile përbëjnë një të drejtë të përbashkët për të drejtën kontinentale, e cila duhet të respektohet nga të gjitha degët e kësaj të drejte. Kur prokurori provon pjesëmarrjen e një personi, b.fj., në krimin e komplotit, ky i fundit duhet të provojë ekzistencën e fakteve që e përjashtojnë nga përgjegjësia penale, sepse bëhet fjalë për një situatë përjashtimore që dikton zbatimin e maksimës *reus in excipiendo fit actor* (i padituri kur prapëson kthehet në paditës).
b) Qëndrimi i dytë doktrinar, diametralisht i kundërt me të parin(…), i mëshon faktit se parimi i prezumimit të pafajësisë përbën pengesë që personit të hetuar t'i kërkohet të provojë pafajësinë e tij. Pra, prokurori duhet të ketë nismën që, përgjatë gjithë procedimit, të provojë jo vetëm të gjitha elementet pozitive që e përligjin ushtrimin e ndjekjes penale ekzistojnë, por edhe se nuk ka asnjë pengesë për ushtrimin e saj. Në shembullin që sollëm, prokurori duhet të ndërmarrë nismën për të provuar se nuk ka shkaqe padënueshmërie, përjashtimi nga përgjegjësia, etj.
c) Së fundi, një degë e tretë e doktrinës, në njëfarë mënyre ndërmjetëse, konsiston në bërjen e dallimit midis barrës së provës, nga njëra anë, dhe barrës së pretendimit, nga ana tjetër. Në të gjitha çështjet që ndjek, prokurori nuk mund të ndërmarrë nismën për të provuar se asgjë nuk mund të bëhet pengesë për ushtrimin e ndjekjes, sepse kjo do të kërkonte kohë dhe do ishte e padobishme… Por, ai duhet të sjellë provën e mosekzistencës së fakteve negative sa herë që personi i hetuar ka pretenduar ekzistencën e njërit apo tjetrit fakt, me një besueshmëri të mjaftueshme. Në këtë këndvështrim, personi i hetuar nuk ka pse të vërtetojë rrethanën përjashtimore që ai ngre, por ka detyrimin ta pretendojë, ngaqë, nëse nuk e bën, prokurori nuk ka pse të ndërmarrë nismën për të vërtetuar mungesën e saj.[407]

Qëndrimi më i përshtatshëm është qëndrimi i tretë doktrinar që bën dallimin mes provës dhe pretendimit: në fakt ky qëndrim ia kalon nismën palës së akuzuar, por pa

---

[404] Shih vendimet nr.19, datë 12.06.2003 dhe nr.19, datë 18.09.2008 të Gjykatës Kushtetuese.
[405] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 27.04.2005.
[406] Shih Çështja *Bulut kundër Austrisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 17358/90), 22 Shkurt 1996, pg. 47; Çështja *Foucher kundër Francës*, GJEDNJ, (Aplikimi 22209/93), 18 Mars 1997, pg.34.
[407] Michèle-Laure Rassat, Procédure pénale, Deuxième édition refondue, PUF, Paris, 1995, fq. 314-315.

cenuar prezumimin e pafajësisë. Por, gjithashtu, e shkarkon prokurorin nga një detyrë e vështirë dhe e padobishme në gati shumicën e rasteve. Në këtë kuptim është e pranueshme se në ngarkim të të pandehurit qëndron vetëm barra e pretendimit dhe jo barra e të provuarit të rrethanës shfajësuese. Nga ana tjetër, mendoj se nuk mund t'i ngarkohet organit të akuzës barra e provës, që me nismën e tij, të provojë mosekzistencën e instituteve të mbrojtjes që përjashtojnë të pandehurin nga përgjegjësia penale. Vlen të diskutohet nëse i pandehuri kur pretendon duhet të përmbushë ndonjë standard dhe nëse po, cili është standardi që duhet të përmbushë. Përgjigja e kësaj e çështje gjendet në parimin *in dubio pro reo*, çka do të thotë se mjafton që i pandehuri të pretendojë para gjykatës në përputhje me standardin e një dyshimi të arsyeshëm se versioni i tij ekziston dhe është i vërtetë. Megjithatë, në ligj nuk përmendet një çështje e tillë. Mendoj se ky nivel standardi është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim akuzën dhe/ose elementët e saj. Në sistemin common law, të pandehurit i kërkohet të provojë sipas standardit që ndiqet në procesin civil, për paditësin dhe të padituri.[408] Mënyra më e zakonshme se si i pandehuri mund të përmbushë barrën e pretendimit është nëpërmjet argumentimit të magësive të akuzës së prokurorit. Megjithatë, i pandehuri nuk ka detyrimin të provojë dhe vërtetojë versionin e tij.

Në praktikën e gjykatave shqiptare evidentohen raste kur gjykata ka konstatuar se i pandehuri nuk ka arritur të provojë pretendimet e ngritura në gjykim. Konkretisht, në vendimin e gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë nr. 423, datë 10.04.2013, arsyetohet se "*Nga ana e tij në gjykim, i pandehuri nëpërmjet mbrojtjes se tij, duke pranuar faktin penal të ndodhur, ai i kërkoi kësaj gjykate, ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga ajo e "Plagosjes së rëndë me dashje" parashikuar nga Neni 88/1 i KP, në atë të "Plagosjes së rëndë me kapërcim të kufijëve të mbrojtjes së nevojshme" parashikuar nga Neni 88/b i KP. Por ndonëse pretendohet sa më sipër, nga ana e mbrojtjes së të pandehurit,..... nuk u paraqit asnjë provë në funksion të një pretendimi të tillë*".[409] Pra, mbrojtja e të pandehurit rezulton se nuk ka paraqitur asnjë provë për të provuar se i pandehuri ka qenë në kapërcim të kufijëve të mbrojtjes së nevojshme. Ky arsyetim i gjykatës nuk është në përputhje me konceptin e barrës së pretendimit që ka i pandehuri. I pandehuri nuk mund të detyrohet të sjellë prova në gjykim. Pretendimi i mësipërm i ngritur në gjykim mund të bazohet në analizën e provave të akuzës dhe në rrethanat objektive, në të cilat ka ndodhur fakti. Në këtë kuptim, gjykata nuk mund t'i kërkojë mbrojtjes paraqitjen e provave në gjykim. Në praktikën gjyqësore ka edhe raste të tjera ku gjykatat kanë konstatuar se i pandehuri nuk ka arritur të provojë versionin e tij. Konkretisht, në vendimin nr. 17, datë 17.01.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se i pandehuri është gjykuar për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i KP. I pandehuri ka ushtruar detyrën e ndihmësfarmacistit në Farmacinë e Shërbimit Onkologjik në QSU " Nënë Tereza", Tiranë. Ka rezultuar se ka patur diferenca mes sasisë së barnave të tërhequra nga Farmacia Qëndrore dhe atyre të bëra dalje në dy repartet e

---

[408] Për më gjerë, Frank.N Miller, etj., Criminal justice administration- cases and materials, Third edition, The Foundation Press, Inc, Mineola, Neë York, 1986. Standardi i kërkuar është ai i mbizotërimit të provave/balancës së probabiliteteve, sipas të cilit, konsiderohet e provuar kur paditësi ose I paditur kanë bindur gjykatën se version i tyre ka më shumë mundësi të jetë i vërtetë në krahasim me atë të palës tjetër, por jo tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Gjithashtu, Peter Murphy, "Murphy për provën", Oxford University Press, 2005, përkth.Erjon Shehi, UET Press 2010, fq. 166.
[409] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 423, datë 10.04.2013.

onkologjikut.[410] Në kuadër të përgjigjeve ndaj pretendimeve të mbrojtjes, gjykata është shprehur se "*të gjitha provat kundërshtojnë pretendimin e mbrojtjes se medikamentet e siguruara nga i pandehuri personave të tretë nuk ishin barna të përdorimit spitalor. Në asnjë rast i pandehuri nuk provoi gjatë gjykimit se ku i siguronte barnat e ndërruara apo shitura dëshmitarëve dhe personave të tjerë të identifikuar gjatë komunikimeve telefonike, fakt që e cilëson të pabazuar pretendimin e tij*".[411] Mendoj se ky nuk është arsyetim korrekt; konkluzioni se pretendimi i të pandehurit bie duhej, të nxirrej nga provat e shqyrtuara. Ky është një vendim i kritikueshëm, pasi tenton që barrën e të provuarit t'ia kalojë të pandehurit.

Në vendimet në vijim, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë korrekte, pasi, pavarësisht se kanë rrëzuar versionin e mbrojtjes, nuk i kanë kërkuar të pandehurit ta provojë këtë version. Konkretisht, në vendimin nr. 143, datë 18.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, arsyetohet se "*Nga ana e mbrojtjes së të pandehurit u pretendua se nuk ka asnjë provë për të vërtetuar akuzën ndaj të pandehurit Gj.T. Mbrojtja u mjaftua vetëm duke vënë në dukje faktin që asnjë person nuk ka deklaruar që ti ketë dhënë drejtpërdrejt para të pandehurit, por nga deklarimet e dëshmitarëve, rezulton plotësisht e provuar se i pandehuri Gj.T ishte bashkëpunëtor i dy të pandehurve të tjerë, M.M e P.K.*"[412] Rezulton se i pandehuri është gjykuar për veprën penale të mashtrimit me pasoja të rënda sipas nenit 143/2 të KP. Gjykata nuk ka pranuar pretendimin e mbrojtjes se i pandehuri nuk ka marrë para drejtpërdrejt nga të dëmtuarit, për sa kohë që është provuar bashkëpunimi i tij në kryerjen e mashtrimit. Gjithashtu, edhe në vendimin nr. 139, datë 23.03.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

---

[410] Nga shqyrtimi në tërësi i provave, konkretisht pyetjes së dëshmitarëve të akuzës, analizës së transkripteve të bisedave të përgjuara telefonike, raporteve të vëzhgimit dhe tërësisë së akteve të tjera procedurale të lejuara për shqyrtim rezultoi plotësisht e provuar se i pandehuri ka ndërmarrë veprime në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, duke keqadministruar me dashje barnat e destinuara për kurimin falas të pacienteve të Spitalit Onkologjik me qëllim sigurimin e përfitimeve monetare personale, veprime që kanë sjellë si pasojë cenimin e interesave shtetërore dhe atyre të pacientëve të shtruar për kurim. I pandehuri u paraqiste pacientëve gjendje të mungesës së barnave citostatike në farmacinë e Spitalit Onkologjik, të cilat ata duhet t'i përfitonin falas në kushtet e kurimit spitalor, me qëllim shitjen e mëpasshme të tyre duke siguruar përfitime ekonomike. Njëkohësisht i pandehuri ndërronte barnat e destinuara për përdorim spitalor, të cilat kishin jo më pak se 2/3 e afatit të skadencës me barna që ishin drejt fundit të afatit të skadencës, të siguruara prej përfaqësuesve të shoqerive që tregtonin barna farmaceutike. Këta të fundit pasi merrnin barnat e përdorimit spitalor nga i pandehuri i përdornin për tenderimin e ardhshëm të zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë në kushtet kur barnat e prokuruara duhet të kishin të paktën 2/3 e afatit te skadencës.

[411] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. 17, datë 17.01.2012.

[412] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 143, datë 18.02.2013. Në këtë vendim rezulton se i pandehuri është akuzuar për kryerjen e veprës penale të "mashtrimit" që ka sjellë pasojë të rënda, sipas nenit 143/2. Në kryerjen e veprës penale të pandehurit kanë bashkëpunuar me njëri tjetrin. Konkretisht i pandehuri P.K ka patur kryesisht rolin e ndërmjetësit, që duke shpërdoruar besimin e të njohurve të tij, prezantonte të demtuarit nga vepra penale me të pandehurit e tjerë dhe kryesisht me M.M. Si "shkak" e justifikim për të kryer mashtrimin e marrë shumat e të hollave, ai i gënjente të dëmtuarit duke i thënë se M.M do të merrte një kredi në bankë gjermane dhe se për këtë do ti ndihmonte Gj.T. Dikujt i ishte thënë se kredia që do merrej ishte 3.000.000 (tre milion) euro dhe dikujt tjetër 8.000.000 (tetë milion) euro. Më pas ky i fundit i prezantonte të dëmtuarit me të pandehurin tjetër Gj.T, i cili prezantohej si biznesmen dhe personi kryesor që kishte lidhje të drejtpërdrejtë me bankën gjermane. Shumat e kredisë, sipas tyre do të kalonin në llogaritë bankare të tij në Malin e Zi dhe duke qenë biznesmen, do ti përdorte këto shuma parash për të investuar në vendin tonë. Në këtë aktivitet Gj.T qëndronte zakonisht i tërhequr dhe të pandehurit e tjerë i prezantonin të dëmtuarit me të pasi i kishin takuar dy deri në tre herë, me qëllim për ta bërë të besueshëm aktivitetin dhe qëllimin e marrjes së parave. I pandehuri P.K ka ndërmjetësuar që M.M ta drejtojë këtë veprimtari kriminale edhe ndaj babait të tij F.K.

Elbasan[413] rezulton se mbrojtja ka paraqitur pretendimin se i pandehuri nuk e ka konsumuar veprën penale të vrasjes me dashje të mbetur në tentativë, në bashkëpunim me një person tjetër të paidentifikuar, pasi gjendemi para rastit të eksesit të ekzekutorit. Po ashtu, mbrojtja ka pretenduar se i pandehuri e ka parë që personi i paidentifikuar ka qëlluar mbi dëshmitarin B.S dhe se ai ka qëlluar pas shpine të dëmtuarin, por i pandehuri nuk ka patur mundësi të ndalonte personin e paidentifikuar që e shoqëronte. Mbi këtë bazë është kërkuar deklarimi i pafajshëm i të pandehurit. Gjykata e ka konsideruar "*të paprovuar, të pabazuar dhe të pavërtetuar pjesërisht variantin e ndodhjes së ngjarjes të parashtruar nga mbrojtësi i të pandehurit, përsa i përket pretendimit për pafajësinë e të pandehurit dhe mungesës së bashkëpunimit me bashkëautorin e paidentifikuar në kryerjen e veprës penale. Gjykata vëren se varianti i pretenduar i mbrojtjes, në rrethanat konkrete kur nuk provohet me dëshmitarë okularë të krimit dhe kur i pandehuri është hetuar e gjykuar në mungesë, nuk mund të pranohet se i përgjigjet tërësisht të vërtetës vetëm mbi bazën e deklarimeve të dëshmitarit V.N, i cili për thëniet e tij i referohet vetë të pandehurit, ndaj të cilit është ngritur një akuzë në këtë gjykim dhe ka një pozicion të veçantë procedural*".[414] Gjykata, pavarësisht se me të drejtë ka konstatuar se versioni i mbrojtjes nuk qëndron, nuk mund t'i kërkojë mbrojtjes të provojë tërësisht të vërtetën, pasi referuar parimit *in dubio pro reo*, për mbrojtjen mjafton pretendimi para gjykatës, përmes krijimit të dyshimit të arsyeshëm, se versioni i saj është i mbështetur. Në këtë rast, pretendimi i mbrojtjes nuk ka arritur që të krijojë tek gjykata dyshimin e arsyeshëm se i gjykuari ishte i pafajshëm për krimin që u akuzua.

Rasti i tretë, i referohet pasurive të gjetura tek një i pandehur/dyshuar apo të afërm të tij, fakt i cili mund të sjellë kalimin e barrës së provës nga akuza tek personi i dyshuar apo persona të tjerë të lidhur me të, në rast se ka dyshime të bazuara se pasuri të tilla janë vënë si rezultat i ushtrimit të veprimtarive kriminale, që lidhen kryesisht me krimin e organizuar dhe trafikimin. Krimi i organizuar kërcënon sigurinë kombëtare dhe stabilitetin e vendit, ai i kundërvihet shtetit të së drejtës dhe dëmton ekonominë kombëtare. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë që rrjedh nga aktiviteti kriminal po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një nevojë e qenësishme në luftën kundër krimit të organizuar. Kjo e fundit ka në themel një qëllim parandalues: zvogëlimin e financimit të aktiviteteve kriminale, duke penguar riinvestimin e këtyre të ardhurave

---

[413] Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit gjyqësor Elbasan ka sjellë për gjykim çështjen penale Nr.294/16 Akti, datë 19.05.2009 në ngarkim të të pandehurit N.D, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të "Vrasjes me dashje" në bashkëpunim, të mbetur në tentativë, të parashikuar nga nenet 76, 22 e 25 të KP. Më datë 10.11.2008, rreth orës 20:30, shtetasi E.K me kushëririn e tij B.S, kanë qenë duke ecur në rrugicën ku ndodhej banesa e tyre dhe përpara tyre ka ndaluar një makinë. Nga autovetura kanë zbritur shtetasi N.D me një person tjetër të paidentifikuar. Personi i paidentifikuar ka nxjerrë pistoletën dhe ka qëlluar në drejtim të këmbëve të shtetasit B.S, duke i kërkuar këtij të fundit që të largohej. Më pas N.D ka mbajtur nga krahët E.K dhe nga pas shpine i ka drejtuar pistoletën personi i paidentifikuar. Ai e ka qëlluar një herë në shpatullën e djathtë. Shtetasi E.K është rrëzuar në tokë dhe pasi janë personat, ka mundur të lëvizë në drejtim të rrugës, ku është parë eshe nga persona të tjerë, të cilët e kanë lajmëruar më pas policinë. Nga akti i ekspertimit mjeko – ligjor i kryer te i dëmtuari ka rezultuar se ka dëmtime të cilat janë shkaktuar nga një qitje me armë zjarri dhe që hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të rënda, pasi kanë qenë të rrezikshme për jetën në çastin e shkaktimit të tyre, po të mos i jepej të dëmtuarit ndihma e kualifikuar mjekësore.

[414] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. 139, datë 23.03.2010.

në ekonomi dhe, në të njëjtën kohë, shkurajimin e personave që merren me veprimtari të tilla penalisht të ndëshkueshme.[415]

Në këtë aspekt, duhet përmendur se vendi ynë që në shtator të vitit 2004 vendosi të adaptonte një sistem të sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve të krimit të organizuar të orientuar drejt të ashtuquajturit "konfiskim civil", të pavarur nga fati dhe përfundimi i procesit penal, duke përqafuar përvojën më të përparuar europiane dhe botërore në lidhje me konfiskimin e pasurisë, nëpërmjet një procedure gjyqësore civile, edhe në mungesë të dënimit të personit të dyshuar në veprimtari të krimit të organizuar. Ligji parandalues pasuror synon të vërë në zbatim një sërë masash me natyrë parandaluese e goditëse kundër pasurive të pajustifikuara ligjërisht që iu përkasin një kategorie të veçantë personash me rrezikshmëri të madhe shoqërore, për shkak të kryerjes prej tyre të veprave penale të rënda.[416] Ligji i vitit 2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar" u shfuqizua nga ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë". Në vendimin unifikues nr.1, datë 25.01.2007, Gjykata e Lartë duke marrë në shqyrtim ligjin e vitit 2004 ka konstatuar se **"***në këtë ligj parashikohen rregulla të posaçme mbi kompetencat dhe procedurën, të drejtat dhe detyrimet e pjesëmarrësve në procedimin parandalues, ndërmjet të cilave evidentohet përcaktimi i barrës së provës së personave të dyshuar dhe personave të tjerë lidhur me justifikimin e origjinës së ligjshme të pasurisë së tyre. I përket prokurorit barra e provës për të vërtetuar në gjykatë se një person në hetim, apo i dënuar përmbush kushtet për t'u cilësuar si "person i dyshuar" për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga pika 1 e nenit 3 te ligjit. Por nga ana tjetër ka theksuar se personi i dyshuar (neni 3, pika 1) dhe personat e tjerë (neni 3, pika 2 dhe neni 8) kanë barrën e provës për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurisë së tyre, për të provuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale a investim të tyre dhe, vetëm për "personat e tjerë" të provojnë se, jo vetëm nga pikëpamja formale, por edhe në fakt, nuk jemi përpara zotërimit në çdo mënyrë të këtyre pasurive prej personit të dyshuar".*[417]

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese ka marrë në shqyrtim, ndër të tjera, nëse ligji i ri i vitit 2009 cënon parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë. Kërkuesit kanë pretenduar, ndër të tjera, edhe se shprehja "*dyshim i arsyeshëm bazuar në indicie*", parashikuar në nenin 3, paragrafi 1 i ligjit nuk është në përputhje me standardin "*dyshim i arsyeshëm*", parashikuar në nenin 27/2 shkronja "c" të Kushtetutës; nenin 5/1 të KEDNJ-së dhe nenin 228/1 të KPrP. Sipas qëndrimit të kërkuesve, një dyshim i bazuar në indicie nuk mund të jetë i arsyeshëm.

Është e nevojshme të theksojmë se qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit. Procedimi i parashikuar në këtë ligj është një procedim i veçantë autonom nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ky ligj. Siç e konfirmon edhe neni 5, paragrafi 1, ky ligj rregullon marrëdhënien ndërmjet procedurës së caktimit të masave parandaluese dhe procedimit penal, duke vendosur

---

[415] Ma.Amarildo Laçi, "Mbi parimin e prezumimit të pafajësisë", Jeta Juridike, nr. 4, Viti XI i botimit, Tiranë dhjetor 2011, fq. 71
[416] Ma.Amarildo Laçi, artikull i cituar, fq. 72.
[417] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 25.01.2007.

se *"procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji"*. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë, i parashikuar nga neni 30 i Kushtetutës, lidhet ngushtësisht me proceset penale. Bazuar në këtë konkluzion rezulton se prezumimi i pafajësisë nuk gjend zbatim në procedime të tilla.

Gjykata ka vlerësuar se neni 27 paragrafi 2 i Kushtetutës mbi kriterin e dyshimit të arsyeshëm lidhet me garancitë kushtetuese ***për privimin e lirisë.*** Ndërsa ky ligj, në nenin 1 për objektin e ligjit, parashikon se *"Ky ligj përcakton procedurat, kompetencat dhe kriteret për zbatimin e masave parandaluese* ***kundër pasurisë së personave****, që janë subjekt i këtij ligji, si të dyshuar për pjesëmarrje në krimin e organizuar dhe trafikim".*[418]

Gjykata vëren se dallimin ndërmjet procesit penal dhe procesit të masave parandaluese. Mungesën e zbatimit të garancive të procesit penal në procedurat e sekuestrimit civil e vë në dukje edhe Gjykata Kushtetuese Italiane, kur shprehet për kushtetueshmërinë e ligjit italian të vitit 1956 (për masat parandaluese ndaj pasurive të krimit të organizuar). Ajo Gjykatë, me vendimin nr. 27 të vitit 1959 dhe vendimin nr. 23 të vitit 1964 ka mbajtur këtë qëndrim: *"...në sistemin ligjor italian ka një dallim thelbësor ndërmjet dënimeve penale dhe masave parandaluese. Të parat përbëjnë një përgjigje ndaj akteve të paligjshme dhe pasojat që sjell ai veprim; të dytat janë mjet për parandalimin e kryerjes së një veprimi të tillë. Me fjalë të tjera një dënim penal lidhet me një vepër penale të kryer, ndërsa masat parandaluese synojnë të reduktojnë rrezikun e veprave të ardhshme. Meqenëse sanksionet penale dhe masat parandaluese janë në thelb të ndryshme, jo gjithë parimet kushtetuese që qëndrojnë në themel të sistemit penal, zbatohen ndaj tjetrit. Për shembull, prezumimi i pafajësisë nuk lidhet me masat parandaluese, pasi ato nuk bazohen në përgjegjësinë penale ose në fajin e personit" (Përkthim i GjK- Shih Vendimi i Gjykatës Kushtetuese Italiane të vitit 1964).*

Ndër të tjera, Gjykata Kushtetuese ka sqaruar edhe kalimin e barrës së provës në procedime të tilla. Gjykata ka vlerësuar se, veçanërisht formulimet e nenit 11, paragrafi 1 (kriteret për sekuestrim), ku parashikohet se prokurori bën kërkesë të motivuar dhe nenit 21 (kërkesa për konfiskim dhe barra e provës), ku prokurori përsëri duhet t'i paraqesë gjykatës arsyet ku bazohet kërkesa, barra e provës fillimisht i takon prokurorit për të argumentuar dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie, se një person është pjesëmarrës në krimin e organizuar dhe trafikim sipas veprave të parashikuara në nenin 3.

Mbështetur në verifikimet e kryera, prokurori ka detyrimin për të parashtruar kërkime të motivuara dhe të dhëna mbështetëse përpara gjykatës për identifikimin e pasurive të personit të dyshuar dhe të personave të tjerë; të tregojë nga ana e tij se ka baza për dyshim të arsyeshëm dhe të dhëna të mjaftueshme për efekt të gjykimit parandalues, se ato nuk janë pasuri të fituara në rrugë të ligjshme, çka motivon ekzistencën e prezumimit të paligjshmërisë së tyre, dhe si rezultat, kalimin e barrës së provës personit të dyshuar.

---

[418] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 23.02.2011.

Pas kësaj, barra e provës kalon te personi i dyshuar, për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprave penale ose investim të tyre. Më pas është detyrë e gjykatës që të sigurojë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, të kryejë një hetim të gjithanshëm dhe të plotë, për dhënien e një vendimi të drejtë dhe të mbështetur në ligj. Pra, në dallim nga procedimi penal, gjykimi parandalues **mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicie**, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Pra, në këtë proces, **barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t'i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria**. Në vijim të këtyre arsyetimeve dhe argumenteve për nevojën e dallimit ndërmjet procesit penal dhe procesit parandalues, garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues.

Qëndrime të tilla të gjykatave tona janë në pajtim me orientimet e GJEDNJ në çështje të tilla. Në çështjen *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*[419], GJEDNJ u shpreh se "*nëse ka një dënim për ndonjë vepër penale në lidhje me trafikun e lëndëve narkotike, nuk është në kundërshtim me procesin e rregullt gjyqësor sipas nenit 6 të KEDNJ, që barra e provës t'i kalojë aplikantit, për të vërtetuar se burimi i të ardhurave të tij, të cilat i ka zotëruar përpara ndodhjes së veprës penale, ka qenë i ligjshëm. Duke qenë se gjykata ka zhvilluar një proces publik, ka shqyrtuar të dhënat e prokurorit, i ka dhënë mundësi aplikantit të paraqesë dokumente dhe prova të tjera, barra e provës në ngarkim të aplikantit është brenda kufijve të arsyeshëm*".[420]

Edhe në një çështje tjetër, në *Filips kundër Mbretërisë së Bashkuar*[421], *GJEDNJ u shpreh se, "përveç kur parashikohet nga neni 6/2 i KEDNJ, e drejta e një individi në një çështje penale për t'u prezumuar i pafajshëm dhe për t'i kërkuar organit të akuzës të mbajë barrën e provës për të provuar akuzat në ngarkim të tij,*

---

[419] Më 23 janar 2002, aplikanti dhe bashkëpunëtori i tij u dënuan për shkak të posedimit të 28 kg heroinë të pastër, e cila ishte konfiskuar nga policia në momentin e arrestimit. Kërkuesi u dënua me 22 vjet burgim. Më 1 korrik 2002, pas shqyrtimit të parashtresave me shkrim dhe me gojë nga aplikuesi dhe prokuroria, gjyqtari nxorri një urdhër konfiskimi. Ai konstatoi se ankuesi kishte përfituar nga trafiku i drogës. Në vlerësimin e shumës që kishte përfituar i dyshuari, gjyqtari mori parasysh një sërë të dhënash ekonomike-financiare. Gjyqtari, pasi dëgjoi të gjitha provat në gjyq, u bind se ankuesi kishte qenë pjesëmarrës kryesor në realizimin e veprës penale dhe se ka kontribuar në një masë të madhe për blerjen lëndës narkotike. Gjyqtari ishte bindur se një dërgesë e tillë nuk mund të përfaqësojë përfshirjen e parë të aplikantit në trafikun e drogës dhe se ai kishte financuar blerjen e lëndër narkotike, me të ardhurat që kishte përfituar nga trafiqet e mëparshme të drogës. Aplikuesi nuk arriti të kundërshtojë para gjykatës këtë prezumim. Pasi gjyqtari kishte vlerësuar shumën që kishte përfituar aplikanti nga trafiku i drogës, barra i kaloi të dyshuarit për të treguar sipas standardit të balancës së probabiliteteve (ekuilibri i probabiliteteve) që aktivet e tij të realizueshme ishin më pak se shuma e përfitimit të tij.

[420] Çështja *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar, (Aplikimi nr. 19955/05 and 15085/06), 23 Dhjetor 2008, pg. 46.*

[421] Në këtë çështje aplikanti Filips ishte denuar për importim të lëndës narkotike kanabis. Pas dhënies së dënimit, prokuroria kishte kërkuar nga gjykata lëshimin e një urdhri për konfiskimin e pasuirisë së tij. GJEDNJ u investua në shqyrtimin e dy problemeve: Së pari, nëse urdhri i konfiskimit që kishte pasuar dhënien e dënimit a përbënte një akuzë të re penale në kuptim të nenit 6/2 të KEDNJ, dhe së dyti, nëse përgjigja e pyetjes së parë është negative, a duhet të aplikohet njësoj neni 6 i KEDNJ në mënyrë që t'I ofrojë mbrojtje aplikantit ndaj prezumimeve të bëra gjatë procedurës së konfiskimit.

përbën një pjesë thelbësore të nocionit të procesit të drejtë sipas nenit 6/1".[422] Megjithatë, në këtë çështje GJEDNJ invokoi jurisprudencën e saj të mëparshme, duke theksuar *se "prezumimi i pafajësisë nuk është absolut, përderisa prezumime ligjore dhe faktike ekzistojnë në çdo sistem të drejtësisë penale. Për sa kohë që KEDNJ nuk shprehet për prezumime të tilla, ato nuk janë të ndaluara në parim, nëse Shtetet qëndrojnë brenda disa limiteve të arsyeshme, duke marrë në konsideratë interesin që rrezikohet dhe respektimin e së drejtës së mbrojtjes".*[423] GJEDNJ u shpreh se *"ndryshimi i barrës së provës është në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ".*[424] GJEDNJ arriti në konkluzionin se, pavarësisht se ligji prezumonte që pasuritë që i gjendeshin një personi, që akuzohej për trafik të lëndëve narkotike, rridhnin prej aktivitetit të tij kriminal, ky prezumim nuk ishte në kundërshtim me KEDNJ. I dyshuari kishte mundësi që në përputhje me një standard të procesit gjyqësor civil si ai i ekulibrit të probabiliteteve, të vërtetonte se pasuritë e tij rridhnin nga burime të ligjshme. I njëjti konkluzion rezulton edhe nga çështja *Geerings kundër Hollandës*, ku GJEDNJ u shpreh se "*aplikanti mban asete financiare, burimi i të cilave nuk mund të vërtetohet. Këto astete në mënyrë të arsyeshme janë prezumuar se rrjedhin prej aktivitetit kriminal. Aplikanti dështoi të paraqiste një shpjegim alternativ bindës*".[425]

Jurisprudenca e GJEDNJ-së, megjithatë, ka përpunuar edhe disa kritere që duhet të përmbushin ligje të tilla që cënojnë të drejtën e pronës së individëve apo personave juridikë, e mirë e marrë në mbrojtje nga neni 1, i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në gjykimet me objekt të tillë duhet që ligji të parashikojë se vendimet gjyqësore mund të ankimohen në gjykatat më të larta dhe masa të tilla (sekuestroja dhe konfiskimi) duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale. Pretendimet e ngritura nga personat e tretë që kanë vepruar in bona fides duhet të vlerësohen me seriozitet në rastet kur ata ngrenë probleme të cënimit të së drejtës së tyre të pronës dhe shteti duhet të gjejë mekanizma që lejojnë mbrojtjen e interesave të tilla.[426]

Këto parime dhe kërkesa të procedimit për sekuestrimin dhe/ose konfiskimin e pasurisë së subjekteve të dyshuar për përfshirje në aktivitete kriminale, kanë gjetur zbatimin e tyre edhe në jurisprudencën e gjykatave. Konkretisht, në vendimin nr. 131, datë 9.05.2012 të Gjykatës së Lartë rezulton nga rrethanat e çështjes se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka regjistruar procedimin pasuror në bazë të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" duke kërkuar masë parandaluese atë të sekuestros në ngarkim të shtetasve A.K si subjekt i përfshirë në veprimtari kriminale për veprat penale të parashikuara në nenin 3 të këtij ligji[427]; personave të tretë të lidhur me të - shtetasve: T.H, Ar.K, E.K

---

[422] Çështja *Filips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 41087/98), 5 Korrik 2001, pg. 40.
[423] Çështja *Salabiaku kundër Francës*, GJEDNJ (Aplikimi nr. 10519/83), 7 Tetor 1988, pg. 28.
[424] Çështja *Filips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 41087/98), 5 Korrik 2001, pg. 44.
[425] Çështja *Geerings kundër Hollandës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 30810/03), 1 mars 2007, pg. 44.
[426] Ma.Amarildo Laçi, "Mbi parimin e prezumimit të pafajësisë", Jeta Juridike, nr. 4, Viti XI i botimit, Tiranë, Dhjetor 2011, fq. 73
[427] Neni 3 I ligjit nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".
1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për:

dhe O.K. Sekuestroja si masë parandaluese është kërkuar të vendoset mbi pasuritë e shtetasit A.K dhe familjarëve të tij dhe personave të lidhur me të për interesa ekonomike, pasi mbi këtë shtetas rëndon dyshimi i arsyeshëm se ai është i përfshirë në aktivitet kriminal të trafikut të lëndëve narkotike. Ky shtetas kërkohet nga autoritet e drejtësisë amerikane si person i cili ka organizuar trafikimin e një sasie të madhe lënde narkotike të llojit kokainë si dhe të mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "***Prokurorit në çdo rast i del si detyrë që të paraqesë përpara gjykatës indicie të mjaftueshme për të provuar dyshimin se pasuria për të cilën kërkohet masa parandaluese është krijuar nga një aktivitet kriminal nga ato që parashikon ligji. Në ligj është parashikuar vendosja e masës preventive vetëm me kërkesë të prokurorit dhe gjykata duhet të shprehet për gjithçka që kërkohet në kërkesë dhe nuk mund të dalë jashtë kërkimeve të bëra prej tij. E drejta e procedimit për prokurorin është përcaktuar në nenin 11 të këtij ligji ku si kriter për marrjen e masës parandaluese të sekuestros është parashikuar se: "1. <u>Me kërkesë të motivuar të prokurorit</u> , gjykata vendos sekuestrimin e pasurive të personave, sipas nenit 3 të këtij ligji...."***.[428] Në bazë të këtij ligji, në përputhje edhe me ato që është thënë më sipër, prokuorit i mjafton që të përmbushë para gjykatës standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicie, një standard që nuk parashikohet në KPP, por i parashikuar në një ligj të posaçëm me procedura të posaçme. Nga ana tjetër, të dyshuarit i kërkohet të provojë se origjina e pasurisë së tij është legjitime. Nga analiza e këtij ligji në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ, rezulton se janë në konflikt dy grupe interesash apo të drejtash. Nga njëra anë, është lufta ndaj kriminalitetit të organizuar dhe nevoja që kanë shtetet për të parandaluar këtë veprimtari, dhe, nga ana tjetër, të drejtat e të dyshuarit, ndër të cilat prezumimi i pafajësisë, e drejta e pronës dhe e drejta e mbrojtjes. Në mënyrë të qartë, gjykatat i kanë dhënë përparësi në këtë dualitet interesash, luftës ndaj kriminalitetit të organizuar. Qëllimi i këtij ligji është goditja e sferës pasurore të personave të dyshuar dhe procedura e parashikuar është një procedurë *sui generis*, çka ka lejuar derogimin prej disa të drejtave të rëndësishme procedurale të të dyshuarit.

Megjithatë, në praktikën e Gjykatës së Lartë konstatohen vendime të saj ku nuk janë marrë parasysh dispozitat e ligjit "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të Organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe vendimi i trajtuar më sipër i Gjykatës Kushtetuese. Konkretisht, në vendimin nr. 69, datë 29.02.2012 rezulton se prokuroria ka bërë kërkesë për konfiskimin e dy apartamenteve të dy personave të afërt të të dyshuarit. Gjykata e Shkallës së Parë e Krimeve të Rënda ka pranuar kërkesën e organit të akuzës. Gjykata e Apelit e Krimeve të Rënda ka ndryshuar vendimin në lidhje me konfiskimin e dy objekteve të mësipëme. Pas rekursit të organit të akuzës, Gjykata e Lartë ka konsideruar si të

---

a) pjesëmarrje në organizata kriminale ose në grupe të strukturuara kriminale, sipas parashikimeve të neneve 333 dhe 333/a të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;
b) pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura, sipas parashikimeve të neneve 234/a dhe 234/b të Kodit Penal dhe për kryerje të krimeve prej tyre;
c) kryerjen e veprave të tjera, për qëllime terroriste, të parashikuara në pjesën e posaçme kreu VII i Kodit Penal;
ç) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 114/b, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal.
d) kryerjen e krimeve për qëllime të fitimit të pasurive të paligjshme, të parashikuara në nenet 114/a dhe 287 të Kodit Penal.

[428] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 131, datë 09.05.2012.

pabazuar në ligj pretendimin e saj se gjykata e apelit nuk ka mbajtur parasysh faktin që ekziston dyshim i arsyeshëm për kryerje të veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP nga i gjykuari M.K, duke pretenduar që pikërisht ky dyshim përbën bazë për konfiskimin e pasurisë. Gjykata e Lartë arsyeton, gjithashtu, se duke u bazuar në mundësitë e parashikuara në ligj, pretendimi i parashtruar gjendet në kontradiktë me parimet që rregullojnë përgjegjësinë penale, në bazë dhe në funksion të së cilës është edhe mundësia e zbatimit të masave parandaluese.[429] Gjykata e bazon argumentimin në dy vendime të GJEDNJ[430], të cilat nuk janë referenca të vlefshme për çështjen që ka pasur në shqyrtim. Në njërin prej vendimeve, GJEDNJ ka shqyrtuar konfiskimin e pasurisë në kuadër të nenit 1, Protokolli 1 i KEDNJ për të drejtën e pronës. Në vendimin tjetër shqyrtohej kryesisht neni 5 i KEDNJ dhe jo neni 6 ku gjendet dhe prezumimi i pafajësisë. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë është i kritikueshëm, pasi nuk mbështetet në konkluzionin e Gjykatës Kushtetuese që përcakton se janë të dallueshme ndërmjet tyre procesi penal dhe procesi i masave parandaluese. Gjithashtu, nuk mbahet parasysh se gjykimi parandalues **mbështetet në dyshimin e arsyeshëm bazuar në indicje**, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Sipas këtij vendimi rezulton se gjykata i ka ngarkuar barrën akuzës të provojë ligshmërinë e burimit të pasurisë. Gjithashtu, referimi në parimin e prezumimit të pafajësisë nuk merr rëndësi, pasi garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues.

Si konkluzion, në lidhje me procedurën e veçantë që parashikon ligji "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë, mund të thuhet se ajo ndryshon nga procesi penal. Këtë dallim e ka theksuar GJEDNJ nëpërmjet jurisprudencës së saj të trajtuar më sipër, si edhe Gjykata jonë Kushtetuese. Procedime të tila quhen procedime parandaluese dhe i shërbejnë luftës ndaj krimit të organizuar. Në procedime të tilla nuk gjen vend parimi i prezumimit të pafajësisë, për këtë shkak standardi i kërkuar i të provuarit që i ngarkohet akuzës është *dyshimi i arsyeshëm i bazuar në indicje*. Ky standard nuk është konsideruar antikushtetues nga Gjykata Kushtetuese. GJEDNJ nuk e parashikon se si do të jetë standardi i të provuarit në çështje të tilla, duke ia lënë shteteve detyrë të përcaktojnë vetë brenda marzhit të vlerësimit. Megjithatë, GJEDNJ e thekson qartë se prezumimi i pafajësisë nuk aplikohet. Gjithsesi, nga ky procedim rrezikohet të cenohet pasuria e individit që gëzon mbrojtjen e nenit 1 Protokolli 1 të KEDNJ. GJEDNJ udhëzon që testi i duhur për t'u aplikuar është parimi i proporcionalitetit. Pra, për të arritur mbrojtjen e interesit publik duhet të sakrifikohet sa më pak të jetë e mundur nga të drejtat e privatëve. Në këtë kuptim, nëse organi i akuzës provon në përputhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në indicje se i dyshuari ka lidhje me aktivitetet e krimit të organizuar, konfiskimi/sekuestrimi i pasurisë që dyshohet si e prejardhur apo që i shërben aktivitetit kriminal, nuk konsiderohet cenim i së drejtës themelore të pronës. Nga ana tjetër, i dyshuari ka barrën e provës të provojë ligjshmërinë e burimit të pasurisë së tij. Kjo është në përputhje jurisprudencën e GJEDNJ, pasi në kushtet kur nuk aplikohet parimi i prezumimit të pafajësisë, nuk i takon organit të akuzës të provojë se burimet e pasurisë së personit janë të ligjshme.

---

[429] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 69, datë 29.02.2012.

[430] Për më tepër, Çështja *Butkevicius kundër Lituanisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr.48297/99), 26 Mars 2002, pg.49-54; Çështja *Sun kundër. Rusisë*, GJEDNJ (Aplikimi nr.31004/02), 05 Shkurt 2009, pg. 30-33.

Standardi i të provuarit që i kërkohet të dyshuarit për të provuar se pasuria e tij rrjedh nga pasuri të ligjshme nuk parashikohet, por ai duhet të kalojë nivelin që i kërkohet organit të akuzës. Sipas logjikës së ligjit, standardi për të dyshuarin duhet të jetë më i lartë se ai i akuzës. Dyshimi i arsyeshëm nuk mjafton pasi ai do të shkonte në favor të akuzës. Standardi i aplikuar në procesin civil, ai i balancës së probabiliteteve, është më i pranueshëm, pasi në bazë të këtij standardi synohet të krijohet bindja te gjyqtari se një pretendim i caktuar ka më shumë të ngjarë të jetë i vërteti. Megjithatë, gjykoj se është e nevojshme që të përcaktohet në ligj, ashtu siç është parashikuar për organin e akuzës, standardi i të provuarit që do t'i ngarkohet të dyshuarit për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë.

4.4 Vlerësimi i provave dhe formimi i bindjes së brendshme të gjyqtarit

Një proces gjyqësor është një hetim mbi ngjarje të ndodhura në të shkuarën, që ka si qëllim kryesor për të përcaktuar me një shkallë të pranueshme probabiliteti faktin e ndodhisë së tyre dhe autorin e dyshuar që, në përputhje me ligjin, i japin të drejtën gjykatës për të dhënë ose mohuar pafajësinë. Procesi gjyqësor nuk është një kërkim për të zbuluar të vërtetën absolute mbi ngjarjet e shkuara, por të vendosë që një version i asaj që ka ndodhur ka mundësi të pranueshme të jetë i drejtë. Është në natyrën e eksperiencës njerëzore pamundësia për të demonstruar të vërtetën absolute për ngjarje të shkuara.[431] Në këtë kuptim, palët dhe gjykata, në përputhje me interesat e tyre, përpiqen sa të jetë e mundur të riprodhojnë dhe risjellin në seancën gjyqësore nga pikëpamja juridike ngjarjen kriminale të ndodhur më parë. Si subjekt procedural me pushtetin për të vendosur (ius dicere procesor), gjykata duhet të individualizojë llojin e faktit historik, dhe më pas, nëse ai përputhet apo jo me ndonjë normë penale abstrakte të paracaktuar nga ligji. Në këtë ecuri ajo mbart detyrimin që të realizojë njohjen e faktit historik vetëm nëpërmjet provave, të cilat janë njoftime mbi faktin. Pra, gjykata nuk ka diskrecion të pakufizuar në krijimin e bindjes dhe më pas në vendimmarrjen mbi fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.[432] Mënyra e vetme për të përcaktuar nëse një vepër penale ka ndodhur, nëse ajo është kryer në një mënyrë të caktuar, nëse i pandehuri është autor i saj, është vlerësimi i provave që paraqesin akuza dhe mbrojtja, në mbështetje të versioneve përkatëse.

Vlerësimi i provave zë një pjesë të rëndësishme në arsyetimin e vendimit gjyqësor. Arsyetimi i vendimit gjyqësor është një garanci që buron nga neni 142/1 i Kushtetutës. ***Në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore penale në vendimin nr.14 datë 03.05.2011 Gjykata Kushtetuese shprehet:***

"*Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar se organet gjyqësore, në kryerjen e funksioneve [433] i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve dhe se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara. Edhe GJEDN është shprehur në mënyrë te përsëritur se vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara në mënyrë të mjaftueshme. KPP-ja për vendimin penal parashikon se vendimi arsyetohet ndryshe është i pavlefshëm. Neni 383 i KPP-së kërkon elementët që duhet të përmbajë një vendim, ku ndër të tjera parashikon një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të*

---

[431] Peter Murphy, "Murphy për provën", Oxford University Press, 2005, përkth.Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 57.
[432] Dhimitër Lara, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010 fq. 85.
[433] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 02.04.2008.

faktit dhe provat mbi të cilat bazohet vendimi, arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar nenet e zbatuara të ligjit. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, është një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre".[434]

Vlerësimi i provave është një atribut që u takon gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të Apelit. Gjykata e Lartë mund të bëjë vlerësimin e provave vetëm nëse gjykon çështje penale që i përkasin juridiksionit të saj filllestar. Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: "*Përsa i përket mënyrës se si janë interpretuar dhe vlerësuar provat nga gjykatat e zakonshme, kjo çështje nuk përbën objekt kontrolli për Gjykatën Kushtetuese, sepse kjo Gjykatë mund dhe duhet të investohet kur ndaj një procesi gjyqësor ka pretendime për mënyrat e marrjes së provave, e fiksimit të tyre, por jo për mënyrën e vlerësimit. Në sferën e gjykimit nga Gjykata Kushtetuese nuk përfshihet mënyra e zbatimit të ligjit material dhe e vlerësimit të provave nga ana e gjykatave të zakonshme*".[435] Pra, është shumë i rëndësishëm roli dhe pushteti i vlerësimit të provave që kanë gjykatat e faktit. Kontrolli kushtetues nuk mund të zëvëndësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor e aq më tepër të vlerësojë ***bindjen e brendshme*** të gjykatave për çështje konkrete.[436]

Nga ana tjetër, arsyetimi i vendimit gjyqësor duhet të jetë logjik. Arsyetimi gjyqësor është një kombinim i tre proceseve të ndryshme logjike[437], ***induktiv*** (arsyetimi induktiv lejon që nga vëzhgimi i rasteve të veçanta, të cilat në shpeshtësinë e përsëritjes së tyre çojnë në rezultate të njëjta, të nxirren rregulla me karakter të përgjithshëm[438]), ***deduktiv*** (është modeli i arsyetimit i cili lejon që duke njohur rregullin, nga rasti i provuar nxirret rezultati që synohet të provohet), ***abduktiv*** (nga fakti i njohur permes nje rregulli identifikojme faktin qe ka sherbyer si shkak i tij). ***Në vendimin nr.33 datë 08.12.2005[439] Gjykata Kushtetuese ka theksuar*** se vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat dhe ligjet e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe

---

[434] Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 03.05.2011.
[435] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 17.05.2010.
[436] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.95, datë 27.07.2001 dhe nr. 7/2005.
[437] Peter Murphy, "Murphy për provën", Oxford University Press, 2005, përkth.Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 59.
[438] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 14.
[439] Për vendime të ngjashme shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 9.3.2009, nr.33, datë 08.12.2005; nr. 23, datë 23.07.2009.

rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik.[440] ***"E drejta është rregull, dhe e drejta e dhënë logjikisht është e drejtë shumë e mirë",*** ka thënë Aristoteli[441]. Një arsyetim i saktë i vendimit është një mënyrë e sigurt që gjeneron legjitimitet në sytë e të interesuarve. Ky efekt do të jetë akoma më i madh nëse palët do ta përjetojnë këtë vendim si pasojë normale e një procesi të rregullt, në të gjithë komponentët e tij[442].

Kur flitet për vlerësimin apo çmimin e provave, natyrisht, këtu është fjala për një çmim të lirë, pa kushte dhe kufizime, për një çmim në përputhje të plotë me rrethanat konkrete të çështjes në shqyrtim.[443] Teoria e çmuarjes së lirë të provave për nga koncepti dhe rregullimi i saj është e kundërt me teorinë ligjore të vlerësimit të provave. Sipas teorisë ligjore, e cila tashmë nuk zbatohet në procedurat penale bashkëkohore, gjatë çmimit të provave për vërtetimin e saktësisë së fakteve në një çështje penale, gjykata është e detyruar t'i njohë secilës provë atë vlerë që më parë ia ka paracaktuar ligji.[444] Ky sistem i vlerësimit të provave është i tejkaluar nga koha.

Në procedurën penale shqiptare, sipas kodit të vjetër të procedurës penale, por edhe sipas kodit të vitit 1995, parimi, në bazë të së cilës bëhet vlerësimi i provave, është bindja e brendshme e gjyqtarit. Provat duhet të vlerësohen në tërësinë e tyre dhe gjyqtari është i lirë që të krijojë bindjen e vet, të pandikuar nga faktorë të jashtëm, si për forcën provuese të provave, ashtu edhe për fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit.[445] Megjithatë, bindja e brendshme e gjyqtarit duhet të jetë në përputhje me arsyetimin logjik e ligjor të analizës së provave, prej së cilës derivon dhe arsyeshmëria e vendimit gjyqësor. Parimi i bindjes së brendshme në çmuarjen e provave gjen shprehje në nenin 152/1 të KPrP, sipas të cilit: *"Asnjë provë nuk ka vlerë të paracaktuar nga ligji. Gjykata, pas shqyrtimit të provave në tërësi, çmon vërtetësinë dhe fuqinë provuese të tyre, duke argumentuar arsyet ku është mbështetur për të krijuar bindjen e saj"* Gjykata e Lartë është shprehur se "*në analizën e provave, gjykata duhet të niset nga parimet bazë për vlerësimin objektiv të tyre dhe kërkesat e nenit 152 të KPrP sipas të cilit përcaktimi i vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor, nuk ka vlerë të paracaktuar dhe se ekzistenca e një fakti mund të nxirret edhe nga indicjet kur ato janë të rëndësishme dhe në përputhje me njëra tjetrën*".[446] Pra, sistemi ynë i procedurës penale, në aspektin e parimit të bindjes së brendshme në çmuarjen e provave, përmbledh këto tipare themelore:

i) Nuk ka hierarki të provave, në kuptimin që asnjëra prej tyre nuk ka vlerë të paracaktuar;
ii) Të gjitha provat duhet t'i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor (që do të thotë se asnjë provë nuk mund të fitojë autoritet të plotë që në fazën e hetimeve);
iii) Provat duhet të shqyrtohen sipas metodës dialektike të lidhjes dhe ndërveprimit të tyre me njëra – tjetrën dhe;

---

[440] Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 08.12.2005.
[441] Po aty.
[442] Po aty.
[443] Izet Hoxha, "Çmimi i provave dhe bindja e brendshme", Drejtësia Popullore, nr. 2, mars-prill, 1969, fq. 13.
[444] Prof.Dr Ejup Sahiti, "Argumentimi në procedurën penale", Fakulteti Juridik, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2006, fq. 198.
[445] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 12.
[446] Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 11.11.2003.

iv) Së fundi, çmuarja e tyre do të bëhet në bazë të bindjes së brendshme që krijon gjyqtari se çfarë faktesh provojnë këto prova dhe me çfarë shkalle vërtetësie arrijnë t'i provojnë këto fakte.[447]

Gjykata e Lartë në disa vendime të saj ka theksuar se neni 152 i KPrP që bën fjalë për çmuarjen e provave shprehet se çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit dhe nuk ka vlerë të paracaktuar. Çmuarja e provave përbën elementin thelbësor të çdo procesi gjyqësor penal që pasqyrohet në vendimin që merr gjykata dhe në çdo rast, gjykata duhet të përcaktojë fuqinë provuese të tyre. Sipas këtij neni, gjykata i çmon provat sipas bindjes së formuar pas shqyrtimit të tyre në tërësi, por kjo nuk mund të mënjanojë çmuarjen rigoroze të provave, faktin që asnjë provë nuk mund të ketë vlerë të paracaktuar me qëllim që vendimi i marrë të jetë bindës. Në vendimin e gjykatës nuk duhet të parashtrohen vetëm provat që janë marrë, por që vendimi të jetë i bazuar, duhet detyrimisht që atyre t'u bëhet një analizë e plotë ligjore dhe llogjike për të mbështetur dispozitivin e vendimit.[448]

Bindja e brendshme e gjyqtarit e formuar sipas vlerësimit të lirë të provave nuk kufizohet vetëm nga parimi kushtetues i arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë aspekt, një rol të rëndësishëm paraqet standardi i të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Nuk mund të ketë bindje të gjyqtarit mbi fajësinë e të pandehurit, nëse nga analiza e të gjitha provave, kjo bindje nuk është në përputhje me standardin e mësipërm. Standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përfaqëson kufirin e lirisë së bindjes së gjyqtarit, në mënyrë që përfundimi i procesit të mos varet nga vlerësime diskrecionale, subjektive dhe arbitrare të gjyqtarit. Ky standard përshkon të gjithë procedurën penale dhe gjen shprehjen e vet më të natyrshme në garancitë themelore të procesit penal, si prezumimi i pafajësisë së të pandehurit, barra e provës në ngarkim të akuzës, kalimit në favor të të pandehurit të dyshimeve mbi akuzën dhe motivimi dhe justifikimi racional i vendimit.[449]

Praktika gjyqësore, kohët e fundit ka njohur që bindja e brendshme e gjyqtarit duhet të formohet në përputhje me standardin e të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Konkretisht, në vendimin nr. 84, datë 21.03.2012, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Kolegji Penal vlerëson se, në gjykimin e zhvilluar kundër të gjykuarve procesi i të provuarit, është i plotë dhe konkluzioni i arritur nga ana e gjykatave për deklarimin fajtor, është logjik e i mbështetur në vlerësimin e të gjitha provave dhe inidicieve të shqyrtuara në gjykim. Gjykatat, në vlerësim të tyre, kanë patur jo vetëm provat shkencore, materiale dhe ato me dëshmitarë, por edhe indiciet e provuara, si: faktin që viktima nuk ka patur konflikte me persona të tjerë, faktin që në momentin e ushtrimit të dhunës ndaj tij ai nuk ka qenë subjekt i ndonjë grabitje, sepse i janë gjetur të gjitha sendet personale, marrja e skedës personale nga telefoni prej të gjykuarit R, drejtimi i lëvizjes së autorëve dhe përputhja me vendin ku u kapën të*

---

[447] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 13. Bindje të brendshme për çmuarjen e provave krijon normalisht edhe prokurori, kur vendos për qëndrimin që do të mbajë lidhur me faktet objekt prove në fazën e hetimeve paraprake. Edhe bindja e prokurorit, i nënshtrohet verifikimit sipas të njëjtës metodë, pikërisht përmes kontrollit të arsyetimit të akteve të tij vendimmarrëse, nga prokurori më i lartë dhe nga gjykata.

[448] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 240, datë 28.05.2008; nr. 280, datë 04.06.2008; nr. 184, datë 9.04.2008; nr. 1, datë 10.01.2011; nr. 394, datë 08.07.2009 etj.

[449] Orazio Longo, "L'oltre ogni ragionevole dubio come regola di giudizio", L'oltre ogni ragionevole dubbio come regola di giudizio | Filodiritto, klikuar më datë 20 Gusht 2022.

gjykuarit pas ngjarjes, interesimi i vëllait të të gjykuarit. Këto indicie së bashku me provat mbas një cross examination ***formojnë bindjen e brendshme tej çdo dyshimi*** *se të gjykuarit janë autorët e vrasjes së shtetasit B.Rr.*"[450]

Në lidhje me termin "*dyshim i arsyeshëm*", që është pjesa tjetër e standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, doktrina e vendeve të sistemit common law, ka dhënë kuptimin e saj: "dyshimi i arsyeshëm nuk është thjesht një dyshim i mundshëm, pasi çdo gjë që i referohet marrëdhënieve njerëzore, të lidhur me gjykimet morale është e hapur kundrejt dyshimeve të mundshme ose imagjinare. Është ajo gjendje e çështjes, ku pas të gjitha vlerësimeve dhe konsideratave mbi provat, i lë mendjet e gjyqtarëve në një gjendje të tillë që nuk mund të shprehen me një bindje të palëkundur deri në një siguri morale, për të vërtetën e akuzës. Koncepti "*bindje e palëkundur*" që përkufizohet si "*siguri e madhe*", është vija e demarkacionit ndërmjet dyshimit të arsyeshëm dhe dyshimit imagjinar; në këtë kontekst duhet të merret parasysh se, pavarësisht faktit nëse konceptit në fjalë i referohemi në aspektin sasior apo cilësor, referimi në vlerësimin, konsiderimin dhe krahasimin e nevojshëm të të gjitha provave në dispozicion, eleminon çdo rikthim të mundshëm në bindjen e lirë dhe arbitrare, e cila bazohet në gjykime të huaja për thelbin e procesit".[451]

4.4.1 Vlerësimi i indicjeve në procesin penal

Një vëmëndje e veçantë i duhet kushtuar mënyrës së vlerësimit të indicjeve. Neni 152/2 i KPrP parashikon se: *"Ekzistenca e një fakti nuk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra – tjetrën."* Nga interpretimi gramatikor i nenit 152/2 kërkohet që indicjet të jenë *"....në përputhje me njëra-tjetrën"*. Nga interpretimi logjik i kësaj shprehjeje rezulton se për të provuar një fakt të caktuar duhet të sigurohen disa indicje që, të marra në veçanti, duhet të plotësojnë kriteret e rëndësisë ose të saktësisë. Në qoftë se do të ishin të rëndësishme dhe të sakta, atëherë do të ishte më e lehtë që, me anën e tyre, të provohej fakti objekt prove. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*Në këtë rast përmbajtja e bisedës telefonike shërben si indicje për akuzën dhe duke qenë e vetme nuk jep provueshmëri të plotë dhe nuk mund të japë sigurinë e fajësisë. Ky vlerësim është në përputhje me nenin 152/2 të K.Pr.Penale, i cili kërkon* ***pluralitet indicjesh*** *duke formuar në vlerësim një provë, me kusht që indicjet të jenë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën*".[452]

---

[450] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 84, datë 21.03.2012.

[451] Orazio Longo, "L'oltre ogni ragionevole dubio come regola di giudizio", L'oltre ogni ragionevole dubbio come regola di giudizio | Filodiritto, klikuar më datë 20 Gusht 2022. Për më tepër shih, Corte di Cassazione Penale n. 931/2012, sez. VI del 13/1/2012,
Principio dell'oltre il ragionevole dubbio: dalla Cassazione penale i criteri interpretativi (Cass. pen. n. 931/2012) | Il portale giuridico online per i professionisti - Diritto.it, klikuar më datë 20 Gusht 2022.

[452] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 97, datë 20.03.2013. Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton se të dy gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme, siç janë bisedat telefonike, të cilat sipas vlerësimit të gjykatave të faktit, janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve dhe pa i analizuar ato me asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte, që provon fajësinë e të pandehurve, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë kësaj prove vlerë të paracaktuar. Në lidhje me përgjimet telefonike, të cilat, sipas gjykatave të faktit, janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve në këtë gjykim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë çmon se konkluzioni i gjykatave të faktit që këto biseda telefonike janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve është i pabazuar, pasi një gjë e tillë nuk provohet me asnjë provë direkte ose indirekte që ndodhet në fashikullin e gjykimit. Shënojmë se në këtë rast Gjykata e Lartë disa biseda

Së dyti, norma i referohet ekzistencës së "një fakti", prej nga del përfundimi se dy a më shumë indicje, të rëndësishme ose të sakta, por detyrimisht edhe në përputhje me njëra-tjetrën, duhet të çmohen në drejtim të provueshmërisë së një fakti të caktuar, ende të panjohur, i cili pretendohet të provohet me anën e rregullave të arsyetimit logjik.[453] Gjykata e Lartë ka përcaktuar dallimin midis nocionit të provës dhe indicjes. Sipas saj "*Ndërkohë që ligjvënësi ka dhënë definicionin përsa i përket se çfarë është provë në kuptimin procedural, kuptimin e indicjes si mjet procedural provueshmërie e jep teoria e së drejtës procedurale penale. Indicja është një pjesë e provës (probatio simplena) e cila nuk mund ta provojë në mënyrë të plotë një fakt por në mënyrë të përafërt. Kolegji Penal vlerëson se dallimi midis provës dhe indicjes qëndron në atë që: nëse e para vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, e dyta është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti*".[454]

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke vërejtur në vendimet e gjykatave raste të paqartësisë në drejtim të interpretimit të natyrës së indicjeve si prova të tërthorta, ka tërhequr vëmëndjen që fajësia e të akuzuarit nuk mund të provohet nga një indicje e vetme.[455] Konkretisht, në vendimin nr. 715, datë 16.12.2009, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se: *Sipas nenit 152 çdo provë i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor dhe nuk ka vlerë të paracaktuar, në të kundërt të asaj ç'ka ka pranuar gjykata e apelit, duke e mbivlerësuar deklarimin e dëshmitarit I.I, i cili kur është afruar pranë vendit të punës ka parë një makinë duke ecur me shpejtësi, brenda së cilës është identifikuar se ishte i gjykuari D.B. Mirëpo vetëm ky fakt, i pashoqëruar me ndonjë provë tjetër nuk mund të çojë gjykatën se është i gjykuari autori i veprës penale të vjedhjes të ndodhur në objektin ku pononte, si roje dëshmitari I.I, aq më tepër kur i gjykuari dhe dëshmitari A.B kanë sqaruar se ata kanë qenë tek vreshtat e tyre, e cila ndodhet në afërsi e në drejtim të vendit të ngjarjes. Në rastin konkret në ngarkim të të gjykuarit D.B,* ***ka vetëm një indicje****, të pa shoqëruar me ndonjë provë tjetër që të vërtetonte akuzën, prandaj dhe me të drejtë gjykata e shkallës së parë nëpërmjet një analize të hollësishme ka arsyetuar se kjo indicje nuk lidhet me asnjë provë tjetër për të provuar akuzën në ngarkim të të gjykuarit D.B.*[456] Arsyeja se përse nuk mund të përcaktohet fajësia me një indicje të vetme, ka të bëjë me vetë nenin 152/2 i cili kërkon që për vërtetimin e një fakti duhet të jenë të pranishme një shumësi indicjesh.

Gjykata e Lartë i ka dhënë zgjidhje edhe rastit kur janë të pranishme disa indicje që japin të dhëna për ekzistencën e faktit. Konkretisht, në vendimin nr. 698, datë 09.12.2009, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se "*në ngarkim të të gjykuarit A.A për veprën penale që është akuzuar, ka vetëm disa indicje (si përgjimet), por ato janë të pashoqëruara me prova që të vlejnë për të provuar akuzën duke theksuar njëkohësisht që, siç pranon gjykata e shkallës së parë, ashtu nuk e ngarkon me qënien*

---

telefonike i konsideron një indicje e vetme, ndërkohë që logjikisht secila bisedë përbën një indicje më vete.

[453] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 16.

[454] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 31, datë 31.01.2013.

[455] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 16.

[456] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 715, datë 16.12.2009.

bashkëpunëtor të të gjykuarit. Gjykata mund të arrijë në përfundime për dhënien e vendimit e përgjegjësinë penale edhe mbi bazën e indicjeve, mbasi ato mund të luajne rol vendimtar për zgjidhjen e çështjes, por kur ato janë të tilla që vërtetojnë ekzistencën e faktit, pa dyshuar në këtë drejtim gjë që në rastin në shqyrtim nuk mund të pranohet, pasi dhe indicjet nuk ndihmojne për të arritur në përfundimin që ka arritur Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda."[457]

Neni 152/2 i KPrP normon që për të nxjerrë ekzistencën faktit nga indicjet, ato duhet të jenë të rëndësishme dhe të sakta. Kriteri i rëndësisë nënkupton që indicja duhet të jetë e qëndrueshme ndaj kundërshtive dhe të krijojë një shkallë të lartë bindjeje në drejtim të ekzistencës së faktit të panjohur që synohet të provohet. Me saktësi të indicjes duhet të kuptohet cilësia e saj për të orientuar drejt një fakti të caktuar dhe që nuk lejon interpretimin në drejtime të tjera. Ligji kërkon që indicjet të jenë në përputhje me njëra-tjetrën. Pra, nëse indicjet në vetvete duhet të jenë të rëndësishme dhe të sakta, midis tyre duhet të ketë përputhje, ato nuk duhet të përjashtojnë njëra-tjetrën, në kuptimin që çmuarja e tyre bashkërisht duhet të çojë drejt të njëjtit përfundim logjik. Rregullat për çmuarjen e indicjeve konsiderohen një lloj kornize kufizuese në procesin e formimit të bindjes së brendshme, për shkak se për të provuar ekzistencën e një fakti duhet të arsyetohet ekzistenca e disa indicjeve (të rëndësishme ose të sakta në vetvete) dhe përputhshmëria e tyre drejt të njëjtit përfundim logjik, proces i cili duhet të arsyetohet, përndryshe vendimi do të ishte i cenueshëm për pavlefshmëri që buron nga mungesa e arsyetimit (neni 442/1, shkronja 'b' në lidhje me nenin 112/3 të KPrP).[458]

Në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, të trajtuar më sipër, rezulton një kontradiktë ndërmjet mënyrës së vlerësimit dhe përcaktimit të fuqisë provuese të indicjeve dhe provave. Nga njëra anë pranohet ajo që edhe vetë ligji parashikon, se ekzistenca e faktit mund të deduktohet nga indicjet, rrjedhimisht kjo do të thotë se mund të pranohet fajësia e të akuzuarit nga gjykata në prezencë të disa indicjeve që vërtetojnë faktin penal. Nga ana tjetër, pranohet, gjithashtu, se fajësia nuk mund të pranohet me një provë të vetme, pasi në këtë mënyrë asaj prove i jepet vlerë e paracaktuar.[459] Kjo kontradiktë del më në pah kur vetë praktika gjyqësore ka përcaktuar se prova *vërteton në mënyrë të drejtpërdrejtë ekzistencën ose jo të një fakti, indicja është një rrethanë nga e cila mund të arrihet në një deduksion të logjikshëm, një konkluzion i përafërt mbi ekzistencën ose jo të një fakti*".[460] Zgjidhja e kësaj kontradikte do të ishte interpretimi i drejtë i togfjalëshit "vlerë e paracaktuar". Mendoj se ligjvënësi nuk e ka lidhur konceptin e vlerës së paracaktuar me numrin e provave që gjenden në gjykim. Provat nuk maten nga pikëpamja sasiore, por cilësore. Kjo do të thotë se gjyqtari duhet të çmojë provën në mënyrë që të përcaktojë lidhjen që ka kjo provë me çështjen dhe cilësinë e kësaj prove për të vërtetuar një fakt të caktuar. Rrugëzgjidhja e dhënë në praktikën gjyqësore që nëse ka vetëm një provë, kjo nuk mund të shërbejë për përcaktimin e fajësisë, jo vetëm që është një zgjidhje sipërfaqësore, por në të njëjtën kohë eleminon bindjen e lirë të brendshme të gjyqtarit në vlerësimin e provës. Kjo rrjedhimisht sjell idenë tjetër, që një gjykim i zhvilluar mbi një provë, është një

---

[457] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 698, datë 09.12.2009.
[458] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 17.
[459] Për më tepër, shih vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 775, datë 14.07.2010.
[460] Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 31, datë 31.01.2013.

gjykim i pavlerë, pasi rezultati është i paracaktuar. Duhet të theksohet se provat në gjykim debatohen sipas parimit të kontradiktoritetit, pra të dyja palët debatojnë në gjykim për të bindur gjykatën në lidhje me vërtetësinë dhe fuqinë provuese të provës. Pikërisht nga rezultati i debatit kontradiktor mes palëve, gjykata arrin të perceptojë se cila është fuqia provuese e provës.

Nuk mund të ketë vlerë të paracaktuar një provë, e cila pas debatit kontradiktor ndërmjet palëve, vërteton katërcipërisht faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale. Sigurisht që kërkohet një analizë e kujdesshme e provës, në drejtim të besueshmërisë së saj (në rastin e dëshmisë) ose origjinalitetit dhe lirisë së vullnetit të personit (në rastin e dokumenteve), por edhe e fuqisë së saj provuese. Ligji ynë procedural nuk e njeh rregullin që paracakton vlerën e provave, duke ia lënë vlerësimin e fuqisë provuese të tyre, çmuarjes së lirë të gjyqtarit.[461] Ligji, gjithashtu, nuk vendos kufizime për vërtetimin e ekzistencës së faktit nga një provë e vetme. Është e arsyeshme përse ligji nuk vendos kufizime të tilla, pasi në eventualitetin e një çështje penale ku ***objektivisht*** ka vetëm një provë, e cila vërteton me siguri kryerjen e faktit penal dhe ajo është e aftë të krijojë bindjen e duhur në ndërgjegjen e gjyqtarit, mohimi i vlerës provuese të saj orienton drejt zbatimit të sistemit të provave ligjore, duke mohuar parimin veprues të bindjes së brendshme të gjyqtarit.

Në drejtim të kuptimit të konceptit të provës së vetme në procesin penal, është e rëndësishme të evidentojmë praktikën e Gjykatës së Lartë, që ka reflektuar ndryshimet ligjore të vitit 2017. Në vendimin nr. **00-2022- 790, datë 20.05.2022 Gjykata e Lartë është shprehur se:** ***Vendimi penal mund të mbështetet dhe në një provë të vetme, nëse kjo është vendimtare për zgjidhjen e çështjes. Duhet theksuar që, nëse ekzistenca e faktit nuk mund të nxirret me siguri vetëm nga një indicje, ligji nuk vendos kufizime për vërtetimin e fakteve nga një provë e vetme. Sigurisht që kërkohet një analizë e kujdesshme e provës, në drejtim të besueshmërisë së burimit.*** Në vijim, Gjykata e Lartë ka shpjeguar kriteret e përcaktuara nga GJENDJ lidhur me vlerësimin e provës së konsideruar të vetme apo vendimtare, duke mos vënë asnjëherë në diskutim mjaftueshmërinë e saj, por faktin që gjatë marrjes së kësaj prove, të respektohen të drejtat e mbrojtjes dhe kontradiktoriteti, duke i dhënë mundësi të pandehurit që të vendosë në dyshim besueshmërinë e dëshmitarit dhe vërtetësinë e thënieve të tij, përmes ushtrimit të së drejtës së pyetjeve ndaj dëshmimtarit. Me anë të këtij vendimi, duket se Gjykata e Lartë i është larguar një praktike të krijuar më herët se fajësia nuk mund të vendosej nga një provë e vetme, pasi në këtë rast vlera e saj paracaktohej. Kjo praktikë, e cila zbatohet edhe sot, kryesisht në gjykatat e faktit, të shkallës së parë dhe Apelet, sipas gjykimit tim, bie ndesh me parimin e lirisë së vlerësimit të provave, të bindjes së brendshme të gjykatës dhe e orienton provueshmërinë drejt vlerës sasiore të provave sesa drejt aspektit cilësor të tyre.

Me reformën legjislative të vitit 2017, ligjvënësi përcaktoi konkretisht dy raste apo situata, në të cilat prova e vetme ose më saktësisht e dhëna e vetme nuk mund të përcaktonte fajësinë e të pandehurit. Konkretisht, në nenin 390/2/3, ligjvënësi përcaktoi se, fajësia e të pandehurit nuk mund të bazohej vetëm në deklarimet e bëra nga personi,

---

[461] Henrik Ligori, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 16.

i cili, me vullnetin e tij, nuk ka pranuar të pyetet nga i pandehuri ose nga mbrojtësi i tij në asnjërën nga fazat e procedimit, si edhe në situatën, nëse fajësia bazohej vetëm ose kryesisht në deklarimet e bashkëtëpandehurit, apo dëshmitë e marra nëpërmjet teknikave të veçanta për fshehjen e identitetit të dëshmitarit, sipas nenit 361/b të KPrP[462]. Nga pikëpamja formale ky parashikim, madje në tërësi e gjithë dispozita e nenit 390 të KPrP, përbëjnë risi për legjislacionin tonë procedural, nga pikëpamja thelbësore, pavarësisht se rregulli i përgjithshëm është vlerësimi i lirë i provave nga gjykata, legjislacioni procedural penal, edhe përpara ndryshimeve ligjore të vitit 2017, kishte parashikuar në temën e provave, disa përjashtime, duke (mos) njohur një vlerë të caktuar ligjore të tyre, pra, duke e paracaktuar vlerën e tyre. Këtë mund ta ilustrojmë me vlerën e kufizuar që kanë pasur, por edhe kanë aktualisht deklarimet e bashkëtëpandehurit, ose të pandehurit në një procedim të lidhur, sipas nenit 152/3 të KPrP. Në fakt, kjo pjesë e kësaj dispozite nuk ka pësuar ndryshime me reformën legjislative të vitit 2017. Megjithatë, duket se ligjvënësi e ka zgjeruar rrethin e subjekteve, që përbëjnë burime provash, për të cilët ka paracaktuar vlerën ligjore si psh. dëshmitarët në pg.2 të nenit 390 të KPrP, të cilët refuzojnë të pyeten nga të pandehurit, apo ata, dëshmitë e të cilëve janë marrë në kushtet e zbatimit të teknikave të veçanta, personat e infiltruar etj. Gjykimi im është se këto norma sjellin padyshim një frymë më garantiste ndaj interesave të të pandehurit, por, nga ana tjetër, vijnë me një "kosto" të caktuar, që është kufizimi i veprimtarisë ose rolit të gjykatës në vlerësimin e lirë të provave.

Megjithatë, në këtë temë, edhe një gjykim tjetër mund të jetë i përshtatshëm, ai sipas të cilit, ligjvënësi duke përcaktuar në mënyrë eksplicite situatat e provave të vetme, vërtetimi i të cilave ndalon ose pamundëson dhënien e një vendimi fajësie, *a contrario*, pranon faktin që në çdo situatë tjetër ku ndeshet prova e vetme, ajo si e tillë mund të jetë e aftë për të prodhuar një vendim fajësie. Dukshëm, ligjvënësi nuk e ka përkrahur qasjen e mëparshme të praktikës gjyqësore mbi konceptin e provës së vetme, e cila, ka qenë e kritikueshme për shkak të efektit që i njihej provës së vetme (*me një provë të vetme nuk mund të deklarohet fajësia e të pandehurit*), duke e transferuar në një farë mënyre këtë koncept nga domeni gjyqësor në atë legjislativ, duke e njohur këtë efekt vetëm në raste tashmë ligjërisht të përcaktuara. Megjithatë, zgjerimi i këtyre kufizimeve apo përjashtimeve edhe në rastet e dëshmitarëve të mbrojtur, me identitet të fshehur, bashkëpunëtorëve të drejtësisë, personave të infiltruar dhe atyrë nën mbulim, gjykoj se do të ketë efekte negative në praktikë, në hetimin dhe gjykimin e disa veprave penale specifike, veçanërisht veprat penale të rënda, si psh. rastet e grupeve kriminale, trafikimet e ndryshme etj., të cilat për shkak të natyrës së tyre, e kanë të kufizuar rrethin e burimeve të provave. "Shqetësimi" i ligjvënësit se këto prova janë të pamjaftueshme (*ndoshta për shkak të vërtetësisë apo sigurisë që mund të ofrojnë në proces një subjekt që lidhet proceduralisht me organin e akuzës-dëshmitari me identitet të fshehur, i infiltruari etj.*) nuk duket i justifikuar nga pikëpamja logjike, kur bëhet fjalë për dëshmitarët. Gjithashtu, kjo nuk shprehet as në nenin 152/3 të KPrP, i cili përcakton shtyllat kryesore të vlerësimit apo çmimit të provave, por as edhe me kufizime të tjera që përcaktohen në prova konkrete, si psh. në rastet e vlerësimit të deklarimeve të bëra në hetimet paraprake gjatë kundërshtimit të dëshmisë ose pyetjes së dëshmitarit të mitur. Në këtë kontekst, në përfundim, gjykoj se qëllimi pozitiv i ligjvënësit për të rregulluar çështjen e provës së vetme, tej kufizimeve të nenit 152/3 dhe atyre të

[462] Neni 390 i KPrP, pikat 2 dhe 3.

parashikuara në prova konkrete, me gjasë do të passjellë zbatim jo uniform të së drejtës penale dhe rezultate të ndryshme në procese penale të ngjashme.

Kreu V

Prezumimet në procesin penal

***Përmbledhje**: **5.1** Kuptim i përgjithshëm i prezumimeve në procesin penal. Raporti me barrën e provës dhe standardin e të provuarit. **5.1.1** Kuptimi i prezumimeve. **5.1.2** Qendrimet e ndryshme mbi ekzistencën e prezumimeve. **5.1.3** Qëllimi i prezumimeve. **5.1.4** Kushtetutshmëria e prezumimeve. **5.1.4.1** Në sistemin ligjor Italian. **5.1.4.2** Në praktikën e GJEDNJ. **5.1.4.3** Në sistemin ligjor të BE-së. **5.1.4.4** Në sistemin common law (Gjykata Supreme e SHBA). **5.1.5** Llojet e prezumimeve. **5.1.6** Efekti i prezumimeve në barrën e proves dhe standardin e të provuarit. **5.2** Prezumimet ligjore në legjislacionin penal dhe prezumimet e faktit. **5.2.1** Parimet e procesit penal dhe prezumimet ligjore. **5.2.1.1** Prezumimi i njohjes së ligjit. **5.2.1.2** Prezumimi i rrezikshmërisë shoqërore. **5.2.1.3** Prezumimi i rrezikut. Veprat penale që rrezikojnë. **5.2.1.4** Prezumimi i moshës së mitur. **5.2.1.5** Prezumimet ligjore të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale. **5.2.2** Prezumimet e faktit dhe mekanizmi prezumues te indicjet. **5.2.2.1** Prezumimet e faktit bazuar në heshtjen (sjelljen) e të pandehurit. **5.2.2.2** Prezumimet faktike në praktikën gjyqësore shqiptare. **5.3** Ndikimi i interpretimeve gjyqësore në krijimin e prezumimeve. **5.3.1** Roli i gjykatës në interpretimin e ligjit. **5.3.2** Prezumimet si rrjedhim i interpretimit. **5.3.2.1** Vendimi unifikues mbi veprën penale vazhduese. **5.3.2.2** Vendimi unifikues mbi pozitën e bashkëekzekutorit. **5.3.2.3** Vendimi unifikues mbi bashkëpunëtorin e panjohur. **5.3.2.4** Vendimi unifikues mbi trafikimin e lëndëve narkotike. **5.3.2.5** Vendimi unifikues mbi vjedhjen me pasojë vdekjen*

5.1 Kuptim i përgjithshëm i prezumimeve në procesin penal. Raporti me barrën e provës dhe standardin e të provuarit

Prezumimet në procesin penal përbëjnë një fushë, në të cilën mungojnë studime të thelluara në doktrinën e së drejtës penale të vendit tonë, përjashtuar trajtimet mbi prezumimin e mirënjohur, atë të pafajësisë. Gjithashtu, edhe në praktikën gjyqësore penale, në vendimmarrjet e gjykatave, është e vështirë të gjenden trajtime apo elaborime të konceptit dhe vetëm në mënyrë tangenciale mund të gjenden përmendje të tij. Për të gjetur një kuptim të tyre në sistemin tonë juridik, duhet t'i referohemi të drejtës procedurale civile, ku doktrina e kësaj të drejte, por edhe praktika gjyqësore, ka dhënë kuptimin e prezumimeve dhe një ndarje të tyre. Sipas saj, prezumime quhen konkluzionet e bëra mbi ekzistencën e një gjendjeje (fakti) nga ekzistenca e një gjendjeje (fakti) tjetër[463]. Në të drejtën e provave, prezumime quhen përfundimet e nxjerra për vërtetësinë e një fakti nga ekzistenca e fakteve të tjera[464]. Një përkufizim më konkret i prezumimeve ka qenë parashikuar në Shtojcën e Dytë të Kodit të Procedurës Civile të Mbretnisë Shqiptare, i cili në nenin 237 parashikonte se, "*Prezumimet janë konsekuencat që ligja ose gjyqtari nxjerr prej një fakti të ditun për një fakt të paditun.*"[465]

---

[463] Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Tiranë 2006, fq. 256

[464] Po aty.

[465] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 00 – 2021 - 706 i Vendimit, datë 10.05.2021, pg. 34

Më lart, në këtë punim, u trajtuan në mënyrë të përmbledhur disa përjashtime të barrës së provës, të evidentuara edhe nga doktrina e së drejtës penale, megjithatë për një kuptim më të plotë të institutit të barrës së provës dhe përjashtimeve prej saj, është e nevojshme të ndalemi te trajtimi i prezumimeve. Ndikimi i këtyre të fundit shtrihet dhe në standardin e të provuarit, në kuptimin që pala në dobi apo favor të të cilit operon prezumimi, nuk ka detyrimin për ta provuar atë në ndonjë nivel provueshmërie apo shkallë sigurie.

5.1.1 Kuptimi i prezumimeve

Në literaturën e huaj, të mbizotëruar kryesisht nga studiuesit e sistemit common law, jepen disa kuptime për termin prezumime. Sipas njërit kuptim, koncepti prezumim përdoret *në kuptimin e zhvendosjes së barrës së provës tek i pandehuri, për të trajtuar një çështje që konsiderohet si çështje e mbrojtjes*; *një tjetër kuptim sugjeron që koncepti duhet të përdoret për të treguar se pasi jepen prova të mjaftueshme për faktet themelore, fakti i supozuar vërtetohet, përveç nëse i pandehuri paraqet prova që hedhin poshtë supozimin*; studiues të tjerë e përkufizojnë si *një term përmbledhës që përfshin situatat në të cilat organi legjislativ përcakton se provueshmëria e fakteve të caktuara* (fakti themelor) *ka efekt në vërtetimin e fakteve të tjera* (fakti i supozuar, që mund të jetë krimi i supozuar ose një element i krimit të supozuar)[466]. Nga studiuesit e sistemit kontinental prezumimi përkufizohet si një procedurë provuese e cila, nga një fakt i njohur, lejon të konkludohet mbi ekzistencën e një fakti të panjohur, që ka lidhje drejtpërdrejtë me zbatimin e ligjit[467]. Praktika gjyqësore civile e vendit tonë evidenton se: *"Prezumimi**, si çlirim nga barra e provës**, konsiston në atë që disa fakte mund të deduktohen nga ekzistenca e fakteve të tjera me të cilat të parat kanë një lidhje shkakësore të domosdoshme dhe të drejtëpërdrejtë. Kështu, prezumimi bazohet në mekanizmin e lidhjes shkak-pasojë, ku një fakt zakonisht shoqërohet nga një tjetër ose është shkak apo pasojë e një tjetri. Njohja e lidhjes shkak-pasojë midis ngjarjeve shoqërore apo natyrore bazohet në përvojën jetësore, shoqërore, shkencore etj. Duke qenë se ekzistenca e një fakti mund të nxirret nga një fakt tjetër (i cili sipas zhvillimit normal të lidhjes shkakësore dihet se i paraprin, e shoqëron apo e pason të parin), do të ishte një angazhim i panevojshëm i palëve apo gjykatës në të provuarit e këtyre fakteve. Në këtë mënyrë, duke operuar me instrumentin e prezumimit, **ligjvënësi synon të përshpejtojë procesin e të provuarit dhe të ekonomizojë procedurën e hetimit administrativ apo gjyqësor**".*[468]

Në kushtet që legjislacioni ynë penal dhe procedural penal (madje jo vetëm, përgjithësisht vendet e civil law karakterizohen nga i njëjti fenomen. psh Italia), nuk përmban ndonjë kuadër normativ lidhur me fushën e prezumimeve, gjykoj që, kuptimi përgjithësues i përmbajtjes së prezumimeve në procesin tonë penal duhet të përfshijë *tërësinë e atyre rregullave, të imponuara nga ligji ose gjykata, të cilat konsiderojnë të mirëqena ekzistencën e fakteve, rrethanave apo gjendjeve të caktuara të një procesi*

---

[466] *Për të tria kuptime*t, Gerald H. Abrams, Statutory Presumptions and the Federal Criminal Law: A Suggested Analysis, 22 Vanderbilt Law Review 1135 (1969), https://scholarship.Law.vanderbilt.edu/vlr/vol22/iss5/5, fq. 1135-1136

[467] Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli", https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzionineldirittopenale.pdf, fq.8

[468] Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 00 – 2021 - 706 i Vendimit, datë 10.05.2021, pg. 37

penal, duke i shmangur palës në dobi të së cilës operojnë, barrën e "tepërt" të të provuarit të tyre.

5.1.2 Qendrimet e ndryshme mbi ekzistencën e prezumimeve

Përpos asaj që është thënë më lart, rezulton nga studimi i doktrinës në fushën e prezumimeve, se nuk ka një qëndrim të unifikuar lidhur me vetë ekzistencën e prezumimeve. Ndonëse një pjesë e konsiderueshme autorësh pranojnë konceptin e prezumimeve si një faktor me rëndësi në temën e provave, ka të tjerë që mohojnë këtë koncept dhe kuptimin e tij në procesin gjyqësor. Sipas profesorit të ligjit Ronald J Allen, *fjala "prezumim" përbën thjesht një emërtim, që është aplikuar në një grup vendimesh të ndryshme, lidhur me formën e duhur të gjykimit dhe mënyrën në të cilën do të vërtetohen faktet për të zgjidhur mosmarrëveshjet ligjore. Në çdo rast të vetëm të përdorimit të termit prezumim, çfarëdo që bëhet përcaktohet nga koncepte dhe politika normale provuese, ndër të cilat më e rëndësishmja është barra e proves*[469]. Sipas gjykimit tim, qëndrimi i mësipërm është pjesërisht i drejtë, pasi i konsideron prezumimet si rrjedhime të politikave apo koncepteve ligjore, por nuk mund të jetë një kuptim përgjithësues për të gjitha sistemet ligjore, për sa i përket efektit të prezumimeve në procesin penal dhe veçanërisht aspekteve të barrës së provës. Lidhur me konfuzionin që ekziston për konceptin e prezumimeve, profesori James T Ranney, është shprehur se *pjesa më e madhe e këtij konfuzioni rrjedh nga pamundësia e shumë gjykatave dhe autorëve për të kuptuar që prezumimet shfaqen në një gamë të gjerë formash dhe përmasash, pasojat e tyre varen pikërisht nga ajo se çfarë krijuesi i tyre ka pasur si qëllim ose më shpesh nga ajo se çfarë gjykata konsideron se ka qenë qëllimi*[470].

5.1.3 Qëllimi i prezumimeve

Justifikimi apo ligjërimi i prezumimeve në procesin penal bazohet dhe gjendet në pozicionin e palëve në procesin penal (i pandehur/akuzuar-prokuror), interesat e kundërta që ata kanë në raport me procesin penal (prokurori përpiqet të argumentojë fajësinë, i akuzuari që është i pafajshëm ose që vepra është kryer në rrethana shfajësuese) dhe interesi i shoqërisë për dhënien e drejtësisë. Edhe pse nuk ka përcaktime në këtë fushë, prezumimet kryesisht tentojnë të shkojnë në favor të akuzës sesa të akuzuarit. Në një ndër çështjet e hershme të Gjykatës Supreme në SHBA, *Jackson and Kansas City Railroad v.Turnipseed* (1910), Gjykata përcaktoi se kriteri për të vlerësuar që prezumimet ishin në përputhje me procesin e rregullt ligjor, ishte *lidhja e arsyeshme/racionale ndërmjet faktit të provuar dhe atij të prezumuar*[471]. Pavarësisht se çështja në fjalë ishte civile, Gjykata theksoi se ky test aplikohej dhe në procesin penal[472]. Përgjatë viteve 1920, karakterizuar nga rritja e krimit të organizuar

---

[469] Ronald J. Allen, Burdens of proof, *Law, Probability and Risk*, Volume 13, Issue 3-4, September–December 2014, Pages 195–219, https://doi.org/10.1093/lpr/mgu005, fq. 208

[470] James T. Ranney, Presumptions in Criminal Cases: A New Look at an Old Problem, 41 Mont. L. Rev. (1980). Available at: https://scholarworks.umt.edu/mlr/vol41/iss1/2, fq.26

[471] Leslie J. Harris, *Constitutional Limits on Criminal Presumptions As an Expression of Changing Concepts of Fundamental Fairness*, 77 J. CRIM. L. & CRIMINOLOGY 308 (1986), https://scholarlycommons.Law.northwestern.edu/jclc/vol77/iss2/2, fq. 318

[472] Po aty.

dhe joefektiviteti i perceptuar i drejtësisë penale për të mbrojtur shoqërinë, testi i lidhjes racionale/të arsyeshme u kritikua, sepse në mënyrë drastike kufizonte përpjekjet legjislative *për të ndihmuar prokurorët*, edhe pse ky test nuk ishte shumë i rreptë[473]. Pra, debati është fokusuar në nxitjen e masave për rritjen e efektivitetit të drejtësisë penale, sesa në vendosjen në plan të parë të të drejtave që vihen në rrezik në procesin penal. Aktualisht, në doktrinë konsiderohet se prezumimet janë mekanizma që synojnë menaxhimin apo minimizimin e kostove të gabimeve gjyqësore.[474] Megjithatë, përpos elokuencës që përdoret për të ligjëruar prezumimet në procesin penal, është i pashmangshëm konstatimi se prezumimet kryesisht synojnë të lehtësojnë barrën e provës të palës që akuzon e që duhet të mbështesë më prova akuzën e ngritur. Thënë kjo, përdorimi i prezumimeve nuk passjell në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe nuk ofron ndonjë siguri se do të shmangen gabimet në procesin gjyqësor. Përkundrazi, aplikimi apo përdorimi jo adekuat i prezumimeve në procesin penal, në kushtet që gabimisht mund të derogohet edhe nga debati gjyqësor e kontradiktoriteti, ka gjasa të përkeqësojë rekordin e gabimeve në procesin penal sesa ta përmirësojë atë. Gjithsesi, mendimi im është që këndvështrimi i prezumimeve si mekanizëm i shmangies së gabimeve gjyqësore duhet të jetë objektivi i dëshiruar dhe i përhershëm prej sistemit tonë ligjor. Siç do të shohim në vijim, në disa raste të marra në studim nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, ky këndvështrim ndaj prezumimeve nuk është marrë në konsideratë, duke theksuar këtu faktin se ndikim të rëndësishëm ka dhe mungesa e traditës në studimin e këtyre fenomeneve.

5.1.4 Kushtetutshmëria e prezumimeve

Duke pranuar këtë qasje të zhbalancuar në kuptimin dhe përdorimin e prezumimeve, jo pa arsye, në doktrinën e huaj, por edhe në jurisprudencën, kryesisht të vendeve të common law, ka një debat të vazhdueshëm mbi kushtetutshmërinë e prezumimeve në raport me institute të tilla si prezumimi i pafajësisë, barra e provës dhe standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, për të cilat ka një traditë të konsoliduar të mënyrës së tyre të operimit në procesin penal.

5.1.4.1 Në sistemin ligjor italian

Autori Francesco Caporotundo shprehet lidhur me këtë çështje se *e drejta e qytetarisë së prezumimeve ligjore në procesin penal është vënë fuqimisht në diskutim duke qenë se ato mund të shkaktojnë një zhvendosje të barrës së provës, që bie ndesh me prezumimin e pafajësisë (jo fajësisë sipas autorit italian), të përcaktuar nga neni 27/2 i Kushtetutës (italiane) dhe nenit 6 të KEDNJ, si edhe nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile e Politike: në të vërtetë, duke qenë se* ***thema probandum*** *e procesit penal është fajësia e të pandehurit, elementët thelbësorë të përgjegjësisë së tij penale duhet të provohen një për një përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, pa mundësinë e thjeshtimit të vlerësimit që do të mund ta ngarkonte të akuzuarin me barrën e vërtetimit të pafajësisë së tij*[475].

---

[473] Po aty.

[474] Për një kuptim më të gjerë shiko, Hamer, David. (2014). Presumptions, standards and burdens: Managing the cost of error. Law, Probability and Risk. 13. 221-242. 10.1093/lpr/mgu006, fq. 221

[475] Francesco Caporotundo, Presunzioni legali e onere della prova nel processo penale, https://www.giurisprudenzapenale.com/wp-content/uploads/2017/01/caporotundo_gp_2017_1.pdf, fq.1

5.1.4.2 Në praktikën e GJEDNJ

Praktika gjyqësore e GJEDNJ lidhur me prezumimet paraqet rëndësi thelbësore për sa i përket kushtetutshmërisë së tyre në procesin penal, veçanërisht në sistemin ligjor shqiptar. Shprehimisht, GJEDNJ ka përcaktuar se Neni 6 para. 2 (neni 6-2) nuk i trajton me indiferencë prezumimet e faktit ose të ligjit të parashikuar në ligjin penal. Nga ana tjetër, GJEDNJ kërkon që shtetet t'i kufizojnë ato *brenda kufijve të arsyeshëm që marrin parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe të ruajnë të drejtat e mbrojtjes*[476]. Lidhur me këtë vendim të GJEDNJ, doktrina europiane është shprehur se në 'rastet kryesore' *Salabiaku dhe Pham Hoang*, të cilat përfshinin shqyrtimin e veprave penale në fushën e doganave, është pranuar përdorimi i prezumimit ligjor të fajit[477].

5.1.4.3 Në sistemin ligjor të BE-së

Të njëjtën qasje, të diktuar nga GJEDNJ ka ruajtur edhe legjislacioni i BE-së. Në Direktivën nr.343/2016 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016, pavarësisht se nuk është parashikuar në pjesën zbatuese të direktivës, në pjesën hyrëse të kësaj të fundit, në pikën 22, janë njohur dhe pranuar prezumimet e faktit dhe të ligjit me disa kritere. Konkretisht, në këtë direktivë parashikohet se "*Barra e provës për vërtetimin e fajësisë së të dyshuarve dhe të akuzuarve është e prokurorisë dhe çdo dyshim duhet të jetë në dobi të të dyshuarit apo të akuzuarit. Prezumimi i pafajësisë do të cenohej nëse barra e provës do të kalonte nga prokuroria tek mbrojtja, pa paragjykuar kompetencat ex officio fakt-gjetëse të gjykatës, pavarësinë e gjyqësorit në vlerësimin e fajësisë së të dyshuarit ose të akuzuarit dhe përdorimin e prezumimeve të faktit ose ligjit në lidhje me përgjegjësinë penale të një të dyshuari ose personi të akuzuar. Prezumime të tilla duhet të kufizohen brenda kufijve të arsyeshëm, duke marrë parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe ruajtjen e të drejtave të mbrojtjes, dhe mjetet e përdorura duhet të jenë në proporcion të arsyeshëm me qëllimin legjitim të ndjekur. Prezumime të tilla duhet të jenë të kundërshtueshme dhe në çdo rast, duhet të përdoren vetëm kur respektohen të drejtat e mbrojtjes*"[478]. Gjykoj se kjo është një qasje që duhet të mbahet në konsideratë për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së prezumimeve edhe në sistemin tonë ligjor.

5.1.4.4 Në sistemin common law (Gjykata Supreme e SHBA)

Në sistemin common law diskutimi në fushën e prezumimeve duket të jetë më i avancuar se në sistemin civil law, duke pasur në konsideratë që çështja e prezumimeve ka qenë objekt i jurisprudencës së Gjykatës Supreme të SHBA që prej fillimit të shek XX, në përpjekje për të trajtuar dhe përpunuar kriteret e përputhjes së prezumimeve me standardet kushtetuese. Përgjatë dekadave të jurisprudencës së Gjykatës Supreme të SHBA, kritere të ndryshme janë prezantuar për të vlerësuar

---

[476] Çështja *Salabiaku kundër Francës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10519/83), 7 Tetor 1988, pg. 28

[477] Elies Van Sliedregt, «A Contemporary Reflection on the Presumption of Innocence», Revue internationale de droit pénal 2009/1 (Vol. 80), p. 247-267, https://www.cairn-int.info/journal-revue-internationale-de-droit-penal-2009-1-page-247.htm?WT.tsrc=pdf, fq. 261

[478] Për më gjerë, shih Direktivën nr.343/2016 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016

kushtetutshmërinë e prezumimeve dhe duket se pas çdo vendimi të saj në këtë fushë, ka pasur gjithnjë kritika. Më lart, sollëm në vëmëndje çështjen *Jackson and Kansas City Railroad v.Turnipseed* (1910), ku Gjykata përpunoi kriterin e *lidhjes së arsyeshme/racionale ndërmjet faktit të provuar dhe atij të prezumuar,* i cili vepronte njëlloj në çështjet civile dhe ato penale dhe që u vlerësua se ishte në përputhje me procesin e rregullt ligjor (due process clause)[479].

Kriteri i mësipërm është aplikuar në disa vendime të mëvonshme të Gjykatës Supreme në çështjet penale, ku do të veçonim çështjen *Tot vs United States 319 US 463 (1943).* Profesori i ligjit Leo H Ëhinery ka shpjeguar se *janë të paktën katër elementë domethënës që janë vendosur nga Gjykata Supreme për të përcaktuar përmbushjen e kriterit të lidhjes racionale/të arsyeshme. Këto elemente janë: standardet për të përcaktuar lidhjen racionale ndërmjet fakteve themelore dhe faktit të prezumuar; natyra lejuese ose detyruese e prezumimit; baza faktike e nevojshme për të përcaktuar ekzistencën e lidhjes racionale ndërmjet fakti themelor dhe atij të prezumuar dhe efekti procedural që u njihet prezumimeve*[480]. Kriteri i lidhjes racionale bazohej në vlerësimin sipas eksperiencës, e quajtur eksperiencë e zakonshme ose e përbashkët.

Në çështjen *Leary v. United States 395 U.S. 6 (1969), Gjykata Supreme adoptoi një standard të njaftueshmërisë provuese në vend të relevancës për të shpjeguar kuptimin e testit të lidhjes racionale. Me fjalë të tjera, jo vetëm që ndërmjet faktit themelor dhe atij të prezumuar duhet të ekzistonte një lidhje logjike, por fakti i prezumuar me shumë të ngjarë/me gjasë (more likely than not) duhet të rridhte nga fakti themelor i prezumimit*[481]. Në këtë çështje, Gjykata, ngriti gjithashtu, çështjen nëse një prezumim në procesin penal duhet të përmbushë standardin e dyshimit të arsyeshëm, kur fakti i prezumuar mund të përbëjë provën e krimit ose një element thelbësor të tij, megjithatë Gjykata nuk e trajtoi më tej këtë çështje, për shkak se konstatoi se në rastin konkret, prezumimi nuk përmbushte standardin minimal *more-likely-than-not*[482].
Vendimi i mësipërm është kritikuar me argumentin se *një prezumim që plotëson testin e Leary-it, por jo testin e dyshimit të arsyeshëm, do t'i lejonte prokurorisë të provonte çështjen pa provuar çdo element të krimit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Së dyti, nëse prokuroria mund të provojë një element të krimit prej prezumimit, atëherë prezumimi i pafajësisë kapërcehet nga prova që nuk është vërtetuar përtej një dyshimi të arsyeshëm*[483].

Në çështjen In re Winship (1970) Gjykata Supreme përcaktoi se klauzola e procesit të rregullt ligjor mbron të akuzuarin nga dënimi, përveç nëse provohet përtej dyshimit të arsyeshëm çdo fakt, i nevojshëm për të përbërë krimin për të cilin ai akuzohet[484]. Nga profesorë të doktrinës, ky vendim njihet si vendimi në të cilin u aplikua shqyrtimi i standardit të dyshimit të arsyeshëm te prezumimet në procesin penal, në kuadër të

---

[479] Procesi i rregullt ligjor (due process clause) mishërohet në Amendamentin e Pestë dhe të Katërmbëdhjetë të Kushtetutës së SHBA-ve
[480] Leo H. Whinery, *Presumptions and Their Effect*, 54 OKLA. L. REV. 553 (2001), https://digitalcommons.Law.ou.edu/olr/vol54/iss3/5 , fq. 562
[481] Po aty, fq. 564
[482] Po aty, fq. 564-565
[483] Shari L. Jacobson, Mandatory and Permissive Presumptions in Criminal Cases: The Morass Created by Allen, 42 U. Miami L. Rev. 1009 (1988) Available at: https://repository.Law.miami.edu/umlr/vol42/iss4/7, fq.1023
[484] In re Winship 397 U.S. 358 (1970)

procesit të rregullt ligjor[485]. *Në këtë kohë prezumimet trajtoheshin ende si një mjet që përmbushnin barrën e bindjes (si pjesë e barrës së provës), në vend që ta shpërndanin atë. Për rrjedhojë, prezumimet potencialisht kërcënonin kërkesat e të provuarit duke mundësuar dënimin mbi të dhëna që linin më tepër se një dyshim të arsyeshëm fajësie. Ky shqetësim u shpreh në termat nëse testi i lidhjes racionale nënkuptonte se fakti i prezumuar duhej të ndiqej nga fakti themelor përtej dyshimit të arsyeshëm apo nëse ai duhej të ishte me gjasë i vërtetë sesa jo i vërtetë*[486].

Në çështjen *Allen* (1979), Gjykata Supreme prezantoi një ndarje apo dallim të prezumimeve, në varësi të efektit që ato kishin te juria, në prezumime lejuese dhe prezumime detyruese. Gjykata shprehu se kur prezumimet kanë natyrë lejuese, konsiderohet e mjaftueshme, nëse fakti i prezumuar me shumë gjasa (testi more likely than not) rrjedh nga fakti themelor. Lidhur me prezumimet detyruese, Gjykata u shpreh se, për sa kohë që prokuroria ka barrën e vërtetimit të fajësisë, ajo nuk mund ta mbështesë çështjen kryesisht te prezumimi, përveç nëse fakti i provuar është i mjaftueshëm për të mbështetur konkluzionin e fajësisë përtej dyshimit të arsyeshëm[487]. Siç rezulton, Gjykata ka pranuar dy standarde që karakterizojnë lidhjen racionale ndërmjet faktit bazë dhe atij të prezumuar, atë që fakti i prezumuar me gjasë rrjedh nga fakti themelor dhe standardin e dyshimit të arsyeshëm.

5.1.5 Llojet e prezumimeve

Prezumimet në procesin penal ndahen në disa kategori, kryesisht në varësi të forcës së tyre detyruese ose bindëse, por edhe të subjektit nga i cili buron prezumimi, që nënkupton ligjin ose gjykatën, megjithatë një faktor me rëndësi është dhe sistemi ligjor ku bëjnë pjesë. Nëse i referohemi vendimit të GJEDNJ në çështjen Salabiaku dhe Direktivës nr.343/2016 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016, të cituar edhe më lart, prezumimet ndahen në prezumime të ligjit dhe prezumime të faktit. Këto akte nuk japin përkufizime të mëtejshme të prezumimeve të ligjit dhe të faktit. Doktrina jonë e së drejtës procedurale civile[488] i është referuar asaj italiane[489], kur i klasifikon prezumimet në prezumime ligjore dhe prezumime të njeriut ose të zakonshme (të thjeshta). Konkluzionet e detyrueshme ***me ligj*** për gjykatën për vërtetësinë e një fakti, kur është provuar një fakt tjetër, quhen prezumime ligjore[490]. Për sa u përket prezumimeve të njeriut, të tilla quhen përfundimet logjike të bëra zakonisht në jetë, kur një fakt zakonisht shoqërohet nga një tjetër ose është shkak

---

[485] Charles W. Collier, The Improper Use of Presumptions in Recent Criminal Law Adjudication, 38 Stan. L. Rev. 423 (1986), available at http://scholarship.Law.ufl.edu/facultypub/664, fq. 429

[486] Leslie J. Harris, Constitutional Limits on Criminal Presumptions As an Expression of Changing Concepts of Fundamental Fairness, 77 J. Crim. L. & Criminology 308 (1986), https://scholarlycommons.Law.northwestern.edu/jclc, fq. 327

[487] Për më gjerë, shih çështjen County Court vs Allen, 442 US 140 (1979)

[488] Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Tiranë 2006, fq. 257

[489] Francesco Caporotundo, Presunzioni legali e onere della prova nel processo penale, https://www.giurisprudenzapenale.com/wp-content/uploads/2017/01/caporotundo_gp_2017_1.pdf, fq.11 dhe 12 dhe Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli", https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzionineldirittopenale.pdf, fq. 9

[490] Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Tiranë 2006, fq. 257

a pasojë e një tjetri.[491] *Këto prezumime nuk janë të urdhëruara nga ligji, prandaj gjykata mund t'i përdorë në rast se i quan të drejta. Këto prezumime qendrojnë deri në provimin e së kundërtës*.[492] Prezumimet ligjore janë kategorizuar në prezumime absolute, *iuris et de iure,* të cilat nuk mund të tejkalohen nga provat e kundërta, ndërsa prezumimet relative, *iuris tantum,* kur provat e kundërta janë të vlefshme për të përjashtuar veprimin e prezumimeve.[493]

Në sistemin common law gjejmë klasifikime të ngjashme si më sipër, megjithatë me disa dallime. Në këtë sistem, prezumimet konsiderohen si rregulla ligjore të cilat përcaktojnë ekzistencën e faktit të prezumuar nga fakti i vërtetuar, ndërsa konkluzionet (inference në gjuhën angleze, në gjuhën shqipe nuk ka fjalë korresponduese) janë ato që rrjedhin përmes logjikës dhe arsyetimit, pas vlerësimit të fakteve të paraqitura në gjykim.[494] Pra, siç rezulton, prezumimi dhe konkluzioni (inference) në sistemin common law dallojnë në faktin që prezumimet bazohen në ligj, ndërsa konkluzionet bazohen në fuqinë provuese të provave.[495] Më tej, prezumimet janë klasifikuar në prezumime lejuese dhe detyruese, e këto të fundit në prezumime të rrëzueshme dhe të parrëzueshme. Kjo ndarje e prezumimeve u prezantua për herë të parë në sistemin common law në çështjen County Court vs Allen (1979) të Gjykatës Supreme të SHBA.

5.1.6 Efekti i prezumimeve në barrën e proves dhe standardin e të provuarit

Më sipër në trajtimin e barrës së provës, paraqitëm disa qendrime të doktrinës lidhur me kuptimin e këtij instituti, si edhe mënyrën e zbatimit në procesin penal të barrës së provës. Në sisteme të ndryshme ligjore jepen klasifikime të ndryshme të barrës së provës, të cilat më shumë se sa përcaktime teorike, janë të rëndësishme për funksionalitetin e tyre. Qëndrimi ynë që niset nga parimi i përgjithshëm, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ, është që barra e provës në procesin penal i takon prokurorit, i cili ka detyrimin për të provuar të gjithë elementët e faktit për të cilin është akuzuar i pandehuri. Megjithatë, në përputhje me drejtën e mbrojtjes së të pandehurit, pavarësisht se kjo nënkupton që i pandehuri mund edhe të mos jetë aktiv në realizimin e mbrojtjes së tij, nuk mund të anashkalohet, që në rastin e pretendimeve të ndryshme të të pandehurit si për sa i përket mënyrës së interpretimit të fakteve nga akuza, ashtu edhe evokimit të rrethanave të tjera që mohojnë faktet e akuzës apo rrethana të tjera shfajësuese (*ose që ulin nivelin e përgjegjësisë penale*), i pandehuri të ketë të ashtuquajturën barrën e pretendimit. E rikthesojmë se kjo nuk mund të përbëjë një detyrim të natyrës ligjore për të pandehurin, por duhet kuptuar e konsideruar brenda logjikës së një procesi penal me elementë akuzator, siç mund të klasifikohet edhe legjislacioni ynë procedural penal. Me reformën legjislative të vitit 2017 në

---

[491] Po aty.
[492] Po aty.
[493] Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli", https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzionineldirittopenale.pdf, fq. 9
[494] Shari L. Jacobson, Mandatory and Permissive Presumptions in Criminal Cases: The Morass Created by Allen, 42 U. Miami L. Rev. 1009 (1988) Available at: https://repository.Law.miami.edu/umlr/vol42/iss4/7, fq.1009
[495] Leo H. Whinery, *Presumptions and Their Effect*, 54 OKLA. L. REV. 553 (2001), https://digitalcommons.Law.ou.edu/olr/vol54/iss3/5 , fq. 554

pjesën e parimeve të përgjithshme të procedurës penale, ligjvënësi parashikoi një dispozitë të re të titulluar provat, ku në paragrafin e dytë parashikohet se: *2. Organi procedues duhet të mbledhë dhe të shqyrtojë si provat që fajësojnë të pandehurin, ashtu edhe ato që janë në favor të tij.* Nga kuptimi i kësaj dispozite rezulton se organi procedues duhet të mbledhë, por edhe të shqyrtojë provat që janë në favor të të pandehurit. Pikërisht, detyrimi për shqyrtim i provave të tilla, nënkupton që burimi i tyre mund të jetë jo vetëm prej aktivitetit procedural të organit procedues në mbledhjen e tyre, por edhe prej iniciativës së të pandehurit për të realizuar mbrojtjen e tij. Ky interpretim lidhet me kuptimin e nenit 34/a të KPrP, pika 1, germa f), ku parashikohet e drejta e personit nën hetim/të pandehurit për të paraqitur prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij.

Sa më sipër, i referohet rregullave të përgjithshme të mënyrës së si funksionon barra e provës në procesin penal. Megjithatë, duket se në fushën e prezumimeve nuk ka rregulla të qarta për mënyrën se si funksionon barra e proves dhe standardi i të provuarit, si edhe as të raportit që ky institut krijon me të drejtën e mbrojtjes dhe kontradiktoritetit në procesin penal. Në gjykimin tim, disa kritere të përgjithshme, por jo ezauruese, mund të deduktohen prej preambulës së Direktivës nr.343/2016 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të datës 9 mars 2016 (pika 22), të cilat mund të merren në konsideratë edhe në sistemin tonë ligjor, pavarësisht se direktiva nuk është ligjërisht e detyrueshme në vendin tonë. Këto kritere mund të përmblidhen si më poshtë:

- Prezumimet duhet të kufizohen brenda kufijve të arsyeshëm, duke marrë parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik dhe ruajtjen e të drejtave të mbrojtjes
- Mjetet e përdorura duhet të jenë në proporcion të arsyeshëm me qëllimin legjitim të ndjekur.
- Prezumime duhet të jenë të kundërshtueshme dhe në çdo rast, duhet të përdoren vetëm kur respektohen të drejtat e mbrojtjes

Orientimi i mësipërm i Direktivës i referohet, jo vetëm ligjvënësit në mënyrën e ndërtimit të prezumimeve, por edhe gjykatave për mënyrën e zbatimit të tyre në procesin penal. Në gjykimin tim, fakti që legjislacioni i BE-së i kushton një rëndësi të posaçme çështjes së prezumimeve në përgjithësi (*në veçanti prezumimit të pafajësisë*) tregon pikërisht për problematikat që mund të krijojë zbatimi i barrës së provës dhe standardit të të provuarit në fushën e prezumimeve. Mund të thuhet me siguri se në rastin e prezumimeve, ku interes *paraqesin, veçanërisht, ato që janë në favor të akuzës*, nuk është e paarsyeshme të konstatohet se barra për ta kundërshtuar faktin apo rrethanën e prezumuar, i ngarkohet palës kundër së cilës prezumimi vepron, konkretisht, personit të akuzuar. Në këtë pikë diskutimi që lind ka të bëjë me dy çështje, së pari nëse barra e provës apo e kundërshtimit/pretendimit imponon ose jo një detyrim për të pandehurin për të paraqitur prova dhe për të bindur gjykatën se fakti i prezumuar nuk ekziston, dhe së dyti, nëse mbi të pandehurin pranohet që mund të ngarkohet një barrë prove mbi kundërshtimin e faktit të prezumuar, cila është masa e duhur apo standardi i të provuarit që përmbush një barrë të tillë prove. Një pjesë e doktrinës së sistemit ligjor italian, duke u nisur nga një diferencim teorik i barrës së provës në barrë thelbësore[496] dhe barrë formale[497] konkludon *që të dyja këto koncepte*

[496] Kjo barrë thelbësore e provës ose 'materiale' nënkupton detyrimin për të bindur gjykatën për një fakt të caktuar.

konvergojnë në konceptin e barrës së provës, mbi bazën e së cilës si prokurori, ashtu edhe i pandehuri, duhet të provojnë faktet që mbështesin, përndryshe gjykata nuk mund t'i marrë në konsideratë; i njëjti mekanizëm vepron, nga ana tjetër, sa herë që prokurori arrin të bindë gjykatën për fajësinë e të pandehurit: në këtë pikë, mbrojtja do të gjendej e ngakruar me barrën për të vënë në dispozicion një provë të kundërt[498].
Kjo pjesë e doktrinës pranon se në rastin e prezumimeve ligjore relative ndodh një inversion i barrës së provës nga prokurori te i pandehuri, duke marrë një shembull të thjeshtë: [nëse prokurori për të vërtetuar përgjegjësinë penale duhet të provojë ekzistencën e fakteve A dhe B, ku fakti B prezumohet prej vërtetimit të faktit A, në këtë rast mbrojtja ngarkohet me barrën për të demonstruar mungesën e faktit B].[499]
Megjithatë, në mënyrë që një konceptim i tillë të mos bjerë ndesh me parimet themelore të procesit penal, si prezumimi i pafajësisë dhe standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, niveli apo standardi me të cilin mbrojtja apo i pandehuri duhet të kundërshtojnë elementët e akuzës apo të paraqesin elementë që përjashtojnë nga përgjegjësia penale, është ai i dyshimit të arsyeshëm.[500]
Në sistemin ligjor amerikan, studiuesit kanë arsyetuar se, [në kushtet që sipas parimit të vendosur në çështjen In Re Winship", "Klauzola e Procesit të rregullt ligjor mbron të akuzuarin nga dënimi, me përjashtim të provueshmërisë ***përtej dyshimit të arsyeshëm***, të çdo fakti që përbën krimin për të cilin ai akuzohet," është e qartë se testi i "lidhjes racionale" nënkupton se, nëse një prezumim ligjor në një çështje penale do të mbështetet në të ardhmen, *fakti themelor duhet të vërtetojë faktin e supozuar të prezumimit përtej dyshimit të arsyeshëm*. Duke pasur parasysh këtë, në rastin e prezumimit lejues, nuk zhvendoset as barra e prodhimit të provave dhe as barra e bindjes, dhe gjykata (ose juria) është e lirë të pranojë ose të refuzojë prezumimin][501].
[Në rastin e prezumimit të detyrueshëm, gjykata (ose juria) duhet të gjejë faktin e prezumuar bazuar në vërtetimin e faktit themelor, përveç rastit kur i pandehuri paraqet disa prova që rrëzojnë lidhjen e prezumuar midis dy fakteve. Një prezumim i tillë mund të zhvendosë vetëm barrën e prodhimit të provave ose këtë të fundit dhe barrën përfundimtare të bindjes njëkohësisht. Në çështjen Allen, Gjykata e Lartë duket se pranoi kushtetutshmërinë e prezumimeve që zhvendosin vetëm barrën e prodhimit të provave, me kusht që faktet themelore të jenë të mjaftueshme për të mbështetur faktin e prezumuar të fajit përtej dyshimit të arsyeshëm. Gjykata në çështjen Allen sugjeroi se një prezumim i detyrueshëm do të ishte kushtetues, nëse një anëtar racional jurie mund të përcaktonte faktin e prezumuar përtej dyshimit të arsyeshëm nga faktet themelore. Megjithatë, vendimi i Allen, së bashku me vendimin e mëvonshëm në *Sandstrom vs Montana*, sugjeron fuqimisht se një prezumim i detyrueshëm që zhvendos barrën e bindjes tek i pandehuri, cenon të drejtën e tij për një proces të rregullt ligjor. Megjithatë edhe në këtë rast, gjykata ka konstatuar se një dënim i bazuar në një udhëzim që në mënyrë jokushtetuese i cakton të pandehurit barrën e bindjes, mund të merret në konsideratë, nëse nga shqyrtimi në tërësi, konkludohet se gabimi kushtetues ishte i padëmshëm përtej çdo dyshimi të arsyeshëm][502].

---

[497] Kjo barrë formale e provës nënkupton detyrimin për të kërkuar apo për të paraqitur në gjykim prova të caktuara.
[498] Francesco Caporotundo, Presunzioni legali e onere della prova nel processo penale, https://www.giurisprudenzapenale.com/wp-content/uploads/2017/01/caporotundo_gp_2017_1.pdf, fq.9
[499] Po aty, fq. 14
[500] Po aty, fq. 23
[501] Leo H. Whinery, *Presumptions and Their Effect*, 54 OKLA. L. REV. 553 (2001), https://digitalcommons.Law.ou.edu/olr/vol54/iss3/5 , fq. 568
[502] Po aty, fq. 569

Zhvendosja e barrës së provës te i akuzuari (ajo e prodhimit të provave ose vënies në dispozicion të provave) është pranuar edhe nga studiues të tjerë, të cilët përcaktojnë se kjo barrë prove është e lehtë, e mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të arsyeshëm.[503,504]

Në mënyrë të përmbledhur, bazuar edhe në qendrimin e një pjese të madhe të doktrinës në fushën e prezumimeve, për t'u dhënë përgjigje dhe pyetjeve të parashtruara në krye të kësaj pjese, mund të theksojmë se në rastin e prezumimeve në favor të akuzës, barra e provës për të kundërshtuar faktin e prezumuar rëndon mbi të akuzuarin. Por, ajo çfarë e dallon pozitën e të akuzuarit nga ajo e prokurorit, është fakti se kjo barrë prove nuk nënkupton detyrimin ligjor të të pandehurit për të vënë në dispozicion prova që mbështesin qendrimin e tij, por më shumë një pozicion aktiv që merr i pandehuri dhe mbrojtja si rrjedhojë e logjikës dhe dinamikës së procesit për të argumentuar qendrimin ose tezën e tij. Se cila do të jetë masa apo natyra e provave që do duhet të parashtrojë i pandehuri përpara gjykatës, kushtëzohet nga fakti që standardi që duhet të përmbushë mbrojtja dhe i pandehuri për të bindur gjykatën se prezumimi në favor të prokurorit/akuzës nuk qendron, është ai i dyshimit të arsyeshëm. Pra, provat apo të dhënat që paraqiten nga i pandehuri/mbrojtja duhet të jenë në nivelin apo shkallën që të ngrenë një dyshim të arsyeshëm mbi vlefshmërinë e prezumimit. Megjithatë, në këtë pikë, ndoshta disi ndryshe nga pjesa më e madhe e doktrinës që mbështesin këtë qendrim, gjykoj se barra e të pandehurit mund të përmbushet edhe duke u mjaftuar me provat që mund të ketë paraqitur akuza, por me një interpretim dhe argumentim të kundërt me akuzën dhe që mbështet tezën e të pandehurit. Elementi i tretë i rëndësishëm, pas barrës së provës së të pandehurit dhe standardit të tij të provuarit, është fakti që sërish, pas përmbushjes së tyre, barra ligjore e provës (barra e bindjes) qendron sërish mbi prokurorin, i cili duhet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm elementët e veprës penale për të cilën është akuzuar i pandehuri, pasi objekti i të provuarit në procesin penal është fajësia e të pandehurit, e njëkohësisht ky i fundit nuk ka detyrimin të provojë pafajësinë e tij. Doktrina në fushën e prezumimeve sugjeron që, *prezumimi në mënyrë të pashmangshme do të shihet si rast përjashtimor, në lidhje me parimin e përgjithshëm të barrës së provës, i cili kërkon që paditësi (prokurori, në gjykimin penal) të humbasë çështjen, kur nuk arrin të provojë të gjitha elementet e rastit objekt gjykimi;* ***ai, në të vërtetë, do të ketë një barrë të plotë prove vetëm në lidhje me elementët konstitutiv të faktit (pozitivë), por ai nuk do të duhet të provojë në mënyrë specifike pathemeltësinë e elementëve negativë (ato që e mohojnë faktin): në rast të mungesës totale të provave në lidhje me këto të fundit, në fakt hipoteza akuzuese do të jetë fituese****. Por, në të njëjtën kohë nuk mund të ekzistojë as prezumimi i mungesës së elementeve negativë (në kuptimin e ngushtë, pengues dhe shuarës): për prezumimin në fakt, kërkohet që të krijojë bindjen përtej çdo dyshimi, ndërsa në lidhje me faktorët negativë dispozitat e procesit penal i atribuojnë të pandehurit benefitin e dyshimit/të pasigurisë.*[505]

---

[503] Shari L. Jacobson, Mandatory and Permissive Presumptions in Criminal Cases: The Morass Created by Allen, 42 U. Miami L. Rev. 1009 (1988) Available at: https://repository.Law.miami.edu/umlr/vol42/iss4/7, fq.1012

[504] Për më gjerë, shih Wodage, W.Y. (2014) Burdens of proof, presumptions and standards of proof in criminal cases, Mizan Law Review, vol. 8, no.1, pp. 252-270. Addis Ababa: St. Mary's University

[505] Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli", https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzionineldirittopenale.pdf, fq. 80

5.2 Prezumimet ligjore në legjislacionin penal dhe prezumimet e faktit

Prezumimet ligjore janë ato prezumime, të cilat janë të parashikuara nga ligji dhe për këtë shkak janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga gjykata dhe palët e tjera të procesit. Ato mund të kenë karakter relativ, në kuptim që prezumimi mund të rrëzohet nga prova të kundërta, ose karakter absolut, të cilat nuk mund të rrëzohen me prova të tjera. Këto të fundit, të cilat nuk pranojnë fakte të ndryshme apo situata të kundërta ligjore, ndaj ekzistencës së atij fakti që rezulton nëpërmjet prezumimit, janë ato të cilat paraqesin edhe problemet më të mprehta të natyrës kushtetuese dhe ligjore.
Më lart, paraqitëm qëndrimin e jurisprudencës së GJEDNJ dhe legjislacionit të BE-së, ku veçanërisht ky i fundit në mënyrë eksplicite ka pranuar ekzistencën e prezumimeve në procesin penal, me kushtin që ato të jenë të kundërshtueshme. Mundësia për të kundërshtuar prezumimin ligjor paraqet rëndësi në rastet e prezumimeve ligjore, të cilat janë në favor të akuzës. Në këtë rast, ne kemi shpjeguar edhe gjatë trajtimit të konceptit të prezumimeve se ato passjellin zhvendosjen e barrës së provës te i pandehuri, përmbushja e së cilës nga i pandehuri është jo vetëm një mundësi për të rrëzuar ekzistencën e prezumimit, por edhe në një kuptim, një detyrim që imponohet nga dinamika e procesit penal, ku i pandehuri dhe mbrojtja vendosen në pozita aktive për të kundërshtuar versionin e akuzës. Nga studimi i legjislacionit penal rezulton se raporti ndërmjet prezumimeve ligjore absolute dhe atyre relative është në favor të këtyre të fundit, megjithatë jurisprudenca unifikuese në mënyrë të diskutueshme ka kontribuuar në krijimin e prezumimeve me karakter absolut në favor të akuzës.

5.2.1 Parimet e procesit penal dhe prezumimet ligjore

Në doktrinën e huaj ka pasur qendrime që prezumimet ligjore, pikërisht për shkak të faktit se parashikohen nga ligji dhe në shumë raste nuk i përmbahen karakterit tipik të funksionimit të prezumimeve, sipas të cilave nga një apo disa fakte të provuara, vërtetohet ekzistenca e faktit apo fakteve të prezumuara, konsiderohen si rregulla apo parime ligjore[506]. Përfaqësuesit e këtij mendimi argumentojnë se të ashtuquajturat *prezumimi i pafajësisë, prezumimi i gjendjes së shëndetshme mendore, prezumimi i njohjes së ligjit, prezumimi i kompetencës së dëshmitarit, prezumimi i rregullsisë së procedimit*, nuk përbëjnë prezumime sipas kuptimit të tyre, pasi nuk ndikojnë në procesin e deduktimit të një fakti nga një tjetër[507].

Megjithatë, në gjykimin tim, nuk asnjë ndalim apo parashikim që prezumimet duhet të vijnë në një formë apo tjetër apo se kuptimi i tyre duhet të jetë patjetër i lidhur me kuptimin klasik të këtij koncepti. Më shumë se sa forma në të cilën shfaqet prezumimi, më rëndësi paraqet impakti konkret që ai ka në procesin penal. Nëse një situatë e caktuar ligjore, në mënyrë alternative, ose mbështet pozitën e njërës palë të procesit, ose i ngarkon palës tjetër detyrimin/barrën për të provuar të kundërtën, me

---

[506] Për më gjerë shih, Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli", https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzionineldirittopenale.pdf, fq.19, 21.
[507] James T. Ranney, Presumptions in Criminal Cases: A New Look at an Old Problem, 41 Mont. L. Rev. (1980). Available at: https://scholarworks.umt.edu/mlr/vol41/iss1/2, fq.6

siguri që kjo situatë ligjore ka trajtën e një prezumimi ligjor. Nga ana tjetër, është e vërtetë që një pjesë e prezumimeve ligjore, siç janë ato të përmendura më lart, për shkak të traditës së gjatë të përdorimit të tyre në procesin penal, kanë marrë trajtën e parimeve ligjore. Këto parime janë të tilla që vërtetësia dhe ekzistenca e tyre nuk kushtëzohet nga ekzistenca e fakteve paraprake që mbështesin parimin. Natyrisht, që funksioni i tyre nuk është cenimi i pozitës së ndonjërës prej palëve të procesit, por përparsia e zhvillimit normal të procesit penal si një kërkesë e interesit publik, në raport me të drejtat dhe garancitë që duhet të gëzojë personi i akuzuar në procesin penal. Kësisoj, nuk ka ndonjë kontradiktë logjike që një prezumim i caktuar të shfaqet në të njëjtën kohë edhe si parim i procesit penal, të cilat mund të jenë kryesisht në favor të prokurorit, si përfaqësuesi më tipik i mbrojtjes së interesit publik, të pandehurit si subjekti më i rrezikuar nga efektet e procesit penal dhe gjykatës, në cilësinë e dhënësit të drejtësisë.

Parimet e mësipërme janë të parashikuara edhe në legjislacionin tonë penal e procedural penal. Prezumimi i pafajësisë është parashikuar në nenin 4 të K.Pr.P dhe përbën ndoshta prezumimin më të rëndësishëm të procesit penal, në të njëjtën kohë, një ndër prezumimet e pakta që synojnë të mbrojnë pozitën e të akuzuarit. Siç është trajtuar në pjesë të tjera të këtij punimi, prej këtij parimi rrjedhin edhe rregullat që kanë të bëjnë me barrën e provës në procesin penal dhe standardin e të provuarit. Prezumimi ka karakter relativ, në kuptimin që ai mund të rrëzohet vetëm nëse akuza arrin të provojë fajësinë e të akuzuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Prezumimet e tjera, si ai i njohjes së ligjit, i përgjegjëshmërisë mendore, i rregullsisë së procedimit, i kompetencës së dëshmitarit, paanësia e gjykatës etj, më shumë se sa në favor të njërës apo tjetrës palë, janë të tilla që shërbejnë për të bërë funksional procesin penal sipas logjikës dhe vullnetit të ligjvënësit, megjithatë efekti i tyre shtrihet mbi palët në masën që imponojnë detyrimin për të kundërshtuar vërtetësinë e tyre, veçanërisht kur ky detyrim rëndon kryesisht mbi të akuzuarin.

5.2.1.1 Prezumimi i njohjes së ligjit

Prej këtyre prezumimeve, do të veçonim prezumimin e njohjes së ligjit. Lidhur me këtë prezumim, në nenin 4 të KP parashikohet se "*Mosnjohja e ligjit që dënon veprën penale, nuk përbën shkak për përjashtim nga përgjegjësia penale, veç rasteve kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme".* Ky prezumim ka karakter relativ nga mënyra e formulimit, pasi pranon si përjashtim faktin që kur mosnjohja është objektivisht e paevitueshme, personi përjashtohet nga përgjegjësia penale. Doktrina e së drejtës sonë penale me të drejtë ka shprehur që *ky përjashtim është shprehje e humanizmit të legjislacionit penal*[508]*,* pasi nëse i referohemi origjinës së këtij prezumimi nga e drejta romake "*ignorantia juris/legis non excusat", duket se parimi nuk ka pranuar përjashtime. I njëjti qendrim është mbajtur në sistemin ligjor Italian, ku Gjykata Kushtetuese ka konstatuar si jo kushtetuese dispozitën korresponduese në të drejtën penale italiane, në pjesën që nuk e përjashton mosnjohjen/injorancën e pashmangshme të ligjit nga përgjegjësia penale* [509] . Megjithatë, përjashtimi i mësipërm, në aspektin material duket më së shumti një arsyetim normal logjik, që do

---

[508] Prof.Dr.Ismet ELEZI, Prof.Dr.Skënder KAÇUPI, Prof.As.Dr.Maksim R HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, Geer, Tiranë 2006, fq.66

[509] Për më gjerë shih, Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr. 364, datë 24 Mars 1988

të rezultonte edhe nëse përjashtimi nuk do të ishte cituar shprehimisht nga dispozita. Diskutimi mbi këtë prezumim është fakti se nëse pritet që përjashtimi i prezumimit, t'i japë këtij të fundit në tërësi karakter relativ, përmbajtja e përjashtimit duket se konfirmon vështirësinë e cenimit apo rrëzimit të prezumimit, duke e bërë praktikisht një prezumim me karakter absolut. Kjo për shkak se, nga mënyra e formulimit, prezumimi rëndon mbi të akuzuarin dhe se i ngarkohet atij barra e provës për të evidentuar rrethanat objektivisht të paevitueshme që kanë çuar në mosnjohjen e ligjit. Terminologjia e përdorur nga ligji "objektivisht e paevitueshme" nuk është e ngjashme me asnjë prej standardeve të trajtuara deri më tani për shkallën apo nivelin me të cilin i pandehuri duhet të bindë gjykatën për versionin e tij. Praktikisht, i pandehuri nëse evokon pretendimin e mosnjohjes së ligjit, duhet që rrethanat të cilat e mbështesin pretendimin, të provohen katërcipërisht. Dijenia mbi ligjin përbën një ndër elementët e anës subjektive të çdo vepre penale, e shprehur në momentin intelektual të formave të fajësisë, dashje apo pakujdesi, e në këtë kuptim, rrjedhimisht, ky do të duhet të ishte detyrim i akuzës për t'u provuar, por fakti është se prezumimi në fjalë është një zgjidhje tradicionale e ligjvënësit për të shmangur mungesën e efektivitetit të ligjit penal ndaj pretendimeve për mosnjohje të ligjit. Lidhur me prezumimin e njohjes së ligjit, Gjykata e Lartë e SHBA, sa i përket çështjeve mbi mospagimin e taksave, në përpjekje për të evidentuar disa përjashtime nga ky prezumim, ka shprehur se*: Rregulli i përgjithshëm, se mosnjohja e ligjit ose një gabim mbi ligjin nuk përbën mbrojtje ndaj ndjekjes penale, është i rrënjosur thellë në sistemin ligjor amerikan. Bazuar në nocionin se ligji është i përcaktuar dhe i ditur, në sistemin common law është prezumuar që çdo person e njeh ligjin. Zgjerimi i statuteve dhe rregulloreve ndonjëherë e ka bërë të vështirë për qytetarin e zakonshëm që të dijë dhe kuptojë shtrirjen e detyrave dhe detyrimeve të vendosura nga ligjet tatimore. Ligjvënësi (kuptohet Kongresi) në përputhje me rrethanat ka zbutur ndikimin e këtij prezumimi, duke e bërë* ***qëllimin e posaçëm për shkeljen e ligjit****, një element të disa veprave penale tatimore federale. Kështu, Gjykata e ka konsideruar termin ligjor 'me dashje' si një përjashtim nga rregulli tradicional. Ky trajtim i veçantë i veprave penale tatimore është kryesisht për shkak të kompleksitetit të ligjeve tatimore. Në jurisprudencën e saj, Gjykata e Lartë e SHBA e ka interpretuar termin "dashje" si* ***shkelje e qëllimtë dhe e vullnetshme e një detyrimi ligjor të njohur***[510].

5.2.1.2 Prezumimi i rrezikshmërisë shoqërore

Përpos sa më lart, vetë mënyra e ndërtimit të Kodit Penal, si një ligj që synon në plan të parë, mbrojtjen e interesit publik, karakterizohet nga prezumime që synojnë të garantojnë pikërisht prevalencën e interesit publik ndaj atij privat apo individual. Një funksion i tillë është i lidhur ngushtësisht edhe me veprimtarinë dhe gjykimin e ligjvënësit në hartimin dhe miratimin e normave penale. Për të ilustruar këtë ide mund të përmendim ndarjen e veprave penale në kundërvajtje dhe krime ose ndarjen e veprave penale në vepra penale formale (*të cilat konsiderohen të tilla pa pasur nevojën për ardhjen e një pasoje kriminale*) ose materiale (*ato te të cilat, pasoja kriminale përbën element të veprës penale*). Psh., nëse vështrojmë Kodin Penal pjesa më e konsiderueshme e veprave penale janë krime, madje ligjvënësi me reformat e vazhdueshme legjislative, vitet e fundit ka ndryshuar ndarjen shkencore të disa veprave nga kundërvajtje penale, në krime, siç është rasti i veprës penale të

[510] Gjykata e Lartë e SHBA-ve, Cheek v. United States, 498 U.S. 192 (1991)

organizimit të lotarive të palejuara, parashikuar nga neni 197 i Kodit Penal[511]. Në pamje të parë duket se ndryshime të tilla janë çështje normale të politikës legjislative, megjithatë arsyeja dhe logjika pas ndryshimeve të tilla, qëndron në faktin se ligjvënësi e prezumon, për të mos thënë që e paragjykon, rrezikshmërinë shoqërore të tillë, në atë masë që një fakt i caktuar nga kundërvajtje penale duhet të kategorizohet si krim. Po në këtë temë, një tjetër çështje problematike konstatohet në vetë kriminalizimin e disa fakteve, të cilat mund të konsideroheshin si shkelje të natyrës administrative dhe të ndiqeshin si të tilla nga organet përkatëse administrative. Përpos veprës penale të cituar më lart, vepra të tjera penale si ***ndërtimi i paligjshëm, vjedhja e energjisë elektrike apo impulseve telefonike, moslëshimi i kuponit tatimor, drejtimi i mjeteve pa leje drejtimi*** etj., janë të tilla për të cilat ekzistojnë institucione apo organe që mund të ndjekin dhe kontrollojnë ligjshmërinë e tyre, si autoriteti i mbikëqyrjes së lojërave të fatit, organet tatimore, inspektoratet e ndërtimit, policia rrugore etj. Është e vërtetë që rritja e fenomeneve të caktuara shqetësuese për shoqërinë kërkon një përgjigje të shtuar shtetërore, por kjo nuk nënkupton, që këto fenomene duhet të kriminalizohen, për shkak se veprat penale, përpos karakteristikave dhe natyrës së tyre, karakterizohen edhe nga rrezikshmëria shoqërore. *Kjo e fundit është kategori objektive, në kuptimin që përcaktimi i saj bëhet në bazë të kushteve objektive të shoqërisë, se cilat janë veprat shoqërisht të rrezikshme. Ky vlerësim apo çmim që i bëhet rrezikshmërisë shoqërore ka karakter objektiv dhe jo subjektiv.*[512] Për të ilustruar këtë argument, sjellim në vëmëndje diskutimin që ka bërë gjyqtari dhe autori Florjan Kalaja me rastin e vendimmarrjes për inicimin e gjykimit incidental lidhur me kushtetutshmërinë e nenit 291 të Kodit Penal, në pjesën që kualifikon si krim dhe dënon penalisht sjelljen njerëzore të drejtimit të automjeteve pa lejen respektive, kur provohet se personi ka njohuri mbi rregullat e qarkullimit rrugor dhe është i aftë të drejtojë mjetin respektiv.[513] Në këtë vendim arsyetohet se: *Pikërisht caktimi apriori nga ligji penal i një dënimi dhe kualifikimi apriori i një sjellje njerëzore si krim, pa marrë parasysh eventualitetet e ndryshme dhe pa parashikuar përjashtime nga rregulli, bën që në rastin konkret gjykata të mos jetë në gjendje të japë drejtësi, të mos jetë në gjendje të individualizojë dënimin apo të detyrohet të bëjë një gjë të tillë edhe kur sjellja njerëzore objekt gjykimi nuk ka rrezikshmëri, edhe kur autori nuk ka rrezikshmëri dhe nuk ka asnjë pasojë të ardhur. Gjykata vlerësoi se në rastin konkret ligji e detyron të dënojë një person për një vepër penale që nuk mbron asnjë nga marrëdhëniet juridike, që ka marrë përsipër Kodi Penal të mbrojë (neni 1/b i Kodit Penal), dhe të japë një dënim në kundërshtim me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit si dhe të humanizmit (nenin*

---

[511] Neni 197 (i pandryshuar)
Organizimi i llotarive të palejuara
Organizimi i llotarive, lojrave të fatit apo bixhozit, në kundërshtim me dispozitat ligjore, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre muaj.

Neni 197 (i ndryshuar me ligjin nr. 44/2019, datë 18.7.2019)
Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin
Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet.

[512] Prof.Dr.Ismet ELEZI, Prof.Dr.Skënder KAÇUPI, Prof.As.Dr.Maksim R HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, Geer, Tiranë 2006, fq.46

[513] Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 330 Akti, datë 12.02.2015 "(Për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese)"

1/c të Kodit Penal)[514]. Më tej, gjykata vijon: (…)***kjo dispozitë e Kodit Penal problemin e madh e ka në konceptimin dhe rregullimin apriori të faktit penal, duke mosparashikuar sakaq mundësinë që i akuzuari të provojë të kundërtën dhe të konfirmojë pafajësinë, çështje e cila diktoi inicimin e këtij gjykimi kushtetues incidental. Kështu antikushtetutshmëria e nenit 291 të Kodit Penal e vlerësuar prej gjyqtarit a quo qëndron në pjesën që kriminalizon dhe dënon edhe sjelljen njerëzore të drejtimit të automjetit pa leje drejtimi ku drejtuesi është i aftë t'a drejtojë atë apo edhe të njohë rregullat e qarkullimit rrugor.***[515] Në vijim gjykata, sipas gjykimit tim, me të drejtë ka arsyetuar në mënyrë të hollësishme se kjo dispozitë në rastet e subjekteve që kanë aftësi për drejtimin e mjeteve, e që gjithsesi do të mbajnë përgjegjësi penale për mungesë të dëshmisë së aftësisë së drejtimit të mjeteve, është antikushtetuese duke cenuar një sërë normash të Kushtetutës (pasi vjen në kundërshtim me nenin 4, 17, 18, 29, 33, 42 dhe 135 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe 7 të K.E.D.Nj), veçanërisht të drejtën për t'u prezumuar i pafajshëm dhe për t'u dëgjuar. Përkundër vendimit të mësipërm të gjykatës, Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 63 datë 22.04.2015 vendosi moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me argumetin se: "*Pretendimet e parashtruara Gjykatës janë ngritur rreth një rasti hipotetik, i cili, sipas saj, nuk është marrë parasysh nga ligjvënësi, pra rasti kur provohet se personi ka njohuri mbi rregullat e qarkullimit rrugor dhe është i aftë të drejtojë mjetin*". Pavarësisht këtij qendrimi të Gjykatës Kushtetuese, në gjykimin tim, vepra penale në fjalë, mbart problematika të natyrës kushtetuese për shkak se prezumohet rrezikshmëria shoqërore e saj, në kuptimin që justifikohet zbatimi i juridiksionit penal, i cili duhet të jetë, siç shprehet edhe gjykata, *ultima ratio ose extrema ratio* dhe prezumohet fajësia në rast se subjekti nuk disponon leje drejtimi, edhe pse mund të ketë aftësinë për drejtimin e mjeteve, pra, objekti i provueshmërisë mbetet vetëm vërtetimi i faktit nëse subjekti ka ose jo leje drejtimi. Praktikisht, rrethanat shfajësuese që mund të evokojë një i akuzuar në një proces të tillë penal janë jo relevante, pasi mënyra se si është formuluar ligji nuk e lejon këtë të drejtë. Ky prezumim ka karakter absolut, pasi nuk i jep mundësinë të akuzuarit që të ngrejë pretendime që i përkasin provueshmërisë së akuzës ndaj tij. Pretendime mbi rrethanat shfajësuese mund të ngrihen si psh. mosnjohja objektive e ligjit ose nevoja ekstreme, por ato nuk janë relevante lidhur me aspektin e provueshmërisë së veprës penale.

5.2.1.3 Prezumimi i rrezikut. Veprat penale që rrezikojnë

Në vijim të trajtimit të mësipërm, në doktrinën e huaj flitet për prezumimin e rrezikut për një kategori veprash penale, në cilat parashikohet rrezikimi i marrëdhënieve juridike të mbrojtura nga ligji penal. Një ndarje e tillë e veprave penale njihet e pranohet edhe nga doktrina jonë e së drejtës penale, e cila bën dallimin ndërmjet veprave penale që dëmtojnë dhe veprave penale që rrezikojnë.[516] Doktrina bën kategorizimin e krimeve/veprave penale që rrezikojnë në krime të *rrezikut konkret* dhe *krime të rrezikut të prezumuar ose abstrakt*[517] (në doktrinë ka edhe qendrime që

---

[514] Po aty, fq.4 e vendimit
[515] Po aty, fq. 6 e vendimit
[516] Prof.Dr.Ismet ELEZI, Prof.Dr.Skënder KAÇUPI, Prof.As.Dr.Maksim R HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, Geer, Tiranë 2006, fq.55
[517] Julia Sarno, Reati di pericolo presunto: la linea sottile tra legittimità e illegittimità costituzionale, 8 Shkurt 2021,

dallojnë krimet e rrezikut të prezumuar nga ai abstrakt, duke i njohur si dy kategori të ndryshme[518]). Sipas kësaj doktrine, koncepti i rrezikut të prezumuar nuk përbën element të çështjes/veprës penale, por konsiderohet si element që përfaqëson një kërkesë politike, përmes së cilës ligjvënësi inkriminon sjellje të caktuara si zakonisht të rrezikshme, pa qenë nevoja, që për qëllime të dënimit të subjektit, prokurori të provojë dhe gjykata të pranojë se interesi i mbrojtur është vënë efektivisht dhe konkretisht në rrezik[519]. Doktrina e së drejtës sonë penale pranon që në të tilla raste bëhet fjalë për rrezik real dhe jo imagjinar, duke argumentuar se vepra penale quhet e kryer nëse ka krijuar rrezik real për objektin e mbrojtur nga legjislacioni penal[520]. Megjithatë, është evidente që shumë vepra penale të parashikuara në Kodin Penal, të cilat kategorizohen në vepra penale që rrezikojnë, nuk kërkojnë përcaktimin e rrezikut si real, por duket se ai prezumohet se ekziston[521]. Madje, në doktrinën e huaj duket se është e gjithëpranuar ideja e ekzistencës së veprave penale të rrezikut të prezumuar; diskutimet i referohen kryesisht mënyrës se si justifikohet prania e tyre në legjislacionin penal, duke i ndarë studiuesit në pro dhe kundër.[522] Qendrimet e kritikëve të këtyre veprave penale përmblidhen në argumentin që në të tilla vepra penale nuk ndështkohet fakti, por subjekti për shkak të një mosbindjeje të thjeshtë, si edhe që këto vepra penale cenojnë *parimin e ofensivitetit*[523].[524] Qendrimet në favor të ekzistencës së këtyre veprave penale përmblidhen në argumentat e nevojave të politikës penale, të parandalimit të përgjithshëm, efekt i të cilit rrjedh nga ndështkimi i këtyre veprave dhe të faktit që është vetë ligjvënësi që vlerëson se një sjellje e caktuar është e dëmshme e duhet të ndështkohet.[525] Autori Francesco Caporotundo është shprehur se *në krimet e rrezikut të prezumuar, ligjvënësi kodifikon norma në bazë të eksperiencës, duke inkriminuar sjelle që në mënyrë të arsyeshme konsiderohen se vënë në rrezik një interes juridik, megjithatë mund të rezultojnë raste kur sjellja/veprimi mund të jetë konform parashikimit të dispozitës penale, por nuk vë në mënyrë konkrete në rrezik ndonjë interes juridik. Me fjalë të tjera, mund të konstatohet hendeku ndërmjet përputhjes në dukje të normës inkriminuese dhe veprimit/sjelljes konkrete, kërkesë e nevojshme që shërben për argumentimin e faktit tipik.*[526] Veprat penale të rrezikut, më specifikisht ato të rrezikut abstrakt/të prezumuar, nga mënyra e formulimit të tyre, por edhe përmbajtjes së tyre, përbëjnë

---

http://www.salvisjuribus.it/reati-di-pericolo-presunto-la-linea-sottile-tra-legittimita-e-illegittimita-costituzionale/

[518] Francesco Caporotundo, Musica nei locali notturni e disturbo della "quiete pubblica": quando si configura il reato, Archivio Penale 2017, nr. 2, https://archiviopenale.it/File/DownloadArticolo?codice=e0d88931-b21a-4b66-bd21-00a77d1a8f06&idarticolo=15198

[519] Po aty, fq.7

[520] Prof.Dr.Ismet ELEZI, Prof.Dr.Skënder KAÇUPI, Prof.As.Dr.Maksim R HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, Geer, Tiranë 2006, fq.55

[521] Disa prej këtyre veprave penale mund të jenë ato të parashikuara në nenet 154/a, 201, 201/a, 201/c, 284/d, 288, 288/a etj.

[522] Paolo Franceschetti, Reato, 13.01.2017, https://www.altalex.com/documents/altalexpedia/2017/01/12/reato#Toc471986579

[523] Në bazë të parimit të ofensivitetit vepra duhet të karakterizohet nga cenimi i një të mire juridike; në fakt, një krim nuk mund të konceptohet pa cenimin: *nullum crimen sine iniuria,* https://dizionari.simone.it/1/offensivita

[524] Po aty

[525] Po aty

[526] Francesco Caporotundo, Presunzioni legali e onere della prova nel processo penale, https://www.giurisprudenzapenale.com/wp-content/uploads/2017/01/caporotundo_gp_2017_1.pdf, fq.22

prezumime absolute, për shkak se për provueshmërinë e tyre është i mjaftueshëm fakti i veprimit/sjelljes në kundërshtim me dispozitën përkatëse penale, ndërsa rrezikimi i marrëdhënieve të parashikuara nga dispozita, prezumohet se ekziston pikërisht me konstatimin e veprimit të paligjshëm. Në mënyrë që dispozita të tilla të përmbushin e testin e kushtetutshmërisë, autori i mësipërm sugjeron që prezumimet e rrezikut duhet të konsiderohen si prezumime relative, duke i lënë hapësirë mundësisë së paraqitjes së provave të kundërta[527]. Në këtë rast, konstatohet një zhvendosje e barrës së provës nga akuza te i pandehuri, pasi këtij të fundit i ngarkohet barra për të argumentuar se mungon rreziku konkret ndaj marrëdhënies juridike që mbrohet nga dispozita penale, pasi përkundër kësaj, akuza mjaftohet me provueshmërinë e faktit apo sjelljes së parashikuar nga dispozita si e kundërligjshme.[528]

5.2.1.4 Prezumimi i moshës së mitur

Përpos diskutimit të mësipërm, i cili vë në dukje në mënyrë të përgjithshme prezumimet ligjore që i referohen formës së konceptimit të legjislacionit penal, në këtë fundit gjenden prezumime konkrete ligjore. Në nenin 41 të KPrP është parashikuar çështja e verifikimit të moshës së të pandehurit. Në paragrafin e dytë të kësaj dispozite është parashikuar se *kur, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit, mbeten dyshime për moshën e të pandehurit, prezumohet se ai është i mitur.* Parashikime të ngjashme gjenden edhe në KDPM, në nenin 46 të tij, në të cilin parashikohet se: *3. Nëse, edhe pas verifikimeve dhe ekspertimit mbeten dyshime për moshën, prezumohet se personi është i mitur.* ***4.*** *Nëse mosha e të miturit është e përcaktuar me përafërsi,* ***për marrjen e vendimit mbi përgjegjësinë penale,*** *do të konsiderohet mosha më e ulët.* Prezumimi i moshës së mitur të të pandehurit është një prezumim që është në favor të tij, pasi statusi i të miturit është i lidhur me një sërë përfitimesh të parashikuara nga legjislacioni penal, ku më i rëndësishëm është përfitimi lidhur me masën e dënimit. Ky prezumim, i cili në gjykimin tim nuk ka karakter absolut, i ngarkon organit të akuzës barrën për të vërtetuar/provuar që i pandehuri nuk është i mitur. Duke qenë se në këtë rast mosha e të pandehurit të mitur ka lidhje me cilësitë e subjektit të veprës penale dhe përgjegjshmërisë së tij, e rrjedhimisht përbën një nga elementët e figurës së veprës penale që duhet të provohen nga prokurori, ky i fundit mund ta rrëzojë prezumimin vetëm nëse provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm që i pandehuri nuk është i mitur. Megjithatë, diskutimi më i rëndësishëm do të ishte se si do të procedohet në rast se mosha e viktimës së mitur nuk është e mundur të përcaktohet. KPrP, por edhe KDPM duket se trajtojnë jo vetëm prezumimin e moshës së mitur për të pandehurit, por edhe të të miturit viktimë. Ky diskutim merr rëndësi në rastet e veprave penale, ku viktima e veprës penale është i mitur, si rasti i veprave penale me ***natyrë seksuale, ato kundër lirisë së personit, kundër moralit dhe dinjitetit, si edhe ato kundër fëmijëve dhe martesës***. Në nenin 7/3 të KDPM, dispozitë e cila kategorizohet në dispozitat e përgjithshme të parashikuara nga ky kod, parashikohet se "*Në rastin kur mosha e personit është e pamundur të përcaktohet saktë, por ka arsye të besohet se është i mitur, ai konsiderohet i tillë, në kuptim të këtij Kodi, derisa të përcaktohet mosha e tij*". Ndërsa, KPrP është më eksplicit kur në nenin 58/a/3 parashikon se: "*3. Nëse ekziston*

---

[527] Po aty.
[528] Po aty.

mundësia që viktima është e mitur dhe mosha e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur."

Duke qenë se ky prezumim do të zbatohet edhe për të miturin viktimë, përbën një prezumim që bie ndesh interesave të të pandehurit, për shkak se çdo vepër penale do të prezumohet se kryhet ndaj të miturit, nëse mosha e tij nuk do të mund të përcaktohej saktësisht, çka do të passillte që veprat penale të kualifikoheshin në rrethana cilësuese, duke qenë se një numër i konsiderueshëm veprash penale, e përmbajnë si rrethanë cilësuese rastin kur vepra penale kryhet ndaj të miturit. Prezumimi do të vepronte në favor të akuzës, pasi në rast të pamundësisë së përcaktimit të saktë të moshës së viktimës, ai do të prezumohej i mitur dhe ligji nuk i ngarkon detyrimin prokurorit që të provojë këtë fakt në mënyrë të pakufizuar. Nga ana tjetër, barra e provës për të kundërtën, pra, që viktima nuk është e mitur, do të zhvendosej te i pandehuri, i cili do të duhej që të argumentonte rrëzimin e prezumimit. Megjithatë, ndryshe nga prezumimet në favor të të pandehurit, ato kundër tij, duhet të rrëzohen prej të pandehurit duke bindur gjykatën në nivelin që të krijojë një dyshim të arsyeshëm mbi (mos) ekzistencën e prezumimit. Prezumimi i mësipërm nga mënyra e formulimit të tij, përbën një prezumim relativ, pasi pranon ekzistencën e provave/argumenteve të kundërta, fakt i cili rezulton edhe nga fakti që prezumimi qendron *derisa të përcaktohet mosha e personit*.

5.2.1.5 Prezumimet ligjore të veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale

Një ndër veprat penale të parashikuara në kodin tonë penal, ku mishërohen pothuaj të gjitha problematikat që lidhen me prezumimet ligjore në përgjithësi, prezumimin e pafajësisë në veçanti, barrën dhe standardin e të provuarit, është vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale (neni 287 i KP). Lufta ndaj fenomenit të pastrimit të parave parashikohet në shumë akte ndërkombëtare, marrëveshje e konventa, të cilat njohin karakterin ndërkombëtar të këtij fenomeni shqetësues. Këto akte e konventa sugjerojnë që shtetet, përmes reformash legjislative e administrative, të ndërmarrin hapa konkrete për luftimin e fenomenit. Në rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare përgjithësisht jepen orientime për një zbatim jo tradicional ose jo tipik të legjislacionit penal sa i përket barrës së provës dhe standardit të të provuarit të veprës penale të pastrimit të parave.[529] Kjo tendencë është ndërkombëtare dhe përfshin jo vetëm institucionet ligjzbatuese, por edhe ato të drejtësisë si prokuroria dhe gjykata. Arsyeja e një konsensusi të tillë qendron në faktin se pastrimi i parave dëmton themelet demokratike mbi të cilat janë ngritur dhe funksionojnë shtetet dhe shoqëria njerëzore, e një cenim i tillë konsiderohet më i rëndësishëm se rreziku që mund t'i kanoset një individi nga cenimi i të drejtave të tij në kuadrin e një procesi penal. Një qasje e tillë vërehet edhe në praktikën e viteve të fundit të GJEDNJ. Në çështjen *Zschüschen kundër Belgjikës*[530], lidhur me rastin e dënimit të një personi nga gjykatat

---

[529] Për më gjerë shih, FATF (2018), FATF President's paper: Anti-money laundering and counter terrorist financing for judges and prosecutors, FATF, Paris, France, 2018, www.fatfgafi.org/publications/methodandtrends/documents/AML-CFT-judges-prosecutors.html

[530] Gjednj, çështja Zschüschen v. Belgium (application no. 23572/07), vendimi datë 02.05.2017, e cila bënte fjalë për dënimin e kërkuesit për veprën penale të pastrimit të parave, për shkak se kishte hapur

belge për veprën penale të pastrimit të parave, GJEDNJ shprehu se *gjykatat vendase në mënyrë bindëse kishin marrë në konsideratë një grup provash rrethanore të mjaftueshme për ta shpallur fajtor kërkuesin.* ***Refuzimi i tij për të dhënë shpjegimet e nevojshme për origjinën e parave, thjesht i kishte konfirmuar këto prova****. Në këtë kontekst, Gjykata përsëriti se nuk ishte e papajtueshme me nocionin e një gjykimi të drejtë penal që kërkuesit të ishin të detyruar të jepnin shpjegime të besueshme për pasuritë e tyre. Nëse rrëfimi i këkuesit për transaksionet e tij financiare do t'i korrespondonte të vërtetës, nuk do të kishte qenë e vështirë për të, të provonte origjinën e parave. Gjykata arsyetoi më tej se përfundimet e arritura nga gjykatat mbi refuzimin e kërkuesit për të dhënë shpjegime mbi origjinën e pasurive bazoheshin në gjykime të shëndosha dhe nuk mund të konsideroheshin si të padrejta apo të paarsyeshme. Në përfundim,* ***Gjykata u shpreh se qasja e gjykatave vendase, të cilat – në përputhje me praktikën gjyqësore të vendosur nga Gjykata e Kasacionit – nuk e gjykuan të nevojshme të përcaktonin veprën kryesore/bazë për të dënuar aplikantin për pastrim parash, nuk kishte pasjellë zhvendosjen e barrës së provës nga prokuroria tek mbrojtja, në kundërshtim me parimin e prezumimit të pafajësisë***.[531]

Ligji ynë penal, në nenin 287 të KP, lidhur me çështjen e nevojës ose jo të përcaktimit të veprës penale kryesore/bazë, sipas gjykimit tim, duket se ndjek përgjithësisht këtë qasje, të ofruar edhe nga praktika e mësipërme e GJEDNJ, veçanërisht nëse interpretohet në mënyrë sistematike pg.1 dhe pg. i fundit i kësaj dispozite. Në paragrafin e parë përmbahen format me të cilat kryhet vepra penale e pastrimit të parave, konkretisht këmbimit ose transferimit të pasurisë, fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve etj. Në paragrafin e fundit është përcaktuar se dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive. Kjo fjali, e cila praktikisht i referohet elementit subjektiv të individit (për shkak se mungesa e dijenisë pasjell mungesën e anës subjektive të veprës penale), ndryshon tërësisht mënyrën e konceptimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit të kësaj vepre penale. Kjo fjali përbën prezumim ligjor, pasi ndryshe nga çdo vepër tjetër penale, ku ana subjektive e veprës penale duhet të provohet nga organi i akuzës përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, si element konstitutiv i figurës së veprës penale, në këtë rast elementi subjektiv deduktohet nga rrethana fakti objektive. Qëllimi dhe dijenia për të cilat bën fjalë pg.i fundit i dispozitës, në interpretim me pg. e parë të saj, janë *qëllimi i fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurisë dhe dijenia se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale*. E perifrazuar, do të kuptohej që *qëllimi i fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurisë dhe dijenia se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale* nxirren nga rrethana fakti objektive. Ligji nuk përcakton se në çfarë mase apo niveli sasior apo cilësor duhet të jenë rrethanat e faktit

---

një llogari bankare në një bankë belge dhe brenda 2 muajve kishte depozituar një shumë prej 75 000 Eurosh. Ky shtetas njihej si i përfshirë në aktivitetin e drogërave në Hollandë dhe nuk kishte të ardhur në atë vend. Në shpjegimet e tij ai kishte deklaruar se paratë rridhnin nga puna në të zezë për një periudhë prej 4 vitesh, por nuk dha shpjegime të mëtejshme lidhur me punëdhënësit e tij, duke shprehur se përmendja e tyre do t'i dëmtonte ata. Përgjatë, procesit ai përfitoi nga e drejta për të heshtur dhe për të mos inkriminuar vetveten.

[531] Po aty.

objektive, në mënyrë që prej tyre të deduktohet qëllimi dhe dijenia, duke e lënë përcaktimin e *quantum probatorio* në vlerësimin e gjykatës. Nëse i rikthehemi pg.të parë rrethana fakti objektive janë këmbimi, transferimi, posedimi, përdorimi etj., e nëse njëra prej këtyre transaksioneve konstatohet mbi një pasuri që policia apo prokuroria mund t'i konsiderojë të pajustifikuara (për shkak të të ardhurave të pakta, për shkak të të ardhurave mesatare në vend etj), prezumimi i mësipërm, do të shmangte nevojën për të vërtetuar që pasuria rrjedh nga një vepër penale, për shkak se ligjvënësi e parashikon dhe e lidh konceptin e veprës penale (bëhet fjalë për veprën penale bazë), te elementi i qëllimit dhe dijenisë, ndërsa te veprimet objektive, ato në dukje janë transaksione normale, nëse nuk ndiqen nga pjesa tjetër e fjalisë. Pra, praktikisht organi i akuzës ka detyrimin të provojë elementët që konstituojnë veprën penale konkrete; në këtë rast organi i akuzës provon se ka ndodhur një posedim/këmbim/përdorim pasurie, të cilën e konsideron të pajustifikuar për arsye të ndryshme, ndërsa aspekti subjektiv i çështjes përftohet prej prezumimit ligjor se *qëllimi i fshehjes ose mbulimit të origjinës së paligjshme të pasurisë dhe dijenia se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale* nxirren nga kjo rrethanë fakti objektive-përdorimi i një pasurie të pajustifikuar.
Në vendimin e mësipërm, GJENDJ shprehu se, qasja e jurisprudencës së gjykatave belge, sipas të cilave, *që një i dyshuar të mbajë përgjegjësi penale për pastrim e parave, është e mjaftueshme të përcaktohet origjina e paligjshme dhe dijenia e personit, pa qenë nevoja e përcaktimit të veprës penale specifike dhe mbi bazën e fakteve, gjyqtari mund të përjashtojë çdo burim ose origjinë të ligjshme të pasurisë*, nuk ka asgjë të gabuar, për më tepër, është në përputhje me nenet 9/3 dhe 6 të Konventës së Këshillit të Evropës mbi pastrimin e parave. Kjo qasje nuk përbën në vetvete shkelje të të drejtave të garantuara nga neni 6/1/2 i KEDNJ. Nga ana tjetër, Gykata e vlerëson këtë qasje të gjykatave vendase, nëse në përputhje me rrethanat e çështjes, ajo ka cenuar të drejtën e personit për të heshtur, për të mos u vetinkriminuar dhe prezumimin e tij të pafajësisë[532].

Siç rezulton nga interpretimi i dispozitës së kodit tonë penal në këndvështrimin e jurisprudencës së GJEDNJ, mund të thuhet se përcaktimi i veprës penale bazë/kryesore, nuk përbën kusht të domosdoshëm për konstituimin e veprës penale të pastrimit të parave. Megjithatë, praktika gjyqësore e gjykatave të vendit tonë ka ndjekur tërësisht një qasje të ndryshme nga ajo çfarë parashikon dispozita dhe praktika e GJEDNJ. Për ilustrim paraqesim arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë Tiranë, e cila ka shprehur se "*Midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) nga njëra anë dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë), duhet të ekzistojë gjithmonë lidhje shkakësore ekskluzive dhe e domosdoshme (condicio sine qua non). Pra, nëse nuk kemi të konsumuar nga ana objektive një vepër penale mëmë nuk mund të filet për pastrim të produktit të saj, pasi produkti sipas nenit 287 të Kodit Penal, duhet të rrjedhë si rezultat i një fakti i cili parashikohet nga ligji si vepër penale. Prandaj, në çdo rast duhet që midis veprimeve të autorit të veprës penale që synojnë pastrimin e produktit të veprës penale dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së pasojës, pastrimi i produktit të veprës penale, duhet të ekzistojë lidhje shkakësore. Në rastin konkret nuk ekziston ndonjë fakt penal që të gjenerojë të ardhura të paligjshme që të kemi më pas pastrim të tyre. Duke u rikthyer në rastin konkret nuk provohet tej çdo dyshimi të*

[532] Gjednj, çështja Zschüschen v. Belgium (application no. 23572/07), vendimi datë 02.05.2017, pg.12 dhe 27.

arsyeshëm se fakti penal i cili i atribuohet të pandehurve ekziston. Gjithashtu, në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë të dhënë konkrete që të pandehurit të kenë kryer ndonjë vepër penale konkrete që të gjenerojë të ardhura, të cilat më pas të pastrohen"[533].

Ky qendrim i praktikës së gjykatave buron edhe prej qendrimeve të konsoliduara të Gjykatës së Lartë. Në një vendimmarrje të ngjashme, Gjykata e Lartë është shprehur se: (…) *Teoria e së drejtës penale ka pranuar se për të pasur ekzistencën e elementeve të veprës së "Pastrimit të produkteve të veprës penale", duhet medoemos që pasuria e krijuar apo vlera monetare që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie, të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhura nga aktiviteti kriminal i kryer. Edhe në këtë drejtim, nuk është hetuar dhe arritur të provohet nga prokuroria se vlera monetare e përdorur nga i gjykuari për të blerë dy sipërfaqet e tokave të përmendura në këtë vendim,* ***të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhur nga ndonjë aktivitet kriminal që ai të ketë kryer****, mbështetur edhe në këtë konkluzion, Kolegji Penal e gjen të papranueshme këtë akuzë ndaj të gjykuarit"*[534]

Nga ana tjetër, një pjesë e doktrinës ka qendrime të përafërta me qendrimin e GJEDNJ. Autori Elvis Zaimi ka shprehur se: "*pastrimi i produkteve të veprës penale/pastrimi i parave", ka ekzistencë të pavarur juridike, dhe përgjegjësia penale, por edhe masat parandaluese dhe sekuestrimet pasurore të caktuara, nuk kushtëzohen me nevojën e të provuarit se produktet e pastrimit të veprës penale janë të lidhura me faktet juridike të nisjes së një procedimi penal apo dhënies së një vendimi fajësie të formës së prerë, në lidhje me një vepër tjetër penale nga e cila e kanë prejardhjen/burimin paratë që pastrohen,* ***por mjafton "dyshimi i arsyeshëm" se produktet/paratë që pastrohen e kanë prejardhjen nga një veprimtari kriminale***.[535] Një pjesë tjetër e doktrinës, ka avancuar më tej në këtë arsyetim, duke pranuar nga njëra anë karakterin autonom të kësaj vepre penale, dhe nga ana tjetër provueshmërinë e lidhjes së saj me veprën kryesore nga të dhëna indiciare. Sipas kësaj pjese të doktrinës, theksohet se *pavarësisht se figura e vepres penale të "Pastrimi i produkteve të vepres penale" ka natyrë integrale në relacion me vepren kryesore, ajo është një veper penale autonome, subjekt i së cilës mund të jetë cdo person. Kjo autonomi theksohet për efekt të aplikimit të përgjegjesisë penale për kryerjen e faktit tipik të pastrimit, por kjo nuk do të thotë se lidhja integrale me vepren kryesore nuk është e rëndësishme, sepse një lidhje tillë justifikon ekzistencën e kësaj të fundit. Në rastet, në të cilat kjo lidhje nuk është e drejtëpërdrejtë, në kuadër të provueshmerisë,* ***determinante është provueshmeria e lidhjes indirekte.***[536] Për të ilustruar këtë qendrim, doktrina gjen mbështetje edhe në argumentet e praktikës gjyqësore të vendeve të tjera. Konkretisht, Gjykata e Lartë e Spanjës në vendimin e datës 12.12.2011 thekson se: *".... për gjykimin e veprës penale të pastrimit, në kushtet e mungesës së një lidhjeje te drejtëpërdrejtë me veprën penale kryesore, kërkohet ekzistenca e indicieve të zakonshme, siç mund të jenë :*

1. *Shuma e parave që është pastruar*

---

[533] Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 5410/211 Akti, datë 24.01.2020

[534] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 327, datë 05.12.2012

[535] Elvis Zaimi, Disa aspekte juridike dhe kriminologjike që lindin nga domosdoshmëria e funksionalizimit të legjislacionit kundër pastrimit të parave, fq.13
https://www.academia.edu/36733161/Pastrimi_i_parave_Artikulli_Luarasi_1

[536] M.Andrea, Y.Pjetërnikaj, Disa aspekte teoriko-praktike të figurës së vepres penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale", **Jeta Juridike Nr.1 Viti 2016, Shkolla e Magjistraturës, fq. 8 e punimit.**

2. *Lidhja e autorëve me aktivitete kriminale të jahtëligjshme*
3. *Rritje e pazakonshme e pasurisë së subjektit*
4. *Natyra dhe karakteristikat e operacioneve ekonomike*
5. *Mungesa e një justifikimi të ligjshëm të hyrjeve që lejojnë realizimin e këtyre operacioneve*
6. *Dobësia e shpjegimeve mbi origjinën e paligjshme*
7. *Ekzistenca e shoqërive "guackë"....."*.[537]

Në analizë të trajtimit të mësipërm, në mënyrë të përmbledhur veçojmë disa karakteristika të kësaj vepre penale, që i referohen standardit të të provuarit, barrës së provës dhe prezumimeve ligjore. Nga ajo që rezulton nga praktika e GJEDNJ dhe një pjesë e doktrinës së të drejtës penale, mund të thuhet se standardi i të provuarit të natyrës së paligjshme të pasurisë/burimit (pra, ajo që nënkupton veprën bazë/kryesore/mëmë) është ai i dyshimit të arsyeshëm të bazuar në rrethanat objektive të çështjes. Natyrisht, barra e provës për të përmbushur këtë standard i takon organit të akuzës, por niveli i ulët i këtij standardi nënkupton një zhvendosje të barrës së provës te i akuzuari, i cili detyrohet që të argumentojë se burimi i pasurisë është i ligjshëm. Ky arsyetim vlerësoj se është në përputhje edhe me konceptimin e veprës penale të pastrimit të parave sipas nenit 287 të KP. Për të ilustruar këtë mendim, sjellim në vëmëndje se neni 287, parashikon në paragrafin e tretë, germa 'ç', se vepra penale e pastrimit të parave do të gjejë zbatim edhe në rastin kur për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, *nuk është filluar asnjëherë çështja penale.* Nëse nuk është filluar asnjëherë çështja penale, kjo nënkupton rrejdhimisht që faktet e pretenduara të asaj çështje nuk janë shqyrtuar asnjëherë, që më tej akoma nënkupton se nuk ka vend zbatimi i standardit më të lartë të procesit penal, atij të tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Me siguri, ky arsyetim, pavarësisht se në gjykimin tim, është në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ dhe me nenin 287 të KP, nuk gjen mbështetje në praktikën gjyqësore aktuale të vendit tonë, pasi edhe në vendimmarrjet e fundit, Gjykata e Lartë vijon t'i mëshojë rëndësisë së veprës bazë. Konkretisht, në një vendim Gjykata shprehet se (…) *vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal për të cilën është akuzuar i gjykuari, është hetuar dhe sjellë për gjykim nga Prokuroria për shkak të lidhjeve të saj me* ***veprën e parë penale****. Meqenëse të dy veprat penale siç paraqiten në akuzën dhe kërkesën për gjykim nga ana e prokurorit, kanë lidhje me njëra-tjetrën, mosarsyetimi i vendimit të gjykatës në drejtim të ndryshimit të cilësimit juridik të veprës së parë penale,* ***ka sjellë ndikimin e saj edhe në përfundimet e arritura për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal***.[538]

Së dyti, në përcaktimin e kësaj vepre penale, siç e trajtuam edhe më lart vepron prezumimi ligjor i ekzistencës së anës subjektive të autorit (dijenia dhe qëllimi). Diskutimi mbi këtë prezumim ka të bëjë me çështjen nëse ai ka karakter absolut apo relativ, pra, nëse është i rrëzueshëm në procesin penal dhe cili është standardi që e kundërshton apo rrëzon këtë prezumim. Sipas gjykimit tim, duke u nisur nga parimi i përgjithshëm, se prezumimet në procesin penal duhet të jenë të kundërshtueshme, por edhe nga fakti që ky prezumim kategorizohet në ato lloj prezumime që mbështeten nga një bazë faktike rrethanash, fakti që këto të fundit mund të jenë të

---

[537] Cit. nga M.Andrea, Y.Pjetërnikaj, Disa aspekte teoriko-praktike të figurës së vepres penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale", **Jeta Juridike Nr.1 Viti 2016, Shkolla e Magjistraturës, fq. 8 e punimit.**

[538] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 17, datë 15.07.2021

interpretueshme nga secila prej palëve të procesit, kjo shpie në përfundimin se prezumimi i mësipërm është relativ, rrjedhimisht i kundërshtueshëm. Natyrisht që barra për të argumentuar rrëzimin e prezumimit i ngarkohet të akuzuarit, pasi prezumimi funksionon në favor të akuzës. Le të marrim një shembull për të argumentuar mundësinë e rrëzimit të prezumimit. Nëse një person X, i cili dyshohet për aktivitete të ndryshme kriminale, i dërgon një sasi monetare personit të afërm Y, i cili e përdor dhe posedon këtë pasuri, në përputhje me nenin 287 të KP rezulton e provuar ana objektive e posedimit dhe përdorimit të pasurisë, si dhe prezumohet dijenia e personit Y se pasuria është produkt i veprës penale. Personi Y për të rrëzuar prezumimin e dijenisë, duhet të argumentojë se nuk ka dijeni për origjinën e paligjshme të pasurisë, *qoftë duke përdorur rrethanat konkrete objektive* psh. faktin që nuk ka udhëtuar në vendin ku jeton i afërmi X, që ka shumë vite që nuk ka udhëtuar jashtë shtetit, që shuma monetare ka kaluar nëpërmjet sistemit bankar apo të transfertave etj., *ose duke paraqitur të dhëna provuese* si psh. një kontratë përfitimi e X në vendin ku jeton që i referohet shumës së parave që i korrespondonjë dërgesës, kontratat e tij të punës përgjatë disa viteve, llogaritë e tij bankare përgjatë disa viteve etj. Standardi që përgjithësisht i kërkohet të akuzuarit për të rrëzuar prezumimin ligjor është dyshimi i arsyeshëm, pra që argumentet e paraqitura, të krijojnë dyshime të arsyeshme lidhur me mungesën e dijenisë së të akuzuarit për origjinën e paligjshme të burimit të pasurisë. Në këtë rast, pavarësisht se prezumimi vepron në favor të akuzës, rrëzimi i tij ose vënia e tij në dyshim nga i akuzuari, shkakton sërish zhvendosjen e barrës së provës te prokurori, të cilit tashmë i duhet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i akuzuari ishte në dijeni të origjinës së paligjshme të burimit të pasurisë. Efekti i prezumimit ligjor relativ shtrihet deri në momentin që i akuzuari argumenton dyshimin e arsyeshëm lidhur me mosdijeninë e tij, pas kësaj faze, prezumimi ligjor duhet të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Ky është arsyetimi që bën të mundur që kjo vepër penale të jetë brenda kontureve të kushtetutshmërisë, konkretisht sa i përket zbatimi të parimit të prezumimit të pafajësisë. Për rrjedhojë, vlerësoj se arsyetim i ngjashëm duhet të vlejë edhe për rastin e veprës penale të financimit të terrorizimit parashikuar nga neni 230/a i KP, e cila ka të njëjtën teknikë legjislative si vepra penale e pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

5.2.2 Prezumimet e faktit dhe mekanizmi prezumues te indicjet

Prezumimet e faktit, ndryshe nga ato ligjore, krijohen gjatë zbatimit të ligjit mbi interpretimin e fakteve dhe provave nga gjykata. Krahasuar me prezumimet ligjore, që pavarësisht se u mungon përcaktimi juridik, gjenden të shpërndara në legjislacionin penal dhe jo vetëm, prezumimet e faktit gjenden kryesisht në praktikën gjyqësore. Megjithatë, edhe për këto të fundit mund të thuhet se kanë pjesërisht një bazë normative, kur bëhet fjalë për mekanizmin e funksionimit të indicjeve në procesin penal, duke qenë se prej tyre deduktohet një fakt i panjohur. Doktrina ka shpjeguar se *indicjet përbëjnë një segment të mekanizmit prezumues, pra fakti i njohur prej të cilit mund të deduktohet fakti i panjohur, në sajë të rregullave empirike të karakterizuara nga vërtetësia dhe besueshmëria. Prezumimi i thjeshtë përbën mekanizmin provues të natyrës silogjistike me anë të të cilit nga fakti i njohur (indicia) arrihet në faktin e*

panjohur, në sajë të lidhjes së verifikueshme sipas rregullave të përvojës[539]. Autori Carlo Pecoraro ka shpjeguar se *indicjet dhe prezumimet nuk janë sinonime, ashtu siç nuk janë konceptet e "dëshmitarit" dhe "dëshmisë": indicja dhe dëshmitari përbëjnë burim provash, pra objektin ose subjektin, prej të cilit mund të rrjedhë një element provë në procedim; prezumimi i faktit dhe dëshmia konsiderohen mjete provuese, d.m.th. veprimtaria përmes së cilës elementi i provës formëson vlerën e saj provuese.* [540] Megjithatë, indicjet mund të konsiderohen vetëm një kategori që operojnë sipas natyrës së prezumimeve dhe e vërteta është se ato mund të përbëjnë mishërimin e kuptimit klasik të prezumimeve, sipas të cilit fakti i njohur (i provuar) shërben për vërtetimin e faktit të panjohur (që duhet provuar), por këto koncepte nuk duhet të barazohen ndërmjet tyre[541]. Prezumimet, siç kemi theksuar, vijnë në forma të ndryshme dhe baza e ekzistencës së tyre mund të jenë si provat indirekte (indicjet), ashtu edhe provat e tjera direkte, apo faktet e tjera të provuara në gjykim, apo tërësia e fakteve të një procesi, madje, siç do të shohim në vijim, edhe vetë qendrimet e palëve gjatë procesit penal, konkretisht të pandehurit.

5.2.2.1 Prezumimet e faktit bazuar në heshtjen (sjelljen) e të pandehurit

Më lart trajtuam vendimin e GJEDNJ Zschüschen kundër Belgjikës, vendimi datë 02.05.2017, i cili, ndër të tjera, ka trajtuar edhe çështjen e nxjerrjes së konkluzioneve apo përfundimeve bazuar në qendrimin e të pandehurit, më konkretisht në të drejtën e tij për të heshtur. GJEDNJ arsyetoi në këtë drejtim se Konventa nuk i ndalon gjykatat që të marrin në konsideratë heshtjen e të pandehurit për të përcaktuar fajësinë e tij, me kushtin që dënimi të mos bazohet ekskluzivisht apo esencialisht në heshtjen e tij. Gjykata argumentoi më tej se refuzimi i të pandehurit për të provuar shpjegimet e tij jo bindëse lidhur me origjinën e parave, ndërmjet rrethanave të tjera, duke passjellë që gjykata vendase të përjashtonte çdo origjinë të ligjshme të mundshme të tyre, nuk përbën shkelje të së drejtës për të heshtur dhe për të mos u vetëinkrimuar[542].

Arsyetimi i mësipërm paraqet vështirësi në zbatimin praktik të së drejtës për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar në raport me prezumimet që mund të perdoren nga akuza duke përdorur pikërisht këto dy të drejta të të pandehurit. Vështirësia qendron, së pari, në faktin e mungesës së përcaktimit të shkallës apo nivelit të bindjes që duhet të garantojnë provat e tjera të çështjes, në mënyrë që e drejta e heshtjes të prezumohet në favor të akuzës, dhe që rrjedhimisht të konkludohet se fajësia nuk është përcaktuar ekskluzivisht nga kjo e drejtë. Problemi i dytë që vërehet ka të bëjë me faktin nëse arsyetimi i Gjykatës ka marrë në konsideratë llojin dhe natyrën e veprës penale të pastrimit të produkteve të veprës penale, siç ishte çështja në fjalë, apo kriteret e përcaktuara janë të aplikueshme edhe në vepra të tjera penale. Problemi i tretë ka të bëjë me faktin nëse opinioni i Gjykatës i përmbahet specifikisht faktit të heshtjes nga ana e të pandehurit apo më gjerë se kaq ka të bëjë mospërmbushjen në mënyrë të kënaqshme në optikën e gjykatës të shpjegimeve dhe

---

[539] Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli", https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzionineldirittopenale.pdf, fq.83-84

[540] Po aty, fq. 84

[541] Indicjet duhet të përmbushin kriteret e përcaktuara në nenin 152.2 të KPrP në mënyrë që prej tyre të deduktohet ekzistenca e një fakti. Dispozita parashikon se: "*Ekzistenca e një fakti muk mund të nxirret nga indicjet përveçse kur këto janë* ***të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën***".

[542] Gjednj, çështja *Zschüschen v. Belgium* (application no. 23572/07), vendimi datë 02.05.2017, pg.29.

rrethanave nga i pandehuri. Sipas gjykimit tim, përgjigja ndaj këtyre çështjeve do të krijonte një panoramë të qartë të konceptit të deduktimit të përfundimeve prej heshtjes së të pandehuri.

Megjithatë, problematika lidhur me këtë temë, daton që më herët në praktikën e GJEDNJ, e më konkretisht me çështjen Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar[543]. *Në Murray, GJEDNJ-ja mori në shqyrtim faktin nëse regjimi i nxjerrjes së konkluzioneve negative nga heshtja e të dyshuarit sipas Urdhrit për Provat Penale (Irlanda e Veriut) 1988, ishte në përputhje me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. GJEDNJ-ja vendosi se do të ishte e papajtueshme me të drejtën për të heshtur, nëse dënimi do të bazohej vetëm ose kryesisht në dështimin e të dyshuarit për t'iu përgjigjur pyetjeve të policisë. Megjithatë, ajo pranoi se këto konkluzione mund të nxirren "në situata që kërkojnë qartësisht një shpjegim" dhe mund të përdoren për të marrë në konsideratë forcën bindëse të provave të prokurorisë, me kusht që të përmbushen një sërë garancish. Këto garanci përfshinin: nëse i dyshuari ishte apo jo i informuar për pasojat e heshtjes; nëse e kuptonte paralajmërimin; nëse i dyshuari kishte apo jo qasje në këshilla juridike dhe nëse konkluzioni ishte nxjerrë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme nga gjykata. Kështu, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së,* ***përfundimet negative nga heshtja e të dyshuarit tolerohen, për sa kohë që ato shoqërohen me garanci, dhe mbështeten vetëm në ato raste kur është formësuar një çështje prima facia, në mënyrë të pavarur nga përfundimet që deduktohen prej heshtjes****. Pavarësisht kritikave, Gjykata ka qenë e qëndrueshme në zbatimin e kësaj qasjeje.*[544]

Lidhur me sistemin Italian*, seksioni më autoritar i Gjykatës së Kasacionit - i ashtuquajturi Sezioni Unite - ka përcaktuar se gjyqtarët mund të nxjerrin përfundime nga sjellja e përgjithshme e të dyshuarit gjatë procesit. Megjithatë, duke vepruar kështu, ata nuk mund të zhvendosin barrën e provës (që i takon prokurorit) dhe nuk mund të minojnë ushtrimin e së drejtës së mbrojtjes. Një seksion tjetër i Gjykatës ka nënvizuar kohët e fundit se sjellja e një të dyshuari gjatë procesit duhet të vlerësohet në lidhje me provat e tjera ose elementët përkatës. Edhe pse këto vendimmarrje nuk i referohen heshtjes në mënyrë specifike, në përgjithësi në praktikën gjyqësore, heshtja konsiderohet se përbën sjellje relevante (që përfshihet në sjelljen e përgjithshme të të pandehurit-shënimi im). Si rrjedhojë, gjyqtarët mund të nxjerrin prezumime negative nga heshtja e të dyshuarit, me kufizime të caktuara*.[545] Siç rezulton, sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës së Kasacionit të Italisë, prezumimet negative ndaj të pandehurit kanë një bazë më të gjerë se sa thjesht heshtja e tij në proces, ato i referohen në mënyrë të përgjithshme sjelljes së tij në proces.

Në kushtet që, koncepti i prezumimeve nga heshtja e të pandehurit, nuk ka një kuadër normativ të përcaktuar, doktrina ka përcaktuar disa karakteristika të mënyrës së vlerësimit të heshtjes dhe sjelljes së të pandehurit në procesin penal:

- *heshtja e të akuzuarit nuk mund të përbëjë në vetvete provë të faktit dhe as nuk mund të konsiderohet pranim i nënkuptuar i akuzës;*

---

[543] Gjednj, çështja *Murray v. the United Kingdom* - 14310/88, vendimi datë 28.10.1994

[544] Yvonne Daly, Anna Pivaty, Diletta Marchesi, Peggy ter Vrugt, Human Rights Protections in Draëing Inferences from Criminal Suspects' Silence, *Human Rights Law Review*, Volume 21, Issue 3, September 2021, Pages 696–723, https://doi.org/10.1093/hrlr/ngab006, fq. 699

[545] Po aty, fq. 706

- *megjithatë, përballë një kuadri solid provues, i cili sugjeron përcaktimin e fajësisë, mungesa e shpjegimeve alternative, mund të konsiderohet si një element, ndonëse me karakter mbetës dhe komplementar, që konfirmon elementet e mbledhura dhe konkluzionet e arritura.*[546]

Në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë të Shqipërisë është konstatuar një rast ku kjo gjykatë ka prezantuar një qasje të përafërt me vendimin e mësipërm të GJEDNJ. Konkretisht, Gjykata e Lartë është shprehur se: *Gjykata nuk mund të pranojë se i akuzuari është fajtor vetëm si pasojë e qëndrimit të tij për të heshtur. Vetëm kur provat kundër tij kërkojnë sqarime, të cilat i akuzuari duhet të jetë në gjendje t'i parashtrojë, refuzimi i dhënies së tyre duke u mbështetur në logjikën e shëndoshë lejon që të arrihet në përfundimin se i akuzuari është fajtor. Nëse provat e paraqitura nga akuza janë aq të dobëta sa nuk kanë nevojë për sqarime, atëherë refuzimi për t'i parashtruar ato nuk mund të argumentojë deklarimin e tij fajtor.*[547]

Në këndvështrimin që paraqet kryesisht praktika gjyqësore ndërkombëtare dhe ajo vendase, në kushtet që koncepti i së drejtës së heshtjes së të pandehurit është shndërruar në objekt të interpretimeve gjyqësore, prezumimet e faktit mbi bazën e heshtjes së të pandehurit ka të ngjarë të përbëjnë, përveç se cenime të barrës së provës, që në një kuptim janë natyrshme në rastet e prezumimeve, por edhe të standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në kundërshtim me qendrimin që paraqet GJEDNJ, ka një kontradiktë logjike ndërmjet ekzistencës së një çështje të provuar nga prokuroria dhe nevojës për të deduktuar prezumime nga heshtja e të pandehurit. Nëse çështja e akuzës është e provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm mbi çdo element që përbën një vepër penale të caktuar, atëherë nuk është e nevojshme që të nxirren prezumime negative nga heshtja e të pandehurit. Në të kundërt rezulton se, në rastet kur çështja e akuzës nuk e përmbush standardin e përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, atëherë prezumimet negative nga heshtja e të pandehurit do të merrnin një rëndësi kryesore, pasi logjikisht vetëm në këtë rast prokurori dhe gjykata do të impenjoheshin në interpretimin e qendrimit të të pandehurit. Si rrjedhim, dhe standardi i përcaktuar nga Gjykata e Lartë se *nëse* ***provat e paraqitura nga akuza janë aq të dobëta*** *sa nuk kanë nevojë për sqarime, atëherë refuzimi për t'i parashtruar ato nuk mund të argumentojë deklarimin e tij fajtor,* e lexuar a contrario *nëse* ***provat e paraqitura nga akuza janë aq të forta*** *sa kanë nevojë për sqarime, atëherë refuzimi për t'i parashtruar ato mund të argumentojë deklarimin e tij fajtor,* duket si një lloj derogimi nga zbatimi i standardit të përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe e fokuson vërtetimin e akuzës në qendrimin e të pandehurit, çka në gjykimin tim vë në diskutim kredibilitetin e procesit penal. Ligji e detyron gjykatën të arsyetojë qendrimin e saj mbi çështjen, duke vlerësuar, ndër të tjera, *arsyet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta*[548]; pra, gjykata interpreton qendrimin aktiv të të pandehurit, realizuar në proces përmes paraqitjes së provave të kundërta me akuzën, por jo edhe pasivitetin apo heshtjen e tij. Logjika e ndjekur me prezumimet nga heshtja e të pandehurit, do të shtronte çështjen e interpretimit të heshtjes edhe në subjekte të

---

[546] Luca Carboni, 'La valutazione probatoria del silenzio: critiche e prospettive' (2018) 5 Processo Penale
e Giustizia, www.processopenaleegiustizia.it/valutazione-probatoria-del-silenzio-critiche-e-prospettive

[547] Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 48, datë 24.02.2014, çështja që është shqyrtuar ka pasur për objekt gjykimin e veprave penale të krijimit dhe pjesëmarrjes në banda të armatosura, si edhe kryerja e veprave penale në kuadër të bandës së armatosur

[548] Neni 383/1, germa "ç" e KPrP

tjera, të cilët kanë detyrimin për të folur/dëshmuar, dëshmitarët (të cilët edhe mbajnë përgjegjësi penale nëse refuzojnë të dëshmojnë), por kjo natyrisht nuk është qasja e duhur në procesin penal. Kjo pasi nxjerrja e prezumimeve negative nga e drejta për të heshtur, e bën këtë të fundit të pazbatueshme apo thjesht teorike. Për më tepër, në kushtet kur shkaktohen pasoja/prezumime negative nga ushtrimi i një drejte, atëherë të tilla duhet të priten me siguri edhe nga mospërmbushja e një detyrimi ligjor (dëshmitarët).

5.2.2.2 Prezumimet faktike në praktikën gjyqësore shqiptare

Në vijim kemi veçuar disa vendime gjyqësore, në të cilat janë trajtuar prezumimet faktike. Rasti i parë i referohet kontrollit të ushtruar nga policia shtetasit QK, të cilit i është sekuestruar një armë zjarri e llojit pushkë. Sipas aktit të ekspertimit teknik ka rezultuar se: "Arma objekt ekspertimi është armë zjarri luftarake e llojit pushkë, nuk është në gjendje të rregullt teknike dhe nuk realizoi qitje luftarake, për shkak të mosfunksionimit të sustës së gjilpërës dhe mosmbylljes së plotë të folesë së fishekut nga pjesët e lëvizshme të kësaj arme". Ndërsa, lidhur me ekspertimin teknik të bajonetës të montuar në pushkën e kapur të pandehurit QK, konkludohet se: "Bajoneta objekt ekspertimi, e montuar në pushkë është fabrikisht e prodhuar në formë shtize, pjesë përbërëse e kësaj arme dhe plotëson kushtet e armëve të ftohta me teh shpues". Në këto rrethana si më lart, Prokuroria ka pretenduar se i pandehuri ka konsumuar plotësisht elementët e figurës së veprës penale *"Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të ftohta"* (të bajonetës), të parashikuar nga neni 279/2 i Kodit Penal.

Gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka arsyetuar se: "*Ka rezultuar se i pandehuri po mbante një armë zjarri pushkë të vjetruar, e cila pas ekspertimit ka rezultuar të mos plotësonte kriteret për tu quajtur armë në kuptim të ligjit, pasi nuk funksiononte dhe nuk realizonte qitje. Nga shqyrtimi gjyqësor nuk rezultoi se i pandehuri të ishte duke mbajtur blerë apo shitur një armë të ftohtë të tipit bajonetë, lehtësisht e dallueshme për cilësitë dhe karakteristikat e saj. Ashtu siç është përcaktuar edhe nga akti i ekspertimit përkatës dhe nga shpjegimet e dhëna para gjykatës nga eksperti përkatës, bajoneta është pjesë përbërëse dhe e pandarë e armës pushkë, një nga pjesët integrale të saj, të cilat së bashku në tërësinë e tyre, formojnë armën e tipit pushkë. Të pandehurit i është gjetur një armë zjarri, që ka si pjesë përbërëse të saj një bajonetë, por që në momentin e kapjes ka qenë e montuar dhe e pandarë prej armës pushkë. Gjykata konkludon se që i pandehuri të mbante përgjegjësi për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 të Kodit Penal, duhej që në rastin hipotetik i pandehuri të ishte në posedim të bajonetës ndarazi nga arma "mëmë", pjesë integrale e së cilës ajo është. Pra nëse i pandehuri, në dijeni të ekzistencës së bajonetës si pjesë përbërëse e armës, do ta kishte ndarë atë nga arma pushkë dhe do të vijonte mbajtjen e këtij sendi të kundraligjshëm, me cilësitë e tij të dallueshme për sulm, atëherë ai do të përgjigjej për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 të Kodit Penal. Nëse do të pranonim të kundërtën, atëherë do të konkludonim se në të gjitha rastet e veprave penale të "Mbajtjes pa leje të armëve të zjarrit" parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, të tipit pushkë, me pjesë përbërëse bajonetë, atëherë personat përgjegjës do të akuzoheshin jo vetëm për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal por edhe për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 të Kodit Penal, që në fakt nuk rezulton të ketë ndodhur*

ndonjëherë në praktikën gjyqësore, për faktin e thjeshtë sepse funksioni dhe destinacioni i armës së zjarrit, në kuptim të ligjit, lidhet me aftësitë e saja për të qitur dhe subjekti duhet të mbajë përgjegjësi pikërisht për mbajtjen dhe posedimin e kësaj arme zjarri, funksioni dhe destinacioni qitës i së cilës e bën atë një send të kundraligjshëm dhe shoqërisht të rrezikshëm. Nëse subjekti këtë armë do ta kishte çmontuar dhe do të ndodhej në posedim të bajonetës tashmë, atëherë ai do të mbante përgjegjësi për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 279/2 të Kodit Penal. Bazuar në analizën e elementëve të anës objektive të kryerjes së veprës penale, gjykata arrin të përcaktojë anën subjektive të kryerjes së veprës penale, duke arritur në përfundimin se në rastin konkret nuk ekziston qëllimi dhe dashja e të pandehurit për mbajtjen e armës së ftohtë, bajonetë. Nga kjo tablo e anës objektive rezulton inekzistenca e anës subjektive të veprës penale, pra dijenia, qëllimi dhe dashja e të pandehurit për të mbajtur një armë të ftohtë të tipit bajonetë. Rrethanat konkrete dhe posedimi i një arme zjarri të orientojnë drejt ekzistencës tashmë të prezumuar të anës subjektive të kryerjes së veprës penale, pra të dijenisë, qëllimit dhe dashjes së subjektit për të mbajtur këtë armë, pasi ai e di se çfarë po mban dhe po e bën këtë me ndërgjegje. Por ky fakt nuk provon ekzistencën e qëllimit, dashjes dhe dijenisë për të mbajtur dhe poseduar një nga pjesët përbërëse të armës që rezulton të jetë bajoneta. ***Pra nga posedimi i një arme zjarri nuk prezumohet ligjërisht ekzistenca e anës subjektive për posedimin në veçanti të një prej pjesëve përbërëse të armës.*** *Që subjekti të mbajë përgjegjësi për veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve të ftohta", në këtë rast të tipit bajonetë të montuar në armë, duhet që të provohet qëllimi dhe dashja direkte e këtij subjekti për të realizuar këtë vepër, që në rastin konkret nuk u arrit të provohet.* ***Mbajtja e një arme zjarri që ka të montuar dhe pjesë përbërëse të saj një bajonetë, nënkupton dijeninë, qëllimin dhe dashjen e prezumuar të subjektit për mbajtjen e një armë zjarri, por mbajtja e saj nuk nënkupton dijeninë, qëllimin dhe dashjen e prezumuar të subjektit për të mbajtur një armë të ftohtë të tipit bajonetë, e montuar dhe pjesë përbërëse e çdo arme zjarri, pushkë të atij lloji.*** ***Ekzistenca e anës subjektive lidhur me mbajtjen e një arme të ftohtë të tipit bajonetë, pjesë përbërëse e armës së zjarrit, nuk është dhe nuk mund të jetë një prezumim ligjor, që nuk ka nevojë të provohet, pasi funksioni i armës së zjarrit në kuptim të ligjit është funksioni qitës i saj dhe i vetmi prezumim ligjor që mund të ekzistojë në këtë rast është dijenia, dashja dhe qëllimi i subjektit për të mbajtur një armë zjarri. Ndërsa dashja dhe qëllimi i subjektit për të mbajtur një armë të ftohtë, bajonetë, pjesë përbërëse e armës, duhet çdo rast konkret të provohet që ekziston.*** *Gjatë këtij gjykimi, nuk u arrit të provohet ana subjektive, pra dijenia, dashja dhe qëllimi i të pandehurit për të mbajtur një armë të ftohtë të tipit bajonetë, pjesë përbërëse e armës së zjarrit. Mbajtja e një arme zjarri nënkupton dijeninë e subjektit që po mban një armë zjarri por jo domosdoshmërisht dijeninë dhe informacionin e tij lidhur me strukturën dhe pjesët përbërëse të armës. Është e vërtetë se mosnjohja e ligjit nuk e përjashton nga përgjegjësia penale por mungesa e informacionit dhe njohurive përkatëse lidhur me pjesët përbërëse të armës, nuk mund të të veshë me përgjegjësi për mbajtjen e çdo pjese në veçanti. Gjithsesi gjykata konkludon se në rastin konkret, nuk u arrit të provohej ana subjektive e veprës penale, pra dashja dhe qëllimi i të pandehurit për të mbajtur një armë të ftohtë të tipit bajonetë, pjesë përbërëse e armës së zjarrit"*[549].

---

[549] Cituar nga Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-1086, datë 23.12.2021

Mbi bazën e arsyetimit të mësipërm, vendimi i gjykatës është gjetur i drejtë edhe nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Në rastin konkret, gjendemi përpara konceptit të prezumimeve të faktit dhe gjykata e shkallës së parë gabimisht i referohet në vendim me termin 'prezumim ligjor'. Siç e kemi theksuar në pjesë të tjera të këtij punimi, prezumimet ligjore janë ato që janë të parashikuara shprehimisht nga ligji dhe për të cilat gjykata ka detyrimin për t'i zbatuar, pavarësisht faktit nëse ndikojnë në barrën e provës apo standardin e të provuarit. Prezumimet faktike, si në rastin konkret, janë ato që bazohen në rrethanat konkrete të njohura të çështjes për të vërtetuar faktet e panjohura. Sipas rrethanave të kësaj çështje, faktet e njohura janë ekzistenca e një arme zjarri e parregullt teknikisht dhe e paaftë për të realizuar qitje, posedimi prej autorit i kësaj arme dhe fakti që arma ka të integruar një bajonetë, e cila përbën armë të ftohtë. Fakti i panjohur është ekzistenca ose jo e dashjes së autorit për të mbajtur bajonetën (armë e ftohtë), pra, ana subjektive e autorit të veprës penale të dyshuar. Duhet theksuar, se ndryshe nga prezumimet ligjore, në prezumimet faktike gjykata nuk është detyruar në nxjerrjen e prezumimeve. Kjo veprimtari është tipike për shpalosjen e bindjes së brendshme të gjyqtarit, pasi në bazë të shqyrtimit në tërësi të rrethanave të çështjes, gjykata mund të konkludojë nëse do të mbështesë ose jo prezumimin. Në këtë kuptim, nuk do të përbënte gabim në arsyetim edhe nëse gjykata do të shprehej për të kundërtën, pra, që ***nga posedimi i një arme zjarri mund të prezumohet ekzistenca e anës subjektive për posedimin në veçanti të një prej pjesëve përbërëse të armës***, në kushtet që i pandehuri e ka poseduar normalisht armën e zjarrit, edhe pse ajo nuk realizonte qitje. Në këtë rast mos aplikimi i prezumimit është një akt që ka mbështetur pozitën apo versionin e të pandehurit, duke pranuar arsyetimin më të favorshëm për të.

Rasti i dytë i referohet procedimit penal të regjistruar nga Prokuroria Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër për veprën penale "Mbajtja pa leje e armëve luftarake", parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, në ngarkim të personit nën hetim RM. Ka rezultuar se, më datë 15.06.2014, gjatë tentativës për të hyrë në fshatin Lazarat, në kuadër të operacionit të zhvilluar për luftën kundër narkotikëve, efektivët e Policisë së Shtetit kanë hasur në rezistencën me armë të një grupi personash të maskuar me qëllim moslejimin e tyre për identifikimin dhe asgjësimin e lëndës narkotike në këtë fshat. Sipas raporteve të shërbimit të punonjësve të policisë, këta persona të armatosur kanë qenë të pozicionuar në pjesën juglindore të fshatit Lazarat, në lartësitë e kodrave të këtij fshati, në një objekt të rrethuar me blloqe betoni, mbuluar me llamarinë me ngjyrë blu, objekt i cili ndodhet në afërsi të banesës të shtetasve TM dhe RM. Pas disa orësh shkëmbimi zjarri, personat e paidentifikuar janë tërhequr nga pozicionet, nga të cilat shtinin me armë dhe nga ana e punonjësve të policisë është bërë kontrolli i zonës duke përfshirë edhe objektin e rrethuar me blloqe betoni, si dhe banesën e shtetasve të mësipërm. Duke qenë se kishte dyshime se shtetasi RM ka qënë në përbërje të grupit të personave që kanë bërë rezistencë ndaj policisë, është kryer arrestimi i tij në flagrancë. Gjatë kryerjes së veprimeve hetimore, nga akti i ekspertimit teknik ka rezultuar se në dy shiritat ngjitës të etiketuara në duart e shtetasit RM, nuk u evidentua prania e nitrateve dhe nitriteve të cilat janë të pranishme dhe tek mbetjet e qitjes me prejardhje nga barutet. Nga ana e Drejtorisë së Policisë Shkencore është përpiluar akti i ekspertimit përkatës mbi bazën e krahësimit të gjurmëve të këtij shtetasi dhe ka rezultuar se ato nuk janë të fiksuara në ndonjë ngjarje kriminale. Në këto kushte, në mungesë të provave që i pandehuri RM ka kryer veprën penale "Mbajtje pa leje e armëve luftarake" parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, atij i është njoftuar akuza për veprën penale "Moskallëzimi i krimit"

parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal.

Mbi bazën e fakteve të mësipërme, Gjykata e Shkallës së Parë ka arsyetuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastër ka arsyetuar se *rezulton e provuar se i pandehuri ka qenë me banim të përhershëm Lazarat, sikurse rezulton e provuar se në të gjithë territorin e fshatit Lazarat është kultivuar bimë narkotike. Nga provat shkresore të administruara provohet se vetëm pranë kësaj prokurorie në lidhje me veprat penale të "Kultivimit të bimëve narkotike" dhe "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", janë rregjistruar 171 procedime penale. Rezulton e provuar se në banesat në afërsi të banesës së të pandehurit në mënyrë permanente është kultivuar bimë narkotike dhe se i pandehuri ka qenë në dijeni të këtij fakti dhe nuk ka ushtruar kallzim në organet e ndjekjes penale.*

Gjykata e Apelit Gjirokastër ka arsyetuar se *ekzistenca e* ***"faktit të ditur botërisht" se në fshatin Lazarat eshtë kultivuar masivisht bimë narkotike, nuk mund të shërbejë si prezumim fajësie, se banorët e tjerë të këtij fshati, të mund të kenë dijeni për personat e përfshire në keto vepra penale.*** *Përgjegjësia penale është një përgjegjësi individuale, dhe askush nuk mund të dënohet penalisht vetëm se është banor i një zone apo një komuniteti, por duhet që përgjegjësia individuale të provohet me prova të cilat vërtetojnë fajësinë e të pandehurit, përtej çdo lloj dyshimi të arsyeshëm. Të gjitha aktet e fashikullit të hetimit, që janë marrë si prova nga gjykata e shkallës së parë, përveç vërtetimit të datës 12.05.2012, nuk kanë lidhje me provueshmërinë e akuzës së moskallëzimit të krimit, por janë vetëm akte që kanë lidhje me dyshimet për vepra të tjera, për të cilat nuk është ngritur akuzë, pikërisht për shkak të mungesës së provave.* ***Vetëm fakti i provuar i qenies të të pandehurit si banor i fshatit Lazarat, nuk mund të shërbejë, qoftë edhe si indicie në kuptim të nenit 152/2 të K.Pr.Penale, për të provuar dijeninë e këtij të fundit për gjithçka që ka ndodhur apo ishte duke ndodhur në këtë fshat***. Bazuar në këtë arsyetim, Gjykata e Apelit ka vendosur pushimin e çështjes.

Gjykata e Lartë e ka çmuar të drejtë vendimin e Gjykatës së Apelit Gjirokastër që ka vendosur prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes. *Kolegji ka risjellë në vëmendje dy parimet thebësore në gjykimin penal; standardi i të provuarit të akuzës tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe parimi i prezumimit të pafajësisë së të pandehurit. Këto parime jo vetëm që qëndrojnë në themel të gjithë procesit penal, por duhet të udhëheqin si punën e gjykatës, por edhe të organit të akuzës. Në vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër jo vetëm që nuk janë zbatuar parimet e mësipërme, por rezulton të jetë prezumuar fajësia e të pandehurit, duke i cenuar atij të drejtën për proces të rregullt ligjor*[550].

Sipas gjykimit tim, qendrimi i Gjykatës së Apelit është i drejtë, pasi në rastin konkret është prezumuar dijenia e të pandehurit, e për rrjedhojë edhe fajësia e tij, duke u bazuar në rrethana që gjykata i citon si "*fakte të ditura botërisht*". Ndërsa, gjykata e shkallës së parë kishte argumentuar se në banesat në afërsi të banesës së të pandehurit në mënyrë permanente është kultivuar bimë narkotike dhe se i pandehuri ka qenë në dijeni të këtij fakti dhe nuk ka ushtruar kallzim në organet e ndjekjes penale. Sipas qendrimit të gjykatës së shkallës së parë, përgjegjësia penale është ngritur tërësisht mbi rrethana që nuk i përkasin individualisht të pandehurit, për rrjedhojë prezumimi faktik i përdorur nga gjykata e shkallës së parë lë shteg për dyshime apo interpretime

---

[550] Cituar nga Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-128, datë 05.02.2021

të ndryshme lidhur me dijeninë e më pas fajësinë e të pandehurit. Në të tilla rrethana, prezumimi faktik i përdorur nuk e tejkalon apo nuk e përmbush standardin e përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Rasti i tretë i referohet një kontrolli të kryer nga shërbimet e policisë ndaj një automjeti dhe një kamioni që vinte pas tij, prej rreth 5 minutash vonesë. Pas ndalimit, në automjet janë konstatuar katër shtetas, të pandehurit QL, MD, HH dhe VB. Në momentin e ndalimit në drejtimin e automjetit ishte i pandehuri QL, ndërsa automjeti ishte në pronësi të VB. Ndërsa, në kamion, në drejtimin e të cilit ishte shtetasi NT, u gjet një sasi lënde narkotike. Procedimi është bazuar kryesisht në thëniet e të pandehurve dhe të dhëna të tjera si të dhënat e ekspertimeve të aparateve telefonike dhe të kompanive telefonike[551]. Gjykata e Lartë, duke e gjetur të drejtë arsyetimin e gjykatave të faktit, ka konkluduar se *"Gjykata e Apelit vlerëson se, kjo vepër penale është konsumuar nga të pandehurit në formën e transportimit të lëndës narkotike nga*

---

[551] I pandehuri NT (drejtuesi i kamionit), duke pranuar faktin ka shpjeguar se është kontaktuar nga shtetasi MD. MD është marrë me organizimin dhe ngarkimin e mallit dhe më pas e ka njoftuar se çdo gjë ishte gati. Ai është nisur nga Gjirokastra rreth orës 01.30 dhe sapo ka dalë nga qytetit atë e ka marrë në telefon MD, i cili e ka pyetur se ku ndodhej. NT e ka bërë me dije për vendndodhjen e tij dhe ka vijuar itinerarin e veprimeve të tij.

I pyetur me cilësinë e personit që ka dijeni për faktet objekt hetimi, por edhe në cilësinë e personin nën hetim ashtu dhe në cilësinë e të pandehurit, MD nuk ka pranuar të ketë asnjë lloj lidhje me substancën narkotike të gjetur në mjetin e shtetasit NT dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim lidhur me këtë fakt.

Shtetasi VB ka mohuar dijeninë lidhur me faktet e mësipërme duke shpjeguar se atij i kanë kërkuar të ikin në Korçë për një punë shtetasit QL dhe HH, të cilët do të merrnin dhe një shok tjetër MD.

I pandehuri HH ka mohuar dijeninë mbi lëndën narkotike dhe se ka qenë shtetasit QL që i ka kërkuar të shkojë në Korçë për të takuar familjarët e tij.

I pyetur në cilësinë e shtetasit ndaj të cilit zhvillohen hetimet i pandehurit QL, ka shpjeguar se ka qenë ka qenë shtetasi HH ai që i ka kërkuar ta shoqëronte drejt qytetit të Korçës. Bashke më ta ka qenë edhe shtetasi VB, i cili ishte personi që vuri në dispozicion mjetin e tij për të shkuar.

Mes numrit telefonik të shtetasit HH dhe QL ka thirrje në datat 09.01.2014 dhe në orën 10.01.2014, në orët 10.48, 10.47, 10.46, 02.12. Midis numrave telefonikë të shtetasit NT dhe MD ka komunikime në datën 11.01.2014, ora 16.20, 05.04, 05.34. Nga të dhënat ka rezultuar se ndërmjet MD dhe QL kanë komunikime të vazhdueshme me njeri tjetrin dhe në mënyrë specifike një ditë para kapjes në flagrancë prej policisë dhe njëkohësisht edhe ditën e ngjarjes. Njëkohësisht referuar përgjigjeve të dërguara nga kompanitë telefonike rezulton se ndërmjet shtetasve NT, HH, QL, VB antenat e qelizave kanë të njëjtin interval rrugor dhe kohor nga qyteti i Gjirokastrës në Përmet dhe mandej në Korçë, që konfirmon faktin se rrugëtimi i mjetit të drejtuar prej shtetasit VB ndiqte të njëjtin ritëm me atë të shtetasit NT, pikërisht për faktin se ishte makina pararojë e kamionit me substancë narkotike.

Sipas akti të ekspertimit daktiloskopik vlerësues nuk u përfituan gjurmë të vlefshme për identifikim.

Në dosjen gjyqësore, prokuroria ka bërë pjesë të saj edhe një kopje të akteve të dosjes penale nr.1655/1 të vitit 2013 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë, në ngarkim të të pandehurve të tjerë ku rezultonte që gjurma papilare e emërtuar me shkronjën "E" i përket shtetasit HH. Me këtë provë, prokuroria pretendoi se ky fakt konfirmon dijeninë dhe rolin e shtetasit HH në proçesin e ambalazhimin por edhe të shoqërimit të lëndës narkotike, pavarësisht nga qëndrimi i mbajtur nga ky i fundit gjatë hetimeve paraprake.

Prokuroria me të gjitha provat e paraqitura në dosjen gjyqësore, të gjitha kundërthëniet e personave nën hetim lidhur me personin që kishte në plan të shkonte në qytetin e Korçës dhe mandej personat që do ta shoqëronin, deklarimet e personin nën hetim, bashkëpunimin e tij me organin proçedues rezulton i provuar fakti se shtetasit HH, QL, VB, MD të kontraktuar përkatësisht nga dërguesi dhe pritësi i mallit kanë organizuar procesin e "hapjes" dhe kontrollit të kamionit ku ndodhej substanca narkotike. Të gjithë personat e vendosur në mjet kanë patur dijeni të plotë për ekzistencën e substancës narkotike dhe njëkohësisht për rolin dhe detyrat specifike të tyre.

qyteti i Gjirokastrës deri për në qytetin e Korçës, megjithëse ata janë ndaluar më parë nga punonjësit e policisë, pikërisht në Ersekë, në vendin e quajtur Qarr. Në këto kushte, me të drejtë gjykata e shkallës së parë konkludon se, të pandehurit MD, QL, HH, NT dhe VB në bashkëpunim ndërmjet tyre, duke u marrë vesh paraprakisht për çdo detaj për të bërë të mundur transportimin e lëndës narkotike të paketuar në 99 pako, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale, kanë konsumuar anën objektive të veprës penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve" e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, pasi provohet ekzistenca e vullnetit të secilit, e marrëveshjes për arritjen e qëllimit kriminal si dhe roli i secilit të pandehur në bashkëpunim. ***Në rrethanat si më sipër u përshkruan, Gjykata e Apelit e gjen të pabazuar pretendimin e ngritur në ankim nga të pandehurit, HH, VB, QL, se nuk kishin dijeni për lëndën narkotike dhe rrethanat e veprës ndaj duhet të deklarohen të pafajshëm.*** *Kjo pasi nga tërësia e provave të marra dhe të vlerësuara në lidhje me njëra-tjetrën dhe jo në mënyre fragmentare sic pretendohet nga mbrojtja e të pandehurve, rezulton e provuar se fakti kriminal objekt gjykimi i atribuohet bashkarisht të pandehurve MD, QL, HH, NT dhe VB."*[552]

Nga analiza e vendimit të mësipërm rezulton se gjykatat e kanë deduktuar faktin e dijenisë dhe bashkëpunimit të të pandehurve nga rrethanat faktike. Konkretisht, janë marrë në konsideratë faktet e lëvizjes së njëkohshme të mjeteve, deklarimet e njërit prej të pandehurve, konkretisht të drejtuesit të kamionit, si edhe të dhënat e komunikimeve telefonike ndërmjet të pandehurve, për të dalë në përfundimin që të pandehurit kanë pasur dijeni për aktivitetin e kundërligjshëm dhe kanë bashkëpunuar me njeri-tjetrin. Në fakt rrethanat e mësipërme të marra në shqyrtim dhe të vlerësuara nga gjykatat nuk duket të krijojnë ndonjë dyshim të arsyeshëm në favor të pafajësisë së të pandehurve, për këtë arsye, gjykoj se gjykatat kanë respektuar zbatimin e standardit të përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Në këtë rast, prezumimi i fakteve në favor të akuzës shkakton zhvendosjen e barrës së provës, në kuptimin e detyrimit të paraqitjes së kundërshtimeve dhe pretendimeve te të pandehurit, barrë të cilën, siç rezulton nga rrethanat e kësaj çështje, të pandehurit nuk e kanë përmbushur.

5.3 Ndikimi i interpretimeve gjyqësore në krijimin e prezumimeve

Kjo tematikë përfshin nevojën për analizimin e disa koncepteve njëkohësisht, me qëllim për të gjykuar drejt mbi rolin dhe ndikimin e jurisprudencës në krijimin e prezumimeve. Këto të fundit mund të jenë ose jo në dobi të njërës apo tjetrës palë të procesit dhe kanë një impakt të konsiderueshëm, veçanërisht kur diskutimi fokusohet në temën e vlerësimit të provave/rrethanave dhe përcaktimit të fajësisë se të pandehurit. Ky ndikim mund të shtrihet më tej edhe në procese të tjera penale duke pasur rolin e precedentit. Çështja e parë që meriton të diskutohet ka të bëjë me rolin e gjykatës në interpretimin e ligjit, e më pas të gjykohet ndikimi konkret i interpretimit gjyqësor në krijimin e prezumimeve dhe aplikimin e tyre.

---

[552] Cituar nga Vendimi i Gjykatës së Lartë Nr. 00-2016-2207 i Vendimit (229), datë 15.12.2016

5.3.1 Roli i gjykatës në interpretimin e ligjit

Roli i gjykatës në interpretimin e ligjit ka përbërë një diskutim të kahershëm, nëse ai kufizohet në shpalosjen e përmbajtjes së normës brenda terminologjisë dhe kufijve të përcaktuar prej saj apo interpretimi ka natyrë "krijuese", pra, nëse gjyqtari është deklaruesi në formë mekanike i ligjit apo krijues i tij. Këtu nuk është fjala për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ku ligjvënësi ka tagrin e krijimit të ligjeve dhe gjyqësori interpretimin perfundimtar dhe zgjidhjen e konflikteve, por për ato raste konkrete kur gjyqtarit i duhet të zbatojë ligjin në një mënyrë të caktuar që i përgjigjet ekzistencës së fakteve/rrethanave të caktuara në një çështje konkrete, ose për të unifikuar ose njësuar praktika jo të njëjta gjyqësore. Veçanërisht, ky diskutim është më konkret në rastin e interpretimit të zgjeruar të normave penale ose zbatimit të analogjisë, kur ajo vjen në favor të personit të dyshuar.

Përgjithësisht, në shoqëritë me tradita të hershme juridike, është pranuar roli krijues i gjyqtarit në dhënien e drejtësisë. Më e theksuar kjo gjë mund të vërehet në sistemin common law, ku precedenti buron prej jurisprudencës së gjykatës. Edhe në sistemin kontinental nuk vërehen dallime thelbësore në këtë drejtim, pavarësisht se kontinenti ka pasur tradicionalisht një qasje më konservatore ndaj respektimit të parimit të ligjshmërisë[553], për më tepër kur bëhet fjalë për procesin penal. Gjykata Kushtetuese gjermane, ndër më të spikaturat e kontinentit, është shprehur lidhur me këtë çështje se: *gjyqtari nuk udhëzohet se si t`i zbatojë instruksionet legjislative të marra fjalë për fjalë në rastet konkrete. Një konceptim i tillë kërkon paraprakisht një mungesë totale të boshllëqeve në rendin pozitiv juridik, gjendje kjo që mund të mbrohet si postulat themelor i sigurisë juridike, por që praktikisht mbetet e paarritshme: Veprimtaria e gjyqtarëve nuk konsiston vetëm në njohjen dhe leximin e vendimeve të ligjvënësit. Detyra e veprimtarisë së gjykatave mund të kërkojë gjithashtu që të kthjellojë përfytyrimet e vlerave që janë pjesë e pandarë e rendit kushtetues ligjor, por që në tekstet e ligjeve të shkruara, nuk kanë dalë qartë apo në mënyrë të plotë, dhe këtë ta bëjë në aktin e një shpalljeje vlerësuese, së cilës nuk i mungojnë as elemente të vullnetshëm dhe t`i realizojë ato në vendime. Në këtë rast gjyqtari duhet të ruhet nga arbitrariteti; vendimi i tij duhet të bazohet mbi një argumentim racional. Duhet bërë e qartë që ligji i shkruar nuk e përmbush funksionin e vet për ta zgjidhur drejt një problem ligjor. Është vendimi i gjyqtarit ai që e plotëson më pas këtë boshllëk sipas rregullave të arsyes praktike dhe "përfytyrimeve bazë të përgjithshme të komunitetit mbi drejtësinë". Kjo detyrë dhe kompetencë për "zbatim krijues së të drejtës", në parim, nuk i është mohuar kurrë gjyqtarit, gjithsesi brenda normave kushtetuese. Të diskutueshëm mund të jenë vetëm kufijtë që do t`i vihen një gjetjeje të tillë krijuese të së drejtës, duke marrë parasysh edhe parimin e pashmangshëm të shtetit të së drejtës të detyrimit të gjyqësorit për t'iu nënshtruar ligjit. Ato nuk mund të përmblidhen në*

---

[553] Ky parim është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike-Vendimi nr.20, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese

një formulë që do të kishte të njëjtën vlerë për të gjitha fushat e së drejtës dhe për të gjitha marrëdhëniet juridike të krijuara e të rregulluara prej tyre.[554]

5.3.2 Prezumimet si rrjedhim i interpretimit

I parë në këtë prizëm, funksioni krijues i gjykatës në interpretimin e normave, fakteve e provave, shpie në formimim e prezumimeve dhe përfundimeve. Në fakt, në analizë të fundit, edhe vendimi gjyqësor është një tërësi prezumimesh e përfundimesh logjike dhe jo një ushtrim me natyrë matematikore. Ky arsyetim përkon, gjithashtu, me qëllimin e procesit penal, që konsiston në zbulimin e së vërtetës procedurale (gjyqësore), jo asaj absolute. Nëse do të veçonim një karakteristikë të prezumimeve që deduktohet nga vendimi i mësipërm është se ato mund të kenë karakter subjektiv, në kuptimin që ato janë përfundime të formuara në përputhje me bindjen e një gjyqtari konkret, por në të njëjtën kohë nuk duhet të bien ndesh me parimin e shtetit të së drejtës.

Për të kuptuar më mirë këtë funksion të gjykatës në krijimin e prezumimeve, çka kuptohet që rezulton në mënyrë implicite nga ushtrimi i interpretimit që gjykata i bën normave, fakteve apo provave, është me rëndësi evidentimi i praktikave unifikuese, të cilat kanë interes të veçantë për shkak të efektit të tyre të përgjithshëm dhe detyrues mbi gjykatat më të ulta. Siç e kemi përmendur edhe në pjesë të tjera të këtij punimi, prezumimet mund të konsiderohen si përjashtime të barrës së provës e rrjedhimisht edhe të standardit të të provuarit, pasi edhe pse qëllimi i tyre është minimizimi i gabimeve në procesin gjyqësor penal dhe afria me të vërtetën gjyqësore, ato favorizojnë njërën palë të procesit, duke vështirësuar pozitën apo versionin e palës tjetër.

5.3.2.1 Vendimi unifikues mbi veprën penale vazhduese

Në gjykimin tonë paraqesin interes disa vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë, të cilat me interpretimet që kanë ofruar, kanë krijuar prezumime të caktuara, që tashmë kanë të njëjtin efekt si e drejta pozitive. Me vendimin nr. 284/2000 Gjykata e Lartë ka trajtuar konceptin e krimit vazhdues. "*Për të patur krim vazhdues duhet të jenë të pranishëm elementë të tillë si: secila vepër nuk duhet të qëndrojë si akt më vete, veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale, të ekzistojë një mendim kriminal, i cili të bashkojë aktet e veçanta në një tërësi të vetme të pandashme". Për të patur krim vazhdues është e domosdoshme që personi të ketë parashikuar hollësitë rreth veprimtarisë së tij kriminale siç janë, koha, mjetet, forma, mënyra për kryerjen e krimit. Mendimi i vetem kriminal, si bosht i kërkësës për krimin vazhdues, presupozon që i pandehuri të ketë përpunuar në mendjen e tij zhvillimin e veprimeve konkrete në kohë e hapësirë. Pavarësisht se është "mendim" ai "lexohet" nëpërmjet veprimeve konkrete që kryen i pandehuri për realizimin e veprës penale".*[555]

---

[554] Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane, Fondacioni Konrad Adenauer, Vinsent-Grafika, Shkup Maqedoni, 2010, fq. 522

[555] Vendimin Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 284, datë 06.10.2000.

Në legjislacionin tonë penal nuk ka një dispozitë që të parashikoj shprehimisht kuptimin e veprës penale vazhduese, si në legjislacione të vendeve të tjera.[556] Për rrjedhojë, vepra penale vazhduese është një koncept që është trajtuar nga teoria e së drejtës penale dhe jurisprudenca, të cilat kanë përpunuar disa kritere për dallimin dhe kuptimin e kësaj lloj vepre penale. Këto kritere përbëhen nga grupe faktesh dhe rrethana të tyre, të cilat janë premisat apo parakushtet për prezumimin e veprës penale vazhduese[557]. Kjo nënkupton që nëse gjykata konstaton praninë e tyre, atëherë ajo duhet të arsyetojë dhe arrijë në përfundimin e ekzistencës së veprës penale vazhduese. Disa legjislacione kanë një qasje të ndryshme nga teoria dhe praktika gjyqësore shqiptare, e cila njeh vetëm veprën penale vazhduese kur personi kryhen disa veprime ose mosveprime që konsumojmë elementët e të njëjtës figurë të veprës penale.[558]

Nevoja për të krijuar konceptin e krimit vazhdues qendron pikërisht në faktin që nga njëra, akuza apo prokuroria të shmanget nga argumentimi për çdo vepër përbërëse të të gjithë elementëve të figurës së veprës penale, në veçanti elementit subjektiv, pasi të gjitha veprat lidhen midis tyre me anë të një mendimi unik kriminal të autorit dhe nga ana tjetër shmang dënimin e autorit, i cili rrezikon të kthehet në një dënim joproporcional. Në literaturën juridike jepen dy arsye, përse legjislacionet e disa vendeve, ose teoria dhe praktika gjyqësore në ato vende që nuk kanë rregullim ligjor të shprehur, kanë pranuar këtë lloj vepre. Arsyet materiale-juridike dhe arsyet procedurale.[559] Në thelb të arsyeve materiale juridike qëndron nevoja për drejtësi të dënimit.[560]Arsyet procedurale-juridike, nisen nga nevoja për ekonomi gjyqësore dhe për thjeshtimin e procedurave. *Sipas kësaj teorie, nëse personi do të hetohej dhe gjykohej për secilën vepër më vete, do të duhej kohë e madhe dhe shfaqet vështirësi në të provuarit e secilit akt kriminal. Kurse, nëse personi akuzohet vetëm për një vepër vazhduese, hetimi do të fokusohej në fillimin dhe mbarimin e veprimeve ose*

---

[556] Kodi Penal i Kosovës e parashikon figurën vazhduese në nenin 81, sipas të cilit: *"Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: viktimës së njëjtë të veprës penale; objekti i njëjtë i veprës; shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore; vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe dashja e njëjtë e kryesit."* Po ashtu, edhe K. Penal Italian e sanksionon atë në nenin 81/2 të tij sipas të cilit: *"I njëjti dënim jepet edhe për atë që me disa veprime ose mosveprime, në zbatim të një mendimi unik kriminal, kryen edhe në kohë të ndryshme, disa shkelje të së njëjtës dispozitë ligjore, ose disa shkelje të dispozitave të ndryshme." Shih* "Commentario breve al codice penale 2009", CEDAM, Breviata Iuris, Fondata da G. Cian e A. Trabucchi, f. 385. Cit.nga Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të. Temë diplome- Shkolla e Magjistraturës, korrik 2013, Magjistrati Gjyqtar Sokol Pina, f. 53.

[557] *Secila vepër nuk duhet të qëndrojë si akt më vete; veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale, të ekzistojë një mendim kriminal, i cili të bashkojë aktet e veçanta në një tërësi të vetme të pandashme; personi të ketë parashikuar hollësitë rreth veprimtarisë së tij kriminale siç janë, koha, mjetet, forma, mënyra për kryerjen e krimit.*

[558] Sipas vendimit unifikues nr. 284, dt. 15 Shtator 2000 dhe 6 Tetor 2000, *"për të pasur krim vazhdues duhet të jenë të pranishëm elementë të tillë si;..., veprimet ose mosveprimet e të pandehurit të konsumojnë të njëjtën figurë të veprës penale..."* Cit.nga Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të. Temë diplome- Shkolla e Magjistraturës, korrik 2013, Magjistrati Gjyqtar Sokol Pina, f. 57.

[559] Shih Vllado Kambovski "E Drejta Penale,Pjesa e Përgjithshme", Botimi i II, përkthyer në shqip nga A. Osmani dhe I. Zejneli, Shtëpia Botuese "Furkan ISM", Shkup, 2007, f. 418. Cit.nga Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të. Temë diplome- Shkolla e Magjistraturës, korrik 2013, Magjistrati Gjyqtar Sokol Pina, f. 55

[560] Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të. Temë diplome- Shkolla e Magjistraturës, korrik 2013, Magjistrati Gjyqtar Sokol Pina, f. 55

mosveprimeve dhe në rezultatin përfundimtar (pasoja në total) që vjen nga vepra, duke dhënë një vendim të vetëm.[561]

Lidhur me natyrën e krimit vazhdues ka pikëpamje të ndryshme në teori. Shumë penalistë mendojnë së krimi vazhdues është një krim unik i vërtetë, ndërsa të tjerë pretendojnë se krimi vazhdues është vetëm një fiksion juridik. Ata që janë të mendimit se krimi vazhdues është në thelb një krim i vetëm argumentojnë kështu: secili nga aktet e shumta, në qoftë se do të shqyrtohet më vete dhe jo në lidhjen e tij me aktet e tjera, ka të gjithë elementët objektiv dhe subjektiv që formojnë një figurë të veçantë krimi, por me qenë se aktet e veçanta kanë si origjinë të përbashkët mendimin e njëjtë kriminal, ato nuk mund të ndahen, por duhen trajtuar si një tërësi, si momente të ndryshme të realizimit të mendimi të vetëm kriminal. Të tjerët, që kanë pikëpamje të kundërt, arsyetojnë në këtë mënyrë: krimi vazhdues është një bashkim vetëm në dukje, një konstruksion juridik që është diktuar nga nevoja që të mënjanojë pasojat e rënda që mund të vijnë nga dënimi i veçantë i krimeve të pavarura. Sipas këtyre mendimi i njëjtë kriminal që realizon lidhjen e krimeve të shumta, është element psikologjik, i cili nuk ka forcë të bashkojë në thelb, në një tërësi krimet e shumta.[562] Autori Sokol Pina argumenton se "*i drejtë është qëndrimi i dytë, sepse siç e shpjeguam më sipër baza për pranimin e veprës së vazhduar është e karakterit material, nisur nga nevoja për drejtësi penale. Pra është një konstruksion juridik që shmang dënimin më tepër të një personi, i cili në kushtet që e kryen veprën penale është i detyruar që pasojat e dëshiruara t'i realizojë me shumë veprime, në raport me një person tjetër që paraqet të njëjtën rrezikshmëri por, i cili e arrin të njëjtën pasojë me një veprim të vetëm.*

Në gjykimin tim ky përfundim është i saktë sa i përket natyrës së veprës penale vazhduese, në konceptimin e saj si një konstruksion juridik, megjithatë sa i përket arsyeve të pranimit të këtij koncepti në literaturën juridike dhe jurisprudencë, gjykoj se janë njësoj të rëndësishme si ato materiale-juridike, ashtu edhe ato procedurale. Fakti që kjo vepër penale është një konstruksion juridik nuk bie ndesh me arsyet procedurale që justifikojnë ekzistencën e saj, përkundrazi duket se e përforcojnë argumentin për pranimin e kësaj vepre penale. Në analizë të këtij koncepti, vlerësoj se me anë interpretimit gjyqësor (mbështetur padyshim edhe nga teoria e së drejtës penale), Gjykata e Lartë ka krijuar një prezumim që në këtë rast ruan një qasje proporcionale ndërmjet interesave të të pandehurit për të përfituar nga një dënim i drejtë dhe shmangies së vështirësive të prokurorisë për të argumentuar elementët e secilit fakt penal të cilin ka kryer i pandehuri, veçanërisht elementë të anës subjektive. Kjo nuk nënkupton që prokuroria të keqpërdorë zbatimin e këtij prezumimi, për shkak se secili fakt duhet të provohet që ka ndodhur, megjithatë elementët subjektivë si qëllimi apo motivet, pavarësisht se mund të ndryshojnë nga njëri fakt në tjetrin nuk ndikojnë në kualifikimin e veprës penale vazhduese. Mendimi kriminal i njëjtë apo unik, nuk nënkupton unitetin e motiveve apo shkaqeve që e shtyjnë personin të kryejë veprën penale. Ndryshimi i motivit nuk ka rëndësi për cilësimin juridik të veprimeve të kryera, si vepër penale vazhduese.[563] Gjithashtu, edhe nga pikëpamja objektive,

---

[561] Po aty, fq.56

[562] Vep. e cit. Grigor Gjika "Për një zbatim të drejtë të nenit 80 të Kodit Penal", Drejtësia Popullore, nr. 1, viti 1966, f. 17. Cit.nga Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të. Temë diplome- Shkolla e Magjistraturës, korrik 2013, Magjistrati Gjyqtar Sokol Pina, f. 57.

[563] Po aty, fq.60

pavarësisht se një apo disa fakte mund të mbeten në fazën e tentativës, kualifikimi i tërësisë së fakteve do të bëhet sipas veprës penale vazhduese. Ky prezumim nuk ka karakter absolut, në kuptimin që, është e mundur që të provohet se nuk ekzistojnë kriteret e veprës penale vazhduese, ku në këtë rast do të ishte detyrimi i prokurorisë për të provuar që mungojnë këto kritere, eventualisht nëse vepra penale vazhduese do të pretendohej nga mbrojtja në mënyrë të arsyeshme, por do të kundërshtohej nga prokuroria e do të konsiderohej si shmangie e të pandehurit nga rreziku i dënimit disa herë për të njëjtën vepër penale.

5.3.2.2 Vendimi unifikues mbi pozitën e bashkëekzekutorit

Interes në temën e prezumimeve paraqesin zhvillimet jurisprudenciale në institutin e bashkëpunimit në të drejtën penale, më konkretisht bashkëpunimi i thjeshtë. Me vendimin nr. 1, datë 12.03.2002, Gjykata e Lartë ka prezantuar konceptin e bashkëekzekutorit të veprës penale dhe mënyrën e aplikimit të përgjegjësisë penale për këtë kategori. Ky koncept nuk është i lidhur me kuptimin klasik dhe rolet e bashkëpunëtorëve sipas Kodit Penal, pasi në këtë të fundit ata janë kategorizuar në organizatorë, ekzekutorë, shtytës dhe ndihmës. Lidhur me bashkëekzekutimin, ndër të tjera, Gjykata e Lartë është shprehur se: "*Kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën e bashkëzekutimit, midis bashkëpunëtorëve nuk ka më ndarje rolesh, në kuptimin klasik të kësaj fjale, (ndarje në rolet organizator, ekzekutor, shtytës dhe ndihmës), por ka një lloj ndarjeje tjetër, e cila ka të bëjë me ndarjen e punëve direkte që duhet të kryejë secili nga bashkëkzekutorët për realizimin e vullnetit të përbashket kriminal, vullnet ky që, në fund të fundit, manifestohet në botën e jashtme, veç veprimeve të secilit, edhe me arritjen e rezultatit kriminal të dëshiruar prej tyre*"[564].

Koncepti i bashkëekzekutimit, ashtu siç trajtuam më lart, për veprën penale vazhduese, është një konstruksion juridik i krijuar prej jurisprudencës së gjykatave dhe jo një koncept që parashikohet specifikisht në të drejtën pozitive. Megjithatë, më me rëndësi se vet krijimi i koceptit të bashkëekzekutorit, është mënyra se si do të atribuohet përgjegjësia penale në këtë rast dhe kualifikimi i veprave penale. Lidhur me përgjegjësinë penale, Gjykata e Lartë argumenton se: "*Është e vertetë që, ashtu sikurse pretendohet në rekursin e paraqitur nga organi i prokurorisë, kur vepra penale kryhet në bashkëpunim, si rregull, bashkëpunëtorët duhet të përgjigjen për veprën penale të parashikuar nga e njëjta dispozitë e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Por, kjo ka të bëjë me përgjegjësinë penale të bashkëpunëtorëve në kryerjen e veprës penale në rastet kur ndodhemi para ndarjes klasike të roleve, në organizatorë, shtytës dhe ndihmës dhe jo edhe kur shtrohet problemi i përgjegjësisë penale të bashkëkzekutorëve të një vepre penale, ku, siç u përmend,* ***ndodhemi përpara ndarjes së punëve midis pjesëmarrësve në një veprimtari të caktuar kriminale, sikurse në rastin në gjykim dhe jo përpara ndarjes së roleve***". Në këtë përfundim arrihet duke u nisur edhe nga përmbajtja e paragrafit të parë të nenit 27 të K.Penal. Sipas kesaj dispozite, organizatorët, shtytësit dhe ndihmësit kanë përgjegjësi, si edhe ekzekutorët për veprën penale të kryer prej tyre në kuptimin që edhe vepra e secilit prej tyre do të cilësohet nga gjykata me atë dispozitë të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal me të cilën do të cilësohet vepra e kryer nga ekzekutori.

---

[564] Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 12.03.2002

Në rastin e marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, në kushtet kur nga aktet e hetimeve paraprake dhe nga provat e administruara gjatë gjykimit, nuk është e mundur të përcaktohet organizatori/ët e kësaj veprimtarie, por, sikurse u përmend, ndodhemi jo para ndarjes së roleve, por para ndarjes së punëve midis pjesëmarrësve në realizimin e kontrabandës, problemi i përgjegjësisë penale të çdo njërit prej tyre, në kuptimin e cilësimit ligjor të veprës së secilit do të zgjidhet, duke patur parasysh parimet e pergjithshme të bashkëpunimit në formën e bashkëkzekutimit, duke e vënë secilin prej tyre në të njëjtin rol bashkëpunimi në atë të bashkëekzekutorit të veprës penale. Siç rezulton nga interpretimi i Gjykatës së Lartë, duke mos gjykuar mbi saktësinë e këtij koncepti apo dhe problematikat e mundshme në interpretimin e figurave të ekzekutorit dhe ndihmësit[565], të cilat duket të jenë të afërta, gjykata ka krijuar një prezumim, e konkretisht atë që *nëse ndërmjet bashkëpunëtorëve, nuk konstatohet apo provohet të ketë ndarje të roleve, por ndarje të punëve midis pjesëmarrësve në kryerjen e veprës penale, përgjegjësia penale e çdo njërit prej tyre do të zgjidhet, duke patur parasysh parimet e pergjithshme të bashkëpunimit në formën e bashkëkzekutimit, duke e vënë secilin prej tyre në të njëjtin rol bashkëpunimi, në atë të bashkëekzekutorit të veprës penale*.

Efekti i këtij prezumimi në praktikën hetimore dhe gjyqësore duket se ka qenë në favor të organit të akuzës, për shkak se në rastet e komplikuara të përcaktimit të roleve në bashkëpunimin klasik, organi i akuzës ka evokuar konceptin e bashkëekzekutorëve. Një praktikë e tillë është vërejtur veçanërisht në veprat penale në fushën e narkotikëve, e konkretisht ato të kultivimit dhe prodhimit e mbajtjes së lëndëve narkotike. Në këto raste, duket se prokuroria ka një barrë të pakapërcyeshme të të provuarit të roleve të bashkëpunëtorëve në organizatorë, ekzekutorë, ndihmës dhe shtytës, në kushtet e mungesës së provave të mjaftueshme për të konkluduar, megjithatë, në të njëjtën kohë duket se mungesa e suksesit për të provuar këto elementë, ka passjellë cenimin e parimeve të përgjegjësisë penale, e konkretisht atë të pergjegjësisë penale personale. Në vlerësimin tim, zbatimi i këtij prezumimi nuk duhet keqpërdorur, duke shmangur kryerjen e hetimeve të plota, por duhet të aplikohet në çdo rast, kur provohet se nuk ka ndarje të roleve në kuptimin e bashkëpunimit klasik dhe duke specifikuar praktikisht konceptin e '*ndarjes së punëve*'. Ky i fundit është një koncept, që edhe nga pikëpamja e terminologjisë, nuk është juridik dhe që nuk është trajtuar nga pikëpamja e përmbajtjes. Në të tilla kushte, praktika gjyqësore ka dëshmuar se ka patur qasje jo të unifikuar nëse pozita e bashkëpunëtorit është ajo e ndihmësit ose bashkëekzekutorit, apo faktet duhet të kualifikohen sipas veprave të tjera penale si moskallëzimi i krimit, veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës, etj.

---

[565] Për më gjerë, Arbër Basholli, Disertacion, Bashkëpunimi i personave në kryerjen e veprës penale, Tiranë, 2018, fq. 110-111, aksesuar në https://unitir.edu.al/bashkepunimi-i-personave-ne-kryerjen-e-vepres-penale/, datë 23.09.2022. *Autori shprehet se: "dallimi ndihmës-bashkëekzekutor mendoj se duhet bërë duke u bazuar në natyrën e veprimeve të kryera të tyre. Ndërsa veprimi i ekzekutorit është pjesë përbërëse e veprimit të kryerjes së veprës penale, veprimi i ndihmësit gjendet jashtë këtij veprimi, ai vetëm sa kontribuon në kryerjen e veprës penale nga personi tjetër".*

5.3.2.3 Vendimi unifikues mbi bashkëpunëtorin e panjohur

Në vendimin tjetër unifikues nr. 4, datë 15.04.2011 lidhur me konceptin e bashkëpunimit, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë arritur në përfundimin unifikues se: **kur nga pikëpamja e anës objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona, vepra do të konsiderohet e kryer në bashkëpunim. Kjo si për rastet kur nuk identifikohen bashkëpunëtorët, ashtu edhe për rastet kur bashkëpunëtori nuk ka përgjegjësi penale për shkak të paaftësisë apo moshës për përgjegjësi penale. Cilësitë e veçanta që shtojnë, pakësojnë apo përjashtojnë dënimin merren parasysh vetëm për bashkëpunëtorin tek i cili ato ekzistojnë.**

Ky qendrim është një ndryshim rrenjësor nga qendrimi tradicional i praktikës gjyqësore shqiptare, pasi sikurse shprehet në vendimin e tij të datës 15.04.1971 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë "*Krimi mund të kryhet në bashkëpunim vetëm nga ata persona që janë subjekte të së drejtës penale. Personi i papërgjegjshëm nuk është subjekt i së drejtës penale, dhe kjo sepse nuk mund të ketë marrëveshje me një njeri i cili është i papërgjegjshëm për veprimet e tij para ligjit*"[566]. Edhe pse ky vendim unifikues ka pasur një rëndësi thelbësore në praktikën gjyqësore pas tij, veçanërisht nga qasja e tij për të vlerësuar në mënyrë skrupuloze ekzistencën e përgjegjësisë penale në formën e bashkëpunimit edhe në rastet kur subjektet bashkëpunuese janë të papërgjegjshëm penalisht, mendoj se çështja e konceptimit të figurës së bashkëpunëtorit të paidentifikuar nuk është e njëjta situatë juridike me kategorinë e subjekteve të papërgjegjshëm. I vetmi kriter i përdorur nga Gjykata e Lartë, por në të njëjtën kohë edhe i arsyeshëm, për të konsideruar veprën penale të kryer në bashkëpunim, kur diskutohet figura e bashkëpunëtorit të paidentifikuar, është provueshmëria e anës objektive të veprës penale. Thënë kjo, duket se në çdo rast, dy apo më shumë bashkëpunëtorë, të identifikuar dhe të paidentifikuar, do të përgjigjen penalisht për veprën penale përkatëse të kryer në bashkëpunim, mjafton që nga ana objektive provohet se vepra penale është kryer nga dy ose më shumë persona. **Pyetja që lind natyrshëm është se çfarë niveli besueshmërie përfaqëson një çështje e caktuar penale sa i përket konfigurimit të anës objektive të saj, por edhe tërësisë së saj, nëse njëri prej bashkëpunëtorëve është i paidentifikuar, nëse ky i fundit nuk ka pasur dhe nuk do të ketë ndonjëherë mundësinë për të shprehur versionin apo qendrimin e vet në pjesëmarrjen ose jo në kryerjen e veprës penale në një proces me natyrë kontradiktore?!**

Sipas gjykimit tim, është i saktë e arsyeshëm argumenti për të marrë në konsideratë anën objektive të veprës penale, por është pamjaftueshme që mbi bazën e supozuar të saj, të konkludohet në përfundimin që vepra penale është kryer në bashkëpunim. Së pari, vetë provueshmëria e anës objektive të veprës penale do të ishte e dyshimtë dhe së dyti, ekzistenca e veprës penale, veçanërisht në rastet e bashkëpunimit, nuk mund të kuptohet pa anën subjektive të saj. Gjykoj se një vepër penale nuk mund të provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, në kushtet kur i dyshuari apo

---

[566] Po aty, fq.111

bashkëpunëtori është i paidentifikuar dhe rrjedhimisht nuk i është nënshtruar një procesi të rregullt ligjor, qoftë edhe nëpërmjet përfaqësimit me mbrojtës. Kjo për shkak se rrethana të anës objektive dhe subjektive të veprës penale nuk mund të provohen në rast se nuk janë shqyrtuar e debatuar gjyqësisht. Rrethana të tilla të anës objektive të veprës penale, si koha e kryerjes, sendi i përdorur, mënyra e kryerjes së veprës penale, veprimet konkrete që mund të ketë kryer secili prej bashkëpunëtorëve, rolet e tyre, etj, do të mbeteshin të dyshimta. Gjithashtu, elementë të anës subjektive si pjesëmarrja rastësore, pra, jo e qëllimtë e bashkëpunëtorit të paidentifikuar në vendngjarje, mungesa e dijenisë së tij për veprën penale që autori kryen ose do të kryejë, apo rrethana kur bashkëpunëtori i paidentifikuar mund të jetë vetë në kushtet e nevojës ekstreme për të mbrojtur të drejta dhe interesa që i cenohen atij apo të afërmve të tij, do të ishte e pamundur të shqyrtoheshin e gjykoheshin. Për rrjedhojë, gjykoj se përfundimi i mësipërm unifikues e prezumon rrethanën e bashkëpunimit në veprat penale të dyshuara të kryera nga dy persona, në rastet kur njëri prej bashkëpunëtorëve është i paidentifikuar. Në këto raste, edhe provueshmëria e anës objektive si kriter përcaktues në këtë vendim, ka të ngjarë të mos i plotësojë elementët e standardit tej çdo dyshimi të arsyeshëm. Siç është cituar në pjesë të tjera të këtij punimi, ky standard nënkupton që dyshimet duhet të çmohen në favor të të dyshuarit sipas parimit *in dubio pro reo.* Në këtë drejtim mendoj se mungesa në proces, qoftë fizike, qoftë juridike, e personit të dyshuar, rrjedhimisht, mungesa e debatit gjyqësor kontradiktor, barazisë së palëve përbën më tepër se dyshim të arsyeshëm, duke vënë në diskutim vetë vlefshmërinë e procesit. Madje më tej, definicioni i mësipërm unifikues do të passillte implikime edhe në përgjegjësinë penale të bashkëpunëtorit të paidentifikuar, i cili nëse do të përballej me një proces gjyqësor penal për të gjykuar përgjegjësinë e tij penale, do të prezumohej në proces si bashkëpunëtor në kryerjen e veprës penale, duke shkaktuar rrjedhimisht edhe ndryshimin e gabuar të barrës së provës nga një përgjegjësi e akuzës në detyrim të të pandehurit.

5.3.2.4 Vendimi unifikues mbi trafikimin e lëndëve narkotike

Prezumime gjenden edhe në disa vendime të tjera unifikuese të Gjykatës së Lartë. Me vendimin unifikues nr. 3, datë 24.01.2011 Gjykata e Lartë ka trajtuar veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal, duke analizuar njëkohësisht edhe institutin e tentativës së kësaj vepre penale. Në nenin 283/a të Kodit Penal është parashikuar se përbën trafikim të narkotikëe *importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike.* Në vendimin e mësipërm unifikues janë trajtuar dhe interpretuar jo vetëm konceptet, me anë të të cilave shfaqet trafikimi, por edhe instituti i tentativës të secilës prej formave objektive të shfaqjes së trafikimit. Në kuadër të prezumimeve nuk paraqet rëndësi themelore interpretimi i një koncepti apo instituti, por mënyra se si asociohet interpretimi me rrethanat që kërkohen të provohen për të vërtetuar kryerjen e një vepre penale. Pikërisht, kjo përbën burimin e prezumimeve, të cilat, në kuadrin e një procesi gjyqësor, faktorizohen dhe ndikojnë në përmbushjen e interesave të akuzës, përfaqësuar nga prokuroria ose të pandehurit dhe mbrojtjes.

Lidhur me trafikimin në formën e importimit, Gjykata e Lartë ka dalë në përfundimin se: "***Vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e importimit, quhet e kryer me vërtetimin e rrethanës se lënda narkotike e ka kaluar kufirin***

tokësor, ajror a detar të Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se ende mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të tranzitit. Po kështu, vepra penale quhet e kryer pavarësisht rrethanës që, lënda narkotike, pas kalimit të kufirit shtetëror apo edhe të kontrollit policor e doganor, ka mbërritur ose jo tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar". Konventat ndërkombëtare me objekt luftën ndaj trafikimit të drogave dhe kriminalitetit të organizuar përmendin nevojën e shteteve për të parashikuar në legjislacionet e tyre veprimtaritë e kundërligjshme, ndër të tilla edhe importimin, ekspertimin, tranzitimin etj. Megjithatë, mbetet në kompetencën e shteteve konfigurimi i veprave penale konkrete. Për ilustrim sjellim në vëmendje përkufizimin që Konventa e vetme mbi drogat narkotike,1961, e ndryshuar nga protokoli i vitit 1972, e cila përcakton se "*Importi" dhe "eksporti" nënkuptojnë në konotacionet e tyre respektive transferimin fizik të drogave nga një shtet në një shtet tjetër ose nga një territor në një territor tjetër të të njëjtit shtet*"[567]. Pikërisht, përmbajtja e mëtejshme e këtyre koncepteve është përcaktuar edhe në vendimin e mësipërm unifikues, duke i analizuar ato në këndvështrimin e kritereve për përgjegjësinë penale. Siç rezulton nga qendrimi unifikues për konceptin e importimit, sa i përket përgjegjësisë penale, vepra penale do të konsiderohet e kryer edhe në mungesë të disa rrethanave objektive, të përcaktuara shprehimisht nga Gjykata e Lartë. Konkretisht, *vepra penale e trafikimit të narkotikëve (neni 283/a), në mënyrën e importimit, konsiderohet e kryer, pavarësisht nëse lënda narkotike mund të mos ketë mbërritur apo të ketë kaluar në pikat kufitare e doganore, stacionet, portet dhe aeroportet e vendit përfshirë këtu zonat e tyre të tranzitit, apo nëse ka mbërritur ose jo tek personi apo destinacioni i dëshiruar nga autorët e veprës në territorin shqiptar".*

Përjashtimi i rrethanave të tilla nga konstituimi i veprës penale të trafikimit (forma e importimit), si pasojë e hapësirave në interpretimin e ligjit, përbën një prezumim që dukshëm shkon në favor të akuzës, për shkak se lehtëson barrën e provës së kësaj pale, duke mos pasur detyrim për të provuar fakte që sipas vlerësimit të Gjykatës së Lartë nuk janë thelbësore për ekzistencën e trafikimit të narkotikëve në formën e importimit. Një barrë prove e kufizuar vetëm në provueshmërinë e elementëve thelbësore të trafikimit të narkotikëve, rrjedhimisht passjell përmbushjen e standardit të të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nga ana e akuzës më lehtësisht. Ky arsyetim mishërohet edhe në përfundimin unifikues të Gjykatës së Lartë sipas të cilit: "***kriter bazë për kuptimin e zbatimin e drejtë të veprave penale të "trafikimit" sipas Kodit tonë Penal është parimi i territorit, i prekjes e përdorimit të tij, me qëllimin e realizimit në rrugë kriminale të përfitimeve, përmes hyrjes ose daljes së paligjshme të personave apo sendeve nga territori shqiptar ose kalimit të paligjshëm të tyre nëpërmjet territorit shqiptar"***. Siç rezulton, me rëndësi për konstituimin e veprës penale të trafikimit të narkotikëve është evidentimi i faktit të kalimit të paligjshëm të territorit shqiptar, madje territori fizik i tij. Në gjykimin tim interpretimi i ofruar nga Gjykata e Lartë përbën një zgjedhje pragmatiste që i ka dhënë përparësi luftës ndaj fenomenit sesa provueshmërisë së të gjithë elementëve objektivë që mund të konstatohen në këtë veprimtari të kundërligjshme, por që gjithsesi nuk vë në diskutim vlerën apo saktësinë e interpretimit. E njëjta logjikë është ndjekur në përfundimet

[567] Neni 1, germa (m) e Konventës së vetme mbi drogat narkotike,1961, e ndryshuar

unifikuese edhe në interpretimin e formave të tjera të shfaqjes së trafikimit të narkotikëve, të eksportimit, tregtimit ndërkombëtar dhe tranzitimit.

5.3.2.5 Vendimi unifikues mbi vjedhjen me pasojë vdekjen

Një vendim tjetër unifikues me interes në fushën e prezumimeve është vendimi nr. 6, datë 30.09.2011, në të cilin është interpretuar vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, sipas nenit 141 të Kodit Penal. Gjykata e Lartë ka dalë në përfundimin unifikues se: "***Vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, e parashikuar nga neni 141 i K.Penal, kur si pasojë ka ardhur vdekja e personit, por nuk është shtënë në dorë (vjedhur) pasuria e tij, do të konsiderohet plotësisht e konsumuar që nga çasti që ka ardhur si pasojë vdekja e personit, të cilit i përkiste pasuria ose ishte vënë në mbrojtje të saj, pavarësisht nga shtënia në dorë ose jo e kësaj pasurie nga subjekti i veprës penale".*** Ndërsa, në nenin 141 të Kodit Penal ku parashikohet vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen, përcakton se: ***Vjedhja e pasurisë, kur është e shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet, ose me burgim të përjetshëm***.

Siç rezulton, është i dukshëm dallimi ndërmjet përkufizimit të dhënë nga Gjykata e Lartë dhe përcaktimit që bën dispozita. Edhe pse pyetja e parë e shtruar për unifikim ka vënë në diskutim edhe institutin e tentativës së kryerjes së kësaj vepre penale, përfundimi unifikues praktikisht e ka mohuar ekzitencën e saj në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen. Ajo që është me interes në kuadër të temës që po trajtojmë, nuk është çështja nëse përfundimi i mësipërm është i drejtë ose jo, por gjykimi nëse interpretimi unifikues ka krijuar prezumim dhe nëse po, efektet e tij për palët në proces. Në gjykimin tim, konsiderata se vepra quhet plotësisht e konsumuar me ardhjen e pasojës së vdekjes së personit pavarësisht nga shtënia në dorë ose jo e pasurisë, përbën prezumim, shoqëruar edhe me faktin që sipas interpretimit unifikues nuk rezulton që kjo vepër penale të mbetet në tentativë[568]. Efekti konkret që ky prezumim ka në një proces penal është prezumimi i fajësisë së autorit për konsumimin plotësisht të veprës penale, nëse ajo provohet, duke mos i dhënë këtij të fundit të drejtën të argumentojë mundësinë e ekzistencës së tentativës, diskutim që lidhet me realizimin ose jo të vjedhjes, e që më tej merr rëndësi të veçantë në caktimin e masës së dënimit[569]. Praktikisht, sipas logjikës së këtij vendimi unifikues, në një proces penal për këtë vepër penale, tema e të provuarit do të fokusohet te objekti i dytë i kësaj vepre penale, cenimi i jetës së personit, pasi ekzistenca ose jo e veprës penale të vjedhjes nuk ka rëndësi nga pikëpamja e të provuarit.

Prezumime të tilla konsiderohen që kanë efektet më të padëshirueshme në procesin penal dhe gjykatat, veçanërisht, duhet të tregojnë kujdesin maksimal për të shmangur interpretime të tilla. Prezumimi si më sipër, ndryshe edhe nga prezumimet më të

---

[568] Pasi Gjykata e Lartë shprehet se ekzistenca e kësaj vepre penale, kërkon ardhjen detyrimisht të pasojës së vdekjes së personit:(…) "*në rastin e nenit 141 të K.Penal vepra penale e vrasjes së personit është element thelbësor i veprës penale të vjedhjes, e cila kurrsesi nuk mund të kryhet nëse nuk vjen pasoja shumë e rëndë, që është vdekja e personit".*

[569] Evidentimi i tentativës paraqet rëndësi, pasi sipas neni 23/2 të Kodit Penal, *gjykata, në varësi të shkallës së afërsisë së pasojës, si dhe të shkaqeve për të cilat krimi mbeti në tentativë, zbut dënimin dhe mund ta ulë atë nën minimumin e parashikuar nga ligji ose të caktojë një lloj dënimi më të butë nga ai i parashikuar në ligj.*

konsoliduara në procesin penal (prezumimi i pafajësisë) ka një karakter absolut, në kuptimin që nuk ka asnjë të dhënë provuese apo argument juridik që mund të evokojë në proces pretendimet për fazën e tentativës së kësaj vepre penale. Ky aspekt është cekur edhe në argumentin kundër të gjyqtarëve të pakicës të këtij vendimi unifikues, të cilët kanë theksuar se: "*Pakica çmon se vepra do te cilësohet **e kryer** atëherë kur autori ka cënuar të dyja marrëdhëniet juridike që mbron kjo dispozitë. Nuk mund të cilësohet vjedhja e pasurisë së tjetrit e kryer kur provohet se autori nuk ka mundur të realizojë deri në fund qëllimin e tij, pra pakësimin e pasurisë së tjetrit. Në rrethana të tilla, ndërkohë që vjedhja e pasurisë ka mbetur në fazën e tentativës, pasoja tjetër që kërkon dispozita e nenit 141 të K.Penal është konsumuar, pra është vërtetuar vdekja e viktimës XY*"[570].

Nga analiza e përfundimit unifikues të shumicës së këtij vendimi dhe mendimit të pakicës, mund të deduktohet, që ndryshe nga teoria e së drejtës penale dhe praktika gjyqësore, të cilat përcaktojnë unitetin e katër elementëve të figurës së veprës penale për të pasur përgjegjësi penale (veçanërisht ana objektive dhe subjektive), lidhur me faktin e vjedhjes në veprën penale të vjedhjes me pasojë vdekjen, duket se mjafton vërtetimi i elementit subjektiv (pra, dashja e qëllimi i personit për realizuar vjedhjen), ndërsa elementët objektivë, ndër të cilat edhe tentativa, janë të parëndësishëm. Ky arsyetim na shpie në prezumimin tjetër të krijuar, atë të prezumimit të ekzistencës subjektive të veprës penale të vjedhjes, çka përbën një mospërputhje të hapur me konceptin e unitetit të anës objektive me atë subjektive. Prezumime të tilla lënë shteg për shumë paradokse në procesin penal. Mund të ndodhë që autori nuk ka kryer asnjë veprim objektiv ndaj pasurisë, por në dinamikën e rrethanave të ngjarjes ka shkaktuar vdekjen e personit, pavarësisht kësaj, gjykata do të deduktojë elementin subjektiv nga fakti që autori është ndodhur/ka shkuar në një vend të caktuar, duke i atribuar në këtë mënyrë faktin e vjedhjes. Mbrojtja e të pandehurit jo vetëm do e ketë të pamundur në mënyrë absolute të pretendojë ndonjë rrethanë shfajësuese, por nuk do të jetë as e interesuar të kundërshtojë ekzistencën e një vepre, e cila nuk i provohet nga akuza, por i prezumohet se ekziston. Ky qendrim unifikues, kur shprehet se *edhe pse pasuria nuk është shtënë në dorë, por ka ardhur vdekja e personit, sërish ka vepër penale të kryer plotësisht*, nuk merr aspak në konsideratë se autori për shkak të bindjes apo arsyeve të veta (jo shkaqeve të pavarura nga vullneti i tij), aty për aty, mund të heqë dorë nga vjedhja, por në dinamikën e ngjarjes shkakton vdekjen e personit. Pikërisht, për këto arsye, vendimi unifikues do të duhet të kishte interpretuar më qartë rrethanën *kur pasuria nuk është shtënë në dorë*, se cilat ishin shkaqet apo arsyet se përse pasuria nuk u arrit të përvetësohej nga autori, së dyti të paraqiste arsyet se përse vepra penale e vjedhjes me pasojë vdekjen nuk ka fazën e tentativës dhe së treti nëse gjykata mund të ndryshojë cilësimin juridik të fakteve *nëse pasuria nuk është shtënë në dorë,* në ç'mënyrë e për cilën vepër penale.

Në përfundim, në përmbledhje të sa më lart, këto ishin disa vendime të Gjykatës së Lartë, që në gjykimin tim kanë krijuar prezumime të caktuara, me efekt në zhvillimin e procesit penal. Ajo çka rezulton e rëndësishme është nevoja për interpretim të kujdesshëm e logjik të ligjeve apo instituteve penale, pasi edhe çdo terminologji apo leksik i përdorur në mënyrë jo të përshtatshme, shkakton pasoja në secilën prej palëve të procesit dhe në vetë drejtësinë e procesit penal. Në teorinë bashkëkohore të së

---

[570] Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 30.09.2011, mendimi i pakicës

drejtës penale prezumimet synojnë shmangien e gabimeve gjyqësore dhe siç është theksuar në hyrje të kësaj pjese, limitet e tyre diktohen parimet kushtetuese dhe ligjore të procesit penal (shteti i së drejtës, ligjshmëria, prezumimi i pafajësisë etj).

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1. Legjislacioni ynë penal, procedural e material, pjesë e sistemit kontinental nuk ka ndonjë kuadër normativ specifik lidhur me konceptet e barrës së provës dhe standardit të të provuarit, për shkak se normat e funksionimit të këtyre koncepteve janë të shpërndara ndërmjet atyre pak dispozitave të ligjit dhe efekteve që ato kanë në procesin penal për shkak të jurisprudencës. Interpretimi sistematik i neneve 4, 8/a dhe 390/1 të KPrP, *këto dy të fundit të parashikuara pas ndryshimeve legjislative të vitit 2017*, mund të përcjellë një ide lidhur me mënyrën e funksionimit të barrës së provës dhe standardit të të provuarit në procesin penal. Barra e provës zbërthehet në kuptimin më të plotë të saj në gjykimin e themelit të çështjes, aty ku prokurori mbart barrën e provës të provojë fajësinë e të pandehurit. Ajo i imponon prokurorit detyrimin që edhe në hetimet parprake apo vendimmarrjet në këtë fazë të mbledhë jo vetëm provat që synojnë fajësinë e të pandehurit, por edhe ato që e shfajësojnë. Paralelisht me barrën e provës, standardi i të provuarit paraqitet në disa nivele të ndryshme në varësi të fazës konkrete të procesit penal; ai ndryshon me avancimin e fazave të procesit penal. Por, sikundër çdo rregulli të përgjithshëm, edhe rregullat mbi barrën e provës dhe standardit të të provuarit kanë përjashtimet e tyre, herë të përcaktuara nga ligjvënësi, herë të vendosura nga praktika e gjykatave.
2. Standardi i të provuarit përfaqëson shkallën e sigurisë gjyqësore dhe vërtetësisë që duhet të arrijë një vendim i organit procedues në procesin penal. Është sistemi matës i shkallës së sigurisë apo probabilitetit që provat i ofrojnë gjykatës për të pranuar si të vërteta fakte të caktuara, standardi me të cilin duhet bindur gjykata nëpërmjet provave të ofruara nga pala që mbart barrën e provës në proces, pala akuzuese. Prandaj, standardi është një sistem matës i cilësisë dhe i forcës bindëse të provave të paraqitura për të përmbushur barrën e të provuarit.
3. Standardi i të provuarit është pjesë përbërëse e parimit të prezumimit të pafajësisë. Pavarësisht se nuk parashikohet shprehimisht në Kushtetutë apo në KPrP, standardi i të provuarit ka natyrë kushtetuese, pasi ai synon të garantojë të drejtat dhe liritë e subjekteve të dyshuar në procesin penal. Gjykata Supreme e SHBA në precedentët e saj ka konfirmuar natyrën kushtetuese të këtij standardi dhe lidhjen e tij me parimin e prezumimit të pafajësisë. Në sistemin tonë juridik normat kushtetuese që përbëjnë bazën e standardit të të provuarit janë nenet 27, 30 dhe 42 të Kushtetutës. Në KEDNJ baza normative e këtij koncepti buron nga neni 6 i saj. Në KPrP baza normative e standardit të të provuarit është neni 4 dhe 390/1 i tij.
4. Standardi i të provuarit ndryshon në varësi të fazës procedurale ku gjendet procesi dhe të natyrës dhe llojit të akteve të parashikuara në KPrP. Në fazën e hetimeve paraprake standardi kryesor i të provuarit është standardi i *"dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova"*. Megjithatë, në këtë fazë në përmbushjen e akteve të ndryshme kërkohen standarde të ndryshme të të provuarit. Disa prej këtyre standardeve janë variante te standardit të dyshimit të arsyeshëm. Disa të tjera janë standarde të pavarura nga dyshimi i arsyeshëm. Në fazën e gjykimit në themel të çështjes, standardi që zbatohet është standardi i provimit të fajësisë *"përtej çdo dyshimi të arsyeshëm"*. Nëse në përfundim të gjykimit ka

dyshime në lidhje me fajësinë e të pandehurit, atëherë parimi që duhet zbatuar është parimi *"in dubio pro reo"*, pra, çdo dyshim për akuzën duhet të çmohet në favor të të pandehurit.

5. Në procesin penal standardi i të provuarit duhet të përmbushet apo të arrihet nga prokurori, për shkak se akuza mbart barrën e provës për të vërtetuar në gjykatë ekzistencën e kushteve dhe kritereve për të kryer akte të caktuara, për të kufizuar përkohësisht lirinë të dyshuarit dhe për t'u quajtur e provuar akuza dhe fajësia e të pandehurit.
6. Lidhur me kompetencën e prokurorit për regjistrimin e çdo njoftimi për veprën penale, sipas mendimit tim prokurorit nuk mund t'i mohohet diskrecioni në regjistrimin ose jo të një procedimi penal, edhe pse është e qartë se neni 287 i KPrP orienton drejt detyrueshmërisë së regjistrimit të procedimit. Në doktrinë ekziston mendimi se për të filluar procedimi penal është e nevojshme ekzistenca e të dhënave, të cilat shfaqin *dyshimin e arsyeshëm* dhe krijojnë bindjen se gjendemi përpara kryerjes së një vepre penale. Edhe nëse i referohemi sistemit të legalitetit/ligjshmërisë, mbi të cilin është bazuar edhe instituti i regjistrimit të procedimit penal në KPrP, sipas këtij sistemi pranohet se roli i prokurorit është i kufizuar në vlerësimin ligjor të mjaftueshmërisë së të dhënave në ngarkim të të dyshuarit. Diferenca me sistemin e oportunitetit nuk ka të bëjë me kufizimin ose jo të rolit të prokurorit në shqyrtimin e të dhënave për regjistrimin e një procedimi penal, por me faktin që në sistemin e oportunitetit, prokurorët marrin në konsideratë përveç të dhënave që mund të ekzistojnë në një çështje, edhe faktorë të tjerë me interes publik. Është pikërisht vlerësimi i këtyre të fundit që u ndalohet prokurorëve në sistemin e legalitetit. ***Në këtë drejtim, propozimi im për përmirësime legjislative do të konsistonte në faktin që në nenin 287 të KPrP të përcaktohej se prokurori procedon me regjistrimin e një procedimi penal, në rastet kur ekziston një dyshim i arsyeshëm mbi ekzistencën e një vepre penale.***
7. Shkalla e sigurisë apo bindjes mbi vërtetimin e rrethanave që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal duhet të jetë e tillë që ekzistenca e rrethanave të tilla të mos jetë e diskutueshme dhe të shmangen opsionet e mundshme apo të arsyeshme që tregojnë se këto rrethana nuk ekzistojnë. Në këtë kuptim, standardi i të provuarit në vendimmarrjen e mosfillimit të procedimit penal i përngjet një standardi të avancuar në procesin penal, i krahasueshëm me standardin që aplikohet në gjykimin e themelit të çështjes kur përcaktohet fajësia e të pandehurit. Nga interpretimi sistematik i nenit 287 të KPrP dhe nenit 291/1 të KPrP, kur prokurori ka dyshime të arsyeshme nëse ekzistojnë rrethanat që passjellin mosfillimin e procedimit, pra, nëse nuk është e qartë që ato ekzistojnë apo qendrojnë, atëherë prokurori, duhet të procedojë me kryerjen e verifikimeve dhe nëse këto nuk japin rezultat, me regjistrimin e procedimit penal. Sipas gjykimit tim, vendimi i mosfillimi të procedimit penal, ndërthur në të njëjtën figurë, në atë të prokurorit, kompetencat e verifikimit dhe zbatimit të barrës së provës e standardit të të provuarit me kompetencat e një gjyqtari, për shkak se disponon një vendimmarrje që duhet të arrijë një standard të lartë të të provuarit.
8. Lidhur me rrethanat e mosfillimit, konkretisht në rastin kur fakti nuk ekziston, jurisprudenca ka zhvilluar praktikën se *"Nëse fakti ekziston apo jo dhe nëse vepra është kryer nga personat e kallëzuar, ky përfundim mund të nxirret*

vetëm pasi të jenë kryer hetimet lidhur me rrethanat. Për rastin kur fakti nuk ekziston, duhen zhvilluar hetime"[571]. Ndërsa, ligji shprehet se mosfillimi në këto raste vendoset kur del **qartë** që fakti nuk ekziston. Pra, ligji ka imponuar si detyrim për prokurorin që mosfillimi vendoset **kur mosekzistenca e faktit është e qartë**, dhe kjo qartësi është e konfirmuar qoftë nga kallëzimi, qoftë nga veprimet verifikuese të kryera në kuadër të atij kallëzimi. Ky arsyetim është në përputhje me argumentin se standardi i të provuarit në rastin e vendimmarrjes së prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është i niveli të lartë bindës. Duhet theksuar se kjo pjesë e normës ka mbetur e pandryshuar edhe nga reforma legjislative e vitit 2017, çka do të thotë se ligjvënësi nuk e ka përkrahur qasjen e jurisprudencës. ***Në këtë drejtim propozimi im për jurisprudencën është që qendrimi i mësipërm, duhet të zbatohet për rastet kur për mosekzistencën e faktit ka paqartësi, pra, kur ka dyshime të arsyeshme se ai mund të ekzistojë, në këtë rast, prokurori ka detyrimin për regjistrimin e procedimit penal sipas nenit 287 të KPrP.***

9. Çështja e pozitës së subjektit që i nënshtrohet hetimit ka qenë objekt i trajtimit nga Gjykata e Lartë përmes jurisprudencës së saj në dy vendime unifikuese, ku janë diferencuar figurat e personit të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale, personi ndaj të cilit zhvillohen hetime dhe i pandehuri. Sipas kësaj jurisprudence "*Këto emërtime nuk përfaqësojnë të njëjtën gjë dhe nuk kanë të njëjtin kuptim*". Edhe pse sipas kësaj jurisprudence sqarohet se autori i mundshëm mund të paraqitet në disa figura procedurale, në të nuk ofrohet një trajtim i hollësishëm i arsyeve apo shkaqeve që kushtëzojnë këto figura të ndryshme procedurale. ***Në këtë drejtim, propozimi im për permirësime legjislative, duke qenë se jurisprudenca e ka mbajtur qendrimin e saj të përsëritur për dallimin ndërmjet të tre figurave procedurale, do të ishte që të kishte një ridimensionim të pozitës së personit që i nënshtrohet hetimit, në drejtim të përcaktimit, së pari të të dhënave provuese që justifikojnë pozitën e personit nën hetim dhe personit të cilit i atribuohet kryerja e veprës penale dhe së dyti të rasteve apo mundësive se kur do të aplikohen masa të cilat kufizojnë liri apo të drejta të individit për këto subjekte sipas cilësisë së tyre.*** Praktika dëshmon raste të shumta, sipas meje në shkelje të frymës së ligjit, kur masat e sigurimit/përgjimet/kontrollet kërkohen nga prokurori dhe caktohen nga gjykata, në mungesë të të dhënave provuese ndaj personit që i nënshtrohet hetimit, duke krijuar në fakt, në të kundërt nga ajo çfarë pritet nga hetimet, efektin e dëmtimit dhe dështimit të tij.
10. Në lidhje me arrestimin e detyrueshëm në flagrancë, si akt i kryer me iniciativë të policisë gjyqësore, kushti i domosdoshëm i parashikuar nga KPrP, është ekzistenca e gjendjes së flagrancës. Ndonëse gjendja e flagrancës është një gjendje perceptimi e drejtpërdrejtë e faktit kriminal, *ictu oculi*, standardi minimal i *njaftueshëm* që legjitimon arrestimin në flagrancë është dyshimi i arsyeshëm. Ekzistenca e gjendjes së flagrancës e prezumon standardin e dyshimit të arsyeshëm, në përputhje me nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së. Në rastin e arrestimit fakultativ në flagrancë (neni 251/2), përveç ekzistencës së gjendjes së flagrancës, ligjvënësi nuk përcakton kritere të tjera shtesë. Kjo do të thotë që policia gjyqësore ka një lloj diskrecioni për të vlerësuar, rast pas rasti, cenimin e lirisë në raport me qëllimin e ligjshëm të

[571] Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 65, datë 30 Janar 2002.

ndjekur, pra, interesin publik. Kriteret që duhet të vlerësojë policia gjyqësore janë *"rëndësia e faktit"* dhe *"rrezikshmëria e subjektit"*.

11. Në lidhje me ndalimin e të dyshuarit për një krim kërkohet ekzistenca e njëkohshme e dy kushteve: *dyshimi se personi është autor i një krimi* që dënohet jo më pak se dy vjet burgim dhe *ekzistenca e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes së tij.* Në KPrP nuk përcaktohet shkalla e standardit të dyshimit se personi është autor i një krimi. Megjithatë, standardi i dyshimit tek ndalimi duhet të interpretohet si *dyshim i arsyeshëm i bazuar në prova*, në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së dhe Gjykatës Kushtetuese. Standardi tjetër që duhet të plotësojë prokurori për vlefshmërinë e ndalimit të të dyshuarit për kryerjen e një krimi, është ai i provueshmërisë së *shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes së të dyshuarit*. Standardi i shkaqeve të bazuara që tregojnë rrezikun e ikjes së të dyshuarit konsiston në ekzistencën e të dhënave objektive, që çojnë në konkluzionin se i dyshuari ka rrezik të ikë. Nuk mund të konsiderohen shkaqe të bazuara supozimet, rrezikshmëria e veprës penale dhe personaliteti i të pandehurit. Si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, ndalimi mund të kryhet edhe me iniciativë të policisë gjyqësore. Në këtë rast standardet që duhet të përmbushen janë të njëjta me rastet e zakonshme kur ndalimi kryhet me urdhër të prokurorit. Megjithatë, policia gjyqësore duhet të evidentojë kriterin e gjendjes së ngutshme që e detyroi të vepronte me iniciativë dhe të mos priste urdhrin e prokurorit. ***Në këtë drejtim, propozimi im për permirësime legjislative, do të ishte që veprimi procedural i ndalimit, si në rastin e vendimmarrjes së prokurorit, ashtu edhe nëse kryhet me iniciativë të policisë gjyqësore, e cila gjithsesi nuk mund ta kryej këtë veprim pa marrë më parë miratimin e prokurorit, të kryhej nëse ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se personi ka kryer një krim, përpos standardit tjetër të shkaqeve të bazuara të rrezikut të ikjes.***
12. Në caktimin e masave të sigurimit standardi i të provuarit është *"dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova"*. Në procesin për caktimin e masës së sigurimit, si masë e përkohshme, janë të mjaftueshme dyshimet e bazuara në nivelin e arsyes, të pranueshme nga njeriu me një logjikë normale, që gjykon paanshmërisht. Standardi i *"dyshimit të arsyeshëm"* se është kryer një vepër penale, i referuar në nenin 5/1(c) të KEDNJ-së, presupozon *ekzistencën e fakteve ose informacioneve që do të bindin një vëzhgues objektiv* se *personi në fjalë mund të ketë kryer një vepër penale*. Kriteret parametrike që përcaktojnë këtë standard janë:

a. Të ekzistojnë fakte që tregojnë se i dyshuari mund të ketë kryer një vepër penale,
b. Këto fakte dhe informacione të krijojnë bindjen tek një vëzhgues objektiv,
c. Dyshimi të jetë i arsyeshëm.

13. Ky standard nuk është e nevojshme të tregojë bindjen, që krijohet nga provat e marra dhe të shqyrtuara në përputhje me kërkesat e ligjit, të cilat në unitetin e tyre, tregojnë se vepra ka ndodhur dhe se ajo është kryer nga ai që akuzohet. Jurisprudenca e fundit e Gjykatës së Lartë thekson se dyshimi i arsyeshëm, provat ku ai bazohet për të justifikuar caktimin dhe vijimin e zbatimit të masës së sigurimit, nuk nevojitet të ketë të njëjtën shkallë sigurie dhe vlerë provueshmërie për të konkluduar, sikurse provat që janë të domosdoshme për dhënien ose jo të vendimit të dënimit ndaj të pandehurit. Mjafton që ato të jenë të tilla që, në gjendjen ku janë aktet e procedimit, prej tyre të mund të nxirren

përfundime se ndaj të hetuarit ekziston një *shkallë e arsyeshme mundësie e fajësisë* për kryerjen e veprës penale që i ngarkohet.

14. Një tjetër standard i rëndësishëm që normon KPrP është standardi i *""të dhënave të mjaftueshme për marrjen e një personi në cilësinë e të pandehurit"*. Neni 34, duke pranuar si bazë për marrjen e një personi si të pandehur ekzistencën e të dhënave të mjaftueshme në lidhje me kryerjen e një vepre penale, me këtë formulim përcakton se si kriter, për vënien e një personi para përgjegjësisë penale, shërben ekzistenca e provave. Është prokurori që vlerëson përmbushjen këtij standardi. Bindja e prokurorit ka karakter probabilistik; nuk kërkohet që provat të krijojnë një bindje të palëkundur, por një shkallë të lartë dhe të arsyetuar probabiliteti, se personi i dyshuar e ka kryer veprën penale dhe duhet një proces gjyqësor për provimin e fajësisë. Standardi i të dhënave të mjaftueshme për marrjen si i pandehur është i ngjashëm me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, përderisa bindja paraprake e prokurorit ka karakter probabilistik. Megjithatë, në këtë rast standardi për marrjen e një individi të pandehur kërkohet që të përmbushë një standard më të lartë se ai që zbatohet në caktimin e masave të sigurimit; të dhënat provuese duhet të mjaftojnë për të krijuar një bazë të arsyeshme për t'i hapur rrugën fazave të mëtejshme të procesit.
15. Standardi që duhet të plotësohet për pranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjyq të çështjes penale, është ekzistenca e *"provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës"*. Në ndryshim nga konceptimi i fazës së hetimit paraprak dhe përfundimit të kësaj faze, përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, ku kërkohej zbatimi i standardit të provave të plota për fajësinë e të pandehurit, aktualisht hetimi paraprak ka një karakter më probabilitar, që rrjedhimisht i transmetohet edhe gjykatës së themelit, duke e ngarkuar atë me detyrimin për të vendosur mbi probabilitetin e ekzistencës ose jo të fajësisë së të pandehurit. Në një kuptim tjetër, jo domosdoshmërisht të lidhur ngushtësisht me kuptimin procedural të procesit, por më shumë me oportunitetin e procesit penal, vlerësoj se është shpërndarë dhe relativizuar përgjegjësia e organeve proceduese (prokuroria dhe gjykata) në aspektin e zbatimit të duhur të legjislacionit penal. Nëse me reformën legjislative të vitit 2017, objektivi i dëshiruar nga ligjvënësi ka qenë padyshim minimizimi i gabimeve në procesin penal, përcaktimi i standardeve të të provuarit të niveleve të ulta në fazën e hetimit paraprak, shoqëruar me kompetenca jo të qarta të prokurorit dhe gjyqtarit të seancës paraprake, kanë gjasa që të kenë efektin e kundërt në praktikën gjyqësore. Në këtë pikë do të rekomandoja që të ndërmerreshin nisma ligjvënëse për të shqyrtuar kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake dhe prokurorit në fazën e përmbylljes së hetimeve, për shkak se nga pikëpamja e standardeve të të provuarit, kjo fazë e procesit ka krijuar kontradikta të shumta, një ndër të cilat është humbja e efektit të parimit *in dubio pro reo*.
16. Në kërkesën për pushim objekti i shqyrtimit është vërtetimi i mungesës së elementëve që përbëjnë faktin penal apo që e përjashtojnë të pandehurin nga përgjegjësia penale. Duke qenë se standardi i aplikuar në rastin e dërgimit të çështjes në gjykim nuk përfaqëson standardin më të lartë të procesit penal, duke nënkuptuar se pranohen edhe dyshimet e arsyeshme rreth këtij standardi (pra që i referohen mundësisë që fakti penal nuk është i tillë si ai i përshkruar nga prokurori apo se i pandehuri ka rrethana që mund ta përjashtojnë nga përgjegjësia penale), prej kësaj rrjedh se kërkesa për pushimin e procedimit

penal nuk mund të bazohet/pranohet mbi dyshime të arsyeshme në favor të të pandehurit, për shkak se në një rast të tillë çështja mund të ndodhë që të ketë njëkohësisht mjaftueshmërisht prova për t'u dërguar në gjykim, çka passjell që shkaqet e pushimit duhet të provohen me një standard relativisht të lartë të të provuari, në mos të provohen katërcipërisht. Sipas konceptimit të seancës paraprake, siç është cituar edhe në përfundimin e mësipërm, parimi *in dubio pro reo* qartazi nuk gjen aplikim në seancë paraprake në mënyrën se si është ndërtuar kjo pjesë e KPrP.

17. Sa më sipër, nëse kryejmë një permbledhje skematike të problematikave të konstatuara në seancën paraprake rezulton se:

- *Standardi i të provuarit i aplikuar në dërgimin e çështjes në gjyq është ai i provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, në ndryshim nga vendimmarrja e prokurorit përpara ndryshimeve legjislative të vitit 2017, kur standardi i aplikuar ishte ai i provave të plota për fajësinë e të pandehurit.*
- *Ky standard i provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës nuk është i barabartë me standardin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.*
- *Standardi i provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës e nënkupton që së bashku me të mund të bashkëekzistojë edhe dyshimi i arsyeshëm.*
- *Nëse gjendet përballë vlerësimit të standardit të dyshimit të arsyeshëm në favor të të pandehurit dhe atij të provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës, gjykata do të zbatonte këtë të fundit dhe do ta dërgonte çështjen në gjykim.*
- *Gjykata mund të vendosë pushimin e çështjes gjatë shqyrtimit të kërkesës së prokurorit për dërgimin në gjyq të çështjes vetëm nëse shkaku i pushimit rezulton haptazi i qartë, prima facia dhe nuk ka nevojë për hetime të tjera.*
- *Kërkesa e prokurorit për pushimin e procedimit penal ka vend atëherë kur të dhënat e mbledhura gjatë hetimeve paraprake nuk rezultojnë të mjaftueshme për mbështetur akuzën në gjykim, çka më tej shërben për të dalë në përfundimin që standardi i aplikuar në këtë proces duhet të jetë i një niveli më bindës se dyshimi i arsyeshëm lidhur me ekzistencën e shkaqeve të pushimit të procedimit.*

  Nga sa më sipër, rezulton një kontradiktë e thellë logjike, ku parimi *in dubio pro reo* nuk gjen zbatim as në qendrimin e gjykatës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe as në kërkesën e prokurorit për pushimin e procedimit penal, ku rrjedhimisht shkaqet e pushimit duhet të provohen mbi standardin e dyshimit të arsyeshëm. Nga praktika e deritanishme e zbatimit të standardeve të mësipërme, rezulton që procesi penal nuk ka ofruar ndonjë shkallë të lartë sigurie, e për rrjedhojë të mënjanojë gabimet gjyqësore, përkundrazi siç e kemi cituar edhe më lartë, ka fituar tiparet e një procesi probabilitar. ***Sipas gjykimit tim, në kuadër të propozimeve për përmirësime të mundshme ligjore, do të ishte e nevojshme që të prekej disi arkitektura e seancës paraprake, duke u hequr nga kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake shqyrtimi i kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq, por çështja të dërgohej automatikisht në gjykim me kërkesë të prokurorit dhe paralelisht standardi i provave të mjaftueshme në mbështetje të akuzës duhet të zëvendësohet me një standard të një shkalle më të lartë sigurie dhe bindje, i tillë që të përjashtojë dyshimin e arsyeshëm nga ekzistenca e tij. Ndërsa, të ruhej formati aktual për kërkesën për pushim, ku urdhërimi i gjykatës për dërgimin në gjyq të kishte një karakter përjashtimor.***

18. Rast përjashtimor përbën urdhërimi i gjykatës për prokurorin më qëllim që ky i fundit të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur gjyqtari i seancës paraprake çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq. Kjo është një risi e prezantuar me ndryshimet legjislative të vitit 2017 dhe është një vendimmarrje që kryhet nga gjyqtari i seancës paraprake gjatë vlerësimit të kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal (ose mbi ankimin ndaj vendimit të pushimit për kundërvajtje penale). Në këtë normë përmbahen paradoksalisht dy veprime procedurale të ndryshme që karakterizohen nga standarde të ndryshme të të provuari, pra, ligjvënësi ka paraqitur në të njëjtën normë detyrimin për të ngritur akuzë dhe për të paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq. ***Në kuadër të propozimeve për ndryshime legjislative, por edhe në varësi të përfundimeve në pikën 16 si më sipër, sipas gjykimit tim, duke qenë se qëllimi i gjyqtarit të seancës paraprake në këtë rast është dërgimi i çështjes në gjyq, për shkak se i rezulton që ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq, e bën të panevojshme parashikimin në pjesën e parë të dispozitës, në të cilën kërkohet edhe formulimi i akuzës, pasi ky është një veprim procedural i detyrueshëm për prokurorin për t'u kryer në rast të dërgimit të çështjes në gjykatë, pra, nuk është çështje fakultative në vullnetin dhe vlerësimin e prokurorit.*** Një parashikim i tillë besoj se do të shmangte dhe dilemat lidhur me kushtetutshmërinë ose jo të kësaj dispozite. Gjithashtu, njoftimi i akuzës duhet të kuptohet si atribut ekskluziv i organit të akuzës, për më tepër që sipas nenit 329/4 të KPrP, Gjykata nuk mund të urdhërojë prokurorin që të formulojë akuzë për persona të tjerë, emri i të cilëve nuk është regjistruar sipas nenit 287 të këtij Kodi.
19. Për lejimin e përgjimit KPrP kërkon plotësimin e dy kushteve. Përgjimi lejohet nëse ai është *"i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara"* dhe *"kur ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova"*.
20. Kontrolli përbën një nga mjetet kryesore të kërkimit të provës. Ai kryhet në bazë të vendimit autorizues të gjykatës dhe standardi i të provuarit që kërkohet për marrjen e një vendimi të tillë është ekzistenca e *"arsyeve të bazuara"* për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale. Standardi i arsyeve të bazuara për nga niveli i provueshmërisë që kërkon, barazohet me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Rregulli i vendosur i shërben qëllimit të garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të individëve, lidhur me privatësinë dhe integritetin fizik. Si përjashtim nga rregulli, nëse kontrolli kryhet me iniciativë të policisë gjyqësore, përveç standardit të arsyeve të bazuara, kërkohen si parakushte shtesë edhe ekzistenca e gjendjes së flagrancës apo rrezikut të ikjes, si edhe gjendja e urgjencës.
21. KPrP parasheh tri forma sekuestrimesh:
    a- Sekuestrimet si mjet për kërkimin e provës. - Standardi i kërkuar për vendimmarrjen është *"ekzistenca e arsyeve të bazuara për të menduar që këto sende kanë lidhje me veprën penale"*. Ky standard barazohet me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova. Edhe në rastet kur sekuestrimi i korrespondencës bëhet me urdhër të prokurorit apo me iniciativë të policisë gjyqësore, *standardi i ekzistencës së arsyeve të bazuara* mbetet i paprekur.

b- Standardi i të provuarit që zbatohet në vendimmarrjen për sekuestron preventive dhe konservative është dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova.

c- Në rastin e sekuestrimit si masë parandaluese zbatohet standardi i dyshimit të bazuar në indicje. Ky standard është i ndryshëm nga standardet e zbatuara në procesin penal, sepse ky akt është pjesë e procesit parandalues dhe jo e procesit penal. Një standard i tillë i një niveli të ulët është parashikuar nga ligjvënësi me ligj të posaçëm, me qëllim luftën ndaj krimit të organizuar. Ai është në përputhje me qëndrimin e GJEDNJ-së dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, të cilat kanë theksuar se në procesin parandalues nuk aplikohet parimi i prezumimit të pafajësisë.

22. Në fazën e gjykimit standardi i të provuarit që zbaton gjykata, kur i pandehuri duhet të deklarohet fajtor, është standardi i fajësisë *"përtej çdo dyshimi të arsyeshëm"*. Ky standard është pjesë thelbësore e parimit të prezumimit të pafajësisë. Në rastin kur gjykata e shpall të pandehurin të pafajshëm, ajo nuk duhet të bindet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përfaqëson shkallën më të lartë të sigurisë gjyqësore që mund të arrijë një vendim gjykate.
23. Standardi i fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm e ka origjinën në sistemin Common Law, të përfaqësuar nga SHBA, Britania e Madhe dhe vendet e Komonuelthit. Legjislacioni italian e ka pranuar këtë standard në KPrP italiane. Gjithashtu, jurisprudenca e gjykatave gjermane dhe franceze është drejtuar drejt zbatimit të standardeve të ngjashëm me të, por ligjvënësit ende nuk i kanë kodifikuar në të drejtën e brendshme. Nga praktika e gjykatave tona rezulton se ende nuk ka një kuptim të qartë të këtij standardi.
24. Standardi i fajësisë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nuk përfaqëson sigurinë absolute të vendimit gjyqësor. Në këtë kuptim, standardi nuk mund t'i shmangë të gjitha dyshimet, që janë të pabazuara apo të paarsyeshme. Standardi nuk përmbushet nëse dyshimet ngrihen në nivelin e dyshimeve të pranueshme nga arsyeja e zakonshme njerëzore. Nga ana tjetër, kur ekziston një dyshim i arsyeshëm në lidhje me fajësinë e të pandehurit, ai duhet të shpallet i pafajshëm nga gjykata. Në këtë rast zbatohet parimi i njohur *in dubio pro reo*. Dyshimi në favor të të pandehurit shpreh idenë se kur paraqiten shumë zgjidhje të barabarta parapëlqehet zgjidhja më e favorshme për të pandehurin.
25. Një aspekt i rëndësishëm i prezumimit të pafajësisë është rregulli i barrës së provës. Në KPrP nuk parashikohet se kujt i ngarkohet në procesin penal barra e provës së fakteve të caktuara, si dhe e fajësisë së të pandehurit, megjithatë nënyrë implicite rezulton nga interpretimi sistematik i neneve 8/a dhe 390/1 të KPrP që barra e provës rëndon mbi akuzën. Gjithsesi, është e gjithëpranuar se organi i akuzës *ka barrën e pro*vës të provojë të gjithë faktet të cilët ngarkojnë të pandehurin me përgjegjësi penale. Jurisprudenca e GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë është shprehur se i pandehuri nuk mund të detyrohet të provojë pafajësinë e tij. Prokurori, si përfaqësues i shtetit, mbart barrën për të provuar akuzën në gjyq. Barra e provës në ngarkim të prokurorit rezulton edhe nga fakti se i akuzuari prezumohet i pafajshëm, prezumim që duhet të rrëzohet nga akuza. Si rregull, prokurori nuk ka detyrimin të provojë mosekzistencën e fakteve apo rrethanave që shfajësojnë të pandehurin.

26. Në doktrinë, kryesisht në atë të huaj, diskutohen rastet kur i pandehuri ka barrën e provës. Në legjislacionin tonë penal ka vetëm disa raste përjashtimore kur i pandehuri, ndonëse nuk ngarkohet me barrën e provës, mbart barrën e pretendimit të rrethanave përjashtimore (mbrojtja e nevojshme, nevoja ekstreme, tronditja e fortë psiqike, etj.). Megjithatë, ai nuk ka asnjë detyrim të paraqesë prova, për shkak se përfiton nga prezumimi i pafajësisë dhe mungesa e detyrimit për të bashkëpunuar me autoritetet. Nga ana tjetër, sapo i pandehuri ka ngritur disa pretendime të arsyeshme, të cilat e shmangin ose e lehtësojnë përgjegjësinë e tij penale, detyrimet e akuzës zgjerohen. Asaj i duhet të provojë, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, se pretendimet e të pandehurit nuk janë të bazuara, duke rrëzuar versionin e të pandehurit.
27. Një përjashtim tjetër i barrës së provës është rasti i sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë në përputhje me ligjin *"Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"*. Procesi që zhvillohet sipas këtij ligji nuk konsiderohet proces penal, por procedim parandalues, me natyrë civile. Si i tillë, në këtë procedim nuk aplikohet parimi i prezumimit të pafajësisë. Barra e provës është e ndarë ndërmjet akuzës dhe të dyshuarit, sipas rregullave të procedurës civile. Akuza ka barrën e provës të provojë sipas standardit të dyshimeve të arsyeshme, të bazuara në indicje, se burimet financiare të të dyshuarit kanë prejardhje të paligjshme. Nga ky çast barra e provës mbartet tek i dyshuari, i cili kërkohet të rrëzojë pretendimin e akuzës dhe të provojë burimet e ligjshme të pasurisë së tij.
28. Ligji nuk përcakton standardin e të provuarit që duhet të përmbushë i dyshuari për të bindur gjykatën se prejardhja e pasurive të tij është e ligjshme. Ky aspekt nuk ka gjetur rregullim as me ndryshimet ligjore të kryera në ligjin e mësipërm përgjatë vitit 2017. Sipas vlerësimit tim, mospërcaktimi i një standardi të provuari për të dyshuarin, shkakton një shpërpjestim të theksuar ndërmjet pozitës së favorshme të organit të akuzës dhe pozitës së të dyshuarit, e cila vijon të mbetet e paqartë. Përgjatë punimit kam sugjeruar që standardi i të provuarit në çështjet civile, ai i balancës së probabiliteteve duket të jetë standardi më i përshtatshëm, që nuk e cenon këtë lloj procedimi me karakter pasuror, parandalues, por nga ana tjetër nuk e ngarkon të dyshuarin me një barrë dhe standard të provuari që është i pajustifikuar logjikisht. ***Në këtë drejtim, në kuadër të propozimeve për përmirësime legjislative, gjykoj se është e nevojshme një ndërhyrje ligjvënëse për të disiplinuar këtë standard. Sa i përket propozimeve për jurisprudencën, në kushtet e mungesës së ndryshimeve ligjore, në gjykimin e rasteve konkrete, duhet të synohet që të zbatohet parimi i proporcionalitetit, ndërmjet nevojës për luftën ndaj kriminalitetit dhe moscenimit të thelbit të së drejtës së pronës.***
29. Vlerësimi i provave është një atribut që u takon gjykatave të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të apelit. Vlerësimi apo çmimi i provave është i lirë, pa kushte dhe kufizime, në përputhje të plotë me rrethanat konkrete të çështjes në shqyrtim. Provat, bazuar në teorinë e çmuarjes së lirë, nuk kanë vlerë të paracaktuar ligjore, por marrin vlerën e tyre, si rregull, pasi debatohen në shqyrtimin gjyqësor. Është gjykata që përcakton vërtetësinë dhe fuqinë provuese të secilës provë. Në këtë kuptim, nuk është konform parimit se provat nuk kanë vlerë të paracaktuar, praktika gjyqësore që përcakton se një provë e vetme nuk mjafton për fajësinë e të pandehurit. Një praktikë e tillë cenon parimin e vlerësimit të provës sipas bindjes së brendshme të gjyqtarit,

duke u dhënë atyre vlerë të paracaktuar. Është e nevojshme që praktika gjyqësore të orientohet në drejtimin që fajësia e të pandehurit mund të përcaktohet edhe nga një provë e vetme, nëse pas debatit kontradiktor rezulton se kjo provë provon tej çdo dyshimi të arsyeshëm se i pandehuri e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

30. Gjykata i vlerëson provat në bazë të bindjes së brendshme, e cila kufizohet nga parimi kushtetues i arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Arsyetimi i gjykatës duhet të jetë në çdo rast logjik dhe i mbështetur në provat e shqyrtuara. Në arsyetimin e gjykatës duhet të pasqyrohen edhe arsyet se pse gjykata i konsideron të papranueshme provat e kundërta. Gjithashtu, standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përbën kufizim për bindjen e brendshme të gjyqtarit. Standardi i përtej çdo dyshimi të arsyeshëm përfaqëson kufirin e lirisë së bindjes së gjyqtarit, në mënyrë që përfundimi i procesit të mos varet nga vlerësime diskrecionale, subjektive dhe arbitrare.
31. Në lidhje me vlerësimin e indicjeve, duhet theksuar se, për të provuar ekzistencën e një fakti, ato duhet të jenë të sakta, të rëndësishme dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Në mungesë të normave pozitive, theksojmë se kriteri i rëndësisë nënkupton që indicja duhet të jetë e qëndrueshme ndaj kundërshtive dhe të krijojë një shkallë të lartë bindjeje në drejtim të ekzistencës së faktit të panjohur që synohet të provohet. Me saktësi të indicjes duhet të kuptohet cilësia e saj për të orientuar drejt një fakti të caktuar dhe që nuk lejon interpretimin në drejtime të tjera. Midis tyre duhet të ketë përputhje, ato nuk duhet të përjashtojnë njëra-tjetrën, në kuptimin që çmuarja e tyre bashkërisht duhet të çojë drejt të njëjtit përfundim logjik.
32. Zgjidhja e ofruar deri më tani nga praktika gjyqësore mbi provën e vetme, sipas së cilës nëse ka vetëm një provë, kjo nuk mund të shërbejë për përcaktimin e fajësisë, është një zgjidhje sipërfaqësore dhe në të njëjtën kohë bie ndesh me parimin e lirisë së vlerësimit të provave, të bindjes së brendshme të gjykatës dhe e orienton provueshmërinë drejt vlerës sasiore të provave sesa drejt aspektit cilësor të tyre. Në drejtim të kuptimit të konceptit të provës së vetme në procesin penal, e gjej me vend të sjell në vëmëndje praktikën e fundit të Gjykatës së Lartë e cila është shprehur se: Vendimi penal mund të mbështetet dhe në një provë të vetme, nëse kjo është vendimtare për zgjidhjen e çështjes. Duhet theksuar që, nëse ekzistenca e faktit nuk mund të nxirret me siguri vetëm nga një indicje, ligji nuk vendos kufizime për vërtetimin e fakteve nga një provë e vetme. Sigurisht që kërkohet një analizë e kujdesshme e provës, në drejtim të besueshmërisë së burimit. ***Në kuadër të propozimeve për jurisprudencën, do të sugjeroja që gjatë marrjes së provave, të evidentuara në proces si prova të vetme, të respektohen të drejtat e mbrojtjes dhe kontradiktoriteti, duke i dhënë mundësi të pandehurit që të vendosë në dyshim besueshmërinë e provës dhe vërtetësinë e saj.***
33. Përjashtime të barrës së provës dhe standardit të të provuarit konsiderohen edhe prezumimet. Prezumimet në procesin penal janë të krijuara nga ligji ose nga praktika e gjykatës. ***Në kuadër të propozimeve për jurisprudencën, do të sugjeroja që Gjykata e Lartë duhet të jetë e kujdesshme në interpretimet jurisprudenciale për të mbajtur në konsideratë shmangien e krijimit të prezumimeve me karakter absolut, të cilat në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ dhe legjislacionin e BE janë të ndaluara, për shkak se ato nuk ruajnë baraspeshën apo drejtpeshimin e duhur ndërmjet interesave të individit dhe interesave të shtetit e publikut. Në kuadër të propozimeve për***

përmirësime legjislative, sugjeroj që në KPrP të përcaktohet një kuadër normativ lidhur me prezumimet, ku të përcaktohen si lejueshme prezumimet ligjore relative dhe prezumimet e faktit, pra, të tilla, që i krijojnë mundësinë palës kundër së cilës operojnë, t'i kundërshtojë ato.

34. Standardi i të provuarit në procesin penal ndryshon nga standardi që zbatohet në procesin civil. Në procesin civil standardi që aplikohet është ai i balancës së probabiliteteve. Sipas këtij standardi, arrin të marrë një vendim në favor të saj, ajo palë e procesit gjyqësor civil, e cila bind gjykatën se versioni i saj ka mundësi të jetë më i vërtetë se ai i palës tjetër. Standardi i zbatuar në procesin civil është i një niveli më të ulët se ai i zbatuar në procesin penal. Në vlerësimin e probabiliteteve, gjykata mban parasysh se, sa më i rëndësishëm të jetë pretendimi, aq më pak mundësi ka që ai të jetë i vërtetë dhe, për rrjedhojë, aq më bindëse duhet të jenë provat e paraqitura në mënyrë që gjykata të konkludojë se pretendimi është vërtetuar sipas standardit të balancës së probabiliteteve. Megjithatë, standardi i balancës së probabiliteteve nuk duhet kuptuar si një standard që ndryshon në varësi të rrethanave dhe rëndësisë së çështjes, por se këto elementë janë pjesë e shqyrtimit që bën gjykata për të përcaktuar mundësinë e vërtetësisë së njërit apo tjetrit version.
35. Ndërthurja e standardit penal të të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm me atë civil të balancës së probabiliteteve passjell rrjedhoja në rastin e padisë civile në procesin penal. Në rastin kur i pandehuri deklarohet fajtor, zgjidhja e kuptueshme është pranimi i padisë civile. Nëse i pandehuri deklarohet i pafajshëm, si rregull, padia civile rrëzohet. Sipas ligjit, përbën përjashtim rasti kur fakti nuk parashikohet si vepër penale ose kur vendoset pushimi i çështjes sipas nenit 387 të KPrP, ku padia civile lihet e pashqyrtuar. Në këtë rast i dëmtuari ka të drejtë të ngrejë padi përsëri në gjykatën civile. Këto parashikime ligjore nuk janë në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila ka njohur mundësinë, që pavarësisht deklarimit të pafajshëm të të pandehurit, i dëmtuari ka të drejtë të dëmshpërblehet civilisht në të njëjtin proces që është gjykuar vepra penale. Ky konkluzion del si rezultat i faktit se në gjykimin civil kërkohet një standard më i ulët i të provuarit (balanca e probabiliteteve). Në këtë këndvështrim, sugjerojmë një ndërhyrje legjislative për përafrimin e KPrP me jurisprudencën e GJEDNJ-së. Në këtë drejtim propozimi im për përmirësime legjislative, do të ishte që, ***rastet e vetme se kur duhet të rrëzohet padia civile është rasti kur gjykata shprehet se rezulton e provuar se i pandehuri nuk e ka kryer veprën penale, si edhe rasti kur fakti nuk ekziston, në çdo rast tjetër, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ, në parim, padia civile nuk duhet të rrëzohet thjesht për faktin e deklarimit të pafajësisë, por duhet të shqyrtohet dhe pas këtij shqyrtimi të përcaktohet themeltësia dhe bazueshmëria e saj, në ligj dhe në prova.***

BIBLIOGRAFI

Libra

1. Alessandro Simoni, Sokol Sadushi, Sokol Çomo, Vështrim krahasues mbi procedurën civile, Tiranë 2006
2. Barbara J. SHAPIRO, Beyond Reasonable Doubt and Probable Cause: Historical Perspectives on the Anglo-American Law of Evidence, Berkeley, University of California Press, 1991.
3. BORELLI-BRANCACCIO, Codice di procedura penale operativo, VI edizione, Edizoni Siomone, giugno 2010.
4. Cherif BASSIOUNI, Scienza e processo penale: Linee guida per l'acquisizione della prova scientifica, Istituto Superiore Internazionale Di Scienze Criminali, a cura di Luisella de Cataldo Neuburger, CEDAM, 2010.
5. Donna GOMIEN, Udhëzues i shkurtër i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Botim i Këshillit të Europës, edicioni i tretë, maj 2005.
6. Dhimitër LARA, Koment mbi Kodin e Procedurës Penale, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010.
7. Dhimitër Lara, Koment mbi Procedurën Penale, Botimet Morava, Tiranë 2019
8. Prof.Dr. Ejup SAHITI, Argumentimi në procedurën penale, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë, 2006.
9. Ejup Sahiti, Rexhep Murati, Xhevdet Elshani, Komentar i Kodit të Procedurës Penale, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Prishtinë, dhjetor 2014
10. Fondacioni Konrad Adenauer, Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Kushtetuese Federale gjermane, Vinsent-Grafika, Shkup Maqedoni, 2010
11. Frank.N MILLER, Robert.O DAWSON, George.E DIX, Raymond.I Parnas, Criminal justice administration- cases and materials, Third edition, The Foundation Press, Inc, Mineola, Neë York, 1986.
12. Giovanni CONSO, Vittorio GREVI, Commentario breve al codice di procedura penale, 7 edizione, CEDAM, 2011.
13. Grup autorësh, Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri, Luarasi University Press, Botim i katërt, Tiranë, 2007.
14. Halim ISLAMI, Artan HOXHA, Ilir PANDA, Procedura penale, Botimet Morava, Tiranë, 2007.
15. Prof.Dr.Ismet ELEZI, Prof.Dr.Skënder KAÇUPI, Prof.As.Dr.Maksim R HAXHIA, Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, Pjesa e Përgjithshme, Geer, Tiranë 2006.
16. James Q.WHITMAN, The Origins of Reasonable Doubt, Yale Law School, Faculty Scholarship Series, Paper 1, 2005.
17. Dr.Jorgo DHRAMI, I pandehuri dhe prokurori, Tiranë 2011.
18. Karim A.A KHAN, Caroline BUISMAN, Christopher GOSNELL, Principles of evidence in international criminal justice, Oxford University Press, 2010.
19. Marek Antoni NOWICKI, Rreth Konventës Europiane- Komentar i shkurtër mbi Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, Botim i Qendrës Shqiptare Për të Drejtat e Njeriut, përkth. në shqip nga Edlira Llohja, Botimet Morava, Tiranë. 2003.
20. M.Tutulani-Semini, E Drejta e deyrimeve dhe e kontratave, Pjesa e Përgjithshme, Scanderbeg books, 2006

21. Michèle-Laure RASSAT, Procédure pénale, Deuxième édition refondue, PUF, Paris 1995.
22. Monica MACOVEI, E Drejta për lirinë dhe sigurinë e personit- Një udhëzues për zbatimin e nenit 5 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Këshilli i Europës, 2002, Ribotim nëntor, 2005, Gjermani.
23. Paul ROBERTS and Adrian ZUCKERMAN, Criminal Evidence, Oxford University Press, second edition, 2010.
24. Peter MURPHY, Murphy për provën, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010.
25. Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, Udhëzues për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, Usaid, Paca, Opdat, Shkolla e Magjistraturës, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010.
26. Sanford H. KADISH, Stephen J. SCHULHOFER, Criminal Law and its Processes. Cases and materials, Fifth Edition, Little-Brown and Company, Boston, Toronto, London, 1989.
27. Dr. Sadushi S., "E drejta administrative 2", shtëpia botuese "Grand Prind", Tiranë, Shtator 2008

Artikuj shkencorë

1. Adnor SHAMETI, "Liria dhe siguria e personit, arresti dhe ndalimi", Jeta Juridike, Shkolla e Magjistraturës, nr. 4 2006, Tiranë, dhjetor 2006.
2. Alma KODRALIU, E drejta për liri dhe siguri, Tribunë Juridike nr. 67(4), viti XI I botimit 2007.
3. Ma.Amarildo LAÇI, "Mbi parimin e prezumimit të pafajësisë", Jeta Juridike, nr. 4, Viti XI i botimit, Tiranë dhjetor 2011.
4. Andi Duraj, Roli i gjykatës në fazat që paraprijnë gjykimin e themeli në procediminn penal, Disertacion, UET, Tiranë, Janar 2021
5. Antonio LARONGA, "Le misure precautelari: aspetti problematici, Il sistema cautelare personale", Roma, 14–16 Korrik 2008, Consiglio Superiore Della Magistratura, Ufficio per gli Incontri di Studio.
6. Arbër Basholli, Disertacion, Bashkëpunimi i personave në kryerjen e veprës penale, Tiranë, 2018
7. Arben SHEHU, "Përgjimet si mjet i kërkimit të provës", Revista Studime Juridike Nr.1, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, Tiranë dhjetor 2010.
8. Artur SELMANI, "Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së paligjshme në Shqipëri, në perspektivën e bashkëpunimit ndërkombëtar", botuar në Manualin "Itali – Shqipëri, Instrumente Ligjorë dhe Teknika të Luftës Kundër Krimit të Organizuar Transnacional Përballje Përvojash", Botim i Institutit të Kombeve të Bashkuara për Kërkimin mbi Krimin dhe Drejtësinë Penale (UNICRI), Tiranë 2007.
9. Carlo Pecoraro, Disertacion, Le presunzioni nel diritto penale, 2007-2008, Scuola Dottorale Internazionale di diritto ed economia "Tullio Ascarelli"
10. Charles W. Collier, The Improper Use of Presumptions in Recent Criminal Law Adjudication, 38 Stan. L. Rev. 423 (1986)
11. Christian DIESEN, "Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases", Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009.
12. Coppolo, G., Citizen's Arrest-Standards, 1998

13. Despina Kyprianou, The role of the Cyprus attorney general's office in prosecutions: rhetoric, ideology and practice, University of London, Dhjetor 2006
14. Elies Van Sliedregt, «A Contemporary Reflection on the Presumption of Innocence», Revue internationale de droit pénal 2009/1 (Vol. 80)
15. Elvis Zaimi, Disa aspekte juridike dhe kriminologjike që lindin nga domosdoshmëria e funksionalizimit të legjislacionit kundër pastrimit të parave
16. Ferdinand ELEZI, "Prova Penale dhe Procesi i të Provuarit", Doktoraturë, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë 2012.
17. Francesco Caporotundo, Presunzioni legali e onere della prova nel processo penale
18. Francesco Caporotundo, Musica nei locali notturni e disturbo della "quiete pubblica": quando si configura il reato, Archivio Penale 2017, nr. 2
19. Gerald H. Abrams, Statutory Presumptions and the Federal Criminal Law: A Suggested Analysis, 22 Vanderbilt Law Review 1135 (1969)
20. Hamer, David. (2014). Presumptions, standards and burdens: Managing the cost of error. Law, Probability and Risk
21. Henrik LIGORI, "Për të vërtetën në procesin penal", Tribunë Juridike nr. 63, Viti 2007.
22. Izet HOXHA, "Arrestimi me dyshime i hap rrugë veprimeve arbitrare", Tribunë Juridike nr. 27, Viti i IV i botimit, 2000.
23. Izet HOXHA, "Bazat për marrjen e një personi në përgjegjësi penale", Tribunë Juridike Nr.21, Viti i III i botimit, 1998.
24. Izet HOXHA, "Çmimi i provave dhe bindja e brendshme", Drejtësia Popullore nr. 2, mars-prill 1969.
25. James T. Ranney, Presumptions in Criminal Cases: A Neë Look at an Old Problem, 41 Mont. L. Rev. (1980)
26. Jeremy Cooper, The burden and the standard of proof
27. Julia Sarno, Reati di pericolo presunto: la linea sottile tra legittimità e illegittimità costituzionale, 8 Shkurt 2021
28. Leo H. Whinery, *Presumptions and Their Effect*, 54 OKLA. L. REV. 553 (2001)
29. Leslie J. Harris, Constitutional Limits on Criminal Presumptions As an Expression of Changing Concepts of Fundamental Fairness, 77 J. Crim. L. & Criminology 308 (1986)
30. Luca Carboni, 'La valutazione probatoria del silenzio: critiche e prospettive' (2018) 5 Processo Penale e Giustizia
31. Luigi VIOLA, Più probabile che non VS prudente apprezzamento, Rivista scientifica di Diritto Processuale Civile, La Nuova Procedura Civile, 3, 2020, datë 08.09.2020
32. M.Andrea, Y.Pjetërnikaj, Disa aspekte teoriko-praktike të figurës së vepres penale të "Pastrimit të produkteve të vepres penale", Jeta Juridike Nr.1 Viti 2016, Shkolla e Magjistraturës
33. Memo ligjore, "Ankimi gjyqësor ndaj vendimit të mosfillimit/pushimit të çështjes dhe fillimi/rifillimi i hetimeve nga prokurori", hartuar nga Flojera Davidhi, Elsa Ulliri, Armanda Xhaferri, 17 korrik 2013
34. Murat Hulaj, Disertacion, Aspekte juridike krahasuese lidhur me fillimin apo me mosfillimin e procedimit penal Kosovë-Shqipëri, UET, Tiranë, Dhjetor 2016
35. Olgert Rumnici, Standardi i të provuarit në procesin penal dhe praktika gjyqësore, Temë diplome, Shkolla e Magjistraturës, Korrik 2013

36. Olgert Rumnici, pjesë e cituar nga shkrimi "Arrestimi në flagrancë i kryer nga policia gjyqësore dhe citizen's arrest", revista BJIR, shtator 2022
37. Orazio LONGO, "L'oltre ogni ragionevole dubbio come regola di giudizio", 9 Gusht 2009.
38. Paolo Franceschetti, Reato, 13.01.2017
39. Ronald J. Allen, Burdens of proof, *Law, Probability and Risk*, Volume 13, Issue 3-4, September–December 2014
40. Sinan BABOÇI, "Kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore, nr.2, Prill-Qershor, viti 1979.
41. Sotiraq Nushi, "Shoqërimi i personave në zyrat e Policisë së Shtetit", Tribunë Juridike nr.1, viti 2009, Luarasi University Press.
42. Spiro SPIRO, "Disa çështje të rregullimit juridik dhe zbatimit në praktikë të masës së ndalimit", Drejtësia Popullore, nr. 4, Viti 1983.
43. Sokol Pina, "Konkurrimi i veprave penale. Probleme të praktikës gjyqësore në lidhje me të". Temë diplome- Shkolla e Magjistraturës, korrik 2013
44. Shari L. Jacobson, Mandatory and Permissive Presumptions in Criminal Cases: The Morass Created by Allen, 42 U. Miami L. Rev. 1009 (1988)
45. Teodor Mosko, Florian KOLANECI, "Kriteret dhe kushtet ligjore për zbatimin e masës së ndalimit sipas Kodit të ri të Procedurës Penale dhe kontrolli i prokurorit mbi ndalimet", Drejtësia Popullore, nr. 4, Tetor-Dhjetor, Viti 1980.
46. Urjana Çuri, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare.Ndikimi i instrumenteve ligjore të BE-së dhe të akteve ndërkombëtare në legjislacionin e brendshëm që rregullon këtë të drejtë. Disertacion për mbrojtjen e gradës shkencore "doktor", Tiranë 2018
47. Robbins, Ira P. (2016) "Vilifying the Vigilante: A Narrowed Scope of Citizen's Arrest," *Cornell Journal of Law and Public Policy*: Vol. 25 : Iss. 3 , Article 1
48. Schëeizer, Mark, The Civil Standard of Proof – What is it, Actually? (August 1, 2013). MPI Collective Goods Preprint, No. 2013/12, International Journal of Evidence and Proof 2016, Volume: 20 Issue: 3, p. 217-234 (revised version)
49. Yvonne Daly, Anna Pivaty, Diletta Marchesi, Peggy ter Vrugt, Human Rights Protections in Draëing Inferences from Criminal Suspects' Silence, *Human Rights Law Review*, Volume 21, Issue 3, September 2021
50. Y.Pjetërnikaj, Provat në procesin civil, Disertacion, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, Qershor 2010
51. Wodage, W.Y. (2014) Burdens of proof, presumptions and standards of proof in criminal cases, Mizan Law Review, vol. 8, no.1, pp. 252-270. Addis Ababa: St. Mary's University

Leksione, raporte, analiza

1. FATF (2018), FATF President's paper: Anti-money laundering and counter terrorist financing for judges and prosecutors, FATF, Paris, France, 2018
2. Henrik LIGORI, "Provat dhe procedimi provues", Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012.
3. Henrik LIGORI, "Për ndryshime e plotësime në titullin VI- hetimet paraprake", Relacion, Komisioni për reformimin e Kodit të Procedurës Penale, Tiranë 2012.
4. Henrik Ligori, Koment mbi nenin 296 të KPrP

5. Ornela Naqellari, Koment mbi neni 291 të KPrP
6. OSBE, Analizë e sistemit të drejtësisë penale në Shqipëri – raporti i programit për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, Shtëpia Botuese Pegi, Tiranë, 2006.
7. OSBE, "Analizë e procedimeve të çështjeve penale në Apel në Republikën e Shqipërisë", Shtypi nga 'albPAPER', Tiranë, 2007.
8. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Studimeve, Kërkimeve ligjore dhe Integrimit, Studim i vendimeve penale të Gjykatës së Lartë.

Vendime të GJEDNJ

1. Gjednj, çështja *Zschüschen v. Belgium* (application no. 23572/07), vendimi datë 02.05.2017
2. Çështja *Fox, Campbell dhe Hartley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, *(Aplikimi nr. 12244/86; 12245/86; 12383/86)*, 30 gusht 1990.
3. Çështja *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, GJEDNJ (Aplikimi nr. 23458/02), 24 mars 2011.
4. Çështja *Barbera, Messegue, dhe Jabardo kundër Spanjës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10590/83), 6 dhjetor 1988.
5. Çështja *Funke kundër Francës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10828/84), 25 shkurt 1993.
6. Çështja *Salabiaku kundër Francës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 10519/83), 7 tetor 1988.
7. Çështja *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar,(*Aplikimi nr. 19955/05 and 15085/06*),* 23. 12.2008.
8. Çështja *Filips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, (Aplikimi nr. 41087/98), 5 korrik 2001.
9. Çështja *Geerings kundër Hollandës*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 30810/03), 1 mars 2007**.**
10. Çështja *Orr kundër Norvegjisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. *31283/04),* 15 maj 2008.
11. Çështja *Ringvold kundër Norvegjisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 34964/97*),* 11 maj 2003.
12. Çështja *Wloch kundër Polonisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 27785/95), 19 tetor 2001.
13. Çështja *Brogan dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar,* GJEDNJ, (Aplikimi nr. 11209/84; 11234/84; 11266/84; 11386/85), 29 Nëntor 1988.
14. Çështja *Murray dhe kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, (Aplikimi nr. 14310/88), 28 Tetor 1994.
15. Çështja *Butkevicius kundër Lituanisë*, GJEDNJ, (Aplikimi nr.48297/99), 26 Mars 2002,
16. Çështja *Sun kundër. Rusisë*, GJEDNJ (Aplikimi nr.31004/02), 05 Shkurt 2009.

Vendime të huaja.

1. Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, *In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970),*
   http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Winship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 10 Janar 2013.

2. Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, *Virgil.D 'Gus' Reichle et.al v. Steven Hoëards, 132 S.Ct. 2088 (2012)*, http://scholar.google.com./scholar_case?case=11818225453453399091&q=the+standard+of+probable+cause+for+arrest&hl=en&as_sdt=2003&as_ylo=2012, klikuar më datë 28 Maj 2013.
3. Gjykata e Lartë e SHBA-ve, Cheek v. United States, 498 U.S. 192 (1991)
4. Corte di Cassazione Penale n. 931/2012, sez. VI del 13/1/2012, http://www.personaedanno.it/attachments/article/37640/931.2012.pdf, klikuar më datë 12 Prill 2013.
5. Corte di Cassazione Penale n. 30328/2002, Sezioni Unite Penali, 11/09/2002, http://www.altalex.com/index.php?idnot=5256, klikuar më datë 10 Prill 2013.
6. Gjykata e Kasacionit në Itali, 18 Shtator 2020, n.2568
7. Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Italisë nr. 364, datë 24 Mars 1988

Vendime të Gjykatës Kushtetuese

1. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 7, datë 02.03.2018
2. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 19, datë 02.04.2012.
3. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 57, datë 21.12.2011.
4. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 7.11.2011.
5. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.28, datë 23.06.2011.
6. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 23.02.2011.
7. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.23, datë 17.05.2010.
8. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 23, datë 23.07.2009.
9. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 15.06.2009.
10. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 18.09.2008;
11. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 12, datë 02.04.2008.
12. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.33, datë 08.12.2005.
13. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.7, datë 27.04.2005.
14. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 28.04.2004.
15. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.19, datë 12.06.2003.
16. Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.95, datë 27.07.2001.

Vendime Unifikuese të Gjykatës së Lartë.

1. Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011.
2. Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 25.01.2007.
3. Vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 5, datë 11.11.2003
4. Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 3, datë 27.09.2002.
5. Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 12.03.2002
6. Vendim Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 284, datë 06.10.2000.
7. Vendimi Unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 6, datë 30.09.2011

Vendime të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

1. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-121 (37), datë 28.01.2022
2. Vendim i Gjykatës së Lartë nr.00-2022- 1189, datë 29.09.2022
3. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-978 (215), datë 26.07.2022
4. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 00-2022-413 (74), datë 01.03.2022
5. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-1086, datë 23.12.2021

6. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 17, datë 15.07.2021
7. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr. 00–2021-706, datë 10.05.2021
8. Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 00-2021-128, datë 05.02.2021
9. Vendimi i Gjykatës së Lartë Nr. 00-2016-2207 (229), datë 15.12.2016
10. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë Nr.153, datë 11.05.2016
11. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 48, datë 24.02.2014
12. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 53, datë 18.02.2013.
13. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 97, datë 20.03.2013.
14. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 31, datë 31.01.2013.
15. Vendimi nr. 222, datë 12.09.2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë
16. Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 327, datë 05.12.2012
17. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 201, datë 05.07.2012.

18. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 235, datë 19.09.2012.
19. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 224, datë 12.09.2012.
20. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 204, datë 11.07.2012.
21. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 292, datë 07.11.2012.
22. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 257, datë 10.10.2012.

23. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 185, datë 28.06.2012.
24. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 209, datë 11.07.2012.
25. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 254, datë 10.10.2012.
26. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 154, datë 30.05.2012.
27. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 131, datë 09.05.2012.
28. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 84, datë 21.03.2012.
29. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 69, datë 29.02.2012.
30. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 244, datë 26.09.2012.
31. Vendim i Kolegjit Penal te Gjykatës së Lartë nr. 90, datë 29.06.2011.
32. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 129, datë 12.10.2011.
33. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 126, datë 06.10.2011.
34. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 1, datë 10.01.2011.
35. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 1031, datë 07.12.2010.
36. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr.370 datë 05.10.2010
37. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 855, datë 06.10.2010.
38. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.nr. 33, datë 13.10.2010.
39. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 348 datë 14.09.2010
40. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.21, datë 09.07.2010.
41. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 775, datë 14.07.2010.
42. Vendim i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, nr. 153, datë 01.04.2010
43. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 715, datë 16.12.2009.
44. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 698, datë 09.12.2009.
45. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 394, datë 08.07.2009.
46. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. nr. 137, datë 27.05.2009.
47. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.nr.52 datë 04.03.2009.
48. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.49 datë 25.02.2009.
49. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.311 datë 19.12.2008.
50. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 280, datë 04.06.2008
51. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 240, datë 28.05.2008
52. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 184, datë 9.04.2008
53. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 114, datë 28.05.2008.

54. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 67, datë 16.04.2008.

55. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 29, datë 13.02.2008.
56. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 291, datë 15.03.2007.
57. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 20, datë 16.03.2007.
58. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 64, datë 07.07.2006.
59. Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 876, datë 21.12.2005.
60. Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 65, datë 30 Janar 2002

Vendime të gjykatave të shkallës së parë dhe të Apelit.

1. Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 5410/211 Akti, datë 24.01.2020
2. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. 330 Akti, datë 12.02.2015 "(Për pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese)"
3. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 653, datë 23.12.2011.
4. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 658, datë 27.12.2011.

5. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 649, datë 21.12.2011.

6. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 647, datë 21.12.2011.

7. Vendim i Gjykatës së Apelit Tiranë nr. 646, datë 21.12.2011.

8. Vendim i Gjykatës së Apelit Durrës nr.296, datë 09.12.2010.

9. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 423, datë 10.04.2013.
10. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 143, datë 18.02.2013.
11. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 12 Akti, datë 06.01.2013.
12. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 3 Akti, datë 04.01.2013.
13. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 523 Akti, datë 05.05.2012.
14. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 524 Akti, datë 05.05.2012.
15. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 808, datë 1.05.2012.
16. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.Akti 1390, datë 05.10.2012
17. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 1474, datë 24.10.2012.
18. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 939, datë 28.05.2012.
19. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. Akti 1768, datë 26.12.2012.
20. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë nr. 50, datë 07.04.2011.
21. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. nr. 36, datë 9.06.2011.

22. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. 17, datë 17.01.2012.

23. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr. 139, datë 23.03.2010.

24. Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan nr.688, datë 15.11.2010.

Burimet normative dhe opinione

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

3. Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike
4. Kodi Penal
5. Kodi i Procedurës Penale
6. Ligji nr.10192 datë 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë".
7. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare Penale.
8. Direktiva nr.343/2016 e Parlamentit Europian dhe Këshillit, e datës 9 mars 2016
9. Opinioni i Këshilli Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë nr. 12 (2009) "Për marrëdhëniet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në një shoqëri demokratike".

Faqe web-i dhe fjalorë

1. http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Winship&hl=en&as_sdt=2003.
2. http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf
3. http://www.filodiritto.com/index.php?azione=visualizza&iddoc=1564
4. http://faculty.law.ubc.ca/wexler/pdf/legal%20proof.pdf
5. http://www.brocardi.it/articoli/5429.html
6. http://ark.cdlib.org/ark:/13030/ft409nb30v/
7. http://digitalcommons.law.yale.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1000&context=fss_papers&seiredir=1&referer=http%3A%2F%2Fwww.google.co.uk%2Furl%3Fsa%3Dt%26rct%3Dj%26q%3Dreasonable%2520doubt%2520essay%26source%3Dëeb%26cd%3D7%26ved%3D0CFQQFjAG%26url%3Dhttp%253A%252F%252Fdigitalcommons.law.yale.edu%252Fcgi%252Fviewcontent.cgi%253Farticle%253D1000%2526context%253Dfss_papers%26ei%3DJhcDUaGlFITctAalzIDYBA%26usg%3DAFQjCNFm7qM4m0qa2kPyY7Kn6uKmJ7hSBw#search=%22reasonable%20doubt%20essay%22
8. http://www.perrupato.it
9. http://www.gjk.gov.al
10. http://www.gjykataelarte.gov.al
11. http://www.gjykatatirana.gov.al
12. http://www.altalex.com
13. http://www.personaedanno.it
14. http://livingfreeandclear.com/downloads/files/Black'sLaw4th.pdf
15. Dizionario giuridico romano, Edizioni Simone, IV Edizione, 2006
16. Fjalori i Gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Botim i dytë i ripunuar, me rreth 35 000 fjalë, Botimet Toena, Tiranë, 2002
17. Henry Campbell Black, M.A., Black's Law Dictionary, revised fourth edition, St.Paul.Minn, West Publishing Co, 1968
18. https://doi.org/10.1093/hrlr/ngab006
19. www.processopenaleegiustizia.it/valutazione-probatoria-del-silenzio-critiche-e-prospettive
20. https://arcadia.sba.uniroma3.it/bitstream/2307/681/1/Lepresunzioninel dirittopenale.pdf
21. https://www.academia.edu/36733161/Pastrimi_i_parave_Artikulli_Luarasi_1
22. www.fatfgafi.org/publications/methodandtrends/documents/AML-CFT-judges-prosecutors.html
23. https://www.giurisprudenzapenale.com/wpcontent/uploads/2017/01/caporotundo_gp_2017_1.pdf

24. https://www.altalex.com/documents/altalexpedia/2017/01/12/reato#Toc471986579
25. https://dizionari.simone.it/1/offensivita
26. http://www.salvisjuribus.it/reati-di-pericolo-presunto-la-linea-sottile-tra-legittimita-e-illegittimita-costituzionale/
27. https://archiviopenale.it/File/DownloadArticolo?codice=e0d88931-b21a-4b66-bd21-00a77d1a8f06&idarticolo=15198
28. https://scholarworks.umt.edu/mlr/vol41/iss1/2
29. https://digitalcommons.Law.ou.edu/olr/vol54/iss3/5
30. https://repository.Law.miami.edu/umlr/vol42/iss4/7
31. http://scholarship.Law.ufl.edu/facultypub/664
32. https://scholarlycommons.Law.northwestern.edu/jclc
33. https://www.cairn-int.info/journal-revue-internationale-de-droit-penal-2009-1-page-247.htm?WT.tsrc=pdf
34. https://scholarship.Law.vanderbilt.edu/vlr/vol22/iss5/5
35. https://doi.org/10.1093/lpr/mgu005
36. https://www.cga.ct.gov/PS98/rpt%5Colr%5Chtm/98-R-0959.htm
37. https://scholarship.law.cornell.edu/cjlpp/vol25/iss3/1/
38. http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/291
39. https://www.lanuovaproceduracivile.com/wpcontent/uploads/2020/09/violaPRUDENZA.pdf
40. https://ssrn.com/abstract=2311210 or http://dx.doi.org/10.2139/ssrn.2311210 https://www.judiciary.uk/wp-content/uploads/2016/01/cooper-burden-standard-of-proof-spring2008.pdf
41. https://dspace.aab-edu.net/bitstream/handle/123456789/675/07bdd401-52aa-4028-b278-f8acc3de8d81.pptx?sequence=3&isAllowed=y